

# ENVER HOXHA

VEPRA

53



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

53

KORRIK 1974 – DHJETOR 1974

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1987



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 53-TË

Vëllimi i 53-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës korrik-dhjetor 1974, një pjesë e të cilave botohen për herë të parë. Kjo është periudha e analizës, në Parti dhe në ushtri, e demaskimit dhe e likuidimit të veprimtarisë armiqësore të zhvilluar në kokë të ushtrisë dhe prapa krahëve të Partisë nga grupi puçist i Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos.

Në fjalimet e mbajtura në mbyllje të plenumeve të 5-të dhe të 6-të të Komitetit Qendror, në disa diskutime në forumet udhëheqëse të Partisë, në fjalën e mbajtur para kuadrove të ushtrisë më 14 tetor, që përfshihen në këtë vëllim, spikatin qartë edhe një herë pjekuria dhe mençuria e Partisë dhe e shokut Enver Hoxha për t'i kapur drejt dhe shpejt problemet, për t'u orientuar e thelluar në to, për t'i shtruar e gjykuar çështjet objektivisht dhe me zemër partie, për të konkluduar e për të nxjerrë mësimë revolucionare.

Metoda dialektike e lidhjes dhe e ballafaqimit të fakteve dhe të argumenteve, taktika e matur që përdori Komiteti Qendror me shokun Enver Hoxha në krye, duke ia nënshtruar këtë veprimtari gjykimit të komunistëve në ushtri, gjithë Partisë, për të bërë lidhjen e hallkave të zinxhirit të punës armiqësore e për të plotësuar tablonë e saj, zbuluan qëllimet armiqësore, drej-

timet, taktikat, format e punës dhe rrezikshmërinë e këtij grupi tradhtar. Në bazë të fakteve e të dokumenteve u vërtetuan plotësisht qëllimi i këtij grupi për të shkatërruar me grusht shteti Komitetin Qendror të Partisë dhe Qeverinë, për të vendosur një rend borqjezo-revizionist, si dhe lidhjet e bashkëpunimi me armiqtë e jashtëm. Siç del në këto dokumente, goditja kryesore e veprimtarisë armiqësore puçiste të grupit të Beqir Ballukut ishte dobësimi dhe asgjësimi i rolit udhëheqës të Partisë në ushtri dhe i karakterit revolucionar popullor të saj, kthimi i Ushtrisë sonë Popullore në një ushtri kazerme, të përshtatshme për komplete e puçe, sabotimi i direktivës së Partisë për armatosjen dhe përgatitjen e mbarë popullit për mbrojtje.

Në materialet e këtij vëllimi pasqyrohen mendimi thellësisht marksist-leninist dhe logjika e fortë e shokut Enver Hoxha për të zbuluar veprimtarinë armiqësore të rrezikshme në ushtri. Në to shohim se si kalohet nga analiza dhe gjykimimi i thellë i fakteve, i veprimeve dhe i ngjarjeve në nxjerrjen e përfundimeve dhe në përgjithësime për të zbuluar rrënjët, objektivat dhe format e kësaj veprimtarie. Shoku Enver Hoxha, me argumente të pakundërshtueshme, zbulon dhe demaskon pjesëtarët e këtij komploti, lidhjet e tyre agjenturore me armiqtë e jashtëm, si dhe lidhjet e këtij grupi me veprimtarinë armiqësore të F. Paçramit e T. Lubonjës në fushën e kulturës e të artit. Qysh në mbledhjen e Byrosë Politike të datës 2 dhe 3 korrik 1974, shoku Enver Hoxha tërhiqte vëmendjen se Beqir Balluku me të tjerë «përpiqen të bëjnë kështu një riorganizim jo vetëm të ushtrisë, por edhe të shtetit, për të penguar ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Ky është fillimi,

pse sikur ata t'ia arrinin kësaj, sikur ne të kishim pranuar tezat që na paraqitin këta, atëherë gjërat do të vinin zinxhir njëra pas tjetrës, posaçërisht dhe veçanërisht deri në superstrukturë, pse çdo gjë në vendin tonë u duhej përshtatur këtyre «direktivave»... kësaj i thonë thjesht t'i vësh kazmën socializmit». Siç do të vërtohej më vonë, veprimtaria e grupit puçist në ushtri ishte pjesë përbërëse e komplotit të madh e të rrezikshëm, koka e të cilit ishte superagjenti dhe armiku i vjetër e i kamufluar i Partisë dhe i popullit, Mehmet Shehu, i cili lëvizte në prapaskenë fijet e komplotit.

Masat që mori Partia në zbatim të porosive e të detyrave që përcaktuan Plenumi i 5-të dhe i 6-të i Komitetit Qendror dhe të mësimëve të shokut Enver Hoxha, synonin pastrimin e frymës së sëmurë në ushtri dhe shëndoshjen e gjendjes, edukimin e forcimin e kësaj arme besnike të diktaturës së proletariatit, forcimin e mëtejshëm të gatishmërisë luftarake dhe të mbrojtjes së atdheut.

Përballimi me sukses i gjendjes që u krijua shtronte me forcë rritjen e rolit udhëheqës të Partisë në ushtri e në terren, forcimin e vigjilencës revolucionare, kuptimin dhe zhvillimin me vendosmëri të luftës së klasave, zbatimin me konsekuencë të parimeve e të normave të Partisë, të mësimëve, orientimeve e direktivave të saj. Shoku Enver Hoxha porosiste t'i kushtojë vëmendje dhe kujdes i veçantë forcimit të unitetit Parti-popull, punës me njerëzit, edukimit komunist të punonjësve.

Në dokumentet e vëllimit trajtohen edhe probleme ekonomike të kohës. Në to ngrihet nevoja e kuptimit dhe e zbatimit me konsekuencë të parimit të mbështetjes në forcat e veta, domosdoshmëria për të punuar me

të gjitha forcat për realizimin e detyrave të planit pesëvjeçar, duke zbuluar dhe shfrytëzuar forcat dhe mundësitë e brendshme të vendit.

Me interes në këtë vëllim është edhe analiza që i bëhet gjendjes ndërkombëtare. Me vlera të padiskutueshme është fjala e mbajtur para zgjedhësve më 3 tetor «Politika jonë është e hapur, është politike e parimeve proletare». Ky dokument përbën një sintezë të politikës së jashtme të pavarur e konstruktive, thellësisht parimore të Partisë dhe të shtetit tonë, si politike e një vendi socialist, ku në fuqi është diktatura e proletariatit që udhëhiqet nga Partia e Punës dhe frymëzohet e i qëndron besnike doktrinës së Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Si e tillë, për të është e huaj politika e koniunkturave, diplomacia e fshehtë e kulisave, e tratativave misterioze dhe e shitjes në ankand të interesave të vendit të vet dhe të vendeve të tjera, është krejtësisht e papranueshme dhe e dënueshme politika e njëqind flaurëve. Mbi këtë bazë i ka ndërtuar e i ndërton vendi ynë marrëdhëniet e tij me fqinjët e me shtetet e tjera dhe këtu e ka burimin e vet prestigji ndërkombëtar që gëzojnë sot në botë Partia e Punës dhe Shqipëria socialiste.

Në këtë dokument si dhe në bisedat me të huajt, që përfshihen në këtë vëllim, mbështeten dhe përkrahen me të gjitha forcat proletariati dhe gjithë popujt që luftojnë kundër të dyja superfuqive, kundër borgjezisë kapitaliste e revizioniste. Dy superfuqitë, SHBA dhe BS, konsiderohen si fuqitë më të mëdha agresore, shkaktare të tensionit, të konflikteve e të vatrave të luftës në botë, si armiqtë më të egër të lirisë e të pavarësisë së popujve dhe të vendeve të tjera. Në të njëjtën kohë demasko-

hen tradhtia e revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye, roli i tyre kundërrevolucionar në lëvizjen komuniste botërore, taktikat e mjetet djallëzore që përdorin ata për minimin e saj dhe theksohet domosdoshmëria e forcimit të unitetit të radhëve të lëvizjes marksiste-leniniste, si kusht i domosdoshëm në luftën për fitoren e revolucionit në botë.

Si gjithë veprat që na la trashëgim udhëheqësi ynë i paharruar, shoku Enver Hoxha, edhe ky vëllim, për vlerat e mëdha me rëndësi teorike e praktike që përmban, do t'i shërbejë edukimit ideopolitik dhe mobilizimit të komunistëve, kuadrove dhe gjithë masave punonjëse në luftën dhe në punën e përditshme për t'i bërë realitet orientimet e direktivat e Partisë sonë dhe mësimet e çmuara të udhëheqësit të madh e të paharruar, shokut Enver Hoxha.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



## VEPRINTARI E RREZIKSHME DHE ARMIQËSORE E BEQIR BALLUKUT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

2—3 korrik 1974

*Kjo mbledhje zgjati dy ditë. Byroja Politike e Komitetit Qendror diskutoi gjallërisht rreth materialit «Mbi disa çështje të rëndësishme në lidhje me gjendjen në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore». Duke hapur mbledhjen, shoku Enver Hoxha tha:*

Këtë mbledhje të Byrosë Politike po e bëjmë posaçërisht për të shqyrtuar disa probleme shumë të rëndësishme për fatet e atdheut, që kanë të bëjnë me vijën e Partisë në ushtri. Siç e keni parë në materialin që ju kemi dërguar, një nga çështjet ku viheshim në korent është se në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore ishte diskutuar një problem organizativ në lidhje me strukturën e udhëheqjes së ministrisë. Për këtë problem kjo udhëheqje ishte ndarë më dysh, një pjesë kishte një mendim, pala tjetër mendonte ndryshe. Të them të drejtën, sa e lexova këtë raport të Drejtorisë Politike, u revoltova, pse aty lihej të kuptohej sikur gjoja çështja shtrohej në formën e një diskutimi akademik për

të mirën e punës, ndërsa unë mendova se këtu fshiheshin çështje të tjera jo me qëllime të mira.

Mirëpo këto çështje kaq kritike dhe të rrezikshme, siç e patë në material, dolën më vonë, në mbledhjen për konsultim që bëri shoku Hysni me një tjetër, me tre kuadrot kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes, shokët Beqir, Petrit dhe Hito. Në atë mbledhje Beqiri, tërë nervozizëm dhe i revoltuar, i ra tavolinës me grusht dhe kërkoi nga shoku Hysni që Komiteti Qendror i Partisë t'u vejë deri në fund këtyre çështjeve. Prandaj sot ne po ia plotësojmë atij këtë dëshirë. Por veç, tashmë, kjo nuk është vetëm dëshira e shokut Beqir, në radhë të parë kjo është dëshira e Byrosë Politike, e cila është ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë të mbrojë vijën marksiste-leniniste në të gjitha drejtimet dhe posaçërisht për këtë problem kaq jetik, siç është mbrojtja e vijës marksiste-leniniste në ushtrinë tonë.

Prandaj, shokë, diskutimi që do të bëjmë në këtë mbledhje të Byrosë Politike, ka një vlerë të rëndësishme. Për këtë arsye unë kërkoj nga shokët, në radhë të parë nga shokët Beqir, Petrit dhe Hito që të tregohen në lartësinë e duhur të udhëheqësve, jo për t'i ngrënë kohë Byrosë Politike, por për ta sqaruar atë plotësisht dhe në mënyrë të sinqertë. Është detyrë t'i kursehen udhëheqjes pyetjet, t'u dilet përpara këtyre, të flitet këtu hapur çdo gjë, duke u bazuar fort në normat marksiste-leniniste të Partisë. Të gjithë e dimë se udhëheqja e Partisë, gjatë gjithë jetës së saj, ka ndeshur herë pas here në veprime të gabuara, bile shumë herë edhe armiqësore, por të gjitha këto ajo i ka studiuar me shumë kujdes e vëmendje të madhe, i ka gjykuar me



pjekuri, pa gjaknxehtësi dhe vetëm pastaj ka vendosur me përgjegjësi e drejtësi marksiste-leniniste.

Këta shokë, të cilëve sot u kërkojmë të na japin sqarime, e njohin mirë vijën e drejtë të Partisë, njohin normat e saj, ata kanë, gjithashtu, të qartë dashurinë e madhe dhe respektin që ushqejnë shokët e udhëheqjes për njëri-tjetrin, natyrisht, gjersa këta qëndrojnë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Ata, gjithashtu, njohin edhe papërkulshmërinë dhe rreptësinë e udhëheqjes së Partisë, kur është çështja për të mbrojtur interesat e popullit, të atdheut dhe të Partisë. E kam çështjen që në ekspozenë tuaj, shokë, ju të tre, të jeni sa më të qartë e të shpjegueshëm, të flisni si komunistë, që edhe neve të na jepet mundësia të gjykojmë me objektivitet e me pjekuri dhe të marrim vendimet më të përshtatshme në interes të mbrojtjes së vijës së Partisë, me qëllim që, në radhë të parë, ushtrinë, si kurdoherë, ta kemi dhe ta bëjmë me të vërtetë gjithnjë e më të fortë, të çeliktë, ashtu siç e duan populli dhe Partia.

Meqenëse çështja është për një problem të një rëndësie shumë të madhe, unë mendoj të mos jemi të shtrënguar për sa i përket zgjatjes së kohës së diskutimeve, shokët le të shfaqin lirisht të tëra pikëpamjet dhe çështjet që mendojnë të trajtojnë dhe për aq kohë sa do të dëshirojnë.

Prandaj le të fillojmë.

Mendoj që në fillim ta marrë fjalën shoku Beqir, të flasim edhe shokët Petrit e Hito, pastaj të themi ne të tjerët pikëpamjen tonë.

*Që në fillim të diskutimit të tij, Beqir Balluku u përpoq të mos i thotë Byrosë Politike të vërtetën për dobësitë që viheshin re në zbatimin e vijës ushtarake*

të Partisë, për qëllimet e antitezave që ishin përgatitur fsheturazi Komitetit Qendror të Partisë, kundër Tezave të Këshillit të Mbrojtjes etj. Për këto arsye, shokët e Byrosë Politike u përpoqën ta ndihmojnë atë me pyetje e këshilla, që ai t'i hapej Partisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtu jemi në Byronë Politike, shokë, këto që po diskutojmë janë probleme shumë delikate, kanë të bëjnë me çështje ushtarake, me taktikën dhe me strategjinë tonë, prandaj duhet të mbahen shumë konspirative.

Pikëpamja e udhëheqjes së Partisë sonë dihet, por ti u trego një çikë shokëve të Byrosë Politike cilat kanë qenë mendimet e udhëheqjes kineze që të kanë propozuar ty?<sup>1</sup> Gjithashtu në këtë çështje na fol shkurtimisht, se materiali është i gjerë, çfarë rekomandojnë tezat e ushtrisë së sotme sovjetike të drejtuara nga revizionistët në lidhje me antitezat tuaja. Kanë ato lidhje midis tyre apo s'kanë? Si konkluzion, me cilat ke qenë ti në fakt?

Diskutimi yt na lë ta kuptojmë këtë, por si komunist na e thuaj më qartë që të gjykojmë edhe ne e të ndihmojmë të shërohesh.

---

1. Siç u vërtetua më vonë, tradhtari Beqir Balluku kishte marrë porosi nga Çu En Lai e Mao Ce Duni të zbatonte në Shqipëri strategjinë dhe taktikën ushtarake të rrëshqitjes në male, të mosmbrojtjes pëllëmbë për pëllëmbë të tokës së atdheut tonë. Gjithashtu ata këshillonin të krijohet aleanca e Shqipërisë me Jugosllavinë e Rumaninë gjoja për t'u mbrojtur nga një sulm eventual i socialimperialistëve sovjetikë. Përveç këtyre, udhëheqja kineze, me qëllim që të dobësonte mbrojtjen e vendit tonë, kishte pikëpamjen që s'ka çfarë i duhen armët e rënda Shqipërisë, mjaftonin për të armët e lehta!

**BEQIR BALLUKU:** Për Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, unë kam kaluar një proces, gjatë të cilit janë rrenjosur disa koncepte, që kanë evoluar javash-javash... Këto koncepte kanë lindur tek unë pas Plenumit të 12-të të Komitetit Qendror<sup>1</sup>. Unë nuk them se edhe para këtij Plenumi nuk i kam pasur, por këto kanë evoluar dalngadalë.

Për pyetjen që m'u bë se «Përse nuk vura në dijeni Partinë për materialin që u kundërvihet Tezave të Këshillit të Mbrojtjes», dua të them se kjo ka ardhur nga budallallëku im.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Budallallëk është ky? Përkundrazi, është një aftësi e madhe të bësh teza, bile në kundërshtim me vijën e Partisë.

**HITO ÇAKO:** Qysh kur shoku Beqir Balluku ka marrë në dorë vërejtjet tona, pas materialit të parë, mua më ka thënë se ka biseduar me shokët e udhëheqjes, bile më ka thënë se ka biseduar me shokun Mehmet [Shehu] për çështjen e forcave bllokuese, frenuese etj.

**BEQIR BALLUKU:** Nuk është gjë kjo, unë kam pasur mendimin tim për çështjen e forcave bllokuese dhe frenuese<sup>2</sup>.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Thuaje copë, shoku Beqir, pse nuk ke besim në udhëheqjen e Partisë dhe në vijën e saj? E them këtë se kushdo që ka besim në udhëheqje, i thotë Partisë që unë kam menduar kështu ose ashtu.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të na thuash edhe atë

---

1. I zhvilloi punimet nga data 29 qershor deri më 1 korrik 1971.

2. Armiku Beqir Balluku merr në mbrojtje armikun o kamufluar Mehmet Shehu.

që ti hedh poshtë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, kur mendon që ne të shkojmë në luftë partizane jo që kur fillon lufta, por bile që tani, se trembesh, ke frikë nga bombat atomike dhe nga forca ushtarake sovjetike, e cila të paktën juve ju ka futur tmerrin. Gjithë thelbi është këtu. Bomba atomike, nuk ka diskutim, është një armë e tmerrshme, kjo nuk duhet nënvleftësuar, por kjo armë nuk duhet të na bëjë të trembemi e të dorëzohemi, përkundrazi, na bie detyrë të marrim të gjitha masat për t'iu kundërvënë kësaj arme shfarosëse. Ka mundësi një gjë e tillë? Po, patjetër, ka mundësi dhe rrugëdalje.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Siç doli këtu, të është sugjeruar disa herë të informosh udhëheqjen për mendimet që ke, kurse ti asnjëherë nuk e ke bërë këtë. Pse ky mosbesim nga ana jote te Partia?

*SHOKU MANUSH MYFTIU:* Të përdorësh metoda fshehur nga Partia nuk është një «budallallëk». Çështja është që «studimet» për të revizionuar Tezat ti u përpoqe t'i bëje gjatë një kohe trevjeçare dhe këtë duke mos e marrë vesh njeri fare, deri në një moment të caktuar. Nuk je i pari ti, shoku Beqir, që po bën një dava të tillë prapa shpinës së Partisë. Këtë ti e di mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Hallin Beqiri e kishte të bënte me vete edhe shumë kuadro nga të ushtrisë, për këtë ai nuk e informonte udhëheqjen.

*SHOKU MANUSH MYFTIU:* Ti, këtej përpunon teza themelore për mbrojtjen, këtej kërkon të japësh dorëheqjen se nuk je i aftë! Me këtë nuk na e mbush dot mendjen, shoku Beqir, këtu ka një kontradiktë në qëndrimet e tua.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Nga njëra anë, ai thotë se

është i paaftë, por, nga ana tjetër, përgatit edhe materiale për të përpunuar teza. Kjo që bëje ti, mos ishte një protestë që nuk ishte dakord me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe i thoshe me këtë udhëheqjes: «Bëj si të duash, unë po largohem»?

*SHOKU HYSNI KAPO:* Dy herë Beqiri më ka thënë mua për dorëheqjen e tij si ministër i Mbrojtjes, unë jam habitur, prandaj e kam këshilluar të shkojë e të bisedojë vetë me shokun Enver, dhe menjëherë e vura në dijeni shokun Enver. Këtu Beqiri ngriti çështjen se «tani ka kuadro të tjerë», por kjo s'është arsye. Në fakt ai ka arsye të tjera, diçka zien brenda në ndërgjegjen e tij.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Megjithëse shoku Hysni i tha dy herë të vinte tek unë për kërkesa të tilla dhe Beqiri i tha se do të vinte, në fakt, nuk erdhi. Më vonë, kur e thirra për punë, i tërhoqa vëmendjen, i kërkova arsyet pse nuk kishte ardhur, ç'ishin këto kërkesa dhe ç'e ka shtyrë të kërkonte dorëheqje dhe të mos vinte tek unë. Mos vallë kishte frikë nga unë, se mos i hiqshin petët lakrorit?

*SHOKU RITA MARKO:* Nuk na sqarove, përse nuk i vlerësoje mendimet e kuadrove për materialet që u kundërvihen Tezave?

*BEQIR BALLUKU:* Nuk i kam parë mendimet e tyre.

*SHOKU ADIL ÇARÇANI:* I keni parë, qoftë edhe në qershor të 1974-ës. Po edhe më përpara përse jo? Si shpjegohet kjo? Ju ua keni dërguar materialin për të bërë vërejtje, ai ju kthehet prej tyre me vërejtje dhe këto ju nuk i paskeni parë. Nuk është kjo mospërfillje nga ana jote?

**SHOKU HAKI TOSKA:** Cilat janë ato gjëra «të këqija» në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, që të shtynë t'i viheshe punës për të bërë «teza» të tjera?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk të ka shkuar gjë në mendje ty, Beqir, që duke bërë këto përpjekje, kërkon të futësh pyka, të çara, në udhëheqjen e Partisë? Çfarë kam thënë unë në Plenumin e 12-të dhe çfarë thonë Tezat? Nuk ke menduar ndonjëherë që po të bëjmë kështu, krijojmë një çarje në udhëheqje? Kush është ai që e kërkon këtë çarje?

Ti the se nuk ke menduar, por në praktikë material që ke përgatitur synon për përçarje. Përveç kësaj, ky material shoqërohet edhe me «citate» të Enverit për t'iu kundërvënë Tezave. Kjo për ne është e qartë. Kurdoherë armiku ka synuar që të arrijë ta shpartalloyë udhëheqjen, që është aq jetike për Partinë dhe për popullin. Mos e ke dashur edhe ti këtë? Ti nuk je kalama në këto gjëra, ke eksperiencë.

*Me gjithë ndihmën që iu dha Beqir Ballukut me anë të pyetjeve e të ndërhyrjeve të shokëve të Byrosë Politike, ai nuk i tha gjërat me emrin e tyre të vërtetë. Pastaj u kalua në diskutime. Pasi folën shokët e Byrosë Politike, të cilët dënuan rreptë pikëpamjet dhe vepri-met e rrezikshme të Beqir Ballukut, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Më lejoni, shokë, të them edhe unë mendimin tim për këtë problem me rëndësi kaq të madhe që shtrohet përpara udhëheqjes së Partisë, Byrosë Politike të Komitetit Qendror.

Si gjithë shokët që diskutuan, edhe unë jam shumë dakord me materialin që na kanë dorëzuar shoku Hysni me shokët e ngarkuar. Ky është një dokument me rën-

dësi ideologjike, politike dhe ushtarake, i qartë dhe i bazuar mirë në teorinë tonë, njëkohësisht ai është objektiv dhe konkluzion i një studimi të shpejtë, por të vëmendshëm, të një numri materialesh voluminoze, të koklavitura dhe jashtëzakonisht të rrezikshme. Për këto arsye materiali që na kanë dhënë shokët ka një rëndësi shumë të madhe. Për këtë veprimtari të rrezikshme të Beqir Ballukut mendoj se duhet të vëmë në dijeni, në radhë të parë, anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë; pastaj kuadrot e ushtrisë dhe gjithë Partinë, natyrisht duke ngarkuar prapë për këtë punë shokët që janë marrë me të, për ta plotësuar si duhet më tej materialin e parë edhe me diskutimet jashtëzakonisht të vlefshme e me përmbajtje të thellë komuniste, bolshevike të të gjithë shokëve të udhëheqjes.

Çështja që po studiojmë, shokë, është rrjedhim i një pune armiqësore nga ana e Beqir Ballukut. Kështu mendojmë ta cilësojmë që në fillim veprimtarinë e tij. Natyrisht, si çdo veprim, edhe këtë që po analizojmë, ne e shohim, si kurdoherë, me syrin e marksist-leninistit, në prizmin e luftës së klasave, pra, drejt, objektivisht, nga pozita parimore dhe jo të shtyrë nga ndjenja të ulëta mikroborgjeze, personale, pasi vetëm nga lufta në pozita parimore varen ndërtimi me sukses i socializmit dhe mbrojtja e atdheut tonë socialist.

Partia kurdoherë na ka mësuar dhe na mëson që në të tilla raste fajesh të rënda për çështje të mëdha (por pa lënë pas dore të voglat, se edhe këto pastaj bëhen të mëdha), ne duhet të jemi vazhdimisht në luftë. Me këtë nuk dua të them që të dyshojmë për çdo gabim apo për disa gabime me radhë që pa qëllim mund të bëjë ndonjëri. Rëndësi ka që gabimet të zbulohen, të nji-

hen dhe të korrighohen, njëkohësisht të shikojmë nëse këto janë ose nuk janë të rrezikshme, kanë apo nuk kanë qëllime armiqësore. Neve, gjithashtu, nuk na lejohehet të flemë mendjen, duke u nisur nga pikëpamja jo e drejtë se gabime mund të bëjnë vetëm ata që janë ndën ne, kurse ne, këtu lart, nuk bëjmë gabime. Po të udhëhiqemi nga të tilla pikëpamje, atëherë do të dalim në rrugë shumë të gabuar, gjë që do të jetë keq për Partinë. Me këtë dua të them që kritikën dhe autokritikën e drejta, parimore dhe konstruktive që bëjmë, qofshin këto të buta, në formën e këshillave shoqërore, qofshin sipas shkallës së gabimit ose të fajit edhe të ashpra kur duhet të jenë të tilla, absolutisht duhet t'u bëhen të gjithë atyre që shmangen nga rruga e Partisë, sepse, pa përjashtim, të gjithë jemi njëlloj përgjegjës përpara Partisë dhe popullit.

Të jemi të ndërgjegjshëm, shokë, për atë që, në qoftë se kemi ardhur në disa vende në udhëheqje, këtu na ka sjellë Partia, vija e saj e drejtë dhe puna jonë, prandaj ky nuk është një privilegj, por një detyrë me përgjegjësi të madhe para Partisë dhe popullit. Prandaj dëshiroj të bëj të qartë se asnjërit nga ne të mos i rritet mendja për këtë dhe të mendojë se qenka kërthiza e botës. Përkundrazi, udhëheqësi në çdo kohë duhet të jetë i thjeshtë, jo vetëm në jetë dhe në veprimtarinë e vet të përditshme si udhëheqës partie, por në një shkallë më të gjerë edhe kur sektori i punës që drejton korr fitore sado të mëdha. Ne udhëheqësit, duhet të jemi të tillë, pse thjeshtësia është karakteristikë e njerëzve të pjekur dhe e trimave, ndërsa mburrjet dhe megalomania janë karakteristika të njerëzve të sëmurë, që përfitojnë nga situatat apo nga pozitat që u ka dhënë Partia



për t'ia hipur popullit dhe Partisë në zverk. Në goftë se lejojmë shfaqje të tilla, ne jo vetëm kemi thyer vijën e Partisë, po me këtë qëndrim i përgatitim varrin atdheut. Këto mësimë të mos i harrojmë, siç i ka harruar krejtësisht shoku Beqir Balluku.

Sikurse ju thashë në fillim, për shkak të kohës së shkurtër, unë nuk pata mundësi t'i lexoja dot të gjitha këto materiale voluminoze, por kam nxjerrë disa ekstrakte vetëm nga njëri prej këtyre materialeve, sa për të pasur një ide të përgjithshme mbi pikëpamjet e rrezikshme të hedhura në to dhe të bëra gjoja me qëllim studimi, por që në fakt janë në kundërshtim të plotë me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Në këtë material, që m'u dha më përpara, kam hedhur disa ide në formë shënimesh, prandaj le të më falin shokët meqenëse janë si të shkëputura. Më pas do të them edhe mendimin, do të bëj konkluzionin për këtë çështje, por për të gjithë ne është e qartë se autori kryesor i këtyre materialeve është Beqiri, ndërsa të tjerët, që ka aktivizuar ai, janë «shkrues».

Autorët e njërit prej materialeve që pata rastin ta lexoj, thonë që në hyrje sikur në vetë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, në shtrimin e formave dhe të mënyrave të zhvillimit të veprimeve luftarake, aty-këtu ka trajtime, të cilat nuk u përputhkan me kërkesat e parimeve dhe të koncepteve themelore të Artit tonë Ushtarak Popullor të shprehura në vetë Tezat dhe në fjalimin tim në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror. Kjo do të thotë se Beqiri me shokët e tij na propozojnë teza të tjera që «të përputhen me këtë art ushtarak». Me një fjalë, sipas tyre, ne, që kemi hartuar Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, qenkemi në kundërshtim me vetveten.

Kjo, shokë, jo vetëm është false, por njëkohësisht një denigrim flagrant dhe shumë i rëndë i udhëheqjes, natyrisht, i bërë me qëllim të keq.

«Mospërputhje» të ideve të fjalimit tim në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, siç përpiqen të thonë ata që kanë përgatitur këto materiale, janë për shembull, pranimi i kundërsulmeve dhe i kundërgoditjeve si forma më e lartë e aktivitetit mbrojtës, ndërtimi operativ dhe i formacioneve të luftimit të njëjësive e të reparteve, duke pasur, si rregull, forcat kryesore për mbrojtjen e brezave dhe të rajoneve të mbrojtjes dhe jo për zhvillimin e aktivitetit të mbrojtjes.

Sipas tyre, ne, pra, paskemi harruar zhvillimin e aktivitetit të mbrojtjes dhe çdo gjë e shikojmë në formë taktike. Mirë që na i kujtokan Beqiri me pasuesit e tij, se do të kishim rënë në greminë! Me këto pohime autorët përpiqen të na vënë në gojën tonë pikëpamjet e gabuar që kanë në kokën e vet, me një fjalë të na hedhin hi syve, duke u vënë në lëvizje me sulme e goditje çdo minutë, kudo dhe asgjëkundi. Por ne, more Beqir, këto figura metaforike nuk i hamë.

Koncepti ushtarak i Partisë sonë është se në ndërtimin e formacioneve luftarake të mbrojtjes duhet të kemi parasysh që përbërja dhe përqendrimi i grupimeve të caktuara për çdo drejtim duhet t'i përgjigjet idesë së luftimit dhe të bëjë të mundur zgjidhjen e detyrës luftarake në mënyrë të pavarur ose sa më të pavarur që të jetë e mundur... duke mbajtur parasysh që të mos i shkoqim forcat, të mos i shpërndajmë ato në mënyrë të barabartë në të gjithë frontin, t'u jepet thellësi

formacioneve luftarake dhe të mbahet një rezervë e fuqishme në dorë të komandës.

Të gjitha këto që përmenda janë aq të qarta dhe aq të drejta, saqë s'kanë nevojë për asnjë koment, pasi komenti mund ta bëjë idenë të errët. Të tilla komente përpiqen të bëjnë Beqiri me ca shokë me qëllim që të errësojnë atë që është e qartë. Mos duan vallë autorët që, duke përdorur thëniet e mia të drejta në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror, të maskojnë tezat e tyre të rrezikshme? Kjo kështu lë përshtypjen të duket, po këtë ne nuk e lejojmë ta bëjnë, se është mashtrim dhe jo vetëm një mashtrim, por unë jam dakord me atë që të gjithë shokët e Byrosë shprehën gjatë diskutimeve të tyre, se kjo është një orvatje e rrezikshme, është shprehje e mendimeve armiqësore që kanë për qëllim përçarjen e udhëheqjes së Partisë. Që kjo është kështu, do ta shpjegoj shkurt edhe më vonë, se si Beqiri për një problem tjetër, siç është ai i strukturës dhe i organizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, ka arritur ta çajë Komandën më dysh. Prandaj e them që tani se kjo ka qenë një orvatje tjetër nga ana e tij.

Tezat kanë përcaktuar drejt si mbrojtjen pozicionale, ashtu edhe kundërsulmet e kundërgoditjet. Antitezat e përpiluesve të materialit janë të dënueshme, sepse nxjerrin goditjet dhe sulmet si nga më kryesoret e fazës së lartë të luftimit, fazë të cilën në fakt ata nuk e pranojnë. Ata ushtrinë tonë moderne duan të na e kthejnë kështu, që ditën e parë të luftës, në çeta partizane.

Pikëpamjet e autorëve të materialit, sipas të cilëve kundërsulmet dhe kundërgoditjet nuk mund të jenë forma më e lartë e aktivitetit të mbrojtjes sonë,

sepse nuk u bazokan plotësisht, sipas tyre, në parimet e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, pasi i angazhokan forcat tona në luftime e beteja të mëdha, të zgjatura dhe nuk qenkan të befashme për armikun, janë krejtësisht të gabuara, të çuditin, bile të bëjnë të mendohesh pak më thellë sesa një habi e thjeshtë.

Sipas tyre, përvoja e luftërave paska treguar se kundërsulmet dhe kundërgoditjet, kur janë dhënë me qëllime vendimtare, në më të shumtën e rasteve nuk kanë pasur sukses të plotë, por kanë arritur vetëm objektiva të kufizuar. Aq më tepër ato nuk mund të kenë sukses në mbrojtjen tonë kundër armiqve shumë herë më të mëdhenj e më të fuqishëm. Unë u bëj pyetjen: nga i kanë nxjerrë ata këto teori false edhe për shkençën ushtarake borgjeze, pa lëre pastaj për tonën? Çfarë disfatistësh janë këta që na hiqen edhe si ushtarakë të ditur! Por është e qartë se, ato që kanë studiuar ose lexuar, i kanë mësuar përciptazi dhe krejtësisht së prapthi ose nuk duan, ose nuk i përshtaten situatës apo më mirë luftës sonë.

Idetë e autorëve se ne nuk duhet të ndërmarrim veprime kundërgoditëse që të likuideojmë sa më parë desantin ajror të hedhur, desantin detar të zbarkuar ose forcat tokësore armike, që kanë shpërthyer në një drejtim të caktuar mbrojtjen tonë, janë jashtëzakonisht të gabuara, pasi po të veprohet siç thonë ata, kjo i lejon armiqtë të përforcohen, të zgjerohen, të krijojnë kushte për të fituar hapësira sa më të mëdha, që të futin në përdorim në shkallë sa më të gjerë potencialin e tyre ushtarak. Luftën këta njerëz e mendojnë si njëfarë loje shahu spontane. Po t'i dëgjoje, këta mbanin vazhdimisht në gojën e tyre fjalë të mëdha, si: «As-

një pëllëmbë tokë armikut», «të bëjmë fortifikata, të ndërtojmë ato, të bëjmë këto», kurse, nga ana tjetër, me antitezat e tyre i vënë minat forcimit të mbrojtjes së atdheut.

Sipas autorëve, kundërsulmet dhe kundërgoditjet kryhen për qëllime të kufizuara, prandaj mbeten si forma të thjeshta të aktivitetit mbrojtës, për rritjen e qëndrueshmërisë së mbrojtjes. . . Në këtë mënyrë, vazhdojnë ata, formave ekzistuese të aktivitetit të mbrojtjes, zjarrit, kundërsulmeve dhe kundërgoditjeve, u shtohet një formë e re, sulmet dhe goditjet, të cilat rritkan aktivitetin e mbrojtjes në shkallën më të lartë. Për ne, këto janë ide false, shoku Beqir, krejtësisht të gabuara dhe është fare e qartë se ato janë formuluar për t'iu kundërvënë Tezave të drejta të Këshillit të Mbrojtjes.

Ideja e sulmeve dhe e goditjeve, si forma më e lartë e aktivitetit të mbrojtjes, sipas këtyre autorëve, nuk ndryshon konceptet themelore mbi mbrojtjen që parashikon Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore . . . , por, vazhdojnë ata, sjell ndryshime esenciale si në idenë për ndërtimin e mbrojtjes, për ndërtimin operativ dhe të formacioneve të luftimit, ashtu edhe në vetë zhvillimin e veprimeve luftarake në mbrojtje.

Siç e shikoni, shokë, vetëm nga këto, çështja nuk kufizohet nga ana e tyre te sulmi dhe te kundërsulmi, te goditja dhe kundërgoditja, por në punimet e tyre ka një transformim rrënjësor të të gjitha atyre që ne kemi bërë e kemi vendosur, të të gjitha atyre që i kemi mbështetur në vijën e drejtë të Partisë sonë, lidhur me prapavijën, me ekonominë, me perspektivën, me politikën e jashtme etj., etj. Këta përpiqen të bëjnë kështu një riorganizim jo vetëm të ushtrisë, por edhe të shte-

tit, për të penguar ndërtimin e socializmit në vendin tonë<sup>1</sup>. Ky është fillimi, pse sikur ata t'ia arrinin kësaj, sikur ne të kishim pranuar tezat që na paraqitin këta, atëherë gjërat do të vinin zinxhir njëra pas tjetrës, posaçërisht dhe veçanërisht deri në superstrukturë, pse çdo gjë në vendin tonë u duhej përshtatur këtyre «direktivave». A, Beqir, kjo nuk do të thotë, siç mundohesh të na bindësh, se ti je përpjekur të «përmirësosh direktivat», kësaj i thonë thjesht t'i vësh kazmën socializmit.

Kështu, pra, kanë menduar Beqiri dhe pasuesit e tij. Kjo do të thotë se këta jo vetëm janë kundër në parim, por janë kundër edhe në zbërthim, në ndërtimin e mbrojtjes dhe të formave të luftimit e të rendit tonë socialist. Këta, më duket mua (pa lëre çfarë llomit), është e qartë se refuzojnë mbrojtjen në front të rregullt, janë për t'i lëshuar territor armikut, kërkojnë me një fjalë qysh sot të na e bëjnë ushtrinë «rrush e kumbulla».

«Arti ynë ushtarak, nënvizojnë ata, trajton dy lloj luftërash: luftën popullore në front të rregullt dhe luftën popullore partizane», që midis tyre ndryshokan për qëllimet, format dhe mënyrat kryesore të zhvillimit. . . , ndërsa në të vërtetë qëllimi i Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore është vetëm një, të asgjësojë agresorët brenda vendit tonë dhe të mbrojë lirinë dhe fitoret e socializmit.

Ideja e këtyre «teoricienëve», sipas së cilës, epërsi

---

1. Pas kësaj pune armiqësore, që sapo i kishte dalë maja e veshit, shoku Enver Hoxha shikonte larg, paralajmëronte si mund të zhvilloheshin ngjarjet më vonë, siç ndodhi në realitet, me grupet armiqësore që u zbuluan në ushtri, në ekonomi, në kulturë e deri te poliagjenti Mehmet Shehu.

dërrmuese në forca e mjete ndaj forcave të armikut në veprimin tonë sulmues mund të realizohet, si rregull, kryesisht në krah e në shpinë të tij dhe sidomos kur ato veprojnë të veçuara, me anën e dhënies së goditjeve të vogla, të shumta, të befasishme e të rrufeshme, e kthen luftën tonë në luftë partizane. «Të krijosh epërsi dërrmuese kundër forcave kryesore të armikut, që janë pykëzuar në mbrojtjen tonë, për asgjësimin e tyre njëherësh me një goditje të vetme të madhe, është e vështirë ose e pamundur», thonë ata. Atëherë, sipas jush, Beqir, ne e paskemi kot këtë ushtri të rregullt që kemi krijuar e stërvitur, e cila Partisë dhe popullit i ka kushtuar kaq shumë sakrifica dhe gjak. As vendin nuk e mbrojmë dot, siç mendoni ju, as armikun nuk e ndalim, as e kundërsulmojmë. Atëherë kot po lodhemi! Sipas jush, le t'i hyjmë vetëm luftës partizane. Duket se këta njerëz s'janë fare në të, as politikisht, as ideologjikisht, as ushtarakisht!

Dhënia e goditjeve të mëdha në formën e kundërsulmeve e të kundërgoditjeve me qëllime të tilla vendimtare që, sipas hartuesve të materialit, qenkan të paarrishme, nuk u bazoka në parimet e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, thonë autorët. Por kjo nuk është aspak e vërtetë. Kjo ide bazohet pikërisht në këto Teza që ç'ke me të dhe është një ide kryesore. Prandaj unë u rekomandoj shokëve të ushtrisë t'i rishikojnë një çikë më thellë këto teza të çoroditurish dhe gjithë veprimtarinë ku kanë mundur të ndikojnë këta njerëz në ushtri, të rishikohen, gjithashtu, me shumë kujdes edhe rregulloret.

Epërsi dërrmuese ndaj forcave kryesore të armikut, që është shumë më epror, nuk mund të krijohet.

thonë ata. Por ne e kemi të qartë se armiku është superior në mësymjen e fillimit, por jo më vonë, pasi ta kemi rraskapitur dhe, sidomos, po të mos kemi shkuar në male që në fillim, siç kërkojnë të na çojnë këta teoricienë të fandaksur.

S'është e vërtetë as ajo që thonë këta se kundërsulmet dhe kundërgoditjet qenkan veprime të detyruara nga armiku, si për vendin, ashtu edhe për kohën e dhënies së tyre në kushtet kur ai është superior, si në tërësi, ashtu edhe në drejtimin e dhënies së tyre. Ato, vazhdojnë këta «teoricienë», nuk sigurojnë kushtet për marrjen e iniciativës së veprimeve në duart tona në shkallë taktike dhe operative. As kjo e ashtuqajtur teze e tyrja nuk është e vërtetë.

Armiku mund të ketë epërsi në një moment, por ne, si të kemi stabilizuar gjendjen, përgatitim nga ana jonë kundërsulmet dhe kundërgoditjet dhe e detyrojmë armikun të mbrohet. Ai na detyroi dhe na imponoi vetë luftën, se na sulmoi dhe asgjë tjetër. Arti ynë ushtarak është i tillë që pas sulmit të armikut, kthehemi ne dhe i imponojmë atij çdo gjë dhe më në fund i shkaktojmë disfatën e plotë. Për këtë ti, Beqir, nuk ke besim, por Partia, që nga anëtari më i thjeshtë i saj e deri në udhëheqje, këtë besim e ka të plotë. Me tezat tuaja ju nuk jeni tjetër veçse disfatistë.

Kundërsulmet dhe kundërgoditjet, që jepen me qëllime vendimtare kundër forcave kryesore të armikut, sipas tyre, i angazhojnë forcat tona në luftime e beteja të mëdha e të zgjatura dhe në këtë mënyrë ato nuk mund të jenë të rrufeshme, që të përfundojnë në epërsinë tonë në forca e në mjete! Dua t'i pyes: përse i angazhojnë forcat tona në luftime e në beteja të zgja-



tura? Dhe me çka propozojnë këta që lufta të mbarojë shpejt?! Sipas këtyre «strategëve» pesimistë del qartë se neve nuk na mbetet tjetër përveç të jemi «të rrufeshëm, marksistë-leninistë, trima» etj., po vetëm me fjalë, ndërsa, kur vjen puna, ata vetë «ua mbathin këmbëve». Ju jeni mburravecë me fjalë, shoku Beqir, kurse me vepra jeni pesimistë, në brendi dhe në shfaqje, ju jeni disfatistë që pa filluar akoma lufta. Kështu paraqiteni ju në tezat tuaja të famshme që na propozoni, ose që i futët në dollap dhe i fshehët.

Vlerësimi i drejtë i situatës në kushtet konkrete, vazhdojnë autorët e kësaj «pune», duke u përputhur subjektivja me objektiven, do të na çonte në konkluzionin për të mos i zhvilluar të tilla kundërsulme e kundërgoditje, gjë që do të shpinte në një mbrojtje pasive, duke i ulur asaj aktivitetin, që është kërkesa kryesore e mbrojtjes. Këta që mendojnë e thonë këto gjëra, janë demagogët e demoralizimit. Tezat tona të kundërsulmeve dhe të kundërgoditjeve nuk përfaqësojnë as pasivitetin, as disfatizmin, kurse «tezat» e tyre, që në dukje janë «të rrepta e të zhdërvjellëta», në brendi janë një fanfaronatë.

Me këto ide vazhdon, natyrisht, zhvillimi «logjik» i demonstrimit të tezave të tyre, që në fakt janë anti-teza dhe të dënueshme. Këto ata i kanë ngritur në «ligje parimore», të diktuar nga «mençuria» dhe «zotësia» e këtyre ushtarakëve «të ndritur». Pra, në qoftë se pranojmë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, atëherë, sipas tyre e Beqir Ballukut, ne bëjmë lojën e armikut, ndërsa, po të përdorim «tezat» e këtyre mashtruesve, qenkemi në rrugën «marksiste-leniniste». Me një fjalë,

ata ndjekin deri në fund avazin e tyre për të na mashtruar.

Lidhur me sulmet dhe goditjet ata vazhdojnë të thonë se këto jepen të rrufeshme dhe realizohen në kohë të shkurtër, kurse të tjerat, sipas tyre, nuk jepen të rrufeshme!! Të tjerat jepen me «vrapim breshke» dhe «me kurajë prej lepurash». Hajde, hajde «ç'teoricienë» pa kokë ose me «kokë kungull»! Sa besim ke ti, Beqir Balluku, me shokët e tu tek ushtria, tek udhëheqja dhe te Partia që e kanë ndërtuar këtë ushtri dhe e edukojnë atë me një punë këmbëngulëse?!

Në një vend të materialit autorët nënvizojnë se «...në bazën e vendimit, që është ideja e luftimit, kryesore nuk duhet të jetë përcaktimi i rajoneve, nga mbrojtja e të cilave varet qëndrueshmëria e mbrojtjes në tërësi, por format e luftimit, mënyra e radha e asgjësimit pjesë-pjesë të forcave të armikut. Kjo, sipas tyre, qenka parimore dhe, i vini veshin, «tepër e rëndësishme», që ka lidhje me përdorimin e forcave kryesore, me faktin që ato do të përdoren për mbrojtjen e rajoneve të mbrojtjes apo për zhvillimin e aktivitetit të saj». Kjo, do të thotë se rajonet e mbrojtjes, ku ne kemi derdhur djersë, dhe Partia ka derdhur mençuri për përgatitjen e tyre, nuk kanë asnjë rëndësi për ta! Sipas tyre: «Lufto si të mundësh dhe ku të mundësh».

«Duke marrë parasysh se rolin kryesor e luan aktiviteti..., forcat kryesore të njësive operative, — vazhdojnë Beqiri dhe shokët e tij, — duhet të përdoren krejtësisht për aktivitetin, duke mos i hedhur ato edhe në zënien e mbrojtjes e brezave të mbrojtjes. Rrjedhimisht del se ndërtimi operativ i njësive operative në mbrojtje, sipas tyre, duhet të përbëhen nga forca të

caktuara për mbrojtjen e brezave dhe të rajoneve të mbrojtjes të destinuara për dëmtim të rëndë të armikut, për frenimin dhe bllokimin e grupimeve kryesore të tij dhe nga forcat kryesore goditëse të destinuara për dhënien e sulmeve dhe të goditjeve të shumta e të njëpasnjëshme për asgjësimin pjesë-pjesë të forcave të armikut».

Kjo, sipas tyre, do të thotë që forcat operative të bëjnë gjumë të thellë, ose më drejt, këtyre s'kanë ç'u interesojnë zonat e mbrojtjes. Këto zona i kanë në kokë Beqiri me Spiro Shalësin, që i mbrojnë me teoritë e Akademisë Ushtarake Italiane të Modenës apo ku gjetkë ka mësuar ky i fundit.

Në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, theksohet në materialin e tyre, këto goditje qenkan quajtur kundërgoditje. Një emërtim i tillë, mendojmë ne, nuk është i saktë, për arsye se në të karakterizohen tiparet e goditjeve që jepen me iniciativën tonë, me qëllime vendimtare e të befasishme, jo si masë kundërveprimi në mbrojtje, por si pjesë përbërëse e mësymjes.

Çfarë po llomotitin kështu këta njerëz, kur ne e dimë se kundërmësymja strategjike është një proces relativisht i gjatë, vjen si rrjedhim i kalimit nga mbrojtja në kundërsulme të shumta, të befasishme, të rrufeshme dhe asgjësuese, me kalimin pastaj nga kundërsulmet në kundërgoditje, duke përgatitur kështu kalimin në kundërmësymje strategjike për asgjësimin e tij.

Në pjesën për organizimin dhe zhvillimin e operacioneve në mbrojtje, autorët e materialit, midis të tjerash, vazhdojnë të thonë se forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore mund të përdoren për mbrojtjen e rajoneve të mbrojtjes, me qëllim që me zjarr e me

kundërsulme të gjakosin rëndë armikun dhe të frenojnë e të bllokojnë mësymjen e tij, ndërsa forcat kryesore të njësive që mbahen të paangazhuara me mbrojtjen e brezave e të rajoneve të mbrojtjes të përdoren për dhënien e goditjeve të njëpasnjëshme.

Sipas këtyre «teoricienëve», teza që kanë sajuar do të thotë që ne të futim në thellësi forcën më të gjallë e më të fuqishme të ushtrisë «për ta ruajtur në konserva», ose më mirë për t'i krijuar disfatën apo edhe për ta zëvendësuar me forcën vullnetare të vetëmbrojtjes, që ka një rol ndihmues, por që nuk mund të zëvendësojë të parën. Tezat e Këshillit të Mbrojtjes janë shumë të qarta për detyrat e forcave të vetëmbrojtjes popullore.

Dhe më poshtë, po në këtë pjesë që bën fjalë për organizimin e operacioneve në mbrojtje, ata thonë: «Ndërsa trupat që sigurojnë qëndrueshmërinë e mbrojtjes frenojnë dhe bllokojnë mësymjen e armikut. . . forcat operative goditëse i japin armikut goditje shkatërruese», se, natyrisht, u duhet ta thonë edhe këtë.

Ç'duan të thonë këta me shprehjen: «**Frenojnë dhe bllokojnë forcat e armikut**»? Mos vallë këta «teoricienë» e kuptojnë, dhe mua kështu më duket se e kuptojnë: «Qëndro, o armik ca, që të çlodhemi, të pimë nga një kafe!». Këta i nënvlerësojnë krejt forcat në pozicionet e mbrojtjes, kanë idenë se këto «po sakrifikohen kot», prandaj thonë: «Lini pozicionet e mbrojtjes, ejani vërdallë nga pozicionet e Durrësit dhe brenda natës gjenduni në Dajt a në Skuterë». Në qoftë se organizimin e mbrojtjes dhe drejtimin e operacioneve ne do t'i linim ashtu siç këshillojnë Beqiri me shokë, edhe në kohën e luftës, Partia duhet të marrë masa që të na pushkatojë që tani dhe jo nesër.

Për sa i përket ndërtimit të Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore për perfeksionimin e mëtejshëm të strukturës organizative të forcave tona të armatosura, autorët thonë në një vend: «...njësitë e këmbësorisë, që t'u përgjigjen kërkesave të forcave operative goditëse, duhet të lehtësohen nga armatimi dhe teknika e rëndë luftarake dhe të plotësohen me efektiva të moshave të reja, në mënyrë që të jenë më të lehta dhe më të manovrueshme». Me një fjalë, këta kërkojnë të na çarmatosin krejt me një pikëpamje të tillë, pse sipas tyre, forcat operative ne duhet t'i kthejmë në «pendë bersalierësh», t'u mësojmë edhe vrapin e tyre dhe armët e rënda të fuqishme t'i çojmë gjoja përpara, «atje ku duhet». Dhe kësaj «atje ku duhet» nuk i japin asnjë rëndësi, pse edhe atë e katandisin në diçka krejt të lëvizshme, «mobile».

I keni menduar thellë ju këto gjëra? Kjo është djallëzorc, Beqir Balluku, dhe Partia nuk e ha, pasi do të thotë që armët e rënda t'ia dorëzojmë armikut. Atëherë, derisa për ju çdo gjë është e lëvizshme, përse nuk i hedhim që sot nëpër furra ose në lumenj armët e rënda, mbasi nuk mund të tërhiqen, prandaj le t'i flakim që tani, sepse, sipas tezës suaj, u dashka që ushtrinë ne ta kemi të armatosur lehtë.

Si konkluzion, Tezat, siç shihet, janë rezultatet e një eksperience të tërë të Ushtrisë sonë Popullore, pa harruar Luftën Nacionalçlirimtare, që, në kushtet e kohës kur u zhvillua, ishte rruga e vetme e çlirimit të atdheut, e marrjes së pushtetit dhe e vendosjes së diktaturës së proletariatit. Tezat janë një orientim i dhënë nga udhëheqja e Partisë për edukimin e ushtrisë, për mbrojtjen e atdheut socialist nga çdo sulm armik,

nga çdo anë dhe në çdo kohë që ai mund të vijë. Ato mbajnë parasysh armikun ose armiqtë me arsenalet e armëve të tyre, me taktikën dhe me strategjinë e luftës së tyre dhe kundërvënien me sukses agresorëve të forcave tona të armatosura, gjithë popullin ushtar, me taktikën dhe me strategjinë tonë të luftës popullore. Të tilla janë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, Beqir Balluku, dhe me ato nuk mund të bëhet shaka.

Lufta partizane përbën një eksperiencë të madhe jo vetëm për ata që nuk e kanë bërë, por edhe për ata që e kanë bërë. Kjo e tillë duhet të jetë dhe nuk duhet të harrohet. Ata që e kanë bërë luftën partizane, këtë eksperiencë jo vetëm nuk duhet ta harrojnë, por ta rikujtojnë dhe ta përdorin drejt. Mund të duket si çudi kur e them këtë, por konstatoj se këta që po na nxjerrin të tilla teorira, nuk kanë mundur ta tretin dot si duhet atë eksperiencë të madhe të luftës partizane, nga e cila nuk kanë ditur ç'të vlerësojnë, ç'të marrin e pastaj ç'të lënë. Kjo, sigurisht, vjen se ata kanë pasur boshllëqe në Luftën Nacionalçlirimtare. Vetë ti, Beqir, ke pasur boshllëqe në këtë luftë, gjë që nuk duhet ta harrosh, bile këto përbëjnë tek ti një vazhdë të tërë. Nga të tilla boshllëqe këta njerëz nuk kanë nxjerrë mësim. Jo vetëm kaq, por, me kalimin e kohës, këto boshllëqe e dobësi të vërtetuara që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ti i ke zvogëluar e i ke lustruar dhe i ke kthyer në «taktika», në kompleksin e taktikave të drejta leniniste të luftës partizane.

Unë nuk e kam lexuar historikun e Brigadës II, se nuk ma ka dërguar njeri, por kam lexuar disa komente që janë botuar lidhur me veprimtarinë e saj dhe me të vërtetë jam zemëruar, për arsye se në to gjendja para-

qitet sikur çdo veprimtari e kësaj brigade shkëlqen, sikur çdo aksion është bërë me mençuri, me zotësi, me taktika, sikur çdo luftim e çdo goditje, deri edhe çdo shpërndarje apo shpartallim, qenkësh bërë me qëllime plotësisht të paramenduara, bile të komanduara deri edhe nga unë apo nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kam dëgjuar se i paskan bërë edhe një himn Brigadës II. Me këto që them nuk dua të ul vlerën e saj, por veç këtë vlerë t'ia japim aq sa e meriton, jo më tepër.

Në qoftë se dëshirojmë ta mësojmë popullin dhe ushtrinë tonë me eksperiencën e Luftës Nacionalçlirimtare, ne duhet t'ua themi atyre edhe të mirat, edhe të këqijat, edhe fitoret, edhe gabimet që janë vërtetuar gjatë zhvillimit të saj. Të bëjmë shumë kujdes që ekzaltimet dhe pohimet e rreme absolutisht të ndalohen në hartimin e historikëve të rretheve, të njësive e të reparteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Historia duhet të jetë reale, prandaj kudo të vihen mirë pikat mbi i. E theksoj këtë posaçërisht për ty, Beqir, ose për ata që donin të të bënin qejfin ty, të cilët Brigadën II, për të mos thënë që e kanë ngritur mbi brigadat e tjera më të mira, të paktën e kanë vlerësuar afër tyre. Po përse e kanë bërë ata këtë? Për të të bërë qejfin ty. Ka te ne edhe të tillë kuadro, elementë arrivistë, që nuk duan të prishin qejfin me shokët përgjegjës, me qëllim që të ruajnë pozitat, bile përpiqen që këto pozita në rrugë të shtrembër t'i përforcojnë dhe të ngrihen më lart, duke hedhur në shkrimet që bëjnë gjëra të paqena. Në disa nga këto shkrime është arritur deri në ngritjen e kultit të personit. Mirëpo këto gjëra të paqena i kush-tojnë shumë atdheut dhe Partisë.

Neve nuk na lejohet ta harrojmë mësimin e madh të Marksit për këtë çështje. Mund të na duket e ëmbël momentalisht një gjë e tillë, mund të përmendet orë e çast e çdo minutë nga propaganda-emri im ose i shokëve të tjerë, por kalimi i kufirit nuk është i drejtë as për mua, as për ju. Të gjithë duhet të na karakterizojë në çdo rast thjeshtësia. Por, edhe kur është e nevojshme që dikush nga ne të përmendet, kjo të bëhet sa duhet, të jetë e matur, sepse ja se si ndodh. Puna që ka bërë Beqir Balluku aktualisht është armiqësore. Partia këtë s'ka frikë ta thotë dhe medocemos do ta thotë. Ajo, gjatë tërë jetës së saj, kurrë nuk ka pasur frikë nga elementët që e kanë tradhtuar ose që i janë kundërvënë. Megjithatë, një përshtypje veprimtaria antiparti e Beqirit do të bëjë, vetë marrja e masave të drejta partie dhe shtetërore kundër tij, do të lërë te disa njerëz ndonjë turbullirë.

Beqir Balluku dy-tri herë më ka parashtruar mua dorëheqjen (më pas do të flas pak edhe për këtë çështje), por i kam theksuar se një kërkesë e tillë, edhe sikur të bëhet me të vërtetë për arsye shëndetësore, më mirë ta lërë që ta gjejë Partia, sepse dhënia e dorëheqjes ka anën e brendshme, por ka të bëjë edhe me propagandën që bëjnë armiqtë e jashtëm. Me këtë dua të them që propaganda e Partisë për personalitetet duhet të jetë kurdoherë e matur dhe të mos ndodhë si para disa muajsh që, kur u sëmura unë (se edhe unë njeri si të gjithë jam), pati shokë që u alarmuan e thanë: «Ç'do të bëhemi ne, sikur të pësojë gjë shoku Enver!». Asgjë nuk do të bëhet, pse Partia është në këmbë, se në udhëheqje ka shokë të tjerë të zotë që kanë luftuar, se ecjen tonë përpara na e garanton uniteti i çeliktë i Par-



tisë dhe i udhëheqjes. Unë jam si gjithë të tjerët, një komunist, që Partia më ka dhënë një detyrë me përgjegjësi, të cilën duhet të jem korrekt dhe i vendosur që ta kryej si duhet derisa të kem mendje dhe fuqi. Kur të vijë koha që ndonjëri nga ne të vdesë, dhe kjo kohë do të vijë, është e natyrshme, atëherë të rrojë Partia, të rrojnë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike e kështu me radhë, pse jemi të sigurt që puna prapë do të ecë gjithnjë e më mirë.

Natyrisht, këto shqetësime të shokëve i kanë rrënjët te dashuria që tregon populli jo vetëm për mua, po për gjithë udhëheqjen e Partisë. Puna është që masave të Partisë dhe të popullit, në rrugën marksiste, t'ua bëjmë të qartë edhe këtë çështje, në mënyrë që në asnjë rast të mos arrijnë në konkluzione dëshpërimi, përkundrazi të kenë besim të plotë në vazhdimësinë e veprës së Partisë. Këtë ne e kemi thënë kurdoherë.

Ca më tepër është e dëmshme dhe e dënueshme të pomposh opinionin për veten tënde dhe për brigadën që ke drejtuar në mënyrat se si është vepruar në Brigadën II, jo nga pikëpamja se do të na ngjasë gjë, se këtë nuk e lejon Partia, por çdo komunist, duke përfshirë udhëheqësit, kur të hedhë çapin, të mendojë më parë interesin e Partisë dhe të popullit, pastaj interesin personal, i cili nuk duhet vënë kurrë mbi interesin e përgjithshëm. Ne rrojmë, luftojmë dhe punojmë për interesin e madh të Partisë dhe të popullit.

U largova ca nga ajo që preka pak më parë lidhur me boshllëqet që ti Beqir ke pasur në Luftën Nacionalçlirimtare, të cilat me kalimin e kohës, siç thashë, i ke zvogëluar dhe ilustruar, duke i kthyer në kompleksin e taktikave të drejta marksiste-leniniste të luftës partiza-

ne, por Partia asnjëherë nuk e ka përzier shapin me sheqerin. S'ka të bëjë aspak me strategjinë dhe me taktikën e luftës partizane ajo që nga dobësia drejtuese e komandës ose e komandantit, nga paniku dhe nga mungesa e ngritjes politike, të shpartallohet e të bëhet fije-fije reparti. Ti e di fare mirë se veprime të tilla Partia i ka dënuar rreptë dhe në kohën e duhur.

Çështja tjetër që harrojnë Beqiri dhe shokët e tij është ajo që sot Shqipëria është një shtet dhe një shtet socialist. Mund të duket si çudi, kur e them këtë, por, derisa këta e ekskludojnë ose e minimizojnë mbrojtjen frontale, kjo do të thotë të mos kenë kuptuar si duhet parimin «duhet mbrojtur çdo pëllëmbë tokë e atdheut», «duhet mbrojtur Shqipëria socialiste». Koncepti i tyre në mbrojtjen e këtij shteti socialist, të organizuar dhe me një ushtri moderne në këmbë, është që këtë shtet ta mbrojmë me luftë partizane. Këto koncepte janë shumë të gabuara dhe pikërisht Tezat e Këshillit të Mbrojtjes nuk e lejojnë rënien në të tilla gabime. Mund të gabosh vetëm me dashje.

Në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes jepet e duhet të jepet drejt edhe ç'është lufta partizane. Por çdo gjë në Tezat është frymëzuar nga ideja që ne nuk duhet të hidhemi në luftën partizane me ushtrinë tonë të rregullt. Kjo të kuptohet mirë. Ne duhet ta evitojmë në ekstrem luftën partizane dhe të luftojmë me të gjitha forcat e mjetet që kemi për ta shkatërruar armikun që në ditët e para, kurse këta njerëz mendojnë krejt ndryshe.

Shokët që zhvillojnë të tilla teorira hiqen si njerëz të mësuar ushtarakë, por çështjet ushtarake nuk mund të merren kurrë të shkëputura nga situatat politike dhe ekonomike, nga strukturat shtetërore, nga forma e shte-

tit dhe nga ideologjia që i frymëzon e i udhëheq të gjitha këto. Në këto çështje, gjithashtu, nuk mund të mos mbajmë parasysh të gjitha këto të dhëna dhe të tjera për anën tjetër, domethënë, për anën e armikut. Kurse Tezat e Këshillit të Mbrojtjes të gjitha i mbajnë parasysh.

Këta shokë «të ditur», pavarësisht se flasin fjalë të mëdha, nuk duan t'i kenë të qarta këto çështje. Edhe tash që kanë në dorë gjithë eksperiencën e Partisë, nuk duan ta kuptojnë se lufta e ardhshme partizane, megjithëse do të ruajë tiparet parimore të luftës partizane të kaluar, do të ndryshojë nga e para jo vetëm nga «taktika e sulmeve dhe e goditjeve» (po përdor fjalët e tyre), por edhe nga shumë aspekte të tjera.

Këta shokë, ngaqë nuk i lë mendjemadhësia, meqenëse qëndrojnë në pozita drejtuese të ushtrisë, harrojnë si filloi lufta partizane, sa djersë, sa gjak e ç'sakrificë të mëdha iu deshën popullit dhe Partisë gjersa arritën të krijonin çetat, batalionet, brigadat etj. Të mos i harrojmë të gjitha këto. Nuk erdhën të tërë, me dhjetëra mijë njerëz menjëherë, për të mbushur radhët e njësiteve ushtarake të Luftës Nacionalçlirimtare. Ky ishte një proces i gjatë e i vështirë, por heroik. Çfarë t'ju them unë për të? Atë e kemi jetuar të tërë. Dhe vija e drejtë e Partisë solli fitoren. Nga lufta partizane u krijua Ushtria Popullore.

Në ato kohë të vështira dhe heroike të Luftës Nacionalçlirimtare Partia s'kishte asgjë, të gjitha ajo do t'i fitonte dhe i fitoi. Partizanët kishin malet, këndeje do të fitonim qytetet dhe i fituam. Partizanët nuk kishin që në fillim «një ushtri të rregullt e moderne», por këtë

do ta krijonin vetë çika-çika me luftë e me gjak dhe e krijuam.

Po sot, pyesim Beqirin dhe të tjerët që mendojnë si ai, kështu është situata si 33 ose si 35 vjet më parë? Jo, do të përgjigjet Beqiri dhe në këtë s'kam asnjë dyshim, por, në realitet, kur këta paraqitin tezat e tyre të gabuara, e fshijnë realitetin e madh. Po pse? Ata edhe duke e ditur, dashur padashur harrojnë që Partia ka ndërtuar sot një ushtri të gjerë e të fuqishme, së cilës i ka caktuar një objektiv të madh e real. Të gjitha ato, që, siç thashë më lart, nuk i kishim kur filluam luftën partizane, tani i kemi dhe të çelikut, të ndërtuara në bazë të ideologjisë marksiste-leniniste. Dhe sot këtë ushtri ta kthejmë në një ushtri partizane? Jo, thonë me druajtje ata, por tezat që na paraqitin, vërtetojnë të kundërtën e thënies së tyre.

Luftën partizane ne e filluam kur armiku na kishte zaptuar atdheun. Tash nuk do t'i lëmë terren armikut. Por, edhe në qoftë se përkohësisht armiku do të pushtojë ndonjë rajon të veçantë, në terrenin e zaptuar prej tij ne do të zhvillojmë veprime sipas taktikës së luftës partizane. Megjithatë, as për këtë mënyrë të luftuari këta shokë nuk i kanë të drejta konceptet. Veprimet taktike të luftës partizane do të jenë shumë më të larta se ato që bëmë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, për arsye se repartet partizane nuk do të formohen fije-fije si atëherë, ato janë që sot të organizuara, me çdo gjë që u nevojitet. Njerëzit në këto reparte politikisht dhe ideologjikisht qëndrojnë shumë lart, janë të stërvitur ushtarakisht, ata janë, me një fjalë, partizanë të një cilësie tjetër, janë, si të thuash, partizanë të një shteti socialist të fuqishëm, ushtarë të vendosur të Partisë

dhe të diktaturës së proletariatit. Nuk e shikon ti, Beqir Balluku, këtë ndryshim të madh?

Veç kësaj, këto reparte në kushtet e solme nuk do të luftojnë të izoluar, pavarësisht se do të jenë në prapavija të armikut, pse krahas tyre ato do të kenë një ushtri të madhe e të fuqishme që lufton në front të gjerë dhe i shkakton armikut humbje të mëdha. Këtë herë i gjithë populli është në këmbë me armë në dorë, kësaj radhe nuk kemi nëpër këmbë organizata reaksionare si Balli Kombëtar, Legaliteti e gjithfarë kuislingësh që të na pengojnë. Të frikshëm, po, do të ketë patjetër. Disa prej tyre ne do të përpiqemi t'i frymëzojmë, mund të dalin edhe disa tradhtarë, po këta do t'i shtypim, do t'i shfarosim.

Pra, si bëhet që ti, Beqir, me shokët e tu i shtroni shtrembër dhe gabim këto çështje që Partia na i ka bërë të qarta? A nuk mendoni ju se, po t'i shtrembërosh mësimet e Partisë në këto çështje kapitale të mbrojtjes, tradhtoni atdheun dhe Partinë, u bëni atyre një dëm të pallogaritshëm? Këto nuk janë çështje të vogla, siç mund të jetë organizimi i ndonjë reparti apo shtimi i ndonjë arme të re këtij apo atij reparti, që edhe këto për mbrojtjen kanë rëndësinë e tyre të veçantë, por nga zbatimi i drejtë ose jo i parimeve të Partisë dhe i Tezave të Këshillit të Mbrojtjes për mbrojtjen e vendit varet fati i atdheut dhe i socializmit.

Shfaqjet e sëmura dhe të dënueshme nuk duhen konfunduar asnjëherë me përpjekjet për plotësimin, për korrigjimin apo për përmirësimin e një direktive. Jo! Të parat e kanë burimin të megalomania, tek ambiciet, të nënvleftësimi i forcave të atdheut dhe të mbi-vlerësimi i armikut, gjë që të këta njerëz ngjall frikë

e panik. Për çështjet e dyta, nga padija, dikush edhe mund të gabohet në ndonjë formë a në ndonjë propozim, por jo në përmbajtje dhe në parimet. Ata që na paraqitin «tezat e reja», unë mendoj se bëjnë pjesë në kategorinë e të parëve dhe jo në atë të të dytëve.

Të kesh ose jo pikëpamje të drejta mbi sulmin dhe kundërsulmin, mbi goditjen dhe kundërgoditjen, mbi mësymjen dhe kundërmësymjen, të merremi vesh, kjo nuk përbën një diskutim të thjeshtë akademik, dhe kështu e kupton këtë çështje gjithë Byroja Politike. Kjo është një çështje jetike për mbrojtjen e atdheut, pse këndej varen edukimi e frymëzimi, varen stërvitjet e mira ose të këqija të ushtrisë sonë, varet përgatitja e mirë ose e keqe e ushtrisë, e kuadrove, e shtabeve; varet më në fund ajo për të cilën luftojmë, fitorja mbi agresorët eventualë.

Këto mendime të gabuara të Beqir Ballukut, në radhë të parë, por edhe të të tjerëve, kanë ndikuar vallë për keq në të gjitha ato që thashë më lart? Me siguri që po, që nga stërvitja e thjeshtë e deri tek ajo më e ndërlikuar dhe në kompleksin e tyre që nga lojërat e vogla e deri tek të mëdhatë, që janë demonstrimi në praktikë dhe edukimi me Tezat e drejta të parimeve të mbrojtjes që ka çuar Komiteti Qendror i Partisë për ushtrinë. Sigurisht ky afirmacion imi nuk duhet interpretuar gabim dhe të spekulohet në të, pse ata që gabojnë dhe që nuk i njohin gabimet, për të minimizuar fajet e tyre, bëjnë edhe spekulime, siç po bën Beqiri.

Në lojërat e ndryshme janë vërtetuar gabime, por në ato janë vërtetuar edhe anë të mira. Për sa u përket gabimeve këto nuk duhen futur të gjitha në një thes, duke thënë se janë bërë me qëllime të caktuara. Jo,

gabimi mund të vijë nga shumë shkaqe. Ai vjen edhe pa qëllime të këqija, por në parimet kryesore, dhe sidomos në zbatimin e tyre në këto lojëra nga shokët kryesorë, që nuk janë dakord me parimet e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, nuk mund të mos ketë pasur ndikime. Kur s'je i bindur për diçka, qoftë edhe sikur të mos jesh kundër, në mos më shumë, gjatë zbatimit të detyrës, do të tregosh patjetër plogështi ose mungesë të frymës revolucionare.

Flitet përherë për çështjen e stilit dhe të metodës së punës, pse kjo ka një rëndësi të madhe. Por mua më duket se disa shokë nuk e kuptojnë sa duhet që stili dhe metoda e punës e gjithsecilit është një çështje botëkuptimi, që ka të bëjë me ngritjen ideologjike dhe politike të personit, me zotësitë e tij tekniko-profesionale, me frymën revolucionare ose jorevolucionare. I gjithë ky kompleks çështjesh ndikon në stilin dhe në metodën e punës së shokëve. Në qoftë se në konceptet e një njeriu nuk është e qartë çështja e burokratizmit, ai do të jetë një burokrat dhe këtë, domethënë, burokratizmin, do ta shprehë edhe në stilin dhe në metodën e punës që i ka ngarkuar Partia; në qoftë se dikush tjetër është një mashtrues, me stilin dhe me metodën e punës së vet ai do të mashtrojë; në qoftë se njëri ka mendime megalomane, megalomaninë e tij ai do ta tregojë patjetër në forma nga më të ndryshmet të punës që bën; në qoftë se, gjithashtu, është njëri i rehateve, këtë anë negative do ta tregojë me paaftësi dhe me mungesë aktiviteti në të gjitha drejtimet.

Me një fjalë, kur flasim për stilin dhe për metodën e punës, është e domosdoshme të kuptojmë se duhet absolutisht të bëjmë një punë të pareshtur politike dhe

ideologjike në veten tonë dhe te shokët për të kuptuar qartë parimet kryesore të marksizëm-leninizmit, shtrembërimet që i bëhen këtij dhe rreziqet e të këqijat që na rrethojnë dhe që ndikojnë në karakterin tonë, pra edhe në punën tonë të Partisë. Prandaj çështjen e stilit dhe të metodës të mos e përdorim si një slogan.

Ne dy-tri herë kur kemi marrë në shqyrtim problemin e ushtrisë në Byronë Politike, kemi kritikuar Beqirin dhe Petritin për dobësi, kemi folur edhe për metodën dhe për stilin e punës që nuk është në nivelin që duam në Ministrinë e Mbrojtjes. Megjithatë, përsëri vazhdohet të thuhet se atje lë shumë për të dëshiruar metoda, se mungon stili revolucionar në punë. Nga kjo çfarë duhet të rezultojë? Duhet të rezultojë që pikëpamjet e Beqirit dhe të Petritit (i cili ka fajet e tij në disa çështje)<sup>1</sup>, i japin tonin punës, gjithë piramidës në ushtri dhe prej kësaj pastaj vijnë rreziqet. Cilat janë këto rreziqe? Rreziqet konsistojnë në përçarjen më dysh të mendimit të komandës. Njëra palë ka pikëpamjen se në mosecjen përpara të punëve në Ministrinë e Mbrojtjes ndikojnë çështjet e strukturës, tjetra mendon se është stili dhe metoda jo e mirë e punës që pengon ecjen si duhet përpara. Kjo ka bërë që disa diskutantë të mbajnë njëri-njëri anë, disa të tjerë të mbështetin palën e dytë. Kjo mund të duket si një gjë shumë e thjeshtë, po nuk është kështu.

«Shoku Petrit na merr kompetencat», thonë partizanët e njëri-njëri anë. Kjo mund të ketë qëlluar ndonjëherë, dy herë, ndoshta edhe tri herë, por duhet parë përse ndodhin këto tek ai? Këto vijnë se atij i duket sikur ata

---

1. Shih në këtë vëllim shënimin 1 të faqes 103.



nuk e kryejnë mirë detyrën. Të tillë e ka mendimin ai, prandaj ne duhet ta kritikojmë Petritin për nënvlerësimin që mund të ushqejë ndonjëherë ndaj vartësve që ka dhe për nervozimin e tij në marrëdhënie me vartësit. Ai duhet të mos e humbë kurrë durimin me ta, edhe në qoftë se vartësit ecin më me ngadalë dhe i kuptojnë çështjet cekët. Petriti e ka për detyrë partie dhe ushtarake të përpiqet t'i nxitë ata të ecin me tempin që duhet, të kenë për problemin, në radhë të parë, një qartësi politike dhe ideologjike, pastaj të kërkojë që detyrën ta zbatojnë si duhet. Durimin, e theksoj, ai nuk duhet ta humbasë kurrë me njerëzit. Ankesat se Petriti nuk u jep vartësve kompetencat që u takojnë, mund të jenë të vërteta.

Në këtë drejtim stili dhe metoda e punës mendoj se duhen kërkuar në karakterin, në konceptet politiko-ideologjike të njeriut, në ç'nivel janë ato të formuara tek ai, sa janë të drejta dhe ku çalojnë. Pikërisht këtë duhet ta bëjnë shokët që flasin kaq shumë për stilin dhe për metodën në punë. Pastaj ata edhe vetë duhet të reflektojnë për të analizuar një punë, kur kjo nuk është kryer mirë ose kur ndonjërit i flitet rreptë nga përgjegjësi, ky duhet të gjykojë nëse ishte e drejtë t'i fliste kështu apo duhet të përdorte një ton më të butë. Të kemi parasysh, shokë, se mënyra e butë e të folurit nuk është aspak oportuniste. Përkundrazi, siç na mëson urtësia e popullit, nganjëherë kjo te njerëzit bën një efekt shumë më të madh edukativ apo nxitës sesa të folurit me ashpërsi. Rëndësi ka çështja që të bëjmë përpjekje që kuadrin ta edukojmë.

U zgjata ca, prandaj le të kthehemi përsëri te Beqiri dhe te Petriti, mbasi çështja e tyre është krye-

sorja. Unë mendoj se nuk është aspak ajo që pohon Beqiri se janë stili dhe metoda e punës ato që pengojnë të shkojnë mirë punët në Ministrinë e Mbrojtjes. Siç e dimë, Beqiri ka pasur me kohë mendime të gabuara dhe këtë ai e tha vetë, por në këto materiale ai ka bërë «evolucion», gjë që do të thotë se ai e ka bërë këtë në kokën e tij dhe në dëm të vijës së Partisë. Dhe ky është një evolucion në kundërshtim me vijën e Partisë që Beqiri e ka bërë jo vetëm për disa probleme bazë në çështjet ushtarake, por në të gjitha konceptet e vijës së Partisë të të gjithë sektorëve. Kjo e ka shtyrë atë të ketë kundërshtime dhe në këtë drejtim ka përdorur një taktikë, që shokët këtu e sqaruan mirë; prandaj jam plotësisht dakord dhe i të njëjtit mendim me të gjithë. Taktika e përdorur prej tij është shumë djallëzore dhe armiqësore. Këtë ti, Beqir, duhet ta kuptosh mirë. Armiku kërkon, në radhë të parë, që Partia, e cila tashmë ka arritur një pjekuri të madhe dhe mbron me vendosmëri marksizëm-leninizmin, të përçahet e të dobësohet. Por tamam se Partia mbron me vendosmëri marksizëm-leninizmin dhe është bërë koka dhe shpirti i socializmit dhe i atdheut, populli ynë ka besim të pakufishëm tek ajo dhe forcon gjithnjë e më shumë unitetin e çeliktë rreth saj.

Pikërisht këtë unitet përpriqet të godasë armiku. Ai kurdoherë ka dashur të dobësojë unitetin e Partisë, pastaj të shpartallojë, në radhë të parë, udhëheqjen e saj. Gjithë veprimtaria armiqësore e imperializmit, e socialdemokracisë tradhtarë dhe më vonë e revizionistëve është përqendruar në këtë pikë, të godasë dhe të mposhtë udhëheqjet marksiste-leniniste të partive komuniste, me qëllim që të sjellë në krye elementë revizionistë,

tradhtarë të marksizëm-leninizmit. Këtë çështje në Partinë tonë ne e kemi shtruar sa herë që është zbuluar një veprintari armiqësore, veçanërisht në kokën e Partisë. Tezat e armiqve të marksizëm-leninizmit në Partinë tonë janë shtruar këtu, në këtë forum, ato janë rrahur në thellësinë e tyre dhe vetë ti, Beqir Balluku, nuk ke qenë i huaj në diskutimet që janë zhvilluar.

Ti, Beqir, dhe këtë ta them me qëllim që të ndreqesh, ke një karakter jo vetëm hipokrit, por nga sa duket edhe intrigant. Ka një dozë të madhe prirjesh për intriga në personin tënd, bile je edhe gënjeshtar. Dhe ti gënjen jo si një gënjeshtar i thjeshtë. Partia më ka mësuar të mos i akuzoj pa baza shokët, por, t'ju them të drejtën, shokë, në raportimet që më bënte Beqiri për punën, nuk kam qenë shumë i bindur, për arsye se shihja tek ai shumë përcipmëri, më fliste më tepër për gjëra të vogla, jokryesore. Unë jam përpjekur të kërkoj prej tij probleme nga më të rëndësishmet, ndërsa nga ai ç'të dëgjoje? Thashetheme. Kur e thërrisja të më raportonte për punët e ushtrisë, më informonte më tepër për ndonjë problem të ndonjë kooperative bujqësore, sesa për sektorin jetik që i është ngarkuar. Natyrisht, mua më interesojnë të tëra problemet dhe ai, gjithashtu, është, në radhë të parë, anëtar i Byrosë Politike dhe mund të merret me çdo problem, por me këtë dua të them se për sa u përket çështjeve ushtarake, shumë pak më raportonte. Këtë përshtypje kisha për punën e tij.

Ka kohë që te Beqiri kam vënë re edhe njëfarë ftohjeje me shokët. Po pse të vinte nga ana e tij kjo ftohje? Ne kemi Shtëpinë e Partisë ku mblidhemi. Unë asnjë shoku nuk i them që të vijë atje sa për një *présence de*

*corps*<sup>1</sup>, se përndryshe do të dyshoja. Jo, në asnjë mënyrë! Atje ne shkojmë pas punës jo vetëm për t'u çlodhur. Por, ajo që ka rëndësi të dorës së parë, për të marrë kontakt me njëri-tjetrin, për të këmbyer mendime, mbase nuk është nevoja që të bisedojmë për çdo problem vetëm në zyrë. Pra, edhe aty na jepet mundësia të bisedojmë për punët. Dhe kjo na ka ndihmuar të sqarohemi për shumë çështje, të vihemi në dijeni të një numri problemesh nga më të ndryshmet dhe të ekonomizojmë kohën. Mirëpo, siç thashë, prej një kohe të gjatë Beqirin nuk e shohim fare aty në mes tonë. Vihet pyetja: Përse nuk vjen? Këtë nuk e marr nga ana formale, as nuk e di ç'qëndrim mban ndaj jush, shokëve të tjerë, por ky qëndrim më ka bërë përshtypje. Megjithatë kam menduar se kushedi çfarë do të ketë.

Tani, në dritën e analizave që po bëjmë, del se kjo nuk ka qenë një diçka e thjeshtë, por rrjedhim i asaj që Beqiri ka punuar prej disa vjetësh me radhë për një vijë të re në ushtri, që ai e ka përpunuar në forma të dënueshme, ilegale, fshehur nga udhëheqja e Partisë, nga Byroja Politike dhe nga Këshilli i Mbrojtjes, bile edhe prapa shpinës së shokëve kryesorë të ushtrisë dhe këtë e ka bërë jo pa qëllim, mendoj unë.

Veprimtaria e Beqirit ka pasur dy qëllime: qëllimi i parë, të krijonte përçarje në udhëheqje, të realizonte dobësimin e saj; qëllimi i dytë, të arrinte të realizonte dobësimin e ushtrisë, dy drejtime nga më kryesoret që synon të realizojë armiku. Të dyja këto qëllime janë punë armiqtësore. Ke vallë lidhje ti me armikun? Unë këtë nuk mund ta them, pse as zemra ma do, as prova

---

1. Frëngjisht — prani fizike.

e fakte tani për tani nuk kemi, vetëm po ta them se puna që ke bërë është krejtësisht armiqësore.

Me kuadrin, në përgjithësi, ti nuk ke bërë një politikë të rregullt partie. Edhe në këtë drejtim, nga më kryesorët, ke vepruar me qëllime të caktuara. Përveç që je orvatur, siç thashë, të eliminosh kuadrot kryesorë të ushtrisë që janë në kundërshtim me pikëpamjet e tua, që pastaj të livadhisje atje lirisht, kjo politikë që ke ndjekur ti me kuadrin duhet parë më thellë. Ne e kemi kritikuar vazhdimisht këtë politikë në ushtri, kemi kritikuar shumë herë sidomos ndryshimet dhe lëvizjet e shpeshta të njerëzve, gjë që sjell pakënaqësi, pse u shkaktojnë atyre vetë vështirësi ekonomike, përveç vështirësive që u sillen organeve të pushtetit e të tjera e të tjera gjëra të kësaj natyre. Në sajë të kritikave që ka bërë udhëheqja, këto lëvizje janë frenuar ca.

Po përse bëheshin këto ndryshime? Ti mund të thuash që këto i kemi aprovuar bashkërisht dhe kjo është e vërtetë, ato ne i kemi aprovuar, por kemi pasur besim te Drejtoria Politike, te Komanda dhe kryesisht tek ti si anëtar i Byrosë Politike. Tani që na dalin përpara këto gjëra, veprimet e kryera në këtë drejtim e kemi për detyrë t'i lidhim, jo posaçërisht që të të rëndojmë ty dhe të të ndëshkojmë, po për të nxjerrë se kjo politikë që ke ndjekur është rezultat i një zinxhiri lojistik të pikëpamjeve të tua të vjetra, të cilat u përpoqe t'i konkretizosh dhe t'i vësh në zbatim një nga një. Kjo nuk është një çështje aq e thjeshtë, që mund të bëhet në një ditë.

Mos harro, Beqir, se na ke bërë presion, je përpjekur të na bësh edhe shantazhe në këtë drejtim, duke paraqitur dorçeqjen, por kjo nuk të ka kaluar. Unë

mbaj mend se, kur më ke folur për këtë çështje, pasi të kritikuar në Byronë Politike në vitin 1970, ti erdhe më takove në rrugë (se i ke zakon muhabetet rrugëve e sokaqeve) dhe më parashtrove kërkesën për largim nga ministria. Menjëherë t'u përgjigja duke të thënë që mos u mundo t'i bësh shantazhe dhe presione Partisë, se ajo nuk ka frikë nga askush, prandaj njihi gabimet, pranoi ato me zemër të hapur dhe vuri veshin këshillave që të bënë shokët, pa për sa i përket çështjes se kur do të hiqesh dhe ku do të vesh, këtë e vendosin Komiteti Qendror dhe Byroja Politike. Këto orvatje nga ana jote u bënë dy herë me radhë dhe pikërisht se nuk arrite dot të eliminoje Petritin<sup>1</sup> dhe shokët e tjerë që të kundërshtojnë. Kjo një.

E dyta, ti, Beqir, nuk arrite dot që «tezat» e tua për çështjen e mbrojtjes të pranoheshin me procedurën e dënueshme trockiste revizioniste, duke u kaluar për diskutim disa kuadrove një material për të cilin udhëheqja nuk dinte gjë fare.

E treta, ashtu siç u përpoqe të mbuloje gjithë veprimtarinë tënde armiqësore, duke na marrë neve për qorra, meqenëse ke pak vështirësi në frymëmarrje, u përpoqe ta shfrytëzoje këtë si një mbulesë për t'u larguar nga Ministria e Mbrojtjes dhe kështu të konservohesh. Po përse të konservohesh? Ti u mundove të largohesh nga Ministria e Mbrojtjes, sepse gjendja t'u bë e vështirë, veprimtaria armiqësore që kishe ndërmarrrë në ushtri po të dështonte, veprimtari kjo që nuk është e shkëputur nga orvatjet e tua për të përçarë udhëheqjen kryesore të Partisë.

---

1. Shih në këtë vëllim f. 414.

E gjithë kjo është e dënueshme. As ti dhe askush tjetër nuk mund t'ia arrijnë kurrë një gjëje të tillë. Po pse nuk mund t'ia arrish? Pse në udhëheqje ne kemi një formacion marksist-leninist qoftë teorik, qoftë praktik, që na frymëzon orë e çast për të ecur me sukses përpara në punën tonë, se ne komunistët shqiptarë jemi mburjtur me një patriotizëm të flaktë, të çimentuar me idealet e pavdekshme marksiste-leniniste. Prandaj as presionet, as intrigat e ndonjë intriganti si ti nuk mund të krijojnë kurrë të çara në radhët tona. Duhet ta kesh parasysh se çdo problem te ne shtrohet dhe diskutohet në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, ashpër kur duhet dhe butë kur është nevoja, po të gjitha mënyrat që përdoren synojnë vetëm në një gjë, në ruajtjen e vijës së drejtë dhe të unitetit të Partisë.

Ti dështove në orvatjet e tua, Beqir, po këtë nuk e the, e fshehe deri në fund. Pas ngritjes së këtyre çështjeve, kur të thirrëm<sup>1</sup> me shokun Hysni, në bazë të kërkesës tënde, ti pate paturpësinë të mos më thoshe asnjë fjalë për këto materiale që kishit përgatitur. Këtë në atë takim unë e dija, se më kishte vënë në dijeni shoku Hysni, por prita që edhe ti vetë të më thoshe: «Ne në ministri. shoku Enver, kemi bërë këtë ose atë material, por siç del ky paska qenë i gabuar. . .». Asgjë nuk më the për të, vetëm u mbrojte. Me këtë ti, sipas pikëpamjes tënde, u përpoqe të lije përshtypjen sikur je me mua, kishe shpresë se unë do të të përkrahja. Unë nuk e kam zakon të mburrem, por butësinë dhe frymën shoqërore në marrëdhëniet e mia me shokët mos i merr për dobësi, nuk i ha unë të tilla orvatje. As rreptësinë

---

1. Më 15 qershor 1974.

mos e merr për keq. Të dyja këto janë të frymëzuara nga drejtësia e vijës së Partisë, janë marksiste-leniniste.

As shokët, as unë nuk jemi gabuar në këtë çështje, të cilën ne e morëm vesh ca me vonesë, sepse nuk na vunë në dijeni në kohën e duhur as Petriti dhe as Hitoja, prandaj të mos ngjasë më një gjë e tillë. E shikoni ju, shokë, Petrit dhe Hito, se sa i rrezikshëm është një qëndrim i tillë? Ai që i bën këto, kushdo qoftë, anëtar i Komitetit Qendror apo i Byrosë Politike, le të jetë, mbi të gjithë ne janë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike, prandaj kur ndonjëri nuk është në rregull, t'i thuhet hapur dhe sinqerisht dhe pastaj të vihet menjëherë në korent udhëheqja e Partisë. Nëse këtu nuk jemi aq kurajozë sa t'ia themi shoku-shokut të vërtetën në fytyrë, qoftë kjo plotësisht e drejtë ose gjysmë e gabuar, nuk meritojmë të jemi në këto vende që na ka besuar Partia. Këto norma ne ua mësojmë të tjerëve, prandaj nuk na lejohet të mos i zbatojmë vetë.

Meqenëse Beqiri ishte ministër dhe mbante kontakt me ne, prandaj nuk vinit ju të na informoni për grindjet që kishit me njëri-tjetrin? Jo ju, që jeni kuadro me përgjegjësi, por edhe një ushtari të thjeshtë nuk i lejohet të veprojë kështu. Dhe, në fakt, ne marrim letra të shumta nga masat që na sinjalizojnë për këtë ose për atë të metë e dobësi etj., dhe ne, ashtu siç na mëson Partia, i shikojmë ato me kujdes dhe marrim masat përkatëse për ndreqjen e situatave. Po ju, kush jua ka mbyllur derën që të vinit të na informoni për çështje me rëndësi kaq të madhe? Kush do t'ju kritikonte pse kishit kundërshtime të drejta me Beqirin ose me cilindo tjetër shok qoftë? Askush! Në qoftë se kur vini të ra-



portoni unë nuk ju pres, atëherë më kritikoni, shokë, përpara Byrosë Politike dhe kjo të më gjykojë dhe të më ndreqë. Kështu siç bëtë ju, nuk na mëson Partia të veprimë. Çështjen e kam që problemet të mos na i ngrini me vonesë, prandaj këtë kijeni mirë parasysh në të ardhmen, pa harruar të na flisni në kohë edhe për të metat që vërtetohen në punën tuaj.

Jam dakord me të gjithë diskutantët që i përcaktuan plotësisht dhe drejt fajet e Beqirit, ndërsa ky pohoi vetëm disa, por nuk pohoi qëllimin e thellë të orvatjeve të tij shumë të rrezikshme. Tani këto që ia thamë, u munduam, natyrisht, për të mirë, se po të mos ia thoshim, nuk do të kishim kryer detyrën që na takon as ndaj Partisë, në radhë të parë, as ndaj një shoku, të cilin nuk duam ta hedhim poshtë, përkundrazi do të përpiqemi deri në fund ta shërojmë.

Por rëndësi më të madhe ka çështja që u zbulua një veprimtari e rrezikshme, prandaj duhen bërë përpjekje që kjo të pastrohet. Kujdesi nuk duhet përqendruar për të shëruar vetëm Beqirin, por, në radhë të parë, ushtrinë, pse një ushtri me një udhëheqje në krye të së cilës është një njeri si ai, nuk mund të ecë si duhet në rrugën e Partisë. Në ushtri duhet të udhëheqë kurdoherë Partia, ajo e ka udhëhequr atë dje, ajo e udhëheq sot dhe ajo do ta udhëheqë atë nesër e kurdoherë. Kjo do të thotë se në krye të ushtrisë duhet të kemi shokë, të cilët me eksperiencën e tyre t'i zhdukin të tilla sëmundje nga rrënjët dhe të bëjnë që atje të ndryshojë stili dhe metoda e punës në frymën dhe në orientimet që thashë.

Ne nuk duhet të shkojmë nga mendimi se në Ministrinë e Mbrojtjes nuk ka kuadro që të mos kenë menduar si Beqiri. Edhe sikur të mos duket kjo, logjika

e Partisë na mëson se duhet të ketë. Kjo për arsye se atë gabim që bëtë ju, Petrit dhe Hito, njëri kandidat i Byrosë Politike dhe tjetri anëtar i Komitetit Qendror, duke mos pasur guximin të vinit t'i flisnit udhëheqjes së Partisë për këtë vijë të gabuar të Beqirit, në situatën ekzistuese duhet të ketë kuadro më poshtë që kanë krijuar mendimin se gjersa shoku Beqir është anëtar i Byrosë Politike, anëtar i Këshillit të Mbrojtjes, zëvendëskryeministër dhe ministër i Mbrojtjes, njeri, pra, me kompetencë dhe i ditur, atëherë ç'të flasim ne më poshtë për këto që shohim, ai i di të gjitha!

Mendoj se kuadrot te personi i Beqirit kanë parë Partinë, por çështja është se shokët e Partisë, ata që përfaqësojnë Partinë në ushtri, me punën e tyre janë përpjekur të krijojnë besim në personin. Ky besim, në qoftë se nga Beqiri është përdorur mirë, është në rregull, por në qoftë se është shpërdoruar nga ana e tij, dhe për këtë s'na siguron njeri, atëherë me siguri te disa njerëz, që këtij i kanë ardhur rreth e rrotull dhe nuk i kuptojnë thellë këto çështje, në mos më shumë, do të ketë të paktën një deziluzion lidhur me masat që po marrim. Prandaj, këta duhen rigjeneruar, duhen ringjallur, në radhë të parë t'u forcohet besimi te Partia dhe të kuptojnë në mënyrë marksiste që edhe në rastin konkret kemi të bëjmë me një luftë klasash. Ta kenë të qartë të gjithë, në ushtri dhe kudo, se kushdo qoftë, komandant reparti, ministër, kryeministër apo sekretar partie, në rast se shkel vijën e Partisë, duhet të kritikohet dhe, po të vazhdojë të bëjë faje, që të shërohet «plaga», duhet të operohet, se kështu nuk vdes Partia, as ushtria, as socializmi në Shqipëri.

Unë jam dakord me propozimin e shokëve që Beqiri

nuk mund të jetë më anëtar i Byrosë Politike, natyrisht, as anëtar i Këshillit të Mbrojtjes, as zëvendëskryeministër dhe as ministër i Mbrojtjes, për arsye se veprimtaria e tij është shumë e rëndë, ndërsa qenien e tij si anëtar ose si kandidat i Komitetit Qendror le ta shohë e ta vendosë vetë Plenumi, kur të mbledhet<sup>1</sup>. Por ne dëshirojmë ta shërojmë Beqirin. Kjo dëshirë veç realizohet duke i kuptuar ai vetë gabimet e rënda, fajin e madh që ka bërë dhe t'i ndreqë ato. Por këto nuk ndreqen me një ditë dhe, që të korrigjohet, Partia duhet t'i japë mundësitë, duke i gjetur një punë të përshtatshme ku mund të shërohet, pse qenia në udhëheqje, siç del qartë, ia ka rritur shumë mendjen dhe kjo mund të jetë një nga shkaqet e fajeve të tij të rënda.

Tani detyra jonë e dorës së parë, pas gjithë kësaj çështjeje, është të marrim sa më parë masa që ta forcojmë punën në ushtri.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

---

1. Plenumi i 5-të i KQ të PPSH, që u mbledh më 25 dhe 26 korrik 1974.

## USHTRI E VËRTETË E POPULLIT, USHTRI E REVOLUCIONIT NGADHËNJIMTAR

*Përshëndetje drejtuar ushtarëve dhe oficerëve  
me rastin e 31-vjetorit të themelimit  
të Ushtrisë Popullore*

10 korrik 1974

Të dashur shokë ushtarë dhe oficerë,

Të dashur vullnetarë popullorë,

Me rastin e ditës së 31-vjetorit të themelimit të Ushtrisë Popullore, e cila sivjet festohet në atmosferën e mrekullueshme revolucionare që ka shpërthyer në të katër anët e vendit për nder të jubileut të madh të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, ju përshëndes nxeh-tësisht ju, që duke punuar me vetëmohim, duke më-suar me zell dhe njëkohësisht duke u stërvitur ushtara-kisht, qëndroni gjithmonë të gatshëm e vigjilentë për mbrojtjen e të gjitha fitoreve madhështore që ka korrur populli ynë nën udhëheqjen e ndritur të Partisë.

Gjatë këtyre 31 vjetëve ushtria jonë, si ushtri e vërtetë e popullit dhe e revolucionit, i ka kryer kurdo-herë me nder të gjitha detyrat e ngarkuara. Duke zba-

tuar me besnikëri vijën marksiste-leniniste të Partisë, Ushtria jonë Popullore ka korrur fitore të mëdha në përvetësimin e Artit tonë Ushtarak Popullor të përpunuar nga Partia, ka ngritur më lart nivelin e përgatitjes politiko-luftarake, të gatishmërisë, të vigjilencës revolucionare dhe të aftësisë tekniko-profesionale, ka forcuar disiplinën e çeliktë dhe ka përsosur gjithnjë e më shumë figurën morale të ushtarit të vërtetë të popullit.

Të gjitha këto fitore ajo i ka arritur sepse në gjakun e saj ka rrjedhur e rrjedh gjaku i kulluar i Partisë, sepse mendja e saj ushqehet gjithmonë nga mendja e ndritur e Partisë, sepse forca e saj buron nga forca e pashtershme e Partisë, sepse si organizatore dhe udhëheqëse të përhershme ka pasur dhe ka Partinë e lavdishme të Punës. Ushtria jonë Popullore i ka arritur këto fitore të mëdha sepse u lind dhe u rrit si ushtri e popullit. Çështja e mbrojtjes së atdheut të ne ka qenë gjithmonë çështje e gjithë popullit dhe detyrë e shenjtë ndaj atdheut e socializmit. Edhe sot, plotësisht i ndërjegjshëm për misionin e lartë të mbrojtjes së atdheut në kushtet e rrethimit dhe të bllokadës imperialisto-revizioniste, i gjithë populli ynë stërvitet për përvetësimin e kërkesave të Artit tonë Ushtarak Popullor.

Me këtë rast përgëzoj dhe uroj nga zemra gjithë efektivin e forcave tona të armatosura për fitore të reja edhe më të mëdha në zbatimin e direktivave të Partisë sonë të lavdishme, për rritjen e mëtejshme të frymës revolucionare, për përsosjen e mjeshtërisë luftarake, për forcimin e disiplinës, të vigjilencës e të gatishmërisë së përhershme luftarake.

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, garanci e for-

cës, e pathyeshmërisë dhe e besnikërisë së ushtrisë sonë ndaj popullit dhe çështjes së socializmit e të komunizmit.

Rroftë populli ynë heroik!

Rrofshin forcat tona të armatosura!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave  
të Armatosura të RP të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 164 (8082), 10 korrik 1974*

*Botohet sipas gazetës «Zëri  
i popullit», nr. 164 (8082),  
10 korrik 1974*

## QIPROJA DHE PLANET HEGJEMONISTE TË DY SUPERFUQIVE NË MESDHEUN LINDOR

*Artikull i botuar në gazetën „Zëri i popullit“*

24 korrik 1974

Siç është njoftuar, më 15 korrik, njësitë e Gardës Kombëtare të Qipros kryen një grusht shteti dhe rrëzuan presidentin e republikës, Makarios, i cili, pasi mundi të largohej nga vendi, mori pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të thirrur me kërkesën e tij, për shqyrtimin e gjendjes së krijuar në Qipro. Në mëngjesin e datës 20 korrik në Qipro zbarkuan forcat ushtarake turke, detare e ajrore, dhe u zhvilluan veprime luftarake në pjesë të ndryshme të vendit. Dje agjencitë e ndryshme të lajmeve njoftuan se Greqia dhe Turqia pranuan pushimin e zjarrit në Qipro sipas kushteve të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të datës 20 korrik.

Ky zhvillim i ngjarjeve në Qipro ditët e fundit ka ngritur tensionin në ishull dhe në rajonin e Mesdheut Lindor dhe çoi në acarimin e mëtejshëm të marrëdhënieve greko-turke. Ngjarjet në Qipro me të drejtë kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik ndërkombëtar dhe kanë ngjallur një shqetësim serioz në mjaft vende e popuj, të cilët janë për ekzistencën e Republikës së Qipros si shtet i pavarur e sovran, për bashkëjetesën paqësore dhe me të drejta të barabarta në një

vëllazërim të singertë e të harmonishëm të të dy komuniteteve të ishullit, të grekëve e të turqve, dhe për ruajtjen e forcimin e paqes e të stabilitetit në Mesdhe, në Ballkan dhe në Evropë.

Krijimi i kësaj gjendjeje të rrezikshme në Qipro është pasojë e drejtpërdrejtë e politikës agresive hegjemoniste që dy superfuqitë — SHBA dhe Bashkimi Sovjetik — ndjekin prej kohësh në Lindjen e Mesme, në Mesdhe dhe në veçanti në pjesën lindore të tij. Qiproja, me pozitën e saj strategjike, ka qenë vazhdimisht, por veçanërisht gjatë viteve të fundit, objekt i lakmive, i ndërhyrjeve dhe i synimeve djallëzore të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik për ta pushtuar atë, për ta pasur atë një bazë të rëndësishme për realizimin e planeve të tyre ekspansioniste në Mesdhe, në Lindjen e Mesme, në Afrikë, në Oqeanin Indian dhe në rajone të tjera.

Dy superfuqitë, në kuadrin e rivalitetit, të luftës për ndarjen e zonave të influencës dhe për sigurimin e supremacisë ndaj njëra-tjetrës, duke mos përfillur të drejtat sovraane të popujve, bëjnë të gjitha përpjekjet për të zënë pozita kyç strategjike dhe baza ushtarake në rajonin e Mesdheut, për të mbajtur aty flotat e tyre të luftës dhe për të nxitur grindje e konflikte, sidomos midis vendeve të Mesdheut Lindor. Një veprimtari e tillë është bërë akoma më e dukshme sidomos pas zhvillimeve të kohëve të fundit në Lindjen e Mesme.

Në mbështetje të kësaj politike dhe për arritjen e këtyre qëllimeve, duke praktikuar politikën e kanonierave, dy superfuqitë kanë vënë tani në lëvizje si forcat e tyre ushtarake, ashtu edhe blloqet agresive të NATO-s e të Traktatit të Varshavës. Nga ana tjetër, ato janë në



kontakt të vazhdueshëm me njëra-tjetrën dhe bëjnë përpjekje që t'i shfrytëzojnë ngjarjet e Qipros për të vendosur një ekuilibër forcash në përshtatje me interesat e tyre hegjemonistë në këtë rajon.

Ngjarjet e fundit në Qipro tregojnë edhe një herë se si dy superfuqitë krijojnë vetë tensione e situata të ndera, ose nxitin të tjerët, me qëllim që t'i arrijnë më lehtë synimet e tyre imperialiste. Në të njëjtën kohë, duke hedhur gurin e duke fshehur dorën, vihen në rolin e arbitrave dhe përpiqen të paraqiten përpara popujve si shpëtimtarë të paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar.

Ngjarjet në Qipro tregojnë edhe një herë fare qartë karakterin e rremë dhe mashtrues të të ashtuquajturave «ulje tensioni», «respektim të pavarësisë e sovranitetit të vendeve», «mosndërhyrje në punët e brendshme të shteteve» etj., për të cilat bëjnë zhurmë të madhe sot imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë. Në të vërtetë, ata ngrenë tensionin, krijojnë rreziqe për paqen dhe lirinë e popujve, marrin nëpër këmbë pavarësinë dhe sovranitetin e kombeve, ndërhyjnë brutalisht në punët e brendshme të shteteve, ushtrojnë politikën e kontrollit e të diktatit dhe përgatitin e kryejnë agresione të reja. Ndërhyrja e të dyja superfuqive në çështjen e Qipros nuk është një gjë e rastit dhe e shkëputur. Ajo është vazhde e strategjisë globale të tyre për të përçarë e për të sunduar popujt, për të vendosur hegjemoninë e tyre, për të shtrirë ekspansionin e tyre neokolonialist. Nuk është, gjithashtu, aspak e rastit që këto tensione në Mesdheun Lindor ndodhin pikërisht menjëherë pas takimit të fundit Nikson-Brezhnev. Ngjarje e situata të tilla kërkojnë nga popujt liridashës të mos bien në kurthet e ngritura nga të dyja superfuqitë im-

perialiste, por të forcojnë vigjilencën dhe të rritin luftën për demaskimin dhe shpartallimin e planeve e të kompleteve të tyre.

Populli shqiptar, i cili ushqen ndjenja miqësore për popullin e Qipros, të Greqisë e të Turqisë dhe që është singërisht i interesuar për sigurimin e paqes e të stabilitetit në Ballkan e në Mesdhe dhe për zhvillimin e marrëdhënieve normale midis vendeve të këtyre rajoneve, ndjek nga afër dhe me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve në Qipro. Interesat e zhvillimit të lirë e të pavarur të popullit qipriot, interesat e paqes e të sigurimit në Ballkan e në pellgun e Mesdheut kërkojnë që t'i jepet fund sa më parë kësaj gjendjeje të nderë, me pasoja të rrezikshme për të ardhmen. Ato e bëjnë akoma më të domosdoshme e të ngutshme nevojën e kundërshtimit me vendosmëri të politikës hegjemoniste të të dyja superfuqive dhe largimin e flotave agresive e të bazave të tyre ushtarake nga Mesdheu. I duhet dhënë fund çdo ndërhyrjeje të huaj në punët e brendshme të popullit të Qipros. Qiproja është një shtet i pavarur, që duhet të lihet i lirë t'i zgjidhë vetë problemet e brendshme.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë qenë dhe janë për ruajtjen dhe për respektimin e pavarësisë, të sovranitetit e të integritetit të Republikës së Qipros, për respektimin e të drejtave të plota e të barabarta të komuniteteve grek e turk, për zhvillimin dhe përparimin e popullit qipriot.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 176 (8094), 24 korrik 1974*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern 1971-1975» (Përmbledhje veprash), f. 539*

**FORCA E PATHYESHME E UDHËHEQJES  
MARKSISTE-LENINISTE TË PARTISË SONË  
QËNDRON NË UNITETIN E MENDIMIT  
DHE TË VEPRIMIT**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 korrik 1974**

Të dashur shokë dhe shoqe,

I dhamë fund, këtu, në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, gjykimit të veprimtarisë armiqësore, që ka zhvilluar Beqir Balluku kundër Partisë, shtetit socialist dhe Ushtrisë sonë Popullore.

Unë dhe të tërë shokët anëtarë e kandidatë të Byrosë Politike i vlerësojmë lart mendimet dhe qëndrimet e të gjithë shokëve, që folën në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, si edhe ato

---

1. Më 25 dhe 26 korrik 1974 zhvilloi punimet Plenumi i 5-të i KQ të PPSH, i cili, pasi shqyrtoi e diskutoi gjerësisht raportin e Byrosë Politike: «Mbi disa çështje të rëndësishme që kanë dalë në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe që kanë të bëjnë me vijën e Partisë në ushtri dhe me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes», mori vendimet dhe masat përkatëse.

të të gjithë të tjerëve, të cilët, megjithëse nuk e morën fjalën, janë, sigurisht, në nivel po aq të lartë marksist-leninist sa edhe ata që diskutuan. Kjo vërteton edhe një herë tjetër pjekurinë dhe zotësinë e madhe të udhëheqjes së Partisë për t'i kapur drejt dhe shpejt problemet, për t'i thelluar ato dhe për të dhënë mendime shumë të vlefshme rreth tyre. Është fat i mirë për Partinë tonë që ka në krye një udhëheqje të dalë nga lufta dhe nga përpjekjet e ashpra që janë zhvilluar me armiqtë e brendshëm e të jashtëm të saj, një udhëheqje që ka eksperiencë të madhe në luftën e përditshme që ajo bën në krye të masave punonjëse për ndërtimin e socializmit. Udhëheqjen e Partisë sonë e karakterizon një vigjilencë e madhe revolucionare, ajo shquhet për pjekurinë marksiste-leniniste, që i jep mundësi t'i shtrojë e t'i gjykojë çështjet objektivisht, pa pasione, po me zemër partie dhe t'i zgjidhë ato kurdoherë drejt.

Ashtu sikurse të gjithë ju, shokë anëtarë e kandidatë të Komitetit Qendror të Partisë, edhe ne, anëtarët e kandidatët e Byrosë Politike, e vlerësojmë shumë të keq, shumë armiqësor qëndrimin e Beqir Ballukut përpara këtij forumi të lartë të Partisë. Në vend që ai të thellohej më shumë në zbulimin e shkaqeve të fajeve të tij të rënda dhe të ecte më përpara në analizën e tyre, përkundrazi, nga qëndrimi që mbajti si në mbledhjen e Byrosë Politike, në aktivin<sup>1</sup> e ushtrisë dhe ca më tepër këtu në Plenumin e Komitetit Qendror del se ai nuk ia

---

1. Më 6-7 korrik 1974 në Durrës u zhvillua një aktiv me kuadro kryesorë të forcave të armatosura, ku u fol për veprimtarinë armiqësore dhe antiparti të Beqir Ballukut.

hapi zemrën Partisë. Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në mbledhjen e Byrosë Politike që bëmë më 2-3 korrik, Beqir Balluku njohu një pjesë të fajeve të rënda të kryera nga ana e tij, megjithatë, as atje, ai nuk na tha psenë e tyre. Për ne është fare e qartë se ai këtë nuk e bëri ngaqë u tremb nga Partia. Po përse të trembej? Partia jonë është një parti marksiste-leniniste me zemër të madhe, prandaj askush nuk ka arsye të trembet prej saj. Edhe faje të rënda sikur të bësh, duhet të kesh besim të plotë në drejtësinë e gjykimit dhe të vendimit të saj. Në qoftë se ka drejtësi të vërtetë në ndonjë vend të botës ose në veprimtarinë e ndonjë partie marksiste-leniniste, kjo ekziston pikërisht në vendin dhe në Partinë tonë. Këtë të vërtetë e dinë dhe e ndiejnë anëtarët e Partisë sonë në çdo moment të jetës, si në çaste gëzimi, edhe në raste vështirësie apo mërzitjeje që shkaktohen kur një anëtar i Partisë gabon. Prandaj secili, në çdo rast, t'i hapë zemrën Partisë, t'i thotë singërisht përse e ka bërë një veprim të gabuar, ku ka qenë qëllimi dhe të jetë i bindur se sa më hapur t'ia tregojë Partisë fajin e kryer, aq më zemërmadhe do të tregohet ajo ndaj tij. Po përse vepron kështu Partia jonë? Për arsye se ajo, si një parti marksiste-leniniste, e vlerëson se gjatë luftës që bëhet për realizimin e programit të saj, ka edhe komunistë që rrëzohen, që bëjnë gabime dhe faje, megjithatë ajo e ndien për detyrë të përpiqet deri në fund që t'i ndreqë, t'i edukojë, t'i përmirësojë ata që mund të përmirësohen. Nga eksperiencia e Partisë së Punës të Shqipërisë, këtë qëndrim të saj e kanë të qartë të gjithë komunistët te ne, prandaj ata kur gabojnë ia çelin zemrën Partisë, i flasin asaj hapur e pa rezerva për brengat e tyre.

Krejt ndryshe na ndodhi me Beqir Ballukun. Ai nuk ia tha Partisë gabimet dhe fajet e rënda që ka kryer. Edhe disa gjëra që tha në mbledhjen e Byrosë Politike, me shumë zor i nxori. Akoma më pak foli ai në aktivin e kuadrove të Partisë në ushtri, ndërsa këtu, në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, u mundua të mohojë gjithçka. Beqir Balluku u frikësua dhe u përpoq të mohojë me arrogancë e me për-buzje gabimet e tij të rënda, qëndrimin e tij ndaj Partisë dhe udhëheqjes së saj. Kur Plenumi i kërkoi që ai të pohonte hapur fajet e tij të rënda, ai mbajti qëndrim të ulët. Ti Beqir Balluku deshe të mohosh gjithë veprimtarinë tënde armiqësore antiparti, që ke kryer dhe që ne, pa pasion, duke u bazuar në fakte dhe dokumente të shumta e të pakundërshtueshme, ta kemi provuar katërcipërisht. Përprjekjet që bëri udhëheqja kanë pasur vetëm një qëllim të pastër: të të ndreqin ty që ke kryer faje. Kështu kemi vepruar e veprojmë sa herë u bëjmë kritika shokëve.

Mendimet e gjithë anëtarëve të Byrosë Politike për çështjen që shqyrtojmë ne i kemi përqendruar në raportin që i kemi paraqitur këtij Plenumi, por në emër të të gjithë shokëve të Byrosë Politike dëshiroj t'ju shpreh atë kënaqësi revolucionare, marksiste-leniniste që ndiejmë ne për faktin që edhe mendimet e gjithë anëtarëve të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, janë në unitet të plotë e të çeliktë si kurdoherë me ato të Byrosë së tij Politike. Pikërisht këtu qëndron forca e pathyeshme e udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë sonë heroike, që mbështetet në unitetin e mendimit dhe të veprimit dhe në besnikërinë ndaj ideologjisë mark-

siste-leniniste, ndaj mësuesve të mëdhenj të proletaria-tit, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Shokë,

Lufta e klasave çon vazhdimisht përpara zhvillimin e jetës në vendin tonë dhe përpjekjet që bëhen për ndërtimin e plotë të socializmit. Kjo luftë, duke qenë forca kryesore lëvizëse e shoqërisë socialiste gjersa të ndërtohet komunizmi, na ndihmon të mbrojmë Partinë dhe shtetin tonë socialist nga degjenerimi borgjezo-revizionist dhe nga synimet e orvatjet e armiqve për rivendosjen e kapitalizmit në Shqipëri. Luftë klasash do të thotë marksizëm-leninizëm i zbatuar në teori e në praktikë. Në këtë luftë mbështetet teoria e Marksit, tek ajo bazohen luftërat çlirimtare të popujve, luftërat revolucionare të proletariatit ndërkombëtar, lufta për vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe për ndërtimin e socializmit në çdo vend të veçantë. Lufta e klasave është në kundërshtim me teorinë e «pajtimit klasor». Me të parën janë gjithë komunistët, marksistë-leninistët dhe revolucionarët e vërtetë; me të dytën, për «pajtimin klasor», janë imperialistët, socialimperialistët, revizionistët, socialdemokratët dhe gjithë antikomunistët e të tjerë si këta.

Këto që po them janë përsëritje e atyre mësimeve të Partisë që të tërë i dimë, por nuk mund të mos vëmë në dukje me krenari të ligjshme, se në krye të luftës së klasave që zhvillojmë ne brenda vendit dhe në shkallë ndërkombëtare qëndron e fortë Partia jonë, e cila lufton me trimëri në vijat e para të zjarrit për vënien në jetë të idealeve të proletariatit. Me zhvillimin e vazhdue-

shëm të luftës së klasave në të gjitha fushat e jetës, në vendin tonë ngrihet një botë e re, ku bëhen mrekulli, ku dalin me shumicë heronj e heroina, por, në të njëjtën kohë, dalin edhe armiq, tradhtarë, sabotatorë, vjedhës e mashtrues. Mirëpo vrulli revolucionar, që frymëzon Partia në vorbullën e luftës së klasave, që zhvillohet në vendin tonë, i spastron të gjithë këta të fundit. Ky vrull i përngjan rrymës së atij lumi të tërbuar që në mitologji flitet se shërbeu për të pastruar «hauret e Avgjisë»<sup>1</sup>. Kështu mund ta kuptojmë luftën e klasave të ne. Kjo luftë spastron dhe vazhdon të spastron plehrat e shoqërisë sonë socialiste, pse vetëm kështu krijohen kushtet që vendi të lulëzojë, që njerëzit të lindin dhe të rriten të shëndetshëm, që zemrat dhe mendjet e tyre të spastrohen nga të këqijat e së kaluarës dhe të modernistes çoroditëse.

Procesi i luftës së klasave do të jetë i gjatë e i pandërprerë. Po përse? Për arsye të ekzistencës së mbeturinave të rendit të përmbysur, si dhe të ekzistencës së rrethimit imperialist e revizionist kundër vendit tonë. Bota imperialiste e revizioniste bën sot një luftë të ashpër, të pamëshirshme, me të gjitha mjetet e format, me propagandë dhe me armë, që të çoroditë kudo njerëzit, që t'i vërë ata nën zgjedhën e saj, që të skllavërojë më lehtë popujt. Armiqtë bëjnë çmos që të luftojnë, në radhë të parë, partitë e vërteta komuniste dhe revolucionare, sepse këto parti u bëhen pengesë për synimet e tyre të errëta. Në ndihmë të botës imperialiste dhe

---

1. Sinonim i papastërtisë së madhe. Sipas mitologjisë greke, për të pastruar hauret, shumë të pista të mbretit Avgjl, u desh të lëshohet lumi.



revizioniste vijnë edhe mbeturinat e ideologjive të klaseve të përmbysura, që, siç na mëson Partia, ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve. Kundër këtyre mbeturinave ne po bëjmë dhe duhet të bëjmë vazhdimisht një luftë të gjatë, të pamëshirshme e të pandërprerë për spastrimin, sikurse thashë, të plehrave dhe për hapjen e rrugëve të gjera, për të arritur në socializëm e në komunizëm. Dhe spastrimi i këtyre plehrave as duhet të na çuditë, as duhet të na demoralizojë. Përkundrazi, të gëzohemi që po qërojmë radhët tona nga armiqtë dhe të pabesët. Në të kaluarën, Partia jonë ka pasur armiq në gjirin e vet, nuk përjashtohet që të tillë të ketë edhe tani brenda e jashtë radhëve të saj, por është meritë e Partisë që me kohë i ka zbuluar dhe i ka flakur tej me vendosmëri këta armiq. Një nga këta është edhe Beqir Balluku.

Nuk do të zgjatëm duke numëruar fajet e Beqir Ballukut, për arsye se jo vetëm që ato i analizuam me hollësi në Byronë Politike, por edhe sepse të tëra u vunë në dukje shumë qartë gjatë punimeve të këtij Plenumi. Vetë ju, shokë anëtarë të Komitetit Qendror, pasi lexuat materialin<sup>1</sup> që patët në duar, arritët të kuptoni se qëndrimi i Beqir Ballukut nuk është i pastër. Këtij problemi të madh, të rëndësishëm dhe shumë të rrezikshëm ju iu futët në gjithë gjerësinë e thellësinë e tij. Diskutimet tuaja, siç e përcaktova pak më

---

1. Raporti i Byrosë Politike «Mbi disa çështje të rëndësishme që kanë dalë në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe që kanë të bëjnë me vijën e Partisë në ushtri dhe me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes» që u shpërnda dhe u lexua nga anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë para mbledhjes së Plenumit.

parë, janë një plotësim shumë i çmuar i gjithë atyre mësimëve që nxori gjatë kësaj pune Byroja Politike. Këtu ne pamë se si ju, kush në një drejtim, kush në një tjetër, analizuat me kompetencë gabimet dhe fajet e rënda të Beqir Ballukut, jo vetëm nga ana politike dhe ideologjike, por dhe nga ana ushtarake.

Të tëra mendimet tuaja, duke përfshirë ndërmjet tyre edhe ato të anëtarëve të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, që nuk e morën dot fjalën, por që diskutimet e tyre të shkruara ia dhanë sekretarisë, janë një thesar i madh për Partinë, një mësim shumë i vlefshëm edhe për ne, që jemi zgjedhur këtu, në Byronë Politike, nga Komiteti Qendror. Asnjërit nga ne anëtarët e Byrosë Politike nuk duhet t'i shkojë mendja se kemi një epërsi të madhe e të padiskutueshme mbi ju, anëtarët e tjerë të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë. Kush mendon kështu gabon sot dhe mund të gabojë rëndë më vonë. Ne e kemi të qartë dhe e themi me tërë kuptimin e fjalës se udhëheqja e Partisë është Komiteti Qendror, ai është truri dhe zemra e Partisë, që na jep shpirt e gjallëri, që na jep vijën e drejtë për zgjidhjen e problemeve të Partisë dhe të shtetit, ndërsa ne, anëtarët e Byrosë Politike, bëjmë pjesë në këtë forum të lartë të Partisë njëlloj si edhe ju. Prandaj respekti ynë, respekti i anëtarëve të Byrosë Politike, është i madh për ju, shokë të Plenumit të Komitetit Qendror. Kështu do të jetë dhe duhet të jetë vazhdimisht, pse pa ju Byroja Politike nuk mund të ecë drejt. Pikërisht pse është Komiteti Qendror i fortë, prandaj edhe Byroja Politike është e fortë dhe ecën në rrugë të drejtë.

Gjithë studimi i veprimtarisë armiqësore të Beqir

Ballukut dhe punimet e këtij Plenumi u zhvilluan me pjekuri dhe me gjakftohtësinë më të madhe dhe vërtetuan se ai ka kaluar shkallë-shkallë në rrugën antiparti e armiqësore. Në këtë rrugë ai nuk ka hyrë pa qëllim, siç u përpoq të na bindte, por me qëllim, me vetëdije të plotë. Qëllimet e tij janë armiqësore dhe të dënueshme nga Partia, nga populli, nga të gjithë ne, pse veprimtaria e tij, siç do ta shpjegoj pak më vonë, vinte në rrezik të madh mbrojtjen e atdheut, përgatitjen ushtarake të popullit për kohë rreziku, ndërtimin e socializmit, lirinë dhe pavarësinë e popullit tonë, që, për t'i fituar, sakrifikoi kaq shumë gjak e djersë dhe përsëri vazhdon të sakrifikojë.

Si synimet që i kishte vënë vetes, ashtu edhe metodat që përdori Beqir Balluku për t'ia arritur qëllimeve të tij të dënueshme, ishin konspirative, puçiste, trockiste. Veprimtaria e tij armiqësore, antiparti dhe antishtetërore zhvillohej fshehurazi udhëheqjes së Partisë. Beqir Balluku shkeli rëndë normat dhe rregullat e vendosura nga Partia në ushtri, ai shkeli rëndë normat e Partisë në të gjitha drejtimit. Atij nuk i kishin shërbyer aspak si mësim gjithë lufta madhështore e Partisë dhe përleshjet e saj me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Respekti që është dhënë nga Partia dhe personalisht nga shokët e udhëheqjes nuk i kishin shërbyer atij për të punuar si komunist. Kur them ndihma nga Partia dhe nga udhëheqja, nuk kuptoj me këtë lavdërimet e bëra Beqir Ballukut, pse edhe nga këto ka pasur nga ana e kuadrove në adresë të tij, por e kam fjalën për kritikën që i janë bërë vazhdimisht për të gjitha ato gabime të tij, për të cilat ne jemi vënë në dijeni, pse për

ato që nuk na ka vënë njeri në dijeni, natyrisht, nuk kishim si të vepronim...

Duke i hedhur shkurtimisht një sy gjithë veprimtarisë së Beqir Ballukut, që arriti deri në këtë shkallë, vihet pyetja: «I tillë ka qenë ky gjatë gjithë jetës së tij në Parti?». Ne këtu jemi në udhëheqje të Partisë, prandaj na vihet detyrë që çështjet t'i gjykojmë të balancuara dhe me drejtësi. Beqir Balluku nuk ka qenë që në fillim armik i Partisë, me pikëpamje revizioniste e trockiste, por pak e nga pak degjeneroi. Kështu ai arriti të përgatitë prapa shpinës së Partisë dhe të udhëheqjes së saj një material kundër Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, duke bërë përpjekje për një organizim të rrezikshëm të ushtrisë, për shtrembërimin e strategjisë dhe të taktikës së luftës sonë, pra, për minimin e mbrojtjes dhe të shtetit tonë socialist. Ai ka punuar, me një fjalë, për revizionimin e vijës së Partisë në ushtri dhe të vijës së Partisë në përgjithësi, ka bërë orvatje për thyerjen e unitetit të mendimit dhe të veprimit në komandën e ushtrisë për të vënë në opozicion kuadrot kryesorë të ushtrisë me vijën ushtarake të Partisë dhe ka arritur deri në tentativa për çarjen e unitetit në udhëheqjen e Partisë...

Beqir Balluku është një njeri që ka luftuar, por ka luftuar dhe ka ecur ashtu si e njohim ne, me të meta e gabime dhe, duke pasur parasysh shkallën e njohjes, Partia e ka kritikuar për këto vazhdimisht. Përgjegjësia kryesore, për organizimin me vonesë të Brigadës II, i përket Beqir Ballukut. Faje të mëdha rëndojnë sidomos mbi Beqir Ballukun pas organizimit të Brigadës II, kur ajo hyri në veprime luftarake kundër armiqve dhe kur u shpartallua. Pikërisht për këtë ka përgje-

gjësi të madhe ai. Mirëpo sa më shumë që kalon koha këto përgjegjësi e gabime po harrohen. Nuk mund të mohohet nga askush, se kuadrot dhe partizanët e Brigadës II, si gjithë partizanët e brigadave të tjera, të divizioneve e të korparmatave, kanë qenë edhe ata luftëtarë trima, të vendosur e të sakrificës, shumë prej tyre u vranë dhe u plagosën. Mirëpo komandanti i Brigadës II ka pasur dobësi të theksuara, të cilat tani, pas dhjetëra vjetësh, nuk duhet të zbuten, të idilizohen dhe të mos vihen fare në dukje. Historia e Luftës Nacionalçlirimtare duhet paraqitur drejt, realisht e me objektivitet.

Dihet se historia në kuptimin e përgjithshëm është një shkencë, që studion tërësinë e fakteve dhe të ngjarjeve që kanë të bëjnë me të kaluarën e një populli ose të mbarë njerëzimit. Historia e Luftës sonë Nacionalçlirimtare ka për qëllim ta informojë popullin mbi të kaluarën, por edhe t'i mësojë dhe t'i edukojë brezat e ardhshëm me realitetin tonë të madh, në të cilin, natyrisht, ka pasur edhe gabime. Kur i vëmë në dukje këto gabime, nuk e ulim aspak, përkundrazi, e ngremë vlerën e madhe të Partisë sonë, të njerëzve tanë, të partizanëve tanë, të komandantëve tanë, që thyen dhe i damkosën në shtyllën e turpër armiq të panumërt, të pajisur me armët më të fuqishme të kohës. Brezat e ardhshëm do të mësojnë se gjyshërit dhe baballarët e tyre, që bënë revolucionin, sado që ishin trima, të rreptë dhe heronj, prapëseprapë edhe ata njerëz kanë qenë dhe, si të tillë, kanë gabuar, veçse gabimet e tyre i kanë ndrequr dhe bile në mënyrë të shkëlqyer. Provë e padiskutueshme për këtë është fakti se në sajë të luftës së vendosur të popullit, të udhëhequr me zotësi

e mençuri nga Partia, u çlirua Shqipëria, u vendos diktatura e proletariatit, u rindërtua vendi dhe, me përpjekje e sakrifica të panumërta, nëpërmjet një lufte të ashpër klasore brenda dhe jashtë vendit, po ndërtohet socializmi. Kjo fitore e shkëlqyer i detyrohet Partisë, u detyrohet njerëzve tanë të luftës dhe të punës, të cilët sot po shkojnë vazhdimisht duke u ngritur, duke u kalitur nëpërmjet luftërave, nëpërmjet të mirave e të këqijave, vështirësive e pengesave të shumta që hasin gjatë përpjekjeve që bëjnë për realizimin e detyrave.

Në luftë ka marrë pjesë edhe Beqir Balluku, ai ka punuar edhe pas Çlirimit në ushtri, por është kritikuar sa herë që ka gabuar, gjatë dhe pas luftës. Megjithatë, është fakt se Partia atij i ka dhënë dorën. Ne mendojmë se Partia kështu, siç ka vepruar, duhej të vepronte. Këtë qëndrim ajo nuk e ka mbajtur vetëm ndaj Beqir Ballukut, po për të gjithë anëtarët e saj që kanë gabuar...

Një parti nuk mund të jetë marksiste-leniniste, në goftë se nuk i kritikon anëtarët e saj dhe nuk u jep këtyre mundësi që t'i korrigojnë në jetë, në punë dhe në luftë gabimet që bëjnë. Kur këto nuk i korrigojnë dhe i përsëritin, Partia vazhdon t'i kritikojë, por, natyrisht, herën tjetër më fort dhe, kur ato trashen, atëherë merren masa, ashtu siç i dimë, sipas shkallës së fajit dhe, në radhë të parë, në interesin e Partisë, por edhe në interesin e personit, për ta sjellë atë në rrugë të drejtë, për ta edukuar me frymën e normave të Partisë.

Por duhet thënë se puna edukative e Partisë te Beqir Balluku nuk ka bërë asnjë efekt, se ai u borjezua. Beqir Ballukut iu rrit mendja, ai mendonte se

po të jesh në udhëheqje, duhet të gëzosh të gjitha favoret që të pëlqejnë. Kjo është një prirje e rrezikshme, shokë, bile jashtëzakonisht e rrezikshme. Në udhëheqësit duhet të na karakterizojë kurdoherë, kudo dhe në çdo pikëpamje thjeshtësia. Në vend që Beqir Balluku të kishte parasysh mësimet e Partisë së udhëheqësin duhet ta shquajë kurdoherë, kudo dhe në çdo drejtim thjeshtësia, ai mendonte se ishte njeri «i madh» dhe «i zoti». Dhe e vërteta është se kur njeriut i pëlqen shumë vetja, atij i rritet mendja dhe dalngadalë merr tiparet e borgjezit, jo vetëm të megalomanit, por edhe të gënjeshtarit. Beqir Balluku, natyrisht, gënjeshtar i bënte me marifete të holla. Ka një jetë të gjatë ai në Parti dhe i njeh mirë normat e saj, prandaj, pavarësisht se i shikon shokët nga lart, nuk është aq budalla, sa të mendojë se të tjerët hanë bar. Metodat që përdorte ai, dhe që karakterizojnë njeriun në degjenerim, nuk kanë qenë kaq të hapëta. Rrezikshmëria e Beqir Ballukut qëndron në atë se të gjitha këto që thamë, që e çuan atë në degjenerim dhe në një rrugë të tillë armiqësore, fshiheshin prapa qenies së tij si anëtar i Byrosë Politike.

Nga kjo ngjarje, në mënyrë të veçantë ne, anëtarët e Byrosë Politike, duhet të nxjerrim mësim të mëdha. Në asnjë rast dhe për asgjë të mos shfrytëzojmë funksionin tonë në forumin e lartë të Partisë. Kurrë të mos kujtojmë sikur jemi Orakulli i Olimp, kurse të tjerët janë ata mbi të cilët duhet të vendosim ne. Në qoftë se ndonjë nga ne, kushdo që të jetë, arrin të mendojë ose të punojë në këtë drejtim, ai duhet dënuar, duhet hequr nga radhët tona, bile sa më parë. Këtë duhet ta bëjë pa hezitim Komiteti Qendror i Par-

tisë, sepse është ai që na ka ngarkuar ta kryejmë këtë detyrë me partishmëri të lartë dhe si duhet, por kurdoherë brenda normave të Partisë dhe me thjeshtësinë më të madhe.

Krejt ndryshe ka vepruar Beqir Balluku. Ai e ka shpërdoruar besimin që i kishin dhënë Partia dhe Komiteti i saj Qendror, duke u përpjekur të sjellë përçarje ideologjike dhe politike në kokën e udhëheqjes, në unitetin e mendimit e të veprimit të saj, që është më kryesorja nga kryesoret. Këtu, që të mos zgjatemi, ka genë synimi kryesor i tij. Për t'ia arritur këtij qëllimi, në fillim Beqir Balluku nuk mund të vepronte jashtë sferës së veprimtarisë, ku e kishte ngarkuar Partia, prandaj ai punoi me këto synime, së pari, në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore dhe në ushtri. Të tilla përpjekje janë nga më të rrezikshmet, prandaj ndëshkohen rreptësisht nga Partia.

Se si ka vepruar Beqir Balluku në këtë drejtim, këtu u fol mjaft nga shokët që diskutuan, por veprimtaria e tij përçarëse e ka fillimin e vet në çështjen e përcaktimit dhe të dhënies së kompetencave. Çështja e ndryshimit të kompetencave ekziston tani kudo dhe do të ekzistojë edhe më vonë, për arsye se këto nuk janë dhënë një herë e mirë. Pra, nuk mund të jenë të pandryshueshme, se edhe vetë jeta jonë revolucionare ka dinamikën e saj. Ato vërtet janë përcaktuar, por nuk mund të thuhet se janë vendosur në mënyrë të përsosur një herë e përgjithmonë, prandaj ka vend që edhe të rishikohen, të korrigjohen, të përmirësohen dhe të ndryshohen sipas situatave, sipas kushteve, sipas zhvillimit të punëve. Shumë faktorë lozin rol në këtë çështje, një nga këta është edhe individualizimi



i drejtë i atyre organeve ose i atyre personave që duhet t'i marrin dhe t'i ushtrojnë këto kompetenca. Kompetencat jepen për mbarëvajtjen e punëve dhe për kryerjen sa më mirë të detyrave. Ushtrimi i drejtë dhe me ndershmëri i kompetencave të dhëna varet, në radhë të parë, nga ndërgjegjja e njerëzve, nga ndjenjat dhe konceptet e tyre. Kështu, kompetencat mund të kuptohen e të zbatohen drejt për të kryer një detyrë të madhe, por, kur ato kuptohen keq dhe me këtë keqkuptim pleksen ndjenjat e mendjemadhësisë, të prepotencës, të dominimit, duke u grindur se «Për ç'arsye më merr ti mua këtë punë që më takon ta bëj unë», «Pse nuk më pyet», «Kush të qëndrojë më lart e kush më poshtë» e të tjera, çështja deformohet e degjeneron deri në qëndrime e veprime pa parim.

Është karakteristike se në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore çështja e «mosmarrëveshjeve» për kompetencat ka marrë prej kohësh një trajtë jo të rregullt, gjë që nuk e gjejmë në dikasteret e tjera. Unë nuk them se në këto dikastere nuk ka të meta e gabime, por fakt është se asnjëherë nuk na kanë ardhur zëra në vesh që të ketë pasur dhe të ketë në to grindje e mosmarrëveshje nga ana e kuadrove kryesorë drejtues për shpërndarjen e kompetencave. Të tilla shfaqje të vazhdueshme si këto, që kanë ndodhur në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, ku njerëzit ankohen se «Ministri nuk na lë fushë të lirë veprimi», se «Për çdo gjë duhet të merret pëlqimi ose t'i raportohet ministrit» e të tjera, e të tjera, ne nuk i kemi dëgjuar deri më sot në asnjë sektor tjetër.

Po kush është fajtori kryesor për këto mosmarrëveshje që kanë ndodhur në udhëheqjen e Ministrisë së

Mbrojtjes? Fajlori kryesor, natyrisht, është Beqir Balluku. Ai, i nxitur nga konceptet e tij megalomane, nga ndjenjat mikroborgjeze dhe nga degjenerimi i tij borgjez, për të realizuar qëllimet e tij antiparti dhe armiqësore, mendonte të përgatiste terrenin, së pari, duke përçarë udhëheqjen në Ministrinë e Mbrojtjes. Një nga mjetet për t'ia arritur këlyre qëllimeve ishte «konflikti»<sup>1</sup> për shpërndarjen e kompetencave. Sigurisht, fajin kryesor në këtë drejtim e ka ai, por duhet vënë në dukje se nuk janë pa faj edhe shokët e tjerë kryesorë të ushtrisë, duke filluar që nga Petrit Dumja, Hito Çakoja e të tjerë, e të tjerë. Kjo çështje, siç u tha këtu, u bë problem tri herë në Byronë Politike ku janë kritikuar ashpër tri herë me radhë Beqir Balluku, Petrit Dumja, Hito Çakoja e të tjerë kuadro kryesorë në ushtri. Megjithatë këto shfaqje mikroborgjeze që përmenda, vazhdimisht kanë nxjerrë kokë në kuadrot kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ngritja e çështjes së strukturës dhe të riorganizimit të komandës, si dhe ankesat për shpërndarjen e kompetencave në kuptimin që njëri ka më shumë, tjetri ka më pak, janë shfaqje të karakterit mikroborgjez, janë prirje të elementëve të sëmurë, që kërkojnë si e si të marrin kompetenca njëri më shumë nga tjetri. Në udhë-

---

1. Në të vërtetë ky «konflikt», në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të cilin Beqir Balluku e paraqiste si për «çështje parimore», nuk ishte veçse një bluf. Ai e përmendte vazhdimisht këtë «konflikt» për të kamufluar veprimtarinë armiqësore të tij dhe të P. Dumes, me të cilin hiqej se kishte mosmarrëveshje, por, në fakt, të dy ishin bashkëpunëtorë në komplotin armiqësor që po kurdisnin kundër Partisë dhe popullit.

heqjen e Ministrisë njëri ankohej se «Ministri nuk më linte mua të punoja», se «Ai ngarkonte me punë jo mua, por të tjerët që janë ndën mua», ministri nga ana e vet kishte pakënaqësi se «Vartësi imediat nuk më informon» e të tjera. Kjo situatë bëri që puna të arrinte aty ku dëshironte Beqir Balluku, të tjerët i mbajtën ison atij. Kështu, ndërsa kuadrot e komandës në Ministrinë e Mbrojtjes u ndanë më dysh, vetë Beqir Balluku, që ishte shkaktari i kësaj situate të rrezikshme, hiqej si qengj. Situata e rrezikshme e ndarjes më dysh të kuadrove kryesorë të komandës, lidhur me strukturën, nuk i shqetësonte aspak kuadrot e komandës, por e konsideronin atë si diçka të zakonshme.

Byroja Politike dhe Këshilli i Mbrojtjes kishin mienduar për këtë çështje, pse strukturën që kërkonte një palë e kishim më përpara në ushtri, por më vonë, për të lehtësuar dhe për të përmirësuar drejtimin e ushtrisë ne e pamë të arsyeshme të krijonim një strukturë tjetër të ministrisë. Mirëpo disa, me gjithë kritikën që u bëheshin, të shtyrë nga ndjenjat mikroborgjeze të prepotencës e të komandimit, vazhdonin të kërkonin rikthimin e strukturës së parë, sa nga kjo këmbëngulje, në fakt, u arrit në një përçarje në komandë.

Kur ne, Hysniu dhe unë, morëm raportin që na kishin përgatitur shokët e ushtrisë për këto probleme, pa ditur asgjë për veprimtarinë armiqësore që kishte zhvilluar prej kohësh e vazhdonte të zhvillonte Beqir Balluku, përnjëherësh atë e kthyem mbrapsht, u tërhoqëm vëmendjen shokëve në ushtri, duke u vënë në dukje që të shikonin mirë se ç'ishin këto gjëra që po ngjishnin. U shpjeguam atyre se struktura ekzistuese e ministrisë nuk kishte asgjë të keqe, por e gjithë e keqja

ishte brenda tek ata, duke filluar që nga Beqir Balluku, në radhë të parë, e kështu me radhë të gjithë të tjerët. Duke e parë me shqetësim gjendjen që ishte krijuar, ne nuk mund ta linim më atë të zhvillohej, ashtu si kishte nisur. Më se një herë i kemi kritikuar ashpër në Byronë Politike Beqir Ballukun, Petrit Dumen e Hito Çakon për këto probleme. Në këtë gjendje e patëm të vështirë të gjenim arsyen se përse të ndodhte tani një gjë e tillë, prandaj menduam se duhej të kishte diçka tjetër, më serioze nga ç'parashtronte raporti i shokëve të ushtrisë. Në materialin që na u dërgua, ku vihej në dukje se komanda kishte arritur të çahet më dysh, as nga Petrit Dumja, as nga Hito Çakoja, pa lënë pastaj nga Beqir Balluku, nuk na thuhej asnjë fjalë për çështjen më të rrezikshme. Na u desh t'i thërresim të tre këta në takim dhe vetëm pas pyetjeve që iu bënë, mezi u arrit më në fund t'ia nxirrnim Petritit këtë çështje.

E gjithë çështja lidhur me mosmarrëveshjet për kompetencat na shpjegohej «me mungesën e eksperiencës dhe me dobësitë në metodën dhe në stilin e punës» që në Ministrinë e Mbrojtjes i kanë në majën e gjuhës. Mirëpo ne e kemi të qartë se tani kuadrove udhëheqës të ushtrisë nuk u mungon eksperiencia. E keqja e madhe nuk qëndronte në metodën e stilin e punës, por ky interpretim vazhdonte atje prej kohësh dhe ngulej këmbë sikur në këto drejtime qëndronte kontradikta parimore, sikur vetëm mbeturinat mikro-borgjeze ishin ato që i bënin ata të mos merreshin vesh me njëri-tjetrin.

Ç'na rezultoi nga këto qëndrime? Na rezultoi një gjendje mjaft e rëndë dhe e rrezikshme që, po të kishim

mbyllur sytë përpara saj, vendi ynë mund të çohet në një katastrofë të sigurt. E imagjinojmë këtë, shokë?

Nuk është e nevojshme, më duket mua, të zgjatëm në disa konkluzione që Partia i ka bërë me kohë, por mund të përmend me pak fjalë se si nga të gjitha këto që u analizuan në këtë Plenum dhe që në pamje të parë e pa u thelluar mund të duken të vogla e fare të vogla, krijohet një situatë e rëndë për Partinë dhe për popullin. Për tërë këtë gjendje, siç u vërtetua në mënyrë krejt bindëse e me fakte të shumta në këtë Plenum, fajtori kryesor është Beqir Balluku. Ai është revizionist, pse të tilla janë «tezat» e tij, revizioniste, antiparti, likuidatore. «Tezat» e tij nuk janë një «korrigjim i thjeshtë» i Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, sikurse u mundua të na mbushte mendjen ai. Këtu nuk është fjala për një korrigjim të thjeshtë, nuk është puna e një plotësimi apo përmirësimi, por orvatje për një përmbysje të plotë të të gjitha Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, që do të thotë dobësim dhe shkatërrim i gjithë mbrojtjes sonë. Po t'i shtojmë kësaj veprimtarie edhe punën e bërë prej tij për përçarjen në Ministrinë e Mbrojtjes, ca më shumë pastaj orvatjet tepër të rrezikshme për përçarje të udhëheqjes së shtetit dhe të Partisë, si dhe përpjekjet për t'ia kundërvënë kuadrot e ushtrisë udhëheqjes së Partisë, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë të pakundërshtueshme aktivitetin armiqësor të Beqir Ballukut.

Për ndreqjen e situatës së krijuar ka rëndësi të kuptohet gjendja dhe gjithçka të realizohet me vepra në jetë, të tregohen pa fjalë bombastike gabimet që janë kryer, qofshin të vogla apo të mëdha, përse janë bërë dhe ku e kanë burimin. Secili t'i bëjë pyetjen

vetes: Përse kam lejuar që të kryhen këto gabime? Gjithkush ta ketë të qartë se gabimet që kryhen dhe burimet e tyre nuk i fshihen dot Partisë. Sado të stërholluara që të jenë metodat, sado arsye të paraqitura si të vërteta që mund të përdoren për t'ia mbuluar realitetin Partisë, Partia jonë nuk mashtrohet. Ka në botë të tjera parti që mund t'i hanë kamuflimet, por Partisë së Punës të Shqipërisë asgjë nuk mund t'i fshihet. Për një kohë mund të ndodhë që edhe kësaj t'i mbahen të fshelura fajet, por ama jo përgjithmonë.

Partia na mëson dhe na këshillon të jemi kurdoherë të sinqertë dhe të thellohemi në gabimet që bëjmë, se në raste të tilla nuk është çështja e interesit të një ose të dy personave që dëmtohen, as çështja e qenies apo jo të një personi në udhëheqje, po çështja e një interesi shumë më të lartë, ajo e interesit të madh të popullit, të socializmit, të revolucionit. Prandaj, cilido, qoftë edhe udhëheqës, duhet të ecë medoemos në rrugën e Partisë dhe t'u bindet direktivave të saj, t'i bëjë ato mish e gjak të vetat, ndryshe nuk mund të jetë jo më në udhëheqje, por as brenda radhëve të Partisë. Në këtë drejtim nuk mund të ketë lëshime, oportunitizëm dhe liberalizëm ndaj anëtarëve të Partisë. Kur shihet se komunisti, cilido qoftë ai, nuk është në rrugë të drejtë, atëherë nuk e meriton të militojë më në këtë Parti. Që nga udhëheqësit e deri tek anëtari më i thjeshtë e më i riu i Partisë, jemi në një radhë dhe përgjigjemi të tërë për thyerjen e normave të saj.

Kultin e personit këtu, në Komitetin Qendror të Partisë, ne e kemi shtruar shumë herë. Unë mendoj, dhe këtë mendim dëshiroj t'ia them Komitetit Qendror, se kjo çështje, shokë, nuk është kuptuar mirë. Nuk

duhen barazuar adhurimi dhe kulti me dashurinë, me simpatinë, me respektin që kanë dhe duhet të kenë Partia dhe populli për të gjithë ata që punojnë mirë e drejt, që janë shërbëtorë të devotshëm të popullit dhe që sakrifikojnë gjithçka për çështjen e Partisë dhe të popullit.

Partia dhe populli duhet të shohin se midis masave ka edhe udhëheqës. Kjo është e domosdoshme, se në të kundërtën do të hidheshim në një tjetër gabim të madh, nga ana e majtë. Por, veç, për çdo gjë duhet vepruar me masë, brenda normave të Partisë. Prandaj, shokë, konceptet dhe situata që ekzistojnë lidhur me kultin e personit duhen ndrequr në rrugë partie, pse sjellin rreziqe të mëdha. Nga të dy anët po të shkosh në ekstrem në këtë çështje, krijohen rreziqe... Kjo që po them është e domosdoshme të kihet kurdoherë parasysh. Dhe këtë problem unë e ngrë deri edhe për kultin e një drejtori fabrike ose të një institucioni, sepse gjithsecili përgjegjës në vendin ku punon, kur nuk është i edukuar si duhet në rrugën marksiste-leniniste, duke shfrytëzuar pozitën që mund t'i jenë besuar në çdo rang qoftë, në Parti ose në shtet, ka rrezik të nxjerrë ndjenjën e njëfarë mendjemadhësie e të njëfarë prepotence.

Ne vëmë re se ka njerëz që marrin përsipër të bëjnë çdo gjë vetë, sikur vetëm ata dinë të punojnë dhe s'ka të tjerë. Jo, shokë, as ata që mendojnë kështu, as ne anëtarët e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të Partisë nuk jemi ata që bëjmë çdo gjë. Edhe ne, udhëheqësit, punojmë si gjithë të tjerët, prandaj askujt të mos i shkojë ndër mend sikur jemi ne që i bëjmë të gjitha. Punët kryhen më shumë atje, në bazë, nga pu-

nëtorët, nga fshatarët, nga teknikët. Prandaj nuk është aspak e drejtë që veprimtarinë krijuese të të gjithë këtyre njerëzve të ndërgjegjshëm, me duar të arta dhe me mendje të shkëlqyer, ta përvetësojmë ne sikur kjo veprimtari të ishte prona jonë. Ca më keq akoma do të ishte sikur të kapardiseshim si gjela me punën e të tjerëve. Ne duhet të bëjmë përpjekje që të kryejmë detyrën që na takon, të ndihmojmë, të organizojmë, të punojmë edhe vetë, duke u pleksur bashkë me masat në punë dhe duke ruajtur thjeshtësinë, që është karakteristikë e shkëlqyer e popullit tonë. Atëherë masat do të na duan e do të na respektojnë dhe, kur të jetë nevoja, do të na mbrojnë me gjithë shpirt si udhëheqës të Partisë e të shtetit të tyre.

Ne lypset ta kritikojmë Beqir Ballukun për veprimet e padrejta dhe për shtrembërimet që bënte ai në politikën e Partisë me kuadrot. Për këtë do të flas më poshtë. Në radhë të parë, dua të them që ky pësim duhet të na bëhet mësim, me qëllim që në qoftë se ka ndonjë anëtar të Komitetit Qendror të Partisë, që për shkak të pozitës që mban u bie në qafë kuadrove, i nënvleftëson, duke pasur në majë të gjuhës për cilindo prej tyre shprehjet «Ky nuk bën», «Ai nuk bën», «Kjo s'bën», «Ajo nuk bën» etj., ta rishikojë qëndrimin e tij. A, jo, shokë, qëndrime të tilla të njëanshme në vlerësimin e kuadrove nuk lejohen nga Partia. Pa të analizojmë një herë vetveten, domethënë, të bëjmë një autostudim dhe të shohim: jemi apo s'jemi në rregull me të tilla koncepte dhe qëndrime, që duken në ndonjë rast në punën me kuadrin? Me këtë nuk dua të them se një udhëheqësi i ndalohet të thotë pikëpamjen që ka nëse bën apo nuk bën një kuadër ose një tjetër për kryerjen



e një detyre. Çështja është që çdonjëri, çdo kuadër, të vlerësohet drejt, objektivisht, të çmohet me syrin e Partisë. Përveç kësaj, për të vlerësuar punën e një kuadri duhet marrë edhe mendimi i kolegjiimit të ministrisë e i kolegëve që kanë lidhje me kuadrin për të cilin bëhet fjalë dhe që e njohin atë nga të gjitha drejtimet, pse vetëm kështu do të ecim ashtu siç na mëson Partia në trajtimin e kuadrit.

Në mënyrë të veçantë për veten time, e kam shtruar shumë herë çështjen e kultit të personit, shokë, dhe ju lutem që këto që po them mos m'i merrni thjesht për modesti. Unë ju bëj thirrje edhe një herë që këtë çështje ta vëmë si duhet në rrugë të drejtë për të gjithë, pse kështu do të veprojmë në interesin e Partisë, në interesin e madh të popullit, ndryshe do të na krijohen situata të rënda. Shprehjet e dashurisë së popullit për mua janë shprehje të dashurisë për Partinë, duke qenë se unë jam Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të saj. Mua, natyrisht, më prek së tepërmi kjo dashuri dhe luftoj vazhdimisht që të punoj, me të gjitha forcat që kam, për ta merituar atë plotësisht, por, mbi cilindo udhëheqës, sado merita që të ketë, qëndron Partia, ajo është e duhet të mbetet në çdo kohë forca e vetme udhëheqëse dhe e pavdekshme. Dua të them se në qoftë se çështjen e kultit të personit, për të cilën po flas e kuptojmë drejt, dhe duhet ta kuptojmë drejt jo vetëm për mua, po për të gjithë, atëherë punët do të na shkojnë akoma më mirë, uniteti ynë do të jetë më i çeliktë, uniteti i Partisë me popullin do të bëhet i pathyeshëm. Ndryshe, krijohen situata të vështira që i shfrytëzon armiku.

Pra, këtë çështje, shokë, ta kuptoni drejt. Të mos

harrojmë atë që ka thënë Marksit kur flitej për të në kohën e Internacionales. Ai thoshte se nga neveria që ka pasur për çdo lloj kultit të individit, nuk ka lejuar që të botohen mjaft mesazhe nga shumë vende të botës, në të cilat flitej për meritat e tij dhe me të cilat e kishin mërzitur, siç thoshte vetë, bile ai as u qe përgjigjur atyre, përveç pak rasteve kur i kishte qortuar ata që i qenë drejtuar. Ky qëndrim i Marksit ka një kuptim të thellë ideologjik. Duke u bazuar në këtë mësim të madh të Marksit, e kam theksuar edhe herë të tjera rëndësinë parimore të kësaj çështjeje. Megjithatë, konstatoj se Partia nuk punon mirë në këtë drejtim. E them këtë se porsa piqem unë me njerëz, të gjithë më shprehin tërë atë dashuri. Me këtë rast të tërë janë mësuar të më thonë: — Shoku Enver të na rrosh ti, ti na bërë gjithë këto të mira, ti na bërë atë, ti na bërë këtë — etj., etj. dhe këto shprehje që të mërzitën, nganjëherë teprohen aq shumë, sa prej tyre nuk guxoj të dal përjashta. Thua ju sa të duash njerëzve, se këto vepra të mira i ka bërë Partia, i ka bërë populli, nën udhëheqjen e Partisë etj., etj., por ata prapë të përgjigjen: — Po, vërtet Partia i bëri, por, po të mos ishte ti, nuk bëheshin — etj. Çfarë të bëjmë ne tani, t'u themi në mënyrë të prerë dhe menjëherë këtyre njerëzve mos flisni më për Enver Hoxhën? Po të vepronim kështu, do të bënim gabim të madh dhe do të dëmtonim rëndë Partinë. Prandaj direktiva kundër kultit të personit duhet të vihet në jetë vazhdimisht e në mënyrë normale si për mua, për të gjithë shokët e tjerë anëtarë të Byrosë Politike, ashtu edhe për ju anëtarët e Komitetit Qendror, bile deri edhe për një drejtor fabrike ose institucioni.

Edhe udhëheqjes si forum, si organ kolegjal, ne

duhet, gjithashtu, t'i japim me masë autoritetin që i përket, natyrisht, t'i japim autoritet më shumë se personave të veçantë, por të kemi kujdes që të mos biem në pozitë e atyre që mendojnë se çdo gjë mund të kryhet vetëm lart. Para pak kohe më shkruante një letër një person nga rrethi i Gjirokastrës dhe më qajej për disa veprime të padrejta që pretendonte se bëheshin në rreth. Ai thoshte: «Shoku Enver, ujët lart del i kulluar, po turbullohet poshtë». Kjo është një shprehje e kultit të udhëheqjes. Porosita që shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Gjirokastrës ta thërritnin këtë person dhe t'i shpjegonin sa më qartë se ujët del i pastër lart, por ai del i pastër edhe poshtë, ashtu sikundër mund të dalë i turbullt nga lart edhe nga poshtë, bile edhe sikur të ndodhte që ujët lart të dilte jo shumë i pastër, poshtë e kanë për detyrë ta pastrojnë atë, ashtu sikundër këtu lart merren masa për ta pastruar ujët kur ai turbullohet poshtë. Kjo mënyrë të menduari dhe të vepruari është marksiste dhe jo ashtu siç më shkruan ky person ose siç mund të mendojë poshtë ndonjë tjetër si ky. Nuk është e vërtetë që në këtu lart jemi të pagabueshëm dhe të tërë poshtë janë të gabueshëm. Çfarë janë këto pikëpamje dhe kush i sjell te ne? Rezultat i kujt është një mendim i tillë? Ky është rezultat i pikëpamjeve të kultit, i pikëpamjeve të shtrembra, që nuk janë marksiste, mbi individët dhe mbi forumet, prandaj këto çështje duhen sqaruar vazhdimisht e në mënyrë të vendosur.

Shokë, Partia në ushtri duhet forcuar, pse, derisa vërtetohen ngjarje të tilla, del vetvetiu konkluzioni se në organizatën e Partisë në ushtri duhet punuar akoma më shumë. Është e vërtetë që ushtrinë dhe kuadrot e

saj i kemi shumë të mirë, por të kemi kujdes nga teprimet dhe të mos përdorim në asnjë rast për vlerësimin e tyre termin bombastik: «I shkëlqyeshëm», «Kemi kuadro të shkëlqyeshëm», që do të thotë se kuadri qenka i përsosur, pa asnjë të metë. Ky qëndrim ndaj kuadrove sjell shumë të këqija, prandaj të jemi pak modestë, se më duket që këtu i ka rrënjët edhe ajo frymë pompoziteti dhe madhështie që ekziston në ushtrinë tonë si trashëgim nga koha kur kishim marrëdhënie me sovjetikët.

I ndjek vazhdimisht me kujdes, nëpërmjet televizionit, festivalet e ndryshme që organizohen te ne. Më pëlqojnë shumë se atje këndojnë njerëzit tanë, këndojnë artistët tanë me dashuri e ngrohtësi për Partinë, për njerëzit e punës, për heronjtë e ndërtimit të socializmit. Por, po të vësh re me vëmendje artistët e ushtrisë, do të shikosh se ata dalin në skenë krejt ndryshe nga ata të ansambleve të tjera amatore e profesioniste, që këndojnë normalisht pa poza e pa prirje për t'u dukur. Edhe te disa ushtarakë ka një ton mburrjeje, sikur ata janë mbi të gjithë të tjerët. Nuk janë kurrë karakteristika të mira për njerëzit tanë mburrjet, lëvdatat, përpjekjet për t'u dukur, pompozitetet dhe pozat. Jo, neve s'na kanë hije të tilla paraqitje, njerëzit tanë duhet të jenë kurdoherë e kudo të thjeshtë!

Po përse ka shfaqje të huaja në ushtri, shokë? Sepse atje organizata e Partisë nuk ka punuar thellë për formimin e karakterit e për edukimin e modestisë proletare të njerëzve të ushtrisë sonë. Prandaj në këto drejtime duhet punuar me këmbëngulje që mësimet e Partisë të kuptohen dhe të zbatohen drejt. Kjo lyp përpjekje të vazhdueshme dhe një vigjilencë të mprehtë

në ruajtjen e vijës së Partisë, pse të gjitha sa kanë ndodhur tregojnë qartë se atje ka munguar vigjilenca revolucionare.

Kur ne kemi parë që ju, shokë të ushtrisë, keni punuar mirë, ju kemi përgëzuar për ato detyra që keni kryer mirë, por në rastin konkret nuk mund të mos ju kritikojmë, bile t'ju kritikojmë ashpër, për arsye se ju nuk vepruat energjikisht kundër kësaj situatë të rrezikshme në ushtri, duke lejuar kështu zhvillimin e veprimtarisë armiqësore nga ana e Beqir Ballukut. Po të vazhdonte gjatë kjo situatë, mund të ndodhte katastrofë në ushtri dhe ne të mos dinim gjë hiç. Vigjilencë është kjo? Jo, shokë, kjo nuk është vigjilencë, ose është një vigjilencë shumë e çalë, sepse jeni mjaftuar vetëm duke konstatuar atë që po shkelte vijën dhe normat e Partisë, pa informuar udhëheqjen. Nga ky qëndrim të krijohet përshtypja sikur për ju nuk ka ekzistuar as Komitet Qendror i Partisë, as Byro Politike dhe as Këshill i Mbrojtjes. Në këtë drejtim del qartë se në ushtri duhet punuar shumë që Partia të mësohet të jetë me të vërtetë vigjilente. Të kuptohet drejt e të respektohet hierarkia ushtarake, por me kusht që organet më të larta dhe përgjegjësit të veprojnë në përputhje me direktivat e Partisë.

Ajo që shpjegova pak më parë për anëtarët e Komitetit Qendror dhe për anëtarët e Byrosë Politike vlen edhe për komandantët dhe për komisarët e ushtrisë. Të gjithë kuadrot me përgjegjësi ushtria do t'i dojë dhe do t'i respektojë, por jo të mbyllë sytë kur ata nuk kryejnë detyrën, kur thyejnë normat e Partisë dhe ligjet e shtetit. Ushtria t'i dojë dhe t'i respektojë eprorët vetëm nga puna e mirë që bëjnë, nga sjelljet shembullore që mbaj-

në, nga partishmëria e lartë në drejtimin e punëve, nga zbatimi me përpikëri dhe pa lëshim i ligjeve, i Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, i normave të Partisë dhe jo nga shkalla e përgjegjësisë që kanë. Hierarkia në ushtri ekziston, por ajo nuk duhet të kuptohet formalisht. Në qoftë se je komandant toge, komandant batalioni apo komandant i një njësie më të madhe të tërë të duan me gjithë zemër, të respektojnë e të nderojnë shumë përderisa punon dhe vepron me të vërtetë si një njeri partie, që zbaton me këmbëngulje vijën dhe normat e Partisë, Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, por nuk të duan vetëm thjesht për arsye se ti je komandant. Një respekt i mbështetur vetëm në hierarki nuk është i ndërgjegjshëm dhe nuk na duhet gjë. Po të kuptohet kjo çështje drejt, nuk do të na ndodhin më në ushtri, jo vetëm ngjarje të mëdha dhe shumë të rënda si kjo e tanishmja, por as të tjera më të vogla, se edhe të voglat, duke u përsëritur shpesh njëra pas tjetrës, formojnë një zinxhir të gjatë nga i cili linden pastaj ngjarjet e rënda e të jashtëzakonshme në ushtri.

Në një raport të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore të vitit 1972 kam lexuar se në ushtri gjatë atij viti ka ardhur duke u rritur numri i aksidenteve. Kjo na shqetësoi shumë dhe thamë: «Ku po shkojnë kështu? Ku është atje organizata e Partisë, a zbatohen atje normat dhe disiplina e Partisë? Ç'bëhet në ushtri për vënien e tyre plotësisht në jetë?». Nuk dua të them me këllë se nuk na ngjasin aksidente edhe në sektorët civilë të punës, por në ushtri më duket se ato ndodhin më shumë për faj të njerëzve, prandaj mendoj se lufta ideologjike e politike kundër çdo shfaqjeje të huaj nga ana e organizatës së Partisë në ushtri duhet të bëhet më e thellë

e më e ashpër. Nganjëherë vihet re që ekziston frika se mos s'thuret disiplina në ushtri, duke u kufizuar vetëm në punën edukative. Partia ka theksuar vazhdimisht që, si kudo, por sidomos në ushtri, duhet të ketë një disiplinë të rreptë, ama kjo nuk duhet të jetë një disiplinë shkopi, por e ndërgjegjshme, marksiste-leniniste dhe e tillë që ushtari të bëhet copë jo për komandantin si person, po për Partinë. Kjo do të arrihet kur çdo ushtar ta kuptojë thellë për ç'arsye dëshiron Partia që ai të jetë i disiplinuar, që çdo gjë në ushtri të kryhet nga të gjithë brenda normave të saj, që të mos shkelen rregulloret ushtarake nga kurrkush etj. Kur ndonjëri, cilidoqoftë ai, kryen akte që nuk janë në pajtim me detyrën dhe me dinjitetin ushtarak, të kritikohet pa hezitim për thyerjen e disiplinës dhe, kur është rasti, sipas rregullave në fuqi, të ndëshkohet.

Beqir Balluku nuk ka pasur kontakte me ushtarët e thjeshtë që këta të mund ta kritikonin për pikëpamjet dhe veprimet e tij armiqësore, ata nuk ishin në dijeni për këto pikëpamje, por shumë shokë rreth e rrotull Beqir Ballukut, që kanë pasur kontakte të shumta me të dhe i kanë konstatuar kush e di sa veprime jo të rregullta në punën e tij, vetëm tani flasin. Këto një mijë e një gjëra që kanë të bëjnë me shkeljen e normave të Partisë nga ana e Beqirit, pse na i nxirrni vetëm tani, shokë? Ku keni qenë që nuk na i keni thënë me kohë? Ne, anëtarët e Byrosë Politike, për ato gabime, të meta e dobësi që ia kemi parë vetë ose për ato për të cilat kemi qenë informuar nga Partia, ia kemi «darë kokën» Beqir Ballukut, duke e kritikuar drejt sipas mësimeve të Partisë, kurse për gjithë të tjerat, që na thuhën tani, ne nuk dinim asgjë, s'kishim se ç't'i vinim në dukje.

Harxhoheshin qindra mijë lekë në ushtri për dreka e për darka të shtruara miqve, megjithëse këto pritje mund të përgatiteshin mirë me më pak shpenzime. Si nuk e ngritën një herë zërin për këto shpenzime pa vend gjithë këta oficerë që venin në to? Ju, shokë, e kritikoni me të drejtë Beqir Ballukun, që vinte në repart dhe atje nuk bënte asgjë, nuk ju ndihmonte fare, po organizonte ahengje. Po ama këto kritika i bëni vetëm tani. Përse nuk informonit me kohë udhëheqjen për këto? . . . Apo pritnit që vetëm anëtarët e Byrosë Politike ta kritikonin? Ne ia kemi thënë Beqir Ballukut të gjitha ato që dinim për të, por ishte detyrë edhe për ju që të na informonit për ato qëndrime që kishit vënë re tek ai dhe që nuk përputheshin aspak me vijën e Partisë.

Në një aktiv të ushtrisë komandantët e disa njësisve ushtarake janë ankuar, se gjatë shumë vjetëve asnjëherë Beqir Balluku nuk u paska shkuar në njësitë e tyre. E vërteta është se ai ka shkuar me dhjetëra herë në rrethet ku janë këto njësi, por nuk ka ndihmuar aspak. Ai bridhte aq shumë rretheve sa e keni kritikuar, por, siç del, ai shkonte «në bazë» jo për të ndihmuar, por për gjah, për dreka e për darka.

Kur e konstatojmë ne këtë metodë pune të përciptë të Beqir Ballukut e kritikojmë nga pikëpamja që thashë, kurse ju poshtë edhe kur ju vinte dhe nuk ju ndihmonte fare, por merrej me darka, me estrada etj., nuk e bënit si duhet detyrën në këtë drejtim. Në vend që ta futnit atë në mengenenë e Partisë, ju keni heshtur para gabimeve të tij. Le të ishte ai anëtar i Byrosë Politike, ju mund ta kritikonit e pastaj të na raportonit njëkohësisht edhe neve. Pra, ndërsa Beqir Balluku ka fajë të rënda për veprimtarinë e tij armiqësore, shokët



e tjerë kanë faj pse nuk e denoncuan këtë veprimtari. Beqir Ballukut tani duhet t'ia themi të gjitha ç'ka bërë dhe ta ndëshkojmë për fajet e kryera, por ama të mos harrojmë as gabimet e lëshimet tona. E kam drejt këtë gjë?<sup>1</sup> Ne themi dhe e përsëritim kushedi sa herë që kemi Partinë, e cila na ndreq të gjithë sa herë që gabojmë. Kjo është e drejtë, sepse sytë e Partisë janë të shumtë, ata shikojnë më larg dhe në një kënd më të gjerë nga sytë e disave që kanë shikim të kufizuar. Dua të them se të gjitha forcat e Partisë, me një vullnet të çeliktë, duhet të bashkohen kundër kujtëdo që gabon, kurdoherë me qëllime të mira për të ndrequr sa më parë çdo shkelje e shtrembërim, në interes të përgjithshëm, njëkohësisht për të shpëtuar e për të ndrequr në kohë edhe atë që ka gabuar.

Në organizatën e Partisë në ushtri duhet të kuptohet, gjithashtu, drejt demokracia proletare dhe jo në mënyra formale, sa të mbulohet prepotenca, hierarkia e sëmurë, kulti i personit, sa të lejohet dobësimi i kritikës së drejtë parimore dhe revolucionare. Krahas demokracisë, duhet të kuptohet thellë në ushtri edhe disiplina, për të cilën fola pak përpara. Ne duhet ta kemi disiplinën të fortë, të ndërgegjegjshme sepse jemi kundër disiplinës nga frika, kundër disiplinës së kastës dhe asaj borgjeze.

Detyrën e ruajtjes së sekretit shtetëror Partia na e ka theksuar vazhdimisht çdo ditë. Ruajtja e sekretit në mënyrë të veçantë në ushtri është një nga detyrat kryesore. Mund të ndërtohet sa të duash objekte ushtarake,

---

1. Zëra aprovimi nga salla.

mund të lodhesh e të bësh stërvitje shumë çdo ditë, mund të bësh gjithçka mirë, por, në qoftë se sekretit fluturon jashtë njësisë ose repartit, jashtë shtabit apo komandës, armiku t'i mëson të tëra ato që bëre dhe merr masa që, kur t'i vijë koha, të shkatërrojë. A kuptohet kështu në ushtri kjo çështje? Mua më duket se nuk kuptohet në këtë shkallë. Kudo ka familjaritet, por më i rrezikshëm se kudo familjariteti është në ushtri. Në aktivin e kuadrove të ushtrisë u theksua me të madhe domosdoshmëria e ruajtjes së sekretit në ushtri. Mirëpo ç'ndodhi? Me të dalë oficerët nga aktivin, u përhapën fjalë për punimet e tij në një kohë kur akoma nuk kishte marrë dëgjimi as vetë Komiteti Qendror i Partisë. Vihet pyetja: Si do ta ruajmë me rreptësi gamën e madhe të sekreteve të tjera ushtarake, gjersa njerëzit tanë nuk qenë në gjendje të mbajnë dot sekret këtë gjë, për të cilën u porositën në mënyrë të veçantë? Partia duhet ta trajtojë me seriozitetin më të madh këtë çështje në ushtri dhe të kërkojë ruajtjen e sekretit me rreptësinë që nevojitet. Ndryshe, në qoftë se armiku i mëson lehtë të gjitha sekretet ushtarake nga llafazanët që i bëjnë muhabetë pazari këto çështje, nuk kanë asnjë vlerë as përgatitjet që bëhen për mbrojtjen e atdheut. Prandaj të nxjerrim mësimet të mëdha nga kjo ngjarje dhe t'i kemi vazhdimisht mirë parasysh këto porosi.

Beqir Balluku, sikurse e dini, tri herë ka dashur të japë dorëheqjen. Kjo nuk është diçka e thjeshtë. Nuk do të zgjatem për këtë çështje pse vetë ju, shokë të Plenumit, i shpjeguat mirë arsyet e këtyre orvatjeve të tij. Ne jemi plotësisht dakord me ato që thatë dhe që përputhen me konstatimet e Byrosë Politike. Kur Beqiri

erdhi për herë të parë e më foli mua për dorëheqjen nga detyra e tij si ministër i Mbrojtjes, unë, natyrisht, kujtova se kjo përçapje nga ana e tij do ta kishte buri-min te mosmarrëveshjet e tij me Petrit Dumen. Kjo ka ndodhur pas mbledhjes<sup>1</sup> që bëri Byroja Politike në vitin 1970, kur ne kritikuan si Beqirin, ashtu edhe Petritin për mosmarrëveshjet për të cilat edhe vetë këta bënë kritikë edhe autokritikë. Beqiri më zuri mua një ditë në rrugë e më tha: «Shoku Enver, e mira është që unë të largohem nga detyra e ministrit të Mbrojtjes». Një metodë të tillë ndiqte ai, e kishte bërë zakon që t'i kapte shokët nëpër qoshe për t'u thënë ndonjë gështje me dy fjalë.

«Pse të largohesh nga detyra?», — ia ktheva unë.

«E po ja, të iki, pse, siç doli edhe në mbledhjen e

---

1. Byroja Politike e KQ të PPSH, e mbledhur më 3 dhjetor 1970, diskutoi mbi disa gështje të përgatitjes luftarake në ushtri, të roitit udhëheqës të komiteteve të Partisë, si dhe të forcimit të rregullit e të disiplinës. Në konkluzionet që bëri në fund të mbledhjes shoku Enver Hoxha kritikoi rreptë Beqir Ballukun dhe Petrit Dumen për faje të rënda në drejtimin jo të mirë dhe në nivel të Ministrisë së Mbrojtjes, për prirje të theksuara kapadallëku, për pikëpamjet jo të drejta, të cekëla e të sipërfaqshme për kuadrin, për mbivlerësim të vetvetes dhe mendjemadhësi, për të meta të theksuara e serioze të të dyve në karakterin e secilit, për gabime të përsëritura, për largim nga baza, nga trupa, për moszbatimin në ushtri të urdhrave dhe të rregulloreve, për nënvlefësimin e edukimit marksist-leninist në ushtri, për përqendrimin në duart e veta të shumë kompetencave etj. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 45, f. 26.) Beqir Balluku dhe Petrit Dumja ishin kritikuar edhe më parë nga udhëheqja e Partisë dhe personalisht nga shoku Enver Hoxha për gabime dhe pikëpamjet e tyre të gabuara.

Byrosë Politike, ne me Petritin nuk merremi dot vesh me njëri-tjetrin» etj.

«Shiko, — iu përgjigja aty për aty, — shantazhe Partisë mos u përpiq t'i bësh, se asnjëri nuk ka frikë prej teje. Do të jesh apo nuk do të jesh ministër, këtë e vendos Partia dhe ti je ushtar i saj, prandaj dorëheqja që po jep nuk mund të pranohet rrugëve».

Ishte hera e parë për mua, shokë, që dëgjoja nga një anëtar i Partisë sonë të kërkonte dorëheqjen nga detyra, pa lëre pastaj që kjo kërkesë të bëhej nga një anëtar i Byrosë Politike!

«Mos kërkon t'i bësh presion Partisë?» — iu ktheva edhe një herë unë.

«Jo», — u përgjigj Beqiri.

«Atëherë, përse e bën këtë kërkesë?» — e pyeta dhe vazhdova: «Shiko Beqir Balluku, mos u përpiq t'i krijosh vështirësi Partisë. Ti duhet të kesh të qartë mirë se Partia nuk ka frikë nga kurrkush. «Arsyeja» që parashtron ti nuk ka asnjë bazë të shëndoshë. Veç kësaj nuk mendon pak si udhëheqës se ç'do të thotë bota nga ky akti yt? Opinioni do të pyesë: «Pse u largua Beqir Balluku nga ushtria, derisa ai nuk ka asnjë arsye?». Ti gabimet e tua i pranove në mbledhjen e Byrosë Politike, prandaj duhet të jesh i qetë dhe të rrish atje ku je caktuar. Në qoftë se nuk duhet të jesh më në detyrën që kryen sot, vendos forumi kompetent».

Ai u largua dhe kjo çështje mbeti me kaq.

Mënyra e paraqitjes së dorëheqjes nga ana e tij dy herë të tjera më vonë na u duk e pashpjegueshme dhe shumë e dyshimtë, po fakte që të hidhnin dritë mbi të vërtetën nuk kishim. Duke u këshilluar së bashku me Hysniun [Kapo] dhe me shokë të tjerë për këtë kërkesë

të përsëritur të Beqir Ballukut, thoshim me njëri-tjetrin: «More pse ndodh kjo, ku e ka hallin ky njeri?»<sup>1</sup>.

Kërkesën e dytë për dorëheqje ai ia drejtoi shokut Hysni, po ky i tha: «Shoku Beqir, kjo çështje i përket shokut Enver, prandaj shko drejtpërdrejt tek ai dhe thuaja arsyet përse nuk dëshiron të jesh ministër i Mbrotjtjes».

«Po, — i kishte thënë ai shokut Hysni, — do të shkoj t'ia parashtroj vetë këtë kërkesë shokut Enver».

Mua kërkesën e tij ma raportoi shoku Hysni. Prita mjaft ditë të më vinte Beqiri, por ai nuk erdhi. Disa muaj më vonë ai shkoi përsëri te shoku Hysni dhe i thotë se dëshiron të japë dorëheqjen nga detyra e ministrit. Si kishte mbaruar fjalën Beqiri, Hysniu e kishte pyetur: «Vajte te shoku Enver, apo nuk vajte?».

«Jo, nuk vajta», — i ishte përgjigjur Beqiri.

«Po unë të thashë që radhën e parë të veje te shoku Enver, se unë s'mund të të them gjë për një kërkesë të tillë. Prandaj shko ia thuaj atij këtë që mendon, jo mua».

«Po, do të vete», — i tha ai përsëri. Megjithatë prapë tek unë nuk u duk.

Kur e thirra një ditë për të më folur për disa çështje ekonomike të ushtrisë për të cilat më kishin ardhur

---

1. Këtu ndërhyr M. Shehu, i cili thotë: «Kërkesa e dytë e dorëheqjes ka ndodhur pikërisht në atë kohë kur shokët kryesorë të Ministrisë së Mbrotjtjes Popullore ia hodhën poshtë Beqir Ballukut materialin e tij të dytë që u përgatit në vitin 1972». Kjo ndërhyrje e M. Shehut flet qartë për atë që ky armik i rrezikshëm, i fshehtë dhe dredharak, kur e pa se po digjej karta Beqir Balluku, u përpoq të shpëtonte të tjerët, P. Dumen e H. Çakon, që ishin pjesëtarë të komplolit.

në vesh disa të dhëna jo të mira, e kritikova rreptë, sa nuk e pa rrugën nga të shkonte. Është kështu Beqir Balluku apo jo?

*BEQIR BALLUKU:* Po, kështu është!

*SHOKU ENVER HOXHA:* I thashë atëherë: «More Beqir, ti ke folur dy herë me shokun Hysni për dorëheqjen tënde nga drejtimi i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç një herë tjetër më parë që më je drejtuar mua. Pra, gjithsej bëhen tri herë që ke përsëritur të njëjtën kërkesë. Mund të më sqarosh, përse e kërkon dorëheqjen?».

«Po ja, — vazhdoi ai, — se jam pak i sëmurë».

«Sëmundjen tënde ne e dimë, — iu përgjigja unë, — të sëmurë janë dhe të tjerë, bile më rëndë se ti, megjithatë asnjë nuk është tërhequr, të tërë vazhdojnë të qëndrojnë në krye të detyrës dhe luftojnë me të gjitha forcat ta kryejnë mirë atë. Prandaj edhe ti, — e këshillova, — organizo si duhet punën, jepu kompetenca shokëve që ke në vartësi se tani kemi sa të duash shokë të ngritur partie edhe në ushtri. Nuk po flasim ne ditë e natë këtu që t'u japim kompetenca shokëve që të përgatiten për të na zëvendësuar në detyrat që na janë ngarkuar? Ti duhet t'i zbatosh edhe porositë e Partisë që kanë të bëjnë me trajtimin dhe përtëritjen e kuadrit, se vjen koha edhe do të sëmuremi, shëndeti me kalimin e moshës do të na bjerë, prandaj duhet të përgatitim kuadro të rinj për në shtabe, në mënyrë që edhe vetë të lodhemi më pak, edhe të rinjtë të mësojnë, të kaliten, të përgatiten. Tani ti do të vazhdosh të jesh në Ministrinë e Mbrojtjes. Kur shoku Hysni të ka këshilluar të vije tek unë për të biseduar drejtpërdrejt, përse nuk ke ardhur për një kohë të gjatë?».

«E po ja, nuk erdha për këtë, nuk erdha për atë», — më përgjigjej.

Ato që më thoshte Beqir Balluku ishin hiç gjëkafshë, ishin gjepura. Për të gjithë ne është e qartë, se ai nuk erdhi tek unë, shokë, pse kishte frikë të më thoshte cila ishte arsyeja që donte të jepte dorëheqjen.

Kishte rast më të mirë se ky takim me mua për Beqir Ballukun që të më thoshte të vërtetën pse grindeshin midis tyre shokët kryesorë të ushtrisë, të më fliste për materialin që kishte përgatitur? Bile edhe kur unë e pyeta: «Mos keni gjë prapë me shokët atje?» ai m'u përgjigj: «Jo, jo, jemi në rregull tani». Në këtë takim Beqiri mund të më informonte si qëndronte çështja, bile me hollësi, se unë i hapa rrugën. Ai po të ishte i sigurtë e i pastër duhet të bënte edhe autokritikë për atë që kishte nxjerrë një material, për të cilin kishte punuar fshehurazi tre vjet me radhë. Jo, shokë, ai nuk më tha asgjë mbi këtë çështje.

Lidhur me dorëheqjen që orvatej të jepte Beqir Balluku, dyshimet tona po bëheshin më të thella, por akoma nuk arrinin të gjenim arsyeën e vërtetë të tyre, të cilën e gjetëm vetëm kur u zbulua çështja kohët e fundit.

E vërteta është që Beqir Balluku donte të largohej nga detyra si ministër i Mbrojtjes që të mbetej vetëm si zëvendëskryeministër dhe këtej, duke intriguar sa më nga lart, të mbante në lidhje dhe të drejtonte përnjëherësh, edhe Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme; me një fjalë të bëhej akoma më i plotfuqishëm dhe të intrigonte më mirë në këto dy dikastere dhe në Qeveri. Përse të mos mendojmë kështu, gjersa ai në mënyrë shumë të fshehtë,

ilegale, bëri gjithë këtë punë armiqësore, trockiste, anti-parti për të përçarë unitetin marksist-leninist të Byrosë Politike?

Beqiri pohon se këto veprime i bëri nga mendjemadhësia, se iu rrit mendja. Atëherë kemi të drejtë ta pyesim: në ç'drejtim iu rrit kjo mendje? Ku synonte të shkonte më lart kjo mendja e tij? Siç u shpjegua qartë në këtë Plenum, është fare e dukshme se Beqir Balluku donte të paraqitej përpara ushtrisë si një «strateg i madh».

Për ne tani është e qartë se Beqir Balluku punoi për të rrëzuar e për të zëvendësuar Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, të aprovuara kolegjisht dhe me materialin që kishte përgatitur së bashku me disa kalemxhinj të tij, donte të thoshte se ai ishte «ushtaraku më i zoti», se ishte një «figurë e shquar ushtarake». Ai mendonte: «Përse të mos e marr edhe unë dekoratën e lartë të «Heroit të Popullit»?». Beqir Balluku atë dekoratë nuk e ka marrë se nuk e ka merituar. Udhëheqja e Partisë nuk është treguar oportuniste ndaj tij që t'i jepte një dekoratë pa e merituar, ajo i çmon njerëzit për aq sa japin. Ka edhe kuadro që s'janë anëtarë të Byrosë Politike e megjithatë e kanë marrë këtë dekoratë. Ka të tjerë, që, megjilhëse janë anëtarë të Byrosë Politike dhe e meritojnë këtë dekoratë, akoma nuk e kanë marrë. Këta, duke qenë njerëz të thjeshtë e pa pretendime, as që e shkojnë ndër mend ta kërkojnë t'u jepet, megjithatë Partia duhet ta shohë këtë problem dhe t'ua japë, pse ata e kanë merituar një mijë herë, ndërsa Beqir Balluku asnjëherë nuk e ka merituar.

Le të vijmë edhe një herë te pyetja që bëra më parë: «Kur t'u rrit mendja, ku doje të shkoje, Beqir Ba-



lluku?». Për ty nuk mund të ishte një dëshirë e thjeshtë vetëm ndryshimi i Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, por, bashkë me to, ti doje të ndryshoje tërë sistemin tonë, sikurse u diskutua këtu. Se në çfarë drejtimi iu rrit mendja Beqir Ballukut dhe ku e kishte qëllimin ai, Byroja Politike dhe Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë i kërkuan shpjegime atij, po ai s'pati guximin ta thoshte të vërtetën.

Karakteristikat për punën armiqësore të Beqir Ballukut ju i vutë në dukje, shokë. Ato e kanë burimin të shmangia e tij nga rruga e Partisë dhe të rrëshqitja në rrugën antimarksiste.

Beqir Balluku ishte njeri që nuk bënte përpjekje për edukimin e tij, për t'u ngritur qoftë teorikisht, qoftë nga ana ushtarake. Edhe kultura e tij e përgjithshme ishte shumë e ulët, për të mos thënë që i mungonte fare. Ai kishte një praktikë shumë të cekët në të gjitha sferat e punës, por aq sa ishte i cekët, aq hiqej sikur i kuptonte dhe i njihte të gjitha problemet. Kush nuk e njihte thellë Beqirin, ky shumë lehtë mund ta gënjente me qenien e tij si anëtar i Byrosë Politike. Ai shkonte në bazë dhe kthehej në ministri, po nuk ngulej e nuk thellohej si duhet në punë, kudo e në çdo rast punonte pa kritere shkencore. Puna e tij ishte e sipërfaqshme, një punë, si të thuash, pa bukë. Pastaj ai kishte zakon të bënte shumë muhabetë të shkëputura e të shturura, kudo dhe me këdo. Kuriozitetet e thashethemet i kishte shumë qejf. Këto karakteristika janë shumë të këqija për një komunist e jo më për një kuadër udhëheqës. Pas gjithë asaj që ai e quante punë, kur shkonte poshtë, fillonte të organizonte, siç thashë pak më parë, dreka e darka, këngë, ahengje, estrada, të gjitha këto të mbulu-

ara me njëfarë modestie prej «rrogozi», duke u hequr si një njeri i popullit, sikur i pëlqente shumë buka e misrit me një kokërr qepë. Por, nga ana tjetër, me gjithë kritikën e vazhdueshme të Partisë për të mos bërë shpenzime të panevojshme, me të vajtur poshtë ky «njeri i popullit» thereshin përnjëherësh katër shqerra.

Ky njeri hiqej si shumë popullor, si punëtor me karakteristika proletare, por në të vërtetë e tërë kjo hipokrizi ka shërbyer si një vello për të mbuluar dobësitë e tij që të mbahej sa më fort pas postit, bile, po të ishte e mundur, të ngjitej edhe më lart sikundër synonte ai.

Edhe të folurit Beqir Balluku e ka shumë pompoz. Kudo që ta shikoje nëpër mbledhje ai përdorte ligjërata me fjalë të mëdha tërë pompozitet, por që nuk shkëlqenin aspak nga përmbajtja e nga idetë, përkundrazi, ato nxinin nga rutina dhe nga frazat stereotipe.

Beqir Balluku bënte një politikë kuadri të neveritshme. Sikurse u tha këtu, ai sot e mburrte ndonjërin, e ngrinte në qiell, ndërsa nesër, kur nuk i pëlqente ose kur i mburruri prej tij i kundërvihej, kishte borxh ta rrëzonte, ta bënte leckë. Ai na sillte në udhëheqje më shumë kritika për kuadrot dhe hiqej sikur vetëm ai i njihte. Secilit i bënte karakteristikën me fraza të fryra nga fjalët e mëdha, që në thelb s'thoshin gjë.

Ju kujtohet, shokë, se si shumë herë në Byronë Politike ne jemi revoltuar dhe i kemi hedhur poshtë propozimet që na bëheshin nga Ministria e Mbrojtjes për transferime kuadrosh, se shikonim sidomos një lëvizje të parregullt, të palogjikshme e të panevojshme që u krijonte vështirësi të mëdha ekonomike dhe psikologjike kuadrove të ushtrisë, të cilët kalonin sa andej-këtej, du-

ke mos gjetur vend kurrë. Sikur të lejonte sektori i kuadrut i Komitetit Qendror të Partisë të plotësoheshin tekat e Beqir Ballukut për lëvizjen e ushtarakëve, do të na ishin dëmtuar shumë kuadro. Megjithatë ka edhe kuadro që janë dëmtuar, se Ministria e Mbrojtjes për një numër jo të vogël kuadrosh të rangjeve të ulëta ka nomenklaturën e vet. Prandaj gabimet në trajtimin e kuadrove duhet të bëhen një mësim i madh për ushtrinë dhe të kihet kujdes i madh për trajtimin e mirë të tyre.

Është karakteristikë se raportimet që na bënte Beqir Balluku nuk ishin për probleme kapitale të mbrojtjes, por më shumë për vogëlimala (dhe këto llafe ai i sillte me thasë e jo me torbë). Çështjet me vlerë që na ngrinte, për të mos thënë hiç fare, ishin shumë të pakta. Po a kishte ushtria probleme që i duheshin raportuar udhëheqjes? Sa të duash! Kishte probleme, për të cilat ai mund të më raportonte edhe mua si Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes dhe si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, dhe për këtë e kishte rrugën të hapët. Po këtë ai nuk e bënte.

Në bazë të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes dhe të mësimave të Leninit ne kemi folur për organizimin e Shkollës së Lirë Ushtarake, dhe po punojmë e po luftojmë që të ecim sa më mirë në këtë drejtim. Ajo që është realizuar deri tash, natyrisht, i detyrohet ushtrisë, u detyrohet kuadrove tanë, që e kuptojnë dhe e zhvillojnë drejt këtë tezë të rëndësishme. Në të ardhmen, me pasurimin e eksperiencës, Shkolla e Lirë Ushtarake do të zhvillohet akoma më mirë dhe më gjerë, në mënyrë që tërë populli ushtar të jetë i organizuar jo në stërvitje formale, por të dijë se si të luftojë kundër

armikut në front të rregullt dhe në prapavijat e tij. Kështu, secili, duke filluar nga ushtari dhe deri tek oficeri më i lartë, do të ketë mundësi të njohë strategjinë dhe taktikën tonë, që çdo veprim në kohë rreziku të kryhet kudo në mënyrë të rrufeshme dhe të arrijmë, me një fjalë, atë shpejtësi, atë organizim dhe atë grusht goditës që asnjë ushtri tjetër në botë të mos e ketë arritur. Po ka ardhur vallë ndonjëherë tek unë Beqir Balluku që të më raportojë se ç'bëhet në këtë drejtim? Jo, asnjëherë! Kanë ardhur Petrit Dumja ose Hito Çakoja të më raportojnë ndonjëherë për këtë problem kaq të madh? Jo, asnjëherë!

Shokët kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes, siç thashë, nuk vinin të na raportonin për problemet kapitale të mbrojtjes dhe të organizimit në ushtri, përkundrazi, kanë qenë të tjerë kuadro dhe të rangjeve më të ulëta ata që më kanë informuar mua për organizimin e Shkollës së Lirë Ushtarake. Kur isha në majin e vitit të kaluar në Elbasan, në mbledhjen e plenumit të Komitetit të Partisë të këtij rrethi, një oficer më raportoi me qartësi të madhe se si e kishin organizuar Shkollën e Lirë Ushtarake. U kënaqa me gjithë mend dhe thashë me vete se edhe gjatë kështu duhet të ndodhë. Megjithatë një organizim i tillë duhet të shikohet në praktikë. Idenë e Shkollës së Lirë ne e hodhëm me qëllim që të përballojmë në mënyrë të organizuar dhe sa më shpejt çfarëdo sulmi të rrufeshëm nga ana e armiqve. Por si do të na dalë kjo shkollë, si po zbatohen Tezat për realizimin e kësaj ideje, ku janë të metat që mund të kenë dalë dhe çfarë duhet të bëjmë për t'i zhdukur ato, cilat janë ndryshimet organizative që duhen bërë, pajisjet me armatime, plotësimi me kuadro, çfarë kursesh të

tjera plus mund të organizojmë për ta çuar edhe më përpara këtë shkollë etj.? Për të gjitha këto probleme të shumta e kaq të mëdha asgjë nuk na ngrinte Beqir Balluku.

Për disa probleme të rëndësishme na dërgoheshin ndonjëherë raporte nga Drejtoria Politike, si edhe nga Ministria e Mbrojtjes të firmosura nga Beqir Balluku, po të shumtën e herës këto ishin raporte «pa bukë», fare të përgjithshme, stereotipe, që s'tregonin asgjë. Hysniu dhe unë shumë herë i kemi kthyer mbrapsht të tilla materiale me shënime dhe me kritika. Se çfarë kanë bërë në Ministrinë e Mbrojtjes me shënimet dhe me kritikatat tona, këtë nuk e dimë, por e kam çështjen që ata duhet t'u hynin më thellë problemeve.

Me Mehmet Shehun unë kam biseduar shpesh për problemet e mbrojtjes dhe i kam thënë se «nuk jam shumë i ngrohtë në drejtim të punëve të ushtrisë, prandaj shikoje më nga afër këtë sektor nga më të rëndësishmit, se nuk jam i qetë». E kam porositur atë që të shkojë edhe vetë nëpër lojërat ushtarake, ku të caktojë në vende kyç oficerë të zotë dhe t'i kontrollojë si jepen e si zbatohen urdhrat e komandës, si sillen kuadrot e lartë të ushtrisë me ata që do të mbajnë frontin, pse me gjithë besimin e plotë që kemi te kuadrot e ushtrisë konstatoj disa gjëra që nuk po na shkojnë mirë<sup>1</sup>.

---

1. Siç u vërtetua më vonë, armiku i Partisë dhe i popullit, M. Shehu, në vend që të zbatonte dhe të vinte në jetë orientimet e Partisë dhe porositë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, shokut Enver Hoxha, punoi për të sabotuar punën edhe në ushtri, për të përgatitur terrenin, për realizimin e komplotit të rrezikshëm kundër Partisë dhe atdheut tonë socialist. Por vigjilenca e mprehtë e Partisë, uniteti i

Beqir Balluku mori fjalimin që mbajta unë në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror të Partisë, që shqyrtoi masat për përsosjen e mëtejshme të përgatitjes e të gatishmërisë luftarake të ushtrisë etj., dhe nxori prej tij fraza të shkëputura, që mendonte t'i përdorte si «argumente» për arritjen e qëllimeve të tij. Përmbajtja e fjalimit tim në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror të Partisë është e drejtë, por Beqir Balluku e ka shtrembëruar fjalën time, duke vepruar pikërisht në të njëjtën mënyrë sikurse veproi ca kohë më parë edhe Agim Meroja me këshillat që i dhashë unë kur më erdhi njëherë në takim, me kërkesën e tij, për të më pyetur për problemet e rinisë. Fjala ime në bisedën që bëra me Agim Meron ishte e qartë dhe në përputhje me vijën e Partisë, por ai e shtrembëroi, duke e interpretuar keq me qëllim. Kur u zbulua kjo që bëri Agim Meroja, ne i kritikua shokët e Partisë në bazë, që, pa u thelluar, e hëngrën shtrembërimin që i bëri ai fjalës sime për rininë. Shokët dëgjuan ç'thoshte ky dhe nuk morën aspak mundimin ta lexonin me vëmendje bisedën time të botuar<sup>1</sup> dhe pastaj t'i tundnin këmbët Agim Meros e t'i kërkonin shpjegime se ku dhe kur paskësh thënë ndonjëherë shoku Enver që të likuidohej organizata e rinisë e të tjera, e të tjera, përse po e shtrembëronte ai bisedën me shokun Enver? Pas Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë ku u dënua veprimtaria armiqësore e Fadil Paçramit dhe e Todi Lubonjës, mësuam se Agim

---

çeliktë marksist-leninist i saj bënë që ai të thyente kokën dhe të dështonte plotësisht plani ogurzi i tij e i padronëve të tij imperialistë e revizionistë, të cilëve ai u shërbente.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 46, f. 87.

Meroja ka thënë se komunistët që kalojnë moshën mbi 50 vjeç nuk u dashka të jenë më në Parti! Sipas tij të tërë ne që e kemi arritur këtë moshë duhej të dilnim jashtë Partisë. Kjo pikëpamje e Agim Meros është anti-parti dhe likuidatore.

Le të mos zgjatemi në këtë çështje, që e kemi analizuar dhe kemi marrë edhe vendimet përkatëse lidhur me të. Unë e përmenda atë pse është interesante të vihet re se të njëjtin qëndrim si shokët e terrenit mbajtën edhe shokët e Partisë në ushtri, të cilët, megjithëse kishin mundësi të nxirrnin mësim nga kritika që i bë shokëve të terrenit lidhur me qëndrimin që mbajtën këta ndaj shtrembërimit me qëllim që i kishte bërë fjalës sime Agim Meroja, në të vërtetë nuk nxorën mësim. Prandaj përgjegjësia e shokëve të ushtrisë është edhe më e madhe. Pse nuk e morën ata fjalimin tim në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror ta studionin me vëmendje dhe t'i thoshin Beqir Ballukut: «Përse po e shtrembëroni fjalimin e shokut Enver? Përse kërkon të fshihesh pas tij?». Përse ju, shokë të ushtrisë, nuk menduat që me këtë veprim armiqësor Beqir Balluku synonte t'u thoshte ushtrisë dhe kuadrove të saj që shoku Enver është në rrugë të gabuar? Përse nuk e bëtë ju këtë? A, shokë, kjo gjendje është mjaft e rëndë!

Beqir Balluku arriti gjer atje sa më në fund u vetizolua nga shokët e udhëheqjes, ai gati preu marrëdhëniet dhe çdo takim me ne jashtë mbledhjeve të punës. Kontaktet me shokët ne i kemi pasur, i kemi dhe do t'i kemi vazhdimisht të shpeshta, veçanërisht me anëtarët e Byrosë Politike, pse na lidhin punët e përditshme të drejtimit. Këto kontakte, që kanë qenë dhe janë aq vëllazërore, aq shoqërore, të sinqerta e në rrugë mark-

siste-leniniste, përse i preu ai me ne? Sigurisht sepse e shihte që ishte fajtor i madh, pasi ishte duke kryer një krim të rëndë kundër Partisë. Kështu, duke mos qenë komunist i vërtetë dhe kurajoz që të vinte e të na thoshte haptas çfarë kishte bërë, ai kishte zgjedhur rrugën e mënjanimit dhe të mospërzierjes fare me shokët dhe vazhdoi deri në fund t'ia fshehë Partisë veprimtarinë e tij të zezë. Kur kjo çështje u zbulua, me kërkesën e tij ai erdhi tek unë. E prita bashkë me shokun Hysni. Megjithëse e dinte që mua ma kishin raportuar çështjen e tij, kur unë e pyeta, Beqiri nuk më tha asgjë për sa kishte ndodhur, përkundrazi u përpoq të më gënjente paturpësisht.

Dëshiroj t'ju them, shokë, se në luftën time kundër armiqve të Partisë nuk më ka ngjarë kurrë kështu siç më ndodhi me Beqir Ballukun. Të tërë armiqtë, kur janë zbuluar, janë përpjekur të mblidhnin këmbët, janë munduar të mos i tregonin asgjë Partisë, por, kur vihe-shin përpara fakteve, nuk guxonin të mohonin fajet e kryera me kaq këmbëngulje sa ky. . . Beqir Balluku nuk i drejtoi asnjë letër Komitetit Qendror të Partisë për t'i treguar, të paktën shkurtimisht, gjithë këtë mënxyrë që bëri. Por edhe në qoftë se do të shkruajë, të kuptojë se letra duhet të jetë një autokritikë e hapët dhe e ndershme. Këtë Partia nuk e do ta ketë si dokument për ta hedhur Beqir Ballukun në gjyq, por për interesin e Partisë, prandaj në qoftë se i ka mbetur një fije ndër-gjegje komuniste i bëjmë thirrje edhe një herë të shkruajë hapur se akoma nuk është vonë.

Duhet ta lidhim ne, shokë, veprimtarinë armiqësore dhe antiparti të Beqir Ballukut me punën armiqësore të Fadil Paçramit e të Todi Lubonjës? Duhet ta lidhim,



mendoj unë, pse edhe në qoftë se duket sikur nuk ka lidhje organike midis tyre, ata i bashkojnë idetë dhe qëllimet që janë të njëjta, të dyja palët donin të arrinin rrëzimin e udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë, fitoren e vijës revizioniste në Parti, likuidimin e socializmit dhe rivendosjen e kapitalizmit në Shqipëri.

Punën armiqësore të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës ju tashmë e dini shumë mirë të gjithë, prandaj nuk është nevoja të zgjatem. Të dy këta në fillim përpiqeshin të ndryshonin superstrukturën, të molepsnin e të komprometonin sa më tepër kuadro, bile kuadro të lartë, por Partia u tregoi vendin Fadil Paçramit dhe Todi Lubonjës.

Të njëjtën gjë u përpoq të bënte edhe Beqir Balluku. Ai synoi të krijonte përçarje së pari në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, dhe, së dyti, në udhëheqjen e Partisë e të shtetit. Për këtë qëllim, me intrigat e tij, ai arriti të shkaktojë një turbullirë të madhe në komandën e ushtrisë, krijoi një çarje për çështjet që dimë. Pas kësaj tentative të ulët, ne shikojmë që ai të zbatojë taktikën e tërheqjes së tij diplomatike dhe këtë e praktikonte sa herë që ndeshte në kundërshtimin e kuadrove të ushtrisë. Kjo orvatje armiqësore, mund të themi se nuk i doli mbarë aspak, sado që përpiquej të tërhiqte njerëz për mbështetje. Qëllimi i fundit i veprimtarisë së Beqir Ballukut ishte që të dilte në krye të Partisë. Ndërsa synimi i Fadil Paçramit me Todi Lubonjën ishin ideologjia, letërsia dhe artet, Beqir Balluku e kishte vështrimin në ushtri, pra, synonte të degjeneronte, në radhë të parë, ushtrinë, ta vinte atë në shërbim të planeve të tij, pse e dinte që po të arrinte këtë objektiv, atëherë do të likuidonte gjithë rendin socialist në Shqi-

përi, me prapavijat e tij, me furnizimet, me bujqësinë e me industrinë, që do të thotë ta çonte vendin në një rrugë tjetër nga ajo ku po e çon Partia.

Duhet ta lidhim ne, gjithashtu, punën armiqësore të Beqir Ballukut me atë të Liri Belishovës, të Koço Tashkos e të Panajot Plakut? Pse jo? Në qoftë se nuk duken lidhje konkrete midis tyre, lidhjet ideologjike dhe përputhjet e qëllimeve midis të dyja palëve nuk mungojnë. Ne e dimë çfarë u përpoqën të bënin Liri Belishova, Koço Tashkoja dhe Panajot Plaku. Po Beqir Balluku ç'tentoi të bënte? Le t'i lidhim tani të gjitha këto orvatje e të shohim ç'rol kanë luajtur në vendin tonë këta agjentë, këta elementë armiq antiparti, që kanë nxitur me veprimtarinë e tyre presionin e armiqve të jashtëm e të brendshëm. Ata, pa asnjë dyshim, kanë luajtur një rol të madh negativ, dhe këtë ne e kemi analizuar për secilin me radhë këtu, në udhëheqje të Partisë. Faktet na kanë bërë të qartë se Liri Belishova, Panajot Plaku dhe Koço Tashkoja kanë qenë agjentë të fuqive armike të vendit tonë, të revizionistëve sovjetikë dhe të titistëve. Edhe Fadil Paçrami e Todi Lubonja kanë vepruar kundër Partisë, prandaj janë armiq të betuar të saj.

Partia jonë në përcaktimin dhe në vlerësimin e çështjeve kurdoherë është mbështetur dhe do të mbështetet vetëm në fakte të pakundërshtueshme, të vërtetuara me kujdesin më të madh. Duke u nisur nga ky parim, konkludojmë se gjithë kjo punë e Beqir Ballukut ka qenë armiqësore, veprimtaria e tij çonte ujë në mullirin e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të vendit tonë, çonte në likuidimin e Partisë, të pushtetit të diktaturës së proletariatit dhe të socializmit në Shqipëri.

Në punën tonë ne duhet të udhëhiqemi kurdoherë nga vija e drejtë e Partisë, që është përpunuar në kongreset e saj dhe zërthehet nëpërmjet direktivave të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Qeverisë. Direktivat që lëshojnë këto forume, jepen në Parti edhe në popull për zbatim, për verifikim, për korigjim. Direktivat dhe vendimet udhëheqja e Partisë sonë i merr në mënyrë kolegjiale, prandaj zor që ato të jenë të gabuara. Kështu na mëson gjithë eksperiencia e veprimtarisë së saj revolucionare 30 e ca vjeçare. Megjithatë nuk përjashtohet që gjatë zbatimit të tyre mund të bëhen dhe gabime, për arsye se nuk mund të ketë përsosmëri të plotë dhe pagabueshmëri. E mira nuk ka fund, gjërat duhet t'i shohim në zhvillimin e tyre të pandërprerë. Ky është një parim dialektik. Rëndësi ka që të merren masa që gabimet të ndreqen. Dhe nga Partia jonë gabimet ndreqen menjëherë, porsa zbulohen.

Të gjithë e dimë se udhëheqësit e të gjitha niveleve flasin nëpër mbledhje, ata zërthejnë direktivat e Partisë dhe, mbështetur në këto direktiva, japin këshilla, por ata kanë kujdes që çdo fjalë e tyre, çdo shkrim i tyre të jetë i peshuar, të jetë brenda vijës së Partisë, brenda direktivave që lëshohen, duke ua përshtatur ato kurdoherë rrethanave, kushteve, nevojave. Këshillat dhe porositë që japin udhëheqësit kurrë nuk duhet të jenë jashtë vijës së Partisë.

Unë do të flas pak edhe se si të përpiqemi t'i kuptojmë dhe si të punojmë me direktivat që lëshohen, me vendimet që merren dhe me fjalimet që mbahen, si duhet të qëndrojmë ndaj tyre që të mos lejojmë t'u bëhen shtrembërime. Në qoftë se në direktivat, në vendimet dhe në fjalimet ka boshllëqe, ka ndonjë gjë të padrejtë.

ose ndonjë trajtim të paqartë, thuajani udhëheqjes ose shokut që ka dhënë një ide të gabuar në fjalimin e vet. Në qoftë se e keni të drejtë vërejtjen, autori duhet të pranojë që kjo ose ajo çështje është e gabuar dhe duhet përpunuar. Në të kundërtën, kur del se fjalimi, direktiva apo vendimi janë të drejtë dhe vërejtja që bëhet për ta nuk qëndron, atëherë ai, të cilit i drejtohet vërejtja, e ka për detyrë ta sqarojë dhe ta bindë atë që gabimisht kujton se diçka duhet korrigjuar.

Në zbërthimin e drejtë, të thellë, të gjithanshëm, objektiv e të qartë të vendimeve e të direktivave duket zotësia e një udhëheqësi, i cili kurdoherë duhet të ketë parasysh që, gjatë punës së vet, të mbrojë dhe të zbatojë me fanatizmin më të madh dhe me vigjilencë vijën e Partisë. Kjo do të thotë se çdo veprim i tij, çdo gjykim i tij, si në teori, edhe në praktikë, duhet të jetë në përputhje të plotë me vijën e Partisë. Nuk i lejohet në asnjë rast një udhëheqësi që të tjerëve t'u japë një këshillë dhe vetë të veprojë në të kundërtën, duke shkelur sipas qejfit normat e Partisë dhe ligjet e shtetit. Në punë dhe në jetë çdo anëtar i Partisë dhe ca më tepër udhëheqësi duhet të ruajë kurdoherë thjeshtësinë, të ketë parasysh në çdo rast se ajo që kryen, ajo që shkruan, ajo që thotë, ajo dituri që ka fituar ose ajo zotësi që shfaq, natyrisht, nga goja dhe nga mendja e tij del, por ajo është fryti dhe mendja e Partisë, e popullit, e klasës punëtore. Prandaj askujt të mos i rritet mendja për ato që thotë ose për ato që shkruan. Kjo është vetëm një detyrë në shërbim të popullit, që ai duhet ta kryejë mirë dhe asgjë tjetër.

Udhëheqësi, ashtu si gjithë të tjerët, mund të gabojë në punën e tij, në fjalimet e tij, në këshillat e tij. Një

gjë e tillë mund të bëhet me dashje, duke menduar prej kohësh me djallëzi, siç ka ndodhur në rastin e Beqir Ballukut, por mund të ndodhë edhe pa dashur. Është e qartë se udhëheqësi, i vetëm, duke pasur një mendje, mund të gabojë më shumë se forumi, që përbëhet nga shumë udhëheqës, pra, nga shumë mendje. Natyrisht, udhëheqësi gabon kur nuk është i formuar si duhet ideologjikisht dhe politikisht ose kur i mungon ngritja teknike e mjaftueshme në profilin e punës ku drejton. Por ç'duhet bërë në këtë rast? Të mos e vëmë në vend udhëheqësin kur gabon, të mos ndërhyjmë për ta korrigjuar për faktin se është udhëheqës? Apo të shkojmë nga parimi jomarksist se duke kritikuar udhëheqësin gjoja kritikojmë gjithë forumin dhe i bëjmë kështu dëm Partisë? Këto pikëpamje janë shumë të gabuara, shumë të dëmshme, bile edhe tepër të rrezikshme, sidomos kur është çështja për udhëheqës të forumit më të lartë të Partisë dhe të shtetit.

Le të shikojmë tani në këtë frymë punën e Petrit Dumes, të Hito Çakos<sup>1</sup> e të disa shokëve të tjerë në Mi-

---

1. Në korrik të vitit 1974, pasi u zbulua veprimtaria komplotuese e armikut B. Balluku, shoku Enver Hoxha dyshonte për qëndrimin e P. Dumes e H. Çakos, pasi gjykonte që B. Balluku nuk mund të ishte vetëm në veprimtarinë armiqësore. Megjithatë, Plenumi i 5-të i KQ të PPSH, për arsye taktike, për të mos larguar vëmendjen nga çështja kryesore, tradhtia e B. Ballukut, në bazë të orientimeve të shokut Enver Hoxha u përqendrua vetëm në gabimet e fajet e Beqir Ballukut. Në këtë Plenum P. Dume e H. Çako jo vetëm nuk thanë gjë për veprimtarinë e tyre dhe as bënë autokritikë, por, në të kundërt, u munduan të lënë përshtypjen se ata ishin «shpëtimtarët e situatës». Por shoku Enver Hoxha, i cili i kritikoi këta të dy në Plenum, dhe i porositi në mënyrë të veçantë që të reflektonin

nistrinë e Mbrojtjes lidhur me qëndrimin që kanë mbajtur ndaj pikëpamjeve dhe veprimeve armiqësore të Beqir Ballukut. Duhet thënë se qëndrimi i tyre në këtë çështje nuk ka qenë i drejtë. Ata nuk vunë në dijeni me kohë udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit për veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut. Këtë veprimtari armiqësore antiparti ne mund ta kishim likuiduar me kohë dhe me më pak dëme se tani sikur këta të kishin vepruar drejt, ashtu siç kërkon Partia.

Këta vuajnë nga mbeturinat mikroborgjeze që ruajnë akoma në ndërgjegjen e tyre. Kundër këtyre mbeturinave këtej e tutje ata vetë duhet të bëjnë një luftë të vazhdueshme për t'i pastruar, që të mos shkaktojnë më turbullira në punën ku i kanë caktuar të drejtojnë Partia dhe shteti. Duhet të kemi kurdoherë parasysh se qëllimi kryesor që përpiqet të arrijë armiku është dobësimi i Partisë. Për t'ia arritur këtij qëllimi ai përpiqet

---

akoma më thellë jo vetëm për veprimtarinë armiqësore të B. Ballukut, por edhe për gabimet e fajet e tyre, nuk u mjaftua me analizën që u bë në këtë mbledhje të Komitetit Qendror, dhe menjëherë pas saj nisi të analizojë qëndrimet e këtyre dy komplotistëve të kamufluar. Gjatë gjithë muajit gusht ai shkroi siunë për çështjen e tyre. Më 12 gusht 1974 shoku Enver Hoxha shkroi materialin «Enigma e Petrit Dumes dhe e Hito Çakos», në të cilin, në mënyrë të argumentuar hldhet dritë mbi punën e vërtetë armiqësore puçiste, komplotiste të këtyre dy bashkëpunëtorëve të ngushtë të Beqir Ballukut. Këtë material shoku Enver Hoxha e përdori në fjalën e mbajtur më 14 tetor 1974 në mbledhjen me kuadrot kryesorë të ushtrisë. (Shih në këtë vëllim, f. 265-296.) Mbi bazën e konkluzioneve të drejta, në të cilat arriti shoku Enver Hoxha, çështja e armiqve P. Dume dhe H. Çako u analizua në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 10 tetor 1974 dhe pastaj në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH të datës 16-17 dhjetor 1974.

të shtrembërojë, në radhë të parë, vijën e saj në të gjitha drejtimet dhe, që t'ia arrijë kësaj, punon për thyerjen e unitetit të mendimit dhe të veprimit në Parti, për krijimin e tarafeve, që në Parti të zënë vend pikëpamjet e mendimet e tyre antimarksiste, antisocialiste. Synimi i armiqve është që me anë të tarafeve, që mund të krijohen në sajë të punës së tyre, të luftojnë për të sabotuar zbatimin e vijës së Partisë. Në rast se Partia nuk reagon fort dhe drejt kundër elementëve antimarksistë, atëherë pa dyshim vjen katastrofa. Natyrisht, për t'ia arritur qëllimit të tij armiku përpiket që të përçajë, në radhë të parë, udhëheqjen. Kjo arrihet vetëm atëherë kur vetë udhëheqja nuk është e shëndoshë. Puna e armikut të klasës lehtësohet kur në Parti depërton ideologjia e tij dhe kur shkelen normat organizative të Partisë. Prandaj udhëheqja duhet të jetë vazhdimisht vigjilente në këto drejtime, të ruajë pastërtinë ideologjike të Partisë dhe kudo e kurdoherë të mbajë qëndrime parimore për të zbatuar normat e Partisë. Kur në udhëheqje nuk zbatohen me rreptësi normat leniniste të Partisë, kur ekziston kulti i individit, kundër të cilit fola më parë, kur mbizotërojnë dhe nuk luftohen mbeturinat mikroborgjeze, kur edhe në udhëheqje nuk zhvillohet drejt lufta e klasës, kur për mungesë vigjilence arrin të depërtojë elementi armik dhe të përhapë pikëpamjet e tij armiqësore, të gjitha këto armiku i klasës i përdor për të përçarë udhëheqjen.

Armiku përpiket të dobësojë, gjithashtu, mbrojtjen e vendit, ushtrinë, organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme; ai punon për të ulur moralin luftarak të popullit, për të çoroditur dhe për të demoralizuar rininë, për të çorganizuar ekonominë, për të sabotuar indus-

trinë, bujqësinë, për të krijuar konfuzion dhe anarki në treg, për të krijuar panik dhe degjenerim në radhët e kuadrove të Partisë dhe të pushtetit. Ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe t'i njohim dhe t'i kemi kurdoherë parasysh këta objektiva të armikut, me qëllim që të mos e lëmë atë të na dëmtojë në asnjë sektor të jetës e të punës sonë.

Partia jonë, vazhdimisht e me guxim, është hedhur e tëra në një luftë të madhe me armiqtë e jashtëm e të brendshëm dhe i ka mposhtur kurdoherë e kudo të gjitha orvatjet e tyre. Ajo i ka demaskuar veprimet e armiqtve dhe ka korrur gjithnjë fitore. Megjithatë gjumi kurrë as na ka zënë as duhet të na zërë.

Në këtë Plenum të Komitetit Qendror të Partisë folën shumë shokë dhe i shtruan shumë drejt problemet, prandaj duke i ritheksuar ato, unë nuk them asgjë më tepër nga ç'është ju, vetëm se ato që thuhet duhet t'i mbajmë kurdoherë parasysh në luftën tonë të përditshme, se pikërisht në drejtimet që përmendëm ka synuar vazhdimisht dhe synon të na dëmtojë armiku.

Detyra më e madhe e Partisë është mbrojtja e vendit, së cilës ajo i ka kushtuar kujdes të veçantë. Populli ka bërë sakrifica të mëdha për forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut dhe, kur flasim për këtë çështje, kuptojmë, në radhë të parë, ushtrinë dhe armën tjetër të diktaturës sonë të proletariatit — organet e Sigurimit të Shtetit. Sakrificat që janë bërë dhe që vazhdojnë të bëhen, shokë, janë të domosdoshme, pse gjendja e përgjithshme ndërkombëtare, për shkak të kursit që ndjekin imperialistët, socialimperialistët dhe revizionistët modernë, shkon drejt ashpërsimit, drejt luftës dhe jo drejt paqes.



Mund të jetë koincidençë, por në këto momente kaq të turbullta, sidomos në zonën e Mesdheut dhe të Ballkanit, zhvillimi i një veprimtarie të tillë armiqësore në ushtri, duhet të na tërheqë seriozisht vëmendjen. Të gjithë jemi në korent se çfarë po ngjet në Qipro. Kjo nuk është një gjë e thjeshtë, pse çështja nuk ka të bëjë vetëm me këtë ishull të vogël me një popullsi prej 600 mijë banorësh dhe me një sipërfaqe rreth 10 mijë kilometrash katrorë. Problemi duhet parë më thellë. Qiproja është një ishull me rëndësi të madhe strategjike në Mesdheun Lindor, që imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe imperialistët anglezë, në rivalitet dhe në unitet midis tyre, përpiqen ta bëjnë një bazë sulmi kundër gjithë popujve mesdhetarë, midis të të cilëve është edhe populli shqiptar.

Pra, ngjarjet që po zhvillohen në këtë zonë nuk kanë të bëjnë thjesht vetëm me ishullin e Qipros, por me një zjarr të madh që mund të shpërthejë në Ballkan dhe në Mesdhe. Ky nuk është një synim i tanishëm i socialimperialistëve sovjetikë, por ka ekzistuar që në kohën e carëve. Kështu forcat e armatosura të socialimperialistëve sovjetikë, duke ndjekur traditat e carëve rusë, dëshirojnë të pushtojnë Adrianopojën dhe Kostandinopojën. Mirëpo kur fillon lufta, pastaj ajo nuk njihet kufi, ajo nuk nis vetëm për Thrakën e për Selanikun, por edhe për Maqedoninë, edhe për Shqipërinë, edhe për Jugosllavinë, se oreksi u hapet shpejt revizionistëve sovjetikë. Kështu, duke u zgjeruar konflikti i armatosur, do të ndërlikohen më vonë në të edhe Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e të tjera, dhe ne do të gjendemi të mbështjellë brenda vorbullës së kësaj përleshjeje.

Me këtë dua të them se momentet që kalojmë nuk

janë aq të lehta, shokë, përkundrazi, ato janë të vështira e fort të rrezikshme, prandaj lypset ta shohim realisht gjendjen dhe të forcojmë vigjilencën. Këto situata, ta kemi të qartë, ne nuk na trembin, as nuk na demoralizojnë, por ama nuk na lejojnë të bëjmë llafe, pale të shohim që zhvillohet veprimtari armiqësore që çon në dobësimin e mbrojtjes së atdheut dhe të mos veprojmë energjikisht. Partia, populli dhe regjimi ynë i diktaturës së proletariatit nuk lejojnë kurrë të vihet në zbatim ajo që mendonte Beqir Balluku dhe në fakt plani i tij dështoi në sajë të vigjilencës së Partisë.

Ka rëndësi të madhe të kuptojmë mirë, shokë, që në këto situata të vështira, çështjen e mbrojtjes ta kemi në radhën e parë të detyrave që kemi për të kryer. Se çfarë ka bërë deri më sot Partia për mbrojtjen, është e tepërt të filloj t'jua numëroj këtu, mbasi ju i dini mirë, por dua të them se duhet të bëjmë akoma shumë e më shumë. Çdo gjë që është bërë deri tani për mbrojtjen, është bërë e studiuar dhe me kujdesin më të madh. Asgjë nuk i është lënë në dorë fatit. Gjithçka është llogaritur, duke pasur kurdoherë parasysh mundësitë tona maksimale, shfrytëzimin e plotë të tyre, plotësimin e çdo boshllëku me mundësitë tona materiale, morale, politike, ideologjike. Këto mundësi, në fakt, tani janë të mëdha.

E gjithë kjo përgatitje për mbrojtjen, e bërë me dekada të tëra, është arritur, siç e dini, në sajë të vijës së drejtë të Partisë në të gjitha drejtimet, veçanërisht në ushtri, duke filluar që nga organizimi, nga stërvitja, nga edukimi politik e ideologjik i saj, gjer tek armatimet dhe punimet e shumta xhenerie, që janë bërë dhe që po vazhdojnë të bëhen me një temp revolucionar, për një përsosje harmonike e të gjithanshme të tyre.

Asnjëherë Partia nuk është udhëhequr nga pikëpamja që të kemi një ushtri parade, por ajo ka punuar dhe ia ka arritur qëllimit për të pasur një ushtri që të luftojë për të siguruar paprekshmërinë e kufijve të atdheut të vet socialist, për të pasur një ushtri të aftë që të fitojë mbi çdo armik. Se kush janë këta armiq e kemi thënë shumë herë. Prapë dhe vazhdimisht këta armiq do t'i demaskojmë ditë e natë, pse ata janë të egër, të shumtë, të armatosur gjer në dhëmbë me armët më moderne. Asnjëherë Partia nuk e ka nënvleftësuar gjithë këtë forcë të madhe të armiqve të shumtë që na rrethojnë me rrathë koncentrikë. Por Partia dhe populli ynë, gjithashtu, nuk i kanë mbivlerësuar armiqtë e vendit tonë, ata kurrë nuk janë frikësuar e nuk frikësohen prej tyre. Duke e vlerësuar realisht armikun, ne kemi forcuar aftësinë tonë mbrojtëse.

Vallë kjo trimëri, ky guxim dhe kjo siguri kaq e madhe në mbrojtje, për të cilat flasim, mos janë shfaqje prej mburravecësh? Jo, shokë, këtu nuk është fjala për mburrje, pse trimëria dhe guximi janë virtyte të popullit shqiptar, të cilin e ka edukuar Partia me konceptet e patriotizmit të lartë socialist. Këto koncepte që ka rrënjësuar e kalitur Partia në masat tona punonjëse e kanë qëndruar aftësinë tonë mbrojtëse. Partia i ka llogaritur forcat e armiqve dhe kurdoherë mban parasysh strategjinë dhe taktikat e luftës së tyre. Partia jonë e Punës dhe shteti ynë socialist kanë ndërtuar më së miri organizimin e mbrojtjes, kanë përcaktuar strategjinë dhe taktikat tona të luftimit që na sigurojnë fitoren. Të gjitha parimet e mbrojtjes në interes të popullit e të atdheut janë mishëruar shumë qartë, në mënyrë shkencore, në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Beqir Balluku

ishte kundër vijës ushtarake të Partisë, kundër këtyre qëllimeve të mëdha të saj.

Oficerët dhe ushtarët tanë duhet të thellohen, shokë, në kuptimin dhe në përvetësimin e mësimëve të Partisë, që pasqyrohen në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Të gjithë duhet t'i përvetësojnë këto mësimë dhe të kuptojnë thellë anën politike, ideologjike dhe anën ushtarake të tyre. Kush mendon se Tezat e Këshillit të Mbrojtjes janë thjesht mendime ushtarake, apolitike dhe pa baza ideologjike, ai nuk është në rrugë të drejtë. Ai që i kupton ato në mënyrë të njëanshme, pavarësisht se mund të jetë teknik i mirë, nuk mund të jetë ushtarak i mirë.

Prandaj ka rëndësi të madhe që Tezat e Këshillit të Mbrojtjes të zbatohen në jetën e përditshme të ushtrisë, në gjithë gamën e veprimtarisë së saj. Kush nuk ndjek, kush nuk përqafon dhe kush nuk zbaton me vullnet të çeliktë dhe me heroizëm e sakrifica vijën e Partisë në ushtri, që pasqyrohet në këto Teza, kush nuk kupton dhe nuk zbaton mirë rregulloret e ushtrisë dhe normat e Partisë në ushtri nuk mund të jetë një ushtarak i mirë. Ushtria jonë është e lidhur ngushtë me popullin si mishi me thoin. Te ne ushtri e popull janë një. Ushtria jonë nuk është një kastë e mbyllur, ajo është ushtria e popullit shqiptar, e një vendi socialist, ku është vendosur diktatura e proletariatit. Kur ka shqetësime populli, ato i ndien edhe ushtria, kur këndon populli, këndon edhe ushtria, kur është i lumtur populli, është e lumtur edhe ushtria.

Ushtria ka ligjet dhe rregullat e saj marksiste-leniniste, nga të cilat udhëhiqet, por ajo duhet të njohë e të

zbatojë, në radhë të parë, vijën e Partisë. Asaj nuk i falet aspak në qoftë se del nga kjo vijë e përgjithshme.

Për këto çështje mbase u zgjata, shokë, prandaj më falni, po m'u desh t'i theksoja si konkluzion i këtyre punimeve të rëndësishme të këtij Plenumi të Komitetit Qendror të Partisë.

Tani le të vijmë te çështja e masave ndëshkimore. Byroja Politike, në mbledhjen e saj të 2-3 korrikut, mori vendim edhe për masat që gjykonte ajo. Këto vendime të Byrosë Politike nuk jua komunikuan dhe mendojmë se vepruan drejt. E përse t'jua thoshim më përpara, kur të gjithë ne anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë i kemi të gjitha mundësitë të shprehim mendimin tonë lirisht, duke i gjykuar çështjet gjithsecili vetë në interes të Partisë dhe të popullit. Dhe ju, pa e ditur ç'kishte vendosur Byroja Politike, e dhatë drejt mendimin, qoftë për fajet e Beqir Ballukut, qoftë për gabimet e ushtarakëve të tjerë.

Byroja Politike kishte vendosur që Beqir Balluku, për fajet e tij të mëdha antiparti, antishtetërore, revizioniste, trockiste e likuidatore të shkarkohej nga të gjitha funksionet e Partisë dhe të shtetit. të përjashtohej edhe nga Partia. Edhe ju, pa e ditur pikëpamjen e Byrosë, shprehët të njëjtin mendim.

Disa nga shokët që diskutuan këtu në Plenumin e Komitetit Qendror propozuan që Beqir Balluku t'i jepet edhe gjyqit për ndjekje penale. Në emër të shokëve të Byrosë Politike dhe në emrin tim personal unë do t'ju lutem juve, shokëve anëtarë të Komitetit Qendror, të më dëgjoni me vërejtje lidhur me propozimin që u bë, pastaj le ta gjykojmë çështjen me gjakftohtësi dhe të vendosim drejt. Ne jemi plotësisht dakord me re-

voltimin tuaj të madh, ju keni plotësisht të drejtë të indinjoheni nga veprimtaria e tij. Kërkesa juaj që Beqir Balluku, përveç përjashtimit nga Partia t'i jepet edhe organeve të drejtësisë për të gjykuar veprimtarinë e tij armiqësore është e logjikshme dhe e bazuar në fakte. Në drejtim të akuzës që mund t'i ngrihej atij ka fakte e dokumente të shumta që mund ta provonin plotësisht fajësinë e tij para gjyqit. Megjithatë ne, anëtarët e Byrosë Politike, mendojmë të mjaftohemi me masën më të rëndë, me përjashtimin e tij nga Partia. . .

Këtu, në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë ne, me argumente të shumta, të shëndosha, të diskutueshme analizuam veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut, e demaskuam atë plotësisht nga ana politike dhe ideologjike. Kjo punë ka rëndësi të madhe. . .

Kur ishim në marrëdhënie të mira me Bashkimin Sovjetik, në kohën e Stalinit, më kujtohet që vajta njëherë në Bukuresht për t'u pjekur me Vishinskin, që ishte atëherë anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe ministër i Jashtëm i Qeverisë Sovjetike. Ai kishte për të më transmetuar disa këshilla nga ana e Stalinit për Partinë tonë, lidhur me luftën që duhet të zhvillonim bashkërisht kundër revizionistëve titistë jugosllavë. Kur mbaruam së biseduari dhe ishim të qartë për këtë problem, unë e pyeta Vishinskin për mendimin që kishte ai lidhur me mundësinë e hedhjes në gjyq të armiqve të Partisë. Ai m'u përgjigj në moment se Lenini dhe Stalini na mësojnë që kundër armiqve të partisë, në radhë të parë, ka rëndësi të gjejmë prova për t'i demaskuar politikisht dhe ideologjikisht, që t'i zhveshim ashtu siç janë përpara partisë dhe popullit dhe të gjithë t'i shohin «la-

kuriq». Natyrisht, ne edhe në burgje kemi dërguar e do të dërgojmë armiq, kur çmojmë se izolimi i tyre nga shoqëria dhe vuajtja e dënimit me burg janë të domosdoshme, por demaskimi i tyre politik dhe ideologjik ka rëndësi të madhe për opinionin shoqëror.

Veprimtaria e Beqir Ballukut, siç e cilësuar ju, është me të vërtetë armiqësore. Partia është përpjekur ta korrigjonte atë, ta ndreqte, ne ia kemi thënë shumë herë atij të metat dhe gabimet që i kemi konstatuar, e kemi kritikuar, bile shpeshherë edhe ashpër, por ai nuk e dëgjoi Partinë.

Natyrisht, kjo që mendojmë ne varet shumë edhe nga qëndrimi në të ardhmen i vetë Beqirit. Vërtet ne tregojmë një zemërgjerësi, por kurrsesi nuk bëjmë lëshim, nuk mbajmë qëndrim oportunist dhe nuk nisemi fare nga opinioni. Këtë, ti Beqir, kije parasysh! Opinioni i brendshëm do ta marrë vesh çështjen, e cila do të diskutohet, pse Partia do t'ua shpjegojë të vërtetën të gjithëve, që t'ua bëjë të qartë. Opinioni i brendshëm i vendit tonë, për të gjitha arsyet që dimë, është i tëri plotësisht me Partinë, me vendimin e drejtë të saj.

Për sa i përket opinionit të jashtëm, natyrisht, armiqtë, për qëllimet e tyre armiqësore ndaj Shqipërisë, do t'i bëjnë jehonë, do ta trumbetojnë me të madhe masën që do të marrim ndaj Beqir Ballukut, por ne nuk kemi frikë nga një gjë e tillë. Ne aspak nuk kemi frikë nga opinioni, kur është fjala për mbrojtjen e parimeve tona të drejta e të pastra.

Siç e dini, në kohën e sotme është situata e puçeve. Një puç u krye vjet në Kili, puç kohët e fundit u bë, gjithashtu, në Qipro, rrëzohet një qeveri andej, rrëzohet një tjetër këtej. Në shumë vende ka pasiguri,

ndërsa te ne nuk ngjan ajo që kishin për qëllim armiqtë, por u flak tej një Beqir Balluk që u lëkund, që tradh-toi vijën e Partisë dhe që përpiquej të organizonte më vonë një puç si ata që përmenda.

Atëherë, në qoftë se pranojmë propozimin e Byrosë Politike, ne i bëjmë edhe një herë thirrje Beqir Ballukut që, duke qenë jashtë Partisë, të mendojë, të reflektojë dhe t'i shkruajë Partisë, t'ia hapë zemrën, t'i thotë të vërtetën. Tani Beqir Balluku të reflektojë jashtë Partisë, se ai nuk mund të jetë më në Parti për fajet e rënda që ka kryer. Natyrisht, në qoftë se ai do të vazhdojë në rrugën e armiqësisë që pati filluar, atëherë Partia dhe shteti kanë të drejtë të marrin masa të tjera të mëtejshme kundër tij dhe t'ia japin çështjen drejtësisë që gjyqi të vendosë në bazë të provave që kemi deri tani dhe të atyre që mund të dalin më vonë nga qëndrimet që do të mbajë Beqiri. Sidoqoftë, ne i bëjmë thirrje atij që të mos shkojë më thellë në rrugën e tij armiqësore, por t'i thotë «ndal» kësaj veprimtarie të shëmtuar.

*Botuar për herë të parë,  
me ndonjë shkurtim, në  
librin: Enver Hoxha, «Për  
Ushtrinë Popullore», vëll.*

*II, Tiranë, 1984, f. 21*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



**L E T E R**  
**PËR VEPRIMTARINË ARMIQËSORE**  
**TË BEQIR BALLUKUT**

29 korrik 1974

GJITHË ORGANIZATAVE TË PARTISË!  
GJITHË KOMUNISTËVE!

Të dashur shokë,

Në mbledhjen e vet të 25 dhe 26 korrikut të këtij viti Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH mori në shqyrtim veprimtarinë armiqësore e antiparti të ish-anëtarit të Byrosë Politike dhe ministrit të Mbrojtjes, Beqir Ballukut, që synonte revizionimin e vijës ushtarake të Partisë, çarjen e unitetit në udhëheqjen e Partisë e në radhët e saj dhe dobësimin e mbrojtjes së atdheut. Me këtë veprimtari të tij ai i është kundërvënë vijës së Partisë në përgjithësi.

Gjithë Partia e di se Komiteti Qendror kurdoherë e ka konsideruar dhe e konsideron çështjen e mbrojtjes së atdheut si detyrën themelore, detyrë mbi detyrat, prandaj edhe nuk ka kursyer asgjë për forcimin e vazhdueshëm të fuqisë mbrojtëse të vendit, për përgatitjen e gjithanshme e sa më të mirë të ushtrisë dhe

të mbarë popullit për mbrojtjen e atdheut socialist nga çdo rrezik. Por Beqir Balluku i është kundërvënë me ndërgjegje kësaj pune të Partisë.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, pas një analize të thellë e të hollësishme marksiste-leniniste të fakteve dhe dokumenteve që u zbuluan kohët e fundit, konkludoi se Beqir Balluku ka bluar në kokën e tij, sidomos këta 2-3 vjetët e fundit, mendime të rrezikshme, të cilat u pasqyruan në disa materiale teoriko-ushtarake që ai bashkë me 2-3 kalemxhinj të tij kishin përpunuar pa dijeninë e Partisë, prapa shpinës së saj, duke ia fshehur ato udhëheqjes së Partisë e Këshillit të Mbrojtjes. Këto materiale ishin krejtësisht në kundërshtim me vijën e Partisë në ushtri, me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Në këtë mënyrë Beqir Balluku përgatiti një platformë kundër vijës së Partisë për çështjen e mbrojtjes, të cilën Plenumi i KQ e cilësoi armiqësore, antiparti, antikombëtare, disfatiste dhe kapitullante.

Qëllimi i fundit i tërë pikëpamjeve të Beqir Ballukut të shprehura në këtë platformë të vet armiqësore antiparti, siç del nga analiza e materialeve teoriko-ushtarake të përgatitura prej tij, që ranë në dorën e Komitetit Qendror vetëm këto kohët e fundit, ishte që, në rast të një agresioni eventual kundër vendit tonë, të hiqej dorë nga mbrojtja e rregullt, siç e kemi të organizuar sot, t'i hapeshin dyert armikut për t'u futur thellë në territorin tonë dhe ushtria, që në ditën e parë të luftës, të shpërndahej e të katandisej në çeta të shkëputura të vogla partizanësh, që do ta fillonin punën nga e para, si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Kur Beqir Balluku u orvat t'ua bënte të ditura kua-drove kryesorë të ushtrisë këto ide armiqësore, disfa-

tiste e kapitullante, ata menjëherë i hodhën ato pa hezitim poshtë, duke mbrojtur me vendosmëri vijën ushtarake të Partisë. Përpara këtij kundërshtimi të vendosur në të cilin u ndesh, Beqir Balluku u detyrua të tërhiqet dhe t'i mbyllë materialet e tij të zeza në kasafortë. Kështu, nuk u lejua që pikëpamjet armiqësore antiparti të Beqir Ballukut të shtriheshin në teorinë dhe në praktikën e ushtrisë sonë. Ato mbetën në kokën dhe në kasafortën e tij. Dhe ndodhi kështu sepse Partia, Komiteti Qendror dhe Këshilli i Mbrojtjes e kanë drejtuar dhe udhëhequr kurdoherë nga afër gjithë veprimtarinë e ushtrisë dhe sepse të gjithë kuadrot e ushtrisë janë bij të Partisë, që i kanë qëndruar e i qëndrojnë gjithnjë besnikë vetëm vijës së Partisë, mësimëve të saj jetëdhënëse, për mbrojtjen dhe zbatimin në jetë të të cilave ata kanë luftuar dhe luftojnë kurdoherë me vendosmëri e guxim.

Sapo u informua Komiteti Qendror i Partisë për këto pikëpamje armiqësore që ushqente Beqir Balluku dhe për materialet teoriko-ushtarake që kishte përgatitur ai, menjëherë e seriozisht iu fut analizës së tyre dhe e shpuri çështjen deri në fund.

Pse shkoi Beqir Balluku në këtë rrugë armiqësore antiparti?

Nga të dhënat që disponon tani Komiteti Qendror del se Beqir Balluku shkoi në këtë rrugë, sepse degjeneroi si komunist. Disa karakteristika të huaja për revolucionarin që nxorën kokë, sidomos kohët e fundit, si ambicia, karrizmi, mendjemadhësia, prepotenca, shikimi i rehatit dhe i interesit të ngushtë personal, shfrytëzimi i pozitës zyrtare për të plotësuar tekcat e tij e çuan Beqir Ballukun në borgjezimin gradual të tij. Kur disa

nga këto shfaqje i kishin rënë në sy udhëheqjes, ajo menjëherë ia vuri në dukje Beqir Ballukut dhe e kritikoi atë rreptë. Por ai nuk ua vuri veshin kritikave të Partisë dhe vazhdoi në rrugën e tij të degjenerimit. Ky degjenerim borgjez e bëri atë të vihej në opozicion me Partinë, të mendonte si armik e të përpunonte materiale që i kundërviheshin vijës së Partisë për çështjet e mbrojtjes.

Në të njëjtën kohë Beqir Balluku shkoi në këtë rrugë edhe sepse u thye dhe u tremb përballë rrethimit të egër imperialisto-revizionist, përballë agresionit të tyre ideologjik ndaj vendit tonë. Strategjia dhe taktika e ushtrive amerikane dhe sovjetike që studionte, si dhe propaganda e shfrenuar e këtyre vendeve, e tmerruan Beqir Ballukun dhe e bënë që të kapitullonte. Në këtë kuptim veprimtaria e tij ka një bazë të përbashkët me atë të Liri Belishovës, të Koço Tashkos e të Panajot Plakut, si dhe të Fadil Paçramit e të Todi Lubonjës.

Për realizimin e qëllimeve të tij Beqir Balluku përdorte metodën e hipokritit, që përpara syve hiqej si mbrojtës i vijës ushtarake të Partisë, ndërsa prapa kraheve, fshehurazi e ilegalisht, përgatiste revizionimin e saj, ashtu edhe metodën e mashtruesit e të intrigantit që synonte të fuste grindje e mosmarrëveshje, të çante unitetin në radhët e Partisë e në udhëheqjen e saj, të cenonte unitetin e ushtrisë dhe të kuadrove të saj rreth Partisë.

Por të gjitha këto orvatje armiqësore të Beqir Ballukut dështuan, sepse uniteti në udhëheqjen e Partisë dhe në gjithë Partinë është i çeliktë, i bazuar fort në ideologjinë tonë ngadhënjimtare, marksizëm-leninizmin. Ato dështuan sepse ushtria jonë, e udhëhequr dhe

e edukuar vazhdimisht nga Partia me mësimet e saj dritëdhënëse, është e lidhur me të si mishi me kockën, mbron e zbaton me besnikëri e vendosmëri vijën e saj dhe është kurdoherë e gatshme që për çështjen e Partisë, të popullit dhe të atdheut të bëjë edhe sakrificën më të lartë.

Duke gjykuar në bazë të logjikës marksiste-leniniste fajet e rënda të Beqir Ballukut, si dhe rrezikshmërinë e madhe të qëllimeve që fshiheshin në veprimtarinë që kishte ndërmarrë, por që s'e realizoi dot, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vendosi ta shkarkojë atë nga të gjitha funksionet që mban në Parti e në shtet dhe ta përjashtojë nga radhët e Partisë.

Veprimtaria armiqësore, antiparti dhe antishtetërore e Beqir Ballukut është e dënueshme edhe nga ligjet tona. Por Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, duke u udhëhequr nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, që thonë se për komunistin përjashtimi nga partia është dënimi më i rëndë, është pushkatim politik, u mjaftua me masën e mësipërme. Në vendimin që mori Plenumi i Komitetit Qendror pati parasysh edhe faktin se «teoritë» dhe pikëpamjet antimarksiste të Beqir Ballukut kundër vijës së Partisë në ushtri e kundër mbrojtjes së atdheut nuk gjetën zbatim në veprimtarinë praktike në fushën e mbrojtjes, por mbetën në letër e në kokën e tij, sepse ndeshën në kundërshtimin e vendosur të kuadrove kryesorë të ushtrisë dhe u zbuluan në kohën e duhur nga Komiteti Qendror.

Beqir Balluku u porositi që, edhe duke qenë jashtë radhëve të Partisë, të mendojë e të reflektojë thellë mbi fajet e tij të rënda dhe t'i shkruajë Partisë për qëllimet e veprimtarisë së tij armiqësore. Njëkohësisht iu tha

atij që, në rast se nuk do t'i thotë ndal vetes, nuk do të qëndrojë korrekt, por do të vazhdojë të ecë e të futet më thellë në rrugën e tij armiqësore, atëherë Partia dhe shteti do të marrin masa të tjera, akoma më të rënda, ligjet dhe diktatura e proletariatit do të goditin pa mëshirë mbi të.

Partia jonë marksiste-leniniste kurdoherë ka marrë e merr vendime të drejta e të pjekura, duke mbrojtur me vendosmëri vijën e saj, pastërtinë e radhëve të saj, interesat e popullit dhe të atdheut, çështjen e madhe të socializmit dhe fitoret e revolucionit. Ajo u ka dhënë e u jep gjithnjë dënimin e merituar atyre që guxojnë të ngrenë dorën kundër Partisë e vijës së saj, kundër unitetit të radhëve të Partisë dhe të popullit me Partinë, kundër interesave të lartë të popullit dhe të atdheut, kundër socializmit e marksizëm-leninizmit.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Nga e gjithë kjo analizë e thellë marksiste-leniniste, që i bëri Komiteti Qendror i Partisë veprimtarisë antiparti e armiqësore të Beqir Ballukut, duhet të nxjerrim mësimë të rëndësishme për tërë punën e Partisë.

Në radhë të parë, duhet të punojmë më mirë të gjithë bashkë për forcimin e gjithanshëm të Partisë, për gjallërimin dhe revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së saj të brendshme, për kuptimin dhe për zbatimin e thellë e të përpiktë të vijës e të mësimëve të saj. Në mënyrë të veçantë, duke nxjerrë mësimë nga ngjarja që analizoi Komiteti Qendror, duhet të forcojmë shumë punën ideopolitike dhe organizative në ushtri. Të rritim më tej rolin e organeve dhe të organizatave

të Partisë në nënreparte, në reparte e njësi dhe të kalitim akoma më mirë me karakteristikat që kërkon Statuti i Partisë gjithë komunistët.

Duhet të rritim kujdesin dhe të forcojmë luftën e të gjithë komunistëve për mbrojtjen dhe për zbatimin e përpiktë të parimeve e të normave leniniste që rregullojnë jetën e brendshme të Partisë. Asnjë çështje me rëndësi, për të cilën ka pikëpamje të ndryshme, nuk duhet të lihet pa u bërë objekt shqyrtimi në organet dhe në organizatat e Partisë.

Asnjë kuadër dhe komunist, me çdo funksion qoftë, nuk mund të mos japë llogari para Partisë për pikëpamjet e shprehura prej tij në formë e në rrugë të ndryshme, kur këto janë në kundërshtim me vijën ose me direktivat e Partisë, si dhe për çdo veprim të tij të padrejtë, për çdo qëndrim jokomunist. Çdo komunist kur dikton te ndokush shfaqje që bien në kundërshtim me vijën e Partisë, e ka për detyrë që jo vetëm t'i luftojë me konsekuencë këto, por edhe të informojë menjëherë Partinë. Çdo forum e organizatë partie dhe çdo komunist duhet të bëjë detyrën e vet në këtë drejtim e të mos mendojë se janë vetëm kuadrot kryesorë e organet përkatëse që do të raportojnë e do të informojnë ku duhet për çdo gjë.

Komunistët dhe kuadrot duhet ta shikojnë Partinë jo te personat e veçantë, por te vija, te politika e te qëndrimet e saj. Personi, me çfarëdo përgjegjësie qoftë, është i nderuar dhe i respektuar për aq kohë dhe vetëm atëherë kur punon e vepron në përputhje me vijën e Partisë e sipas direktivave të saj, kur zbaton me përpikëri normat e Partisë dhe u përmbahet kudo e kurdoherë kërkesave të Statutit të Partisë mbi karakteri-

stikat që duhet të ketë komunisti. Ndryshe, kushdo që të jetë, duhet të kritikohet.

Së dyti, të zhvillojmë vazhdimisht e pa ndërprerë për asnjë çast luftën klasore kundër çdo veprimtarie armiqësore e shfaqjeje të huaj, qoftë kjo në shoqëri, qoftë në radhët e Partisë, qoftë edhe në ndërgjegjen e secilit. Të mbajmë kurdoherë parasysh mësimin e marksizëm-leninizmit se lufta e klasave është një forcë lëvizëse që çon përpara punën për ndërtimin e socializmit e të komunizmit dhe njëkohësisht mbron partinë dhe shtetin socialist nga degjenerimi dhe rivendosja e kapitalizmit. Në valët e kësaj lufte pastrohet Partia dhe shoqëria jonë socialiste nga armiqtë e «plehrat» dhe formohen e kaliten anëtarët e devotshëm të Partisë, luftëtarët e pararojës, revolucionarët e vërtetë. Në këtë luftë të ashpër klasore pastrohet ndërgjegjja e njerëzve tanë nga mbeturinat e së kaluarës dhe nga ndikimet e propagandës moderne e çoroditëse.

Agresioni i egër ideologjik imperialist e revizionist ndaj vendit tonë, si dhe mbeturinat e ideologjive të huaja në ndërgjegjen e njerëzve, nuk mund të mos ndikojnë në një masë apo në një tjetër edhe në radhët tona.

Synimi kryesor i veprimtarisë së armiqve ka qenë dhe është prishja e unitetit të çeliktë të radhëve të Partisë, e unitetit monolit të popullit me Partinë, përballë të cilit ata kanë thyer kurdoherë kokën. Synimi tjetër i përhershëm i veprimtarisë së armiqve ka qenë dhe mbetet dobësimi i fuqisë mbrojtëse të atdheut. Prandaj na del detyra ta ruajmë si sytë e ballit e ta forcojmë gjithnjë e më shumë unitetin e çeliktë të radhëve të Partisë dhe të Partisë me popullin, ta ruaj-



më, ta forcojmë e ta rritim gjithnjë e më shumë fuqinë mbrojtëse të atdheut, gatishmërinë luftarake të të gjitha forcave tona të armatosura, të mbarë popullit tonë ushtar.

Së treti, të tregojmë edhe në të ardhmen kujdes të posaçëm e të vazhdueshëm për forcimin e mbrojtjes së atdheut tonë socialist, duke e konsideruar këtë si detyrën kryesore. Në çdo kohë e kudo çdo qytetar të mendojë e të punojë vazhdimisht për përgatitjen e gatishmërinë luftarake dhe për forcimin e gjithanshëm të mbrojtjes së vendit.

Në mënyrë të veçantë organet dhe organizatat e Partisë në ushtri duhet ta konsiderojnë si detyrën e tyre kryesore përvetësimin dhe zbatimin në jetë të vijës e të mësimëve të Partisë për mbrojtjen në të gjitha aspektet e përmbajtjes së tyre. Lufta për forcimin e mbrojtjes duhet kuptuar edhe nga pikëpamja politike, edhe nga pikëpamja ideologjike, edhe nga pikëpamja ushtarake.

Kush nuk ndjek, nuk përqafton dhe nuk zbaton me vullnet të çeliktë dhe heroizëm vijën e Partisë në ushtri, që pasqyrohet në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, kush nuk kupton dhe nuk zbaton me rreptësi në punë dhe në jetë ligjet e shtetit dhe normat e moralit komunist, pra jo vetëm kërkesat e rregulloreve ushtarake, ai nuk mund të jetë kurrë ushtarak i mirë i Ushtrisë sonë Popullore, e cila nuk është një kastë e mbyllur, por e lidhur si mishi me kockën me popullin. Ushtria jonë është armë e fuqishme në duart e Partisë për mbrojtjen e diktaturës së proletariatit dhe të fitoreve të revolucionit. Si e tillë ajo duhet të edukohet përditë e të përgatitet pa pushim në mënyrë që në mendjen, në zemrën

dhe në ndërgjegjen e çdo ushtari të rrënjosen thellë vetitë e larta të proletariatit fitimtar.

Forcimi i disiplinës së shëndoshë të ndërgjegjshme proletare në ushtri duhet të qëndrojë gjithnjë në qendër të vëmendjes së organeve e të organizatave të Partisë dhe të të gjitha komandave në ushtri.

Kujdes i veçantë i duhet kushtuar sidomos vigjilencës dhe ruajtjes së sekretit në të gjitha fushat, por posaçërisht sekretit ushtarak. Gjithçka bëjmë, ndërtojmë e përgatitim për të forcuar mbrojtjen e atdheut vihet në rrezik në qoftë se bie në vesh të armiqve. Prandaj me askënd që nuk i takon, pavarësisht nga vendi dhe përgjegjësia që ka, të mos bisedohet për çështjet e mbrojtjes që përbëjnë sekret ushtarak. Komiteti Qendror tërheq seriozisht vëmendjen e të gjitha organeve dhe të organizatave të Partisë në ushtri e në terren, të të gjithë komunistëve, të ushtarakëve dhe të civilëve që marrin pjesë në stërvitjet apo në punimet mbrojtëse, që t'u japin fund bisedave e muhabetëve për këto çështje që kanë të bëjnë me fatet e atdheut. Çdo komunist e punonjës duhet të mbahet vazhdimisht në korent të problemeve që ngre Partia. Dhe Partia në kohën e në rrugën e duhur kurdoherë i ka informuar komunistët dhe popullin për gjithçka. Por secili, para së gjithash, duhet të interesohet të kryejë mirë detyrën që i është ngarkuar. Njëkohësisht të interesohet të dijë e të mësojë, gjithnjë në rrugë partie, çështjet që i hyjnë në punë. Të dijë, gjithashtu, të ruajë sekretin e të mbajë konspiracionin për ato çështje të qendrës së punës apo jashtë saj, qofshin ato politike, ekonomike e sidomos ushtarake, për të cilat është në dënim, por që nuk ka pse t'i dinë të tjerët.

Asnjëherë të mos harrojmë rrezikun e rrethimit imperialist e revizionist. Sidomos në situatat aktuale, kur të dyja superfuqitë, në rivalitet dhe në bashkëpunim të rrezikshëm me njëra-tjetrën, po kërcënojnë seriozisht botën me shpërthimin e luftës, kur ngjarjet në Qipro mund të shfrytëzohen nga forcat amerikane e sovjetike për të futur më mirë duart e këmbët në Ballkan e në Mesdhe, në këto situata, që as na trembin dhe as na alarmojnë, na duhet gjithnjë të jemi të gatshëm, vigjilentë e konspirativë, të jemi shumë të kujdesshëm në qëndrimet dhe në veprimet tona. Prandaj të luftohen kuriozitetet, llafet, thashethemet. Të mësohet çdo komunist e qytetar që të kërkojë të dijë atë që i takon, aq sa i takon dhe atëherë kur i takon. Dhe asgjë që s'duhet thënë të mos e bëjë muhabet me kërkënd tjetër.

Së katërti, të tregohet kujdes i posaçëm e i vazhdueshëm për kuadrot, për edukimin dhe për trajtimin e tyre në rrugën e shëndoshë të Partisë. Qëndrimi ndaj vijës së Partisë dhe kryerja e detyrave, këto duhet të jenë kurdoherë kriteret bazë për vlerësimin e punës së tyre. Të ndihmohen e të mësohen ata për të qenë sa më korrektë në këto dy drejtime, të kritikohen e të dënohen, kur s'janë në rregull me to, të lavdërohen, të stimulohen e të ngrihen në përgjegjësi, kur edhe vijën e Partisë e ruajnë me fanatizëm dhe e zbatojnë me përpikëri, edhe detyrat e ngarkuara i kryejnë plotësisht, në kohë e me cilësi të lartë. Kuadrot dhe komunistët, në përgjithësi, duhet të mbajnë kurdoherë parasysh mësimet dhe direktivat e Partisë, që, si shërbëtorë besnikë të popullit, të japin rregullisht llogari përpara masave, të dëgjojnë me shumë kujdes zërin e tyre. të

zbatojnë menjëherë vërejtjet dhe propozimet e tyre të drejta, të jenë parimorë e të luftojnë si servilizmin, ashtu edhe konformizmin.

Së pesti, të ruhet e pastër e kurdoherë e nderuar figura e udhëheqësit. Këta të jenë të ndërgjegjshëm se në rolin e udhëheqësit të masave, në funksionet drejtuese me rëndësi që mbajnë, i ka sjellë Partia, vija e saj dhe puna e tyre. Prandaj ky nuk është një privilegj, por një detyrë me përgjegjësi të madhe përpara Partisë dhe popullit. Asnjërit nuk duhet t'i rritet mendja për këtë dhe të mendojë se nuk ka si ai. Përkundrazi, udhëheqësi duhet të jetë i thjeshtë në jetë dhe në veprimtarinë e përditshme, edhe kur sektori i punës ku drejton korr fitore sado të mëdha. Thjeshtësia është karakteristikë e njerëzve të pjekur dhe e trimave, ndërsa mburrjet dhe megalomania janë karakteristika të njerëzve të sëmurë, që përpiqen të përfitojnë nga situatat apo nga pozitat që u ka dhënë Partia për t'i hipur popullit e Partisë në zverk.

Këto mësimë duhet t'i mbajmë vazhdimisht parasysht e t'i vëmë në jetë kudo e kurdoherë.

Të dashur shokë,

Këto ishin përfundimet në të cilat arriti Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror, duke analizuar veprimtarinë armiqësore antiparti të Beqir Ballukut. Ishte një gjë e keqe, e mbarsur me rreziqe të mëdha ajo që një armik i kamufluar punonte dhe vepronte fshehurazi kundër vijës së Partisë në krye të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Por është një gjë shumë e mirë, një fitore e

rëndësishme që u zbulua, u demaskua dhe u pastrua kjo e keqe.

Armiqtë do të përpiqen ta shfrytëzojnë këtë që ngjau, për qëllimet e tyre. Por ata e dinë mirë dhe, në mos e dinë, do ta mësojnë edhe një herë se në Shqipërinë socialiste Partia dhe populli në fuqi e mbajnë kurdoherë të shëndoshë, të pastër e të paprekshme situatën e brendshme revolucionare.

Siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe siç e ka provuar eksperiencia më tepër se 30-vjeçare e Partisë sonë, pastrimi i radhëve të Partisë nga elementi armik antiparti e forcon akoma më shumë atë, forcon më tej unitetin e saj rreth Komitetit Qendror, si edhe unitetin e popullit rreth Partisë, kalit ndërgjegjen, vigjilencën dhe gatishmërinë luftarake të komunistëve dhe të punonjësve, rrit pa masë hovin e tyre revolucionar në plotësimin me nder të të gjitha detyrave për ta ngritur lart e më lart emrin e atdheut tonë socialist, për ta bërë Shqipërinë tonë kala të pamposhtur nga çdo «rrebesh e tufan».

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# PROJEKTPLANIN E PESËVJEÇARIT TË ARDHSHËM TA STUDIOJMË E TA REALIZOJMË POLITIKISHT DHE EKONOMIKISHT SI TRËNGUAR

Shënime<sup>1</sup>

16 shtator 1974

Bisedën me Abdylin e zhvillova në parim, pa u futur në detaje. Veprat për pesëvjeçarin e ardhshëm janë vendosur më parë dhe nuk diskutojmë për to, ne duhet t'i kërkojmë dhe të luftojmë që kinezët të na i japin.

Për këtë problem kisha folur më parë me Mehmetin [Shehun] dhe e kisha orientuar të mbliidhte shokët e Qeverisë që ta rishikonin shumën e kërkesës, se mendoj që kinezët nuk do të na e pranojnë<sup>2</sup>. Asnjëherë

---

1. Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka shkruar pas bisedës që zhvilloi me Abdyl Këllezin lidhur me kreditë që do t'i kërkoreshin Kinës për pesëvjeçarin e gjashtë, 1975-1980.

2. Në fakt kinezët nuk po jepnin ato kredi për të cilat ishim marrë vesh. Lidhur me këtë çështje, në Ditarin Politik më 13 dhjetor 1974, shoku Enver Hoxha shkruante: «Sot më raportuan për fjalën që kishte mbajtur kryetari i delegacionit kinez, pasi tanët u parashtruan gjerësisht atyre kërkesat për objekte. A. Këllezi m'u duk ca si optimist, po unë nuk jam optimist...»

Përfaqësuesi kinez kishte thënë: «Duhet të na jepni të

nuk na kanë dhënë aq sa kemi kërkuar. Me kërkesat tona duhet të jemi të arsyeshëm, që edhe nevojat kryesore të na plotësohen, por edhe kinezët të mos i vëmë në pozita të atilla që të dalin me konkluzionin se «shqiptarët mbetën të pakënaqur».

I thashë Mehmetit që, po të na i japin kinezët të gjitha këto që ne kërkojmë, është gjë shumë e mirë, dëm asgjë s'na shkon, por, megjithëse thuhet «se janë bërë kërkesa të shtrënguara, është bërë luftë në mes dikastereve etj., etj.», unë nuk jam fort i bindur për këtë.

Mehmeti i kishte shtruar këto dhe Abdyli erdhi të më parashtronte rezultatet: 50 milionë më pak. Shumë, natyrisht, e vogël.

Abdyli filloi të më tregonte mënyrën se si e kishin nxjerrë këtë shumë. Kishin kërkuar që plani duhej të rritej kaq në çdo sektor dhe, mbi këtë bazë, ata poshtë kishin llogaritur kërkesat për të cilat baza

---

dhëna të plota që të mund të gjykojmë ku e si bazohen kërkesat tuaja»...

Pasi m'u lexua ky fjalim i kinezit, A. Këllezi më tha se «ne do t'ua japim të gjitha të dhënat me hollësi». — Jo, t'ua japim të dhëna, por nuk është nevoja me hollësi dhe për të gjitha gjërat, — iu përgjigja.

Shokëve u thashë, dhe këta ishin dakord, se «siç po e gjykoj unë, kinezët kanë dy tendenca: të marrin të gjitha të dhënat për ekonominë tonë, por të mos na japin ç'kërkojmë; të nxjerrin shumë pengesa dhe të na japin pak. Prandaj shokët tanë në të dy këto drejtime duhet të bëjnë shumë kujdes, t'ua japin atyre ato të dhëna që janë të domosdoshme dhe të sigurojnë prej tyre zbatimin e të gjitha detyrimeve që kanë ndaj nesh, dhe jo të japin shumë e të marrin pak». (Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 95, 96.)

nuk di nga dalin e sa dalin (pse asnjë orientim nuk i jepet nga sipër, për kufirin e kërkesave të kredisë nga Kina). Bile, llogaritë e bazës i kapërcenin një miliard e njëqind a dyqind milionë rubla. Ky është një orientim jo i saktë dhe kjo na çon në atë që të kërkojmë pa përgjegjësi 500 traktorë të rinj dhe 6 mijë deri 8 mijë vegla të tjera bujqësore, të kërkojmë një sasi të madhe kamionësh në një kohë kur vumë në shfrytëzim hekurudha të reja, të kërkojmë gjeneratorë të panumërt kur në plan kemi vënë hidrocentrale dhe termocentrale gjigante, kërkojmë çeliqe dhe për të bërë frigoriferë e lavatriçe kur çeliku s'c zë dot me dorë, nga shtrenjtësia.

Pra, kërkesat, i tërhoqa vëmendjen Abdylit, nuk janë studiuar politikisht dhe ekonomikisht shtrënguar, ne duhet të realizojmë projektplanin e pesëvjeçarit të ardhshëm, pa u ulur në vijat kryesore që parashikojmë, ku duke bërë sforco të mëdha dhe ku sakrifica. Kohët paraqiten të vështira në botë dhe duhet t'i kemi parasysh se do të ketë vështirësi e sakrifica edhe për ne. Në fund i thashë se duhet të përgatitin edhe dy variante të tjera, nga kjo që na propozojnë dhe ato të jenë të studiuara mirë, të balancuara dhe jo të rastit e se ju «kështu gjykuat më mirë». Ai ishte dakord me vërejtjet e mia. I thashë përsëri Mehmetit çfarë i këshillova Abdylit dhe ai ishte dakord me mendimet e mia.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



**NGA QËNDRIMI I MIQVE DHE I ARMIQVE  
NDAJ NESH KEMI MËSUAR T'I DUAM  
ME GJITHË ZEMËR MIQTË DHE T'I  
URREJMË PA MASË ARMIQTË**

*Nga biseda me një delegacion të Republikës së  
Vietnamit të Jugut, të kryesuar nga Nguyen Huu Tho<sup>1</sup>*

**17 shtator 1974**

*Pasi u uroi mysafirëve mirëseardhjen dhe shprehu  
gëzimin për vizitën e tyre në vendin tonë, shoku  
Enver Hoxha vazhdoi:*

Megjithëse jemi larg, ne e kemi ndjekur nga afër  
luftën tuaj heroike e të pashembullt, kemi qenë me ju,  
kemi luftuar së toku dhe, me forcat që kemi pasur,  
kemi përkrahur e kemi ndihmuar luftën tuaj legjen-  
dare kundër imperializmit amerikan, klikës së Sajgonit  
dhe tradhtarëve të popullit të Vietnamit. Vite me radhë  
ne e kemi ndier si detyrë të parë internacionaliste t'ia  
bënim të njohur popullit tonë luftën që keni bërë, tak-  
tikën dhe strategjinë, vështirësitë dhe fitoret tuaja.

---

1. Në atë kohë kryetar i Këshillit të të Urtëve të Qeverisë  
Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të  
Jugut.

Prandaj ne themi se kemi luftuar dhe kemi jetuar tok me ju. Lufta juaj, sikurse e kemi thënë më parë, e themi tani dhe do të vazhdojmë ta themi edhe në të ardhmen, është bërë jo vetëm për çlirimin e popullit tuaj, por njëkohësisht ajo ka vlejtur edhe si një shembull i shkëlqyer për të gjithë popujt e tjerë të botës, që luftojnë për çlirim, për sovranitet kombëtar, për socializëm. Përvoja e kësaj lufte është një mësim i vlefshëm për të gjithë ne. Pikërisht për këtë arsye jemi shumë të gëzuar këto ditë që ju kemi në mes nesh ju, përfaqësues të një populli dhe ushtrie heroike, që bëtë aq shumë sakrifica dhe arritët disa rezultate, që ne i konsiderojmë si fitoret tona.

Ne, natyrisht, nëpërmjet radios dhe shtypit e ndjekim vazhdimisht gjendjen në Vietnamin e Jugut dhe, pak a shumë, jemi në dijeni si zhvillohet situata atje. Lajmet e agjencive të huaja na bëjnë të njohur se në Vietnamin e Jugut vazhdohet të luftohet. Ju edhe ne bëjmë mirë që i mbajmë armët në duar, pse ajo që ju ngjau dhe vazhdon t'ju ngjasë juve, mund të na ngjasë edhe neve, mund t'u ngjasë edhe popujve të tjerë. Mungesa e vigjilencës i hap rrugën katastrofës.

Sigurisht ju do të na vini në dijeni rreth zhvillimit të ngjarjeve më mirë se agjencitë e huaja. Është e vërtetë se populli ynë ka fituar lirinë dhe ka marrë pushtetin tërësisht në duart e veta, por ne kemi nevojë për miq, për solidaritet të sinqertë, për dashuri dhe për unitet marksist-leninist në luftën që bëjmë kundër revizionistëve sovjetikë dhe zagarëve të tyre, se ata kanë shumë zagarë, si dhe kundër imperializmit amerikan.

*Duke marrë fjalën, kryetari i delegacionit falënde-*

roi për pritjen e ngrohtë dhe për ndihmën që populli, Partia dhe Qeveria Shqiptare i kishin dhënë, i jepnin dhe do t'i jepnin popullit vietnamez. Ai foli shkurtimisht për Marrëveshjen e Parisit si dhe për eksperiencën e fitoret e popullit shqiptar në ndërtimin socialist të vendit. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Faleminderit për fjalët e mira që thatë për ne. E pritnim me gëzim rastin që ju të na vinit në Shqipëri për të shkëmbyer me njëri-tjetrin mendime dhe eksperiencë. Ju vini për herë të parë në Shqipëri, kurse shoku Nguyen Van Hien<sup>1</sup> ka ardhur edhe herë të tjera. Këtu ka qenë edhe shoqja Bin, me të cilën kemi zhvilluar bisedime të hapëta shoqërore.

Në bisedat me shokët vietnamezë kemi këmbyer mendime mbarë e prapë, veçse kurdoherë kemi folur singërisht, si shokë e miq që jemi. Nuk e dimë si na çmojnë të tjerët, por mendojmë se miqtë duhet të jenë të hapët e të singertë me njëri-tjetrin, kështu sikurse kemi qenë ne me ju.

Ka pasur raste kur të tjerët na janë hequr si miq, por në të vërtetë me kohë na kanë dalë armiq dhe nga pabesia e tyre ne kemi mësuar shumë. Nga qëndrimi i miqve dhe i armiqve ndaj nesh, ne kemi mësuar t'i duam me gjithë zemër shokët dhe miqtë e singertë dhe t'i urrejmë pa masë armiqtë. Urrejtja kundër armiqve është një faktor me rëndësi që i nxit masat punonjëse për ndërtimin e socializmit dhe për kalitjen e miqësisë marksiste-leniniste me miqtë. Po të mos i urrejmë si duhet armiqtë, do të biem në pozita oportuniste ndaj

---

1. Në atë kohë ministër në Qeverinë Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të Jugut.

tyre. Historia e popujve të tjerë dhe ajo e popullit tonë, si dhe ideologjia jonë marksiste-leniniste, nuk na lejojnë të mos bëjmë dallim midis miqve, t'i futim të tërë miqtë në një «thes», prandaj e kemi gjetur të domosdoshme t'i kategorizojmë ata.

Ne, shqiptarët, me miq si ju flasim pa rezerva. Sikurse u kemi thënë edhe shokëve të tjerë vietnamezë, edhe shoqes Bin, në bisedimet që kemi pasur me ta, nuk dimë dhe nuk mund ta përfytyrojmë, për shembull, ndihmën që ju ka dhënë juve Bashkimi revizionist Sovjetik. Ne shprehim pikëpamjen e Partisë sonë se Bashkimi Sovjetik tashmë është kthyer në një vend revizionist, se ai është një shtet armik, aktualisht fashist, që udhëhiqet nga revizionistë e fashistë. Po të mos jua them këtë mendim tonin, Partia do të më heqë veshin dhe do të më qortojë, duke më thënë: «Pse nuk folë hapur me miqtë vietnamezë? Me shokët tanë bën ti diplomaci?». As shokët, as Partia nuk do të ma falnin po të fshihja mendimet për hir të diplomacisë. Prandaj ju them se në çdo «ndihmë» të revizionistëve sovjetikë fshihen djallëzia, intriga dhe qëllimi për të nënshtruar të tjerët para fuqisë së tyre të madhe. Faktet historike i provojnë këto të vërteta, që nuk mund të mbulohen me asnjë mjet dhe me asnjë lloj propagande.

Ne jua kemi thënë mendimin e Partisë sonë për Konferencën e Parisit. Rreth saj kemi pasur rezervat tona për disa arsye:

Së pari, sepse ishim të bindur që lufta akoma nuk kishte mbaruar, se ajo do të vazhdonte sikurse po vazhdon, se ju do t'ia gërryenit themelet pushtetit të Sajgonit dhe të amerikanëve. Ushtria amerikane «iku» andej, por, ushtarakët amerikanë, kësaj here pa uni-

formë, kanë mbetur atje, brenda në Vietnam, së bashku me ushtrinë e Van Thieut, me specialistët dhe me armët e tyre.

Së dyti, imperialistët dhe veglat e tyre nuk e lëshojnë vullnetarisht pushtetin nga duart, prandaj duhet t'ua marrim atë me luftë.

Së treti, ne kishim frikë se mos kjo «paqe» që u arrit në Paris mund të demoralizonte popullin hero të Vietnamit, i cili, duke u nxitur nga ndjenja pacifiste, kishte rrezik të lëshohej pa arritur fitoren. Pra ne dyshonim se mos vallë njerëzit, që ishin ngritur në kulm të luftës, tani do të kujtonin se e arritën me të vërtetë paqen.

Për çështjen e «paqes» në Vietnam, për këtë paqe false, sot po flasin të gjithë, deri edhe bankierët e botës, duke filluar nga zvicerani, suedezi e gjer te kanadezi dhe australiani e të tjerë. Të gjithë bëjnë thirrje: «Të ndihmojmë popullin e Vietnamit, se u dogj e u përvëlua!» Ne e admirojmë simpatinë e popujve të botës për popullin tuaj, se popujt kurdoherë janë miq me njëri-tjetrin, por e përçmojmë me neveri «simpatinë» e klikave sunduese që derdhin lot krokodili për ju.

Për rezervat që kishim ne për marrëveshjen e Parisit, nuk kemi thënë asnjë fjalë publikisht, sepse e duam Vietnamin dhe unitetin e plotë të luftëtarëve të tij të shquar, të cilët kanë përpara akoma një luftë të madhe për të bërë. Me kaq sa mund të gjykojmë, në bazë të fakteve që kemi, ju them sinqerisht, ju shprehemi me ndjenjat e zemrës, se ju, luftëtarët e Vietnamit, nuk jeni fajtorë për përfundimin e Marrëveshjes së Parisit. Historia vazhdimisht do të flasë për luftën e vietnamezëve. Popujt duhet t'ju nderojnë për

heroizmin tuaj dhe t'ju ndihmojnë me të gjitha mundësitë. Edhe ne, me ato mundësi të vogla që kemi, ju kemi ndihmuar dhe prapë do t'ju ndihmojmë. Ne e kemi parashikuar në planin tonë ndihmën ndaj jush. Sa herë bënim planet, parashikonim edhe projektet për ndihmën që duhet t'i jepnim Vietnamit të Veriut dhe të Jugut. Megjithatë ndihma jonë është diçka fare-fare e vogël për ju, prandaj mos na i përsëritni falënderimet që na drejtoni.

Mbase të tjerët nuk jua kanë thënë kaq hapur vërejtjet e tyre siç po jua themi ne. Megjithatë, pavarësisht se si veprojnë të tjerët, neve, komunistëve shqiptarë, na pëlqen të jemi të sinqertë me ata që i duam. Me ju, të na besoni, flasim me zemër të hapët, pse lufta në Vietnam është një çështje me rëndësi për ju dhe për ne. Sipas pikëpamjes sonë, revolucioni juaj nuk mund të quhet i përfunduar, pse fundi i tij duhet të ishte marrja e pushtetit në duart e popullit dhe çlirimi i plotë i vendit nga armiqtë e brendshëm dhe të huaj. Populli juaj ka bërë sakrifica kolosale, prandaj atij nuk i takonte ky rezultat i cunguar i Konferencës së Parisit. Ai meritonte fitoren e plotë dhe përfundimtare. Ne, sipas mendimit tonë, e kemi rrahur këtë çështje po me atë interesim që analizojmë punët tona, sepse ju duam, ju kemi shokë, ju kemi vëllezër.

Kur u mbajt Konferenca e Parisit për Vietnamin, imperializmi amerikan po kalonte një krizë të thellë, ai ishte në tronditje e sipër. Me vazhdimin e luftës agresive kundër vendit tuaj, presidenti Nikson ishte diskredituar keqas. Lufta juaj heroike kishte arritur kulmin e saj, ju ishit gati duke e mundur në fushën e betejës imperializmin amerikan, kur e ndërpretë luftën dhe nuk

i bëtë edhe disa çape që duheshin bërë. Ne mendojmë se ky qëndrim nuk ka ardhur për fajin tuaj, por për fajin e udhëheqësve revizionistë sovjetikë, që kanë luajtur një rol shumë negativ me intrigat dhe politikën hipokrite që praktikuan. Imperialistët sovjetikë, si rezultat i marrëveshjeve Nikson-Brezhnjev, ndihmuan që presidenti amerikan të dilte nga situata e vështirë ku ishte katandisur dhe i dhanë mundësi atij që, bashkë me atë vagabondin tjetër, Kisingerin, të hiqeshin para publikut amerikan gjoja si ndërtuesit e paqes në Vietnam! Duke shkelur mbi gjakun dhe të drejtat e ligjshme të popullit heroik vietnamez, revizionistët sovjetikë i futën Niksonit disa «shiringa» që t'i zgjatej jeta për njëfarë kohe, sepse ai me siguri do të ishte rrëzuar më parë nga pushteti për shkak të luftës suaj të vendosur.

Tani, pas kësaj që bënë, sovjetikëve ua do puna t'ju hiqen si miq, t'ju japin edhe «ndihma». Ne, shqiptarët, që i kemi provuar «ndihmat» e tyre, e dimë mirë se ato janë helm. Ata i përmendin shpesh dhe i reklamojnë vend e pa vend «ndihmat» që na ka dhënë neve Bashkimi Sovjetik. Mos u besoni të tërave sa thonë, se shumica janë shpifje. Ata të ndihmojnë diçka, po me kusht që të të nënshtrojnë, kurse ne, duke mos pranuar diktatin e tyre, i thamë Hrushovit: «Bar do të hamë dhe juve nuk ju nënshtrohemi!».

Katër vjet të tërë pas luftës, populli shqiptar i dje-gur, i përvëlur, me bujqësi të shkatërruar, gati pa industri, pa rrugë, i vuri vetë gjoksin dhe, me thonj e me dhëmbë, e rindërtoi vetë vendin e tij dhe nuk pranoi as «ndihmën» e amerikanëve, as atë të anglezëve dhe të të tjerëve si këta. Titoja (ku vajtët ju dhe që kush e di si ju ka folur, natyrisht nga «maja e Olimpët»), jo ve-

tëm nuk i mbajti premtimet për ndihmë, por nëpërmjet agjentëve që kishte në vendin tonë, na i rrëmbeu si kusar edhe ato pak ushqime e mallra industriale që kishim në Shqipëri. Edhe qilimat, edhe pak stofra që shteti ynë ua shpronësoi ish-tregtarëve të mëdhenj të Shqipërisë, titistët me pretekste të ndryshme na i rrëmbyen. Stalini na ndihmonte ne me sa mundësi që kishte dhe si marksist-leninist i madh që ishte na tha hap-tazi: «Shokë shqiptarë, tani për tani nuk kemi t'ju japim më shumë, se vetë Bashkimi Sovjetik është djegur nga lufta». Më pas Stalini e shtoi ndihmën ekonomike për Shqipërinë, duke na dhënë ndonjë kombinat, disa fabrika dhe traktorë. Pas vdekjes së tij në fuqi erdhën hrushovianët, të cilët filluan «të na mblihdnin rripat». Mikojani donte të na mësonte se «lopa duhet të bëhet fabrikë». Kështu, sipas tij, duhej që nga lopa jonë, e cila akoma nuk kishte të hante, të merreshin 4 000 litra qumësht në vit, në një kohë kur vetë ata në vitet e para pas fitores së Revolucionit të Tetorit nuk merrnin më shumë se 800 litra qumësht për çdo lopë! Mikojani na «mësonte» kështu që ne të mos i kërkonim prodhime ushqimore për popullin, megjithëse ishim në gjendje shumë të vështirë. Kur i kërkuam njëherë Hrushovit pak drithë dhe disa mallra me kredi për të plotësuar nevojat e popullit tonë, Mikojani na u përgjigj: «Nuk ju japim mallra pa para në dorë». Këto presione ekonomike, që na bëheshin me qëllim që ne t'u nënshtroheshim revizionistëve, i kemi hedhur poshtë dhe kemi mbrojtur lirinë, pavarësinë, sovranitetin dhe dinjitetin e Republikës sonë Popullore.

Revizionistët sovjetikë, që e kanë shndërruar vendin në një shtet të madh shovinist, mendojnë të krijojnë



ku të jetë e mundur baza ushtarake. Ata dëshirojnë të kenë të tilla edhe te ju për të kërcënuar Kinën, por ne jemi të bindur se te populli vietnamez ata nuk do të gjejnë fushë të lirë veprimi në këtë ndërmarrje të urryer të tyre.

Tani revizionistët sovjetikë po kërcënojnë Jugosllavinë, Shqipërinë dhe Greqinë. Ata e kanë shndërruar Bullgarinë (ku ju do të veni nesër) në një plasdarm, atje kanë vendosur shumë ushtarë e parashutistë desantë, si dhe një numër të madh avionësh dhe armësh të tjera. Po presin sa të vdesë Titoja, sa të vdesim edhe ne dhe pastaj shpresojnë «të gjejnë shesh e të bëjnë përshesh». Ata kujtojnë se pas vdekjes sonë do të jenë të lirë të vijnë këtu, të kapin portet tona aq të dëshiruara prej tyre dhe të sundojnë mbi popullin shqiptar. Por ëndrrat e tyre do të dështojnë, përpjekjet e tyre, qofshin edhe me armë, me siguri do të thyhen. Ne nuk jemi vetëm në luftën kundër socialimperialistëve, ka miliona njerëz në botë që mendojnë si ne dhe do të na përkrahin, po të jetë nevoja.

Armiqtë mendojnë se armët e tyre do të fitojnë mbi ne, që jemi «të vegjël», por harrojnë se ideja jonë është e madhe, se njerëzit që janë të vendosur të mbrojnë deri në fund një çështje të drejtë dinë të fitojnë mbi armët e pushtuesve. Lufta juaj e vërteton më së miri këtë që thashë. Njerëz jeni ju, njerëz janë edhe kukullat e Sajgonit, vietnamezë jeni ju, vietnamezë janë edhe ata, por, ndërsa ju jeni të çeliktë, sepse luftoni për kauzën e madhe të çlirimit të popullit, ata janë plehra, sepse shërbejnë si mercenarë të imperialistëve amerikanë.

Ne kemi bindje, shokë, se ju do t'i thyni edhe amerikanët edhe kukullat e Sajgonit, sepse aktualisht

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë mbërthyer në një krizë të madhe ekonomike, politike dhe ushtarake. Kjo krizë ka ndikuar për keq në marrëdhëniet e aleatëve perëndimorë. Të gjitha koniunkturat që janë krijuar, ne duhet t'i shfrytëzojmë në favor të çështjes sonë, pa qenë nevoja të futemi në ingranazhet e sovjeta-amerikanëve. Sajgoni mund të ketë më shumë ushtri nga ju, amerikanët mund të kthehen përsëri në Vietnam, por në qoftë se vazhdon lufta juaj, si forcat e Shteteve të Bashkuara, ashtu edhe ushtria sajgonce, do të dështojnë me turp.

Ne i kuptojmë situatat tuaja, por kuptojmë edhe ndjenjat që ushqeni. Zemra juaj rreh për popullin dhe për atdheun dhe këtë e treguat në luftë dhe do të vazhdoni ta tregoni përsëri, duke punuar e duke luftuar. Ju dhe ne jemi të bindur se, pa luftuar, nuk mundën agresori dhe armiqtë e popullit. Këtu qëndron uniteti ynë. Po të preken me trëndafila, siç bëjnë pasuesit e Hrushovit, Amerika imperialiste dhe kapitalizmi në përgjithësi mund të rrojnë me shekuj.

Ju siguroj se ne do të jemi deri në fund me ju, me popullin heroik të Vietnamit. Prandaj ju lutem u transmetoni shokëve dhe gjithë luftëtarëve në Vietnam përshëndetjet tona të përzemërta.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern 1971-1975» (Përmbledhje veprash), f. 543*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern 1971-1975» (Përmbledhje veprash), f. 543*

## POLITIKA JONË ËSHTË E HAPUR, ËSHTË POLITIKË E PARIMEVE PROLETARE

*Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës elektorale  
nr. 209 të Tiranës*

3 tetor 1974

Ju falënderoj që caktuat si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor mua, ushtarin e Partisë, djalin dhe vëllanë tuaj dhe ju siguroj se do t'u shërbej Partisë e popullit gjersa të rroj. Çdo gjë që bëjmë së toku ia detyrojmë të gjitha Partisë, vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, që qëndron në bazë të të gjitha fitoreve e që përbën garancinë për të ardhmen socialiste të vendit tonë. Lavdërimet dhe himnet u duhen bërë vetëm Partisë e popullit dhe askujt tjetër.

Te ne Parti, klasë, masa e udhëheqës janë një dhe të pandarë. Prandaj është e natyrshme që zgjedhjet në vendin tonë kanë treguar e tregojnë kurdoherë unitetin e çeliktë të Partisë me popullin, bashkimin e pathyeshëm të masave punonjëse në radhët e Frontit Demokratik, kompaktësinë e klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies sonë popullore.

Zgjedhjet e kësaj legjislature të Kuvendit Popu-

llor zhvillohen në pragun e një ngjarjeje të shënuar, 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor. Me këtë rast Partia, pushteti dhe mbarë populli ynë mund të bëjnë me krenari bilancin e fitoreve të arritura dhe me optimizëm mund ta shikojnë të ardhmen. Vitet që kanë kaluar janë të tëra vite të lavdishme, ku secili ka lënë gjurmë të pashlyeshme në truallin tonë, ku secili përbën një përmendore më vete.

Në jubileun e shënuar të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut me kënaqësi të madhe mund të shikojmë se programi i Partisë për industrializimin e vendit, për kolektivizimin e bujqësisë, për zhvillimin e revolucionit kulturor dhe për edukimin e njeriut të ri është realizuar me sukses në të gjitha etapat dhe në të gjitha hallkat. Sot, nga lartësia 30-vjeçare, ne mund të shikojmë në tërë madhësinë e qartësinë e tij kursin e drejtë që mori Partia që në fillim për këto çështje, drejtësinë e politikës ekonomike që përpunoi e që zbatoi ajo, vitalitetin e parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Brenda një kohe relativisht të shkurtër populli ynë ka krijuar një ekonomi shumëdegëshe, që forcohet vazhdimisht dhe që zgjerohet pandërprerë me sektorë të rinj të prodhimit modern. Është ndërtuar një industri komplekse, nxjerrëse dhe përpunuese, e rëndë dhe e lehtë, një bujqësi e përparuar dhe e zhvilluar në mënyrë të gjithanshme.

Si rezultat i punës kolosale vetëmohuese që ka bërë populli ynë në këta tridhjetë vjet, është bërë e mundur që sot të plotësohen tërësisht ose në një shkallë të gjerë nevojat e planifikuara të ekonomisë kom-

bëtare dhe të popullit me energji elektrike, me lëndë djegëse e karburante, me lëndë të para e ndihmëse, me pjesë ndërrimi e me pajisje të ndryshme. Gjithnjë e më mirë po plotësohen nevojat tona me mallra të konsumit të gjerë të prodhuara në vend, ashtu siç është rritur në përpjesëtime të mëdha eksporti, jo vetëm i lëndëve të para, por edhe i mallrave gjysmë të fabrikuara e të fabrikuara.

Një zhvillim të madh ka marrë sidomos industria minerare e kromit, e hekurit, e bakrit dhe e mineraleve të tjera. Shfrytëzimi i këtyre pasurive të mëdha të vendit hap perspektiva të reja për të ardhmen e ekonomisë sonë. Ne kemi një industri të naftës të zhvilluar, përpunimi i së cilës tani bëhet në vend me anë të rafinerive të shumta e moderne. Këto përbëjnë bazën që në të ardhmen jo të largët të krijohet industria e petrokimisë. Gati të gjitha lëndët e para tani përpunohen në vend dhe kthehen në të mira materiale, në tekstile, këpucë, konfeksione të ndryshme, sende ushqimore etj.

Suksese të mëdha janë arritur edhe në zhvillimin e bujqësisë, kësaj dege shumë të rëndësishme të ekonomisë popullore. Për zhvillimin e saj është ndjekur një rrugë e drejtë, duke filluar që nga Reforma Agrare, bonifikimet, mekanizimi, krijimi i industrisë së plehrave kimike, përdorimi i farërave të zgjedhura, përmirësimi i racave në blegtori dhe, mbi të gjitha, kolektivizimi i bujqësisë, deri në krijimin e kooperativave të tipit të lartë. Kjo rrugë çoi në forcimin e alcancës së klasës punëtore me fshatarësinë, të cilat u lidhën jo vetëm shpirtërisht, por edhe ekonomikisht e materialisht me vijën e Partisë e të socializmit. Tani fshatí ynë koo-

perativist po përparon çdo ditë e më shumë dhe dallimet midis tij dhe qytetit po ngushtohen vazhdimisht.

I gjithë ky zhvillim dhe përparim ka diktuar dhe ka bërë të mundur shtrirjen e një rrjeti të tërë rrugor, që tani lidh të gjitha skajet e Shqipërisë, deri në fshatrat më të largëta. Krahas transportit automobilistik e atij hekurudhor, u krijua transporti detar, që na lidh me shumë vende të botës.

Shqipëria, që në të kaluarën rronte në errësi, është sot një vend krejt i elektrifikuar. Hidrocentrale e termocentrale vigane po i shtohen vendit në çdo pesë-vjeçar. Këto vepra, që shfrytëzojnë burimet e brendshme ujore etj., vënë në lëvizje uzina e kombinat dhe nesër do të vënë në lëvizje Kombinatin e madh Metalurgjik të Elbasanit.

Kultura dhe arsimi, që kanë marrë një hov të madh e të paparë, janë ngritur mbi baza shkencore marksiste-leniniste. Nga shkollat tona është krijuar një armatë e tërë kuadrosh të dalë nga gjiri i popullit. Ne kemi tani mjaft talente të shquara në shkencë, në teknikë dhe në art.

Vija e Partisë sonë ka qenë dhe është që e gjithë superstruktura e shoqërisë, e ngritur në përshtatje të harmonishme me bazën e vet ekonomike, t'i shërbejë plotësisht zhvillimit të gjithanshëm të vendit në rrugën e socializmit.

Natyrisht nuk mund të themi se kemi arritur perfeksionin në çdo gjë, por është fakt se të gjithë njerëzit e artit, të shkencës dhe të kulturës janë të lidhur ngushtë me zhvillimin real e konkret të socializmit në vendin tonë dhe me vijën e Partisë. Asnjë eksperiencë keqberëse nuk ka mundur të zërë vend në këtë trup

të shëndoshë dhe, kur ndonjë njeri i lig ose armik është orvatur të helmojë atmosferën tonë të pastër, fryma e lartë revolucionare e ka mbytur dhe e ka shpartalluar.

Të gjitha këto janë fryt i punës, i mendjes dhe i djersës së popullit, i cili është krijuesi, drejtuesi dhe shfrytëzuesi i të gjitha këtyre të mirave. Ky është socializmi, që populli e ndërton vetë dhe e gëzon vetë.

Një pasqyrë të qartë të këtij zhvillimi të vrullshëm socialist të vendit na e jep edhe Tirana, kryeqyteti i atdheut tonë të lavdishëm, që rritet e zbukurohet nga dita në ditë. Ju të gjithë jeni dëshmitarë të ndryshimeve dhe të realizimeve të mëdha që janë bërë e po bëhen në Tiranë. Punonjësit e kryeqytetit tonë vijnë në këto zgjedhje të reja me nder e ballëlart për rezultatet që kanë arritur në të gjitha fushat. Kjo na gëzon të gjithë dhe është një siguri se edhe në të ardhmen punonjësit e Tiranës do t'i mbajnë lart frymën revolucionare që i karakterizon dhe hovin e tyre në punë.

Suksese të shquara kanë arritur gjithë punonjësit e Shqipërisë socialiste. Tani me gëzim mund të themi se objektivat e caktuar në planin e pestë pesëvjeçar, përgjithësisht, po arrihen. Ne kemi një ekonomi të qëndrueshme, që nuk njeh kriza, inflacion, papunësi etj. Kjo është rezultat i epërsisë së socializmit, i vijës së drejtë të Partisë dhe i punës vetëmohuese të popullit.

Shihni ç'po ndodh tani në botë! Një krizë e rëndë ekonomiko-financiare ka përfshirë të gjitha vendet kapitaliste. Inflacioni po bën kudo kërdinë dhe ka arritur përpjesëtime kërcënuese. Thesaret e bankave të mëdha kanë filluar të boshatisen, borxhet kanë vaj-

tur deri në fyt dhe spekulimet valutore janë shtuar jashtëzakonisht. Papunësia, gjithashtu, ka filluar të rritet dhe çmimet po ngrihen pa pushim. Kostoja e jetesës është shtrenjtuar dhe gjendja e masave punonjëse keqësohet vazhdimisht. E ashtuquajtura shoqëri e konsumit, e reklamuar dhe e ngritur në qiell nga borgjezia si «shoqëri e së ardhmes», s'është veçse një shoqëri e kalbur në dekadencë, që po i zbulon gjithnjë e më shumë plagët e vjetra të përhershme të kapitalizmit, që ajo përpiqej t'i mbulonte.

Te ne këto gjëra nuk do të ndodhin kurrë. Por në këto situata të turbullta ne duhet të mobilizojmë forcat dhe të jemi të gatshëm për çdo të papritur. Stabilitetin ekonomik e politik që kemi krijuar, duhet ta mbrojmë të gjithë, çdo ditë dhe në çdo sektor. Kjo kërkon që t'i kryejmë një për një, në kohë e deri në fund, të gjitha detyrat e planit të shtetit, sepse çdo mosrealizim krijon vështirësi, që rëndojnë mbi ekonominë dhe mbi jetën e popullit.

Sot situata në botë është e tillë që interesat e vendit e të mbrojtjes kërkojnë që sakrifica dhe kursimi të jenë në rendin e ditës. Partia dhe Qeveria do të bëjnë çmos që furnizimi i popullit të mos preket dhe çmimet të mos ngrihen. Por në një kohë që çmimet e çelikeve e të pajisjeve që importojmë janë ngritur shumë, për ne shtrohet si detyrë imperative t'i mirëmbajmë makineritë dhe t'i përdorim ato në mënyrë sa më racionale. Një sektor tjetër ku ne duhet të bëjmë kurtime të mëdha, është ai i karburanteve dhe i energjisë elektrike. Puna e filluar në këtë drejtim duhet të vazhdojë dhe të gjenden rrugë e burime të reja për të kursyer sa më shumë.



Populli do më shumë sheqer, mish, vaj etj. Ju e dini se akoma nuk i sigurojmë dot plotësisht në vend të gjitha nevojat tona për këta artikuj. Gjithashtu ju e dini se çnimet e këtyre artikujve në tregun botëror janë rritur shumë dhe kanë tendencën të ngrihen akoma më tepër. Prandaj këtu dalin detyra të mëdha për bujqësinë tonë, e cila duhet t'i plotësojë më mirë dhe t'i tejkalojë planet e caktuara. Në radhë të parë, duhet të rritim prodhimin e drithërave të bukës dhe të gjitha produktet e tjera bujqësore e blegtorale. Që të marrim më shumë mish e bulmetra, duhet të shtojmë lopët, dhentë e dhitë, të zgjerojmë bazën ushqimore për blegtorinë, të përmirësojmë kullotat, të rritim prodhimtarinë e tyre.

Në situatat e sotme duhen luftuar me rreptësi sidomos tendencat për ta pritur çdo gjë nga jashtë. Na vihet detyrë të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë e burimet tona dhe, duke u mbështetur në aftësitë e forcat tona, të prodhojmë në vend sa më shumë pajisje, pjesë ndërrimi, makineri, me qëllim që të pakësojmë importin e tyre. Nga ana tjetër, të marrim masa të gjithanshme për të shtuar eksportin, për të zgjeruar gamën e tij dhe për të rritur cilësinë e mallrave që nxjerrim jashtë. Për secilin duhet të jetë e qartë se, për të importuar, duhet eksportuar.

Ne do të na duhet të kapërcejmë vështirësi e pengesa të reja, që rrjedhin nga rrethimi i egër imperialisto-revizionist, nga koniunkturat politiko-ekonomike dhe nga krizat financiaro-valutore që kanë mbërthyer botën kapitalisto-revizioniste. Prandaj të vëmë të gjitha forcat dhe të shkrijmë të gjitha energjitë tona, gjithë mençurinë dhe shpirtin krijues e vetëmo-

hues për t'i realizuar me sukses detyrat që na dalin përpara.

Tani Partia dhe Qeveria janë duke përpunuar treguesit kryesorë të zhvillimit të ekonomisë për pesëvjeçarin e gjashtë 1976-1980. Perspektiva të reja i çelen popullit tonë përpara, fitore e suksese më të mëdha e presin atë në të ardhmen. Ekonomia jonë do të zhvillohet me ritme të shpejta, ajo do të ngrihet në një nivel të ri e më të lartë. Industria do të marrë një zhvillim më të madh, do të ngrihen degë e ndërmarrje të reja, do të përmirësohet më tej struktura e prodhimit industrial, duke i dhënë prioritet, si kurdoherë, zhvillimit të industrisë së rëndë e përpunuese, pa lënë pas dore industrinë e lehtë e ushqimore, me synim që të shfrytëzohen më mirë e më racionalisht burimet dhe pasuritë e vendit.

Bujqësia jonë socialiste do të zhvillohet e do të ecë më përpara. Do të forcohet më tej baza materialo-teknike e saj, do të vihen gjerësisht në jetë të rejtat e agroteknikës, do të forcohen e do të përsosen më tej organizimi dhe drejtimi i saj dhe, mbi këto baza, do të sigurohet një rritje më e shpejtë e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Rrugë të hekurta e automobilistike, shkolla, spitale, shtëpi kulture e banesa të reja do të zbukurojnë qytetet e fshatrat tona. Rezultatet e shkencës dhe të teknikës do të përdoren më gjerë në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës. Marrëdhëniet socialiste do të përsosen pa ndërprerje, do të ngrihet më tej mirëqenia materiale e kulturore e masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, do të ngushtohen më shumë dallimet midis fshatit e qytetit dhe midis zonave fushore

e malore. Jeta e popullit tonë do të bëhet më e begatshme e më e kulturuar. Mbrojtja e atdheut dhe e fitoreve të arritura do të forcohet akoma më shumë.

Shokë dhe shoqe,

Sistemi ynë i demokracisë socialiste, në të cilin bëjnë pjesë edhe zgjedhjet për organin më të lartë të pushtetit shtetëror, ka lindur nga revolucioni popullor dhe është mbështetur fort në mësimet e marksizëm-leninizmit. Ai është rritur e është zhvilluar nëpërmjet një lufte të ashpër klasore, të brendshme e të jashtme, dhe është kalitur e është perfeksionuar nga praktika e madhe e ndërtimit tonë socialist.

Vetëm revolucioni dhe diktatura e proletariatit u sigurojnë masave të gjera punonjëse mundësinë që të marrin pjesë në drejtimin e jetës së shoqërisë, të thonë fjalën e tyre për politikën e brendshme e të jashtme të shtetit, të gëzojnë efektivisht liritë e të drejtat demokratike.

Për demokraci flasin edhe në vendet borgjeze e revizioniste. Teoricienët e propagandistët e tyre bëjnë një zhurmë të madhe, duke i atribuar asaj merita gati «hyjnore», duke e paraqitur atë si kulmin dhe formën më të lartë të organizimit shoqëror. Por, siç na mëson marksizëm-leninizmi, demokracia ka qenë dhe do të jetë kurdoherë klasore. Sistemi i demokracisë borgjeze dhe tërë aparati i saj janë një mjet për sundimin e klasës kapitaliste mbi punonjësit, ai ekziston për të mbrojtur shfrytëzimin dhe interesat e saj egoistë.

Shembull mjaft të freskët kemi Kilin. Borgjezia

e këtij vendi nuk u pengua aspak nga morali i demokracisë borgjeze dhe nga traditat e saj për të sjellë në fuqi fashizmin, kur e pa se po rrezikoheshin pozitrat e saj klasore. Dhe ajo shtypi me hekur e me zjarr jo vetëm punëtorët dhe fshatarët, por u preu kokat edhe të gjithë atyre që besonin në «themelet e patundura» të demokracisë borgjeze.

Një shembull tjetër i qartë i falsitetit të demokracisë borgjeze dhe të atij degjenerimi të brendshëm që ajo kërkon të fshehë prapa parullash mashtruese demagogjike, është edhe i ashtuquajtura skandal i Uotergeitit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Zbulimi i makinacioneve të grupeve të ndryshme të pushtetit lidhur me zgjedhjet presidenciale, ndërhyrjet e grupeve të fuqishme financiare, korrupsionet e aparatit shtetëror etj. treguan se edhe e ashtuquajtura demokraci amerikane është e kalbur që nga fundi e deri në krye. Ajo është një fasadë e jashtme e lustruar, e ngritur me qëllim që të pengojë pamjen e vërtetë të një diktature të egër të klasës kapitaliste që t'i ndalojë punonjësit të shikojnë e të kuptojnë gjendjen e tyre të vërtetë.

Për demokraci, bile edhe «socialiste», flasin edhe revizionistët. Po çfarë demokracie është ajo, kur punëtorët dhe fshatarët shtypen e shfrytëzohen nga kasta burokratike në fuqi, kur mbi punëtorët dërgohen tanke, si në Poloni, ose kur qeverinë e parlamentin i rrëzon dhe i ngre pushtuesi i huaj, si në Çekoslovaki, kur kombet e kombësitë në Bashkimin Sovjetik janë mbytur nga shovinizmi rusomadh?

Sistemi ynë i demokracisë socialiste është krejtësisht i ndryshëm nga ai i vendeve borgjeze. Deputeti

te ne nuk është një politikan profesionist, i vendosur mbi masat dhe jashtë ndikimit të tyre. Përfaqësuesi ynë në Kuvendin Popullor plotëson njëkohësisht funksionet e deputetit dhe punon drejtpërdrejt në prodhim, në zyrë ose në ndonjë sektor tjetër të veprimtarisë shoqërore. Ai jo vetëm merr pjesë në hartimin e në aprovimin e ligjeve, por edhe në zbatimin e tyre konkret në praktikë. Ai ndodhet kështu në kushte objektive materiale e shpirtërore për të çuar në Kuvend mendimet e dëshirat e masave, zërin e popullit, ashtu siç ndodhet në kushte për të çuar në masat dhe për të punuar për plotësimin e vullnetit të mbarë popullit, të shprehur nëpërmjet veprimtarisë së Kuvendit Popullor. Deputeti te ne nuk ka asnjë privilegj material. Ai, në bazë të Kushtetutës, gëzon të drejtën që të mos arrestohet, as të ndiqet penalisht pa pëlqimin e Kuvendit Popullor ose të Presidiumit të tij. Populli ka të drejtë ta revokojë atë në çdo kohë kur ai nuk e justifikon besimin e dhënë.

Jo vetëm deputetët, por të gjithë kuadrot e funksionarët, të çdo rangu qofshin, te ne janë nën kontrollin e përditshëm të masave, nën vëzhgimin e tyre të rreptë e të drejtë. Kjo nuk është shprehje e ndonjë situatë frike e mosbesimi, as edhe ndonjë praktikë formale. Kuadrot janë bij besnikë të popullit, gjaku i gjakut të tij dhe midis tyre nuk ka interesa të kundërt. Ashtu siç i ka porositur Partia, ata bëjnë të gjitha përpjekjet për të dëgjuar me kujdes zërin e masave dhe për të zbatuar shpejt e mirë vërejtjet dhe propozimet e tyre të drejta. Ata luftojnë arrogancën e prepotencën, si dhe servilizmin e konformizmin. Por masat

kërkojnë llogari të rregullt, me qëllim që të mbahen të forta ato fije të çeliktat që lidhin kuadrot me masat, që të mos shuhet kurrë në to fryma popullore, që pulsi i tyre të rrahë me një ritëm me atë të popullit, që mendja të punojë në të njëjtin drejtim.

Partia i ka edukuar dhe i edukon masat që kuadrot, funksionarët ose çdo person, me çfarëdo përgjegjësie qoftë, t'i vlerësojnë e t'i respektojnë në atë shkallë dhe për aq kohë sa ata punojnë e veprojnë në përputhje me vijën e direktivat e Partisë, me ligjet e shtetit dhe me normat e moralit komunist. Partia e para ka dhënë shembullin se askujt nuk duhet t'i mungojë guximi për të kritikuar këdo qoftë kur largohet nga vija e drejtë e saj dhe e popullit tonë.

Ne kemi mundur të mposhtim presionet e ndryshme armiqësore dhe të kapërcejmë vështirësitë e panumërta që na kanë dalë përpara, pasi kemi zhvilluar në mënyrë të pandërprerë, parimore e konsekuente luftën e klasave në të gjitha fushat, si kundër veprimtarisë armiqësore, ashtu edhe kundër shfaqjeve të huaja, qoftë kjo në shoqëri, në radhët e Partisë ose në ndërgjegjen e secilit. Por Partia na porositi ta mbajmë gjithmonë parasysh dhe të mos e harrojmë kurrë mësimin e madh marksist-leninist se lufta e klasave, si motor i historisë, është një forcë e madhe lëvizëse, që çon përpara punën për ndërtimin e socializmit, siguron lirinë e pavarësinë e atdheut, mbron mirëqenien e popullit. Ajo është një armë e fuqishme që na spastron nga të këqijat, na kalit e na bën revolucionarë, që mbron Partinë, shtetin dhe gjithë vendin nga degjenerimi dhe rivendosja e kapitalizmit. Në kushtet aktuale zhvillimi i luftës së klasave merr një rëndësi e kup-

tim të veçantë, pasi ajo është mburoja më e sigurt për të thyer agresionin ideologjik të armiqve, për të mbytur orvatjet për ringjalljen e mbeturinave të huaja ideologjike dhe për të neutralizuar ndikimet e propagandës çoroditëse borgjezo-revizioniste.

Synimi kryesor i veprimtarisë së armiqve tanë ka qenë dhe është prishja e unitetit të radhëve të Partisë, udhëheqjes së pagabuar të popullit tonë, prishja e unitetit dhe e kompaktësisë së popullit, që përbën atë shkëmb graniti ku janë thyer të tëra orvatjet djallëzore të armiqve të ndryshëm.

Por synimet e tyre kanë dështuar e do të dështojnë me turp, sepse uniteti i Partisë, i popullit dhe i pushtetit në Shqipëri ngrihet mbi themele të patundura. Në bazë të këtij uniteti qëndrojnë transformimet e mëdha revolucionare, prona socialiste mbi mjetet e prodhimit, bashkësia e interesave themelore të të gjithë punonjësve, vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë, ideologjia proletare, që është e papajtueshme me çdo gjë të huaj për rendin tonë socialist.

Presioneve të shumta të armiqve, rrethimit e bllokadave, propagandës së tyre djallëzore edhe në të ardhmen ne duhet t'u kundërvëmë bashkimin tonë monolit, unitetin e të gjithë popullit rreth Partisë. Ashtu si deri më sot, ne do t'i përballojmë ato duke u kalitur edhe më tepër politikisht e ideologjikisht, duke zhvilluar në mënyrë të pandalshme ekonominë, duke forcuar e duke çelikosur mbrojtjen e vendit, duke ruajtur e duke kultivuar kulturën kombëtare socialiste.

Ndërtimin e socializmit në Shqipëri, i cili bëhet në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, Partia e ka parë kurdoherë të lidhur ngushtë me forcimin dhe

me fuqizimin e mbrojtjes së atdheut. Besnike dhe konsekuente deri në fund e vijës së saj marksiste-leniniste, ajo i ka edukuar anëtarët e saj, masat punonjëse, gjithë popullin dhe ushtrinë që mbrojtjen e atdheut ta konsiderojnë si detyrë themelore, të përhershme dhe të vazhdueshme, detyrë mbi të gjitha detyrat. Ajo s'ka kursyer asgjë për forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit, për përgatitjen sa më të mirë të ushtrisë dhe të të gjithë popullit-ushtar. Ushtria dhe populli janë pajisur me mjete moderne, janë stërvitur e po stërviten vazhdimisht që të dinë t'i përdorin ato në çdo situatë dhe me efikasitetin më të madh.

Armiqtë, imperialistë e socialimperialistë, përpiqen të na frikësojnë me armët e tyre të shumta e të fuqishme. Por forca e vërtetë nuk qëndron as në numrin e ushtarëve dhe as në sasinë a në llojin e armëve. Historia ka vërtetuar se i pathyeshëm është ai vend dhe ai popull, qoftë ky edhe i vogël e inferior në armatime, që lufton për një çështje të drejtë dhe që është i vendosur ta mbrojë atë deri në fund. Nuk ka ushtri më të fortë sesa populli i armatosur dhe i përgatitur ushtarakisht dhe nuk ka armë më të fuqishme se lufta popullore, në zjarrin e së cilës digjet e shpartallohet çdo agresor.

Partia dhe populli ynë nuk janë frikësuar kurrë nga kërcënimet, ashtu siç nuk janë mashtruar nga lajkat e demagogjitë pacifiste. Armiqtë nuk do ta zënë kurrë në befasi popullin tonë. Ai është i përgatitur në mënyrë të gjithanshme, politikisht dhe ushtarakisht, ekonomikisht dhe organizativisht, për t'i bërë ballë çdo të papriture dhe t'i japë grushtin dërrmues kujtdo që



do të guxonte të prekte, sadopak, kufijtë e shenjtë të atdheut, fitoret e revolucionit e të socializmit.

Partia, populli dhe ushtria te ne janë një e të pandarë. Ushtria jonë është e fuqishme dhe e pathyeshme, pasi ajo është e lidhur si mishi me kockën me Partinë dhe me popullin, pasi mbron e zbaton me besnikëri vijën e Partisë, pasi është kurdoherë e gatshme që, për çështjen e Partisë, të popullit dhe të atdheut, të bëjë edhe sakrificën më të lartë.

Shokë dhe shoqe,

Politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë është politikë e një vendi socialist, ku në fuqi është diktatura e proletariatit, që udhëhiqet nga Partia e Punës, e cila frymëzohet dhe i qëndron besnike doktrinës së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Republika Popullore e Shqipërisë ka mendimet e saj dhe politikën e vet konstruktive e zhvillon hapur, në dritën e diellit. Për të asnjë çështje nuk është e huaj dhe ajo askënd nuk lejon që t'i mbyllë gojën. Çdo shtet, çdo popull ka të drejtën e vet t'i shfaqë lirisht mendimet e tij, të kundërshtojë ato të të tjerëve me të cilat nuk është dakord, ashtu sikurse të tjerët kanë të drejtën t'i kundërshtojnë të tijat kur nuk i aprovojnë. Është krejt e gabuar të rrish duarlidhur e gojëmbullur kur të tjerë veprojnë në dëm të popujve dhe të shteteve, ose të pranosh, siç mund të dëshirojë ndokush, se, meqë je një shtet ose një popull i vogël, është pretenciozitet i madh të thuash fjalën tënde, të mbrosh të drejtën tënde dhe të shokut, ose të dalësh me pikëpamjen tënde përpara «të mëdhenjve».

Modestia false dhe shpirti oportunist prej skllavi janë të huaja për politikën e shtetit shqiptar dhe të diktaturës së proletariatit.

Të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, janë fuqi imperialiste agresore. Ato po e ndajnë botën në sfera të influencës dhe po procedojnë në ndarjen dhe në zaptimin e tregjeve botërore. Qëllimi i tyre i fundit është të dominojnë tërë botën, popujt dhe shtetet. Këtë lindin kontradiktat e papajtueshme midis tyre që mund të çojnë në një luftë tjetër të madhe botërore. Hegjemonizmi i tyre, armatimi i tyre i pafrenueshëm, nuk zhvillohen aspak në qetësi, por me turbullira të mëdha, nga të cilat zien bota jonë.

Të dyja superfuqitë sot ndodhen në një krizë të madhe ekonomike, kulturore e shpirtërore. Regjimet dhe ideologjitë e tyre i ka mbuluar korrupsioni. Askush nuk u beson më, por këto, me forcë e me demagogji, u imponohen kapitalistëve të tjerë, të cilët janë të pleksur kokë e këmbë në rrjetat e merimangave të të dyja superfuqive imperialiste dhe zor se mund të çlirohen nga zgjedha po nuk u ngrit në këmbë vetë populli. Natyrisht, pasojat e tmerrshme të krizave, të dyja fuqitë imperialiste dhe ata që janë zënë në rrjetat që kanë përgatitur ato, kërkojnë t'uua ngarkojnë punonjësit të vendeve të tyre. Këtë dalin konfliktet shtet me shtet dhe qeveritarë me popull. Por populli, që i heq vuajtjet, nuk mund të presë shpëtim nga të tjerët. Vetën ai mund ta shpëtojë vetë, pasi udhëheqësit kapitalisto-revizionistë, kur është puna për t'u mbrojtur nga revolucioni popullor, janë solidarë me njëri-tjetrin.

Kapitalistët, kur e shohin se e kanë të humbur da-

vanë, atëherë i hedhin maskat në përrua dhe vendosin diktaturën fashiste. Këtë janë duke e bërë tani disa shtete, kurse disa të tjera e kanë bërë me kohë. Parulla dhe demagogji ka boll, por njerëzve «shihu punën dhe jo gunën».

Të dyja superfuqitë janë armatosur deri në dhëmbë për veten e tyre, kurse të tjerëve u bëjnë propagandë që të çarmatosen. Nga ana tjetër, ato janë bërë tregtaret më të mëdha të armëve. Kjo duket si kontradiktore, por nuk është ashtu. Armë ato vërtet u shesin të tjerëve, por armët moderne i mbajnë për vete, ruajnë kurdoherë proporcionet dhe epërsinë. Bile armë u japin vetëm atyre që mendojnë se i kanë të sigurt e të tyret. Këtë ato e shfrytëzojnë, nga njëra anë, për t'u thithur gjakun e për t'u grabitur pasuritë, duke u hequr si miq e duke u futur brenda në vathët e tyre, ku bëhen zotër dhe, nga ana tjetër, për t'i nxitur që të luftojnë me fqinjët.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik nxitin kudo grindjet, ringjallin mosmarrëveshjet e vjetra shekullore, përpiqen të dobësojnë rezistencën që mund t'u bëhet atyre. Ndërkaq, në interes të tyre krijojnë konflikte dhe këto i shoqërojnë gjoja me mbrojtje të njërit ose të tjetrit, duke i rënë gjoksit me «be e rrufe», duke kërkuar mbledhjen e Këshillit të Sigurimit me një tamtam të madh, derisa çdo gjë mbaron si fluskë sapuni.

«Paqja» u vendos në Vietnam, por atje lufta vazhdon. Mbaroi gjoja Vietnami, por filloi lufta në Lindjen e Mesme. U bë gjoja paqja edhe këtu, por lufta vazhdon në shumë mënyra. Mbaroi gjoja lufta arabo-izraelite, por filloi çështja e Qipros. Vazhdon procesi që

thamë më sipër. Kush i kurdis të gjitha këto konflikte? Të dyja superfuqitë imperialiste, sovjetike dhe amerikane, që luajnë me fatet e popujve të botës.

Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës vanë në kozmos dhe po lëshojnë satelitë të panumërt. Njerëz dhe shtete përsëritin se këto shpikje i «përkasin njerëzimit, se bëhen për të mirën e tij». Në vetvete ato janë me të vërtetë shpikje kolosale, por vallë në dorë të kujt janë? Kush i gëzon dhe për ç'qëllime i përdor? Shfrytëzohen ato në të mirën e njerëzimit apo vihen në përdorim për t'u spiunuar popuj dhe shtete nga këto dy superfuqi? Mos vallë u pakësua rreziku i luftërave agresive? Aspak! Mos po zhduken në botë uria dhe mjerimi? Përkundrazi, këto më keq po shtohen! A u përmirësua jeta e të varfërve dhe a u likuidua forca e të pasurve? E kundërta po ngjet. Të këndosh «sukseset e njerëzimit», do të thotë të bëhesh tellall i superfuqive kapitaliste e revizioniste.

Ku qëndron sigurimi i popujve të Evropës ose i popujve të botës? Në udhëtimet e hapëta dhe misterioze të njëfarë Kisingeri, të njëfarë Gromikoje, apo në dallaveret e një Brezhnjevi, që gjakos popullin sovjetik dhe të tjerë, në udhëtimet e një Niksoni, që mbyllet botën në gjak dhe udhëheq Mafian amerikane në skandalin më të turpshëm të Uotergeitit, që tronditi gjithë Amerikën? Këtyre t'u lihet të sigurojnë të ardhmen e botës? E ardhme e bukur do të jetë!

Natyrisht, ata që u besojnë iluzionistëve tragjikë janë të lirë të venë në mbledhjet e Vjenës, të Hel-sinkit dhe ku të duan. Le të bëjnë pallavra me njëri-tjetrin. Por edhe ne jemi të lirë të mos vemi në ato mbledhje dhe nuk vemi. Në ato mbledhje dhe konfe-

renca mungojmë jo vetëm ne, por edhe popujt. Kjo ka rëndësi për ne. Mirëpo ndokush thotë: Ç'na propozojnë shqiptarët, si të bëjmë? Shqiptarët çdo ditë e thonë mendimin e tyre; kush do ta dëgjojë, e ka të qartë. Shqiptarët thonë: Çdo gjellë ku përzihet helmi, nuk mund të hahet, sepse të vdes, ajo duhet shqelmuar e derdhur. Ka disa që thonë: Po ç't'u bëjmë amerikanëve dhe sovjetikëve, ata janë të fuqishëm — t'i lëmë jashtë derës? Shqiptarët thonë: Jo vetëm t'i lëmë, por edhe t'i izolojmë dhe t'u veshim «këmishën e forcës». Kjo është një dëshirë, thonë ata, por realiteti është ndryshe. Kurse ne shqiptarët themi që këtë dëshirë ta kthejmë në realitet. Po iu nënshtrova diktatit sovjeto-amerikan, atëherë nuk shpëton dot nga zgjedha. Ne shqiptarët nuk e pranojmë as diktatin, as zgjedhën e tyre. Jemi të vendosur të luftojmë deri në fitore.

Disa, kur na dëgjojnë, buzëqeshin, ose kakarisen e thonë: «Ç'mendjemëdhenj këta shqiptarët, kanë pretendime të ndreqin botën!». Po kush janë këta që flasin kështu? Janë ata që duan të sundojnë botën dhe popujt, ata që nuk u pëlqen që popujt të ngrenë zërin kundër tyre, ata që janë mësuar të shohin nga lart dhe të komandojnë me plumb e me kërbaç. Dhe këta na hiqen si njerëzit më të thjeshtë të botës!

Ne u themi atyre se nuk jemi mendjemëdhenj, por jemi ushtarët e asaj armate të madhe e të fuqishme që po bën revolucionin, nga i cili ata tmerrohen dhe do të gjejnë vdekjen! Ky revolucion nuk është i «lepeve e i peqeve», i përluljes së kurrizit dhe i zvarritjes në plehra, por është goditja e fuqishme, është vazhdimi i Revolucionit të Madh të Tetorit, janë luftërat çli-

rimtare të popujve. Këtë ata e quajnë «pretencion e mendjemadhësi», pasi nuk u pëlqen, sepse u gërryen themelet dhe u shkatërron ndërtesën që kanë ngritur mbi kufomat e njerëzve.

E brejtur nga kontradiktat e saj të brendshme, e mbërthyer nga krizat e rënda e të gjithanshme, e vënë nën goditjet e vazhdueshme të forcave të revolucionit, të çlirimit kombëtar, të demokracisë e të progresit shoqëror, bota kapitalisto-revizioniste ecën drejt një degjenerimi e dekompozimi gjithnjë e më të madh.

Borgjezia përpiqet të frenojë krizën e tanishme dhe të shpëtojë nga katastrofa duke ua hedhur barrën e saj klasës punëtore e masave punonjëse dhe të ruajë të paprekshme fitimet e saj. Kjo vijë nuk mund të mos shkaktojë revoltën e proletariatit dhe të të gjithë atyre që shtypen e që shfrytëzohen nga kapitali.

Masat punonjëse, forcat e tyre më të ndërgjegjshme, me siguri që do të ngrihen në këmbë për të mbrojtur interesat e tyre jetikë dhe këtë situatë krize ta kthejnë në një situatë të favorshme për ta çuar përpara çështjen e revolucionit.

Revolucioni, lufta për pavarësi politike dhe ekonomike, përbëjnë një proces të pandalshëm historik. Kushtet e sotme të zhvillimit shoqëror të botës i shtyjnë ato përpara me një forcë gjithnjë e më të madhe dhe i bëjnë të domosdoshme. Kjo përbën edhe një garanci të sigurt për fitoren e tyre.

Politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë mbron interesat e vendit tonë në arenën ndërkombëtare, mbron e lufton tok me vendet socialiste dhe me ato demokratike përparimtare për lirinë, për përparimin dhe për demokracinë e vërtetë në të gjithë

botën, për lirinë e njerëzve të punës dhe të mendjes.

Republika Popullore e Shqipërisë lufton imperia-  
lizmin amerikan, socialimperializmin sovjetik, imperia-  
listët e tjerë dhe gjithë reaksionin botëror, që janë  
shkaktarët e fatkeqësive të njerëzimit, shkaktarët e  
luftërave shtypëse e grabitëse, shkaktarët e grindjeve  
e të përçarjeve, të diversioneve e të kompleteve që  
ngjasin në globin tonë, shkaktarët e urisë dhe të mje-  
rimit në shkallë botërore. Shqipëria socialiste jep kon-  
tributin e vet modest në këtë luftë dhe në këto përpje-  
kje të mëdha të njerëzimit; ndihmë modeste, por që e  
jep haptazi, pa druajtje dhe pa frikë nga kurrkush.  
Dhe këta «kurrkush» mund të jenë të fortë, të fuqi-  
shëm, por fuqia e politikës së Republikës sonë Popu-  
llore qëndron në atë që ajo mbron çështjen e drejtë  
të saj, çështjen e shenjtë dhe të dashur të të gjithë  
popujve. Këtë çështje duhet të dish ta kërkosh, ta  
gjesh, ta bësh tënden dhe ta mbrosh me të gjitha forcat.  
Por ta mbrosh me të gjitha forcat, do të thotë të pra-  
nosh që më parë të gjitha sakrificat. Republika Po-  
pulllore e Shqipërisë këtë rrugë e ka zgjedhur në sajë  
të udhëheqjes së saj të lavdishme, Partisë së Punës,  
dhe nga kjo rrugë nuk është lëkundur dhe nuk do të  
lëkundet nga asnjë furtunë.

Politika e Partisë së Punës dhe e Republikës Po-  
pulllore të Shqipërisë është e hapur, e çiltër, i thotë  
të katër të vërtetat në fytyrë, pa marrë parasysh se  
njërit ose tjetrit nuk i pëlqejnë. Politika jonë përp-  
thet me interesat e popujve dhe jo të klikave dhe të  
ideologjive që i shtypin këta popuj. Ajo kërkon miqë-  
sinë e këtyre popujve dhe jo atë të shtypësve të tyre.  
Ajo nuk është politikë e koniunkturave, por politikë

e parimeve proletare, ajo nuk buron nga një diplomaci e fshehtë e kulisave, e tratativave misterioze, e shitjes në ankand të interesave të vendit të vet dhe të vendeve të tjera.

Politika e vendit tonë nuk është politika e shteteve me njëqind flamurë në xhep. Republika jonë Popullore nuk e ul flamurin e saj as përpara shantazhit e frikës dhe as përpara rublës e dollarit. Duhet ndjekur kjo politikë e drejtë parimore e burrërore, apo vallë ajo që t'u biesh në gjunjë, të zvarritesh barkazi përpara amerikano-sovjetikëve, të bëhesh një shtet putanë? E para duhet ndjekur, kurse tjetra duhet luftuar dhe demaskuar pa mëshirë.

E tillë është politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë, prandaj me ne janë me qindra e qindra milionë njerëz dhe Shqipëria është, nga ana e vet, me ata qindra e qindra milionë njerëz në unitet mendimi dhe veprimi.

Ne, njerëzit e Republikës Popullore të Shqipërisë, të një vendi të vogël në Ballkan, që ka vuajtur tërë jetën nga shkelës imperialistë e barbarë dhe që me luftë të armatosur fitoi lirinë dhe çdo gjë që gëzon sot, u bëjmë thirrje gjithë njerëzve të thjeshtë të botës: Kujdes! Imperializmi amerikan dhe imperializmi rus po e çojnë botën në një luftë tjetër botërore, më të tmerrshme nga të gjitha të tjerat! Këta të dy janë shkaktarë të krizave të sotme të mëdha, ata po rivalizojnë me njëri-tjetrin për hegjemoni botërore, po luftojnë për të pushtuar tregje, që do të thotë për të pushtuar dhe për të skllavëruar popuj. Janë pikërisht ata të dy që armatosin klika dhe qeveri antipopullore, për t'i pasur si xhandarë dhe mish për top për kasap-



hanën e pashmangshme që po përgatitin po t'i lëmë të veprojnë.

Shihni ç'po ngjet në botë! Shtypen popujt e Bashkimit Sovjetik dhe po pompohen ata me një nacionalizëm agresiv; shtypen popujt e vendeve pseudo-socialiste të Evropës dhe klikat që sundojnë në to ua nënshtrajnë interesat e popujve të tyre Bashkimit Sovjetik dhe Traktatit të Varshavës. Kremli i shtyp dhe i kërcënon ata: «O do të bëni kështu si dua unë dhe si ju urdhëroj unë, ose ju pushtova dhe ju shtypa, siç bëra me Çekoslllovakinë». Kështu veproi Hitleri. Ky e nisi më parë me Austrinë, pastaj me Çekoslllovakinë dhe vazhdoi me të tjerët. Kështu e filloi edhe socialimperializmi sovjetik dhe kështu do ta mbarojë. Siç e filloi dhe e mbaroi Hasha, ashtu e filloi dhe do ta mbarojë Husaku, ashtu edhe Bek-Giereku, Zhivko-Fillovi dhe të tjerë.

Imperializmi amerikan po i shtrydh nën «thundrën e gjakosur» popujt. Ai i ka mbytur «aleatët» e tij duke u përpyetur me çdo kusht t'i mbajë këta nën kërcënimin e vazhdueshëm të krizës ekonomike, të bombës atomike, të rrezikut sovjetik, të intrigave dhe të diversionit. Ai përpiqet të ruajë aleancën e Atlantikut, të nxitë brenda në të rivalitete, kurdoherë në favorin e tij, të krijojë pasiguri në vendet dhe në qeveritë e të ashtuquajturve aleatë të tij.

Shtetet e Bashkuara sulmojnë Vietnamin, Kamboxhian dhe, solidarë të dy, amerikanë dhe sovjetikë, ndërhyjnë në Pakistan e në Afganistan, shkaktojnë luftëra në Lindjen e Mesme, kurdisin tragjedinë e Kilit dhe të Qipros.

Të gjithë janë në ankth. Ku do të godasin nesër?

Bota është mbushur tani plot zhurmë e parulla, që përhapen nga agjentë provokatorë, nga kalemxhinj të shitur, nga diplomatë sallonesh e klubesh, që janë të gjithë mbjellës të mjegullës, të shantazhit dhe të frikës në shërbim të të dyja superfuqive: «Nesër, thonë ata, i vjen radha Jugosllavisë. Ç'do të bëhet pas Titos? Jo Jugosllavia do të hyjë nën sferën e sovjetikëve, jo në atë të amerikanëve; jo Rumania është një kafshatë e sovjetikëve, jo Shqipëria nuk mund të mbetet pa u sulmuar. Greqia me kë do të bëhet tani që doli nga NATO-ja?» etj., etj.

Të gjitha këto thënie shprehin dëshirat dhe planet e të dyja superfuqive; këto janë jo vetëm përgatitje psikologjike demoralizuese, por edhe përgatitje efektive ushtarake për të dobësuar qëndresën e popujve dhe për t'i mbytur pastaj këta në gjak.

Psikoza e luftës dhe e frikës ushqehet nga të dyja superfuqitë. Këto psikoza kërcënuese trumbetojnë si shpëtim dy ombrella, njëra amerikane, tjetra sovjetike. Sipas tyre, në qoftë se dëshiron të shpëtosh, zgjidh e merr. «Mos mendo më me kokën tënde, vullneti dhe liria jote janë të lidhura me këto dy kuçedra». Mbi të gjitha këto psikoza shantazhi, frikësimi e terrori mbretëron një tym i madh mbledhjesh, kontaktesh, bisedimesh, komisionesh bilaterale e multilaterale. Çdo gjë diskutohet, por asgjë nuk zgjidhet; dhe kur diçka vendoset, asgjë nuk është e sigurt. Edhe ai i pakti «moral borgjez» i akteve diplomatike të kohëve të kaluara është kthyer sot në një ndyrësi dhe kalbëzim të llahtarshëm. Në politikën e superfuqive dhe të aleatëve të tyre mbretërojnë degjenerimi, falsiteti, mashtrimi.

A duhet të rrinë popujt duarlidhur përpara kësaj katastrofe që po i përgatitin njerëzimit këto klika kriminelësh? Sigurisht që jo. Ç'duhet bërë atëherë? Ne themi se duhet luftuar. Por si duhet luftuar? Me mesazhe, me telegrame urimi dhe përgëzimi për ata që kërkojnë të të bëjnë varrin? Të mos flasësh publikisht veçse lëvdata për revizionistët sovjetikë, që kërkojnë të të groposin e të të gëlltitin, t'u hedhësh lule xhelatëve imperialistë amerikanë, të kërkosh dhe të pranosh kredi skllavëruese nga të dyja superfuqitë dhe pastaj të pretendosh se po lufton kundër tyre? Jo, këtë gënjeshtër, këtë demagogji, nuk e ha kush! Që të bësh një politikë të drejtë, realiste, ndaj vendit tënd dhe ndaj vendeve të tjera, duhet të jesh i çliruar nga kompleksët që kanë krijuar dhe krijojnë superfuqitë imperialiste dhe agjentët e tyre.

Këto fuqi të errësirës na akuzojnë ne, shqiptarët, se vetizolohemi. Po nga kush izolohemi ne dhe ç'kuptojnë ato me izolimin tonë? Pastaj, ç'na këshillojnë të bëjmë? Ato na këshillojnë që të mos izolohemi nga imperialistët e revizionistët, të marrim kredi prej tyre dhe të bëjmë ortakë në vendin tonë ata që vazhdimisht na kanë shtypur dhe na kanë pirë gjakun. Ato na këshillojnë ta bëjmë vendin tonë han me dy porta, ku të hyjnë derri e dosa, me brekë e pa brekë e leshrat përmbi supë dhe hipitë të hedhin vallet e tyre për të zëvendësuar vallet e bukura të popullit tonë. Ata përpiqen të korruptojnë njerëzit tanë, të vijnë të futin kudo te ne hundët prej spiuni, të organizojnë puçë dhe komplete, të pushtojnë pikat strategjike të vendit, të krijojnë baza ushtarake, ta bëjnë vendin tonë koloni të të huajve dhe ta kthejnë popu-

llin e lirë në një skllav. Po nuk i bëre këto, thonë ata, atëherë ke izoluar veten nga kjo botë «kaq e mrekullueshme, nga ky qytetërim kaq i mahnitshëm». Po ua dhe këto koncesione këtyre kuçedrave, ato të lejojnë edhe t'i shash, të quhesh «komunist», të hiqesh edhe si «marksist-leninist». Por të gjitha këto janë blofe, sepse ato të kanë zënë prej gryke dhe ti s'lëviz dot, ti je skllav, je agjent i tyre, ti ke shitur vendin dhe popullin tënd.

Të tillë skllavë ato duan që të bëhemi edhe ne, përndryshe ne s'quhemi «të qytetëruar», nuk quhemi «të modës». Këtë modë jetese dhe mendimi ne e hedhim poshtë me neveritje dhe asnjë shpresë të mos kenë se do të ngjasë ndryshe. Garantë të sigurt për këtë janë populli ynë i lavdishëm dhe Partia heroike e Punës, të dy në unitet të plotë mendimi dhe veprimi.

Njerëz të poshtër, armiq, agjentë të të huajve kanë dalë herë pas here me qëllim që ta pengonin ndërtimin e socializmit, mbrojtjen e shkëlqyer dhe të çelikut të vendit tonë, por ata janë spastruar dhe janë asgjësuar menjëherë, me të nxjerrë majën e veshit. Lufta e klasave, që me kaq sukses, me vendosmëri dhe me vigjilencë zhvillojnë Partia dhe populli ynë, i zbulon dhe i dërrmon pa asnjë mëshirë këto kalbësira të shoqërisë sonë.

Kur fshesa e hekurt i spastron këta nga radhët tona, armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm ngrenë veshët, pëshpëritin me frikë ndonjë parullë: «Vanë, u përçanë, u ka hyrë krimbi» etj. Po ç'thonë, vallë, Partia dhe populli? «Kokës t'u biem, se njëqind mijë herë më të fortë bëhemi». Parullat e armiqve nuk janë veçse kuja e disfatës së tyre. As habiten, as hutohen,

as frikësohen populli dhe Partia jonë nga të tilla parulla, ata janë mësuar me to. Populli dhe Qeveria jo vetëm që i njohin këta njerëz që lëshojnë helm kur armiqtë kanë ngrënë grushte dërrmuese, por dinë t'u administrojnë këtyre edhe ilaçet e përshtatshme. Dhe kjo e forcon akoma më shumë situatën tonë, pasi planet djallëzore të armiqve, të jashtëm e të brendshëm, dhe njerëzit e këtyre planeve dështojnë dhe kapen me presh në dorë. Këtu qëndron forca e diktaturës së proletariatit, forca e vendit tonë socialist, forca e ideve marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Po çirren Kremli revizionist dhe zagarët e tij duke thënë se «duam lidhje, duam marrëdhënie diplomatike, duam miqësi me popullin shqiptar, me atë popull që e duam shumë». Be e rrufe bëjnë ujtit e veshur me lëkurë qengji që duan të na përqafojnë për të na mbytur më mirë, që të na puthin tri herë sipas zakonit të kishës ruse, për të na dërguar te Krishti. Por ne u themi këtyre armiqve të socializmit e të leninizmit, armiqve të betuar të popullit tonë dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë se ne kurrë nuk do të pajtohemi me ta, kurrë nuk do të jemi miq me ta, por armiq do të jemi kurdoherë! Ata të mos mendojnë se këto janë mendimet e disa udhëheqësve shqiptarë, që sot rrojnë dhe nesër do të vdesin. Jo! Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të vdesin kurrë! Ne jemi ushtarët e tyre, jemi miliona dhe kemi një mendim të vetëm, një qëndrim të vetëm të palëkundshëm. As topi, as raketat, as avionët, as bomba juaj atomike nuk na tunden as sot, as mot.

Partinë dhe popullin tonë nuk i gënjen dot më demagogjia e Radio Moskës, që çdo natë lëshon me

nostalgji lot krokodili për miqësinë e vjetër shqiptaro-sovjetike. Ajo ka qenë miqësia jonë në kohën e Stalinit të madh. Këtë miqësi as e kemi fshehur dhe as e fshehim kurrë, por atë e shkelën pikërisht ata që tradhtuan çështjen e marksizëm-leninizmit, të bolshevizmit, që tradhtuan idetë e Leninit dhe të Stalinit, që tradhtuan internacionalizmin proletar dhe miqësinë me popullin shqiptar. Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli ynë me ta s'do të kenë kurrë paqe, por luftë dhe, për ta fituar këtë luftë, ne jemi të përgatitur dhe me siguri, në mos sot, nesër do të fitojmë mbi ta.

Ata duhet të dinë edhe një gjë. Dhe kur them këtë, flas në emër të popullit shqiptar dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë. Ne nuk ua kemi frikën as atyre, as armëve të tyre. Ne u themi tradhtarëve të Kremllit dhe zagarëve të tyre se dimë të bëjmë dallim ndërmjet popullit sovjetik dhe krerëve revizionistë, por ne nuk bëjmë dhe nuk do të bëjmë asnjë dallim midis këtyre krerëve dhe atyre që i ndjekin këta. Të gjithë tradhtarët ne i futim në një thes. Me Shqipërinë socialiste dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë nuk mund të veprohet dot si me Pragën dhe me partinë e Dubčekut.

Me megalomaninë dhe me prepotencën e një shteti të madh fashist sundimtarët e Kremllit, duke vrenjtur vetullat e trasha prej komediani, mund të thonë: «Ku e gjejnë këtë forcë këta picirrukë që t'i qëndrojnë përballë Bashkimit Sovjetik?». Përgjigjen doni? Merrni Marks, Engelsin dhe Leninin (sepse Stalinin ju e keni akuzuar), i lexoni ata për një minutë drejt (sepse ju i lexoni së prapthi) dhe atje do të gjeni përgjigjen e saktë se ku e ka burimin forca jonë. A jeni da-

kord, zgjedhës të mi, me këtë përgjigje që po u japim këtyre tradhtarëve armiq? (*Salla buçiti nga një «po» e fuqishme dhe nga duartrokitje e ovacione.*)

Revizionistët sovjetikë, si në kohën kur rronte Hrushovi, ashtu edhe tani, me Brezhnjevin, ndjekin të njëjtat qëllime, përdorin të njëjtën taktikë dhe mbajnë të njëjlin pozicion propagandistik. Duke ndjekur rrugën e tradhtisë hrushoviane, Partia Komuniste revizioniste e Bashkimit Sovjetik po organizon tani një mbledhje të partive revizioniste të Evropës<sup>1</sup>, me qëllim që t'u imponojë pikëpamjet e saj, t'i mbajë në zap dhe të tregojë se gjoja nuk është e izoluar, se ajo është «qendra e komunizmit botëror». Partitë e tjera që do të marrin pjesë në këtë mbledhje, do të provojnë se janë në rrugën e tradhtisë, ato do të bëhen komplise të veprimtarisë keqbërëse e kundërrevolucionare të udhëheqësve revizionistë sovjetikë. Partia e Punës e Shqipërisë e dënon me ashpërsi një të tillë mbledhje komplotiste, por, nga ana tjetër, është një sukses që popujt dhe komunistët e botës do të shohin edhe një herë në këtë rast fytyrën e vërtetë të këtyre partive që po mblidhen për të komplotuar.

Krërët e Kremlinit dhe zagarët e tyre pretendojnë se janë marksizëm-leninizmi, se vendet e tyre janë socializmi. Kush bëhet me ta, e kungojnë si të tillë; kush është kundër tyre, jo vetëm që s'qenka marksist-

---

1. Kjo mbledhje, për shkak të kontradiktave të thella që ekzistonin midis partive revizioniste, u zvarrit për më tepër se 2 vjet. Ajo u mbajt në Berlin më 29-30 qershor 1970, mbas dy takimeve konsultative dhe gjashtë versioneve të dokumentit përfundimtar që u desh të bëheshin.

-leninist, por është edhe i lidhur, i shitur e në shërbim të imperializmit amerikan. Me fjalë të tjera, ata thonë: «O me ne, o me ata». Po të jesh si kundër imperializmit amerikan, ashtu edhe kundër socialimperializmit sovjetik, për ta është e papranueshme.

Hrushovi na akuzoi ne, shqiptarët, si të shitur tek imperializmi. Por kush u shit, ne apo ai? Brezhnjevi, meqë nuk i jemi nënshtuar, na akuzon se bëjmë lojën e amerikanëve, kurse ai vetë dhe pasuesit e tij janë miq dhe bashkëpunëtorë të ngushtë të amerikanëve, ata puthen e flenë çdo ditë me amerikanët, kurse ne, që jemi në luftë dhe në thikë e në pikë me ta, na akuzojnë. Këto gënjeshtër prej tradhtarësh nuk i beson njeri, pasi njerëzit e ndershëm dhe me tru në kokë janë në gjendje të kuptojnë politikën dhe qëndrimet e Republikës sonë Popullore dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, ta shohin në zbatim dhe në zhvillim këtë politikë. Këtu, te këta njerëz mbështetemi ne dhe i falënderojmë për gjykimet e drejta mbi politikën tonë. Dhe të tillë janë shumica dërrmuese, komunistë dhe jekomunistë, njerëz me mendime të ndryshme politike, ndër të cilët edhe nga ata që mund të mos jenë dakord me rrugën tonë.

Por ka edhe nga ata që u besojnë shpifjeve të renegatëve imperialistë të Kremlinit. Çfarë të bëjmë? Ekzistojnë edhe të tillë. Të tillë njerëz kishte edhe Hitleri, si brenda edhe jashtë Gjermanisë. Me demagogji dhe me terror ai edhe popullin gjerman e vuri në rresht. Ja, kjo ngjet sot në Bashkimin Sovjetik.

Por Shqipëria është vallë një vend i izoluar, siç trumbetojnë armiqtë tanë? Aspak! Shqipërinë socialiste e njeh e gjithë bota, e vizitojnë njerëz të panu-



mërt, miq të saj nga të gjitha vendet. Me 65 vende<sup>1</sup> ne kemi marrëdhënie diplomatike, tregtare, kulturore. Politika e hapur dhe besnike e Republikës Popullore të Shqipërisë me miqtë dhe me dashamirësit respektohet, ashtu siç respektohen arti dhe kultura e popullit tonë, sikurse çmohen drejt dhe pozitivisht përpazimet e gjithanshme të vendit tonë.

Vallë mos jemi ne të izoluar pse s'kemi lidhje diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Është e vërtetë se në senatin amerikan as Trumani, as Niksoni, as Fordi nuk kanë folur për lidhje diplomatike me Shqipërinë, ose për «dashurinë e zjarrtë» që ata paskan për Shqipërinë, siç po bëjnë hipokritët e Moskës. Por herë pas here Departamenti i Shtetit lëshon nga një «tullumbace» në erë dhe pret përgjigje. Çdo ditë po i japim përgjigje ne imperializmit amerikan.

Pas Luftës së Dytë Botërore, kur luftuam së toku kundër Hitlerit, Shqipëria shfaqti dëshirën të vendoste marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por këto nuk denjuan të lidhnin marrëdhënie me një qeveri të malit, donin që në Shqipëri të vendosej një qeveri e salloneve dhe e koka-kolës. Mirëpo ja që populli shqiptar s'e bëri qejfin qeder, ai u ngroh dhe lulëzoi në pjesën e diellit që i takon, dashkëshin a nuk dashkëshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ato nuk deshën të lidhnin atëherë marrëdhënie diplomatike me ne, tani nuk duam ne të lidhim

---

1. Deri në vitin 1966 RPSSH kishte marrëdhënie diplomatike me 104 shtete.

të tilla marrëdhënie me to. Shumë njerëz mund të thonë se iu prish puna Shteteve të Bashkuara të Amerikës pse nuk duam ne të lidhim marrëdhënie diplomatike me to. Kjo është e vërtetë. Por është po aq e vërtetë se edhe neve s'na priset puna.

Qeveria angleze, që ka po ato pozita të qeverisë amerikane ndaj nesh, lëshon edhe ajo herë pas here nga një «tullumbace» për lidhje diplomatike, por ne i themi: Para se të hidhni të tilla tullumbace, zhblloni arin që i keni grabitur popullit shqiptar dhe, tok me interesat e tij, ia dërgoni Shqipërisë. Kështu i themi ne edhe qeverisë së Bonit, që bën një politikë revanshiste dhe që Shqipërisë i ka borxh si detyrime për dëmshpërblimet e luftës shuma që arrijnë në miliarda marka.

Mos vallë presin që ne t'u bëjmë temena e t'u përulim kurrizin këtyre qeverive që na kanë bërë kaq të këqija, kaq padrejtësi? Jo, kurrë! Ato gabohen, gabohen, gjithashtu, të gjithë ata që na akuzojnë ne për kokëfortë.

Ne kemi simpati për popullin punonjës amerikan, anglez e gjerman, por jo për ata që marrin nëpërkëmbë të drejtat, liritë dhe sovranitetin e popujve. Ne i luftojmë ato qeveri dhe ata njerëz që kanë ide skllavëruese. Ne kemi shumë miq e dashamirës në Francë, në Belgjikë, në vendet nordike e skandinave dhe në shumë vende të tjera të botës. Ne i respektojmë dhe ata na respektojnë, pavarësisht se regjimet dhe ideologjitë tona janë të ndryshme.

Ne respektojmë ata popuj dhe ato qeveri që nuk u përulën diktateve dhe dëshirave të të dyja superfuqive, që bëjnë një politikë të pavarur dhe sovranë. Da-

shamirësit e Republikës Popullore të Shqipërisë e respektojnë politikën tonë, pavarësisht se mund të mos jenë dakord në të gjitha çështjet, por ata e kuptojnë se siç kanë të drejtë vetë të bëjnë politikën e tyre, edhe ne kemi po aq të drejtë të bëjmë tonën. Njerëz të shquar kanë dalë në të kaluarën nga gjiri i këtyre popujve dhe kanë folur e kanë shkruar me simpati për popullin shqiptar. Edhe tani, në kohën e re, punëtorë, profesorë, doktorë, filozofë, diplomatë e gazetarë me zë kanë folur dhe flasin e shkruajnë me simpati për popullin tonë të vogël e trim, që asnjëherë nuk i ka rënë kujt në qafë.

Me popujt fqinjë jugosllavë dhe grek ne jemi miq. Fuqitë imperialiste dhe agjenturat e tyre kanë pasë futur fitilat dhe detonatorët për të na vënë në grindje me njëri-tjetrin. Por neve, popujve të Ballkanit, këto na janë bërë mësim dhe, përpara rrezikut të përbashkët, edhe pse mund të mos jemi dakord për shumë gjëra, kemi gjetur dhe mund ta gjejmë fjalën. Faktet historike nuk mund të shlyhen. Kur është sulmuar njëri, është sulmuar edhe tjetri nga i njëjti armik. Të njëjtët armiq kanë nxitur njërin ose tjetrin për të dobësuar të tretin. Fitolin e fuçisë së barutit e mbanin armiqtë e popujve tanë dhe klikat e shitura tek ata.

Popujt shqiptar, jugosllavë e grek kurrë nuk i ka gjunjësuar armiku i jashtëm. Këta popuj nuk kanë shpirt prej skllavi dhe këtë ata e kanë treguar vazhdimisht gjatë historisë së tyre shekullore. Shqiptarët, jugosllavët dhe grekët nuk janë nga ata që e mbajnë kot koburen në brez, kur qofshin amerikanët, qofshin sovjetikët ose ndonjë tjetër do t'i sulmojnë dhe do të përpiqen t'u grabitin lirinë dhe sovranitetin. Prandaj

të dyja superfuqitë ose shtetet acroplanmbajtëse që ato i kanë në zap mund të shohin ëndrra me sy hapur, por as populli jugosllav, as ai grek e as ai shqiptar nuk do të lejojnë kurrë që t'i shkulin sovjeti, amerikani, fashisti italian a gjerman. Varri i tyre do të bëhet këtu, në vendet tona, po të futen në aventura të tilla.

Ne u kemi thënë dhe u themi popujve jugosllavë e grek se kufiri i Shqipërisë me ta do të jetë kurdoherë i qetë dhe armiku duhet më parë të ndeshet me ne shqiptarët, ai do të thyhet dhe zor se do të arrijë në kufijtë e tyre. Kemi besim se kështu do të ngjasë edhe nga ata kundrejt nesh.

Ne duam të rrojmë të lirë në vendet tona. Të mos mendojnë armiqtë se do ta kenë të lehtë punën me ne. Ne shqiptarët u duam të mirën popujve jugosllavë dhe grek. Ta zhvillojmë miqësinë në rrugën më të përshatshme për secilin, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit, dhe asgjë të mos lejojmë në territoret e vendeve tona që, për një arsye ose për një tjetër, mund të cenojë ose të kërcënojë interesat e fqinjësisë së mirë. Shqipëria, Jugosllavia dhe Greqia jo vetëm rrojnë pa Traktatin e Varshavës dhe të NATO-s, por ato rrojnë të lira dhe të pavarura. Ne përshëndetim përpjekjet e qeverisë greke për të dalë nga NATO-ja. Populli grek nuk lejoi të merret nëpër këmbë dhe kush mendon se sekretarë Departamenti të Uashingtonit e ministra të Jashtëm të Moskës mund të bëjnë dallavere dhe intriga mbi popullin grek, i bëjnë llogaritë gabim. Bota mban mend mirë se Greqia ka derdhur gjak në luftën për çlirim kur ka të tjerë që kanë dredhur zinxhirin.

Ne u themi fqinjve tanë: Në vendin tonë as ka, as

nuk do të ketë baza ushtarake të huaja, por ne dëshirojmë që edhe ata t'i largojnë bazat e huaja ushtarake nga vendet e tyre. Asnjë pretekst nuk mund të qëndrojë në këmbë kur u jepen leje flotave të të dyja superfuqive jo vetëm që të kenë baza të përhershme, por edhe të drejtë të ankorohen, të riparohen e të furnizohen. Kjo është shumë e rrezikshme si për vendin që i jep këto koncesione, por edhe për fqinjin. Me këto veprime nuk mund të jemi dakord me kërënd. Ne e kemi deklaruar qëndrimin tonë ndaj flotave agresive amerikane dhe sovjetike në Mesdhe dhe i qëndrojmë besnikë dhe konsekuentë kësaj politike.

Popullit bullgar ne i duam të mirën, kemi qenë dhe jemi miq me të, por kjo miqësi po errësohet jo për fajin tonë. Populli bullgar duhet të çelë sytë, sepse ata që ka mbi krye po e kthejnë Bullgarinë në një koloni të vërtetë të socialimperialistëve sovjetikë. Krrët e Moskës dhe agjencia e tyre bullgare, me Todor Zhivkovin në ballë, e kanë kthyer Bullgarinë në një plasdarm kundër vendeve tona. Popullin bullgar sovjetikët duan ta përdorin si mish për top kundër popujve tanë. Todor Zhivkovi dhe klika e tij në duart e sovjetikëve janë bërë provokatorë të rrezikshëm kundër Jugosllavisë, Shqipërisë, Greqisë, Turqisë etj. Ëndrrat e carëve të vjetër janë identifikuar me dëshirat e carëve të rinj ruso-bullgarë dhe Todor Zhivkovi, që ëndërron një Bullgari të madhe, nuk e thotë kot sloganin «në shekuj me Rusinë». Ne i themi popullit bullgar: miqësia është miqësi dhe ne i qëndrojmë besnikë miqësisë me popullin bullgar të të madhit Dimitrov, por kjo miqësi ka ligjet e veta. Në rast se populli bullgar lejon banditët në vendin e tij dhe që andej të na

sulmojnë, atëherë nuk ekziston më ajo miqësi e sinqertë dhe e pastër.

Edhe me popullin rumun ne kemi qenë dhe jemi miq dhe i duam Rumanisë të mirën. Ne jemi për një Rumani të lirë e sovranë dhe e sigurojmë se Republika Popullore e Shqipërisë do të jetë kurdoherë afër saj në luftën kundër socialimperialistëve sovjetikë që kërcënojnë orë e çast lirinë, sovranitetin dhe integritetin e saj tokësor. Karshi nesh, udhëheqësit rumunë kanë bërë faje dhe s'i kanë njohur kurrë këto faje. Natyrisht, ne e kemi thënë haplazi, kjo nuk është një gjë e mirë dhe nuk e forcon miqësinë si duhet. Agjencitë e huaja trumbetojnë se socialimperialistët sovjetikë po kërcënojnë orë e çast lirinë, sovranitetin dhe integritetin tokësor të Rumanisë. Nga ana tjetër, shtypi dhe radioja e Rumanisë s'lënë rast pa u hedhur lule, pa u bërë lavdërime xhelatëve, renegatëve, imperialistëve të Moskës. Kë të besojmë, kë të luftojmë, kë të mbrojmë dhe përse ta mbrojmë? Ne konstatojmë se Rumania e ka mirë me sovjetikët, ajo e ka mirë edhe me amerikanët, merr nga njëri, merr nga tjetri; fjalë të mira për njërin, fjalë të mira për tjetrin. Agjencitë e huaja thonë se sovjetikët përpiqen ta përpijnë, po amerikanët vallë mos duan ta lëpijnë?

Rumunët mund të thonë se kjo është taktika dhe strategjia e tyre, ju mos u përziëni në punën tonë. Jemi të detyruar të përziëmi, pse udhëheqja rumune po hiqet se bën një politikë të madhe botërore, ajo flet për të ardhmen e popujve të Ballkanit, ku për fat të keq të tyre bëjmë pjesë dhe ne, shqiptarët. Udhëheqja rumune, pa marrë as edhe mundimin të pyesë dhe Shqipërinë, bën thirrje që vendet e Ballkanit të mblidhen

duke u futur në vathë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe sovjetikët që të vendosim për paqen e për socializmin. E bukur paqe dhe i bukur socializëm!!

Sidoqoftë ne deklarojmë se jemi miq me popullin rumun, do ta kalitim vazhdimisht këtë miqësi, do ta mbrojmë vazhdimisht kauzën e drejtë të popullit vëlla rumun, por themi, gjithashtu, hapur se të quhesh komunist dhe t'i bësh vendit dhe socializmit një mbrojtje të tillë siç bën udhëheqja rumune, nuk pajtohet as me ideologjinë, as me strategjinë dhe me taktikën e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe as me karakterin e popullit shqiptar.

Ne kemi dëshirë të kemi marrëdhënie të mira e miqësi me Italinë. Por konstatojmë se tani atje po ngrenë krye fashistët, të cilët kanë shpërthyer një fushatë të gjerë krimesh, kërcënimesh dhe kërkujnë të ringjallin frymën e vjetër të aventurave musoliniane. Akte të terrorit fashist janë kryer edhe kundër ambasadës shqiptare në Romë, që është e paprekshme. Duhet dënuar e u duhet dhënë fund të gjitha atyre veprimeve që pengojnë zhvillimin normal të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis dy vendeve tona.

Një miqësi e ngushtë e vëllazërore e lidh popullin tonë me popullin heroik të Vietnamit. Vendi ynë ka përkrahur e përkrah me vendosmëri luftën e drejtë të popullit vietnamez për çlirimin e Vietnamit të Jugut, për mbrojtjen e Republikës Demokratike të Vietnamit dhe për ribashkimin e atdheut. Partia, Qeveria dhe i gjithë populli shqiptar dënojnë me forcë politikën agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Vietnam, të cilat vazhdojnë angazhimin e tyre ushtarak, nxitin administratën e Sajgonit të marrë nëpër këmbë

marrëveshjet e Parisit dhe e ndërsejnë atë në provokacione të rënda kundër popullit vietnamez. Ne shprehim besimin e patundur se populli vëlla i Vietnamit, me luftën e tij të vendosur, do të arrijë të gjitha aspiratat e veta kombëtare dhe çështja e tij e drejtë do të triumfojë plotësisht.

Ne përshëndetim fitoret historike që po arrin populli trim kamboxhian, nën udhëheqjen e Frontit të Bashkuar Kombëtar, në luftën kundër imperialistëve agresorë amerikanë dhe regjimit kukull të Lon Nolit. Jemi të bindur se fitorja përfundimtare e popullit kamboxhian kundër agresorëve të huaj dhe tradhtarëve të Pnom-Penit është e pashmangshme.

Midis vendit tonë dhe Republikës Popullore Demokratike të Koresë ekzistojnë marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimi, të cilat forcohen e zhvillohen vazhdimisht. Ne gëzohemi shumë për sukseset që arrin populli vëlla korean në ndërtimin e socializmit. Populli ynë përkrah qëndrimin e drejtë të partisë dhe të qeverisë së Republikës Popullore Demokratike të Koresë për largimin e trupave të huaja nga Koreja e Jugut dhe për ribashkimin e vendit.

Aktualisht Lindja e Mesme përbën një nga problemet që preokupojnë jo vetëm popujt e kësaj zone, por mbarë opinionin publik botëror. Si rezultat i përzierjes së superfuqive, paqja e vërtetë aty është mjaft larg për t'u vendosur. Në horizont nuk po duket ndonjë zgjidhje e shpejtë që do të përputhej me interesat e vërtetë sovranë të popujve arabë, që do t'u kthente atyre tërësisht tokat e grabitura dhe që do të rivendoste të drejtat e mohuara të palestinezëve.

Të ashtuquajturat plane të paqes, që fabrikohen



në kancelaritë e Moskës dhe të Uashingtonit, kanë për qëllim ta varrosin çështjen e vërtetë arabe. Çdo iniciativë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik ndërmarrin në Lindjen e Mesme, synon të forcojë pozitën imperialiste dhe të shtojë aty ndikimin e tyre.

Por një paqe e cinguar e antiarabe si ajo që Shtetet e Bashkuara e Bashkimi Sovjetik kërkojnë të imponojnë, nuk mund ta ketë jetën të gjatë. Katër luftërat e gjertanishme arabo-izraelite e kanë vërtetuar këtë. Ne jemi të bindur se popujt arabë, që kanë traditën të lashtë dhe një shpirt aq liridashës e përparimtar, do t'i dërrmojnë të gjitha intrigat e planet antiarabe të Izraelit e të superfuqive dhe, me forcat e tyre të bashkuara, do t'i arrijnë të gjithë objektivat e lartë kombëtarë.

Kohët e fundit flakët e luftës u ndezën edhe në Qipro. Një kërcënim i ri u krijua për paqen e sigurinë në Mesdheun Lindor e në Ballkan. Zhvillimi i ngjarjeve të deritanishme dëshmoi se tragjedia e re qipriote lindi në sfondin e rivalitetit sovjeto-amerikan, të atmosferës së intrigave e të kompleteve që të dyja superfuqitë, veç e veç ose së bashku, kurdisin kundër popujve. Imperialistët amerikanë kërkojnë të vendosen politikisht e ushtarakisht në ishull dhe socialimperialistët të peshkojnë në ujëra të turbullta. Ata po përfitojnë nga situata për të ringjallur armiqtë e vjetra turko-greke dhe për të krijuar një gjendje që do të lehtësonte ekspansionin, ose do të justifikonte ndërhyrjen e tyre.

Problemet e Qipros janë të shumta dhe, sigurisht, aspak të lehta për t'u zgjidhur. Por ne mendojmë se populli qipriot, grek dhe turk, është në gjendje dhe i

ka mundësitë të vendosë vetë për fatet e tij, i lirë nga presionet e jashtme dhe në bazë të interesave të tij sovranë. Qiproja është një shtet i pavarur e sovran, anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe i njohur nga shumica e shteteve të botës. I tillë ai duhet të mbejet dhe askush nuk ka të drejtë ta sulmojë atë, nën çfarëdo preteksti qoftë, të përzihet në punët e tij të brendshme dhe t'i imponojë zgjidhje që nuk përputhen me vullnetin e shprehur lirisht nga populli qipriot.

Këto situata, që nuk zhvillohen larg nesh, na imponojnë një rritje edhe më të madhe të vigjilencës revolucionare, një mobilizim edhe më të madh për të zhvilluar një luftë më të fortë e më të gjithanshme kundër të gjithë armiqtë dhe në të gjitha frontet.

Republika Popullore e Shqipërisë, ashtu si deri më sot, do të qëndrojë në ballë të luftës kundër imperia-lizmit, revizionizmit e reaksionit dhe do t'u japë përkrahjen e saj gjithë atyre popujve e vendeve që luftojnë për lirinë e pavarësinë kombëtare, për emancipimin dhe përparimin shoqëror.

Edhe në të ardhmen ne do të ndjekim atë politikë të jashtme që i ka siguruar vendit tonë pozita të shëndosha ndërkombëtare, miq të fuqishëm dhe dashamirës të shumtë, një emër të nderuar dhe një prestigj të lartë.

Shokë,

Duke përfunduar, më lejoni të shpreh sigurinë se masat tona punonjëse do ta mbajnë kurdoherë lart frymën revolucionare që ka karakterizuar kurdoherë popullin tonë, do t'i mobilizojnë të gjitha forcat për

t'i realizuar deri në fund detyrat e planit, do të luftojnë me vendosmëri kundër ndikimeve e ideologjive të huaja dhe do ta çojnë, si kurdoherë, përpara çështjen e madhe të ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Pjesëmarrja e të gjithëve në votime dhe votimi i të gjithëve për kandidatët e Frontit Demokratik do të jenë një fitore tjetër e shkëlqyer e popullit tonë në rrugën e tij triumfuese socialiste, një provë tjetër e lartë e pjekurisë politike dhe e bindjeve të thella ideologjike, një kontribut i shquar në forcimin dhe në konsolidimin e mëtejshëm të themeleve të çelikta të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Fronti Demokratik i Shqipërisë!

Rroftë e u forcoftë pushteti ynë popullor!

Rroftë Partia jonë e Punës, udhëheqësja e ndritur e të gjitha fitoreve tona, garancia e së ardhmes sonë të sigurt!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 233 (8156), 1 tetor 1974*

*Dotohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**USHTRIA JONË ËSHTE USHTRIA E PARTISË,  
ME NORMA, ME LIGJE DHE ME IDEOLOGJINË  
MARKSISTE-LENINISTE**

*Nga konkluzionet e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

10 tetor 1974

Shokë,

Tani dëshiroj të flas pak edhe unë. Jam plotësisht dakord me kritikën dhe me vërejtjet që bënë shokët e Byrosë Politike, të cilat kanë një vlerë shumë të madhe për Partinë...

Ne i dëgjuam autokritikat e kuadrove kryesorë të ushtrisë të ftuar në mbledhje dhe mendimi im është se ata, për të mos thënë fare, nuk u larguan shumë nga ato që kanë dhënë me shkrim. Prandaj nuk jam dakord me këto autokritika dhe veçanërisht me atë të Hito Çakos.

---

1. Kjo mbledhje e posaçme e Byrosë Politike u bë për sqarimin e mëtejshëm të veprimtarisë armiqësore në ushtri. Në mbledhje iu dha fjala të ftuarve: Hito Çakos, Sadik Bekteshit, Halim Ramohitos dhe Dilaver Poçit. Pasi diskutuan me radhë edhe të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Byrosë Politike, fjalën e mori shoku Enver Hoxha.

A janë autokritika të thella këto të tyre, a janë ato të sigërtë dhe të hapëta? Mendimi im është se jo! Po pse vallë ngjet kështu? Kjo është çështje konceptesh, konceptesh të paformuara marksiste-leniniste, kurse te këta persona është fjala për koncepte të shtrembra, të vetëquajtura marksiste-leniniste, por që nuk janë veçse revizioniste.

Këta janë komunistë, kanë bërë Luftën Nacionalçlirimtare, janë zgjedhur në Komitetin Qendror, janë emëruar në poste kryesore udhëheqëse në ushtri e megjithatë kanë bërë gabime kaq të rënda parimore!!

Po cilat janë këto gabime të rënda të tyre? Ja përmbledhtazi:

Për ta, në praktikë, ushtria konsiderohet si një vend i tyre, ku ata bëjnë ligjin, janë zotër dhe mund të vepronë si të duan. Sipas tyre ata mund të shkelin ligjet, urdhëresat, normat dhe asnjëri nuk ka të drejtë të ndërhyjë. Ata fshchin atje të vërtetën, heshtin për të metat, ata shtypin me prepotencën dhe me arrogancën e tyre në teori e në praktikë, nuk përfillin atje Partinë, nuk marrin parasysh dhe përbuzin mendimet, vërejtjet dhe kritikën e vartësve. Në fakt, ata nuk kanë konsideratë as për udhëheqjen kryesore të Partisë, përdorin parulla, formula e deri emrin e udhëheqjes së Partisë për të vepruar shtrembër e për të falsifikuar, për ta çuar në greminë punën e Partisë dhe për t'u imponuar Partisë dhe ushtrisë ligje dhe norma antiparti. Të gjitha këto që përmenda e të tjera janë vërtetuar, në një mënyrë ose në një tjetër, në punën e tyre.

Këta mund të thonë: «Si shumë na ngarkove shoku Enver!». Jo, jam shumë i moderuar, duhet të jem akoma më i ashpër.

Mos vallë ekzagjeroj ndonjë gjë kur them: Ngjanë të gjitha këto gjëra në ushtri? Po, ngjanë, këtë nuk mund ta mohoni. Atëherë, ju, si anëtarë të Komitetit Qendror, përse i lejuat të zhvilloheshin? Ju keni përgjegjësi të madhe dhe kryesore për këtë. Askush nga ju nuk mund të thotë se nuk i pa këto gjëra, në një mënyrë ose në një tjetër. Atëherë si komunistë, si revolucionarë, si njerëz me koncepte të drejta marksiste-leniniste që hiqeni, përse nuk u ngritët t'i vinit në vend këto ligësi? Ju nuk e bëtë këtë. Ndonjëri mund të thotë: «Këtë ose atë veprim e kam kundërshtuar, e kam kritikuar». Mirë, le ta besojmë për një çast, po ç'doli nga kjo? Ç'gjë frenoi nga e keqja ky kundërshtim yti i pretenduar? Mos vallë e keqja u ndalua? Jo, aspak, ajo u trash edhe ca më shumë!!

Ndonjë tjetër mund të thotë: «E po ja, u theva». Mirë, po pse u theve? Si të mëson Partia, të thyhesh apo të mos thyhesh?...

Urdhri im si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë është i qartë për sa i përket përdorimit të literaturës së huaj. Ju, që nga Hito Çakoja, Petrit Dumja, Sadik Bekteshi, ti, Ramohito, pse nuk e zbatuat atë direktivë, po e hodhët në shportë? Këtë quani ju zbatim të urdhërave të Partisë? Ju, në ushtri, këtë quani respekt për udhëheqjen e Partisë? Ja ç'rezultoi nga kjo shkelje flagrante juaja e kësaj direktive! Mund të na thoni, kush e ka përgjegjësinë për këtë? Mos ju rëndojmë ju kur ju bëjmë përgjegjës? Aspak! Jemi shumë të butë!

Kur ju gjenit kundërshtime në vijë ose në praktikën e punës nga njëri ose nga tjetri ushtarak, pse nuk i shtronit ato në Parti dhe kur organizatat-bazë ose

komiteti i Partisë në Ministrinë e Mbrojtjes nuk arrinin t'i vinin çështjet brenda normave, pse nuk u drejtuat në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror? Ju nuk mund të pretendoni se nuk i njihnit këto norma. Atëherë Partisë dhe udhëheqjes së saj, këto veprime antiparti, këto grindje ose zënka, përse ia fshehët? Përgjigjen jua thanë shokët, po jua them edhe unë: Ju nuk vepruat kështu, se keni pikëpamje revizioniste për Partinë, se ju ka mbuluar familjariteti, ju ka mbuluar megalomania. Ju e konsideronit veten se nuk kishit nevojë për ndihmën e Partisë, të komiteteve dhe të udhëheqjes së Partisë dhe mendonit se të palarat tuaja duhej t'i lanit në mes tuaj, duke i fshehur nga Partia.

Vallë të gjitha këto që vërtetohen me fakte në veprimtarinë tuaj koncepte marksiste-leniniste janë? A nuk është e qartë se ju ushtrinë e keni pasë konsideruar si një kala të mbyllur, si një vend ku ju mund të bënit si të donit, të silleshit si t'ju vinte për mirë, të shkelnit ligjet e normat dhe të vinit të reja, nga ato që juve ju vinin për shtat?

Ç'u thoni këtyre fakteve? Në realitet të gjitha këtyre pyetjeve ju u bëtë bisht. Po ç'përgjigje do t'i jepni Partisë dhe ushtrisë, kur të riktheheni, në analizat që do të bëhen? Këtë avaz të ndytë do të këndonit dhe atje? Jemi të sigurt se këtë herë diskutimet nuk do të jenë të buta, ndaj jush, siç kanë qenë deri tash, do të kërkohet llogari deri në një nga të gjithë ndaj gjithë atyre që kanë gabuar dhe kanë bërë fajë. Gojët tash do të hapen në Parti dhe në ushtri, pavarësisht kush janë ata që kanë gabuar ose që kanë bërë të këqija.

Në organizatat e Partisë në ushtri tash do të dërr-

mohet hierarkia e sëmurë, nuk do të ketë më grada e pozita, të gjithë do të jenë anëtarë të thjeshtë e me të drejta të barabarta. Për punën tuaj të përgatiteni, t'i jepni llogari Partisë deri në një, duke lënë mënjanë kontronot false, të jeni të sigjertë e të çiltër me të dhe të keni bindjen se Partia nuk do t'ju lëshojë lehtë nga kudhra e saj.

Ty, Hito Çako, kur hapa mbledhjen në fillim, unë të vura disa pyetje precize, shokët e Byrosë Politike të bënë, gjithashtu, pyetje me shumë rëndësi. Ti atyre u bëre bisht, jo se nuk dhe nga ndonjë përgjigje banale ose të rëndomtë, por nuk zbulove të vërtetën e gjërave, gënjeve pa pikë turpi.

**E para, ti nuk zbulove arsyeën e vërtetë: pse ia ke fshehur udhëheqjes së Partisë të vërtetën mbi punën e Beqir Ballukut? Sepse ti ke qenë dakord me Beqir Ballukun. Ky bënte punë armiqësore në anën ushtarake, ti bëje punë armiqësore antiparti në anën politiko-ideologjike. Të dyja këto veprimtari ishin të sinkronizuara, të koordinuara. Ishte një komplot dinak antisocialist. Qëllimi është i qartë, dobësimi dhe sabotimi i mbrojtjes së vendit. Ju përgatitnit terrenin për një invadim sovjetik. Këtu nuk bëj asnjë supozim. Vetë faktet e vërtetojnë këtë dhe faktet janë kryeneçe.**

E dyta, Hito Çako, rezulton se nuk është e vërtetë që ti të mos kesh pasur dijeni për çka bënte Beqir Balluku, jo vetëm në hartimin e antitezave, por edhe mbi gjithë veprimtarinë armiqësore dhe amorale të tij në ushtri. Për të gjitha këto ti jo vetëm ke heshtur, por edhe e ke përkrahur, e ke inkurajuar Beqir Ballukun, ke qenë dakord me të. Faktet këtë vërtetojnë.

**E treta, ti, Hito Çako, nuk kishe besim tek udhëhe-**



qja e Partisë, të Komiteti Qendror dhe të Sekretari i Parë i saj e Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë, për arsye se ti je revizionist, element antiparti, se ti ua fshehe deri në fund të vërtetën, pse me kohë po bëhej një punë e theksuar dhe sistematike armiqësore nga ti e nga Beqir Balluku dhe këtë veprimtari e mbajtët të fshehtë me të gjitha mjetet. Këto deduksione dalin nga faktet.

E katërta, ti, Hito Çako, kur e pe se Beqir Balluku po digjej, i vure atij pishën, që tymi të mbulonte gabimet dhe tradhtinë tënde. Ti na u hoqe si kundërshtar i rreptë i Beqir Ballukut, kurse ti ishe shok në komplot me të, ishe një mik i flaktë i revizionistëve sovjetikë. Kjo që po bëj nuk është literaturë, por deduksion logjik i mbështetur në fakte.

E pesta, ti, Hito Çako, je recidivist në hile dhe në rrugën tënde antiparti. Jo një herë ti ke vepruar kundër Partisë, kundër udhëheqjes së saj dhe kundër Sekretarit të saj të Parë. Kur u shqyrtua puna armiqësore antiparti e Tuk Jakovës, u zbulua se ky armik i Partisë, për gjithë veprimtarinë dhe qëllimet e tij antiparti, kishte biseduar me ty, Hito Çako. Dhe ti këto ia kishe mbajtur fshehur Partisë. Kur u detyrove t'ia thoshe asaj, se u zure keq, bëre atëherë njëfarë autokritike dhe more angazhim solemn se nuk do ta përsërisje kurrë një gabim të tillë. Partia të dha dorën, ti e pështyve dhe përsërite prapë të njëjtin gabim akoma më të rëndë e më të rrezikshëm. Këtë herë ti komplotove kundër Partisë, kundër udhëheqjes së saj, kundër ushtrisë. Këto janë fakte, asgjë nuk shtonet, asgjë nuk rëndohet.

Unë mund të zgjatesha më shumë mbi punën tënde antiparti, mbi karakterin tënd prej intriganti dhe arro-

ganti, mbi modestinë tënde false, mbi buzëqeshjet servile ndaj udhëheqësve kryesorë të Partisë dhe të shtetit, kurse, nga ana tjetër, bëje këto që ke bërë. Unë po përpiqem të jap këtu një përmbledhje dhe një plotësim përkrah atyre që thanë shokët, por do të kem rastin që këto t'i zhvilloj edhe më gjerë në një mbledhje që mund të bëj me kuadro të ushtrisë<sup>1</sup>. Mendoj, Hito Çako, se këto që u thanë në adresën tënde do të shërbejnë që t'i flasësh hapur Partisë dhe kuadrove të ushtrisë, pse vetëm kështu mund të shërohesh nga kjo sëmundje e rëndë.

Ti Petrit ke të meta shumë serioze dhe të dënueshme në pikëpamjet e tua politiko-ideologjike dhe në karakterin tënd, që të kanë bërë të gabosh shumë rëndë. E kemi për detyrë të flasim hapur, si komunistë, sepse vetëm në këtë mënyrë korrigjohen shokët që gabojnë, e për t'ia arritur këtij qëllimi bëjmë të gjitha përpjekjet. Na vjen keq për çdo shok që nuk korrigjohet.

Me ty, Petrit, Byroja Politike ka bërë shumë përpjekje në këtë drejtim. Ajo mjaft herë të ka vënë në dukje se në karakterin tënd ka shfaqje shumë të theksuara mendjemadhësie e këto të duken në punë dhe në jetë, jo ndaj nesh, anëtarëve të Byrosë Politike, por me shokët e tjerë e sidomos me ata të punës në ushtri, shfaqjet e mendjemadhësisë kanë qenë të vazhdueshme. Më e keqja është se arroganca dhe prepotenca jote në punë mbulohen shumë herë me një pamje «modestie rrogozi» që në vështrimin e parë të gabon. Por këto

---

1. Kjo mbledhje me kuadrot kryesorë të forcave të armatosura u zhvillua më 14 tetor 1974. Shih në këtë vëllim f. 194.

karakteristika të personit tënd e kanë burimin dhe në paqartësinë tënde ideologjike; shumë koncepte revizioniste, borgjeze të janë veshur në mendimet e tua dhe këto të kanë luajtur e të lozin lodra të hidhura në jetën dhe në punën tënde.

Ti, Petrit, e ke mbivlerësuar shumë edhe të kaluarën tënde luftarake, edhe zotësinë tënde si ushtarak, edhe kontributin që ke dhënë ti në organizimin dhe në modernizimin e ushtrisë. Këto kontribute, aq sa janë, ne nuk t'i kemi mohuar, por në ushtri jo kurdoherë ke punuar sa duhet dhe si duhet, sidomos në rrugën dhe brenda normave të Partisë.

Dua të theksoj se Partinë ti «e ke dashur» dhe «e do» jo si duhet dashur dhe si duhet mbrojtur ajo, jo sipas ideologjisë së saj. Këtu qëndron faji yt i madh, kjo të ka çuar ty në gabime të rënda. Me pikëpamje ideologjike të gabuara, me karakteristika prej mendjemadhi e prepotenti, me pikëpamjen se ti je ushtarak i zoti, më i zoti se gjithë të tjerët, ti kishe arritur në mendimin se nuk bën gabime ushtarake, as politike, jo vetëm në vija të trasha, por edhe në ato të hollat. Këto të kanë dhënë ty disa tipare të theksuara të një oficeri të vjetër dhe të kanë bërë të harrosh se ushtria jonë është ushtria e Partisë, e proletariatit, me norma, me ligje dhe me ideologjinë marksiste-leniniste. Ti kujtoje dhe kujton se i di këto, por faktet në punë na tregojnë se këto norma dhe ligje ti nuk i ke zbatuar.

Kjo pamje e tillë e gjërave nga ti ka pasur efekte të dëmshme, të rrezikshme në punën ushtarake dhe të Partisë në ushtri. . .

Ti, Petrit, si edhe Eqir Balluku, kur ju ka kritikuar Byroja Politike për punën e dobët, e keni kuptuar

dhe dilnit me konkluzionin sikur për ç'po ngjiste në ushtri vinte për shkak të grindjeve personale mes Beqirit dhe teje, sikur këto ishin çështje stili, metode dhe kompetence. Të paktën dhe të shumtën këtë përshtypje na jepnit neve. Ne ju kemi kritikuar edhe për këto, pse ishin shfaqje që pengonin punën. Tash është e qartë pse Beqir Ballukut i vinte mirë që të qëndronim në këto ujëra, pse kështu humbisnin gjurmët e punës së vërtetë armiqësore që përgatitnit. Ai kërkonte ta reduktonte çështjen në «stil, metodë dhe kompetenca».

Në Byronë Politike nuk na ndihmoi kush nga ju që të shihnim më qartë. Një fjalë the ti vetëm në fund se «nuk je dakord në çështje parimore me Beqir Ballukun» dhe e gjithë çështja u zgjidh. Këtë gjë ti nuk e bëre më parë. Ky është nga gabimet e tua më të mëdha.

Ti nuk ke qenë dakord me kohë me Beqir Ballukun, por edhe ai nuk ishte dakord me ty. Pse nuk ishte dakord? Pse ti punoje ashtu si punoje, ai «nuk punonte», ti «nuk gënjeje», «ai gënjente», «ai komplotonte», ti «jo», «ai nuk tregonte asnjë zotësi në çështjet ushtarake dhe blifonte», por ti e shikoje që ai blifonte, në vend që të ndiqje rrugën e vërtetë për t'i prerë hovin Beqir Ballukut, domethënë të përdorje rrugën e kritikës në Byronë Politike dhe në komitetin e Partisë, ti zgjodhe vetëm rrugën e zënkave, veprime, si të thuash, në platformën subjektive, u përpoqe të merreshe vesh me të dhe ta mbyllje çështjen. Kështu, ti shkove në terrenin që donte ai, ti u fute vetë në rrugën e gabimit e të tradhtisë. Ti thua se re në kundërshtim parimor me Beqir Ballukun, atëherë me kohë, që më 1971 e më përpara kishe parë se Beqir Balluku po gabonte dhe po

tradhtonte vijën e Partisë dhe të ushtrisë, por ti nuk na vure në korent, na i mbajte fshehurazi. Po përse na i mbajte fshehurazi? Se kishe humbur besimin tek udhëheqja kryesore e Partisë dhe te Sekretari i saj i Fazë. Ti arrite të mendosh se ne e mbështetnim Beqir Ballukun në veprimtarinë e tij keqberëse që ne as e dinim, kurse që të gjithë ju na e mbanit të fshehtë. Ja, këtu të sollën ty pikëpamjet e çua jo të qarta si komunist. Ti jo vetëm nuk i kishe të qarta normat dhe parimet e Partisë, por as i zbatove edhe ashtu shtrembër siç i dije.

Megjithëse ti ishe «në kundërshtim të vazhdueshëm» me Beqirin, megjithëse diktove se «ai po tradhtonte vijën», deri në fund u përpoqe që këto gjëra t'i mbuloje. Kjo duket si kontradiktore, por është logjike për një shok, që nuk i ka të qarta parimet proletare marksiste-leniniste të Partisë sonë. . .

Ajo që thua ti se nuk i fola udhëheqjes më përpara, pse mendoja se mos ma merrte për të keq dhe thoshte që «Petriti vazhdon të grindet me Beqirin, me gjithë kritikën që i janë bërë», ka qenë logjike sipas teje. Por prapë kjo logjikë të çoi në çështjen e madhe dhe të rëndë, të humbisje besimin tek udhëheqja, te Partia dhe për një tradhtar në kokën e Partisë dhe të ushtrisë heshte për veprimtarinë e tij. Arsyen tjetër që ngrite në Byro se nuk arrite dot të konkludoje, hidhe poshtë se nuk qëndron. . . !

Ti, Sadik Bektashi, hiqesh poshtë e përpjetë si një njeri i mësuar, një shok që e zotëron mirë e bukur marksizëm-leninizmin, hiqesh sikur shkencën ushtarake e zotëron në majë të gishtërinjve dhe jo vetëm kaq, por merr poza të atilla të palejueshme e të dënueshme

që u fut druajtjen vartësve, përdor ndaj tyre atë mënyrën e një bajraktari e të një njeriu që flet nga maja e shkencës. Por faktet treguan të kundërtën e asaj që hiqesh ti. Ti ke shumë më pak vlera në këto drejtime. Me pozat e një malësori të sëmurë dhe që fshihet nën slogane komuniste, kur të cenohet personaliteti, vjen menjëherë në zyrën time dhe kërkon që unë të vë në vend ofezën që të paskësh bërë Beqir Balluku. Por, kur ky komploton e minon Partinë dhe ushtrinë, ty as që të shkon në mendje të marrësh mundimin e të vish tek unë ta denoncosh. Mund të na thuash se këtë gjë nuk e ke diktuar?! Po atëherë, kur e diktove, ashtu sikurse erdhe shpejt e shpejt kur të ofendoi personin tënd, përse nuk erdhe të më njoftoje? Kuptohet se çështja personale kishte shumë rëndësi për ty, kurse ajo e Partisë s'e kishte atë rëndësi. Ti tash thua se bëre gabim, po përse e bëre atë gabim? Pikërisht këtë duhet të zbulosh që të shërohesh.

Është lehtë të thuash që «nuk e diktova punën armiqësore të Beqir Ballukut» etj., etj. Po punën që bëje ti brenda në institutin që udhëhiqje dhe që e kishte kthyer në një furnizues të ushtrisë me materiale të ndyta revizioniste të partisë dhe të ushtrisë sovjetike, nuk e pe që kishte tipare revizioniste...?

Nga e kishte marrë ti këtë leje dhe këtë urdhër që të veproje kështu? Ku qëndronte komunizmi yt? Puna jote ishte me shumë përgjegjësi, ajo ishte një punë politike dhe ideologjike. Ti u tregove shumë i dobët si komunist në këtë drejtim dhe ke përgjegjësi të rëndë. Partia dhe shokët të kërkojnë llogari. Ti je qarë dhe po qahesh se s'të jepeshin kuadro të zotë etj., por megjithatë edhe ata që të ishin dhënë, ti nuk dite

t'i drejtoje, i prishe, pse, siç del, ti vetë dhe i pari, ishe i prishur, nuk ishe në rregull me Partinë, me vijën e saj.

Këto janë çështje shumë serioze, janë çështje jetike për Partinë, për ushtrinë dhe për popullin. Me këto çështje nuk mund të lejohet kurrkush të bëjë shaka, t'u hedhin bombën dhe të fshehin dorën. Prandaj duhet zhveshur nga mbeturinat dhe duhet spastruar nga ideologjia revizioniste, ndryshe nuk kuptohen drejt këto kritika të hidhura, të ashpra, por të drejta dhe plotësisht të merituarra që po ju bëjmë. Çdo gjë është shikuar nga interesi i lartë i Partisë dhe i socializmit. Asnjë cklzagjerim nuk ka në thëniet e shokëve të Byrosë Politike, asnjë qëllim fyerjeje ose diskriminimi për ndonjërin. Bile jam i mendimit se edhe më shumë po të zgjatëshim, akoma më mirë do të ishte për Partinë dhe për shokët. Por unë i propozoj Byrosë Politike që konkluzionet për këtë problem të mos i japim sot. Le t'i lëmë shokët e ushtrisë të reflektojnë thellë mbi këto që u thanë këtu për të mirën e Partisë dhe të tyre...

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të njëjzë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

**TË SPASTROJMË ME FSHESË TË HEKURT  
VEPRIMTARINË ARMIQËSORE TË BEQIR  
BALLUKUT, TË NXJERRIM MËSIMË PËR  
FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS  
SË PARTISË NË USHTRI**

*Fjala në mbledhjen me kuadrot kryesorë  
të forcave të armatosura<sup>1</sup>*

14 tetor 1974

Të dashur shokë,

Çka do t'ju them janë pikëpamjet unanime të Byrosë Politike të Komitetit Qendror. Ju kemi thirrur këtu, në Komitetin Qendror të Partisë, për të zhvilluar

---

1. Kjo mbledhje u bë në aparatën e KQ të PPSH lidhur me veprimtarinë armiqësore të B. Ballukut, P. Dumas e H. Çakos. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 10 tetor 1974, që analizoi punën armiqësore të zhvilluar në ushtri, shoku Enver Hoxha propozoi që problemet që u diskutuan në Byrosë Politike të shtroheshin në një aktiv të kuadrove të ushtrisë dhe, pas aktivitetit, në tërë ushtrinë të zhvillohej një diskutim i gjerë dhe i zjarrtë revolucionar për të spastruar sa më parë dhe rrënjësisht punën e kalbur dhe të sëmurë që ishte bërë atje nga komplotistët e puçistët.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Byrosë Politike të KQ të PPSH.



një bisedë. Kjo do të jetë jo një bisedë letrare, por si kurdoherë, e hapët, me karakter politiko-ushtarak, një bisedë punë dhe me frymë kritike konstruktive.

Dëshiroj të them qysh në fillim se gjatë kësaj bisede nuk do të përdor fjalë të mëdha e lavdëruese për ushtrinë tonë dhe për kuadrot e saj, sepse kjo do të ishte një punë boshe. Trajtimi fantastik dhe bombastik i problemeve fshih realitetin, ekzagjeron sukseset, mbulon gabimet dhe të metat. Kush vepron kështu, sipas fantazisë së tij «pjellore», u kalon çështjeve përciptazi. Një stil i tillë punë në trajtimin e problemeve ngushton këndin e vështrimit, të vë në gjumë, prandaj nga Partia nuk lejohet që të përdoret një stil i tillë në asnjë sektor punë.

Partia na mëson ta gjykojmë çdo gjë realisht, të raportojmë realisht dhe, mbi këtë bazë, të nxjerrim përfundime të sakta, të caktojmë detyra të drejta. Detyrat që rrjedhin nga një analizë e tillë janë të vetmet detyra të drejta e reale, që bazohen në sukseset e arritura dhe shërbejnë për të korrur suksese të tjera më të mëdha. Detyrat tona përcaktohen gjithashtu edhe nga analiza e gjithanshme e të metave dhe e gabimeve të vërejtura në punë, nga të cilat mësojmë kurdoherë për të mos i përsëritur.

Duke e parë në këtë prizëm punën armiqësore të Beqir Ballukut, del se ai nuk vepronte në rrugën e Partisë. Në gjithë veprimtarinë e tij të përditshme, ai luftonte, në radhë të parë, kundër frymës politike të Partisë në ushtri, pastaj kundër frymës ushtarake të saj. Del se në çështjet ushtarake ai ishte fare i çekët, ndërsa në çështjet politiko-ushtarake ishte antiparti. Beqir Balluku shkonte shpesh në reparte, ku i mblidhte

kuadrot, bile i thërriste ata edhe në qendër, por nuk bënte punë. Po ç'bënte atëherë në këto mbledhje? Dëgjonte veresie raportet e shokëve dhe u përgjigjej përciptazi propozimeve e nevojave që kishin kuadri dhe reparti. Është fakt se ai nuk shkonte kurrë i përgatitur nëpër mbledhjet, sepse ishte i bindur që «i dinte të gjitha!». Prandaj bënte muhabete për gjërat që do t'i dilnin përpara, krijonte probleme, fantazonte për të fshehur menefregizmin e tij, dëgjonte ku ishin të metat dhe, më në fund, jepte urdhra siç i vinte për mbarë. Gjithë këtë «punë» e mbulonte me parulla bombastike, që mësohen fare lehtë dhe bëhen shprehi kur i përdor për njëzet e ca vjet me radhë si ministër i Mbrojtjes. Këto llafe atij i dukeshin se tingëllonin si gjëra «shken-core» e «të thella».

Kur duheshin dërguar raporte në Komitetin Qendror, siç u tha edhe nga ju në mbledhjet që zhvilluat, Beqir Balluku i «krasiste» ato, u hiqte kritikën që i bëheshin punës, për të krijuar përshtypjen se «Në ushtri çdo gjë shkon mirë». Ju i pranoni këto «qethje» që bënte ish-ministri. Disave prej jush u vinte edhe mirë që Byroja Politike e Komitetit Qendror të mos i mësonte dobësitë e punës dhe t'ju merrte për «njerëz të pagabueshëm e të zotë», për «koka ushtarake».

E shihni, shokë, ku të çon një rrugë e tillë anti-parti që ndiqte Beqir Balluku? Prandaj këtë frymë të sëmurë duhet ta luftojmë deri në fund dhe për asgjësimin e saj le të përdorim kurdoherë metoda të drejta partie. Metoda e drejtë e Partisë në paraqitjen e problemeve është ajo që as të mos e nxish gjendjen, që ta bësh pesimiste dhe pa shpresa, por as edhe ta frysh e ta zbukurosh atë, se kështu largohesh nga realiteti dhe

fshch të metat e gabimet, ushqen megalomaninë dhe prepotencën, gjë që krimb përbrenda gjendjen, punët dhe njerëzit. Ushtria nuk dëshiron lavdërime pa baza.

E vërteta është se ne kemi një ushtri të fortë, një ushtri të ngritur politikisht, të stërvitur ushtarakisht, me kuadro të aftë, që kanë eksperiencë partie dhe ushtarake, që janë të futur dhe të lidhur me masën e ushtarëve. Gjithë populli ynë, si ai që mban armën, edhe ai që nuk e mban akoma për arsye moshe, mëson si të luftojë, si të sulmojë, si të mbrohet dhe si të fitojë anekënd vendit tonë, në të gjitha kohët, në të gjitha rrethanat.

Në krye të ushtrisë është Partia e Punës e Shqipërisë, e cila e krijoi dhe e kaliti atë në zjarrin e luftës, e edukoi dhe e armatosi në periudhën e pasluftës, vazhdon ta edukojë, ta armatosë, ta stërvitë dhe ta kalitë kurdoherë me ideologjinë marksiste-leniniste. Ushtrisë sonë nuk mund t'i ngulen në tru, në zemër dhe në veprime veçse fryma, teoria, praktika, zakonet dhe ligjet e proletariatit. Dhe kur afirmojmë me plot gojën dhe me bindjen e thellë se ushtria është besnike deri në vdekje e Partisë, e udhëheqjes së saj të lavdishme, kur themi se Partia dhe ushtria janë besnike deri në fund ndaj popullit shqiptar, ndaj diktaturës së proletariatit dhe socializmit, me këtë ne shprehim një të vërtetë të pamohueshme, një realitet të madh.

Këtë të vërtetë, siç e ka provuar jeta, nuk e durojnë dot armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, të cilët jo vetëm përpiqen të futin në radhët tona agjentë, spiunë, diversantë e të tjerë, por bëjnë dhe *performance*<sup>1</sup>

---

1. Frëngjisht — demonstrime.

e shpikje të reja ushtarake, për të pasur epërsi mbi ne. Armiku dhe agjentët e tij, duke përdorur «gogolin» e armëve të tyre, të potencialit të tyre të madh njerëzor dhe ekonomik, mundohen të na demoralizojnë, të na frikësojnë, të na thyejnë. Por, a duhet t'i lejojmë ne vetes të na mbërthejë shantazhi i armikut, të kapitulujmë e të tradhtojmë kauzën tonë të madhe, siç bëri Beqir Balluku? Në asnjë mënyrë jo! Na lejohet neve t'i bëjmë llogaritë e mbrojtjes dhe të fitores sonë, pa marrë parasysh forcën e armikut që na sulmon, strategjinë dhe taktikën e tij? Në asnjë mënyrë jo!

Ne kemi besim të plotë në forcat tona njerëzore pëse njerëzit tanë i kalit në çdo drejtim Partia e Punës. Ky potencial njerëzor, që është i vogël në raport me numrin e armiqve, si rrjedhim i punës edukuese, organizuese e drejtuese të Partisë, dhjetëfishohet e qindfishohet në fushën e betejës.

Gjithashtu ne e kemi ushtrinë të armatosur mirë. Armët që kemi ne në duar s'janë as të vjetruara, as të pakta, as të disa tipave të kufizuar, prandaj themi me plot bindje se një armatim i tillë në duart e një ushtrie të proletariatit, siç është ushtria jonë, mund të konsiderohet shumë i fortë.

Me këto armë dhe me armë të tjera akoma më moderne që do të kemi në të ardhmen ne do t'i mposhtim armiqtë. Po përse do t'i mundim? Se do të përdorim mirë armët tona, se ata që i përdorin armët te ne janë njerëz të ndërgjegjshëm politikë dhe ushtarakë, që luftojnë për kauzën e madhe të popullit sipas strategjisë dhe taktikës sonë që janë krejt të kundërta nga ato të armiqve. Strategjia dhe taktika jonë ushtarake bazohen në teorinë marksiste-leniniste, në parimet dhe në nor-

mat politike, ideologjike dhe ushtarake të proletariatit, në përputhje me kushtet gjeografike dhe ekonomike të vendit tonë, në përshtatje me potencialin tonë njerëzor, duke pasur parasysh edhe mundësitë e armiqve në veprim.

Vazhdimi i pandërprerë i edukimit për përdorimin e armëve të luftës është një nga detyrat e rëndësishme që duhet t'u mësohet mirë ushtarëve të republikës. Këtë detyrë ju duhet ta kryeni me kujdes, por kjo nuk është e tëra. Mësimi që i jepet ushtarit për ta përdorur armën është relativisht aq i lehtë, sa edhe puna e punëtorit që mëson tornon, që ndërton makinën elektronike, hidrocentralin etj. Por çështja më e rëndësishme është ajo se si duhet ta konsiderojë ushtari armën që ka në dorë, si të qëndrojë ai përpara saj dhe përpara armikut në kohë e në momente të ndryshme. si të kombinojë veprimet taktike; kur duhet të ecë i vetmuar, në grup ose së bashku me reparte të tjera, kur duhet të shpejtojë e kur s'duhet të nxitohet, kur të sulmojë dhe kur të qëndrojë në vend apo të tërhiqet, kur t'i ekonomizojë municionet dhe kur t'i harxhojë ato etj. Këto dhe shumë çështje të tjera janë kërkesa të artit ushtarak, i cili nuk është aq lehtë të përpunohet dhe të mësohet vetëm në akademi, siç mendojnë disa. Atje mësohen parimet themelore, të ilustruara me shembuj konkretë të punës dhe të jetës së ushtrisë sonë. por larmia e shembujve që paraqet jeta përmban në vetvete edhe larminë në taktika, sipas pozicioneve të terrenit, që nuk paraqiten kurdoherë njësoj, jo vetëm për shkak të konfiguracionit gjeografik të tij, por edhe të zhvillimeve të ndryshme të operacioneve. Por, në qoftë se kemi të qartë gjithë vijën e Partisë dhe e zbatojmë atë në tërësinë e vet,

po t'u mësojmë qartë ushtarëve armët e ndryshme, përdorimin si duhet të tyre, po t'u mësojmë atyre politikën e luftës sonë, atëherë do të kemi gjithmonë një ushtri të pamposhtur.

Gjithë Partia tanimë është informuar mbi veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut, tradhtia e të cilit u zbulua dhe u demaskua. Nga gabimet ne duhet të nxjerrim mësim për të forcuar më tej gjendjen. Çdo gjë ka të mirën dhe të keqen e saj. Ndërsa të mirën, domethënë armatosjen e Partisë me një eksperiencë të re që fitohet nga ngjarja e keqe, duhet ta konsolidojmë, të keqen, domethënë frymën antiparti dhe antikombëtare të tradhtarit Beqir Balluku, ta qërojmë që të mos përsëritet më.

Partia dhe populli janë shumë të indinjuar dhe të revoltuar nga puna armiqësore e Beqir Ballukut. Shumë njerëz kërkojnë që ky armik, për krimet që ka kryer, t'i jepet gjyqit. Këta gjykojnë drejt, veprimtaria e Beqir Ballukut edhe penalisht është e dënueshme, por nuk duhet humbur durimi. Duke gjykuar veprimtarinë e tij dhe qëndrimet negative që ai ka mbajtur ndaj fajëve të kryera, me siguri që do të japë llogari të mëtejshme, por duhet ta thellojmë hetimin e çështjes në rrugë partie dhe shtetërore jo se nuk kemi fakte të mjaftueshme për dënimin e këtij renegati, se argumente kemi boll, por sepse është e domosdoshme që të analizohen mirë etapat e zhvillimit të punës së tij armiqësore, që kur ka filluar e gjersa u zbulua, duke parë ç'degëzime ka pasur dhe gjer ku është shtrirë kjo veprimtari, si është manifestuar në njerëzit dhe në punët, gjer ku i ka rrënjët etj.

Gjykimi i nxituar i tij nga organet e drejtësisë, mund të sjellë shumë pengesa në drejtimet që thashë më lart, sepse akuza do të kufizohet vetëm në materialet<sup>1</sup> e urryera që ai kishte përpunuar (dhe që janë aktakuza më e rëndë dhe e faktuar e tradhtisë së tij), por nuk janë gjithçka vetëm zbulimi dhe dënimi sipas ligjit i kësaj veprimtarie armiqësore. Beqir Balluku vërtet u bë tradhtar, por ai nuk lindi i tillë. Duhet thelluar akoma në zbulimin e shkaqeve objektive e subjektive, përse përfundoi ai në tradhti, kush e frymëzoi në këtë veprimtari kriminale dhe kë tjetër infekttoi ai?

Hedhja në gjyq me shpejtësi e Beqir Ballukut do të influenconte rrethin e mundshëm të njerëzve të infektuar nga ai me dashje ose pa dashje. Ata që janë infektuar me dashje do të fshihnin këmbët, ndërsa të tjerët do të frikësoheshin dhe nuk do të bënin autokritikë të hapët komuniste, kështu nuk do të spastroheshin nga «infeksioni». Me gjykimin e shpejtuar të Beqir Ballukut dhe me marrjen fund menjëherë të procesit gjyqësor kundër tij, shumë njerëz do ta quanin çështjen të ezauaruar, do të mendonin se «u mbyll davaja», pasi tashmë

---

1. Është fjala për «tezat teoriko-ushtarake» të komplotistëve, të cilat, kur u zbuluan, u quajtën «materiale të zeza», sepse ishin krejt të kundërta me Tezat e Këshillit të Mbrotjtjes dhe me vijën ushtarake të Partisë. Përgatitja e tyre filloi më 1971 dhe përpilimi i tyre bëhej pas shpinës së Partisë. Ato lu shpërndanë fshehurazi disa kuadrove të komandave të njëjsteve, me qëllim që Beqir Balluku me shokë të siguronin përkrahjen dhe mbështetjen e tyre. Baza e këtyre antitezave ishte «teoria e rrëshqitjes», siç u quajt, domethënë disfatizmi, kapitullimi para pushtuesve të huaj, lënia e qyteteve dhe e territoreve armiqve, tërheqja në male etj.

u gjend dhe u dënua fajtori. Mirëpo nga ky lloj gjykimi do të mbylleshin gojët e atyre që kanë gabuar me ndërgjegje ose pa ndërgjegje. Një situatë të tillë Partia nuk duhet ta lejojë kurrë, pse është e mbarsur me rreziqe. Prandaj, veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut Partia (siç ka vepruar edhe në raste të tjera kur janë zbuluar armiq), duhet ta bëjë një problem të madh me qëllime edukative: për revolucionarizimin e mendjes së njerëzve, për spastrimin e ndërgjegjes së tyre nga të këqijat, për të zhvilluar në të gjitha fushat e jetës shoqërore luftën e klasave, për t'i treguar gjithë Partisë dhe popullit se lufta e klasave është jetike dhe shpëtimtare për socializmin, se ajo spastron, kalit, forcon, zhvillon më tej, shpie përpara shoqërinë.

Le të shikojë e të bindet Partia në gjithë këtë punë se lufta e klasave nuk zhvillohet me fushata, por është një proces i tërë e i vazhdueshëm në praktikën e përditshme të punës e të jetës. Le të shohin Partia dhe populli se, pas luftës që u bë për demaskimin e armiqve si Fadil Paçrami, Todi Lubonja e të tjerë, doli edhe armiku tjetër, Beqir Balluku. Shumë njerëz, që u treguan «të nxehtë» në dënimin e dy të parëve, thanë se i kishin kuptuar si duhet mësimet që dolën nga ajo e keqe dhe e fjetën mendjen, duke menduar se revolucionarizimi u bë, por harruan të vazhdonin zbatimin me rreptësi të parimeve dhe të normave të Partisë që udhëheqin këtë revolucionarizim.

Pikërisht për këtë arsye Partisë i duhet të ngrihet prapë në këmbë për revolucionarizimin e saj, jo vetëm për të dënuar thjesht aklën tradhtar të Beqir Ballukut, por për të zbuluar edhe shkaqet pse lindi dhe përse u zhvillua kjo veprimtari, pse nuk u vërejt me kohë,



pse ndodhi që nuk u bë çështje edhe kur u pa nga disa shokë etj. Me një fjalë, të rifillojmë vazhdimisht e vazhdimisht të rigjykojmë vetveten, ndërgegjen dhe veprimet tona. Këtë rigjykim duhet ta bëjmë haptazi në organizatën e Partisë. Rrugë tjetër nuk ka për shërim, rrugë tjetër nuk ka për mbrojtjen e Partisë dhe të socializmit. Të dënosh një tradhtar si Beqir Balluku është një gjë e nevojshme, por, në të njëjtën kohë, dhe së bashku me të, duhen dënuar dhe «armiqtë e padukshëm» të strukur brenda në ndërgegjen e njerëzve. Komunisti duhet të jetë i ashpër kundër këtyre «armiqve të padukshëm», që, po nuk u luftuan shtohen e përhapen si kanceri, gjersa më në fund e shtrijnë trupin e prekur prej tij për vdekje. Në qoftë se nuk e bën këtë luftë ideologjike, njeriu as nuk mund të jetë, as nuk mund të quhet komunist.

Shumë shprehje, shfaqje, qëndrime e veprime të Beqir Ballukut në funksionet që kishte në udhëheqje, kalonin pa u vënë re dhe pa iu kushtuar rëndësia e duhur. Tash që e dimë se ai është armik, analiza e veprimtarisë së tij merr një rëndësi të madhe. Ai ka folur me shumë njerëz nga të katër anët. Në mes të atyre gjërave që ka thënë andej-këndej, në forma të ndryshme ai thoshte edhe mendime dhe ide të shtrembra, që nuk i viheshin re, por ato mendime nuk ishin gjë tjetër veçse pasqyrimi i shumë të këqijave që fshiheshin në ndërgegjen e tij dhe që shfaqeshin si helm i sheqerosur nga goja e një «udhëheqësi kryesor, të pagabueshëm, të pakritikueshëm, që dinte çdo gjë». Këto të këqija dhe thënie të tij, që janë si hallkat e një zinxhiri, të hedhura andej-kütej, tash duhet t'i qëmtojmë dhe të formojmë me to zinxhirin e pashkëputur, gjë që do të na ndihmojë

të nxjerrim konkluzione dhe mësimë të sakta. Partisë i duhet që, nëpërmjet debateve, tregimeve, kritikave, autokritikave, informacioneve etj., të ndërtojë skemën e zhvillimit dialektik të këtij akti antiparti, antirevolucionar. Me këtë rast kërkohet që njerëzit «të shqepin» gurmazin nga gëlbazat, me qëllim që të spastrohen «bronket e mushkëritë» e ushtrisë dhe kjo të marrë frymë lirisht.

Në konkluzionet e Plenumit të 5-të të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut» u hodhën një sërë idesh, me qëllim që t'i shërbejnë për orientim Partisë mbi këtë problem. Në Letrën<sup>1</sup> që iu dërgua Partisë u theksuan veçanërisht (dhe kjo bënte pjesën më të madhe të përmbajtjes së Letrës) detyrat e saj, mësimet që duhen nxjerrë nga kjo ngjarje. Të dy këto materiale janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, sqarimi i njërit ka nevojë për atë të tjetrit. Në të dy materialet Partia duhet të thellohet, që secili prej tyre të bëhet ushqim për të gjithë ne.

Lidhur me veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut me siguri do të vërtetohet njëri nga këto tri versione: ose ai ka qenë agjent i jugosllavëve, ose u bë agjent i revizionistëve sovjetikë, ose degjeneroi më vonë, sepse u tremb, u thye, derisa arriti në tradhti. Analiza për një kohë të gjatë e veprimtarisë, e qëndrimeve dhe e thënieve të Beqir Ballukut duhet të na vërtetojë

---

1. Është fjala për Letrën e datës 29 korrik 1974 që Komiteti Qendror i PPSH u drejtoi të gjitha organizatave të Partisë për t'i njohur me veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut në ushtri. (Shih në këtë vëllim, f. 115.)

shkaqet e tradhtisë së tij dhe për këtë jam i bindur se do të na ndihmojnë shokët e Partisë.

Ishte vallë e lidhur veprimtaria armiqësore e Beqir Ballukut në ushtri me agjenturat e huaja dhe me punën armiqësore të armiqve të brendshëm dhe veçanërisht të Fadil Paçramit e të Todi Lubonjës? S'ka asnjë dyshim se po, por një gjë e tillë duhet saktësuar që të zbulohen fijet, format dhe metodat e përdorura nga ai dhe nga shokët e tij, qofshin këta brenda ose jashtë vendit. Mos vallë kjo kërkesë e Partisë mund të krijojë një «psikozë pasigurie dhe frike»? Jo, shokë, nuk duhet të krijojë një psikozë të tillë, sepse analizën e bën Partia, gjykimin e bën Partia, çdo gjë bëhet në rrugë partie.

Sipas mendimit tonë, Beqir Balluku mund të ishte që më parë një agjent i revizionistëve jugosllavë ose sovjetikë, jo vetëm politikisht dhe ideologjikisht, por nuk përjashtohet që ai të kishte edhe lidhje organike me ta<sup>1</sup>. Na vihet si detyrë t'i zbulojmë këto lidhje, që mendoj se kanë ekzistuar, pse lidhjet ideologjike e politike dhe përpjekjet për përgatitjen e terrenit kundër pushtetit dhe Partisë sonë janë të qarta në veprimtarinë e tij armiqësore. Tash detyra tjetër është që këtë qartësi ta kthjellojmë akoma duke përcaktuar kur filloi degjenerimi i tij, kur filloi t'i hyjë frika, kur filloi thyerja, si lindi tek ai megalomania që e nxiti në tradhtinë e tij, kur i filloi veprimet më të hapëta organizative për

---

1. Nga faktet e të dhënat e zbuluara më vonë vërtetohet plotësisht ky parashikim i shokut Enver Hoxha. B. Balluku ishte agjent i vjetër i jugosllavëve, i sovjetikëve dhe i kinezëve, mbante lidhje agjenturore me ta, mernte urdhra e direktiva prej tyre. Ai bënte pjesë në komplotin e madh të kryesuar nga superagjenti Mehmet Shehu.

t'u përgatitur që «të merrte situatën në dorë» dhe «të bënte kthesën» në favor të titizmit apo të brezhnjevizmit.

Puna armiqësore e Beqir Ballukut nuk është aq e thjeshtë, sa të përmbledhet me pak fjalë: «Ky me dy-tre veta, filloi në mënyrë të fshehtë të reviziononte Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, i ndryshoi, i mbylli në kasafortë, u zbulua, asgjë s'mundi të vinte në veprim dhe me kaq mbaroi». Ky arsyetim do të ishte shumë i sipërfaqshëm. Veprimtaria armiqësore e Beqir Ballukut nuk mund të barazohet me një vjedhës ose vrasës të thjeshtë, çështja e të cilit lihet në duar të një apo dy hetuesve. Prandaj problemin duhet ta thellojmë dhe ta shpiem deri në fund. Këtë punë s'ka kush e bën më mirë se Partia dhe vetë ushtria.

Është e domosdoshme ta zbulojmë deri në fund planin komplotist të Beqir Ballukut, i cili, i vetëm, nuk ishte e mundur të rivendoste kapitalizmin në vendin tonë. Pse, me dy veta do t'i dilte ai përpara Partisë dhe ta rrëzonte?! Këtë mund ta besojnë vetëm naivët, por jo Partia.

Komploti kërkon edhe fshehtësi. Po e zbatoi vallë këtë fshehtësi Beqir Balluku? Në përgatitjen e materialeve të zeza deri diku e zbatoi, por kjo gjë duhet vërtetuar me analiza marksiste-leniniste. Le të supozojmë se materialet për revizionimin e vijës ushtarake të Partisë u përgatitën prej tij në mënyrë sekrete. Atëherë vihet pyetja: «Ç'do t'i bënte Beqir Balluku këto materiale, do t'i mbante të mbyllura në kasafortë, apo do t'i vinte në zbatim? Në qoftë se do t'i vinte në zbatim, me cilët do të bashkëvepronte?». «Këto janë punë të hetue-

sisë», mund të mendojë ndonjë. Jo, përpara se të bëhen punë të hetuesisë ato janë çështje partie.

...Beqir Balluku, që përgatiste materiale të cilat do t'i vinte në zbatim në këtë ose në atë formë, shpejt ose vonë, u tregua i frikshëm përpara anëtarëve të Komitetit Qendror në Plenumin e 5-të, sa gati mohoi edhe ato fakte që kishte pranuar në Byronë Politike<sup>1</sup>. Po përse u frikësua Beqir Balluku? Ai u frikësua se u zbulua. Po ku e mbështeste atëherë «trimërinë» kur filloi punën e tij armiqësore? Duke menduar përgjigjen logjike që mund t'i jepet kësaj pyetjeje, del që, me sa duket, kemi të bëjmë me një punë të vjetër armiqësore kundër Partisë dhe pushtetit, punë që mbeti e mbyllur, derisa u zbulua. Beqir Balluku përdorte çdo metodë që mendonte se u përshtatej në mirë situatave konkrete që krijoheshin brenda dhe jashtë vendit tonë. Ai ishte prudent, por veprimtarinë e vazhdonte.

Puna armiqësore e Beqir Ballukut në gjirin e ushtrisë kishte një natyrë me atë të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës. Të dyja palët luftonin për të arritur një qëllim: dobësimin dhe likuidimin e rolit të Partisë, të diktaturës së proletariatit, demoralizimin dhe shthurjen e rinisë, si në terren dhe në ushtri, minimin dhe përçarjen e kuadrove dhe të udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit.

Por Beqir Ballukun nuk e bashkonte vetëm i njëjti qëllim armiqësor me Fadil Paçramin, me Todi Lubonjën dhe me të tjerët. Atë e bashkonin edhe metoda të njëjta

---

1. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të zhvilluar në datën 2-3 korrik 1974.

për të arritur qëllimin armiqësor. Të marrim një nga këto metoda: zhvillimin e kultit të tyre. Të dyja palët përpiqeshin të ngrinin dhe të përgatitnin kultin e personit të tyre si «udhëheqës të afirmuar» dhe të «perspektivës». Këtë kult e përgatitnin në mënyrë të bashkërenduar në sektorët që drejtonin. Beqir Balluku, duke dërguar në reparte «simitet» e tij të përgatitura nga të tjerët, bile të shkruara edhe disa ditë para se të dilnin dokumentet zyrtare të Partisë, donte të tregohet si «një kapacitet i madh ushtarak». Shkrimet dhe fjalimet e tij shoqëronin shumë herë fjalimet e mia. Ndonjëherë ai fliste për të njëjtat gjëra që do të flisja edhe unë, për të dhënë përshtypjen e rreme se «Këto çështje që ngre Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, i kam ngritur unë më parë» dhe se «Unë, Beqir Balluku, jam plotësisht dakord me shokun Enver», ose «Shoku Enver është plotësisht dakord me mua, Beqir Ballukun». Dhe kishte nga ata shokë naivë që e hanin këtë marifet të tij. Kështu vepronin edhe Fadil Paçrami e Todi Lubonja, të cilët donin të afirmoheshin si «teoricienë të shquar».

Një metodë tjetër djallëzore si për Beqir Ballukun edhe për grupin e Fadil Paçramit ishte veprimi i njëjtë për spostimin e rolit të organizatës-bazë të Partisë. Beqir Balluku e kishte bërë leckë rolin e organizatës-bazë dhe të komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të cilave ua kishte hipur në zverk dhe ato bënë siç donte dhe siç urdhëronte ai. Këto i keni thënë tani vetë ju, shokë komunistë, që punoni në Ministrinë e Mbrojtjes. Të njëjtën rrugë ndiqte edhe grupi i Fadil Paçramit, që godiste me pallë andej-këtej, që i vriste kuadrot shpirtërisht dhe demoralizonte njerëzit. Atë

s'mungonin të goditnin drejtpërdrejt vijën e Partisë së bëntë, gjoja në mënyrë sekrete, edhe Beqir Balluku; ata bënë ligjin në organizatat-bazë të Partisë pranë institucioneve artistike e kulturore, kërcitnin dhëmbët dhe grushtin në Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës, pale në Komitetin e Partisë të Rajonit nr. 1, që nuk e përfillnin fare.

Midis taktikave të përbashkëta që ndiqnin Beqir Balluku dhe grupi i Fadil Paçramit e i Todi Lubonjës kishte edhe një ndryshim: ndërsa Fadil Paçrami arrinte të fliste edhe me arrogancë përpara disa udhëheqësve kryesorë të Komitetit Qendror, të tregojë si gjoja i bindur në ato që i thoshin, por që në fakt gënjente dhe nuk përfillte këshillat dhe rekomandimet e tyre, përkundrazi Beqir Balluku i shmangej me kujdesin më të madh rënies në konflikt me sekretarët e Komitetit Qendror, me anëtarët e Byrosë Politike dhe të Qeverisë. Taktika e tij ka qenë: «Urtë e butë e plot tigani!», «Mos kundërshto, por prano!», «Gënje dhe mashtro me marifet!», «Mos diskuto në Byro!» ose «Fol shumë rrallë!», sepse kështu nuk do të kishte mundësi që të zbuloheshin injoranca dhe gabimet e tij. Edhe kur diskutonte në Byronë Politike, Beqir Balluku godiste me zë të trashë dhe pompoz të gjitha ato gabime dhe të meta që kritikonin shokët. Kështu ai fshihte tërë ato qëndrime arrogante që mbante ndaj kuadrove dhe veprimet e tij antiparti dhe antishtetërore që kryente në ushtri.

Kur u shtrua në Byronë Politike veprimtaria armiqësore e Fadil Paçramit dhe e Todi Lubonjës, taktika që përdori Beqir Balluku ishte kjo: mblodhi këmbët, foli disa fjalë kundër tyre, lëshonte nga një sharje poshtë e përpjetë, sa për të lënë përshtypjen se «ishte parimor»,

por, kur erdhi puna të fliste në Plenumin e 4-t<sup>1</sup> të Komitetit Qendror, ku u dënua puna armiqësore e Fadil Paçramit, Todi Lubonjës e të tjerëve, ai s'foli fare. Çfarë u tha shokëve pas Plenumit? «Nuk fola, sepse në Byronë Politike vendosëm që të mos diskutonim të tërë»! Kjo ishte një gënjeshtër me brirë. Me këtë qëndrim ai dha tonin në ushtri, që të mos punoheshin seriozisht materialet e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror.

Megjithëse puna armiqësore e grupit të Fadil Paçramit u demaskua në Parti dhe në popull, Beqir Balluku e vazhdoi veprimtarinë e tij antiparti. Si e bënte ai këtë, pa pasur frikë se mund të zbulohet? Ai kishte hyrë tashmë në këtë rrugë armiqësore dhe nuk dilte dot prej saj; ai kishte arritur që me konceptet reaksionare të tij të lidhte veprimtarinë e tij me atë të armiqve të jashtëm të vendit tonë. Se si i realizonte ai këto lidhje, këtë duhet ta gërmojnë e ta provojnë Partia dhe organet e diktaturës së proletariatit, në mos sot, nesër.

Ç'dëm i ka sjellë punës së kuadrit në ushtri veprimtaria armiqësore e Beqir Ballukut? Kjo është një pyetje e natyrshme që mund të bëjë secili, kur dëgjon për çështjen e këtij tradhtari. Më parë dhe më mirë se kushdo duhet t'i përgjigjen kësaj pyetjeje Drejtoria Politike e Ushtrisë Popullore dhe Komiteti i Partisë i Ministrisë së Mbrojtjes. I ka sjellë dëme punës me kuadrin

---

1. Zhvilloi punimet nga data 26 deri më 28 qershor 1973. Plenumi dëgjoji, diskutoi dhe miratoi njëzëri raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre» mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 51, f. 277.)



veprimtaria armiqësore e Beqir Ballukut? Po, i ka sjellë. Përgjegjësi për këto dëme ka vetë ai, që zhvillonte punën armiqësore, po përgjegjësi të madhe kanë, gjithashtu, Drejtoria Politike, komiteti i Partisë i ministrisë, komandat dhe personeli që merret me kuadrin. Përgjegjësi ka edhe vetë secili kuadër që ka pësuar dëmin ose që ka vërejtur se me veprimet e padrejta që janë kryer ndaj tij, po i bëhej dëm Partisë dhe, megjithëkëtë, nuk ka reaguar. Kur e shtroj kështu problemin, mund të duket sikur po e shpërndaj shumë përgjegjësinë. por nuk duhet të mendohet kështu.

Të gjithë e përdorin shpesh parullën: «Politikën e kuadrit e bën Partia», por nuk e kuptojnë të tërë si duhet këtë parim me rëndësi të madhe teorike, politike dhe tekniko-profesionale. Pikërisht për këtë arsye mjaft shokë nuk e zbatojnë mirë. Shumë herë politika e kuadrit kuptohet si një veprim mekanik «hiq e vur njerëz». Kur vërehet se nuk janë plotësuar organikat, mendohet: «Oburra t'i mbushim». Për të transferuar dy kuadro, lëvizin 20 të tjerë për shkak të sistemimit të atyre që transferohen! Krijohet një repart i ri dhe lëvizin shumë kuadro etj.!

Po Komiteti Qendror i Partisë i kishte vënë re këto të meta në punën me kuadrin? Po, i kishte vënë re. Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror, të cilëve u vinin propozime për kuadro të nomenklaturës së tyre, i kanë dënuar këto veprime dhe kanë hedhur poshtë shumë propozime që bëheshin jashtë kritereve të caktuara. Komiteti Qendror kishte porositur vazhdimisht Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Hito Çakon, Sadik Bekteshin (kur ky i fundit ishte drejtor politik) e të tjerë, që Partia duhet të vërë dorë me kujdes në trajtimin e

kuadrit, të kërkojë që të zbatohen drejt rregullat dhe normat e saj për këtë problem, që parimet lidhur me politikën e kuadrit të mos zbatohen kurrë në mënyrë automatike e të gënjeshtërt. Mënyra e gënjeshtërt e zbatimit të parimeve të Partisë për kuadrin ishte ajo sipas së cilës, gjoja, bëheshin të gjitha konsultimet ose studimet që kërkon Partia për trajtimin e kuadrit, por në realitet këto jo vetëm zhvilloheshin të përcipta e gjysmake, por as që merreshin parasysh, sepse pengonte hierarkia. Kështu, pavarësisht nga «konsultimet», vendoste ministri, drejtori politik, shefi i Shtabit e të tjerë. Pazarllëqet bëheshin në rrethe të ngushta dhe në këto vendosej, në këto rrethe i vihej kapaku çështjes dhe ky «kapak» cilësohej me të madhe: «Politikën e kuadrit në ushtri e bën Partia!».

Jo, shokë, kjo nuk është politikë partie për kuadrin, po një politikë personale. Vendosi e kuadrit, pa dyshim, e bëjnë forumet kompetente, por, kur vete atje projekti përkatës, duhet të jetë i përpunuar në bazë të rregullave dhe të normave të Partisë, në të gjitha hallkat. Në këtë mënyrë propozimet për kuadrin, që bëhen sipas udhëzimeve të Partisë, në shumicën dërrmuese me siguri do të miratohen.

Disa punonjës thonë se zbatimi i kësaj procedure kërkon një «punë të gjatë», se «po të punohet kështu, s'ua dalim dot nevojave urgjente» etj. Këto «arsyetime» janë profkat e atyre që s'duan të zbatojnë politikën e Partisë lidhur me kuadrin, janë pikëpamje antiparti, që lulëzojnë vetëm në ushtritë borgjeze, ku emërimi, gradimi ose degradimi i ushtarakut është privilegj i përfaqësuesve të grupeve monopoliste, i kastave familjare dhe ushtarake, i oficerëve madhorë, që të tërë

marrin rryshfete për këto gjëra. Rregullat dhe normat e Partisë sonë për politikën e kuadrit as nuk pengojnë dhe as nuk zvarritin dhe, po të zbatohen me kujdes dhe me rreptësi, ne do të kemi shumë mundësi që kuadrin ta përgatitim, ta edukojmë, ta spastrojmë nga dobësitë e të metat, ta kontrollojmë, ta shoshitim dhe ta vendosim në punë në mënyrë demokratike atje ku ai e meriton.

Kur Partia ka përpunuar dhe ka vendosur rregulla të drejta nga më demokratiket lidhur me politikën e kuadrit, i ka pasur parasysh rreziqet që mund t'i turren Ushtrisë sonë Popullore nga vënia në jetë në mënyrë të cunguar të këtyre rregullave, prandaj ka porositur dhe ka kërkuar vazhdimisht zbatimin e tyre me përpikëri. Kush mendon se kjo procedurë që ka vendosur Partia «ngadalëson punën, nuk është operative, nuk merr sa duhet parasysh mendimin e «të mëdhenjve», pa pëlqimin e plotë e të padiskutueshëm të të cilëve në ushtri s'ka rregull, s'ka disiplinë, s'ka frymë luftarake, nuk ka respekt ndaj hierarkisë, ndaj komiteteve, ndaj komandave dhe deri ndaj Komitetit Qendror», ai është krejtësisht i gabuar. Ata që notojnë në këto ujëra, që janë «lagur» ose «spërkatur», nuk janë në rrugë partie, prandaj i këshillojmë të largohen shpejt nga ky llum që të çon në rrugën antiparti ku shkoi Beqir Balluku.

Mendimi i udhëheqësit pa dyshim që ka rëndësi, por që ai të jetë i pranueshëm, nuk duhet të vijë në kundërshtim me atë të të gjithë Partisë, përkundrazi, ato çka thotë udhëheqësi është e domosdoshme të mbështeten në mendimin dhe në teorinë e Partisë, pa të cilën ai individualisht nuk është asgjë, s'ka asnjë vlerë.

Partia asnjëri nuk ka dërguar në udhëheqje, në komandë që të shfrytëzojë postin, të kënaqë tekat e tij për privilegje të paligjshme dhe të bëjë si i do qejfi. Në qoftë se lejojmë gjëra të tilla, atëherë do të humbasë besimi i bazës ndaj udhëheqjes dhe njerëzve të saj dhe në ushtri nuk do të ketë rregull e disiplinë të ndërgjegjshme proletare, por një disiplinë borgjeze të bazuar në frikën e vazhdueshme, në një pasiguri fizike dhe shpirtërore. Kjo frikë dhe pasiguri do të dukej tek ushtarët dhe kuadrot, qofshin këta të ulët apo të lartë, të cilët do të dëgjonin t'u flitej orë e çast për norma të Partisë, por zbatimin në praktikë të këtyre normave nuk do ta shikonin. Çfarë përfundimesh mund të kishim, pra, në këto raste? Dëshpërim! Ushtarakët me vete do të thoshin: «Me këto që na thuhën, po na mashτροjnë!».

Politika e kuadrit në ushtri, ashtu si edhe në sektorët e tjerë, është një çështje e madhe jo vetëm organizative, siç e kuptojnë gabimisht disa njerëz me horizonte të ngushta, por ajo është, në radhë të parë, një çështje ideologjike dhe politike. Këtë të vërtetë ka kuadro që e përsërisin shpesh nëpër mbledhje apo në diskutime me shokët, megjithëkëtë as këta vetë nuk e kuptojnë thellë dhe nuk bëjnë përpjekjet e duhura që të formojnë bindje për të, prandaj bëjnë një punë rutinë.

Shokët që merren me kuadrin (dhe këtë duhet ta nënvizojmë se nuk janë njëzet ose dyqind veta), nuk janë vetëm punëtorët politikë, por janë edhe kuadrot ushtarakë, s'janë vetëm mësuesit e pedagogët e kurseve, të shkollave të mesme dhe të akademisë, por të gjithë kuadrot e reparteve. Me kuadrin në ushtri merret gjithë Partia, organizatat-bazë të saj, gjithë komu-

nistët dhe çdo ushtarak në veçanti. Kjo është e domosdoshme, sepse nuk mund të pasqyrohet gjithë dinamika e zhvillimit të çdo kuadri në disa fletë me shënime që futen në dosjen personale të secilit dhe që ruhen në kartotekën e sektorit të kuadrit, sepse nuk mund të vendosim për ngritjen, për uljen, transferimin, dekorimin ose ndëshkimin e kuadrit, duke u bazuar vetëm në mendimet e një ose të dy vetave, qofshin këta të mirë ose «të mëdhenj».

Zbatimi i mirë i politikës së Partisë me kuadrin krijon te njerëzit kënaqësi dhe bindje. Kjo ka rëndësi të madhe. Kudo në punën e ushtrisë sonë duhet të zotërojnë bindja dhe jo detyrimi. Detyrimi për kryerjen e detyrës duhet të burojë nga bindja e shëndoshë politiko-ideologjike marksiste-leniniste, gjë që do të thotë që secili ta kryejë me përpikëri dhe në kohë detyrën ushtarake, sepse e kupton dhe e ndien që ajo duhet kryer doemos.

Por edhe kur bëhet një politikë e drejtë kuadri, duke zbatuar me rreptësi normat e vendosura nga Partia, në praktikë nuk mund të përjashtohen gabime, sepse nuk është lehtë të arrihet përsosmëria, prandaj duhet të bëhen përpjekje që, sa të jetë e mundur, të mos i krijohen kuadrit shqetësime, qofshin këto fizike, qofshin shpirtërore. Shqetësimet krijohen zakonisht kur bëhet një politikë personale dhe arbitrare me kuadrin. Por edhe kur lëvizja e kuadrit kryhet në bazë të normave të vendosura dhe pa gabime, ka raste që te vetë kuadri që transferohet, kur ai nuk është i formuar mirë, mund të lindin farë lehtë pakënaqësi të pajustificueshme, që e kanë burimin në moskuptimin e drejtë të nevojave që kanë Partia dhe komanda për lëvizjen e tij,

të ndjenjave mikroborgjeze të rehatisë, të mendjemadhësisë etj. Në qoftë se trajtimi i kuadrit bëhet në rrugë dhe në frymë partie, atëherë shqetësime do të ketë më pak dhe kuadri me teka mikroborgjeze ose do të edukohet, ose do të vihet me shpatulla në mur. Në rastin e fundit, kuadri që e ka zor ta pranojë lëvizjen, edhe kur ajo është e drejtë, nuk do të mund të thotë më se këtë ia bëri ky ose ai shok. Por edhe në qoftë se do të flasë kot, është detyra e Partisë të vërtetojë të kundërtën me fakte bindëse. Cilido që nuk ndjek mësimet e Partisë për trajtimin e kuadrit është i prirë ta heqë qafe me rastin më të parë atë që bën vërejtje ose kritika dhe i nxjerr «telashe» eprorit.

Kujtoj se këto mendime për politikën e kuadrit duhet të thellohen në ushtri, prandaj le të provokohen për këtë qëllim studime teorike dhe të ndërmerren veprime praktike. Për një problem kaq të rëndësishëm dhe të ndërlikuar duhet të ndryshojnë stili dhe metoda e punës. Ndikimet e punës armiqësore të Beqir Ballukut duhet t'i shikojmë jo vetëm në drejtim të tezave armiqësore që ka formuluar ai, por në të gjitha drejtimet, një nga të cilat është edhe puna me kuadrin. Në këtë fushë duhet të hidhet tej fryma çoroditëse, antiparti dhe armiqësore e Beqir Ballukut etj. Kjo frymë, që ka sjellë dëme, duhet njohur, ndryshe nuk spastrohet. Beqir Balluku përpiqej të përçante, të çorodiste e të vriste shpirtërisht kuadrot tanë të ushtrisë. Kriteret antiparti që praktikonte ai në punën me kuadrin ishin të larmishme: disave u binte kokës kot, disa i fuste në baltë, të tjerë i shante e i përçmonte, ndërsa disa i lavdëronte dhe kur s'e meritonin. Kjo është një punë e tërë antiparti.

Duhet të ndryshojë rrënjësisht një frymë e tillë në ata njerëz që mendojnë gabim si dikur për fajin: «Kush e bëri? I varfri». Jo, ai që bën fajin, le ta njohë vetë! Kur ky s'e bën këtë, t'ia thonë shokët dhe ai të marrë dënimin e merituar, të cilin ta vuajë duke qenë i bindur, ndryshe nuk shërohet.

Këto shpjegime për punën me kuadrin i bëra edhe për t'u dhënë përgjigje shokëve të komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes, që në mbledhjen e organizatës së tyre për punimin e Letrës së Komitetit Qendror kanë pyetur: «Ç'dëme i ka sjellë politikës së kuadrit në ushtri veprimtaria armiqësore e Beqir Ballukut?». Ata bënë mirë që pyetën, por unë mendoj se më parë këtë pyetje duhet t'ia bënë jo një herë, por një mijë herë vetes dhe jo vetëm tash që u zbuluan aktet e qelbura të Beqir Ballukut dhe fryma e sëmurë në kuadro e në drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, por në çdo rast që vërtetoheshin këto shfaqje. Veprimet që përmenda duhej t'i ishin bërë të njohura prej kohësh Komitetit Qendror të Partisë.

Siç dihet, për të forcuar punën në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Mbrojtjes, sipas orientimeve të Byrosë Politike, në vitin 1970 aprovoi një strukturë të re organizative, të përshtatshme për këtë dikaster, të cilën e pëlqyen edhe drejtuesit e ministrisë. Mirëpo, pa kaluar shumë kohë, në udhëheqjen e atjeshme nxorën krye përsëri mosmarrëveshjet ndërmjet drejtuesve kryesorë. Ata grindeshin «për strukturën organizative, për kompetenca dhe për ndarje funksionesh në dikaster».

Grindjet dhe mosmarrëveshjet për strukturën organizative, për ndarjen dhe rindarjen e kompetencave në

Ministrinë e Mbrojtjes kishin marrë një trajtë të shëmtuar. Shfaqjet e kësaj natyre, siç ishin ankesat e varësve se «Ministri nuk na lë fushë veprimi», se «Për çdo gjë duhet të merret pëlqimi ose t'i raportohet ministrit» dhe ky, ministri, nga ana e tij, sikurse thoshte, qe i pakënaqur për shkak se «Vartësi imediat nuk më informon», nuk kanë ndodhur në ndonjë dikaster tjetër. Kjo situatë, që sa vinte e trashej, arriti gjer në shkallën sa kuadrot e komandës në Ministrinë e Mbrojtjes u ndanë më dysh: gjysma mendonte të mbetej në fuqi struktura organizative e re që ishte aprovuar, kurse gjysma tjetër kërkonte ndryshimin e saj dhe rikthimin në strukturën e vjetër.

Beqir Balluku me këtë synonte të thyente unitetin, të përçante komandën, ta paraqiste këtë përçarje si diçka «të zakonshme» dhe ta hiqte veten si «qengj», në një kohë që ai vetë ishte frymëzuesi dhe shkaktari kryesor i kësaj situate të rëndë që qe krijuar. Në këtë veprimtari, si armik që ishte, ai shfrytëzoi prirjet e sëmurura të karakterit mikroborgjez të disa kuadrove të ministrisë, që kërkonin si e si të merrnin kompetenca njëri më shumë nga tjetri. Pikërisht këta kuadro i mbajtën ison atij.

Mosmarrëveshjet midis drejtuesve kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe përçarja e komandës, në të vërtetë nuk kishin të bënin thjesht me strukturën organizative të dikasterit, me kompetencat, as me «çështje stili e metode pune», siç thuhej në raportin e Drejtorisë Politike dërguar Komitetit Qendror të Partisë më 3 maj 1974, por ato ishin shprehje e një gjendjeje shumë të rrezikshme brenda në udhëheqjen e ministrisë, e provokuar nga armiku Beqir Balluku dhe e ushqyer nga



sedra mikroborgjeze, nga ndjenjat e prepotencës dhe të etjes për të drejtuar të disa kuadrove që, me gjithë sqarimet dhe kritikën që u qenë bërë, kërkonin përsëri kthimin në strukturën e parë. Pas tyre fshiheshin konceptet armiqësore për taktikën dhe strategjinë e ushtrisë sonë, për format organizative dhe metodat e Luftës Popullore. Kjo duket qartë po të kihet parasysh fakti se Beqir Balluku kishte tre vjet me radhë që punonte për përgatitjen e një materiali «teorik». Këtë material ai e hartoi së bashku me njerëzit që vareshin organizativisht nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, por gjoja pa dijeninë e këtij të fundit. Këta njerëz frymëzoheshin nga Beqir Balluku. Ky material «teorik» u kundërvihet politikës së Partisë në ushtri dhe Tezave të Këshillit të Mbrojtjes.

Sa herë që Beqir Ballukut i haste sharra në gozhdë, sidomos në momentet kur kishte rrezik të zbulohet veprimtaria e tij antiparti, ai orvatej t'i bënte presion Partisë duke kërkuar që të jepte dorëheqjen nga detyra e ministrit të Mbrojtjes. Që nga viti 1970 e gjer në tremujorin e parë të vitit 1973 ai ka dhënë disa herë dorëheqjen dhe ka propozuar kurdoherë që Petrit Dumja të bëhej ministër në vend të tij.

Këto qëndrime trockiste: përpjekjet për t'i bërë presion udhëheqjes që ajo «t'ia hiqte qafe» shokët e komandës, me të cilët Beqir Balluku gjoja nuk shkonte, përgatitja fshehurazi e materialeve kundër Partisë dhe popullit, si dhe provokimi i grindjeve për strukturën organizative të Ministrisë së Mbrojtjes ishin një e tërë dhe koincidojnë në kohë. Kjo veprimtari armiqësore e Beqir Ballukut nuk mund të jetë aspak e rastit, për-

kundrazi ajo flet për bashkërendimin e menduar mirë të disa veprimeve nga ana e këtij tradhtari.

Krijimi i grupeve me mendime të kundërta i nevojitej Beqir Ballukut, në radhë të parë, sepse kështu përçahej dhe dobësohej udhëheqja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe pastaj sepse rrethin e njerëzve që e përkrahnin, ai do ta përdorte (sikurse e përdori) për të përgatitur materiale që s'ishin tjetër veçse antiteza të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, si dhe për veprime të tjera të mëtejshme.

Përgatitja e këtyre materialeve ka filluar prej tij në vitin 1971. Njëpërmjet tyre Beqir Balluku donte të dilte me «diçka të madhe», me «një material shumë interesant», që, sipas tij, «do të forconte ushtrinë», që «do të shpëtonte ushtrinë» etj. Me qëllim që të mos zbulohesh dhe të mos pengohesh përgatitja e materialit, Beqir Balluku kishte urdhëruar njërin nga shkruarit e vet që të mos vihej asnjëri në dijeni me përmbajtjen e tij, duke shtuar dhe shpifur sikur për këtë punë paskësh dijeni vetëm shoku Enver. Por e vërteta është se për këto materiale thellësisht armiqësore që përgatiteshin me porosinë dhe nën drejtimin e drejtpërdrejtë të këtij komplotisti të rrezikshëm nuk dinin gjë Byroja Politike, Këshilli i Mbrojtjes, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë.

Duke i studiuar objektivisht e të lidhura bashkë veprimet puçiste e komplotiste të Beqir Ballukut, përpjekjet e tij për të thyer unitetin dhe për të përçarë udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes, për forcimin e një grupi në dëm të tjetrit, degjenerimin e tij moral dhe politik, si dhe përmbajtjen e materialeve «teorike» që

përgatiti në mënyrë sekrete, është me vend të gjykohej se ai synonte të «kurorëzonte me sukses» veprimtarinë e tij tradhtarë dhe qëllimet armiqësore jo përnjëherë (se e kishte të qartë që nuk kishte mundësi), por me valë të gjata e shkallë-shkallë. Kështu, në fillim ai punonte për të revizionuar vijën ushtarake të Partisë dhe për të përçarë udhëheqjen e saj. Pasi të realizoheshin këta dy objektiva, sikurse konkluduan Byroja Politike dhe Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të Partisë, Beqir Balluku do të përpiqej pastaj të reviziononte vijën e Partisë në fushën ekonomike, më pas edhe vijën e politikës së jashtme dhe të arrinte të përmbyste kështu krejt vijën e përgjithshme të Partisë.

Për përmbajtjen e materialit që u përgatit, kuadrot kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes morën dijeni që në vitin 1971, ata ishin mirë në korent të mosmarrëveshjeve dhe të debateve që zhvilloheshin në udhëheqjen e dikasterit për riorganizimin e tij, për të cilin Beqir Balluku porositi më vonë që të bëhej njëfarë «studimi». Tani, duke i gjykuar në kompleks të tëra çështjet që kanë dalë gjatë diskutimeve të shokëve të ministrisë, lind pyetja: Në qoftë se paska munguar guximi për të kërkuar llogari, vallë kureshtje kanë ngjallur veprimet e kryera nga tradhtari Beqir Balluku? Ç'janë këto materiale «teorike» e «studime» që përgatiten në mënyrë sekrete pa ndihmën e kuadrove kryesorë të ministrisë? Petrit Dumja, që kishte marrë vesh sa përmendëm më lart dhe me gjysmë zëri e pyeti Beqir Ballukun se ç'ishte ky material, përse nuk u ngrit me forcë kundër përgjigjes fyese që iu dha nga ai: «Kur të mbarojë materiali do ta shohësh»?! Me këtë rast Petriti, i cili, siç na është thënë, ishte në «konflikt» me ministrin, duhej

medoemos që të paktën t'i ishte drejtuar Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe të njoftonte se «Nga ana e Beqir Ballukut po përgatiten materiale «interesante» për ushtrinë dhe ai me shokët jo vetëm që s'janë vënë në dijeni për to, por u thuhej nga Beqiri se do t'i shikonin pasi të kishin përfunduar!». Petriti duhet të vinte në dijeni, gjithashtu, se Beqir Balluku hiqej sikur këto materiale bëheshin gjoja me porosinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë dhe në bazë të fjalimit të mbajtur prej tij në Plenumin e 12-të<sup>1</sup> të Komitetit Qendror. Po të ishin njoftuar me kohë këto veprime të poshtra të Beqir Ballukut çdo gjë do të ishte demaskuar e do të ishte vënë në vend qyshkur, që në vitin 1971. Mirëpo për ç'arsye nuk u mor kjo iniciativë e drejtë, të cilën edhe normat e Partisë e kërkonin, por e nxitnin edhe kontradiktat që thuhet se ekzistonin në mes Beqir Ballukut dhe të tjerëve e veçanërisht midis tij e Petrit Dumes?

Thuhet, gjithashtu, se nga Beqir Balluku përgatitja e materialeve bëhej në mënyrë sekrete. Është e vërtetë se ai kështu ka dëshiruar, por në praktikën e punës a mund të besohet që në radhët e ushtrisë të ruhej kaq shumë sekret i pretendohet? Shumë mirë do të ishte

---

1. Zhvilloi punimet nga data 29 qershor deri më 1 korrik 1971. Mori në shqyrtim raportet e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi projektidirektivat për planin e pestë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH për vitet 1971-1975», dhe «Mbi masat për përsosjen e mëtejshme të gatishmërisë luftarake të ushtrisë e të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore». Në përfundimin e punimeve të Plenumit, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 46, f. 374.)

sikur të ruhej me rreptësi sekreti ushtarak. Kjo bile është absolutisht e domosdoshme dhe jetike për mbrojtjen e atdheut, por, për fat të keq, në radhët e ushtrisë dhe në shumë nga kuadrot e saj vërehet një familjaritet shumë herë aq i sëmurë, saqë problemet ushtarake, me vend e pa vend, bëhen objekt diskutimi jo vetëm midis kuadrove, por edhe në mes tyre dhe grave, në mes tyre dhe farefisit që kanë. Shembullin më të keq në këtë drejtim, sikurse po zbulojnë shokët me diskutimet e tyre në Parti, e jepte vetë Beqir Balluku, gruaja e të cilit bënte pazarllëqe me oficerët e komandës, ndërhynte në Drejtorinë Politike për të përkrahur njërin apo tjetrin për çështje që lëre ajo, por as shumë të tjerë nuk duhet t'i dinin. Mund të besohet me të vërtetë që kalemxhinjtë e Beqir Ballukut ishin kaq parimorë si komunistë dhe kaq të përpiktë në ruajtjen e sekreteve ushtarake? Vallë kishin arritur këta njerëz në atë shkallë sa të mos u thoshin fare as nga një fjalë Hito Çakos, Petrit Dumes dhe Sadik Bekteshit?

Natyra e punës politike, ideologjike dhe studimore e sektorëve që drejtonin Hito Çakoja e Sadik Bekteshi, përveç të tjerave, nuk lejon të mos vihen re dhe të mos merret dijeni për shtrenbërimet që po bëheshin në vijën ushtarake të Partisë dhe prej atyre vetë.

Të pranojmë tash për një moment tezën e tyre bajate që thotë «nuk u vumë në dijeni». Po vetë këta nuk nuhatën të paktën gjë fare se ç'po bëhej, kaq «të taposur» paskan qenë në çështjet politike, ideologjike dhe ushtarake? Jo! Unë dhe ju të gjithë, shokë, besojmë se ata s'janë pa përvojë në këto punë. Këta të dy, sikurse thanë disa shokë në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë në Ministrinë e Mbrojtjes, kanë kaluar nëpër

duart e tyre kaq raporte e kaq artikuj të shkruar në revistat ushtarake, ku janë hedhur edhe mendime në kundërshtim të hapët me vijën e Partisë, kanë kaluar nëpër duar, gjithashtu, shumë materiale revizioniste sovjetike. Këta janë përkthyesit dhe shpërndarësit e këtyre materialeve antiparti. Në qoftë se Hito Çakoja dhe Sadik Bektashi na thonë se nuk i kanë parë këto materiale, se nuk i kanë lexuar, atëherë duhet të na përgjigjen: «Ç'kanë bërë që nuk i paskan parë? Me ç'punë tjetër merreshin, kur lanë pas dore detyrën kryesore që u kishte ngarkuar Partia?».

Çështja shtrohet kështu: O këta shokë i panë këto veprime armiqësore, ose nuk i panë. Në rast se i panë, të bëjnë autokritikë, t'i pohojnë dhe të na thonë përse nuk njoftuan dhe përse nuk luftuan kundër tyre deri në fund. Në qoftë se nuk i panë, atëherë të vënë mirë në dukje shkaqet që ua penguan vështrimin. Për të dy rastet ata duhet të bëjnë një autokritikë të thellë, një analizë të thellë, një rishikim të imët të ndërgjegjes së tyre dhe të shokëve përkrah tyre.

Nga diskutimet e zhvilluara kohët e fundit nëpër organizatat-bazë kanë dalë në pah shumë pikëpamje e veprime të tjera armiqësore të Beqir Ballukut, të cilat, gjithashtu, vetëm tani po i thuhen Partisë.

Dy nga tezat reaksionare të shprehura prej tij kanë qenë: «Stërvitjet kanë shpenzime të mëdha» dhe «Tunelet e armët e rënda janë një peshë e madhe për ne». Këto pikëpamje ai nuk i ka thënë asnjëherë haptas në Byronë Politike, as në Qeveri, as në Këshillin e Mbrotjtjes, ato ai i ka lëshuar poshtë e lart gjatë punës dhe janë një shprehje e qartë e armiqësisë dhe e qëndrimit të tij hipokrit, me dy faqe.

Në fakt, po t'i shikosh në sipërfaqe këto dy teza të Beqir Ballukut, duket sikur ai qan hallin e «shpenzimeve të mëdha» që «rëndojnë ekonominë», del, pra, sikur ai na qenkësh një «kursimtar i rrallë», një «ekonomist i kulluar». Por kjo që donte të krijonte ai është vetëm një përshtypje e rreme. Thelbi reaksionar i këtyre ideve dhe veprimeve që përpiqej të kryente Beqir Balluku, qëndron në faktin se ai synonte me çdo mënyrë të dobësonte fuqinë mbrojtëse të vendit. Pikëpamja e tij se «Stërvitja, tunelet dhe armët e rënda duan shpenzime të mëdha», është një shprehje e antitezave që përgatiste ai për t'ua kundërvënë Tezave të Këshillit të Mbrojtjes. Ato kanë brenda helmin e «kotësisë së mbrojtjes», frymën e kapitullimit përpara armiqve imperialistë e revizionistë, disfatizmin e pesimizmin, të cilat janë të tëra me pasoja tepër të rrezikshme për mbrojtjen, sepse, po të zhvillohen, mbjellin demoralizim, çmobilizim e panik në ushtri dhe në kuadrot e saj. Shkurt, këto pikëpamje e veprime të Beqir Ballukut kanë një domethënie të caktuar, sipas të cilës s'ka ç'na duhen stërvitjet dhe tunelet. Po të na sulmojë armiku, sipas tij, ushtria do të vejë në mal! Atëherë, po sipas tij, as armët e rënda nuk ka ç'i duam. Ky tradhtar, pra, ishte për një ushtri të çrregullt, liberale, të pastërvitur dhe të çarmatosur.

Po si mund të ishte e tillë ushtria jonë, kur në të njëjtën kohë armiqtë e saj janë të armatosur gjer në dhëmbë? Jo, këtë nuk e ha as populli, as ushtria jonë. Prandaj ne përgatitemi e do të përgatitemi vazhdimisht. Sa për shpenzimet, nuk ka ekonomie më të mirë se Partia.

Gjatë punës së përditshme Beqir Balluku është ka-

rakterizuar nga koncepte e qëndrime krejt të huaja, të papajtueshme me normat e moralit socialist. Shpesh ai bridhte tërë ditën lart e poshtë dhe u linte porosi var-tësve të tij: «Po pyetën nga lart për mua, u thoni se këtej rrotull jam», «Mos tregoni ku po shkoj, në qoftë se kërkojnë ata të udhëheqjes»! Mjaft shokë të Minis-trisë së Mbrojtjes e dinin mirë se nga shkonte ai, por njeri s'e ngrinte zërin. Ai ishte tej e tëhu për gjah e në ahengje, ai ishte shndërruar, siç na raportojnë tash, në një kulak që shkonte dhe grumbullonte zahiret e dimrit e të beharit. Në vend të punës, Beqir Balluku ndiqte me pasion qejfet, ahengjet, drekat e darkat. Ky njeri, që e hiqte veten sikur e hante meraku për «shpenzimet e mëdha që po bëheshin për mbrojtjen», kur vinte çështja për qejfet e tij, s'donte të dinte fare për lekun e popullit. Interesi personal ka qenë në qendër të vëmendjes së tij.

Shumë shokë në vend që t'i denonconin veprime të tilla, bënëin të kundërtën, krijonin të gjitha kushtet që ky qelepîrxhi «të kënaqej sa më shumë»! Por në të tilla veprime që inkurajonte ai, për fat të keq janë kompro-metuar edhe disa kuadro e komanda repartesh, të cilët jo vetëm merrnin pjesë në ahengjet që zhvilloheshin, por nuk mungonin t'i dërgonin atij rregullisht edhe «shporta të mbushura», t'i mbanin ministrit lopë, dhen, bletë, kuaj apo të rezervonin apartamente posaçërisht për të. Kësaj i thonë «rroftë sebepi dhe oburra të për-fitojmë diçka edhe ne nga pasuria socialiste». Turp t'u vijë atyre shokëve që i kanë lejuar vetes të tilla gjëra!

Për të zhvatur sa më shumë, Beqir Balluku donte që disa lloje shpenzimesh të caktuara të kalonin, gjoja për kontroll më të mirë, jo nga drejtoria përkatëse e dikasterit, por nga sekretari i vet, një njeri matrapaz



dhe servil. Qëllimi ishte që Beqir Balluku të manipulonte, siç manipuloi, financën, të tërhiqte andej të holla sa të donte dhe kur të donte. Ai ishte kthyer në një Esat pashë Toptani i dytë.

Dhe kur bëheshin këto veprime? Pikërisht në një kohë kur Partia fliste me të madhe kundër të tilla shfaqjeve të huaja dhe i kishte ndaluar rreptësisht, veçanërisht në ushtri. Kjo frymë e sëmurë dhe e dënueshme, jo vetëm ushqente servilizmin dhe i shërbente interesit e rehatisë personale të Beqir pashait, por po përhapej gradualisht si pa u kuptuar dhe në disa kuadro të tjerë të ushtrisë, gjë që ishte tepër e rrezikshme. Dhe atyre që përfitonin nga këto qëndrime në dëm të pasurisë socialiste, në vend që të ngriheshin në këmbë dhe të vinin kujën, të ngrinin zërin lart e të thoshin: «Ç'po bëhet kështu?», u vinte mirë dhe nuk mungonin t'i bënin edhe lëvdata Beqir Ballukut, këtij «politikani të shquar», veçse i shquar si Lukulusi<sup>1</sup>.

Me të drejtë lind pyetja: «Fshehurazi i bënte Beqiri këto veprime?». Jo, aspak, ai vepronte në sy të shokëve, të cilët heshtnin dhe i quanin «veprime të rregullta». Bile disa i fërkonin krahët, i ngrinin kultin e personit, derisa pati ndonjë kuadër si Hito Çakoja që arriti t'i thotë Komitetit Qendror se «Shoku Beqir po lodhet, po punon shumë, prandaj duhet ruajtur shëndeti i tij!»! Sa qesharake tingëllojnë tash gjëra të tilla, sa syleshë dhe oportunistë kanë qenë këta shokë!

Beqir Balluku, duke shkuar poshtë e lart nëpër

---

1. Politikan, ushtarak dhe pronar i madh skllëvërisht në Romën e vjetër, që shquhej për luksin e tepruar dhe për ahengjet e mëdha që organizonte.

ahengje, synonte që me një të shtënë të vriste shumë zogj: të bënte qejf për vete me harxhet e popullit, të krijonte përshtypjen, ja «unë jam njeri i thjeshtë popullor, i shkrirë me masat», njëkohësisht me poshtërsitë e tij ai orvatej të diskreditonte të gjithë udhëheqjen.

Mjaft diskutantë në mbledhjet që u bënë në ushtri tregojnë tani se Beqir Ballukut i pëlqente shumë vetja, mbivlerësonte mendimet e tij dhe s'i përfillte fare ato të të tjerëve, ai nënvlerësonte edhe vetë Partinë, merrej shumë me thashetheme, të cilat i nxiste edhe më tej. Shkonte fiu andej e fiu këtej për t'u treguar gjoja operativ. Si ky ka edhe shokë të tjerë që, kur venë në bazë, nuk «shtrojnë gunën» e të mësojnë nga njerëzit e thjeshtë, sepse nuk nisen nga pozitat e nxënësit, por të një mësuesi të rëndomtë. Nga mendjemadhësia e shfrenuar, Beqir Balluku mendonte se, po të jesh në udhëheqje, je «vetë Ali e vetë kadi», që do të thotë se lejohet të bësh çdo gjë, mund të sillesh si të duash.

Me këtë koncept dhe qëndrim mikroborgjez lidhet ngushtë edhe një tipar tjetër negativ që e karakterizonte Beqir Ballukun: arroganca e tij. Ndonjëri, që nuk i kundërshtonte Beqirit ose që ushqente kultin, që sillej me servilizëm apo konformohej me të, mund t'i «shpëronte» arrogancës së tij, ndërsa të tjerët, që s'kishin dhënë prova të tilla, i priste sjellja e ashpër, breshëria e sharjeve dhe e fyerjeve të tij. Aq e theksuar ishte kjo prirje te Beqir Balluku sa që mjaft kuadro në diskutimet e tyre kanë thënë se kur shkonin tek ai për ndonjë punë në zyrë, më përpara pyesnin: «Si e ka sot gjendjen shpirtërore ministri?». Kuptohet që, po të ishte në rregull «gjendja shpirtërore e ministrit» mund

të shkohej në zyrën e tij, në të kundërtën, mjerë ai që guxonte të hynte brenda!

Shumë shokë, që kanë marrë fjalën nëpër mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë, na japin një varg faktesh të qëndrimeve burokratike e liberale të Beqir Ballukut, të cilat, natyrisht, nuk mund të mos kenë lënë gjurmën e vet në punën e Partisë e të komandave në ushtri.

Beqir Balluku nuk merrej me probleme themelore të përgatitjes luftarake, në shumë stërvitje të rëndësishme ai vetë nuk dukej asnjëherë. Gjatë 12 vjetëve nuk shkoi në asnjë stërvitje të njësisë të një rrethi kryesor kufitar. I tillë na del Beqir Balluku, në këtë gradë të ulët kishte arritur degjenerimi i tij dhe tradhtia nuk kishte se si të mos e shoqëronte atë këmba-këmbës dhe të mos e bënte një armik të betuar të popullit, të Partisë, të socializmit.

Beqir Balluku synonte t'i liberalizonte njerëzit. Liberalizmi ishte një nga prirjet e tij të rrezikshme. Duke spekuluar në parimin e drejtë të Partisë për thellimin e vijës së masave, ky armik i mbuluar me fraza të majta e ultra të majta, gjoja për demokratizimin e punës në ushtri, u përpoq të kultivonte liberalizmin në radhët e forcave të armatosura. Shpejt ai i hoqi rregulloret dhe me këtë veprim donte t'i thoshte ushtrisë: «Shthuru, demoralizohu!». Dhe hodhi parullat: «Disiplinën, rregullin, i vë vetë ushtari», «Ndërrimin e rojës e bën vetë ushtari», «Mund të bëhet ushtarak kushdo që do të futet në ushtri» etj., etj. Me fjalë të tjera, sipas tij, s'kanë ç'na duhen rregulloret dhe disiplina proletare. Ky është anarkizëm. Por këtij armiku iu ndal dora.

Ushtria jonë është ushtri e popullit, ushtri e revo-

lucionit. Si e tillë, ajo nuk mund të kuptohet pa disiplinë e pa rregull proletar, pa zbatuar parimet dhe normat e Partisë. Armiqtë do të gëzoheshin shumë, po të na shihnin të shthurur, liberalë, anarkistë, sepse në këtë mënyrë do ta bënin më lehtë punën e tyre. Por ata s'kanë për të na parë kështu kurrën e kurrës.

Karakteristike ishte se Beqir Balluku kërkonte t'i shmangej kontrollit të Partisë. Për këtë qëllim ai bënte përpjekje të vazhdueshme për të vënë Drejtorinë Politike në kundërshtim me Shtabin e Përgjithshëm dhe me grupin e inspektorëve të këtij shtabi. Ai nuk i nënshtrohej disiplinës së Partisë, për të kishte një disiplinë tjetër. Kur donte, ai vinte në mbledhjen e organizatës-bazë, kur s'donte, nuk shkonte. Në mbledhjet e komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes s'ka vajtur asnjëherë. Nuk çante kokën për problemet e Partisë e të komandës që dilnin nga mbledhjet.

Por kujdesi më i madh i Beqir Ballukut ishte t'i shpëtonte kontrollit të Byrosë Politike. Një nga taktikat që ndiqte ai ishte t'ia fshihte Komitetit Qendror dobësitë e punës në ushtri. Ai trembej t'i raportonte Partisë të vërtetën, me të bardha e me të zeza, sepse qe rrezik t'i dilnin të palarat në shesh.

Tendenca e Beqir Ballukut për t'i shpëtuar kontrollit të Partisë nuk shpreh vetëm një mossinqeritet të thjeshtë. Jo, kjo është një nga shfaqjet konkrete të degjenerimit të përgjithshëm të personit të tij. Mos harroni, shokë, se «tezat» e Beqir Ballukut, që ishin antitezat e vijës dhe të politikës së Partisë, ishin rezultati logjik i degjenerimit të tij. Duhet kuptuar se ky degjenerim nuk u bë në një ditë, as në një vit, por është arritur nëpërmjet një procesi të tërë, shkallë-shkallë.

Bëheshin aktive ushtarake e politike të panumërta për rritjen e aftësisë mbrojtëse, për forcimin e gatishmërisë luftarake dhe të vigjilencës revolucionare në ushtri etj., por «sëmundja», që qëndronte e fshehtë, po mahisej. Si anëtar i Byrosë Politike, Beqir Balluku e zhvillonte punën kryesisht në ushtri. Atje i mbolli ai të këqijat e veprës së tij të ndyrë.

Beqir Balluku degjeneroi dalngadalë edhe moralisht. Jeta e tij personale, familjare e shoqërore karakterizohej nga prirja për rehatllëk, nga kërkesat për privilegje dhe nga shturja. Ai degjeneroi si komunist, u borgjezua, u krimb moralisht, bile shumë herë në mënyrë skandaloze. Degjenerimin e tij moral ai e fshih-te me djallëzi nga Partia, duke e mbuluar pas funksioneve që kishte si një udhëheqës kryesor. Shumë njerëz shikonin sjellje dhe qëndrime të tij të padrejta, të paligjshme, por nuk i denoncuan, duke menduar gabim (dhe jashtë mësimeve të Partisë), se të tilla gjëra mund t'i lejohen një udhëheqësi!

Por ky degjenerim s'mund të qëndronte vetëm në fushën e moralit, në kuptimin e gjerë të fjalës, ai patjetër do të zhvillohej, siç u zhvillua, edhe më tej. Degjenerimi i tij borgjez, që nisi nga gjërat e vogla të karakterit moral, çoi si pasojë në degjenerim politik e ideologjik, në batakun revizionist.

Me kalimin e kohës, ky tradhtar i fshehtë, filloi të mendonte se me të ishin jo vetëm titistët dhe revizionistët sovjetikë, por edhe revizionistët kinezë, prandaj u bë «trim» dhe arriti në konkluzionin se na ishte një «njeri i fortë dhe i së ardhmes». Për tradhtarin Beqir Balluku, frikaman, renegat, revizionist dhe borgjez, Partia dhe udhëheqja e saj «s'vlenin një grosh» dhe

«duheshin spastruar me çdo formë», por forma dhe mjetet duheshin përgatitur. Ai u shkëput edhe fizikisht nga udhëheqja dhe merrej me përgatitjen efektive për shkatërrimin e ushtrisë, të Partisë, të shtetit, të ekonomisë etj. Si reaksionar dhe tradhtar, atij filloi t'i punonte mendja<sup>1</sup> si të komplotonte, të intrigonte, të korruptonte e të komprometonte njerëz. Beqir Balluku, duke i bërë llogaritë gabim, shihte ëndrra me sy hapur. Planet që kishte në kokë e bënë atë të mendonte se si t'i vinte minat Partisë, socializmit dhe unitetit tonë. Ai kujtoi se ngjarjet në botë zhvilloheshin në favorin e tij, prandaj Beqir Balluku shpejtoi veprimet dhe ra brenda.

Është e natyrshme që në ushtri të ketë hierarki. Por a duhet që kjo të dobësojë atje rolin udhëheqës të Partisë? Në asnjë mënyrë jo! Por është fakt, se hierarkia ushtarake te ne ka ulur rolin e organizatave-bazë dhe të komiteteve të Partisë, me gjithë riorganizimin që u bë dhe masat<sup>2</sup> e drejta që u morën për të zbatuar në

---

1. Siç doli dhe u dokumentua më vonë, frymëzues i Beqir Ballukut dhe i veprimtarisë së tij puçiste, komplotiste, armiqësore ishte poliagjenti Mehmet Shehu, që luante fijen e komplotit në prapaskenë.

2. Më 4 mars 1966 u mbledh Plenumi i 16-të i KQ të PPSH, i cili mori vendime të rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë, të pushtetit, të Ushtrisë Popullore dhe të gjithë jetës së vendit. Këto vendime iu njoftuan masave me anë të Letrës së Hapur të Komitetit Qendror të PPSH drejtuar komunistëve, punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve të vendit tonë. Për Ushtrinë Popullore u morën këto vendime: heqja e gradave, krijimi i komiteteve të Partisë si organe drejtuese të të gjithë punës së Partisë në njësi, në re-

ushtri norma demokratike dhe proletare. Këto masa kanë qenë dhe janë shpëtimtare për ushtrinë. Po të mos merreshin ato nga Partia, situata në ushtri do të keqësohej.

Janë bërë përparime në çdo drejtim, edhe në forcimin e punës së Partisë në ushtri. Megjithatë, shihni se ç'del gjatë diskutimeve për veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut: vazhdon prepotenca dhe arroganca e disa kuadrove, degjenerimi moral i disa të tjerëve etj. Ka nga ata që sugjeronin se «Komiteti i Partisë i Ministrisë së Mbrojtjes duhet të sillet me takt ndaj drejtoreve, se këta janë «goxha kuadro»! Ndërsa shoku... në diskutimin e tij të tanishëm, arrin deri atje sa të thotë: «Hija e rëndë e Beqir Ballukut, si anëtar i Byrosë Politike e zëvendëskryeministër, e veshur me prepotencën, me arrogancën dhe me hakmarrjen, na kishte bërë të merrnim përsipër edhe fajet e gabimet e tij!» Vaj halli, shokë, në rast se anëtarët e Byrosë Politike do të kenë «hije të rëndë» dhe kuadrot nga frika do të thonë për gjithçka «amin» e do të marrin mbi vete fajet që s'u takojnë. Sa mirë bërë që e pohove këtë gjë, shoku... por a mendon ti të thellohesh edhe në anën tjetër, pse arrite të tregohesh i frikshëm dhe servil? Kur s'ke guxim t'i qëndrosh Beqir Ballukut, duke pasur me vete të drejtën dhe mbështetjen e plotë të Partisë, ku do ta gjesh vallë atë guxim, që të përballosh luftën kundër armikut të brendshëm e të jashtëm, në rast të një sulmi ndaj atdheut tonë socialist? — «Ah, atëherë do të jem

---

parte dhe në institucione ushtarake, si dhe rivendosja e komisarëve politikë në komandat e të gjitha hallkave. (Shih: «PPSH Dokumente Kryesore», vëll. V, f. 23.)

trim, do të më shihni», — mund të na thuash. Jo kështu, shokë! Partia kërkon t'i shohë tani trima anëtarët e saj, që të sigurohet se do të tregohen të tillë edhe nesër e kurdoherë.

Është e çuditshme jo për Beqir Ballukun, por për shokët e tjerë të udhëheqjes të Komandës së Përgjithshme, se si ata nuk ngulën këmbë që raporti i Drejtorisë Operative «Mbi zbatimin e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes» të na dërgohej neve. Një raport të tillë ne po e presim vazhdimisht. Ju, shokë, thoni se po i zbatoni këto Teza, po si i zbatoni? Ka gabime në këtë zbatim? Ka shkelje ose shtrembërime të tyre? Mos vallë mendoni se, kur ka neglizhenca të theksuara në punën politiko-ideologjike të Partisë, ana ushtarake shkon «shkëlqyeshëm», siç keni zakon të flitni me terma të fryrë, që janë mbeturinë e frazeologjisë ushtarake sovjetike? A ia bëni vetes pyetjen: «Pse Beqir Balluku atakoi Tezat e Këshillit të Mbrojtjes?».

Sigurisht, Beqir Balluku shihte se në kuptimin teorik dhe në zbatimin praktik të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, nga ana juaj kishte boshllëqe, kishte zvarritje dhe lëshime, të cilat ai u përpoq t'i shfrytëzonte me qëllim të keq, ndërsa ju ishit në «gjumin e lavdishëm» se nga ana profesionale qëndronit «në lartësinë e duhur».

Ta themi hapur, shokë, ju nuk e kishit sa duhet sensin kritik në shikimin e çështjeve. Por Partia ka kërkuar dhe kërkon nga ju që t'i shikoni ato realisht, me sy shumë kritik, sepse edhe puna juaj është e kontrollueshme, ashtu siç është e kontrollueshme puna e të gjithë kuadrove në të tërë sektorët e tjerë të vendit tonë, por me një ndryshim: ndërsa puna e një inxhinieri



duket nëse është e mirë apo e keqe, sepse lidhet me faktin nëse funksionon apo jo, ta zëmë, hidrocentrali ose kombinati, prova vendimtare e punës suaj do të duket vetëm një herë: kur armiku do të guxojë të na sulmojë. Pra, rezultatet e punës së disave janë me «valë të shkurtra», të disa të tjerëve me «valë të gjata». Dhe ju bëni pjesë në këta të fundit. Të mos punojë një fabrikë, është një gjë që rregullohet, por të humbasësh luftën dhe të të pushtojë armiku atdheun, kjo është katastrofike. Këtë krahasim mos e harroni asnjëherë, veçanërisht ju, shokë ushtarakë, prandaj ndërgjegjja juaj duhet të jetë e lartë, edukimi politiko-ideologjik dhe ai ushtarak duhet të zhvillohen në mënyrë të përpiktë dhe të kontrollohen me rreptësi të madhe.

Kur u diskutua në organizatën-bazë, ku bën pjesë Rahman Perllaku, këtij iu drejtuan pyetje të tilla: «Për këtë gjë, e vure në korent shokun Petrit?», «Shoku Petrit e dinte këtë gjë?», «Kur u vu në korent shoku Petrit?», «Pse nuk fole me shokun Petrit?». Pra, «shoku Petrit» andej, «shoku Petrit» këtej, ai kudo. Asnjë shoku të kësaj organizate nuk i shkoi në mendje ta pyeste Rahmanin: «E ke vënë ti në dijeni për këtë ose për atë çështje komitetin e Partisë të ministrisë ose Komitetin Qendror të Partisë?».

Ndërsa, kur diskutoi Petrit Dumja, midis të tjerash ka thënë se «Rahman Perllaku ka qenë i vetmi në Shtabin e Përgjithshëm dhe në gjithë ushtrinë që i ka mbajtur ison Beqir Ballukut, që ka mbrojtur materialin e tretë të tij, është dashuruar dhe e ka propaganduar atë». Ky pohim ka të vërtetën e vet, por nuk është plotësisht real dhe modest për Petrit Dumen. Kështu, ky përpiket që ta kufizojë këtë problem kaq të mprehtë ve-

tëm në dy persona, prej të cilëve njëri është ustai dhe tjetri çiraku. Kjo do të thotë se idetë dhe veprimet armiqësore të Beqir Ballukut «qëndronin në erë, ishin vetëm një imagjinatë e sëmure», çështja, pra, s'na qenka e rëndësishme dhe nuk është nevoja të veprohet siç po veprojmë për të bërë analiza dhe thellime të mëtejshme!

Më kanë njoftuar se, më vonë, Hito Çakoja dhe Petrit Dumja kanë thënë se «Duhet të thellohem vetëm në zbulimin e punës armiqësore të Beqir Ballukut, të ballafaqojmë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes me antitezat e tij dhe të mos gërmojmë më tej, se mjaft kuadro janë ngatërruar». Domethënë, prapë ta mbulojmë këtë çështje. Ky sugjerim, që u hodh poshtë, nuk bie fare erë partie. Por a nuk është ky mendim kontradiktor me të parin, kur, sipas Petritit, vetëm Rahman Perllaku qenkësh dashuruar me antitezat? Atëherë ç'na duhet ky ballafaqim i Tezave me antitezat? Si shumë i bindur tregohet Petrit Dumja në analizat e tij, që gjoja ka zhvilluar mbi këto çështje, të cilat çalojnë në shumë drejtime. Teknokratizmi i tepruar dhe praktikizmi i ngushtë të pashoqëruar me studime politiko-ideologjike, të çojnë në mendjemadhësi të rrezikshme, në egocentrizëm dhe në një vështrim subjektivist të problemit.

Çështja që po diskutojmë nuk është vetëm një «moment kritik» për Rahman Perllakun, të cilit ti Petrit i the se «Bëre autokritikë, sa për të kaluar rrezikun». Duhet kuptuar se ky ka qenë një rrezik për gjithë Partinë, për ushtrinë dhe për rendin tonë socialist. Pavarësisht se Rahmani ka bërë gabime, nuk është e drejtë ta kufizosh këtë rrezik në dy persona. Kjo do të thotë të minimizosh, të mbulosh një gjendje, që ishte shumë e rrezikshme dhe që nuk u zbulua për shumë vjet me

radhë. Edhe tani që u zbulua sëmundja dhe duhet shëruar plotësisht, ti, Petrit, përsëri hedh mendimin se «Në ushtri s'ka asnjëri që të mendojë, siç mendonte Beqir Balluku». Kjo gjë duhet hetuar me prurëncë dhe në rrugë partie. Partia nuk mund t'i bëjë kurrë të sajat mendimet që shprehen me kapadaillëk dhe me kaq «siguri» pa baza.

Në organizatën-bazë, ku bën pjesë Petrit Dumja, asnjë shok nuk hapi gojën për ta kritikuar atë. Ajo që u tha Petriti shokëve të organizatës-bazë (të cilët as që e rimorën fjalën prapë dhe të korrigjoheshin) se «po më krihni bishtin, që nuk po më kritikoni» etj., nuk ishte aspak e mjaftueshme për zhvillimin e mbledhjes në nivelin e duhur. Një gjë e tillë ngjau, sepse në këtë organizatë-bazë të Partisë, ku militojnë kuadro të rëndësishëm, nuk ekziston një frymë e lartë partie, prandaj atje rrezikshmërinë e çështjes komunistët e shihnin vetëm te Beqir Balluku. Ata mendonin se qëllimet e këtij synonin vetëm Petrit Dumen, se Petriti e demaskoi Beqirin, pra, ky ishte «shpëtimtari i situatës» dhe ne, — thoshin ata, — që jemi në një organizatë-bazë me të, kemi qenë në shenjë të Beqir Ballukut, prandaj të jemi solidarë me Petritin, të cilin s'duhet ta kritikojmë dhe kështu «Një pjesë e lavdisë së tij (Petritit), na takon edhe neve».

Doemos do të ngjiste kështu, kur Petrit Dumja, pas zbulimit të punës armiqësore të Beqir Ballukut, më bëri mua një letër, në të cilën midis të tjerash shkruante: «Këto pikëpamje të Beqir Ballukut nuk kanë influencuar në ushtri!» Kjo nuk është e vërtetë. Pse në një ditë i erdhi në mendje Beqir Ballukut të atakonte dhe të ndryshonte taktikën dhe strategjinë e artit tonë ushta-

rak? Shumë naivë dhe syleshë do të tregoheshim, në rast se do ta gjykonim kështu problemin. Beqir Balluku ka punuar me të gjitha mënyrat që ushtrinë ta infektonte me të këqijat e tij, prandaj bën gabim të madh Petrit Dumja, kur më «siguron» në letrën e tij se Beqir Balluku s'ka pasur në ushtri as influencën më të vogël.

Të mos shkojmë më larg, po le të shohim se Beqir Balluku, në radhë të parë, ka ndikuar tek ti, Petrit. Atëherë merre pak me mend ç'mund të ketë ndikuar ky armik në kuadro të tjerë më të ulët, kur merrte vendime dhe lëshonte udhëzime për interpretimin e çështjeve ushtarake etj. Kjo frymë është përhapur në ushtri për shkak se qe dobësuar vigjilenca. Vigjilenca ka qenë e dobët, jo vetëm para se të zbuloheshin gabimet, por ajo edhe tani, pas zbulimit të tyre, është akoma e tillë. Çështjet duhet të thuhën ashtu siç janë, ndryshe gjendja nuk ndreqet.

Mbledhja e organizatës-bazë të Partisë në Drejtorinë Operative tregoi se komunistët, që bëjnë pjesë në të, nuk u ndalën si duhet në analizën e të metave të tyre, nuk kritikuan shoqi-shoqin për asnjë të metë, nuk nxorën as shkaqet e mungesës së vigjilencës. Pra, roli udhëheqës i kësaj organizate nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Është e shpjegueshme se kjo organizatë nuk mund të ishte në rolin e vërtetë udhëheqës, gjersa aty thuhej nga komunistët se vetëm «Petriti është një ushtarak i zoti» dhe drejtoria është një «drejtori teknike». Këtyre gjërave u duhen gjetur rrënjët, sepse është lehtë të thuash që «Roli i organizatës së Partisë nuk është ndier», por duhet të zbulojmë psenë, pra, shkaqet që nuk është ndier ky rol. Është e qartë se në këtë organizatë

normat e Partisë janë parë në mënyrë formale, atje zotëronte hierarkia e sëmurë, mendjemadhësia, prepotenca, servilizmi etj. Të gjitha këto shfaqje shihen në jetën e shokëve të kësaj organizate, e cila duhet t'i vinte ato në shenjë me forcë me anën e një kritike dhe autokritike të shëndoshë revolucionare. Kjo duhet medoemos të bëhet paskëtaj.

Ju, shokë të kësaj organizate, jeni treguar servilë ndaj Petrit Dumes, kishit kultivuar kultin e tij, duke menduar se «Petriti është një ushtarak i zoti», paçka se ai bënte gabime, të vogla dhe të mëdha. Ju mendonit gjithashtu: «Pse ta kritikojmë atë, ai është goxha kuadrë». Harruat, shokë, se edhe Petrit Dumja ishte përpara organizatës-bazë të Partisë njësoj si edhe ai shoferi komunist. Që nga unë e deri poshtë të tërë jemi ushtarë të Partisë dhe vetëm në shërbim të saj, për të mirën e popullit e të socializmit. Çdo gjë që themi ne, është eksperiencia e Partisë, asaj i takojnë dafinat dhe jo neve, individëve.

Në vështrim të parë duket se këto çështje janë të qarta, por duhet të bëhen akoma më shumë të qarta, pse në realitet nuk janë kuptuar e thelluar si duhet. Kush nuk i kupton drejt parimet e mësipërme, ai ka hyrë në rrugën e lavdisë personale, ka hyrë në rrugën e koncepteve borgjeze për rolin e ushtrisë. Ai që ka hyrë në këtë rrugë, duhet të tregojë garanci se po korrigjohet ose duhet larguar nga ushtria.

Organizata dhe komiteti i Partisë nuk mund të qëndrojnë në bisht e të merren me gjëra të dorës së tretë, me cikërrima, duke menduar se gjërat e mëdha «shihen dhe vendosen jashtë Partisë, nëpër shtabe, në mes udhëheqësve kryesorë individualisht». Shpeshherë

thuhet: «Këtë çështje do ta çojmë në Parti». Por ç'ngjet? Ose thuhet kjo për të frikësuar dikë, ose çohet formalisht dhe diskutohet e vendoset jo si duhet dhe siç është drejt, por si duan «kryesorët».

Në fakt, në ushtri, në udhëheqje nuk ndihet si duhet Partia, por ndihen komandantët, komisarët ose drejtorët. Mirëpo vetëm këta nuk janë as Partia, as ushtria. Kur arrihet të mendohet, siç ka ndodhur me kuadrot e lartë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, se «Problemet e strategjisë dhe të taktikës janë probleme të mëdha teorike, prandaj me këto nuk duhet e nuk mund të merren organizatat-bazë», kjo, praktikisht dhe thjesht, do të thotë që Partinë ta largosh nga udhëheqja e ushtrisë, ushtrisë t'i presësh kokën e t'i shkulësh zemrën dhe të lësh kështu Beqir Ballukun që të merret me strategjinë dhe me taktikën, ta lësh të punojë fshehurazi në dëm të interesave të Partisë e të ushtrisë.

Ku qëndron roli i Partisë në këto veprime, bile nga më kryesoret? Ky rol është reduktuar në slogane e në parulla, që duhet menjëherë të marrin fund dhe çdo gjë të vihet në vend. Partia, me të drejtë, është treguar e durueshme me kuadrot e saj që gabojnë, por edhe durimi ka një kufi. Nuk duhet të pritët që ky kufi të vihet vetëm nga lart, por nga tërë Partia, nga organizata-bazë, nga forumet dhe nga individët veç e veç si komunistë.

Kur e pyetën shokët: «Pse nuk i bëre këto faje të Beqir Ballukut çështje partie?» Hito Çakoja u përgjigj se për këtë material mendonte kështu: «Dale ta shohin një herë këta, specialistët, që janë të zotë, ta shohin komandat e shtabet, pastaj Partia». Ky veprim është tërësisht i gabuar, është revizionist. Po pse është i gabuar

e revizionist? Se kështu Partia mbetet në bisht të situatës. Çështje të thjeshta i quan ti, Hito, këto? Shkoni, pra, tashti në Parti, i diskutoni këto dhe Partia do të të tregojë se çfarë je, do t'i thellojë dhe do të dalë me konkluzione ndaj këtyre mendimeve të tua revizioniste.

Si ti, Hito, ashtu dhe Petriti (për këtë pashë procesverbalet dhe shënimet që kam vetë për mbledhjet e Këshillit të Mbrojtjes të vitit 1966) keni pohuar dhe keni bërë autokritikë se vendimet e marra nga Komiteti Qendror për demokratizimin e ushtrisë, për komandën unike, për gradat etj., në fillim nuk i kuptuat drejt, më pas thatë se i kuptuat. Mirëpo ne vërejmë se edhe tash nuk i keni kuptuar si duhet, derisa nuk e keni të qartë rolin e Partisë në ushtri. Kështu ka edhe shokë të tjerë, të cilët, në valën e parë, kur dolën normat e vendosura, thanë se i pranuan, por koha tregoi se këta i kuptuan ato si një zjarr kashte. Në fakt, disa norma jo vetëm nuk u pranuan, por as nuk u zbatuan. Me keqardhje vërejmë se ka akoma kuadro, natyrisht pa grada (por që jetojnë me nostalgjinë e gradave), që tregohen arrogantë, mendjemëdhenj, prepotentë, hiqen sikur i dinë të gjitha, duan favorizime, duan të respektohen edhe kur nuk e meritojnë. Po kështu ka edhe nga ata që kanë marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare aty nga mbarimi i saj dhe kanë prirje të vihen në një radhë me ata që kanë luftuar qysh në fillim. Ka kuadro të tjerë që nuk kanë treguar ndonjë zotësi të madhe gjatë luftës, megjithatë, përpiqen të hyjnë në radhën e heronjve!

Është e nevojshme të kuptohet thellë se masat që ka marrë Partia për të forcuar e demokratizuar punën në ushtri, duke vendosur normat ushtarake në frymën

e normave të Partisë, në frymën e proletariatit, ishin absolutisht të domosdoshme. Në rast se Partia nuk do të kishte vendosur masa për demokratizimin e jetës së ushtrisë, merreni me mend se si do të zhvillohej situata aktualisht. Prandaj ju them: Rikthehuni në ato materiale, shokë, se keni shumë nevojë t'i ristudioni dhe t'i rifreskoni!

Partia duhet të zhvillojë në rrugën e drejtë kritikën jo vetëm nga lart-poshtë, por sidomos atë nga poshtë-lart, si dhe kritikën paralele. Ndryshe ajo nuk mund të forcohet, nuk do të jetë në rolin e saj drejtues, dhe në këto kushte do të krijohet patjetër «kulti i udhëheqësve». Kjo në ushtri është kështu si po them dhe s'mund të jetë ndryshe. Si rrjedhim, atje të gjitha ndërrimet bëhen për udhëheqësit. Këta, pa pikë thjeshtësie, përpiqen të zënë vendet e para dhe, në rast se ndonjëri prej tyre zemërohet për diçka, «për të fituar davanë», fillon të bëjë autobiografinë, duke i hedhur lule vetes! Mendime e qëndrime partie janë këto, ju lutem? Thjeshtësi proletare i thonë kësaj? Jo, shokë, kjo bie erë e qelbur mikroborgjeze.

Të tërheqin vëmendjen veçanërisht mendimet e shprehura nga shokët e organizatës-bazë të grupit të inspektorëve pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Natyrisht, këta janë shokë të vjetër, shokë të mirë, të luftës dhe me eksperiencë të madhe. Megjithatë diskutimet e tyre të habitin. Ja ç'thonë këta: «Në ministri kishte dy stile pune, dy korrente, po ne i kemi bërë sehir». Të ketë dy korrente në ministri, do të thotë të ketë dy korrente për çështje vije. T'i bësh sehir këto korrente, do të thotë të pranosh dy vija ushtarake, dy stile dhe të lidhësh duart në kundërshtim me mësi-



met e Partisë. Ka qenë vallë kështu, siç thonë shokët e kësaj organizate? A mund të pranohet pastaj se këta vetëm «kanë bërë sehir»? Unë mendoj se një palë kanë qenë me njërin korrent, disa me korrentin tjetër dhe me siguri këta shokë të ashtuquajtur sehirxhinj kanë vënë interesin e ngushtë personal mbi normat dhe mbi interesat e Partisë. E realizojnë këta shokë sa faj i rëndë është një qëndrim i tillë si ky që kanë mbajtur ata përpara Partisë?

Por këta shokë kanë shkuar edhe më tej. Duke e parë përçarjen, ata nuk kanë ndërhyrë për ta zhdukur atë. Shoku ... në këtë organizatë ka thënë: «Ne vinim në kolegjiun, shihnim kundërshtime midis Beqirit dhe Petritit dhe dilnim nga kolegjiuni «të pataksur», ndër-sa poshtë punonim me kokën tonë, në bazë të vijës së Partisë». Domethënë, sipas këtij shoku (i cili nuk merr mundimin të flasë në emër të tij, por flet në numrin shumë, duke thënë «ne»), ushtria nuk paska pasur kokë, por gjithsecili punonte sipas mendjes së tij. Dhe këtë situatë ky shok e quan «vija e Partisë»! Kësaj i thonë: «Rroftë anarkia!». Na «pataksej» ky shok se në kolegjiun të ministrisë kishte kundërshtime dhe mjaftohej vetëm duke «u pataksur»!

Vihet pyetja: Duhet të ketë apo të mos ketë diskutime, kundërshtime e debate për probleme të ndryshme që merren në shqyrtim? Ky shok akoma nuk e paska kuptuar se duhet të marrë pjesë me doemos në debate dhe të luftojë për të kundërshtuar të keqen e për të mbrojtur të mirën, ai ditka vetëm të «patakset». Dhe këtë na e quan vijë partie. Por kjo «pataksje» e tij në vetvete fshih frikën, servilizmin, mungesën e zbatimit të demokracisë proletare në ushtri, nënshkrimin

ndaj normave të vjetra të hierarkisë, të disiplinës e të bindjes pa kushte të vartësit etj., etj. Eh, shoku... , mësimet e Partisë ti dhe mjaft shokë si ti është e qartë se nuk i keni tretur si duhet. Prandaj është e domosdoshme t'i përvisheni punës më mirë me zemër e me ndërgjegje dhe shpreh bindjen se kësaj do t'ia arrini.

Dëshiroj t'i bëj një vërejtje shokut..., i cili ka shprehur në organizatën-bazë mendimin se «Edhe kur thirren shokë në Komitetin Qendror, janë aq shumë persona të pranishëm, sa është vështirë të shfaqin mendime». Po kush të ka ndaluar ty shok të flasësh? Bile prandaj thërriteni në Komitetin Qendror, për të thënë gjithçka. Atëherë, shokët që thirren përse nuk flasin? Drejtoja këtë pyetje vetes dhe mos ia hidh fajin shokëve të Komitetit Qendror! Në qoftë se Hito Çakoja nuk të rregulloi ty një takim me shokun Hysni, ti fare lehtë mund të ngrije receptorin e telefonit dhe të kërkoje vetë takim me shokun Hysni, i cili me siguri, do të të priste menjëherë. Ndodhi një ditë që Beqir Balluku fyu një shok, i cili më mori mua në telefon dhe më kërkoi takim. Unë e prita menjëherë, e dëgjova dhe menjëherë e detyrova Beqir Ballukun të shkonte t'i kërkonte ndjesë për fyerjen që i kishte bërë. Të gjithë ata shokë që kanë çështje dhe mendojnë se këto duhet t'i bisedojnë drejtpërdrejt, qoftë edhe me ne sekretarët, dyert e Komitetit Qendror janë kurdoherë të hapura për ta.

Lexova edhe materialet mbi zhvillimin e mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë në Institutin e Studimeve Ushtarake. Komunistët e këtij institucioni gjykuan se «Autokritika e Ernest Jakovës dhe e Spiro Shalësit nuk ishte e plotë», por, në fakt, po vetë bënë autokri-

tikë? Po, por më të dobët. Thoshin se «S'dinim gjë për materialet e zeza, por kishim dëgjuar se po përgatiteshin» dhe më tej vazhdonin se «Disa ide nga përmbajtja e këtyre materialeve po futeshin në artikuj të ndryshëm» etj. Po si reagonin këta shokë, si «engjëj»? Apo menduan se «Këto punë bëhen si bëhen, i dinë të mëdhenjtë»?!

Është e domosdoshme të shikohet midis të tjerash edhe çështja se kush duhet të punojë në këtë institut, sepse ky nuk mund të jetë më një *refugium peccatorum*, sikurse ka ndodhur deri tani. Jo çdo ushtarak që kalon nga mosha, që s'është më për ushtri, jo çdo ushtarak pensionist e të tjerë duhet të futet në këtë institut «që të mos bëhet i pakënaqur», se «ka luftuar» dhe prandaj u dashka t'i japim titullin «anëtar i institutit»! Është shumë gabim të mendohet dhe të veprohet në këtë mënyrë, shokë. Në Institutin e Studimeve Ushtarake, në qoftë se do ta mbajmë, duhet të venë njerëz të zgjedhur dhe të aftë politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht, të atillë që të jenë në gjendje të punojnë, të prodhojnë dhe të japin në maksimum, në sasi e në cilësi dhe jo «t'i bien buzukut», siç thotë populli, dhe jo të përkthejnë e t'i servirin ushtrisë sonë materialet helm të ushtrisë dhe të partisë revizioniste sovjetike.

Ky institut nuk është krijuar që punonjësit e tij të lexojnë sa për të lexuar libra dhe revista të huaja ushtarake, as për t'u «kselhasur» me kuriozitete, por për t'i shfrytëzuar këto materiale si duhet e në mënyrë kritike, dhe jo t'i futin në ushtri, siç kanë bërë në mënyrë antiparti, por, në radhë të parë, ata duhet të mësonin materialet e Partisë sonë, të ndiqnin e të përpunonin me këmbëngulje artin tonë ushtarak. Kjo do të thotë të

studiosh me kujdes materialet teorike të Partisë, të forcosh, të zhvillosh, të kualifikosh mendimin e njëjtë shkencor të ushtrisë sonë. Të mos mendohet se çdo gjë në mendimin shkencor të ushtrisë sonë ka arritur kulmin dhe nuk ka vend më të ecet më tej. Asnjëri të mos mendojë sikur i njeh të gjitha gjërat, të gjitha dredhitë dhe taktikat ushtarake të armiqve, sikur ne i kemi marrë të tëra masat, sa të arrijmë të themi, siç tha, pa kurrfarë kthjelltësie Hito Çakoja, se «Ne i presim, le të vijnë armiqtë e të na sulmojnë!». Kjo megalomani e sëmurë, është po aq e rrezikshme sa edhe kapitullimi dhe frika e armikut Beqir Balluku.

Përse ekzistojnë te shokët këto boshllëqe lidhur me kuptimin dhe me zbatimin e drejtë të politikës dhe të normave të Partisë? Shkaqet duhet t'i kërkojmë dhe t'i gjejmë në dy drejtime: në punën e dobët të Drejtorisë Politike dhe të kuadrove që merren me punën ideopolitike, si dhe në moskokëçarjen e mjaft kuadrove për t'u thelluar sa duhet në problemet. Sigurisht, sektori politik nuk punon mirë, po pse nuk punon dhe pse nuk lufton ky kundër rutinës e burokratizmit? Pse nuk shpjegohen si duhet problemet dhe normat e Partisë? A do të vazhdojmë të pranojmë ne ekzistencën e këtyre dobësive dhe shfaqjeve të rrezikshme të konformizmit? Deri kur do ta lëmë punën ideologjike të Partisë në plan të dytë e të tretë? Do të jetë shumë e rrezikshme, po të qëndrojmë në këto pozita, shokë.

Partia jonë ka theksuar kurdoherë rëndësinë e madhe që ka puna politike dhe ideologjike në çdo sektor, por sidomos në ushtri. Është gabim të gjykohet, siç bëjnë disa kuadro të ushtrisë, të cilët, duke u nisur nga

koncepte të gabuara thonë: «Ky është ushtarak i mirë nga ana teknike, ky tjetri është njeri politik, bën disa referate». Për ta, i pari është më i miri, më i zoti dhe ky është komandanti, kurse i dyti, punëtori politik, vjen më pas, nga fundi! Ka kuadro që mendojnë se s'ka gjë që shkelen normat e Partisë, njafton që normat ushtarake dhe shtetërore të mos shkelen! Sipas tyre, normat ushtarake nuk shkelen se këto janë diçka ndryshe nga të tjerat, pse për to vepron disiplina, kërkon hesap hierarkia. Këtej lindin mendimet se ana ushtarake në ushtri shkon mirë, paçka se ka shkelje të normave të Partisë dhe se puna politike dhe ideologjike çalon.

Të gjithë komunistët në ushtri, pa përjashtim, duhet ta ndiejnë veten dhe të veprojnë, para së gjithash, si komisarë politikë, në kuptimin që të dinë dhe të zbatojnë me vendosmëri vijën e Partisë. Kjo nuk është detyrë që varet nga cilësitë e personit ose nga fakti nëse e ka apo nuk e ka ai titullin e komisarit politik në organikat e ushtrisë. Asnjë komandant nuk mund të quhet i mirë, pa qenë komisar i mirë politik, asnjë nuk mund t'i kuptojë mirë çështjet ushtarake të ne dhe të veprojnë si duhet në këtë drejtim, pa kuptuar dhe pa zbatuar mirë vijën politike të Partisë, pa u pajisur me ideologjinë revolucionare të saj, marksizëm-leninizmin. Pikërisht se nuk kanë gzykuar kështu shokët e Institutit të Studimeve Ushtarake thonë si pa gjë të keqe se «Në shkrimet dhe në studimet tona ne shikonim vetëm anën profesionale dhe nuk shihnim si duhet atë politiko-ideologjike». Kjo do të thotë të mos qëndrosh në binarët e Partisë, të kesh kuptim të gabuar borgjez për ushtrinë tonë, ta konsiderosh këtë

apolitike, mercenare, që t'i mësosh vetëm zanatin e pushkës e të vrasjes. Kur thuhet se «Kemi parë anën profesionale dhe kemi neglizhuar anën politiko-ideologjike», në këtë rast edhe ana profesionale është neglizhuar.

Kam përshtypjen (dhe kjo jo pa baza) se dokumentet e Partisë sonë në ushtri jo vetëm nga komandantët, por edhe nga punëtorët politikë, lexohen përciptazi, konsiderohen si materiale të thjeshta, si literaturë që «e dimë» dhe jo si materiale ku trajtohen thellë probleme të natyrave të ndryshme, që janë fryt i studimit të ligjeve objektive, në bazë të të cilave bëhet zhvillimi dhe drejtimi i jetës ekonomike, politike dhe ideologjike të vendit. Ose këto materiale shpeshherë studiohen jo me syrin politik dhe ideologjik, pa i marrë gjërat në zhvillimin e tyre dialektik, pa u thelluar në to, pa menduar pse janë thënë ashtu dhe jo ndryshe, cilat kushte ishin kur doli materiali që studiohet, ç'ndryshime pozitive janë bërë, si kanë rrjedhur këto ndryshime, ç'detyra na dalin sot etj., etj. Duhet thënë se ka edhe disa të tjerë që nuk i lexojnë fare materialet e Partisë, duke u nisur nga mendimi shumë i gabuar: «Ç't'i lexoj, ngjarjet unë i kam jetuar!».

Kuadri ushtarak formohet dhe kalitet në kudhrën e madhe që i thonë Parti, në organizatën-bazë të Partisë, në organizatën e bashkimit të rinisë, në ushtri, në stërvitjet e përditshme, në punimet xheniere, në shkolla, në akademi etj. Në të gjitha këto hallka kryhet procesi i edukimit joformal dhe jorutinë, por i edukimit revolucionar, të gjallë dhe krijues të kuadrit. Njerëzit duhen parë në punë e sipër për të kuptuar si i kanë përvetësuar mësimet e Partisë, si i zbatojnë

këto mësimet, ç'aftësi dhe iniciativa të mira tregojnë në punë etj. Kështu del edhe detyra që, përveç mësimet që u japim njerëzve, të mësojmë edhe ne prej tyre. Kur shikon se nxënësi yt po çan përpara, po bën mrekulli, duhet të nxitel ai që të shkojë akoma më përpara. Nuk duhet të tregohesh kryelartë e arrogant ose të inatosesh nga vërejtjet e tij të drejta. Të mos mendohet se duke pranuar vërejtjet e drejta të vartësit ulet dinjiteti i eprorit. Përkundrazi, në rast se nuk vepron si duhet dhe mban qëndrime mospërfillëse ndaj të tjerëve, atëherë nuk mund ta ndjekësh kuadrin në zhvillim, nuk mund t'ia njohësh këtij të mirat dhe dobësitë, që t'ia nxitësh të parat dhe t'ia spastrosh të dytat, nuk mund të kualifikohesh ideologjikisht dhe politikisht.

Vallë është i mjaftueshëm për kuadrot ushtarakë leksioni disa herë i cekët i punëtorëve politikë dhe ushtarakë, që gjoja shpjegojnë një temë të caktuar, në rast se ata, kur përgatiten, nuk mendojnë se kuadri ushtarak duhet të jetë me horizont të gjerë politik, ideologjik dhe ushtarak? A mund ta zgjerojnë horizontin e dijeve të tyre një ose dhjetë tema me përmbajtje të njëjlojtë e të përsëritur çdo vit? Apo mendohet se, meqenëse janë ushtarakë, mjafton të njihen vetëm me mësimet ushtarake? Vallë e kuptojnë shokët se duhen studiuar seriozisht klasikët e marksizëm-leninizmit? Po si mund të studiohen, të përvetësohen e të zbatohen mësimet e marksizëm-leninizmit, kur nuk punohet me këmbëngulje dhe vazhdimisht që secili të zhvillojë kulturën e tij të përgjithshme, kur nuk studiohet historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe e luftërave klasore të proletariatit? Si mund të kuptohet mirë «Kapitali» i Marksit, në qoftë se nuk njihet sadopak his-

toria e lindjes dhe e zhvillimit të shoqërisë kapitaliste, e klasës revolucionare të proletariatit, e imperializmit si faza më e lartë dhe e fundit e kapitalizmit? Si mund të kuptohen parimet ushtarake të zhvilluara në mënyrë aq të shkëlqyer nga Marksi dhe Engelsi, në rast se njerëzit nuk njihen me historinë e popujve, me lëvizjet e tyre për liri dhe pavarësi, me konfliktet që kanë rrjedhur dhe me përfundimet e tyre, nga të cilat Marksi dhe Engelsi kanë bërë deduksione teorike, në të cilat bazohet Partia jonë?

A mund të quhet e mjaftueshme që kuadrove dhe ushtarëve tanë t'u flitet shkarazi për zhvillimin politik, ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit tonë, duke arsyetuar se «Këtë zhvillim ata e shohin çdo ditë»? Është e vërtetë se ata e shikojnë realitetin e zhvillimit tonë, por nuk dinë si duhet bazën teorike dhe ideologjike ku është mbështetur Partia për të arritur këtë zhvillim. Mund të quhet punë e mjaftueshme që një oficer ose ushtar të ndihmohet të dijë, qoftë edhe mirë, vetëm punën e tij të mbyllur speciale, pa i zhvilluar dhe pa i hapur atij horizonte tej kësaj pune?

Jam i bindur që ju do t'u përgjigjeni negativisht këtyre pyetjeve dhe kjo është përgjigjja më e drejtë që mund të jepet në frymë partie. Me të tilla pyetje, që lindin nga analiza e dobësive të punës, mund të zgjatesha shumë. Këto i bëj me qëllim që nëpërmjet tyre të vë në dukje nevojën e madhe që kanë komunistët dhe kuadrot në ushtri për ngritjen e nivelit të tyre ideopolitik e kulturor. Por ç'punë e shëndoshë politiko-ideologjike i thonë asaj, kur në format e edukimit mungojnë drejtorët e Ministrisë së Mbrojtjes? Në tremujorin e parë të këtij viti është realizuar 50 për qind e pro-



gramit dhe në këto forma vetëm 50 për qind e kuadrove kanë marrë pjesë dhe të tërheq vëmendjen se më shumë mungojnë në to kuadrot e lartë. Janë përmendur sidomos emrat e disa kuadrove kryesorë, të cilët gjatë vitit 1972 nuk paskan marrë pjesë fare në këto forma. Sa keq! Si duket, këta shokë nuk kanë nevojë për teorinë e Partisë, pse, po të kishin nevojë, duhet të venin në format e edukimit të saj.

Të mos i gënjejë mendja disa shokë, që kanë formuar bindje të rrezikshme, se «specializimi» i tyre qenka i mjaftueshëm në konceptin e ushtrisë sonë si armë e diktaturës së proletariatit që udhëhiqet nga Partia. Mos mendojnë këta shokë se kanë arritur kulmin e diturisë? Mos vallë Partia për ta po «grin» kot, duke thënë se tërë jetën duhet mësuar dhe punuar? Ç'është kjo kastë «të diturish» që kanë zënë postet e larta dhe kujtojnë se duhet «të japin vetëm urdhra» që t'i zbatojnë të tjerët? Kush po i bën gabimet më të rënda dhe më të rrezikshme? Këto gabime, shokë, më shumë i bëjnë kuadro të lartë. Po kush i merr më parë dënimet dhe kujt i bëhen kritikët më të rënda? Për fat të keq, zakonisht, janë kuadrot më të ulët ata që pësojnë më parë. A mund ta quajmë këtë një frymë partie, frymë revolucionare, frymë proletare? Jo, kurrë s'mund ta quajmë të tillë!

Një prirje tjetër e gabuar në ushtri është ajo që, kur flitet diku për ushtrinë në dokumentet e Partisë, atëherë mendohet se «kjo na intereson» dhe oburra punëtorët politikë përgatitin materiale me fraza stereotipe, sikur të nxirrnin «simite nga furra»! Problemet e tjera nuk u interesojnë aq shumë këtyre shokëve, sepse «ato janë për sektorët jashtë ushtrisë». Mendohet

shumë gabim, shokë! Ushtria nuk është diçka më vete, e izoluar nga jeta, nga sektorët e tjerë të punës në vendin tonë. Thuhet se «Ushtarët dhe oficerët vihen në dijeni për problemet e tjera që e shqetësojnë Partinë», por kjo nuk është aq e vërtetë sa ç'thuhet. Pikërisht ky është një minus i madh që duhet kuptuar e korigjuar me seriozitet.

Kuadrot ushtarakë, aktivë dhe ata rezervistë, është e domosdoshme të kuptojnë se Ushtria jonë Popullore nuk është vetëm ushtri e kazermave, pse ajo përbëhet nga gjithë populli ushtar. Këtej del se nuk lejohet që kuadrot e ushtrisë të qëndrojnë në bisht të kuadrove të terrenit, të cilët, edhe duke prodhuar të mira materiale në industri e në bujqësi, duke punuar në sektorët e tjerë, duke ndërtuar hekurudha, hidrocentrale e vepra nga më të ndryshmet, mësojnë vazhdimisht të përdorin edhe pushkën, mitralozin, raketën dhe mjetet e tjera të luftës. Përse shokët e terrenit duhet t'i dinë problemet e ushtrisë, ndërsa ju, shokë ushtarakë, nuk e quani të nevojshme të njiheni me problemet e tjera të Partisë dhe të pushtetit? Duhet të dish si bëhet ndërtimi socialist i vendit, që të dish pastaj ta mbrosh atë.

Ka shokë që mendojnë se «Ne e kemi çdo gjë të programuar dhe s'na mbetet kohë t'i studiojmë të gjitha materialet e Partisë». Unë u kam pas thënë vazhdimisht Beqir Ballukut dhe Petrit Dumes: I rishikoni programet tuaja, rishikoni kurset dhe leksionet tuaja, rishikoni normat, stilin dhe metodën e punës suaj, pse në dispozicion keni shumë kohë, të cilën është e domosdoshme ta ekonomizoni si duhet. Koha është flori. Për ushtrinë ajo është flori në dy pikëpamje: në vështrimin teorik dhe në atë praktik.

Ushtarët e thjeshtë, që vijnë aktualisht në ushtri, nuk janë më analfabëtë, por me shkollë 8-vjeçare, bile shumë prej tyre dhe me të mesme, ata vijnë nga një organizatë rinie, nga një punë intensive politike në jetë, në shkollë, në familje, në punë e në shoqëri. Ata vijnë tani në ushtri dhe gjejnë si edukatorë kuadro me eksperiencë që kanë mbaruar shkolla e akademi ushtarake etj. Ne, pa marrë parasysh këto ndryshime cilësore, vazhdojmë të ruajmë akoma norma të vjetra për mësimin dhe edukimin politiko-ushtarak të ushtarëve. Atëherë, në këto kushte përse ankohemi se nuk tepron koha? Prandaj, ju rekomandoj dhe, si Komisar e Komandant juaji i Përgjithshëm, ju urdhëroj t'i rishikoni me kujdesin më të madh këto probleme dhe të na dilni me propozime konkrete.

Shumë herë në ushtri, kur analizohen probleme në Parti, ndihet një varfëri ideopolitike; çështjet nuk analizohen thellë e me sy kritik, nuk zbulohen shkaqet e ngjarjeve që zhvillohen. Shihni ç'ngjau me punën armiqësore të Beqir Ballukut? Kjo punë ka vite që ka filluar. Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror u bë, u zhvilluan si në terren dhe në ushtri 4 aktive partie, apo më shumë, u mblodhën posaçërisht dhe diskutuan gjithashtu katër herë organizatat-bazë në terren e në ushtri. Dhe përse? Pikërisht për punën armiqësore të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës me shokët e tyre. Por, gjatë kësaj kohe, paralelisht lulëzonte në kokën e ushtrisë fryma e qelbur antiparti e Beqir Ballukut. Po gjithë ato diskutime që u bënë, zbuluan gjë, a ia hoqën të paktën një çikë petën lakrorit?

Në të gjitha dokumentet e Partisë në ushtri, që bëjnë fjalë për analizën e punës së Beqir Ballukut, as-

njëherë nuk pashë të flitej për punimet dhe raportin e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror, asnjëherë nuk pashë të merrej si udhërrëfyes ky material me vlerë kaq të madhe politike dhe ideologjike, teorike dhe praktike, nuk pashë ndonjë shok që të bënte autokritikë dhe të thoshte: «Ne as i kemi kuptuar, as i kemi zbatuar, por i kemi konsideruar si të huaja për ushtrinë materiale të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror». Ne kemi reflektuar dhe jemi shqetësuar, për arsye se kjo ndodhi nuk është e zakonshme. Po ju, shokë, a keni reflektuar për këtë ndodhi? Mendoj se jo!

Pra, gjatë punimit të materialeve të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të PPSH u duk një fenomen karakteristik jo i shëndoshë: ndërsa në terren u bë një «qilizmë» (relative, por u bë), në ushtri u diskutua si në hava, jo me këmbët në tokë, plugu kaloi përciptazi, atje u zhvillua një punë formale, mbasi gojët nuk u hapën fare ose u hapën për disa kuadro të ulët, për shoferët. Kjo ka qenë shumë e rrezikshme.

Një gjë e tillë tregon se ekzistojnë dobësi në organizatat-bazë të Partisë, në komitetet e Partisë në ushtri dhe në kuadrot e saj. Në këtë situatë, të raportosh se gjendja është e «shkëlqyeshme», do të thotë të fshehësh të vërtetën. Pikërisht këtu e gjeti mbështetjen kryesore Beqir Balluku. Ai tha me veten e tij: «Partia dhe kuadrot nuk po flasin, kjo është një situatë pozitive për mua dhe për punën time», dhe mori kështu guximin për ta vazhduar punën armiqësore. Beqir Balluku mendoi: «Kuadrot e ushtrisë kanë arritur një shkallë korrupsioni dhe komprometimi, prandaj deri diku jam i imunizuar nga kjo anë». Ai mendoi, gjithashtu, se kishte arritur në një gjendje të tillë që një pjesë e kuad-

rove kishin frikë të flitnin kundër tij, një pjesë tjetër ishin me të, të tjerët po i gënjente me demagogji ose u linte të kuptonin sikur gjithçka që po bënte ai, kishte «aprovimin e Byrosë Politike dhe të shokut Enver». Pra, Beqir Balluku kishte arritur në përfundime anti-parti dhe reaksionare. Kjo punë armiqësore vazhdoi të thellohet më tej, prandaj Beqir Balluku kujtoi se kishte ardhur koha që mund të kalonte fare lehtë në një fazë tjetër më të lartë: në atë të hedhjes poshtë të vijës së Partisë në ushtri, të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes etj. Pikërisht në këtë fazë, ky armik, siç thashë më sipër, mendoi se do të kishte edhe ndihmën e jashtme të revizionistëve.

E shikoni si u fryr koka e këtij tradhtari? Beqir Balluku u përpoq të hynte në histori si «njeri i madh, që shpëtoi situatën», por hyri nga dera e pasme si tradhtar i marksizëm-leninizmit, i Partisë, i popullit dhe i revolucionit. Kjo ëndërr e tij i ngjet përrallës së bretkosës që desh të bëhej ka!

Është e qartë se punimet e Plenumit të 4-t u morën sikur nuk i përkitnin ushtrisë, por të tjerëve, sikur ushtria, dhe sidomos kuadrot e lartë të saj, ishin të imunizuar nga ato mbeturina dhe shfaqje të rrezikshme, që vuri në dukje ky Plenum. Mirëpo, prepotenca dhe epërsia, nën maska thjeshtësie dhe «demokracie 'rrogozi», ishin në rendin e ditës në disa kuadro të lartë të ushtrisë. Këta jepnin tonin për të fshehur gabimet. Bile puna kishte arritur deri atje sa që punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes të thoshin: «Kini kujdes nga instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror, se, kur vijnë ata, të nxjerrin lakrat në shesh». Këto që them janë të

hidhura, por, në qoftë se nuk i zbulojmë e nuk i po-hojmë, s'kemi si t'i ndreqim.

Fakti është se, duke punuar materialet e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror në ushtri, nuk dolën në shesh këto kalbësira që u vërtetuan dhe u zbuluan kohët e fundit. Dhe kur ngjau kjo proçkë, shumë kuadro dhe bile të lartë, për t'u shfajësuar, filluan të thonë: «Bëmë shir», «Nuk i dalluam dot»! Kur pyeten: «Po pse nuk i dalluat?», ata përgjigjen: «Gabuam». Dakord që gabuat, shokë, po pse gabuat? Kësaj pyetjeje duhet t'i përgjigjeni deri në fund. Dhe që t'i përgjigjeni deri në fund duhet të keni parasysh një gjë nga më vendimtare: Partia është zemra dhe truri i ushtrisë. Kjo do të thotë se vija e Partisë në të gjithë sferën dhe madhësinë e saj, duhet të hyjë thellë dhe të plekset me të gjitha qelizat e ushtrisë, të zotërojë dhe të udhëheqë ndërgjegjën, mendjen dhe veprimet e njerëzve në ushtri, qofshin këta komunistë ose anëtarë të Bashkimit të Rinisë, ushtarë të thjeshtë apo kuadro.

Ju, shokë të ushtrisë, kuadro politikë dhe ushtarakë, keni një përgjegjësi të madhe. Ju edukoni një ushtri të tërë me një art ushtarak dhe me veti të atilla, që t'i bëjë ballë një prove të madhe, kur kjo të paraqitet. Nuk ju lejohet, pra, të bëni një punë shkel e shko. Duhet të dini dhe ta keni të qartë se një inxhinier i mirë, qoftë edhe shumë i zoti, mund të bëjë një projekt të bukur, por ky projekt duhet të zbatohet. Mirëpo, kur nuk ka zbatues të mirë, punëtorë dhe mjeshtër në radhë të parë, vepra që ndërtohet nuk qëndron në këmbë. Prandaj është e domosdoshme që punëtorët dhe mjeshtërit të përgatiten me kohë e me kujdes që të bëhen të zotë për zbatimin e projekteve. Kështu qëndron e

duhet të qëndrojë puna edhe me kuadrin e ushtrisë. Puna e kuadrit ushtarak nuk është e mjaftë vetëm me mbarimin nga ana e vet të shkollës ose të akademisë ushtarake, me hedhjen në një kartë të vijave, të rrafshëve apo të shigjetave të kuqe, të zeza ose blu, pa përgatitur mirë e në nivelin e duhur ushtarët dhe kuadrot më të ulët që të përballohet furtuna. Oficerët, pra, duhet të mësojnë shumë, të studiojnë vetë, po të mësojnë njëkohësisht edhe të tjerët. Zanati i oficerit nuk është një zanat burokrati. Ai duhet të jetë i lidhur ngushtë me trupën, të jetë i lidhur me eksperiencën e bazës. Teoria e mirë del nga një praktikë e mirë dhe e gjatë, sepse është praktika ajo që vërteton teorinë.

Kuadrot e ushtrisë duhet të jenë krijuar në punën e tyre, të kenë dhe të zhvillojnë imagjinatën. Por një gjë të tillë nuk e lejojnë rutina, burokratizimi, shikimi i bazës nga lart dhe me nënvleftësim. Punën në ushtri nuk e lejojnë të zhvillohet drejt edhe mendimet e gabuara të disave që thonë: «Duhet me qenë i butë me vartësit», ose «Duhet me qenë i rreptë». As njëra, as tjetra s'janë metoda të mira. Kuadri i ushtrisë duhet të veprojë me partishmëri të lartë, të jetë i drejtë, i çiltër, i dashur, i shkueshëm dhe i thjeshtë me ushtarin dhe të stërvitet vazhdimisht bashkë me të. Në këto metoda dhe në këtë praktikë pune e kanë burimin të gjitha parimet e demokratizimit të ushtrisë. Kështu do të kaliten më tepër ushtria jonë dhe kuadrot e saj.

Siç shihet, me mësimin dhe me edukimin pleksen të gjithë faktorët politikë, ideologjikë, ekonomikë dhe ushtarakë. Pikërisht në këto drejtime reale duhet të shtohet vazhdimisht puna e Partisë për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha mundësive të mëdha që ekzi-

stojnë në vendin tonë, për t'i kthyer në realitet këto mundësi, për të ngritur punën ideopolitike, gatishmërinë luftarake dhe përgatitjen ushtarake çdo ditë në një shkallë gjithnjë e më të lartë. Këto janë probleme që duhen kuptuar drejt në tërësi dhe të pashkëputura nga njëra-tjetra, pra, duhet punuar me kujdes, me imtësi dhe me frymë konstruktive për çdo problem veç e veç e për të gjithë në tërësi.

Besoj se në vija të përgjithshme është e qartë rrezikshmëria e punës armiqësore të Beqir Ballukut, këtij rrufjani tjetër politik. Them në vija të përgjithshme, se Partia, veçanërisht në ushtri, duhet të zbulojë dhe të luftojë çdo pjesë, sado e vogël qoftë, të kësaj pune armiqësore. Kjo duhet bërë me durim, me partishmëri, me drejtësi, me qëllim që njerëzit, të cilët kanë gabuar, janë gënjyer dhe s'kanë reflektuar, të ndihmohen, të korrigjohen dhe të shërohen.

Byroja Politike, pa i njohur mirë dhe pa qenë e informuar për shkeljet e bëra, për disa konstatime që kishte i ka kritikuar metodat e punës të Ministrisë së Mbrojtjes. Për këto kritika Beqir Balluku, Hito Çakoja në Drejtorinë Politike dhe Shtatmadhoria nga një anë thoshin «Lepe e peqe», por, nga ana tjetër, vazhdonin të bënin sipas kokës së vet! A mendoni ju, shokë të komitetit të Partisë të ministrisë e të komandës, çfarë alarmi shpëtimtar do t'i ishte dhënë Partisë nga ju, sikur të kishit njoftuar Byronë Politike dhe Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror të Partisë për ato që kishit në zemër?.. Në këto kohë ne akoma nuk i dinim të gjitha poshtërsitë e tij. A e dini ju, shokë, se Byroja Politike i ka kritikuar ashpër dy-tri herë Beqir Ballu-



kun dhe Petrit Dumen për gabimet në punë dhe as njëri, as tjetri nuk thanë një fjalë për të gjitha këto që dolën më vonë?

Kur flasim kështu, nuk kemi për qëllim dhe nuk duam të shkarkojmë veten nga përgjegjësia jonë. Ne kemi përgjegjësi për atë që një anëtar i Byrosë Politike, siç ishte Beqir Balluku, kreu gjithë këto veprime armiqësore, por, me këtë rast, kërkojmë edhe të ndihmohemi. Vigjilenca e udhëheqjes ka shumë nevojë për vigjilencën e tërë Partisë, pa të cilën udhëheqja nuk mund të ecë dhe mund të bëjë gabime, që i kushtojnë shtrenjtë Partisë.

Në këtë drejtim duhet thënë haptazi se organizata e Partisë në ushtri dhe kuadrot e saj nuk e kanë kryer si duhet detyrën e Partisë. Ndryshe do t'i vihej fre veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut. Kur themi se kuadrot ushtarakë nuk e kanë kryer detyrën si duhet, natyrisht, nuk e kemi fjalën për të tërë, se nuk mund dhe nuk duhet të futen të gjithë kuadrot në një thes. Nga rrethi i gjerë i kuadrove, për mendimin tonë, ne përjashtojmë nga përgjegjësia ata nga brigada e poshtë, por jo disa kuadro të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të disa njësive të larta, pse janë këta që mbajnë një përgjegjësi të rëndë, se i shihnin gjërat më nga afër, i njihnin detyrat dhe kompetencat e tyre dhe i dinin ose duhet t'i dinin më mirë normat e Partisë, ligjet dhe rregulloret e ushtrisë. Atëherë këta shokë përse e lanë Beqir Ballukun të bënte tërë këto të këqija? Pse nuk vinin ata në korent organizatën-bazë të Partisë dhe të luftonin me rreptësi deri në Komitetin Qendror edhe përmbi kokën e Beqir Ballukut ose mbi të cilitdo tjetër që thyente këto norma, ligje e rregullore?

Këtë mënyrë revolucionare të menduari dhe të vepruari a nuk e ka diktuar dhe a nuk e dikton çdo orë e çdo ditë Partia, e cila ka theksuar dhe thekson vazhdimisht se të kritikosh drejt udhëheqësit, nuk dëmtohet Partia, përkundrazi, ajo forcohet, kurse kuadri që gabon ose shërohet nga gabimet dhe vazhdon t'i shërbejë me besnikëri Partisë, ose hidhet poshtë si peshk i qelbur. Kur them se duhen kritikuar udhëheqësit kur gabojnë, nuk kam parasysh vetëm ne, kryesorët, po të gjithë, pra, edhe ne, edhe ju e deri në bazë, deri te çdo anëtar i thjeshtë partie, pse çdo komunist është një udhëheqës. Që të gjithë mund të gabojmë. Para kritikës parimore dhe para përgjegjësisë për shkëlqjen e vijës së Partisë jemi të tërë të barabartë. Dënimet që meritojnë ata që gabojnë, varen nga shkalla e rrezikshmërisë dhe e rëndësisë së fajeve që kanë kryer. Në asnjë mënyrë nuk duhet menduar se të gjithë ata që kritikohen se kanë gabuar, kanë tradhtuar. Jo, mjaft prej tyre janë besnikë të Partisë, veçse Partinë, parimet dhe qëllimet e saj ata i kanë parë nga ana sentimentale, disa herë të lidhura ngushtë me interesat vetjakë. Po ta shikosh Partinë nën këtë prizëm të sëmurë, të jesh i bindur se do të bësh gabime, të cilat, po nuk i pe me kohë dhe nuk i ndreqe hapur, me siguri që do të vazhdosh të gabosh më rëndë dhe kështu do t'i bësh dëm Partisë dhe vetes.

Ne duhet të gërmojmë e të thellohem i patjetër, jo vetëm në gabimet e Beqir Ballukut, por në të njëjtën kohë secili të gërmojë edhe në ndërgjegjen e tij, për të parë mirë pse ra në këto gabime, ç'barëra të këqija ka në ndërgjegje. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë analizë, atëherë duhet pranuar se nuk është bërë gjë, se fryma

e qelbur e Beqir Ballukut, që e demaskuam, do të mbetet brenda në ushtri, gjë që përbën një rrezik të madh. Prandaj, të spastrojmë me fshesë të hekurt veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut, të nxjerrim mësim për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë në ushtri.

Kuptohet se kjo është një punë partie, është një punë e komunistëve, të cilët s'duhet të kenë frikë për të thënë haptazi gabimet. Ka komunistë që nuk flasin hapur, por fshehin disa gjëra që shohin te vetja dhe te shoku për shkak se kanë frikë. Dhe kjo fshehje «vishet» me leckë të dobëta, që sot ose nesër koha dhe lufta do t'ua çjerrin edhe më keq. E kemi për detyrë partie që komunistëve të tillë t'ua heqim frikën, t'i spastrojmë, t'i formojmë si trima që të kenë kurajë të bëjnë autokritikë. Këtë Partia e bën për ushtarët e saj, për ushtarët e revolucionit, jo për t'i dënuar, po për t'i ndihmuar, për t'i shpëtuar dhe për t'i ndrequr.

Por edhe vetë komunistët duhet ta bëjnë këtë gjë-nëpërmjet autokritikës së shëndoshë. Ne flasim vazhdimisht për autokritikën. Duhet thënë se komunistët bëjnë autokritikë, ata i njohin ndershmërisht gabimet dhe ndreqen. Kjo situatë e mirë e ka gjallëruar dhe e ka kalitur Partinë. Por dëshiroj të theksoj jo atë që bëhet mirë, por atë që nuk bëhet mirë, pra atë që do të shërbejë jashtëzakonisht që edhe vetë kuadri të lehtësohet krejtësisht nga brenga dhe ankthi që e mendojnë, por t'i shërbejë edhe shokut si mësim. E kam fjalën për zbulimin e shkaqeve të gabimit. Nuk mjafton vetëm të pranosh e të thuash se gabova, por rëndësi të madhe ka që të analizosh dhe të thuash sinqerisht përse gabove. Me këtë rast nuk është e mjaftueshme të thuash vetëm se nuk kuptova manovrat e atij që më-

shtyu në gabim, por duhen përmendur edhe prirjet që ke në ndërgjegje e në karakter, në të cilat kanë gjetur një fushë të lirë kalimi idetë dhe veprimet e gabuara të tjetrit ose të tuat. Kjo analizë, që përmenda, nuk bëhet aq sa duhet dhe ashtu si duhet. Çdo herë, në të gjitha ngjarjet, Partia na e ka theksuar këtë mësim. Këtë po na e thekson ajo përsëri me rastin e dënimit të punës armiqësore të Beqir Ballukut.

Jeta dhe puna e Partisë të ne zhvillohen dhe ecin përpara në bazë të parimeve dhe të normave revolucionare marksiste-leniniste. Po si mund të zbatohen drejt në rrugë partie normat, kur shkohet nga mendimi i gabuar se «I madhi është i plotfuqishëm, ai është i paprekshëm dhe i pakritikueshëm»? Ose a mund të thuhet se zbatohen normat e Partisë, kur mendohet se «Po të kritikoj, po të bëj vërejtje, do të hakmerren mbi mua»? Në qoftë se baza lejon që, për një arsye ose për një tjetër, vërejtjet e drejta të saj t'i marrë era, që kritikën e saj të drejta të kthehen në objekt hakmarrjeje nga të kritikuarit, në qoftë se ajo shikon se disa komitete partie thyejnë dhe shkelin parimet dhe normat e nuk ngre zërin, kjo praktikë është shumë e dëmshme. Baza jo vetëm nuk duhet t'u nënshtrohet këtyre anomalive, por, përkundrazi, ajo duhet të kundërshtojë fort përmbi kokën e cilitdo qoftë, deri lart në Komitetin Qendror të Partisë. Ndryshe lind frika, ndrydhet kritika, fishket autokritika ose kjo armë në duart e Partisë zhvillohet cekët, duke thënë: «Ç'më duhet të hap zemrën, pse t'i them të gjitha ato që kam, do të m'i marrin për keq dhe e pësoj» etj.

Këto që them nuk janë «teorira», shokë, por janë ndodhi reale. A duhet t'i japim ne fund këtyre gjërave?

Medoemos që po! Partia, jo një herë, por një mijë herë na i ka thënë e na i përsërit vazhdimisht. Varet nga ne që t'i kuptojmë dhe t'i zbatojmë drejt këto çështje. Unë do të thosha se i kuptojmë, por nuk i zbatojmë si duhet. Kështu shpjegohen ato shfaqje negative shpirtërore, që ne nuk i zbulojmë dhe nuk i luftojmë vetë. Prandaj, kur s'e bëjmë si duhet vetë këtë, duhet ta bëjnë pa druajtje të tjerët.

Por shumë herë, për të justifikuar mungesën e vigjilencës, thuhet: «Ku di unë ç'ka në zemër shoku». Ky mendim nuk i përgjigjet së vërtetës. Kur ke një shok të afërt, me të cilin jeton, punon e lufton, s'ka se si të mos i njohësh zemrën dhe ndërgjegjen e tij. Shoku që ke pranë do të të shfaqë mendime, dëshira, kënaqësi, hidhërime, guxim, tërheqje etj. Kur është i zgjuar, ai do të tregohet i shkathët në kapjen dhe në arsyeimin e ngjarjeve dhe të fenomeneve të realitetit, do të jetë i matur në vlerësimin dhe në zgjidhjen e problemeve që dalin. Kur është megaloman, s'ka si të mos e heqë veten si njeriu më i ditur, më trimi, më i zgjuari, më i forti. Kur është intrigant do të shfaqë smirën e tij, duke gënjyer e duke mashtruar për të vënë njërin kundër tjetrit. Por, pavarësisht nga marifetet që mund të praktikojë, ai nuk mund të krijojë përshtypjen se në çdo rast dhe për çdo gjë është parimor dhe i drejtë, prirjet e tij të sëmura diku do t'i nxjerrin patjetër «brirët».

Botëkuptimi i njeriut formohet në jetë, në ambientin familjar e shoqëror të tij. Pikëpamjet dhe mendimet nuk lindin bashkë me njeriun, ato zhvillohen nëpërmjet ndeshjes së anëve të kundërta, që vërtetohen në zhvillimin e botës materiale dhe në jetën shoqërore.

Kështu ndeshen mendimet e reja socialiste me pikëpamjet e vjetra borgjeze e revizioniste, zakonet e reja me të vjetrat etj. Në këtë ndeshje të ashpër e reja që lind e rritet e mund të vjetrën që vdes. Por mund të vijë një kohë e përshtatshme që, për shumë arsye të njohura, e keqja e mundur «ringjallet» dhe prandaj kundër saj duhet luftuar përsëri. Këto kontradikta janë shprehje e luftës së klasave që zhvillohet objektivisht brenda dhe jashtë Partisë, e luftës kundër mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve.

Ky proces lufte që vërtetohet në jetën shoqërore brenda ndërgjegjes së individit ose ndërgjegjes së tij dhe asaj të shokut, ose të shokëve që ka pranë, zhvillohet në kohë. Nuk thotë më kot populli: «Koha i provon njerëzit», prandaj nuk është me vend të thuhet: «Nuk e di unë ç'ka në kokë o në zemër një shok», të cilin e njeh për një kohë të gjatë, sepse ke punuar dhe jetuar me të. Edhe për shokun që mund të mos e njohësh personalisht, por që për sjelljet dhe qëndrimin e tij viresh në dijeni nga burime të sigurta, nuk mund të mungosh të japësh një vlerësim të drejtë e të thelluar. Çdo mendim i kundërt nuk është i drejtë, është pa baza teorike partie.

A e realizoni tash ndonjë çikë më mirë, shokë, se puna armiqësore e Beqir Ballukut nuk është aq e thjeshtë dhe e kufizuar në disa materiale ushtarake, të cilat u zbuluan dhe u hodhën poshtë? Përkundrazi, ky ishte një plan i madh politik dhe organizativ, që bluhej në kokën e tij dhe të atyre armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që e frymëzonin atë. Çështja ushtarake ishte mjeti me të cilin ai do të vinte në zbatim puçin dhe komplotin antishtetëror dhe antiparti që

kishte ndër mend të bënte. Prandaj Partia kurdoherë na ka mësuar se nuk duhet ndalur dhe nuk duhet kënaqur, duke thënë se sëmundjes i pashë vetëm «majën e veshit», por të bëhen përpjekje për ta shëruar rrënjësisht nga sëmundja gjithë organizmin.

Ka mjekë që e heqin veten kompetentë, por, kur ndodhen përpara pacientit, e zbulojnë me zor sëmundjen që ka ai. Kur arrijnë ndonjë sukses të pjesshëm, hiqen si klinikistë dhe specialistë të mbaruar. Por në fakt ata janë larg një analize të thellë të sëmundjes dhe të marrjes së masave të menjëhershme dhe efektive, që sëmundja të mos kthehet në një epidemi. Të tillë «mjekë» ka pasur edhe në ushtri kur u zbulua puna armiqësore e Beqir Ballukut.

Partia është dhe duhet të jetë kurdoherë e drejtë me kuadrot, meritat e tyre kurrë të mos i errësojë, por as edhe të metat dhe gabimet të mos ua mbulojë për hir të meritave. Në qoftë se meritat e ndonjë kuadri ngrihen në «majë të gjilpërës», ai do të dëmtohet, do të humbasë thjeshtësinë, do të bëhet mendjemadh dhe, më në fund, në rast se nuk ndreqet, do të dalë nga binarët e Partisë.

Gjatë analizës së punës armiqësore të Beqir Ballukut na ka tërhequr vëmendjen fakti përse dy anëtarë të Komitetit Qendror, njëri nga të cilët edhe kandidat i Byrosë Politike<sup>1</sup>, duke qenë në dijeni të pikëpamjeve të gabuara ushtarake të Beqirit, qysh në vitin 1966 me «teorinë e rrëshqitjes»<sup>2</sup>, nuk erdhën të na vinin në

---

1. Petrit Dumja.

2. Me këtë «teori» puçistët, sipas urdhrave të padronëve të tyre imperialisto-revizionistë, synonin që qysh në sulmin e

korent. Përse ata nuk erdhën as më vonë të na informonin, kur akoma më konkretisht po shikonin se «Beqir Balluku ishte duke përgatitur materiale sekrete anti-parti»? Përse Petrit Dumja dhe Hito Çakoja nuk erdhën të na flitnin as në kohën që i morën vetë në dorë këto materiale, i diskutuan ato dhe, siç na thanë, nuk qenë dakord me përmbajtjen e tyre? Më së fundi, përse nuk na vunë në dijeni akoma më pas, atëherë kur, me gjithë «kundërshtimet» që kishin me Beqir Ballukun, ky ngulte këmbë në përhapjen e materialeve të tij në shokë të tjerë dhe këta qenë «në kundërshtim me to dhe me mënyrën e veprimeve të këtij armiku»?

Përgjigjeve të të gjitha këtyre pyetjeve Petrit Dumja dhe Hito Çakoja i dolën me njëfarë autokritike që s'mund të quhej nga ne as e shëndoshë dhe as e thellë. Ata të dy thanë: «Bëmë gabim», «Kujtuam se shoku Beqir e vinte në korent udhëheqjen, pse ashtu na thoshte mjaft herë». Petriri nga ana e tij kishte frikë se «mos i merrej për keq nga udhëheqja dhe i thuhej prej saj që ai me Beqirin, me gjithë kritikën që u qenë bërë, vazhdonin të grindeshin me njëri-tjetrin për çë-

---

parë të armiqve ndaj vendit tonë të aplikonin «tërheqjen strategjike në male» të forcave tona të armatosura, lënien e bregdetit dhe të qyteteve në duart e agresorëve. Siç u vërtetua më vonë, ky plan strategjik armiqësor që po përgatitnin komplotistët ishte sugjeruar edhe nga Çu En Lai, i cili, si proamerikan që ishte, synonte të zbatoheshin në Shqipëri planet e imperializmit amerikan. Ai i kishte thënë Beqir Ballukut: «Për ju nuk ka strategji tjetër, përveç strategjisë së malit», që, siç shkruan shoku Enver Hoxha në Ditarin e tij Politik, do të thotë: «Ua mbatni këmbëve në male që në ditën e parë të sulmit armik». (Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 124.)



shtje personale». Ndërsa Hito Çakoja përgjigjej: «Kujtonim se këto mendime të gabuara nuk ishin të Beqirit, por të Ernest Jakovës dhe të Spiro Shalësit» etj.

Në këto gjëra «kryesore» vinte rrotull dhe vazhonte të bazohej autokritika e të dy këtyre, duke shkuar me pikëpamjen se «kjo na qenkësh e mjaftueshme dhe shpjegon çdo gjë». Por që të dy u gabuan dhe nuk kanë bindur dot njeri. Në Plenumin e Komitetit Qendror të Korrikut të këtij viti unë i këshillova që të dy që të thelloheshin në gabimin e tyre të madh, pse në atë kohë, në bazë të të dhënave që kishim, nuk donim që të largohej vëmendja nga çështja kryesore, nga tradhtia e Beqir Ballukut. Ne mendonim se, më vonë, pasi të sqarohesh kjo çështje, kur të bëheshin mbledhjet në komandat dhe në organizatat-bazë të Partisë në ushtri, pasi edhe këta të dy vetë, Petrit Dumja me Hito Çakon, të kishin reflektuar më thellë në gabimet e tyre, ata do të kërkonin të vinin dhe të na flitnin sinqerisht për arsytet e vërteta të qëndrimit të tyre. Por asnjëri prej tyre nuk erdhi dhe hala po vazhdojnë të mos e thellojnë autokritikën e tyre. Prandaj gjersa ata nuk po na thonë gjë vetë, detyrohemi që këtë t'ua kërkojmë ne.

Petrit Dumja me Hito Çakon kanë pohuar se kishin parë që «Beqir Balluku po gabonte rëndë». Ata e dinë që gabimet e shokëve, sipas rëndësisë duhet të kritikohen në organizatat-bazë përkatëse dhe në forume. Ata dinë, gjithashtu, se duhet të raportojnë më lart nga eprori i tyre imediat, sidomos kur është puna për një çështje kaq të madhe vije, për të cilën, sikurse kanë pohuar vetë, ishin «në kundërshtim parimor me Beqir

Ballukun». Mirëpo një gjë të tillë ata nuk e bënë. Atëherë me të drejtë vihet pyetja: Përse nuk e bënë?

Petrit Dumja dhe Hito Çakoja takoheshin vazhdimisht me mua, ata takoheshin me shokun Hysni dhe akoma më shpesh me Mehmet Shehun, të cilin e kishim ngarkuar të kujdesej më nga afër për ushtrinë. Atëherë si ndodh që nuk na e zunë në gojë, qoftë edhe një herë të vetme, këtë problem kaq të rëndësishëm dhe të kërkonin ndihmë e zgjidhje nga ne? Mund të qëndrojnë në këmbë përgjigjja e tyre: «Mendonim se ju vinte në korent Beqiri»? Jo. Kjo nuk qëndron! Por, edhe sikur të supozojmë të kundërtën, cila është ajo normë partie që të dy këta, ca më tepër duke qenë vetë në udhëheqje, i pengonte që të na e ngrinin këtë problem, pavarësisht se «mund të na e ngrinte Beqiri»? Jo, nuk ka një normë të tillë, por ka një normë të kundërt: «Çdo gjë, të mirë ose të keqe, të drejtë ose të shtrembër, duhet t'ia thuash Partisë, ta diskutosh dhe, ai që nuk ka të drejtë, të bindet». E dinë këtë normë Petrit Dumja dhe Hito Çakoja? Medoemos që e dinë. Atëherë përse nuk e zbatuan? Ja konkluzionet në të cilat kemi arritur në dritën e të dhënave që kishim:

Konkluzioni i parë: Autokritika e tyre nuk ka qenë e shëndoshë. Ata nuk na kanë thënë arsyen e vërtetë përse e mbajtën të fshehur nga udhëheqja këtë çështje.

Konkluzioni i dytë: Të dy këta ose i panë gabimet e Beqirit, ose nuk i panë, pra, një nga të dyja. Në fillim ato, sikurse është «teoria e rrëshqitjes», mund të mos i kenë quajtur të rrezikshme ose s'i kanë parë fare, ose kanë qenë të një mendimi me të. Më vonë na thanë se i kanë parë, dhe në fakt, i kanë parë, por këtë ne

me pahir ua nxorëm, si të thuash, me darë. Që të dy hiqeshin se «ishin në kundërshtim me antitezat e Beqirit», atëherë përse nuk vunë në korent udhëheqjen kryesore të Partisë?

Nga kjo pyetje logjike del konkluzioni i tretë: **Petriri Dumja dhe Hito Çakoja kishin humbur besimin tek udhëheqja e Partisë dhe veçanërisht tek unë...** Ata dinin se Beqiri përdorte duke e shtrembëruar fjalën time të mbajtur në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror. Mirëpo fakti është se ata heshtën. Petriri me Hiton nuk patën kurajën komuniste të vinin tek unë, të ma shpjgonin çështjen dhe të kërkonin sqarime prej meje. Për të gjitha këto që përmenda, Petriri me Hiton vendosën të heshtnin.

Por, kanë rënë vallë dakord këta me njëri-tjetrin për këto çështje apo jo? Faktet tregojnë se duhet të kenë rënë dakord, ndryshe në mos njëri, tjetri do të na kishte raportuar, të paktën që «Beqiri ka këto dhe këto pikëpamje dhe unë nuk jam dakord me të». As këtë ata s'e bënë. Po përse nuk e bënë? Arsyeja e një qëndrimi të tillë jepet në konkluzionin e tretë të mësipërm.

Petriri me Hiton bashkëpunonin me Beqir Ballukun, që synonte, së pari, në përçarjen e unitetit të udhëheqjes. Duke rënë në këto pozita, heshtja ata do t'i komprometonte, gjë që Beqiri do t'ua përdorte si shantazh. Nuk menduan pak këta se sa më shumë që të heshtnin, aq më tepër dëmtonin Partinë dhe aq më shumë e rrezikshme bëhej çështja?! Pohimin e kundërshtimeve me Beqirin mezi e tha Petriri. Ky pohim atij iu nxor si me darë dhe vetëm kur panë se u kritikua Beqiri për çështjen e «organizimit» të komandës. Atë-

herë, mendoi Petriti, «Hajde ta lëshoj»<sup>1</sup>, ndërsa Hito Çakoja i mbajti atij ison dhe kështu filloi të zbërthehej «Çështja Beqir Balluku».

Petriti është më kurajoz se Hitoja, por që të dy nuk patën as kurajën më të vogël politike që kërkon Partia. Hito Çakoja, ca më keq akoma, sepse është recidivist në këto çështje. Unë mund t'ju them se në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë të vitit 1955, kur u analizua veprimtaria armiqësore e Tuk Jakovës, doli se Hito Çakoja kishte kohë që kishte biseduar me Tukun për ato çështje që u dënua dhe këtë e pati mbajtur fshehurazi nga Partia. E kritikua atëherë rëndë Hito Çakon dhe ai «bëri autokritikë», por, siç shihet, këtë autokritikë të tij e mori era dhe prapë tani, me Beqir Ballukun, ai përsëriti të njëjtin gabim të rrezikshëm.

Hitoja pastaj është edhe oportunist e intrigant. Ai nuk duhet të jetë as shumë i mprehtë. Raportet që na bënte si drejtor i Drejtorisë Politike të ushtrisë ishin të

---

1. Këtu fillon manovra e P. Dumes dhe e H. Çakos: ta digjin B. Ballukun që të shpëtonin kokën, t'i zinin vendin dhe të zhvillonin më tej komplotin e nisur. Faktet dhe dokumentet e mëvonshme vërtetuan se armiku i kamufluar Mehmet Shehu për të shpëtuar veten dhe tërë komplotin, bëri çmos të shpëtonte në atë kohë Petrit Dumen dhe Hito Çakon, të cilëve në Plenumin e 5-të të Komitetit Qendror u tha se «nuk do t'u pritej koka». Ata patën shumë shpresë tek ai, ndaj nuk e dhanë Mehmet Shehun, por ky nuk i shpëtoi dot nga rreziku që të mos dëmtonte veten. Në tërë këtë, ndihmoi edhe armiku tjetër i Partisë dhe i popullit, Kadri Hazbiu, i cili duke qenë ministër i Punëve të Brendshme, siç u zbulua më vonë, nuk thelloi, por mbuloi hetimet e grupit armiqësor në ushtri dhe u transmetoi pjesëtarëve të tij porosinë e M. Shehut që të mos thoshin asgjë më shumë nga ç'thanë në Plenumin e 5-të dhe të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë.

përgjithshme, pa shumë bukë. Me ne luante më shumë rolin e raportuesit të vogël dhe jo për probleme të mëdha. Në raportimet që na bënte s'gjeje kurrë mendime të vendosura të tij. Hitoja, atje ku qe caktuar të punonte, bënte një punë të vogël formale, shabllone e rutinë. Ai i ka pasur të gjitha këto anë negative që po vë në dukje, të cilat nuk kanë munguar të ndikojnë për keq në punën e Partisë në ushtri.

Edhe Petritin në mbledhjet e Byrosë Politike dhe në punë ne e kemi kritikuar për shumë gabime, por e keqja është se i përsërit. Atje ku është caktuar me detyrë Petriti si udhëheqës nuk dallohet për qëndrime të shëndosha partie, përkundrazi, në personin e tij vihet re një frymë e theksuar megalomanie e komandimi, ai bie në sy për një stil pune si diçka «pretoriane». Kjo bëhet më e rrezikshme kur ai përpiket për t'u mbuluar me një modesti false. Edhe Petritit i pëlqenin drekat dhe darkat. Na thonë se «Kudo që vinte, merrte me vete orkestrën me gërneta, shpesh dy kuaj shale e ndiqnin hipur në kamion» etj. Ideologjikisht të tilla qëndrime janë të papajtueshme me mësimet e Partisë. Petriti nuk bën përpjekjet e nevojshme për t'u ngritur në këtë drejtim.

Në ushtri do të ketë dhe ka gabime të tjera, se Beqir Balluku dhe fryma e punës antiparti që ai ka përhapur atje, ka lënë medoemos gjurmë, të cilat ne duhet t'i zbulojmë dhe t'i luftojmë deri në rrënjë. Por nuk është vetëm Beqir Balluku që ka punuar për t'i vënë kazmën ushtrisë. Kohët e fundit udhëheqja e Partisë është vënë në dijeni se Hito Çakoja, ish-drejtor i Drejtorisë Politike të ushtrisë, vite më parë ka marrë libra

sovjetikë politiko-ideologjiko-psikologjikë, botime të vitit 1972, të destinuara «për punën e partisë në ushtrinë revizioniste sovjetike», i ka përkthyer ato dhe ua ka shpërndarë me kapituj komisarëve të reparteve etj., duke kërkuar prej tyre që këtij materiali, të shkruar sipas tij nga «koka të mëdha», t'i bënin disa ndryshime të vogla, pastaj «këto ushqime» të helmatisura t'i adoptonin për punën e Partisë sonë në ushtri. Dhe këta komisarë e kanë bërë këtë punë të dënueshme, pa u thelluar për dëmin e madh që sillte.

Halim Ramohitoja ka thënë se nuk ka pranuar ta përpunonte kapitullin që i dha Hitoja, ndërsa ky, pasi ia kthyen kapitujt në fjalë, të tëra këto i përmbodhi në një libër, i vuri këtij «kësulën» e komisarëve tanë dhe e botoi nën drejtimin e Ilo Priftit.

Përveç materialeve të tjera dhe këtij që përmenda, me urdhër të Hito Çakos, është përkthyer për ushtrinë tonë, në shumë kopje edhe një material tjetër revizionist, botim gjithashtu i vitit 1972 dhe i destinuar për edukimin e komsomolit në ushtrinë sovjetike. Pasi mbaroi përkthimin e këtij materiali tjetër revizionist, katër muaj më parë Hito Çakoja ua përcolli këtë me një letër të firmosur prej tij shefave në Drejtorinë Politike për ta studiuar e për të vendosur që t'i dërgohej organizatës së rinisë të ushtrisë. Ky material, sipas të thënave të disa kuadrove të Drejtorisë Politike të ushtrisë, «nuk u dërgua». Po për ç'arsye? S'ka dyshim se Hito Çakoja u tremb, se ky hap tjetër armiqësor i tij do të zbulonte «poçen e natës me... trëndafila».

Dhe dëgjoni me vëmendje çfarë thotë në mes të tjerash Hito Çakoja në letrën e tij përcjellëse: «Unë e studiova këtë libër dhe më duket interesant për punën

ë rinisë. Ka eksperiencë të madhe pune të përgjithësuar. Ka gjëra që duhen marrë që andej dhe aplikuar në kushtet e punës organizative të rinisë në ushtrinë tonë (duke përfshirë, — dëgjoni, — edhe organizatat e rinisë në strukturat e kohës së luftës)».

Dhe ca më poshtë ai vazhdon: «...për problematikën që ngrihet dhe rrugët që trajton si të punohet, pas dy-tre muajve apo më parë, të organizojmë mbi këtë bazë një aktiv (ose seminar) me përgjegjësit e rinisë, të shikojmë ku jemi ne me këtë çështje në punën e organizatës së rinisë dhe të japim udhëzime e orientime, të ndihmuar edhe nga shënimet e nxjerra nga ky libër se si të punohet në kushtet tona për këto probleme...».

S'ka ku të vejë më qartë, e zezë shkruar mbi të bardhë. Ky njeri fare haptazi punoi për të futur në organizatat e Partisë dhe të rinisë sonë materiale ushtarake dhe ideologjike të huaja dhe këto i konsideronte si «materiale bazë», të cilat, sipas tij, duhet të jenë si «busull dhe peshore e florinjte» për të parë a është e drejtë apo jo vija e Partisë sonë. Me fjalë të tjera, sipas Hito Çakos, materialet teorike të marksizëm-leninizmit dhe të Partisë sonë nuk paskan vlerë, s'janë të drejta, ato e orientojnë në rrugë të gabuar Partinë dhe rininë tonë, prandaj «T'i rishikojmë këto në dritën e materialeve revizioniste» që, sipas tij, na qenkan «Shumë interesante dhe me rëndësi të madhe dhe për këtë ne duhet t'i adoptojmë». Ç'punë armiqësore antiparti prej tradhtari!

Kjo veprimtari nga ana e Hito Çakos, sikurse e shikoni qartë, është e njëjtë, e organizuar dhe e koordinuar me veprimtarinë ushtarake antiparti të kryesuar

nga Beqir Balluku. Të dyja këto zhvilloheshin paralel njëra-tjetrës dhe kishin të njëjtin objektiv. Nga njëra anë goditej prej tyre vija ushtarake e Partisë, nga ana tjetër goditej vija e saj politike dhe ideologjike. Beqir Balluku me të tjerë, në rrugën tradhtare revizioniste, përpiqeshin të shkallmonin nga ana e tyre mbrojtjen e vendit tonë, kurse Hito Çakoja ushqente dhe «edukonte» Partinë në ushtri me idetë e revizionistëve sovjetikë. Kështu Beqir Balluku kishte për objektiv që të dobësonte vendin nga ana ushtarake, në mënyrë që sulmi i mundshëm armik të na gjente të pafuqishëm dhe të na shkatërronte lehtë, ndërsa Hito Çakoja punonte për të demoralizuar organizatën e Partisë, atë të rinisë, gjithë ushtrinë për të përgatitur kështu terrenin që çdo gjë te ne të shpartallohej që në goditjen e parë. Sipas Beqir Ballukut dhe Hito Çakos, ne nuk duhej t'i rezistonim sulmit revizionist, përkundrazi «ta prisnim atë me lule», pse do të ishte «shpëtimtar», meqenëse «shpëtimtare» qenkëshin idetë revizioniste që ata futnin në Partinë dhe në rininë tonë.

Lidhur me këtë, qëllimi armiqësor duket edhe në fjalët e Hito Çakos aty, ku në letrën në fjalë, ai thekson se këto parime revizioniste duhet të futen «duke përfshirë edhe organizatat e rinisë në strukturat e kohës së luftës». E shihni, shokë, sa e qartë që është?!!

Materialet e Beqirit neve na u mbajtën fshehur dhe më në fund na u tha se «U zbuluan dhe u kundërshtuan nga Petriti dhe nga Hitoja». Në fakt, ato nuk u zbuluan nga këta të dy. Edhe kundërshtimi që i bënë të dy Beqir Ballukut nuk ka qenë i shtyrë nga qëllime të partishme dhe parimore.

Hito Çakoja, Petrit Dumja e disa të tjerë, gjitha-



shtu, na e kanë mbajtur të fshehur dhe bile vazhdojnë akoma të na e fshehin veprimtarinë e rrezikshme revizioniste kundër vijës ideologjike dhe politike të Partisë edhe pas zbulimit të veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut. Gojë e këtyre nuk u hapën fare për këto çështje. Përkundrazi, Petrit Dumja e Hito Çakoja u hoqën si «shpëtimtarët e situatës». Punë e dyfishtë armiqësore!

Hito Çakoja, si drejtor politik në ushtri, u thirr nga dy sekretarë të Komitetit Qendror, shokët Hysni Kapo e Ramiz Alia, për të dhënë sqarime për këto çështje, por në këtë takim atij as që i kishte shkuar sadopak ndër mend që t'i fliste Partisë për këtë punë armiqësore të tij. Më pas ai na bëri gjoja një «autokritikë» me shkrim dhe na e dërgoi. Por edhe kjo atij iu kërkua, se vetë as që i kishte shkuar mendja dhe me siguri që nuk do ta bënte. Unë e lexova atë me vëmendje dhe mund t'ju them se e tëra, nga kreu e deri në fund është një mashtrim, një manovër pa kripë për të fshehur fajet e veta të rënda. Në këtë të ashtuquajtur autokritikë Hitoja flet gjoja me «naivitete e me thjeshtësi», por plot dinakëri dhe hipokrizi. Kryesorja për Hito Çakon është se «Fajin e madh e kanë të tjerët, e ka Beqir Balluku që na gënjeu, që na mashtrroi» etj., etj. E dyta, për fajet e tij ai bën përgjegjës Petrit Dumen dhe ushtarakët e tjerë që janë anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë. Pasi i vë «mirë» pikat mbi i, duke i shpërndarë dhe dozuar mbi të tjerët fajet e tij, Hito Çakoja flet pastaj për vete, duke thënë se «ka gabuar», por ka gabuar duke u udhëhequr nga materialet revizioniste sovjetike, të cilat i ka futur në Parti dhe në ushtri me besimin se «bënte mirë», se «kështu genkëshin gjendur dhe kë-

shtu u vazhdua, — sipas tij, — edhe pas vitit 1960», «kështu u aktivizua ai edhe pas vitit 1967 dhe deri dje». Për Hito Çakon kjo ishte «normale», ishte «normë».

Pastaj në të ashtuquajturën autokritikë të tij, Hito Çakoja vazhdon: «Fajin e kemi ne ushtarakët dhe personalisht unë, Hito Çakoja, sepse kemi pasë kryer akademia ushtarake sovjetike, nga të cilat na kishin mbetur plehra revizioniste në kokë dhe plehra të tjera na u shtuan më vonë»...

Pasi thotë këto, ai pastaj i bie fort gjoksit se «Ka ndjekur me besnikëri vijën e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, prandaj ushtria jonë ka arritur, si rrjedhim, rezultate të shkëlqyera, kolosale» etj., etj. . . Dhe, që t'i qëndrojë besnik lojës së tij prej gënjeshtari anti-parti, ai nënvizon sikur «Dje i pa këto gabime, kur ia vunë në dukje shoku Hysni dhe shoku Ramiz». E shihni, shokë, se si ai bën edhe lodrën e budallait?! Po Partia që ka folur tërë jetën, nuk ia paska hapur sytë këtij farë komunisti shtrembanik?

Hito Çakoja erdhi si drejtor i Drejtorisë Politike të ushtrisë, në qoftë se nuk gabohem, aty nga viti 1967. Ja ç'thotë ai në «autokritikën» e tij: «Më 1967, kur dolën Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, filloi një luftë e rreptë kundër pikëpamjeve revizioniste në ushtri» etj. .

E para, në vitin 1967 Hito Çakoja, Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe disa të tjerë nuk filluan luftën kundër revizionizmit, por nisën luftën e rreptë kundër Tezave të Këshillit të Mbrojtjes dhe kjo luftë e tyre shkoi kreshendo, derisa, më në fund, u zbulua qelbësira. Tezat këta i shtypën në 500 kopje dhe vetëm 200 kopje shpërndanë, kurse të tjerat i fshehën në sirtarë,

se gjoja ruanin sekretin. Në gjuhën e vërtetë kjo do të thotë «Të mos marrë dijeni ushtria për të cilën janë hartuar këto Teza». Në të njëjtën kohë në ushtri u futën prej tyre materiale revizioniste dhe kjo ishte «normale», thotë Hito Çakoja. Gjatë kësaj kohe Beqir Balluku punonte për t'i rrëzuar këto Teza, kurse mjaft kuadro në praktikë vepronin pa e ditur sipas pikëpamjeve politike, ideologjike dhe ushtarake revizioniste. Dhe këtë mënyrë pune Hito Çakoja na e quan, dëgjonit shokë, «Luftë të rreptë kundër revizionizmit».

Por ka diçka tjetër akoma më të egër dhe më antiparti që del nga thënia e mësipërme e Hito Çakos. Meqenëse lufta kundër revizionizmit në ushtri, sipas tij, paska filluar në vitin 1967, kur dolën Tezat dhe «pasi kishte ardhur Hito Çakoja si drejtor i Drejtorisë Politike», kjo do të thotë sikur Partia dhe ushtria, deri para kësaj date qenkëshin zhytur në revizionizëm dhe në rrugën e tradhtisë ndaj popullit. Ja, këtë akuzë po i bën ky element antiparti Partisë që luftoi dhe po lufton me një vendosmëri të pashoqe në rrugën marksiste-leniniste.

Po Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, prapa të cilave në mënyrë hipokrite kërkon të fshihet ai, nga kanë dalë, more Hito Çako, nga një vijë e drejtë dhe e lavdishme e Partisë apo nga një llum revizionist? Nga llumi revizionist mund të jesh ti, Hito Çako, dhe jo Tezat. Kë kërkon të mashtrosh kështu ti me këtë, ne? Mos mendon vallë se ne u bindëm, kur ti dhe Petriti u hoqët si «shpëtimtarë të situatës», si «mbrojtësit e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes», si «zbuluesit e punës armiqësore të Beqir Ballukut»? Jo, ne nuk ishim të bindur aspak për një gjë të tillë, por menduam të spas-

trohej një herë plaga e Beqir Ballukut, pastaj Partia duhej të vazhdonte diagnozën e sëmundjes, pse duhe-shin përpunuar të dhënat, shumë gjëra duhej akoma të verifikoheshin dhe më së fundi të merreshin masat që sëmundja të shërohej nga rrënjët.

Mos ke kujtuar dhe vazhdon të kujtosh ti se Partia është syleshe, që mund ta gënjejë lehtë kur të dojë dhe si të dojë një Beqir Balluk, një Petrit Dume, një Hito Çako ose ndonjë tjetër? Sa gaboheni, mor të mjerë! Këto që keni bërë ju nuk janë gabime as të thjeshta, as edhe se i keni bërë rastësisht një herë. Si duket, ju mendoni se, meqenëse e kaluat lumin dy herë më përpara, do ta kalonit atë edhe herën e tretë. Por as herën e parë dhe as të dytën mos pandehni se ia keni hedhur Partisë, ndërsa të tretën apo të katërtën herë nuk ju lejon më njeri që të veproni. Tashmë ju e keni mbushur kupën, prandaj Partia e ka ndër-gjegjen të qetë për qëndrimin ndaj jush, pse shumë herë ajo jua dha dorën, por ju nuk u mbështetët tek ajo.

Realizoni pak, shokë, ç'punë e tmerrshme armiqësore ishte duke u zhvilluar në gjirin e ushtrisë sonë, në gjirin e asaj ushtrie që populli ynë në kaq luftëra, në beteja të përgjakshme e në furtuna të tmerrshme e ndërtoi me aq guxim e vuajtje, që Partia jonë e madhe marksiste-leniniste e mësoi, e edukoi dhe e çoi në fitore. Në këtë ushtri të popullit, që në themelitë e saj ka 28 mijë dëshmorë, në këtë ushtri që me dekada e me dekada po lufton ashtu si gjithë Partia kundër revizionizmit titist dhe atij sovjetik, këta konspiratorë antiparti, Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, janë përpjekur fshehurazi dhe haptazi të futnin në-

përmjet organizatës së Partisë helmin revizionist sovjetik të Iyer me pak sheqer, që ju, shokë të ushtrisë, me një lehtësi të kritikueshme, ta gëlltitnit. Dhe kjo «cipë sheqeri» ishin «betë e rrufetë» që bënëin ata për Partinë, për popullin dhe për citatet e mia. Çfarë pune djallëzore.

Veprimtaria armiqësore revizioniste e Hito Çakos në drejtimin e punës së Partisë në ushtri, sikurse thashë, bëhej hapur: dërgoheshin letra, shtypeshin dhe shpërndaheshin materiale, kurse për udhëheqjen kryesore të Partisë dhe për Këshillin e Mbrojtjes këto gjëra mbaheshin të fshehta. Bile të fshehta u mbajtën këto edhe pas daljes dhe diskutimit të punës armiqësore të Beqir Ballukut, të cilën nuk e zbuloi as Hito Çakoja, as Petrit Dumja, por, dhe kjo duhet njohur ndershmërisht, nuk e zbuluan, për fat të keq, as shumë nga kuadrot e ushtrisë që Hito Çakoja dhe Petrit Dumja i kishin komprometuar.

Ndërsa Beqir Balluku punonte fshehurazi dhe për atë që bënte ju thoshte juve se «është urdhri i shokut Enver», «zhvilloj fjalimet e shokut Enver» dhe ju, shokë, i hanit këto pa reflektuar pak, Hito Çakoja, Petrit Dumja e të tjerë punonin fshehurazi nga udhëheqja e Partisë, kurse para kuadrove me përgjegjësi të ushtrisë vepronin haptazi. Në punën për edukimin e ushtrisë Hito Çakoja rekomandonte pa dorashka tekstet dhe materialet revizioniste si ato që thashë më lart, duke i shoqëruar bile edhe me letër, në të cilën ju thoshte: «Merrni këto helme dhe i sheqerosni». Dhe ju i shoqërosnit ato me citatet e mia dhe me ato të shokëve të tjerë, pa ju bërë kjo punë që kryenit as përshtypjen

më të vogël. Ju bëheshit kështu pa dashur bashkëpunëtorë të disa konspiratorëve.

Prandaj me të drejtë vihet pyetja: Përse këto punë armiqësore në ushtri u zhvilluan me dijeninë e disa kuadrove të lartë, në një kohë që udhëheqjes i janë mbajtur fshehur? Pastaj, kur rrezikshmëria e punës armiqësore të Beqir Ballukut u zbulua, përse nuk ndihmuan ata që të zbuloheshin edhe kjo veprimtari armiqësore shumë e rrezikshme që zhvillonte Hito Çakoja? Përse nuk u fol në aktivet që u bënë për punën e tij të hapët armiqësore dhe nuk iu raportua udhëheqjes? Mirë u tha se «Beqir Balluku i mbajti sekret për një kohë» materialet që po përgatiste, po, kur këto u zbuluan, përse nuk u hapën gojët? Pastaj për punën e hapët armiqësore të Hito Çakos, në mos që kur ky filloi nga ana e tij në këtë rrugë, të paktën kohët e fundit, kur veprimtaria armiqësore e Beqir Ballukut u diskutua kudo, si nuk mori mundimin asnjëri nga kuadrot e ushtrisë për t'ia raportuar udhëheqjes?

Vihet, gjithashtu, pyetja: Kishin dijeni Beqir Balluku dhe Petrit Dumja për veprimet e Hito Çakos? Patjetër që kanë pasur dhe për këtë ata do të pyeten, por fakt është që neve nuk na kanë folur fare për to. Po përse nuk na kanë folur? Ata mund të na përgjigjen me formulën: «Nuk dimë gjë». Mirëpo, sikurse thotë populli, problemi «bën mu». Si është e mundur që Hito Çakoja të mos i vinte në korent Beqir Ballukun dhe Petrit Dumen për materialet revizioniste që sajonte? Si mund të na thotë Petriti «Nuk di gjë» për një material të tillë, kur në anën ushtarake si këto materiale janë futur me barrë? Pastaj këtë material ai e ka pasur në dorë dhe duhet ta ketë lexuar. Atëherë ç'mendim

ka pasur dhe ç'mendim ka për të? Ai duhet të ketë ose mendim të mirë ose mendim të keq. Në qoftë se ka mendim të keq, atëherë përse nuk e denoncoi? Në qoftë se e ka gjetur të mirë, prapë ai është fajtor. Akoma edhe një pyetje tjetër: Idetë e revizionistëve sovjetikë janë adoptuar në edukimin ushtarak të efektivit të ushtrisë sonë? Do të hapen gojët për këtë gjë, apo fjalët për ta sqaruar atë do të nxirren si me darë? Në këtë problem normat e Partisë jo vetëm që janë shkelur, por nga disa kuadro kryesorë në ushtri është thyer krejt vija e Partisë sonë, është bërë një orvatje serioze për të zëvendësuar marksizëm-leninizmin me ideologjinë reaksionare revizioniste.

Krahas kësaj duhet punuar për të shëruar ata kuadro të ushtrisë që këta dy armiq kryesorë i kanë molepsur dhe komprometuar, pse kanë parë tek ata koncepte të gabuara dhe mbeturina të theksuara dhe i kanë shfrytëzuar këto për punën armiqësore që ishin duke zhvilluar.

Pra, Petrit Dumja ishte në dijeni të plotë të këtyre veprimeve. Ai hiqet gjoja si ushtarak, por e njëjta gjë zhvillohej para syve të tij edhe nga ana ushtarake. Dhe këto veprime të dënueshme i fshiheshin udhëheqjes së Partisë. Shumë kuadro të ushtrisë kanë thënë se gjoja Beqir Balluku e paskësh fajin që zhdukte nga raportet kritikën, kurse për fat të keq, edhe puna e tyre ushtarake lë shumë për të dëshiruar.

Këto probleme ne duhet t'i thellojmë me gjakftohtësi, por me vendosmëri.

Shumica prej jush zbatonit me besnikëri udhëzimet e Partisë dhe është kjo që e ka bërë ushtrinë tonë një ushtri të fortë. Është në sajë të punës edukative

politike, ideologjike dhe ushtarake, sipas mësimëve të Partisë sonë dhe në luftë me pikëpamjet revizioniste, titiste dhe sovjetike, që ushtria jonë është kalitur. Mirëpo këta elementë diversionistë, Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, duke zhvilluar në ushtri punën e tyre armiqësore, përpiqeshin që me një gur të vritnin dy zogj: të kribnin ushtrinë dhe të shpartallonin mbrojtjen e vendit dhe këtë e bënë gjoja në emër të Partisë, në emër të Komitetit Qendror. Ata përpiqeshin të diskreditonin te ju vijën e Partisë dhe udhëheqjen e saj, ju thoshin juve, me fjalë të tjera, se «udhëheqja e Partisë mbështetet në vijën ushtarake dhe politike të partisë revizioniste sovjetike». Në fakt, këtë kuptim ka letra shoqëruese e Hito Çakos. Shumica e shokëve të tjerë që nuk e dinin këtë punë diversioniste dhe dinake, merrnin helmin e sheqerosur me citate slogane dhe e hanin si bukë shqiptare. Këta janë të pafajshëm.

A lejohet, shokë, që të zhvillohej një punë e tillë armiqësore nga një grup revizionistësh? Sigurisht që nuk lejohet! Prandaj është koha që të pastrohet thellësisht ndërgjegjja e atyre që kanë bërë faje e gabime, të hidhen tej ambiciet e sëmura personale, egoizmi dhe prirjet për lavdi personale.

Ata shokë që kanë gabuar pa dashur, e duan Partinë dhe popullin, prandaj të kthehen përnjëherësh në rrugën e Partisë dhe të popullit. Por kjo rrugë, duhet të dini, kërkon luftë, kërkon sakrifica e sinqeritet, kërkon drejtësi e vendosmëri komuniste. Askush të mos mendojë se kjo rrugë mund të bëhet me hile. Hileja, gënjeshtria, mashtrimi i kanë këmbët të shkurtra. Prandaj ata që kanë gabuar, me dashje ose pa dashje, me



bindje ose të gënjyer, të mos i harrojnë këto fjalë të urta të popullit.

Është e domosdoshme të bëhet një kthesë në mentalitetin dhe në disa koncepte të gabuara, që duken në disa shokë kryesorë të ushtrisë, sidomos nga ata që kanë mbaruar akademitë e ndryshme ushtarake në Bashkimin Sovjetik. Ju bëtë Luftën Nacionalçlirimtare, u edukuat në këtë luftë nga Partia jonë marksiste-leniniste, me punën dhe me përpjekjet tuaja të palodhura ju keni fituar një eksperiencë të vlefshme dhe Partia si kurdoherë vazhdon e do të vazhdojë t'ju edukojë. Partia ju dërgoi ju në Bashkimin Sovjetik për të mësuar më tej artin luftarak stalinian dhe këtë ju e përvetësuar me zell, por, natyrisht, për ta zbatuar në kushtet e ushtrisë dhe të vendit tonë. Kështu ka bërë dhe vazhdon të bëjë Partia me doktrinën tonë, marksizëm-leninizmin. Ajo e mëson, do ta mësojë vazhdimisht dhe do ta zbatojë atë në kushtet tona, në mënyrë shumë korrekte dhe jo shabllon.

Marksizëm-leninizmi është kundër revizionizmit dhe Partia jonë i qëndron besnike në çdo gjë marksizëm-leninizmit, kurse Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik e tradhtoi atë në çdo gjë, duke përfshirë edhe çështjet ushtarake. Ushtria sovjetike në strategjinë dhe në taktikën e saj, në politikën dhe në ideologjinë e saj, në karakterin, në përdorimin, në sasinë dhe në shumëllojshmërinë e armëve të saj, pas tradhtisë së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, është transformuar në një ushtri agresore, në një ushtri imperialiste, në një ushtri të tipit fashist.

Megjithëse Partia jonë ka vite me radhë që flet për këto katastrofa që kanë ndodhur në Bashkimin Sovje-

tik dhe në ushtrinë e tij, ka akoma disa që këtë nuk e kanë kuptuar si duhet, kurse disa të tjerë si Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja nuk duan ta shohin dhe ta kuptojnë. . .

Disa kuadro të ushtrisë kur pyesin veten se kush i ka pajisur me zotësi politike dhe ushtarake, në vend që të mendojnë: «Mua më bënë të tillë Partia ime, marksizëm-leninizmi, populli im, lufta e popullit tim, eksperiencia e Partisë dhe e popullit», kujtojnë se të tillë i bënë akademitë që kanë mbaruar në Bashkimin Sovjetik. Ky është një mendim i gabuar. Akademitë sovjetike të kohës së Stalinit, ku kanë studiuar shumë nga ju, zënë një vend plotësues në këtë çështje. Por të mendohet se ato janë baza dhe të mohohet eksperiencia jonë, kjo është e papranueshme dhe të çon në qorrsokaqe, të bën të nënvleftësosh Partinë dhe ushtrinë tonë, të bëhesh një megaloman kozmopolit dhe të çon në atë që punën e madhe të Partisë ta quash një «gjë të vogël», «eksperiencë të një lufte partizane» etj., kurse «akademia është akademi». S'ka dyshim se akademitë sovjetike ku nësuan kuadrot tanë vërtet ishin të kohës së Stalinit, mësimet e të cilit për ne janë pjesë e pandarë e marksizëm-leninizmit, por përvoja e luftës së popullit dhe të Partisë sonë nuk duhen nënvlerësuar kurrë. Por duket se disa kuadro akoma nuk kanë marrë vesh dhe nuk kanë realizuar si duhet ç'kanë qenë Hrushovi e Malinovski dhe ç'janë sot Brezhnjevi, Greçkoja, Gorshkovi, Jepishevi e shumë të tjerë banditë si këta. Të gjithë këta janë një klikë tradhtarësh të marksizëm-leninizmit, që tashmë janë kthyer në fashistë dhe në agresorë, ndërsa akademitë dhe shkenca aktuale ushtarake sovjetike, që orientohen prej tyre, kanë mba-

ruar prej kohësh të jenë staliniane. Përkundrazi, ato ka vite që janë transformuar në institucione antimarksisiste, hitleriane, armike të marksizëm-leninizmit.

Atëherë a nuk është një punë e thellë armiqësore që materiale revizioniste të merren dhe t'u jepen si ushqim kuadrove dhe ushtrisë sonë? Për këtë shkencë kemi nevojë ne? Për këtë eksperiencë kemi nevojë ne? Por ne me këtë shkencë dhe me këtë eksperiencë ka kohë që po luftojmë dhëmb për dhëmb dhe duhet të vazhdojmë të luftojmë deri në fund me të gjitha forcat tona. Dhe, që të luftojmë me sukses, më parë duhet t'i kemi të qarta parimet e Partisë sonë për ushtrinë, pastaj të kemi besim të plotë në të dhe shkencës revizioniste sovjetike t'i kundërvëmë shkencën marksiste-leniniste të Partisë sonë mbi artin dhe strategjinë ushtarake.

Të informohesh mbi taktikën dhe mbi strategjinë e armiqve (dhe këta armiq për ne nuk janë një, por janë shumë), nuk do të thotë aspak që ato t'i adoptosh dhe t'i futësh në ushtrinë tënde. Qëllimi i kësaj pune duhet të jetë gjetja e pikave të dobëta të kësaj taktike dhe të kësaj strategjie dhe pas kësaj të bëhen përpjekje për t'i luftuar dhe për t'i dërrmuar armiqtë. Këto janë dy gjëra që nuk duhen përzier me njëra-tjetrën. Prandaj, duke abuzuar në atë që është thënë se kuadrot e ushtrisë sonë duhet të njihen me qëllimet e armikut, lypset të mos fshihen orvatjet mashtruese për futjen e «kalit të Trojës» në ushtri, sikurse ka bërë Hito Çakojë. Kjo është një orvatje që nuk mund të mbetet pa u zbuluar dhe pa u dënuar rreptësisht nga Partia.

Prandaj të mos mbyllim sytë, të mos shkojmë me ëndrra, shokë, duke menduar se armiku nuk punon

në ushtri. As të mos mendojmë se ushtria është e imunizuar nga puna armiqësore. Përkundrazi, ta kemi shumë të qartë se armiku, qoftë ai i jashtmi, qoftë armiku i brendshëm, më shumë se kudo punon në drejtim të ushtrisë. Të mos shkojmë gjithashtu me mendimin se kuadrot e ushtrisë, për arsye se janë ushtarakë, se kanë bërë luftën, qenkan «të imunizuar e të pamposhtur përpara propagandës së armikut dhe janë të spastruar nga komplekset e mbeturinave mikroborgjeze të strukura në ndërgjegjen e njerëzve», se atëherë do të gabojmë rëndë. Sikurse na del, këto mbeturina disa herë mund të jenë edhe më të theksuara tek ata, pse kujdesin dhe estimën që kanë Partia dhe populli për ushtrinë, ka edhe ndonjë kuadër ushtarak që përpigjet t'i përvetësojë si të vetat dhe bëhet «gjel» sikur çdo gjë e di ai, sikur atij i lejohet çdo gjë, sikur është vetëm ai që «do të shpëtojë atdheun» në kohë rreziku, kurse të tjerët jo.

Rregulloret ushtarake, në rast se nuk kuptohen dhe nuk zbatohen në rrugë dhe në frymë partie, me siguri që e frenojnë dhe në fakt e kanë frenuar deri diku zbatimin me rreptësi të normave të Partisë, sikurse janë disiplina, kritika, autokritika etj.

Organizatat e Partisë të ushtrisë duhet të jenë luftarake, sepse ato përgatiten për kohë lufte. Mirëpo ato përgatiten jo vetëm për kohë lufte, por me qëllim që qysh tani të jenë revolucionare e luftarake, pse në fakt vazhdimisht në luftë jemi. Shokët e Partisë në ushtri të mos i harrojnë kurrë këto mësimë, ose jo t'i dinë e t'i zbatojnë ato në mënyrë të përciptë, por t'i kenë kurdoherë parasysh dhe t'i zbatojnë në thellësi me një përgjegjësi të lartë revolucionare, marksiste-leniniste, para Partisë, popullit e atdheut.

Letra<sup>1</sup> e Komitetit Qendror të Partisë po punohet. Sigurisht, si në organizatat-bazë, ashtu edhe në mbledhjet e ndryshme që janë bërë e vazhdojnë të bëhen, është duke u dënuar ashpër veprimtaria tradhtare e Beqir Ballukut, por në ushtri duhet punuar me këmbëngulje për t'u spastruar rrënjësisht fryma që kishte lejuar të zhvillohej kjo punë e sëmurë dhe me këtë nuk kuptoj vetëm materialet e shkruara nga Beqir Balluku dhe të gjitha ato që kanë bërë Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, por edhe atë që bënë këta për të përgatitur në ushtri terrenin për mbjelljen e ideve revizioniste.

Në këtë drejtim, si kurdoherë, është e domosdoshme dhe jetike që, në frymë të shëndoshë partie, me guxim revolucionar marksist-leninist, sikurse na ka mësuar vazhdimisht Partia, të përdoret drejt arma shpëtimtare e autokritikës dhe e kritikës. Pa bërë secili më parë spastrimin e vetvetes, nuk mund të luftojë si duhet dhe në mënyrë të efektshme kundër të metave e gabimeve të tjerëve. Gjithashtu, po të mendohet se, duke mos e kritikuar drejt, objektivisht, ashpër dhe kur duhet shokun që gabon, dhe duke e marrë këtë në «mbrojtje», ne kemi ruajtur kështu Partinë, ushtrinë dhe shtetin e diktaturës së proletariatit nga armiku, atëherë gabojmë rëndë, sepse armiku do të na mbetet brenda. Duke vepruar në të kundërtën, ne ruajmë të pastra radhët tona, armiku mbetet jashtë dhe Partia, ushtria, pushteti dhe të tjerat forcohen, kaliten vazhdimisht dhe bëhen të pathyeshme.

E theksoj këtë se është e çuditshme cektësia, që vihet re te disa shokë, për këto çështje të mëdha që

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 115.

kanë ngjarë në ushtri. Kjo është një cektësi e palejueshme. «Beqir Balluku i ka fajet» thonë ata. Mirëpo të tjerët nuk paskan fajet? Gojët për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje nuk hapen dhe si duket ekziston mendimi: «Të mos i japim shokët!», gjë që do të thotë t'i mbajmë fshehur gabimet, të mos ia themi Partisë gabimet dhe fajet që ata kanë bërë. Po kush është Partia? Përgjigjja është në majë të gjuhës nga ana e shokëve të tillë: «Partia është mëma jonë e lavdishme» etj., etj. Po atëherë «kësaj mëme të lavdishme përse ia fsheh fajet, përse nuk i flet hapur?», «Epo ja, gabim!- thonë dhe me kaq mbyllet «autokritika» e tyre.

Disa prej këtyre shokëve që janë ndikuar nga puna armiqësore në ushtri vijnë rrotull shprehjeve si: «Na është thënë që materialet e armikut duhet t'i njohësh që t'i luftosh, mirëpo neve ja, «na shkau koka e zigjit» dhe këto materiale i futëm në Parti dhe në ushtri, ashtu sikurse i merrnim, pa u thelluar», «Gabim është, gabim» thonë dhe me kaq i japin fund së ashtuquajturës autokritikë të tyre. Dhe ata mund të vazhdojnë të shprehen në këtë mënyrë për një numër fajesh të kryera prej tyre, duke menduar lehtë se fundja «ndonjë hata nuk u bë», pavarësisht se mësimet e Partisë nuk mësohen, nuk analizohen dhe nuk zbatohen për vite e vite me radhë.

Shumë shokë e vënë kështu çështjen: «Ne jemi me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, kurse ata ishin kundër Tezave». Çështja nuk mund të vihet në këtë mënyrë, se është gabim. Tezat e Këshillit të Mbrojtjes janë një pjesë e vijës së Partisë, prandaj çështja duhet të vihet më drejt dhe në mënyrë të prerë me këta njerëz: «Jeni apo nuk jeni ju me vijën e Partisë?». Për të mos folur

për Hito Çakon, të thuash sikurse pohon Petrit Dumja se «Jam me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes», nuk është aspak e mjaftueshme, prandaj i bëj atij pyetjet: «Po Instituti i Studimeve Ushtarake, që përkthen dhe furnizon ushtrinë me helm, është me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes? Nga kush varet dhe kush e kontrollon këtë institut? Mos vallë mendon ti Petrit se zbaton vijën e Partisë, kur me fjalë na «siguron» se zbaton Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, por në fakt shumë veprime të palejueshme ndodhin edhe në stërvitjet ushtarake? A mendon ti se Tezat nuk janë në kundërshtim me të tilla veprime dhe me shumë gjëra të tjera të papëlqyera që Partia po i zbulon dhe do t'i shërojë?».

Punët në praktikë dhe vija e Partisë, shokë, janë të lidhura ngushtë dhe të pazgjydhshme nga njëra-tjetra... Kështu siç kanë vepruar Petrit Dumja e Hito Çakoja nuk është aspak në rrugën e Partisë. Po të lejojmë të veprohet ashtu siç mendonin ata, do të dëmtonim rëndë çështjen e popullit, Partinë dhe ushtrinë, do të sakrifikonim idealet e mëdha dhe intefesin e përgjithshëm.

Unë u bëj thirrje nga ana e Partisë, nga ana e Byrosë Politike dhe nga ana ime disa shokëve që të largohen sa më parë nga këto pozita të gabuara dhe të rrezikshme që nuk janë në rrugën e Partisë. Rruga e Partisë është rruga e drejtë e analizave marksiste-leniniste, është rruga e gjykimit me gjakftohtësi dhe objektivitet për problemet dhe për njerëzit, është rruga e zgjidhjeve të drejta dhe e shërimit rrënjësor të gabimeve dhe të atyre njerëzve që gabojnë, është rruga e edukimit të të gjithëve dhe këto gabime të na bëhen

mësime dhe të mos i përsëritim më. Këtë e kërkojnë interesat e lartë të Partisë, të popullit, të atdheut.

Prandaj, të ngrihet në këmbë organizata e Partisë në ushtri, të ngrihen në këmbë komunistët, kadro dhe ushtarë dhe, si revolucionarë, duke analizuar thellë këtë veprimtari të rrezikshme që ishte duke u zhvilluar, të bëjnë në frymë dhe në rrugë partie qilizmë, të spastrojnë nga rrënjët çdo kalbësirë, në çdo qoshe që këto të jenë struktur. Vetëm kështu do t'i shpëtojmë ne Partinë dhe ushtrinë, do t'i kalitim ato, do t'i bëjmë të pathyeshme dhe nuk do të lejojmë në asnjë rast që armiku të marrë në anën e vet asnjërin nga kuadrot tanë.

Shokë,

Nga të gjitha sa thamë më sipër dalin një varg konkluzionesh. Dëshiroj të theksoj tani disa prej tyre, që t'i kemi parasysh në luftën që do të bëjmë të gjithë së bashku për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë në ushtri.

Partia ka krijuar një ushtri të fuqishme, misioni i së cilës është që, bashkë me tërë popullin ushtar, të mbrojë atdheun e vet socialist, diktaturën e proletariaut, fitoret e revolucionit. Në përmbushjen e kësaj detyre të lartë ne udhëhiqemi nga doktrina jonë ushtarake marksiste-leniniste që përfaqësohet nga Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, në themel të të cilave është vija e Partisë. Prandaj kuptimi teorik dhe zbatimi praktik i këtyre Tezave siguron udhëheqjen e drejtë të Partisë në edukimin revolucionar të ushtrisë për mbrojtjen e atdheut nga çdo sulm armik, nga çdo anë dhe në çdo kohë që ai mund të vijë.



Tezat e Këshillit të Mbrojtjes kanë një rëndësi të madhe politiko-ideologjike dhe ushtarake. Baza politiko-ideologjike e këtyre Tezave qëndron në parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, në vijën e drejtë dhe në eksperiencën e më shumë se tri dekadave të Partisë sonë të përpunuara në mënyrë krijuese në kushtet e Shqipërisë. Baza ushtarake e tyre qëndron në konceptet për strategjinë dhe për taktikën që përmban Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore. Tezat e Këshillit të Mbrojtjes janë rezultatet e një eksperience të tërë të Ushtrisë sonë Popullore, duke përfshirë edhe Luftën Nacionalçlirimtare.

Përpunimi teorik i Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, i vijës ushtarake, i vijës së mbrojtjes, është vepër e Partisë, e Komitetit të saj Qendror. Këto Teza kanë një përmbajtje të thellë e të gjerë dhe përfshijnë tërësinë e problemeve të Artit Ushtarak Popullor: strategjinë e përgjithshme ushtarake, artin operativ, taktikën e përgjithshme ushtarake, strategjinë dhe taktikën e luftës partizane.

Për këto arsye Tezat e Këshillit të Mbrojtjes duhet të bëhen ushqimi i gjithë ushtrisë — i ushtarëve dhe i kuadrove. Me qëllim që të kuptohen drejt e thellë këto Teza është e domosdoshme të rishikohen të gjitha programet e edukimit politiko-ushtarak, të gjitha leksionet dhe referatet e përgatitura. Të tërhiqet menjëherë çdo material i mëparshëm për këto çështje, jo vetëm porsa vërehet që është i gabuar, por edhe kur është përpunuar dobët. Të rishikohen rrënjësisht dhe të spastrohen materialet që kanë dalë nga Instituti i Studimeve Ushtarake. Çdo gjë në ushtri të bazohet në vijën e përgjithshme të Partisë dhe veçanërisht në

Tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Tezat duhet të shpjegohen shkencërisht, duke u trajtuar në tërësinë e tyre politike, ideologjike dhe ushtarake.

Gjithë stërvitja ushtarake, në teori dhe në praktikë, me kuadrot e trupave të çdo arme, me ushtarakët e zyrave e të komandave, me pedagogët, me studentët dhe me nxënësit e shkollave ushtarake, me të gjithë, duhet të zhvillohet e lidhur ngushtë dhe në bazë të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes.

Asgjë të mos i shpëtojë vijës së Partisë. Politika dhe pushka duhet të shpjegohen thellë politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht. Parullat që përdoren kanë një domethënie teorike. Pikërisht kjo duhet zbuluar e duhet shpjeguar dhe jo të qëndrohet në sipërfaqen e tyre dhe të përdoren ato si slogane, gjë që lejon shtrembërime, devijime, keqinterpretime, siç ka ndodhur aktualisht në kuptimin e shumë problemeve aktuale kapitale të ushtrisë. Beqir Balluku, ish-anëtar i Byrosë Politike dhe ish-ministër i Mbrojtjes Popullore, në jetën dhe në punën e tij ushtarake nuk i ka mbrojtur dhe nuk i ka vënë në zbatim Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, sepse me antitezat e tij, ai ishte kundër këtyre Tezave. Prandaj, çdo gjë duhet vënë drejt në vend, me seriozitetin më të madh dhe me përgjegjësi të plotë.

Është e nevojshme dhe e domosdoshme që kuadrot e ushtrisë të kuptojnë se puna armiqësore e Beqir Ballukut, puna e dobët e Shtatmadhorisë dhe e Drejtorisë Politike kanë lënë gjurmë në stërvitjen ushtarake dhe në edukimin ideopolitik të ushtrisë. Në këtë drejtim ata duhet të gërmojnë në praktikë që këto dobësi të korrigjohen e të zhduken pa frikë, pa hezitime dhe pa marrë parasysh se cenohet «krenaria» apo «personal-

teti» i njërit ose i tjetrit, në punën e të cilit janë vërtetuar dobësi dhe gabime.

Nuk mund të jemi të kënaqur me një punë, e cila paraqitet e mirë në përgjithësi, por në pjesët e saj përbërëse ka të meta të theksuara të veçanta. Nuk mund ta quajmë ne një njësi të ushtrisë të stërvitur dhe të edukuar mirë, kur puna e saj matet vetëm me rezultatin në qitje. Mund të qitësh mirë në shenjë, dhe kështu duhet, por ky tregues nuk është gjithçka. Kur nuk «qit» mirë edhe në drejtimet e tjera që kanë të bëjnë me edukimin politik e ideologjik, me strategjinë, me taktikën dhe me qëndrimet e njerëzve në praktikë, kjo do të thotë se jo çdo gjë shkon mirë, prandaj në këtë rast duhet dhënë alarmi.

Mungesa e gjendjes së alarmit nga ana juaj tregon vetëkënaqësi, qetësi. Mirëpo qetësia juaj, shokë, ta themi haptazi, na ka shqetësuar. Shihnim gabime, shkelje discipline e mungesa të tjera, i kritikoni ato, po shumë prej tyre na fshiheshin. E kujt i fshiheshin? Partisë! Ne kërkojmë që edhe fëmija të mësohet t'i tregojë prindit të vërtetën për gabimin që bën. Po i rrituri, njeriu i pjekur, komunisti, kuadri nuk duhet t'ia thotë të vërtetën nënës së tij të madhe e të urtë, Partisë? Kjo punë s'është kryer kështu kurdoherë në ushtri, shokë, prandaj s'duhet të përsëritet kurrë më!

Eksperienca na tregoi se organizimi aktual i punës politike dhe puna e zhvilluar gjer tani nga Drejtoria Politike e Ushtrisë Popullore janë të pamjaftueshme dhe të dobëta. Me gjithë këshillimet dhe rekomandimet e vazhdueshme, lidhjet e Drejtorisë Politike me aparatën e Komitetit Qendror deri tani, siç dihet, kanë qenë formale, të çala dhe të reduktuara vetëm me drejtorin po-

litik, Hito Çakon, i cili, në fakt, na ka gënjyer. E tërë kjo punë e Drejtorisë Politike binte erë të fortë burokratizmi, formalizmi e teknokratizmi. Megjithëse Drejtoria Politike shihej si gjithë sektorët e tjerë të aparatit të Komitetit Qendror, ajo gati nuk kishte asnjë lidhje me këta sektorë, bile as me sektorët e agjitacionit e të propagandës dhe me ata të organizimit, duke qëndruar kështu krejt e veçuar në «kullën e fildishtë» për punën e saj gjoja të posaçme ushtarake.

Edhe nga aparati i Komitetit Qendror s'bëhej gati asnjë kontroll i frytshëm partie në ushtri. Nuk është kontrolluar si kuptoheshin dhe si zbatoheshin detyrat që caktonte Partia për ushtrinë. Edhe lidhjet e organizatave të Partisë në reparte me komitetet e Partisë të rretheve ishin thuajse të paqena. Shokët e ushtrisë s'janë afruar as në derë, pavarësisht se komandanti ose komisar i korpusit apo ndonjë shok tjetër ushtarak zgjidhej në plenumin e komitetit të Partisë të rrethit ose në byronë e tij. Siç duket, ky organizim, kjo ndihmë dhe ky kontroll nga ana e Partisë nuk janë të mjaftueshëm.

Ushtria duhet të jetë nën drejtimin e Partisë, jo në kuptimin formal e sentimental, por efektivisht, jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht. Përveç forcimit të punës së Partisë në ushtri, duhet të vendosen dhe të forcohen lidhje konkrete pune, kontrolli dhe ndihme nga komitetet e Partisë të rretheve dhe nga aparatet e tyre. Kjo nuk duhet të mbetet një çështje vetëm parimore ose dëshirë fakultative, por të bëhet realisht.

Është e vërtetë se puna e ushtrisë është një punë e veçantë dhe sekrete, por asgjë sekrete nuk mund të ketë për Partinë, për komitetin e Partisë të rrethit, që

është shtabi kryesor drejtues në rreth. Sekretet e planeve operative duhet t'i njohin vetëm ata udhëheqës, të cilëve u takon t'i dinë, sepse këto plane janë konspirative. Por me edukimin e shumanshëm të ushtrisë, të kuadrove dhe të ushtarëve, duhet të merren gjithë shokët e ushtrisë dhe të terrenit. Ose, punimet xhenciere të mbrojtjes bëhen nga ushtria dhe nga populli, pra, asgjë të veçantë dhe të fshehtë nuk ka dhe nuk mund të ketë në këtë drejtim. Kështu që pretendimi për ta quajtur Ushtrinë tonë Popullore si diçka krejt «të izoluar», sepse ka një «punë speciale» dhe «shumë sekrete», nuk mund të qëndrojë në këmbë.

Çdo sektor pune në ushtri, në terren e kudo në vendin tonë ka të veçantën dhe sekretin e vet, që duhet të ruhet, por kjo nuk do të thotë se mund t'i fshihet gjë Partisë, e cila drejton. Kështu edhe ushtria ka specifikën dhe sekretet e saj, që, natyrisht, duhet t'i kemi parasysh dhe t'i ruajmë, por gjithmonë nën drejtimin dhe sipas rrugës së drejtë të Partisë.

Ushtria ka dhe ruan organizimin dhe drejtimin e vet në rrugë shtetërore dhe në rrugë partie, por për t'i forcuar më shumë këtë organizim dhe drejtim, është e domosdoshme që ajo të mbajë lidhje efektive me Partinë dhe me pushtetin në bazë. Bashkërendimi më i mirë i detyrave ushtri-pushtet dhe Parti-ushtri në bazë, do ta fuqizojë më tepër punën në ushtri dhe në terren. Të metat në këtë drejtim duhen ndrequr sa më parë me masa dhe forma organizative, me metoda dhe me stil revolucionar pune, brenda normave të Partisë, në bazë të problemeve që shtrohen para ushtrisë. Prandaj këtë problem ne duhet ta studiojmë dhe të marrim masa për të rivendosur vartësi të reja më të përshtatsh-

me nga ato që kemi sot. Për këtë qëllim t'i dilet sa më parë me propozime konkrete Komitetit Qendror të Partisë.

Ushtria jonë të karakterizohet kurdoherë nga disiplina proletare në frymën e vendimeve të Komitetit Qendror. Kjo disiplinë, absolutisht e domosdoshme, të jetë e rreptë jo vetëm për ushtarët, por, në radhë të parë, për oficerët. Për këtë qëllim ju duhet t'u riktheheni e të studioni imtësisht të gjitha materialet e Komitetit Qendror të Partisë që trajtojnë këtë çështje, duke i bërë kësaj një zberthim rrënjësor, politik, ideologjik dhe filozofik.

Detyrat që caktohen për ushtrinë duhet të përshkohen fund e krye nga fryma e partishmërisë së lartë proletare. Kjo do të thotë që detyrat politike dhe ideologjike në ushtri të mos jenë asnjëherë të shkëputura nga detyrat ushtarake. Kjo do të thotë, gjithashtu, që komitetet e Partisë të jenë në krye të marrjes së vendimeve, të cilat të zbatohen rreptësisht nga komandantët, komisarët dhe nga shefat e shtabeve. Asnjë nga këto detyra të marra në një formë të tillë nuk mund të shuajë ose të dobësojë përgjegjësinë e gjithsecilit në funksionet që i janë caktuar dhe as iniciativën krijuese gjatë zbatimit të detyrave. Kush nuk i kupton dhe nuk i zbaton kështu detyrat, ai nuk e kupton dhe nuk e zbaton drejt parimin që Partia është në udhëheqje të ushtrisë. Llogari për zbatimin e detyrave dhe të normave të Partisë e të ushtrisë duhet t'u kërkohet me rreptësi si oficerëve, edhe ushtarëve, pse të gjithë, pa përjashtim, janë përgjegjës.

Në ushtri duhet të zotërojë dashuria proletare në mes ushtarëve dhe kuadrove. Kuadrot e lartë të jenë

kurdoherë të thjeshtë dhe të mbajnë marrëdhënie të drejta me kuadrot e ulët, të kenë respektin më të madh për ta. Përjashtohet çdo privilegj. Askujt, ushtar apo oficer qoftë, anëtar partie ose anëtar i Bashkimit të Rinisë, nuk i lejohej të mos ngrejë zërin kundër abuzimeve dhe padrejtësive që shikon. Ndaj atyre që do të hakmerren ose që do të përpiqen të mbytin kritikën dhe autokritikën Partia duhet të godasë fort dhe pa hezitim.

Partia kërkon që në ushtrinë tonë të vendoset kudo dhe kurdoherë rregull, disiplinë proletare dhe kontroll i rreptë për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e pasurisë socialiste ushtarake. Çdo abuzim që do të vërtetohet, sado i vogël qoftë, të bëhet problem dhe fajtori të çohet menjëherë në gjyq e të largohet nga ushtria.

Për mbajtjen e Ushtrisë sonë Popullore Partia dhe shteti bëjnë sakrifica të mëdha. Ushtarakët e të gjitha niveleve bëjnë përpjekje që ta mbajnë ushtrinë kurdoherë të gatshme për të kryer plotësisht misionin e lartë që i është ngarkuar, por kuadrot e ushtrisë të mos mendojnë sikur janë vetëm ata që bëjnë një punë të lodhshme. Janë mijëra e mijëra kuadro të tjerë që çajnë malet dhe bëjnë sakrifica të mëdha familjare dhe shoqërore për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Prandaj prej kuadrove ushtarakë kërkohet një patriotizëm i zjarrtë komunist dhe një thjeshtësi e madhe proletare.

Çdo shfaqje e mendjemadhësisë, e arrogancës dhe e prepotencës në radhët e ushtrisë duhet të luftohet me ashpërsi. Një luftë e tillë forcon unitetin ushtarak dhe eliminon nga gjiri i ushtrisë të gjithë ata që orvaten të futin në të pikëpamjet e një ushtrie borgjeze. Partia duhet të punojë me ngulm që të vijë në radhët

e kuadrove të ushtrisë një numër i madh elementësh të rinj, bij punëtorësh, fshatarësh dhe intelektualësh popullorë, të cilët ta konsiderojnë edukimin e tyre për të qenë kuadro të rinj të ushtrisë një nder të madh dhe një detyrë të lartë fisnike.

Më së fundi, për të mos u zgjatur, ju rekomandoj, shokë, të gjithëve, që të ristudiohen thellësisht e me kujdes nga ju tërë materialet e Partisë dhe jo vetëm ato që kanë të bëjnë me ushtrinë, por edhe gjithë materialet e tjera, që deri tani i keni neglizhuar. Edhe në përmbajtjen e kësaj bisede, e cila pasqyron pikëpamjet e Byrosë Politike, ju kërkoi të thelloheni, me qëllim që të ndihmoheni në përmirësimin e mëtejshëm të punës suaj.

Që prej spastrimit të elementëve titistë nga ushtria dhe demaskimit të veprimtarisë armiqësore të grupit titist, në ushtrinë tonë nuk ka pasur shfaqje armiqësore, ku të paktën të ishin komplikuar shumë kuadro, sepse veprimtari armiqësore individësh si Panajot Plaku, Teme Sejkoja e të tjerë ka pasur, po këta janë gjykuar dhe dënuar. Drejtësia popullore nuk ka vërtetuar që të jenë ndërlikuar të tjerë në këto punë armiqësore. Në ushtrinë tonë çdo gjë ishte e qetë, bile «shumë e qetë», derisa u zbulua çështja e Beqir Ballukut dhe e bashkëpunëtorëve të tij.

Por duhet njohur se Partia, Komiteti Qendror dhe Qeveria nuk kanë qenë shumë vigjilentë dhe nuk e kanë parë kurdoherë me një sy kritik gjithë punën që bëhej në ushtri. Ne «e kemi pasë fjetur mendjen», si të thuash, dhe këtu kemi gabuar!

... Në ushtri ndodhnin ngjarje të jashtëzakonshme që kishin karaktere të ndryshme. Disa na thuheshin dhe



ne jepnim udhëzime, urdhëronim si të punohej për t'i zhdukur ato dhe për të shëruar njerëzit. Nga kuadrot kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes në raste të tilla na thuhej: «Si urdhëron, do të marrim masa menjëherë», bile na thuhej dhe që më parë se «masat ishin marrë». Mirëpo shumë ngjarje nuk na thuheshin, na fshiheshin dhe kjo është e kuptueshme; qëllimi ishte që ne të mos merrnim pasqyrën e vërtetë të punës së tyre në ushtri, të mos shihnim dobësitë e tyre, që të vazhdohej të thuhej se «Ushtria jonë është në gjendje të shkëlqyeshme», se «Ajo stërvitet në mënyrë të shkëlqyeshme» dhe, pra, «Mbrojtja e atdheut është e shkëlqyeshme dhe e çeliktë». Kuadrot kryesorë, me të cilët ne kishim kontakt, natyrisht, donin të na hidhnin hi syve me thëniet e tyre: «Mos u shqetësoni, ushtria është në duar të sigurt, jemi kompetentë të mëdhenj ushtarakë dhe politikë, çdo gjë e njohim, e dimë» etj.

Vallë i hanim ne këto thënie të tyre? E drejta është se jo të gjitha. Ne drejtpërdrejt komandantë repartesh dhe njësisish nuk qenë, por më vigjilentë dhe më të rreptë duhet të ishim në kërkimin e llogarisë, më mirë e më thellë duhet t'i vlerësonim ngjarjet që ndodhnin në ushtri dhe që na vinin në vesh. Ne duhet të kishim organizuar edhe kontrole me punëtorë partie jo të ushtrisë, me të deleguar të Komitetit Qendror dhe të komiteteve të Partisë të rretheve.

Një praktikë e këthillë ka bërë që ushtria të jetë konsideruar nga kuadrot e saj si «një kështjellë e mbyllur» që të tjerët nuk duhet të futin hundët në të, pse ata mendonin: «Ne jemi plotësisht të mjaftueshëm, bile, po të jetë e mundur, t'u japim mësim edhe të tjerëve».

Gjendja që ishte krijuar pati ngjallur një vetëkënaqësi të tepruar në kuadrot e ushtrisë, ajo nxiti dhe zhvilloi në disa prej tyre, sidomos tek të mëdhenjtë, megalomaninë, prepotencën, bajraktarizmin. Respekti, dashuria dhe kujdesi i Partisë për ushtrinë u përdor prej këtyre kuadrove si një atu<sup>1</sup> për kapardisjen e tyre. Parulla «Ushtria-garancia», që thotë populli, ka qenë dhe është e drejtë, por disa kuadro që kishin huqet që zura në gojë, nuk ishin «garancia», ata abuzonin në këtë respekt, dashuri dhe kujdes të Partisë dhe të popullit.

Ushtria, me organizimin e saj, është ndarë me të vërtetë në reparte, por me të drejtë Partia vazhdimisht dhe me forcë ka theksuar se «duhet luftuar shpirti i repartit». Kjo frazë është një sintezë me kuptim ideologjik, politik, ushtarak, taktik dhe strategjik. E keni marrë ndonjëherë mundimin ju, Hito Çako dhe Petrit Dume, që të shihni se çfarë fshihet prapa kësaj fraze? E keni analizuar, e keni zbërthyer, ua keni shpjeguar oficerëve dhe ushtarëve se ç'do të thotë ajo, apo ishte më lehtë për ju që t'i jepnit ushtrisë sonë «psikologjinë revizioniste sovjetike», që ushtari ynë të dijë se si vepron kjo «psikologji në trurin e njeriut, në materien e bardhë dhe në materien si në hi»? Jo, juve as që ju ka shkuar ndonjëherë në mendje një gjë e tillë, megjithëse e hasnit çdo ditë në jetën e ushtrisë. Përkundrazi, nëpër repartet «fshiheshin gabimet, që të mos u dilte nami i keq», «nuk jepeshin shokët» me qëllim që «të ruhej fama e repartit dhe e ushtrisë», në përgjithësi lustroseshin gjërat në repart, që ky «të merrte notë të mirë»

---

1. Atu — këtu në kuptimin letër e mirë (në lojën me letra).

dhe nuk bëhej vazhdimisht si duhej koordinimi i armëve të ndryshme në veprim.

Po pse ngjishnin këto? Nuk ka materiale të Partisë për këto gjëra? Apo ushtria nuk ka eksperiencën për të bërë jo një studim e një referat, por libra të tërë? Atëherë përse nuk i bëtë? Ti, Halim Ramohito, në autokritikën që na ke dërguar, na vë në dukje se gjatë 5 vjetëve me radhë ke shkruar gjithsej 150-200 faqe material. Je lodhur shumë! 30 faqe në vit për një zëvendës drejtor të Drejtorisë Politike të ushtrisë, nga të cilat hiq nja njëzet faqe artikuj të përgjithshëm, nuk janë hiçgjë për zëvendësimin e direktivave të Partisë, për përgjithësimin e eksperiencës së madhe të ushtrisë. Por vallë nga kush pret ushtria jonë për t'u edukuar? Kur ju keni krijuar atje vakuumin, natyrisht, këtë vakuum e ka plotësuar literatura politiko-ushtarake e huaj revizioniste. Na thuaj pastaj sa të duash ti se e paske kundërshtuar Hito Çakon, kur ai fuste këto materiale në ushtri!

Elementë të tillë dallaveraxhinj si Hito Çakoja lënë gjithashtu të kuptojnë se «Mirë, xhanëm, ne bëme gabim, po këta libra ne ia kemi dërguar edhe aparatit të Komitetit Qendror, pse nuk i pa ai dhe të na ndalon-te»? Ti, Hito Çako, shpif, nuk e bën dot ortak aparatit e Komitetit Qendror për qelbësirat e tua! Ti këta libra i ke përkthyer dhe i ke shtypur, pa pyetur dhe pa marrë mendimin e kurrkujt jashtë komandës së ushtrisë. Në ta ti ke lënë të kuptohet sikur autorët e tyre janë kuadrot tanë, s'ke shënuar fare se këto janë përkthime ose adoptime të këtij apo të atij libri sovjetik. Bile tani që po i kontrollojmë këto botime, shohim se në

mënyrë false dhe shumë të dënueshme ti, për të mos thënë se kështu kanë thënë Brezhnjevi, Suslovi, ose ndonjë renegat tjetër, ke vënë në to sikur kam thënë unë këtë ose atë gjë! Dhe këta libra, si hileqar që je, ti ua ke dërguar jo vetëm aparateve, po edhe të gjithë neve, pikërisht me qëllim që, kur të zbulohet ndotësia, të lehtësoje fajin tënd të rëndë. Po këtë shantazh tëndin s'e ha Partia jonë dhe kjo ndotësi nuk na spërkat dot as ne, as shumicën dërrmuese të kuadrove të ushtrisë sonë që është mashtruar nga ju.

Shokë të dashur të ushtrisë, ruhuni nga të tilla veprime keqbërëse të armiqve të fshehtë! Ata, për të fshehur përgjegjësinë e tyre, duan të komprometojnë sa më shumë nga ju. Këta keqbërës kanë shkuar nga ky arsyetim: «Ta zhvillojmë punën armiqësore, të infektujmë kuadrot, të krimbim ushtrinë, të përdorim të gjitha mjetet dhe mënyrat që të mos zbulohemi dhe, kur të vijë momenti vendimtar, pra, kur të plasë hufta, ushtria dhe mbrojtja të jenë përtokë. Revizionistëve sovjetikë, që do të na sulmojnë dhe do të na okupojnë, ne do t'u themi: «Ja, ne kemi qenë me ju, ja librat ideologjikë, ja strategjia juaj, ja rregulloret tuaja, ne me këto e kemi ushqyer ushtrinë tonë, pra, kemi qenë me ju dhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë»».

Këta, në rast se zbuloheshin, së pari, kishin menduar dhe vazhdojnë të mendojnë akoma se «Si zor të merren masa kundër nesh nga Partia dhe nga shteti i proletarëve», pse ne «kemi komprometuar shumë kuadro» dhe, së dyti, «ne jemi pompuar dhe na kanë pompuar si koka të mëdha ushtarake, jemi «heronj të popullit», prandaj s'mund të goditemi dot lehtë». Nuk

kanë përasysht ata se Partia dhe populli të ngre dhe të nderon, kur u qëndron atyre besnik, po veç të thyejnë kokën kur i tradhton, kushdo që të jesh.

Prandaj gjithë Partia në ushtri, kuadro dhe ushtarë, komunistë dhe të rinj, të ngrihen në këmbë dhe, nëpërmjet debateve të zjarra revolucionare, të tërë ta godasin këtë punë armiqësore, të godasin dhe të demaskojnë kryesorët, të bëjnë vetë autokritikë dhe asnjëri të mos e ndiejë veten të vrarë shpirtërisht dhe të demoralizuar, duke thënë «Pse nuk e pashë më parë këtë, pse nuk i kundërshtova, pse pata frikë?» etj., etj. Partia kurrë nuk e ka përzier dhe nuk e përziën shapin me sheqerin. Ju, shokë, jeni forca e pathyeshme e Partisë, e ushtrisë sonë heroike. Këta elementë keqbërës, që kryen këtë veprimtari armiqësore, nuk mundën ta degjeneronin dot ushtrinë dhe Partinë tonë, orvatjet ata i bënë por dështuan.

Ju, shokë, kuadro të ushtrisë, komunistë dhe të rinj nuk kishit dijëni për veprën e disa matrapazëve, që merrnin literaturë armike, e qëndisnin me citate të Partisë sonë dhe jua jepnin juve sikur ishte e Partisë sonë.

Tani kjo situatë e sëmurë që kanë krijuar këta elementë mashtrues duhet shëruar përnjëherë. Është Partia, jeni ju, kuadrot besnikë të saj dhe të ushtrisë, oficerë dhe ushtarë, komunistë dhe të rinj, që do ta bëni këtë shëndoshje. Nga kurrkush tjetër mos prisni që ta bëjë këtë. Prandaj mblidhuni, diskutoni, vendosni drejt, me gjakftohtësi dhe me zjarr revolucionar, zhdukni të këqijat, ndreqni të metat e gabimet dhe ndihmoni shokët që pa dashur kanë gabuar, spastroni edukimin

tuaj nga plehrat revizioniste dhe zbatoni kudo mësimet, materialet e normat e Partisë dhe ligjet e diktaturës së proletariatit.

Ushtria jonë është ushtria e proletariatit, prandaj të pamëshirshëm duhet të jemi kundër armiqve dhe tradhtarëve. T'u bëjmë luftë mendjemëdhenjve, «feudalëve» ushtarakë, mburravecëve, shantazhierëve, gënjeshtarëve dhe shfrytëzuesve të gjakut të ushtrisë, t'u bëjmë gjithashtu luftë vagabondëve, si atyre që janë futur kontrabandë në radhët tona, ashtu edhe atyre që degjencerojnë. Kjo është rruga e Partisë, kjo është rruga e Ushtrisë Popullore.

Mendoni kurdoherë, shokë, të kaluarën e mjerë të popullit tonë, mendoni Luftën heroike Nacionalçlirimtare, gjatë së cilës na u vranë me mijëra e me mijëra shokë e shoqe, na u dogj e na u bë vendi shkumb e hi; mendoni luftën e madhe të rindërtimit, luftën plot vetëmohim e sakrifica të Partisë dhe të popullit; mendoni luftën e pamëshirshme që po na bëjnë armiqtë e panumërt dhe i thoni vetes ditë dhe natë, orë e çast: «Duhet ta vë unë interesin e vogël personal përpara kësaj çështjeje të madhe? Duhet vallë të udhëhiqem unë nga gjërat meskine dhe të harroj të mëdhatë? Do ta lë vallë veten të më heqë nga hunda ndonjë sharlatan dhe të mos mbroj vijën e Partisë, të mos zbatoj me konsekuencë dhe me vendosmëri normat e saj? Do të lakmoj unë privilegjet dhe të njollos fytyrën e proletariatit dhe të patriotit?». Përgjigjja nga të gjithë duhet të jetë: «Jo, kurrë jo!». Dhe kjo të shprehet me një forcë të tillë në jetën tonë, sa që të dridhen armiqtë, kurse populli, me Partinë e vet në krye, të ecë përpara

si vigan i pamposhtur. Komiteti Qendror është i bindur se në ushtrinë tonë ka dominuar dhe kurdoherë do të dominojë kjo frymë e lavdishme proletare!

Rroftë Partia!

Rroftë Ushtria Popullore!

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 71*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NË GJYKIMIN E SITUATAVE DHE NË SHFRYTËZIMIN E KONIUNKTURAVE TË MBAJME QËNDRIM PARIMOR

*Nga biseda me ambasadorin kinez*

16 tetor 1974

*Gjatë bisedës, pas përshëndetjeve të zakonshme, duke shkëmbyer mendime për probleme të ndryshme ekonomike e çështje të tjera me ambasadorin kinez, shoku Enver Hoxha, midis të tjerave, tha:*

Buka është kryesore për ushqimin e popullit, prandaj drithërat në vendet tona duhen prodhuar në sasi të madhe. Kjo është e domosdoshme. Imperializmi, veçanërisht ai amerikan, po bën presion duke i ngritur çmimet, bile në këtë drejtim ia drodhi edhe Bashkimit Sovjetik. Në këtë situatë, revizionistët sovjetikë u kanë bërë lëshime të tjera amerikanëve. Së pari, kanë marrë përsipër të lejojnë shtypin perëndimor të hyjë lirisht në Bashkimin Sovjetik, së dyti, qytetarët e vendeve perëndimore që kanë marrëdhënie familjare etj. me qytetarë sovjetikë, të hyjnë e të dalin lirisht në këtë vend. Sipas komenteve të agjencive të ndryshme të lajmeve, marrëveshja në këtë drejtim është arritur. Revizionistët sovjetikë gjithmonë u kanë bërë lëshime im-



perialistëve amerikanë, por këta u kërkojnë të lëshojnë akoma më shumë, të japin, si me thënë, jo vetëm gishtin, por gjithë dorën, ndryshe nuk u shesin grurë dhe, po nuk u shitën, atëherë në Bashkimin Sovjetik bëhet katrahurë e madhe.

Sot filloi në Varshavë mbledhja e partive revizioniste të Evropës. Pse e bëjnë revizionistët sovjetikë këtë mbledhje? Sepse janë në pozita jashtëzakonisht të vështira, të rënda. Ata e organizuan këtë mbledhje për të fshehur diskreditimin që kanë pësuar dhe për të krijuar përshtypjen në botë sikur Bashkimi Sovjetik na qenka qendra e komunizmit ndërkombëtar! Kjo përshtypje e rreme u nevojitet revizionistëve për të mashtruar komunistët e vërtetë në botë, të cilët e kanë kuptuar se revizionistët sovjetikë dhe shërbëtorët e tyre nuk janë më komunistë, por tradhtarë të komunizmit. Popujt e dinë se kush janë komunistët, marksistë-leninistët e vërtetë.

Qëllimi tjetër i revizionistëve sovjetikë është që me këtë mbledhje të zhvillojnë më tej fushatën kundër Kinës dhe Shqipërisë. Në mos folshin drejtpërdrejt kundër nesh, atje do të flasin tërthorazi, se gjuha është pa kocka dhe mund të lëvizë nga ta duash. Por, pavarësisht se çfarë do të flasin dhe çfarë do të vendosin, ata asgjë nuk do të fitojnë, përkundrazi do të humbasin. Asnjëri nuk do t'u besojë fjalëve të tyre, pasi kushdo e shikon se socialimperializmi sovjetik është i lidhur si mishi me thoin me imperializmin amerikan.

Në këto kushte bota pyet: «Ç'është ky Bashkimi Sovjetik, që e heq veten komunist dhe bashkëpunon me imperializmin amerikan?!». Pra, duke ndjekur zhvillimin e ngjarjeve, duke parë se revizionistët sovjetikë

puthen me imperialistët, domosdo njerëzit e ndershëm nxjerrin konkluzionin e drejtë se ata janë tradhtarë, kurse ne, që nuk pajtohemi kurrë me shkeljen e parimeve marksiste-leniniste, jemi komunistë të vërtetë.

Për të marrë pjesë në këtë mbledhje, jugosllavët dhe rumunët vunë gjoja kushte. Ata kanë kontradikta me revizionistët sovjetikë, por ata nuk janë marksistë-leninistë, nuk janë parimorë, janë të lëvizshëm, të lëkundshëm, të paqëndrueshëm, sot thonë kështu, nesër flasin ndryshe. Titon ne e njohim me kohë. Atij nuk mund t'i besohet sepse gjithmonë ka ndjekur një politikë mashtruese. Sot ai flet kundër sovjetikëve, nesër merret vesh me ta. Me qëndrimin që mbajnë, jugosllavët duan t'i thonë Bashkimit Sovjetik se nuk janë plotësisht dakord me Kinën. Edhe rumunët mbajnë të njëjtin qëndrim me dy faqe, njëlloj si jugosllavët.

Udhëheqësit rumunë nuk janë të qëndrueshëm dhe këmbëngulës as për ruajtjen e pavarësisë kombëtare. Është e vërtetë se ata kanë kontradikta me revizionistët sovjetikë, por këto nuk kanë lindur për probleme parimore, domethënë për mbrojtjen e vijës marksiste-leniniste, sepse, siç e thashë, ata as që janë marksistë-leninistë. Mosmarrëveshjet në gjirin e revizionistëve ushqehen dhe udhëhiqen nga prirje që nuk janë të shëndosha. Qëndrimi ynë kundër revizionistëve sovjetikë është krejt i ndryshëm nga ai i rumunëve, sepse ne udhëhiqemi fort nga marksizëm-leninizmi, jemi parimorë e të guximshëm në demaskimin e armiqve të socializmit.

Rumaninë e çliroi ushtria e Stalinit, armata e komanduar nga Tollbuhini. Pas Çlirimit unë shkova në Rumani *incognito* për t'u takuar e për të biseduar me

Vishinski lidhur me tradhtinë e udhëheqjes së Jugosllavisë. Vishinski më deklaroi se ato që thoshte Titoja për sovjetikët ishin shpifje, se ai dhe klika e tij ishin tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe se çështja e Jugosllavisë ishte çështje e brendshme e popujve të saj. Ai theksoi, gjithashtu, se vetë popujt dhe komunistët e Jugosllavisë duhej të luftonin kundër kësaj klike. Këto fjalë i kam dëgjuar me veshët e mi nga goja e Vishinskit.

Gjatë qëndrimit në Rumani në një takim me Dezhin që ishte Sekretar i Përgjithshëm i Partisë, ai më tregoi se rumunët fituan në sajë të ushtrisë sovjetike, ndryshe ata nuk ua dilnin dot forcave reaksionare. Dezhi më tregoi vetë historinë se si e hoqën qafe mbretin Mihael. «Dua të të tregoj për mbretin Mihael» — më tha. «Dy veta, Groza dhe unë, shkuam në pallatin e mbretit, i cili ishte i detyruar të na priste, se në Rumani ishte ushtria sovjetike, ushtria e Stalinit. Kur hymë, pamë se pallati mbretëror ishte mbushur me oficerë. «Duhet të abdikosh» — i thamë midis të tjerave. Mirëpo, mbreti, pasi na dëgjoi, u përgjigj me fodullëk se nuk pranonte të abdikonte. Në një moment na kërkoi leje të dilte jashtë. Ne vritnim mendjen të kuptonim pse doli. Siç dukej, për të urdhëruar gardën e vet të na arrestonte kur të dilnim. Kur u kthye, Groza i zgjati dokumentin e parapërgatitur që ta firmoste për heqjen dorë nga fronti mbretëror. Mirëpo ai përsëri kundërshtoi. Atëherë ndërhyra unë: «Zoti Mihael, — nuk i thashë lartmadhëri me qëllim, — shtoi Dezhi, — masat që po merr për të na arrestuar janë të kota. Je i rrethuar dhe ne mund të të rrëzojmë me forcë». Më në fund,

mbreti u detyrua të firmoste dokumentin e abdikimit<sup>1</sup>. Kur dolëm nga pallati, — tha Dezhi me mburrje, — ne kaluam në mes oficerëve të dëshpëruar të mbretit, me kokën lart dhe me dokumentin në çantë».

Jua tregova shkurt historinë e kësaj fitoreje «të shkëlqyer» mbi një mbret të falimentuar, për të bërë analogji me udhëheqësit e sotëm rumunë, të cilët shpesh manifestojnë shenja frike ndaj sovjetikëve. Është fakt se ata janë gjithmonë në rrezik për shkak të qëndrimeve të pavendosura që mbajnë. Në një moment, kur ta shikojë situatën të përshtatshme, Bashkimi Sovjetik mund ta sulmojë Rumaninë. Po do t'i rezistojnë dot udhëheqësit rumunë sulmit të sovjetikëve? Është me vend të dyshohet shumë për këtë.

Ne mendojmë se atje duhet një punë e madhe politike dhe ideologjike me masat punonjëse që ato të përgatiten për t'i rezistuar me këmbëngulje një sulmi të sovjetikëve. Ne i duam të mirën popullit rumun. Ai nuk është dakord me ndërhyrjet e sovjetikëve dhe kjo është pozitive, por, kur shikojmë situatën në Rumani, korrupsionin dhe degjenerimin e madh që ekziston atje, nuk mund të mos mendojmë dhe të dyshojmë se edhe atje mund të ndodhë si në Çekosllovakia.

Gjatë Luftës së Parë e të Dytë Botërore çekët luftuan. Në kohën e Luftës së Parë, Beneshi e Masariku, me sa u ishte e mundur, luftuan për shkëputje nga Austro-Hungaria. Edhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore, sllovakët rezistuan në pjesën më të madhe, luftoi bashkë me ta edhe Viliam Shiroki, ish-kryeministri i Çekosllovakisë dhe një nga udhëheqësit kryesorë të

1. Mbreti i Rumanisë Mihael I abdikoi më 30 dhjetor 1947.

lëvizjes komuniste në Sllovaki, të cilin Hrushovi e qëroi. Kurse ndaj pushtuesve sovjetikë, udhëheqësit revizionistë kapitulluan pa kushte dhe populli çek nuk mundi të organizohej për të rezistuar.

Pas vdekjes së Titos mundet që ndikimi sovjetik në Jugosllavi të ndihet më shumë se sot. Sidoqoftë, popujt e saj nuk do të pranojnë që sovjetikët të futen brenda pa luftë. Rron apo nuk rron Titoja, pushtimi i vendit prej tyre nuk është ndërmarrje e lehtë.

Në Jugosllavi ndjenja e pansllavizmit nuk është e fortë. Është e vërtetë se carët rusë gjatë historisë kanë qenë pro mbretërve serbë e malazez, por në kohën e Luftës së Parë Botërore Rusia nuk e mbështeti sa duhej mbretërinë e serbëve, kroatëve e sllovenëve. Kështu që ndjenja e miqësisë me Rusinë filloi të ftohej, duke shkaktuar turbullirë në marrëdhëniet midis dy vendeve. Ndryshe qëndron çështja me Bullgarinë, ku ndjenjat pansllaviste janë të theksuara. Atje pansllavizmi është shumë më i fortë dhe më primitiv se në Jugosllavi. Historikisht bullgarët kanë qenë më afër me rusët. Bullgaria në shekuj ka qenë me Rusinë dhe këtë traditë revizionistët bullgarë po e zhvillojnë më tej.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, sipas mendimit tonë, mund të bien në ujdi me njëri-tjetrin për sa i përket Jugosllavisë. Jugosllavia nuk është vetëm Serbia, republika e saj më e madhe, as Mali i Zi i vogël. Është e vërtetë se si kudo, edhe atje secili popull ka karakteristikat e veta; serbët e malazezët dallohen nga maqedonasit, po kështu edhe kroatët e sllovenët nga tre të parët. Mirëpo tashmë në Jugosllavi është krijuar njëfarë ndjenje e Federatës, njëfarë uniteti në kuadrin e kësaj Federate, e cila, edhe

sikur të bëhej akoma më reaksionare nga ç'është aktualisht, edhe sikur Jugosllavia të kthehej përsëri siç ka qenë në kohën e kral Aleksandrit, nuk mund të priset në çfarëdo kohe. Edhe ndjenjat rusofile, tendencat prosovjetike që mund të ekzistojnë në gjirin e Federatës janë shumë të dobëta përballë prirjeve centrifugale që ekzistojnë kundër Rosisë. Në Maqedoni ka prirje të theksuara për t'u bashkuar me Bullgarinë, kurse serbët nuk duan që ajo t'u shpëtojë nga dora. Edhe në Serbi, pavarësisht se ka ndjenja rusofile, nuk janë për nënshtrim ndaj Rosisë. Kroacia e Sllovenia janë antiruse. Ato kanë prirje të anojnë nga Perëndimi: sllovenët nga italianët, kurse kroatët nga austriakët. Prandaj, të gjithë këta popuj që formojnë Federatën jugosllave, nuk do të rrinë duarlidhur në qoftë se sovjetikët, pas vdekjes së Titos, sulmojnë Jugosllavinë. Po të shpërthejë një sulm sovjetik, ai nuk do të kalojë lehtë. Në Jugosllavi do të bëhet luftë.

...Thonë se ky ose ai grup ka dalë kundër Titos, se kundër tij doli edhe Rankoviçi e të tjerë, por asnjëri nuk ka pasur sukses. Kundërshtarë të Titos ka pasur edhe më parë në Jugosllavi, por ai i ka likuiduar të gjithë shpejt e shpejt. Titoja është politikan akrobat, ai dredhon e mashtron sipas situatave që krijohen. Faktet që përmenda të bëjnë të mendosh se Jugosllavia nuk mund të pushtohet aq lehtë. Përveç kësaj, pas vdekjes së Titos, ndikimi i shteteve që kreditojnë Jugosllavinë, do të vazhdojë të jetë i madh, sepse ekonomia e këtij vendi nuk është në gjendje të përballojë gjithë ato borxhe të mëdha që ka ndaj tyre, si bie fjala, ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë Perëndimore etj.

Sidoqoftë ne do të jemi kurdoherë vigjilentë. Kontradiktat midis rumunëve e jugosllavëve nga njëra anë dhe sovjetikëve nga ana tjetër, ne duhet t'i shfrytëzojmë në dobinë tonë dhe në dëm të revizionistëve. Marksizëm-leninizmi na forcon bindjen në fitore dhe na bën të kemi kujdes që t'i gjykojmë mirë situatat dhe, në shfrytëzimin e koniunkturave, të mbajmë qëndrim parimor në interesin e përbashkët të të dy vendeve tona, duke bërë në çdo rast dallimet e një koniunkturave nga një tjetër.

Ta ngremë këtë doli për shëndetin tuaj, shoku ambasador. Faleminderit për vizitën dhe mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## MBI NJË LETËR «AUTOKRITIKE» QË MË DËRGON PETRIT DUMJA

17 tetor 1974

Shoku Hysni,

Rilexoje me kujdes këtë letër që po të dërgoj. Është një tjetër farë «autokritike» e shokut Petrit Dume.

Për të mbuluar fajin e tij, ky po trillon në kokë, përpiqet të gjejë ndonjë «arsye» të vlefshme që atij «nuk i paska humbur kurrë besimi ndaj udhëheqjes dhe ndaj meje».

Po ngatërrohet më shumë duke u përpjekur të shfajësohet. Me këtë letër që më dërgon, ai do të më thotë se «nuk erdha ta denoncoja Beqir Ballukun, sepse nuk kisha arritur në konkluzione» etj. Por, edhe kur «arriti në konkluzione» pse nuk erdhi të na thotë? Këtë i kërkojmë ne të na e pohojë, por Petriti kërkon të na bindë se «kot nuk erdha», me një fjalë, sepse «ty, shoku Enver, të kisha parë se si e goditje rëndë Beqir Ballukun, që tentonte të më hiqte qafe» etj. Me këtë ai do të më thotë se «ti, Enver, ke qenë kurdoherë kundër Beqirit dhe pro meje, Petritit», pra, me fjalë të tjera, «si të humbisja unë besimin tek ti? Unë isha i prirë të vija tek ti, por... kot nuk erdha». Domethënë «kjo që pretendohet se kisha humbur besimin te ju, nuk



qëndron», prandaj më këshillon, të tërheq fjalët që them për të.

Çështja e dytë që përpiqet «të vërtetojë» se «humbjen e besimit, nuk mund ta pranoj», është ajo se autokritikat që ai ka bërë për këtë çështje janë «gjetur nga ne të mira», bile «ai ka pranuar gabime, por edhe më shumë».

Atëherë, si bëhet që tani, «unë, Petriti, po akuzohem për këtë mosbesim?». Dhe për këtë ka gjetur një arsye që gjoja e hedh si pa gjë të keqe, por që nuk është veçse një trillim intrige kundër... Kjo është akoma më e ligë dhe më e keqe për të.

Petriti në letër lë të kuptojë: «Shih shoku Enver, se mos të ka ngatërruar (filani) dhe të ka çuar në mendim të gabuar ndaj meje, pse është vetë (filani) që më tha se «nuk e zuri gjumi gjithë natën», pse më paskësh thënë mua, kur e vura në korent për çështjen e Beqir Ballukut, se «Beqir Balluku nuk qenkësh gjë, dhe ju e keni ndihmuar. Unë, — vazhdon Petriti, — nuk i thashë gjë atij, pyeteni» etj. Me fjalë të tjera, ai do të thotë: «Mos ka ardhur tek ti (filani) dhe ka raportuar, ose më mirë, ka shpifur për mua, dhe ato që ai ka thënë vetë, i vë në gojën time (Petritit)?».

Po pse ka arritur të trillojë kështu për këtë shok? Unë mendoj, se, e para, në vend që të reflektojë në gabimet e tij, imagjinon si të gjejë një diçka për të fshehur fajin e vet dhe, e dyta, ti Hysni, e di incidentin që ngjau në mes këtij shoku dhe Petritit në lojën e fundit ushtarake.

Atëherë Petriti, ka menduar që «shoku... ka qenë i zemëruar, dhe, për t'u hakmarrë, shkoi te shoku Enver dhe shpifi për mua (Petritin)» dhe unë (Enveri) «e

hëngra, rashë brenda», prandaj, akuza e «mosbesimit» reduktohet në një «mosmarrëveshje».

Këtu qëndron dhe intriga e Petritit që kërkon të ngatërrojë edhe filanin, që është xhevahir dhe krejt i larë nga këto gjëra. Ne e njohim mirë këtë shok.

Mundet dhe ajo çka thotë Petriti se i ka thënë këtij shoku, të jetë e vërtetë, sepse këtij i ka rënë si bombë çështja e Beqir Ballukut dhe nuk e ka zënë gjumi tërë natën. Kjo ka ngjarë, me siguri, për tradhtinë e Beqir Ballukut dhe jo pse më tha mua se «e kam pasë ndihmuar atë, se ai nuk ishte gjë». Mirëpo, Petritit, ky interpretim i intereson dhe prandaj na e raporton.

Nuk është mirë, që Petriti përpiqet të mendojë shfajësime të kota, në vend që të pohojë të vërtetën. Prandaj vërja në dukje këto gjëra dhe e këshillo të vërë kokën në duar, të lexojë me kujdes dhe të reflektojë thellë mbi çdo fjalë, në diskutimet e shokëve të Byrosë Politike dhe në të miat. Ndryshe nuk kemi si ta ndihmojmë, kur ai nuk ndihmon veten dhe Partinë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ATDHEU I TYRE ËSHTË GJITHË SHQIPËRIA

*Letër ngushëllimi drejtuar familjes së Ilija Qiqit*

*Zervat — Gjirokastër*

**30 tetor 1974**

Të dashur prindër, motra dhe vëllezër të Ilias,

Ju shpreh hidhërimin tim të thellë dhe ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta për vdekjen e djalit e vëllait tuaj të dashur, birit besnik të popullit tonë<sup>1</sup>.

Vdekja e Ilias është e rëndë, sepse e shkëputi atë papritur nga familja dhe nga gjiri i shoqërisë në moshën më të bukur, kur ai po hidhte hapat e parë në jetë për t'u shërbyer me devotshmëri Partisë, popullit dhe atdheut, Shqipërisë së tij socialiste. Megjithatë kjo ngjarje kaq e hidhur të ngjall edhe krenari, sepse vendimi që ai mori për t'u kthyer pa humbur kohë në krye të detyrës, nga Burreli në fshatin Lis, për t'u dhënë mësim nxënësve që i donte dhe e donin aq shumë,

---

1. Ilija Qiqi ra në krye të detyrës më 14 tetor 1974. Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha atij titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste».

flet për një shembull të lartë të ndërgjegjes socialiste në punë.

Jam i informuar se Ilija ishte i zellshëm dhe i lidhur ngushtë me punën. Edhe pse kishte pak kohë në Lis të Matit, ku që duke shërbyer si mësues, me qëndrimet dhe sjelljet e tij të mira ai shpejt meritoi besimin, dashurinë dhe respektin e shokëve, të cilët e kishin zgjedhur sekretar të organizatës së rinisë të shkollës.

Duke shndërruar në bindje të thellë ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë, ky komisar i ri i dritës, siç i quan populli ynë arsimitarët e vet, vdiq për të mos u harruar kurrë nga nxënësit e tij të vegjël, nga shokët, nga familja dhe nga mbarë atdheu, që ai e kishte aq shumë në zemër.

Më kanë prekur shumë si qëndrimi burrëror i mbajtur nga ju pas marrjes së lajmit të hidhur dhe fjalët aq të ngrohta që shprehni për Partinë tonë të dashur në letrën që më dërguat, ashtu edhe marrja me shpejtësi e vendimit për të dërguar djalin dhe vëllanë tjetër, Stefanin<sup>1</sup>, që të vazhdojë detyrën e Ilias, duke e zëvendësuar atë menjëherë në vendin ku shërbente.

Ky është një gjest i lartë kuptimplotë. Vajtja nga Dropulli e pjesëtarit tjetër të familjes suaj për të punuar në Burrel, shpreh me qartësinë e dritës atë patriotizëm të zjarrtë dhe ndjenjë të pastër të vëllazërimit socialist që ka kalitur e kalit çdo ditë te njerëzit tanë Partia. Është kënaqësi e madhe që bij minoritarë shkojnë në vullnetarisht e me gëzim në çdo cep të vendit, sepse

---

1. Stefan Qiqi shkoi në Lis si mësues, në vend të vëllait të tij. Me punën e tij shembullore u bë anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë.

janë të ndërgjegjshëm që sot atdheu i tyre është tërë Shqipëria, se socializmi ndërtohet kudo, në Jug e në Veri, dhe çdo qytetar e gjen lumturinë jo vetëm atje ku ka lindur, por në gjithë territorin e Republikës sonë Popullore.

Duke qëndruar shpirtërisht pranë jush, bashkë me ngushëllimet, ju dërgoj edhe përshëndetjet e mia të nxehta dhe shpreh dëshirën që paskëtaj të keni kurdoherë gëzime, lumturi dhe suksese në punë. Stefanin e përgëzoj nga zemra për gatishmërinë që tregoi dhe i uroj shëndet e rezultate të mira në detyrën aq të bukur të mësuesit për edukimin komunist të brezit të ri.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 261 (8176), 31 tetor 1974*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për rininë»  
(Përmbledhje veprash),  
vëll. II, f. 399*

## UDHËZIMET NUK MUND TË ZËVENDËSOJNË PUNËN E VËRTETË SQARUESE ME NJERËZIT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit  
Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

21 nëntor 1974

*Duke marrë shkas nga një pyetje që u bë në këtë mbledhje nëse ka shumë raste nxjerrjeje aktesh nënligjore të panevojshme, shoku Enver Hoxha tha:*

Me sa di unë, ka. Kjo vjen se punonjësit e administratave të dikastereve e kanë zor të venë e të ngulen në rrethe e në bazë për problemet e ndryshme. Kjo tregon se këta shokë nuk merren sa duhet praktikisht me edukimin e njerëzve, prandaj, për të «plotësuar» këtë boshllëk të punës së tyre, mendojnë: «Oburra, të lëshojmë udhëzime». Dhe kështu lëshohen udhëzime mbi udhëzime, që rrethet janë të detyruara t'i kenë parasysh në punën e vet. Kur rrethet ndeshin vështirësi në punë dhe drejtohen për ndihmë, marrin këtë përgjigje: «E keni udhëzimin, pse nuk veproni sipas tij?». Të

---

1. Në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje u diskutua rreth raportit «Për bazueshmërinë në ligje të akteve nënligjore të nxjerra nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore».

gjitha këto «udhëzime» që jepen për «sqarimin» e kuptimit të ligjit, janë shfaqje të burokratizmit, që të zënë frymën. Ato nuk mund ta zëvendësojnë punën sqaruese për kuptimin e ligjeve, për sqarimin dhe për bindjen e njerëzve. Formulimi pa qenë nevoja dhe dërgimi postë i «udhëzimeve», për të zëvendësuar punën e vërtetë sqaruese lidhur me kuptimin e ligjit, u ka krijuar kohë «të lirë» disa njerëzve, që, për të mos e shkuar kohën «dëm», organizojnë në kurriz të ekonomisë popullore dreka, darka e ahengje, që me të drejtë po kritikohen me forcë nga Partia.

Prandaj aktet nënligjore të tepërta duhen shkurtuar, duke mbetur vetëm ato që janë të nevojshme. Për këtë është e domosdoshme që ligjet të hartohen sa më qartë që të jetë e mundur dhe, pas kësaj pune, të merren masa që përmbajtja e tyre t'u shpjegohet njerëzve, pa qenë nevoja të pasqyrohet me akte nënligjore të nëvonshme, ajo që mund dhe duhet të thuhet në ligj. Pra, lypset të dallohet mirë, teorikisht dhe praktikisht, kufiri midis ligjit dhe aktit nënligjor.

Kur miratojmë një ligj, ne nisemi nga parimi që ai të jetë i bazuar në kërkesat që ngre zhvillimi ynë socialist. Me kalimin e kohës një ligj mund të mos u përgjigjet më kushteve të reja dhe të jetë i papërshtatshëm, për arsye se rrethanat e ndryshuara kërkojnë vendosjen e normave të reja, prandaj duhet punuar që ligji në fuqi të shfuqizohet dhe në vend të tij të miratohet një tjetër që të përputhet me kërkesat e aktualitetit. Këto ndryshime që lindin nga nevoja, imponojnë nxjerrjen e dispozitave të reja të arsyeshme, që janë të një niveli më të lartë nga ana cilësore. Për t'i dalë në krye me sukses kësaj pune, gjatë procesit të zba-

timit të tij në praktikë, ligji duhet të kontrollohet gjithë kohën, të ndiqet me kujdes ku janë të mirat e të metat e tij, sa është kuptuar ai dhe si mobilizohen njerëzit për ta vënë atë në jetë, është e mjaftueshme apo nuk është e mjaftueshme puna politike që është bërë për njohjen e tij nga masat etj.

Nuk është i rekomandueshëm hartimi dhe nxjerrja vend e pa vend e shumë udhëzimeve, vendimeve, urdhëresave e akteve të tjera nënligjore. Kur vjen koha dhe nevojitet ndryshimi i një ligji, pse vetë jeta ka vërtetuar që ai nuk u përshtatet më kushteve të krijuara, atëherë, me të drejtë, ai duhet ndryshuar. Megjithatë duhet pasur shumë kujdes që të mos nxirren shumë urdhëresa e udhëzime «për të sqaruar» edhe këtë, edhe atë kuptim të ligjit. Në raste të tilla le të bëhen interpretime me karakter shkencor për zbërthimin e përmbytjes së ligjit, pa qenë nevoja të nxirren udhëzime pas udhëzimesh.

Unë mendoj se te ne aktualisht nuk është shqetësuese gjendja e legjislacionit, për arsye se ne nuk bëjmë ligje të ngatërruara, as të shumta, por të kemi kujdes që të mos e teprojmë me aktet nënligjore. Këtë çështje e bisedova edhe me shokun Kryetar të Presidiumit të Kuvendit Popullor, me të cilin ishim të një mendimi.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, që gjendet në AQP*



## EDHE NJË HERË PËR SHKOLLËN E LIRË USHTARAKE

22 nëntor 1974

1) Tezat për Shkollën e Lirë Ushtarake, nga ana teorike, dhe vijat e përgjithshme të organizimit të saj janë dhënë. Duhet të shumëzohet materiali «Teza për Shkollën e Lirë Ushtarake»<sup>1</sup>, që është mbajtur fshehurazi nga «Treshja», të vihet në dorë të ushtrisë për edukimin e saj ideologjiko-ushtarak. Të njihen me të edhe komitetet e Partisë në terren.

2) Ç'fat ka pasur zhvillimi i këtyre direktivave, nuk dimë gjë. Shtatmadhuria asnjëherë nuk ka raportuar, me gjithë kërkesat tona të shumta.

3) Në bazë të të gjithë analizës së punës armiqësore të Beqir Ballukut, të Hito Çakos dhe të Petrit Dumes rezulton se këta kanë qenë kundër direktivave të dhëna për Shkollën e Lirë Ushtarake dhe i kanë sabotuar, duke e konfunduar atë me pikat e hapjes.

4) Pikat e hapjes nuk mund të mos lidhen me Shkollën e Lirë Ushtarake, ato janë dhe do të reduktohen në një, por duhet të demaskohet armiqësia e Beqir Ballukut, e Hito Çakos dhe e Petrit Dumes, të cilët ishin edhe kundër pikave të hapjes, edhe kundër Shko-

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 43, f. 1.

llës së Lirë. Për ta kishte «vlerë» vetëm ushtria efektive, ushtria kuadër, ushtria e kazermave.

Këtë ushtri-kuadër ata nuk e konsideronin siç e mendon Partia, prandaj luftuan që ta dobësonin dhe ta krimbnin. Pikat e hapjes, që Partia i krijoi për t'u kthyer në baza të fuqishme të shkollave të lira ushtarake, këta tre armiq i «adoptuan», se me atë mendje që kishin, menduan që «ushtinë e hallakatnin më shumë» dhe kjo shkonte drejt qëllimit të tyre. Për armët speciale, që mbahen të grumbulluara, ata ishin të kënaqur që mbeteshin në kazerma.

5) Stërvitja e rezervistëve, e forcave vullnetare etj. konsiderohej prej tyre si stërvitja e ushtrive rezerviste borgjeze. Atyre ata nuk u vinin fare rëndësi, u kishin zënë këmbët, nuk kishte programe rigoroze stërvitjeje, nuk kishte asnjë kontroll për të. Forcat dhe koha përdorëshin sipas qejfit të «treshes». Kontrolli i komandës qe shumë i dobët, kontrolli i partisë nuk kishte aspak.

6) Si konsekuencë Shkolla e Lirë ishte për ta e panevojshme, po, për të mos dalë hapur kundër, atë e vetëquajtën «pika e hapjes — Shkolla e Lirë» dhe kuptimi e organizimi i saj mbetet kuptimi borgjez, jo i gjithë populli ushtar.

Partisë dhe Shtatmadhorisë, duke u bazuar në parimet e vendosura, u bie për detyrë të rishikojnë dhe të përsosin në kuptimin e vërtetë të fjalës organizimin e shkollave të lira ushtarake, vendet dhe sasinë e tyre, programet ushtarake, bazën materiale dhe lidhjet organike me njësitë e ushtrisë aktive dhe me Partinë në rreth.

7) ...

8) Për sa u përket lidhjeve dhe drejtimit të Partisë, para se të vendosim, duhet të thotë mendimin e tij edhe shoku Hysni, veçanërisht për organizimin e Partisë. Por, kur të vendosim për këtë çështje, parimin që «një komunist nuk duhet të bëjë pjesë në dy organizata partie», ne duhet ta kemi parasysh. Prandaj organizata e terrenit është kryesorja dhe e vetmja.

Koha që bëjnë pjesë në Shkollën e Lirë si efektive ushtarakë komunistët e terrenit është e përhershme, por si «pjesëtarë të një organizate partie në Shkollën e Lirë» ata qëndrojnë për një periudhë fare të shkurtër, më pak se një muaj. Prandaj këtë mund të mos e quajmë organizatë partie. Shkolla e Lirë duhet të ketë një udhëheqje partie, e cila, po të jetë komitet, në qoftë se i plotëson kushtet, nuk do të jetë e nevojshme që të mblidhet, siç mblidhen ata të terrenit. Një udhëheqje më e vogël se komiteti, mund të jetë më efektive dhe operuese.

Në rast se për ndonjë çështje duhet që udhëheqja e Shkollës së Lirë të mblidhet kur nxënësit (rezervistët) janë liruër, ajo mund të thërritet dhe çka vendoset e kërkohet për komunistët e terrenit dhe të ushtrisë, u komunikohet organizatave të tyre përkatëse. Mbledhja e komunistëve të Shkollës së Lirë mund të bëhet edhe dy ose e shumta tri herë në vit (kur është e domosdoshme) dhe kjo duhet të thërritet nga udhëheqja e Partisë e Shkollës së Lirë. Thirrja e këtyre mbledhjeve nuk mund dhe nuk duhet të bëhet rregull dhe rutinë: Këto mbledhje janë të jashtëzakonshme. Lidhjet më lart s'pësojnë ndonjë ndryshim. Kështu kam menduar unë për këtë çështje, por kjo duhet diskutuar.

Më në fund kisha edhe një vërejtje për formën,

meqë Tezat për Shkollën e Lirë Ushtarake më ranë përsëri në dorë pas 4 vjetësh.

Citati, siç e dimë, përdoret për të forcuar idenë dhe për t'i dhënë mundësinë lexuesit të gjykojë se kjo që paraqitet, mbështetet në teorinë e klasikëve. Në një shkrim mund të përdoren shumë citate, por unë nuk kam parë që këto të përdoren në seri. Mendoj të bëhen referenca në fund të shkrimit, ku mund t'i gjejë lexuesi, pse si ato kanë shumë klasikët tanë, që ne duhet t'i studiojmë jo vetëm si citate të veçuara, por të studiojmë edhe veprat nga janë nxjerrë ato. Kurse në shkrimin tim «Teza për Shkollën e Lirë Ushtarake» citatat bëhen nja 7 faqe, por mund të përdoren vetëm një ose dy citate.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 174*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 174*

## Ç'ËSHTË PËR NE KOMUNISTËT ORGANIZATA-BAZË E PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë  
të Partisë*

25 nëntor 1974

Të gjithë komunistët e njohin rolin e madh të organizatës-bazë, por e kemi për detyrë që të kontribuojmë të tërë që kjo ta luajë këtë rol. Nuk është e mjaftueshme vetëm ta shpallësh këtë parim, kryesorja është ta kuptosh atë teorikisht dhe ta zbatosh në gjithë madhësinë dhe rëndësinë e tij. Kjo, natyrisht, varet nga vetë komunistët. Në qoftë se këta janë parimorë, në qoftë se janë revolucionarë, në rast se vazhdimisht e vazhdimisht edukohen me teorinë marksiste-leniniste dhe çdo gjë e shohin dhe e gjejnë në prizmin e kësaj teorie, atëherë, pa asnjë dyshim, organizata-bazë do të ngrihet në rolin e saj të vërtetë, ajo do të bëhet një organizatë luftarake, revolucionare. Duke u vënë në të vërtetë në krye të masave dhe duke jetuar në gjirin e tyre, ajo do të hidhet në vijën e parë të luftës për ndërtimin e socializmit, për edukimin e njeriut të ri të shoqërisë sonë. Kështu organizata-bazë do të zhvillojë me sukses luftën e klasave, do të vihet në krye të pu-

nonjësve dhe, tok me ta, do të dëgjojë mendimet dhe dëshirat e tyre, duke u korigjuar atyre dhe vetes mbeturinat borgjeze dhe mikroborgjeze.

Një organizatë e tillë, duke qenë në udhëheqjen e qendrës së prodhimit, ku është krijuar, në praktikë, brenda ligjeve, do të luftojë për të zbatuar të gjitha detyrat që i caktohen kolektivit. Ajo, me komunistët që e përbëjnë, duhet të bëhet shembull heroizmi, pune, sakrifice, ndershmërie, modestie e pastërtie morale dhe veprimet e saj dhe të komunistëve që bëjnë pjesë në të, do t'i hapë në dritën e diellit dhe nuk do t'ia fshehë gjykimin të masës. Një organizatë e tillë duhet t'i ketë sytë kudo, në mënyrë që kudo të ndihet pulsi gjallërues dhe jetëdhënës i Partisë. Po të kemi parasysh vetëm këto që përmenda, kuptohet sa të rënda janë detyrat që ka organizata-bazë e Partisë dhe sa përgjegjësi të madhe kanë komunistët për kryerjen e tyre. Të jesh komunist, nuk është një punë e rehatshme. Qenia anëtar partie duhet merituar me punë, me luftë, me sakrifica dhe jo me të marrë këtë titull të mos bësh gjë më.

Forca e madhe e komunizmit duhet të shpërthejë në Parti, në organizatat-bazë dhe në komitetet e saj, në gjirin e klasës, në gjirin e gjithë punonjësve dhe të organizatave të tyre. Këndej del edhe roli i madh i organizatës-bazë të Partisë. Jeta në të duhet të ziejë. Duhet të luftohet çdo praktikë o formë pune që pengon luftën revolucionare në organizatën-bazë. Këtu komunistët nuk mund të venë as për të fjetur, as për t'u mërzhitur. Si rregull, është caktuar që mbledhja e organizatës-bazë të bëhet një herë në muaj, por nuk është e thënë që kjo të mos mbledhet edhe më shpesh dhe

komunistët atje nuk duhet të venë sa për të qenë të pranishëm, për të shkuar radhën.

Praktika na tregon se në gjithë këtë punë nga më kryesoret të Partisë, në disa organizata-bazë komunistët priren t'i bëjnë mbledhjet në një kohë shumë të kufizuar, duke menduar se «na priset programi», «do të vemi të hamë bukë» etj., etj. Në qoftë se shkohet me të tilla pikëpamje apo predispozicione, atëherë duhet të dalim me konkluzionin se një organizatë-bazë e tillë është dobësuar, çka do të thotë se në të komunistët janë «plakur» dhe fryma e tyre revolucionare është vyshkur. Në këtë rast duhet menjëherë të bëhet një analizë serioze e gjendjes, të gjenden arsyet që mund të jenë të shumta, parimore dhe joparimore, dhe të dilet nga të tilla situata të sëmura.

Në organizatën-bazë komunistët duhet të venë me zjarr dhe me dëshirë të madhe, atje ata duhet ta ndiejnë veten më mirë se kudo gjetkë. Në organizatën-bazë janë të gjithë njësoj, me të drejta dhe me detyra të njëjta, atje s'ka grada, s'ka hierarki, s'ka poste e pozita, epror dhe vartës, atje ka vetëm komunistë me përgjegjësi të njëllorja dhe të përbashkëta partie, por edhe me detyra dhe me përgjegjësi të veçanta dhe për të dyja, edhe për detyrat, edhe për përgjegjësitë, duhet të jepet dhe të kërkohet llogari.

Nga ana tjetër është edhe çështja se ç'do të diskutojmë në mbledhjen e organizatës-bazë. Kjo çështje nuk duhet të mbetet vetëm në dorën e sekretarit të organizatës-bazë, për të është e domosdoshme të mendojnë të gjithë komunistët, të cilët edhe të përgatiten seriozisht për mbledhjen e organizatës. Ka mjaft raste që gjatë muajit, komunistët nuk mendojnë për temën

që u caktua. Kështu mjaft prej tyre venë në mbledhje jo të përgatitur, dëgjojnë fjalimin «e përgatitur» plot formula dhe shprehje të përgjithshme, të përsëritura qindra herë. Të tjerët mbajnë ndonjë shënim gjatë mbledhjes dhe tjerrin disa fraza stereotipe dhe ky është i gjithë diskutimi që bëhet nga ana e tyre. Pastaj propozohet të mbyllet mbledhja gjatë së cilës mbahet gjoja procesverbal, formal, dhe «ku ishe? — asgjëkundi», «e kaluam radhën».

Neve, komunistëve, nuk na lejohet të zhvillojmë një mbledhje formale të organizatës, nuk na lejohet që në organizatën-bazë ta ngushtojmë numrin e çështjeve që duhet të diskutojmë. Neve, komunistëve të një organizate shkolle, për shembull, s'na interesojnë vallë problemet jashtë shkollës? S'na interesojnë problemet ekonomike, problemet e tjera të politikës së brendshme apo të politikës së jashtme? Nuk rrojmë ne në gjirin e masave dhe nuk ndeshemi me vështirësitë e jetës? Pse të shkojmë nga pikëpamja se «ka kush interesohet për këtë ose për atë problem, se për to ka organizata të tjera». Bukur, le të ketë organizata të tjera dhe ato le ta bëjnë mirë punën e tyre, por as ne në organizatën tonë të shkollës nuk na pengon kush, bile këtë kërkon Partia që, kur shohim se furnizimi i popullit me ushqime, për shembull, nuk bëhet në rregull, dhe si ky ka me mijëra probleme, ta ngremë edhe ne në organizatën tonë. «Epo ja, i ngritëm, thonë, pastaj ç'të bëjmë?». Nga diskutimi i problemit të dilet me konkluzione dhe t'i propozohet komitetit apo ministrisë përkatëse që të marrë masa, të dilet me konkluzione edhe për Komitetin Qendror të Partisë.

Mirëpo, përse nuk veprohet kurdoherë kështu? Epo



ja, «rregulli», «rutina», «rendi i ditës» dhe vërejtjet e tilla që s'mungojnë: «shok, mos dil nga tema», «shok, sikur e zgjate shumë, shkurtoje», «shok, mos më ndërpre kur flas, kur të mbaroj merre po të duash fjalën», «ngrihu në këmbë të diskutosh» (se konsiderohet parimore të mos ngrihesh), të gjitha këto e shumë të tjera vlerësohen sikur gjoja në organizatë ka mbretëruar «rregulli, disiplina» etj. Duke u mbështetur në këto forma, padashur në organizatën-bazë imponohen ata «që dinë të tjerrin mirë fraza» dhe ata që kanë eksperiencë më shumë. Natyrisht këta të fundit japin një ndihmë të madhe për shokët e organizatës-bazë, por të kemi kujdes se forma të tilla pune të normuara dhe burokratike ndrydhin iniciativën e shokëve më të rinj e me më pak eksperiencë, me më pak kulturë dhe këta pastaj nuk flasin, se kanë frikë dhe druajtje.

Çfarë të thotë një komunist shofer o pastrues në një organizatë-bazë të Partisë në ushtri, kur atje nuk flitet kurrë për problemet me të cilat ndeshet, për problemet e sferës së punës së vet ose jashtë saj? Të tillë komunistë nuk janë shumë në korent me «problemet e organizimit të ushtrisë», kurse jashtë ushtrisë ata kanë shumë probleme për të diskutuar. Komunistja që fshin, por që bën pjesë në një organizatë-bazë administrative, as që ka dhe as që di të flasë për problemet që vihen në rendin e ditës të kësaj organizate si planifikimi shkencor etj. Mirëpo kjo është në gjendje të shtrojë probleme të tjera, por që për fat të keq të tilla probleme nuk vihen në rend të ditës.

Si konkluzion dëshiroj të theksoj se duhet të zhdukim çdo pengesë që e mban organizatën-bazë të mpirë, qoftë kjo edhe një pengesë joparimore, por formale. Le

të sjellim ndër mend mbledhjet e organizatave-bazë të kohës së luftës. Ato ishin të thjeshta nga pamja, por shumë të zjarrta nga punët dhe nga rezultatet. Shokët jo vetëm që venin në organizatën-bazë për të marrë pjesë në mbledhje, por ata venin atje edhe me rrezik vdekjeje. Edhe atëherë kishte objektiv mbledhja, por rendi i ditës herë caktohej që më parë, herë jo (shpesh ai diskutohej dhe caktohej aty për aty). Kur rendi i ditës ishte i caktuar, asnjëherë nuk harrohej të vihej atëherë pika «Të ndryshme». Kjo nuk vihej kot, por pse ishte e nevojshme dhe nuk merrej parasysh nëse do të zgjatej koha e mbledhjes, se shokët do t'i zinte shtet-rrethimi dhe do të rrezikohej kontrolli i lagjes nga armiku. Tash që kemi gjithë këto punë, gjithë këto probleme dhe gjithë këto mundësi, ne e kemi hequr thujtë fare nga rendi i ditës pikën «Të ndryshme».

Këtë çështje nuk e them për herë të parë, por ka ardhur koha që ta rivendosim, pse i jep gjallëri jetës së brendshme të organizatës, i jep gjallëri debatit, ndihmon të ngrihen në organizatë probleme të mprehta, ngre vigjilencën, hap horizonte të gjera mendimi dhe veprimi për komunistët. Pikërisht këtë kërkon edhe Partia dhe jo formalizmin, rutinën dhe burokratizmin.

Të gjithë ne, komunistët, duhet ta kemi të qartë se organizata-bazë është Partia, atje është baza, ajo është themeli i Partisë. Sa më të forta, sa më të çeliktë të jenë këto themele, aq më e fortë dhe e çeliktë do të jetë gjithë Partia që përbëhet pikërisht nga sumumi i organizatave-bazë. Partia është e fortë, kur janë të forta themelet e saj, organizatat-bazë. Njësia themelore e Partisë quhet organizatë-bazë pikërisht se atje është baza e Partisë, atje janë themelet e saj, pa të cilat nuk

mund të ndërtohet, të funksionojë dhe të udhëheqë masat Partia e tipit të ri.

Çdo komunist është pjesëtar i një organizate-bazë dhe kjo është një shkollë e madhe për të. Në organizatën-bazë komunistët mësohen të jenë, në radhë të parë, komunistë dhe të mendojnë, të punojnë, të luftojnë dhe të sillen si revolucionarë. Lënda e këtyre mësimëve, e këtyre qëndrimeve, e kësaj etike, është teoria jonë marksiste-leniniste. Kjo teori nuk është diçka boshe, nuk përbëhet nga formula të shpikura, të ujditura, nuk është një ëndërrim idealist i kozmogonisë<sup>1</sup> ose i shkencave misterioze të një fantazie ekzuberante<sup>2</sup> dhe mistike. Jo, kjo është teoria e shpjegimit materialist të botës, e atij materializmi historik që gjeti shprehjen e vërtetë tek teoria e Marksit dhe e Engelsit. Pikërisht këtë teori mësojmë ne në Partinë tonë. Kjo teori është e pavdekshme, është e gjallë, pse shpjegon jetën në zhvillim, ajo zbulon dhe shpjegon ligjet dialektike të zhvillimit, ua bën këto të qarta njerëzve, të cilët i zotërojnë, i shfrytëzojnë, i vënë në shërbim të tyre dhe e çojnë kështu botën dhe shoqërinë njerëzore përpara.

Në gjithë këtë zhvillim ne, komunistët, anëtarë të një Partie, që ndjek me besnikëri mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, jo vetëm duhet të quhemi me fjalë komunistë, por të tillë duhet të jemi ne edhe me vepra. Në radhë të parë, ne duhet të mësojmë dhe të përvetësojmë teorinë tonë marksiste-leniniste, gjë që mësohet në organizatën-bazë. Shkollat e Partisë, kurset e edukimit dhe të gjitha mjetet që ka krijuar Par-

1. Teoria që ka të bëjë me formimin e botës.

2. Të pasur, pjellore.

tia, tek organizata-bazë e kanë burimin, te veprimtaria e saj e përditshme. Marksizëm-leninizmi studiohet dhe përvetësohet pikërisht që njeriu të punojë, të mendojë, të veprojë dhe të sillet në përshtatje me ato norma, me atë etikë, me atë hov, me atë drejtësi, guxim dhe heroizëm që kërkon misioni dhe qëllimi i komunizmit, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit, shoqëria pa klasa, shoqëria në të cilën njeriu pajiset me virtyte të larta proletare.

Pikërisht një nga qëllimet e shumta të edukimit të organizatës-bazë është ndërtimi i njeriut të ri me virtyte shembullore. Organizata-bazë është ajo vatër edukimi që kalit tek anëtarët e Partisë tiparet komuniste, frymën e partishmërisë së lartë proletare në punë dhe në jetë. Anëtari i Partisë duhet t'i bëjë kurdoherë vetes këtë pyetje: I kam unë si duhet cilësitë revolucionare të komunistit? Aq më tepër këtë pyetje është e domosdoshme t'ia drejtojë vetes ai anëtar partie që është zgjedhur në forumet udhëheqëse, i cili duhet të luftojë që të bëhet shembull për gjithë komunistët e tjerë dhe për masat punonjëse. Kur ai nuk është i tillë, atëherë organizata-bazë përkatëse dhe komiteti i Partisë, bile edhe ai vetë, duhet të kërkojnë që t'i lëshohet vendi një komunisti tjetër me cilësi më të mira.

Organizata-bazë është ajo vatër e zjarrtë revolucionare, ku shtrohen probleme nga më të rëndësishmet që preokupojnë Partinë, shtetin dhe popullin. Atje shtrohen problemet, diskutohen këto nga të gjitha anët, vihen në dukje të mirat e të këqijat që mund të sjellin zgjidhja ose lënia pas dore e tyre, atje zbulohen mënyrat dhe mjetet për të zhdukur anët e dobëta e ne-

gative dhe komunistët armatosen me vendimet e qarta të veprimit masiv e individual.

Nga mendimet revolucionare dhe të pjekura rrjedhin vendimet e komiteteve të Partisë të çdo shkalle. Këto vendime lindin nga një terren pjellor, që është bërë qilizmë dhe që e ka burimin tek organizata-bazë. Fara që mbin në këtë terren është fryt i mendimeve të komunistëve të bazës. Sa më e shëndoshë të jetë fara, sa më mirë të jetë përgatitur terreni, aq më i bukur e me kokrra plot do të jetë kalliri i grurit. Kjo i përngjet edhe punës e mendimit rrezatues të organizatës-bazë. Sa gabohen disa shokë që çdo gjë të mirë që krijohet dhe që shohin, ia dedikojnë udhëheqjes! Jo, çdo sukses i dedikohet gjithë Partisë dhe Partia është në bazë, dhe udhëheqja është pjesë përbërëse e saj. Në qoftë se baza është e shëndoshë, e mirë, luftarake, të tilla tipare do të ketë edhe udhëheqja. Ashtu si komunistët nuk mund të ndahen nga klasa punëtore dhe nga populli, ashtu edhe udhëheqja nuk mund të ndahet prej tyre. Prandaj rëndësia e organizatës-bazë, që është themeli i Partisë, është kolosale.

Në organizatën-bazë nuk shkohet për të diskutuar, për të sqaruar e për të komunikuar vetëm urdhra nga lart, por edhe për të bërë bilance të ndryshme të punëve, për të studiuar dhe për të zgjidhur punë të tjera, shkohet jo vetëm për të zbatuar vendimet e Komitetit Qendror, të komiteteve të Partisë të rretheve dhe të vetë organizatës-bazë, por edhe për t'u sugjeruar atyre probleme të reja që nxjerr jeta, për t'u bërë propozime për korrigjime apo shtesa vendimeve të marra ose për të marrë vendime të reja që i lyp koha. Po nuk u veprua kështu në organizatën-bazë, atëherë ku duhet të

veprohet? Të veprohet ndryshe, do të thotë të biesh në idealizëm.

Disa mendojnë se diskutimi i këtyre problemeve në organizatën-bazë mund të kryhet brenda një ore ose një ore e gjysmë, kurse për të shkarravitur letra rrimë tërë ditën dhe këtë e çmojmë si një punë «shumë të rëndësishme». Por ç'rëndësi ka qoftë edhe një punë shumë e dobishme, përpara mbledhjes së organizatës-bazë që qëndron në bazë të çdo pune? Prandaj duhet ta vlerësojmë lart punën e organizatës-bazë, ta përgatitim atë sa më mirë me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, çka do të thotë që të përgatitemi më parë të gjithë seriozisht, vetë ne, komunistët, dhe përgatitja për të shkuar në mbledhje të saj të mos konsistojë vetëm rreth rendit të ditës, por edhe për probleme të tjera.

Disa shokë i kanë dhënë organizatës-bazë një hije të rëndë, duke e konsideruar atë shumë herë sikur është vetëm vendi i kritikave dhe i autokritikave. Është shumë gabim të konceptohet kështu dhe të veprohet në këtë mënyrë në organizatën-bazë. Në radhë të parë kjo është vendi ku diskutohet dhe përpunohet vija e Partisë, ku komunistët armatosen me politikën dhe ideologjinë e Partisë, për t'u orientuar drejt në luftën për zbatimin e strategjisë, të taktikës si dhe të orientimeve e të direktivave që do t'i çojnë në fitore.

Gjatë punës së saj ndërtimtare, organizata-bazë shëron të dobëtit, të mefshtit, të paqartët, ata që i ka zënë myku, që nuk zbatojnë detyrat ose i ka mbuluar megalomania etj. Puna që bëhet në të është, si të thuash, përgatitja e vazhdueshme e sulmit. Në këtë përgatitje të shumanshme organizata-bazë shtron, në teori dhe në praktikë, edhe pengesat, edhe origjinën e tyre,

po ajo kritikon shoqërisht edhe bartësit e tyre. Është e domosdoshme kjo kritikë, pse siguron suksesin, është, gjithashtu, e domosdoshme që kjo kritikë të mos mbetet teorike, por t'u vihet gishti konkretisht gjithë atyre komunistëve që nuk ecin me hapin revolucionar. Vetëm të kihet parasysh që organizata-bazë të mos kthehet vazhdimisht e vazhdimisht në një vend ku komunistët ngahera kritikohen dhe nuk shtrohen probleme. Një praktikë e tillë nuk është aspak e rekomandueshme. Komunistët që qortohen, që kritikohen, duhet t'i njohin gabimet dhe fajet që bëjnë dhe jo t'i fshehin, jo t'i minimizojnë, të mos gënjejnë. Të tilla shfaqje janë të shëmtuara. Komunistët që shkojnë nga këto rrugë, duhen konsideruar shumë më të rrezikshëm nga ai komunist që vërtet ka bërë një faj të rëndë, por ia thotë Partisë çdo gjë hapur, me sinqeritetin më të madh. Pas debatit që hapet për të shqyrtuar fajin apo gabimin e një komunisti, Partia duhet të gjykojë me gjakftohtësi e vigjilencë, por dhe me ngrohtësi për anëtarin e saj të çoroditur, por të penduar, që nuk i fshih gjë Partisë, por i kërkon dorën.

Prandaj në dritën e ngjarjeve që kanë ndodhur, në dritën e eksperiencës së madhe të Partisë sonë, në dritën e mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, duhet ta shohim në rolin vendimtar të organizatës-bazë, rolin e teorisë, rolin e normave. Të gjitha këto duhet të bëhen gjaku dhe kocka jonë, në mënyrë që nga organizata-bazë ne të jemi në gjendje të hidhemi në betejën e ashpër të jetës dhe në jetë t'i zbatojmë ato, të zdrugatim vetveten ditë dhe natë, se kështu socializmi dhe komunizmi do të triumfojnë në vendin tonë.

Edhe unë jam anëtar i Partisë, si gjithë të tjerët, dhe organizata-bazë është edhe për mua një shkollë e vërtetë komuniste. Përpiqem t'i nënshtrohem normave dhe disiplinës së Partisë, por ka edhe ndonjë rast që mungoj në mbledhje, sigurisht me leje, për shkak të ngarkesës së madhe me punët e Partisë. Por kam edhe një arsye tjetër që më bën të mungoj ndonjëherë: shpesh nëpër mbledhje zihet në gojë emri im, duke thënë se «kështu ka thënë shoku Enver», «në bazë të mësimëve të shokut Enver» etj., etj. Ju them sinqerisht, jo për modesti, por këto gjëra nuk mund t'i dëgjoj, më vjen shumë rëndë. Unë kuptoj edhe pozitën tuaj, pse ju mbështeteni në dokumente të Partisë që mbajnë emrin tim, por vihuni në pozitën time dhe do të shikonit sa e vështirë është për mua kur dëgjoj të flitet për personin tim.

Meqenëse jemi në organizatën-bazë të Partisë, dua të flas edhe për një çështje të rëndësishme: Byroja Politike analizoi punën armiqësore të grupit antiparti të Beqir Ballukut. Natyrisht, e gjithë Partia dhe ne si anëtarë të saj duhet të kuptojmë se kjo veprimtari ka qenë shumë e rrezikshme, jo e sipërfaqshme. Nuk kemi të bëjmë me gabime të thjeshta, të bëra nga padija, por me qëllime të përcaktuara. Qëllimi i këtij grupi ishte të likuidonte Komitetin Qendror të Partisë, Qeverinë dhe të ndërronte sistemin me anë të një puçi ushtarak. Prandaj ngjarjet në ushtri duhet të shkaktojnë në komunistët, në popull e ushtri reflektime të thella dhe të mësohen shokët të nxjerrin konkluzione e mësimë revolucionare.

Ne dëgjuam këtu diskutimet e dy shokëve... Me gjithë respektin që kam për këta dy shokë, ju pyes



ju: Ç'kuptuat nga diskutimi i tyre? Sigurisht, ju kuptuat që ata theksuan nevojën e respektimit të normave etj., etj., por në organizatë duhet të diskutojmë më konkretisht, duke u përqendruar në atë problem që shqetëson organizatën dhe, për të, të zhvillohen debate derisa të përcaktohet një mendim i përbashkët.

Nuk mund të lejohet miqësia e sëmurë, shoqëria e sëmurë, farefisllëku para interesit të Partisë. Këtë s'duhet ta lejojmë asnjëherë. Në tërësi i dimë këto gjëra, por praktika tregon se nuk i zbatojmë si duhet. Në goftë se nuk i zbatojmë si duhet, këto kthehen kundër Partisë, në goditje kundër saj dhe pushtetit popullor. Shumë gjëra që shokët e Partisë i shikojnë duhet të dinë t'i peshojnë, t'i vlerësojnë, të nxjerrin konkluzione e t'i thonë udhëheqjes mendimet e tyre. Por jo të na sillen këtu një mijë mendime. Këtu të na sillen kuintesenca.

Si u zbulua puna armiqësore e këtij grupi? Vetëm kur u kritikuan rëndë përpjekjet e Beqir Ballukut për të ndryshuar organizimin e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Për këtë çështje puçistët arritën të ndahen më dysh, kush të kishte fuqinë. Me ta mësuar këtë, ne shokët e Byrosë Politike thamë që kjo është e sëmurë. Ne i thamë «hajt sikter» asaj pikëpamjeje, se strukturën e kemi në rregull.

Kur e pamë më thellë këtë çështje armiqte u zunë ngushtë dhe, më në fund, Petrit Dumja e dha Beqir Ballukun, duke thënë se «me Beqir Ballukun kam kontradikta parimore». Beqir Balluku këtë sulm nuk e priste, i erdhi nga prapa krahëve dhe u përpoq ta frikësonte Petrit Dumen, i ra fort tavolinës duke thënë: «Komiteti Qendror t'i shkojë deri në fund kësaj çësh-

tjeje». Por ai ra brenda. Dhe Partia i shkoi deri në fund çështjes.

Byroja Politike e kuptoi se kemi të bëjmë me tradhti, se këta zihen për të marrë fuqinë, të bëjnë puçin dhe ne të firmosim atë që duan ata. Por në atë kohë Byroja Politike tha që kryesorja është t'i nxirren rrënjët kësaj pune, pa e hedhur menjëherë në gjyq Beqirin për ta dënuar, se i vdekuri nuk flet. Dhe kësaj pune i hyri Partia. Doli qartë se edhe Petrit Dumja e Hito Çakoja janë të rrezikshëm, pra të tre, Beqir Balluku, Petrit Dumja e Hito Çakoja, kanë qenë dakord në qëllimet e tyre kundër Partisë.

Puna armiqësore e tyre nuk është vetëm materiali i zi, kryesorja është me mbyt Partinë në ushtri, dhe deri diku kjo ishte arritur. Ishin zhdukur normat, ishte futur frika, ishte dobësuar organizata e Partisë në ushtri, kjo kishte humbur forcën, hierarkia kishte zhdukur demokracinë, komandonin ata kuadro të ushtrisë që ishin anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë, dominonte prepotenca, arroganca. Këto janë fakte që ne po i kalojmë në duar.

Drejtoria Politike nuk duhej të ishte në Ministrinë e Mbrotjtjes. Ajo u bë një formë organizative e papërshtatshme, që shkaktoi izolimin e Partisë në ushtri nga Komiteti Qendror i Partisë. Ajo nuk duhej lënë gjatë, duhej likuiduar me kohë, jo të ndërrohej lokali, por koncepti për Drejtorinë Politike. Puna e Partisë në ushtri duhej të bëhej nga instruktorët e Komitetit Qendror, njësoj si me terrenin, si me të gjithë sektorët. Puna politike në ushtri duhet të zhvillohet njëlloj si me atë punëtorin e naftës, me të cilin, kur punon për ta ngritur politikisht e ideologjikisht, arrihen rezultate të larta në

punë. Kështu edhe oficeri, po u ngrit e u aftësua nga ana politike e ideologjike, po të mësojë edhe artin ushtarak, atëherë ai drejton mirë. Nuk mjaftojnë lidhjet që mbaheshin me Drejtorinë Politike, këto lidhje duheshin mbajtur me bazën, me komunistët, me ushtarët dhe kjo nuk është bërë mirë.

Armiqtë në ushtri vepruan që disa kuadro t'i ngrinin në përgjegjësi, t'u jepnin privilegje për t'i pasur njerëz të tyre, kurse të tjerë t'i demoralizonin. Nga ata që ngriheshin në poste, që u jepeshin vetura, do të siguroheshin, sipas tyre, edhe njerëz për puçin. Ky ishte një veprim armiqësor i rrezikshëm, që zhvillohej prej vitesh, që ushtria të bëhej e pafuqishme. Prandaj duhet kuptuar mirë rrezikshmëria e kësaj pune armiqësore, sepse kuadro ushtarakë, që kanë qenë trima në luftë, u frikësuan, u mposhtën nga tre armiq, të cilët donin të dobësonin ushtrinë, forcën mbrojtëse të saj, donin të përgatitnin terrenin për një ndërhyrje eventuale ushtarake nga jashtë. Sepse puçi nuk kryhej vetëm, duhej edhe përkrahja e armiqve të jashtëm. Këtu çonin antitezat e Beqir Ballukut që diheshin nga Hito Çakojja, Petrit Dumja, Sadik Bekteshi e ndonjë tjetër. Këta ishin kundër Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, prandaj përpunohej një material, i cili u kundërvihej tezave të Partisë, i deformonte ato dhe dobësonte mbrojtjen. Për këtë Beqir Balluku bashkë me Petrit Dumen kanë thirrur kalemxhinjtë në Pogradec për t'i përpunuar antitezat (materialin e zi). Petrit Dumja e Hito Çakojja i panë këto materiale dhe i thanë Beqir Ballukut që të përmirësohen, dy materialet e para të mos shpërndahen, por Beqir Balluku i shpërndau, bëri gabim sipas tyre dhe, kur doli materiali i tretë, këta pandehën se

u mbyll kjo histori, pra menduan se «s'na e mori vesh udhëheqja». Por udhëheqja e mori vesh, e nuhati. Kur Petriti u thirr, atëherë ai pati frikë dhe mendoi se kjo çështje s'mbaron me kaq, do të vejë në Byronë Politike, e cila s'më lëshon kollaj, prandaj u hodh në sulm kundër Beqir Ballukut që të shpëtonte për vete.

Kur u shtrua çështja në Byronë Politike ne u thamë: pse nuk informuat për antitezat? Kjo pyetje ishte si një kockë e fortë që u mbeti në fyt. Ata u shprehën: «Bëmë gabim të madh». Por Petriti dhe Hitoja jo vetëm që sulmuan Beqir Ballukun, por me të dalë nga mbledhja vanë e zunë kuadro kryesorë, duke u thënë: «Bëni deklaratat se jeni kundër materialit të zi të Beqir Ballukut». Këtë e pohoi më vonë Halim Ramohitoja: «Më thirri Hito Çakoja e më tha «bëni shkresa që jemi kundër antitezave të Beqir Ballukut». Dhe unë kështu bëra». Pse u bë kjo? Petriti e Hitoja menduan: «Ne u dogjëm, prandaj të dy të djegim njërin. Beqir Ballukun».

Beqir Balluku s'tha asnjë fjalë kundër Petritit e Hitos, megjithëse këta folën për të. Ai i dinte të gjitha ato që kishin bërë këta të dy, po pse nuk tha gjë Beqir Balluku kundër tyre? Ai nuk tha gjë për të mbrojtur një çështje tjetër më të madhe, komplotin. Ajo që kishin ndër mend të bënin, të bëhej edhe pa Beqir Ballukun. Dhe kështu Petriti e Hitoja u gëzuan, na dolën si shpëtimtarë të situatës!

Këtë manovër Byroja Politike nuk e hëngri, ajo donte të shikonte qëndrimin e tyre, të dinte ç'do të bënin, por ajo donte të shikonte edhe qëndrimin e ndonjë shoku tjetër kryesor të ushtrisë. Ne donim të zbullohej me rrënjë puna armiqësore, kurse Petrit Dumja e

Hito Çakoja u munduan të tregonin se veç Beqir Ballukut, tjetër njeri s'ka! U bë aktivi i Durrësit, por ata nuk thanë asnjë fjalë, bile më keq vepruan edhe në Plenum, fajet ia lanë Beqir Ballukut. Kjo tregon se ata e kishin dëmtuar shumë Partinë. Ata kujtuan se kjo punë mori fund. Pas aktivitet të Durrësit i thamë Petritit që të kthehemi në organizatë. Petriti tha: «Jo, nuk ka nevojë të shkojmë në organizatën-bazë, por vetëm të shpjegojmë Tezat dhe antitezat». Por ne s'e kishim këtu qëllimin, ne donim të provonim Petrit Dumen. Kur e pyetëm Petritin përsëri: «Pse s'ia ke thënë Partisë», atëherë ai s'kishte nga mbahej, por u përpoq të kalonte me përgjigjen: «Ja kam thënë, pse më pyesni prapë?».

Ti je në Byronë Politike, i thamë, takohesh sa herë me ne, pse nuk na ke thënë gjë, apo s'kishte besim te ne. Ti u tregove kaq i rreptë kundër Beqir Ballukut, ti kishte kundërshtime parimore me të, prapë s'na kishte thënë gjë. E porosita të reflektojë. Pas kësaj më bëri një letër, por në këtë letër u fut më thellë, ra keq brenda, se ai mendonte që një shok tjetër kishte ardhur tek unë e më kishte raportuar më parë.

Këta që të tre janë armiq, që vepronin kundër Komitetit Qendror, kundër Partisë dhe pushtetit popullor. Çështja është e qartë, mbetet të sqarohen lidhjet me jashtë. Më e mundshme është t'i kenë me sovjetikët, por mundet edhe me NATO-n, edhe me jugosllavët.

Kjo që na ngjau në ushtri është e rëndë, por situatën do ta kapërcejmë patjetër. Ta shërojmë ushtrinë tonë, se roli i saj është i rëndësishëm, prandaj duhet të marrim masa. Njerëzit t'i shërojmë në rrugë partie, sepse jo të gjithë kuadrot e ushtrisë që kanë gabuar

janë armiq. Ata që kanë bërë gabime t'i kuptojmë, pse janë në gjendje të vështirë shpirtërore dhe janë të preokupuar si ranë në këto gabime, si do ta bëjnë kthesën. Ka shokë që mendojnë shumë për këtë gjë. Prandaj Partia duhet të punojë me ta, t'i ndihmojë të kuptojnë se normat e Partisë janë shkelur, por të jemi edhe elastikë, sepse bëhet luftë për të shpëtuar njerëzit dhe kjo nuk është politikë lëshimesh. Fshesën e hekurt ta përdorim vetëm kundër armiqve, kurse shokët që janë infektuar t'i shërojmë. Ka shokë që kanë gabuar se janë gënjyer dhe kanë pasur frikë. Prandaj shokët e Komitetit Qendror dhe të tjerë që do të punojnë, të luftojnë për të vendosur normat, por edhe të shpëtojmë njerëzit, sepse kjo u ra edhe atyre si një bombë. Ata nuk mund ta realizojnë menjëherë këtë që ngjau në ushtri, prandaj hezitojnë në autokritikë. Partia duhet të punojë me durim, me mbledhje të organizatës, në mënyrë individuale, në frymë marksiste-leniniste.

I sëmuri nuk shërohet menjëherë, me një ilaç. Ka shokë që kanë marrë doza helmi tepër, për vite me radhë. Këtu duhet pjekuria e Partisë, pjekuria jonë. Duhet ton, por edhe takt. Edhe toni ka rëndësinë e vet, por ka raste që kur flitet pa ton, me takt, njeriu tronditet shumë. Nuk është nevoja të bërtasësh për t'i treguar tjetrit rrugën e drejtë. Ata kanë gabuar, por dhe ne kemi gabime. ata kanë mbeturina, por edhe ne kemi mbeturina. Ta kuptojmë njeriun se është një objekt i sëmuri, por është edhe subjekt i shërueshëm dhe të kemi bindje se do ta shërojmë. Kemi mijëra kuadro të mirë në ushtri, por ka edhe nga ata që duhen hequr, se kanë bërë dëme të mëdha.

Pse na ngjau kjo në ushtri? Sepse ushtria është

një terren i mbyllur si në vazo. Por edhe në terren ka të meta e dobësi, ka prepotencë, arrogancë, ka byro e komitete partie që japin edhe raporte fiktive. Këto janë të hidhura dhe të rrezikshme për çdo sektor. Prandaj ju instruktorët kur ktheheni nga terreni, t'i raportoni udhëheqjes, por të mos na sillni një mijë e një konstatime. Komiteti Qendror ka nevojë të informohet për probleme të rëndësishme, ndërsa çështjet e vogla, që janë në kompetencën tuaj, t'i zgjidhni vetë, sepse në qoftë se do të na jepni shumë çështje nuk do të dalë në pah problemi kryesor nga i cili udhëheqja të nxjerrë konkluzione.

Kur ishit për kontroll me ekip në ushtri, ju na thatë në Byronë Politike plot konstatime, dhe ne menduam se këto janë njëlloj si në terren. Po të na thoshit një konstatim të rëndësishëm, për shembull, që në ushtri ka frikë, atëherë do të ishte ndryshe, do të na tërhiqej vëmendja më mirë.

Po këtu nuk është faji juaj, është faji edhe yni që punën e Partisë në ushtri ia kishim lënë kryesisht Drejtorisë Politike. Mungesë kontrolli të organizuar ka edhe në terren. Për shembull, është kontrolluar nga Komiteti Qendror i Partisë Ministria e Financave, Banka ose a është kontrolluar ushtria nga Ministria e Financave? A është kontrolluar ndonjëherë nga ju Ministria e Punëve të Brendshme? Jo të kontrolloni normat, ka apo jo kritikë, por përse s'ka. Kontrolli të bëhet për gjëra konkrete, për shembull, si është politika e goditjes. Komiteti Qendror duhet të kontrollojë që Partia të jetë kudo luftarake, të vihet në krye të punës dhe shokët e Komitetit Qendror të ndihmojnë që të bëhet e tillë. Kështu siç ndodh sot, që me degën

e punëve të brendshme të mbajë lidhje vetëm sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, nuk mund të vazhdojmë. Kjo nuk mund të jetë vetëm një privilegj i sekretarit të parë. Udhëheqja e Partisë duhet të njohë mirë gjendjen, se vetëm me ato që na thoshin Hito Çakoja e Beqir Balluku nuk mund të ecet. Kur vinte Beqir Balluku tek unë, më fliste për gjëra të parëndësishme. Takimet me të ishin mërzitja ime më e madhe, sepse më informonte për gjëra të vogla.

Këtej të nxjerrim mësimin që gjërat e vogla të zgjidhen nga ju, sipas kompetencave të gjithsecilit, mua dhe udhëheqjes të na jepni probleme të mëdha, që nuk mund t'i zgjidhni ju. Po të sillni gjëra të vogla, të mos ofendoheni kur t'ju thonë që kjo s'është për mua. Te sekretarët e Komitetit Qendror të vini për gjëra që i kalojnë kompetencat tuaja, veç jo në këmbë, por të studiuara. Kështu shokët do të mësohen të punojnë me kokën e tyre, të jenë të guximshëm, të mbajnë përgjegjësi. Jo për çdo gjë të shkohet tek eprori e të pyetet ky, si ta bëj atë e si ta bëj këtë, por secili të vrasë mendjen e të bëjë punën e tij. Të gjitha këto të na bëhen mësim edhe për punën e Partisë në terren. Të marrim masa, por masat të jenë të studiuara.

Dëgjova këtu se do të bëni disa tema, nuk jam kundër temave, por mos u mundoni të perifrazoni, materiale ka boll Partia dhe shumë të mira. T'i mësojmë njerëzit e Partisë t'u rikthehen jo vetëm materialeve të vitit 1972, por edhe materialeve të mëparshme. Këto materiale nuk janë pa vlerë, janë materiale të nxjerra nga eksperiencia dhe që i kanë vërtetuar lufta e praktika jonë, ato janë marksiste-leniniste. Mbase nuk janë të sistemuara si veprat e Marksit e të Leninit, por ai



që do të merret me teori të madhe le të shfletojë Mar-ksin, Engelsin, Leninin e Stalinin. Por ka ndonjë që mundohet të bëjë teori të madhe, që hiqet si filozof dhe na merr teza të revizionistëve e na i servir për të edukuar anëtarët e Partisë sonë!

Organizatën-bazë nuk duhet ta zhvillojmë me formula, merrni një problem ose dy dhe me eksperiencën tuaj i thelloni ato. Këtu u fol që të dërgohen shokë nga terreni në ushtri. Nuk jam kundër këtij mendimi, por ne duhet edhe komisarët t'i bëjmë të zotë, se janë nënvleftësuar, spostuar, por këta janë shokë të mirë, të luftës. Kur them të luftës, të kuptohemi mirë, nuk e kam fjalën për ata të Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe për të luftës për ndërtimin e socializmit, sepse, ashtu siç ka thënë Lenini, lufta për ndërtimin e socializmit, për mbajtjen dhe forcimin e pushtetit është më e vështirë se lufta për marrjen e këtij pushteti. Kush ka bërë Luftën Nacionalçlirimtare dhe sot bën luftën për ndërtimin e socializmit, konsekuent në vijën e Partisë, atëherë ky është edhe më i kalitur, por jo të ndodhë që ndonjëri të mbahet me luftën, të mburret me të kaluarën dhe sot nuk është në rregull, gënjen, vjedh etj. Ka ushtarakë që nuk zbatojnë si duhet programet, që nuk kanë kryer mirë detyrat. Këta t'i ndihmojmë dhe të kemi besim se do të ndreqen, të mos e konsiderojmë veten sikur jemi superiorë dhe ata kërkojnë mëshirë nga ne. Nuk ka mëshirë kristiane në Partinë tonë, por ndihmë shoqërore, në rrugë partie, jo me prepotencë, por me bindje. Ndryshe ka rrezik të uëshqehet kulti i udhëheqjes. Edhe personin, edhe udhëheqësin që punon mirë duhet ta duash e ta nderosh. Personi dhe udhëheqja e ka për detyrë të të bindë. Udhëheqësi dhe çdo

shok me përgjegjësi, kur shkon në organizatën-bazë, duhet të jetë modest dhe, me qëndrimin e tij, të krijojë një ambient të ngrohtë, ku shokët të shfaqin lirisht mendimet e tyre, ashtu si i kanë. Edhe për një çështje jo të drejtë nuk duhet vepruar me prepotencë, por me durim, për të krijuar bindje te njerëzit për drejtësinë e çështjes dhe, pasi të zhvillohet një luftë mendimesh midis shokëve, të sigurohet uniteti i veprimit.

*Në fund të mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë, u paraqitën biografitë e tre shokëve të rinj që kishin ardhur në efektivin e kësaj organizate. Shoku Enver Hoxha, duke dëgjuar biografitë e tre komunistëve të rinj, që ishin për një kohë të gjatë punëtorë dhe erdhën në aparatit e Komitetit Qendror të Partisë, tha:*

Shokë të tillë, nga klasa punëtore, na sillni lart. në Komitetin Qendror, sepse Partia ka nevojë për të pasur në udhëheqje prej tyre.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 64*

*Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë, që gjendet në AQP*

# SI DUHET TË FUNKSIONOJNË ORGANIZATAT E PARTISË NË USHTRI

Udhëzime

26 nëntor 1974

Partia duhet të jetë në udhëheqje të ushtrisë. Kjo do të thotë se vendimet e kongreseve, të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit janë orientimet bazë, mbi të cilat duhet të bazohet organizata e Partisë në ushtri, që me organizatat-bazë në reparte, me komitetet e Partisë në njësitë dhe me aparatet e tyre, nëpërmjet komisarëve dhe zëvendëskomisarëve e ushtron nga afër këtë drejtim.

Të gjitha parimet, normat, kërkesat e rregulloret e Partisë, të drejtat dhe detyrat që Statuti i Partisë u cakton anëtarëve dhe kandidatëve të saj, janë të njëjta për të gjithë; të tërë janë të detyruar t'i njohin dhe t'i zbatojnë ato pa asnjë dallim vendi, pune, moshe dhe vjetërsie në Parti. Asnjë privilegj nuk lejohet për kërrkënd, në çdo funksion që të jetë në Parti dhe në shtet.

Çdo vendim që merret nga organet udhëheqëse kryesore të Partisë duhet t'u kalojë për dijeni dhe veprim edhe organeve të Partisë në ushtri. Kjo nuk duhet kuptuar në mënyrë formale: «Komisari dhe koma-

ndanti morën dijëni dhe mbi vendimin u shënuan fjalët: «U pa»». Jo. Pasi të marrë dijëni komisari, ky, edhe kur vendimi të jetë vetëm sa për t'u njohur, duhet të përgatitet dhe t'ia shtrojë atë komitetit ose organizatës-bazë me detyra të konkretizuara, veçanërisht kur duhet t'i shtrohet gjithë Partisë dhe ushtrisë. Kur vendimet e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit do t'i dërgohen Partisë, duhet t'i dërgohen, gjithashtu, edhe ushtrisë, kurse ato të komitetit të Partisë të rrethit, që mendohet t'u dërgohen organizatave-bazë të Partisë për dijëni, t'u dërgohen edhe organizatave të Partisë të reparteve, por vetëm atyre brenda rrethit. Këto vendime të fundit më shumë e në përgjithësi janë sa «për dijëni», por ato nuk janë vetëm për komandantin dhe për komisarin.

Studimi dhe zbatimi i vendimeve dhe i udhëzimeve që i venë ushtrisë dhe reparteve të saj nga lart ose nga komiteti i Partisë i rrethit duhet të kontrollohen nga ana e Komitetit Qendror dhe nga aparati i tij, nga komiteti i Partisë i rrethit e aparati i tij. S'duhet harruar dhe neglizhuar, gjithashtu, kontrolli punëtor i dërguar dhe i përgatitur nga Komiteti Qendror ose nga komiteti i Partisë i rrethit për disa probleme që këta mendojnë se ky kontroll është i nevojshëm dhe i dobishëm. Komitetet e Partisë në ushtri janë të detyruara t'i raportojnë Komitetit Qendror dhe komiteteve të Partisë të rretheve për fatin e vendimeve të dërguara. Ato duhet të raportojnë seriozisht, realisht dhe në këto raportime të jepet si konkluzion mendimi i organizatave-bazë të Partisë për çështjet që trajton çdo vendim. Komiteti Qendror ose komiteti i Partisë i rrethit duhet të organizojë edhe kontrole të befasishme

për vërtetimin e disa problemeve të caktuara, për të cilat linden dyshime në raportimet që bëhen.

Çdo ushtar dhe oficer e ka për detyrë dhe të drejtë që t'i shkruajë drejtpërdrejt Komitetit Qendror ose komitetit të Partisë të rrethit për ndonjë çështje, për ndonjë padrejtësi, për ndonjë kuadër që ka sjellje të këqija. Letrat që i dërgohen udhëheqjes së Partisë nuk duhet të hapen dhe të kontrollohen nga komanda. Kush e shkel këtë porosi dënohet.

Dërgimi i letrave udhëheqjes së Partisë nga ushtarët dhe oficerët duhet të konsiderohet si një ndihmë shumë e çmueshme që i jepet Partisë nga ana e tyre. Kjo praktikë në ushtri jo vetëm që nuk aplikohet, por, në të kundërtën, luftohet dhe goditet nga «hierarkia», pse gjoja me këtë «ulej prestigji dhe autoriteti i kuadrove». Faktet na treguan sa e rrezikshme ka qenë kjo pikëpamje dhe kjo procedurë dhe sa të këqija i solli ajo ushtrisë dhe kuadrove.

Kompetencat dhe detyrat e komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të reparteve, kompetencat dhe detyrat e organizatave-bazë dhe të byrove të tyre, atje ku ka, ato të sekretarëve të Partisë të të gjitha instancave, janë të njëjta si në gjithë Partinë, në të gjithë sektorët e punës. Në këtë drejtim ka përgjegjësi kolegjiale, ka edhe përgjegjësi personale për funksionet që i janë ngarkuar secilit dhe që duhet t'i kryejë gjithmonë në funksion të vendimeve kolegjiale. Ka, gjithashtu, përgjegjësi personale për çdo komunist për kryerjen e detyrës atje ku secili është ngarkuar të ushtrojë profesionin...

Format organizative të Partisë dhe të rinisë, ndry-

shimet e herëpashershme në to, lidhjet, vartësitë e tyre brendapërbrenda ushtrisë dhe me komitetin e Partisë dhe të rinisë jashtë ushtrisë, vendosen nga Komiteti Qendror i Partisë. Organizata e Partisë në ushtri, kur e sheh të nevojshme, mund t'i bëjë çdo propozim Komitetit Qendror të Partisë në këtë drejtim. Propozimet duhet të jenë fryt i studimeve serioze shkencore, të diskutuara në Parti, në komandë dhe të miratuara në formë kolegjiale.

**Partia në ushtri organizohet, zhvillohet, rritet dhe kalitet në bazë të nevojave që paraqiten, në mënyrë që t'i mbulojë të gjitha drejtimet e ushtrisë, armët dhe repartet e ndryshme ushtarake të saj.** Kjo është një nga çështjet e rëndësishme organizative të Partisë në ushtri. Kjo është, gjithashtu, një punë shkencore dhe jorutinë, joburokratike. Komiteti Qendror i Partisë ka caktuar norma dhe kritere për këtë çështje të përgjithshme për gjithë Partinë, por edhe për çështje të veçanta, për sektorë pune të rëndësishëm nga madhësia ose nga përbërja etj. Kështu që për ushtrinë puna ka karakteristikat e veta. Ky organizim dhe dinamizmi i zhvillimit në të gjithë komponentët e ushtrisë duhet të ndiqet këmba-këmbës nga Partia në ushtri dhe nga sektori i kuadrit në Ministrinë e Mbrojtjes që duhet të jetë kryesisht organ i Partisë dhe të mbajë lidhje me sektorin e kuadrit të Komitetit Qendror të Partisë, me atë të Statutit, pra me sektorët organizativë në radhë të parë.

**Politikën e kuadrit në ushtri e udhëheq dhe e bën Partia, sipas rregullave të vendosura nga Komiteti Qendror i Partisë...** Politika e kuadrit nuk konsiston vetëm në procedurën e vendosjes së kuadrit, por edhe në

edukimin, në rritjen, në kalitjen dhe në përgatitjen e tij. Në këtë çështje nuk po zgjatem se kam folur edhe herë të tjera.

Të gjithë komunistët në ushtri, të inkuadruar në organizatat përkatëse të Partisë, kanë për detyrë të mendojnë, të punojnë dhe të militojnë që Ushtria jonë Popullore të jetë një ushtri e edukuar politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht në rrugën marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë, të jetë një ushtri me organizim të përsosur, që t'u përgjigjet realitetit, kushteve dhe nevojave të mbrojtjes së vendit, t'u përgjigjet nevojave të përballimit me sukses të sulmeve eventuale të armiqve, të brendshëm dhe të jashtëm, të mësohet të bëjë luftën e gjerë popullore në bazë të strategjisë dhe të taktikës që kanë përcaktuar Komiteti Qendror dhe Këshilli i Mbrojtjes, të jetë një ushtri e armatosur me armë sa më moderne dhe në sasi të mjaftueshme për një luftim të gjatë e në rrethim.

Për t'ua arritur si duhet këtyre objektivave, të gjithë: komunistë e kuadro, ushtarë të thjeshtë, anëtarë të organizatës së rinisë duhet t'u kushtohen totalisht objektivave që përcaktova më lart. Që të arrihet kjo, të tërë pa përjashtim duhet të lartësohen në mënyrë që të gjitha detyrat e përgjithshme dhe speciale, në grup ose si individë, në punë partie dhe ushtarake kurrë të mos konsiderohen të ndara dhe të shkëputura nga njëra-tjetra, por kurdoherë të lidhura ngushtë dhe në unitet midis tyre, të kuptohen dhe të zbatohen në frymë të lartë partie. Në frymë të lartë partie të kryhet stërvitja luftarake, në frymë të lartë partie të bëhet edukimi teorik, zhvillimi i punës ideologjike dhe i shkencës ushtarake, në frymë të lartë proletare të bëhet zbatimi

i parimeve dhe i normave të Partisë, i ligjeve dhe i rregulloreve ushtarake.

Prandaj detyra e Partisë në ushtri është e dyfish-të: edukimi politiko-ideologjik i efektivit dhe edukimi ushtarak i tij. Të dyja këto përbëjnë një detyrë të vetme e të madhe. Në Ushtrinë tonë Popullore, që edukohet dhe udhëhiqet nga Partia, këto detyra nuk mund të ndahen, ato duhet të ccin paralelisht, shtrënguar njëra me tjetrën. E para ndihmon që e dyta të kryhet mirë dhe si duhet. Po nuk u realizua e para si duhet, e dyta dobësohet dhe i tërë edukimi ndërron formë në orientimin politiko-ideologjik dhe ushtarak.

Prandaj në tërë këtë proces të madh pune kanë rëndësi organizimi i ushtrisë, organizimi i Partisë, formimi dhe kalitja e kuadrove, shpërndarja e tyre e drejtë dhe e përshtatshme, edukimi e stërvitja e vazhdueshme dhe e vazhdueshme. Për këtë edukim shërbejnë programet për edukimin politiko-ideologjik dhe për edukimin ushtarak, për edukimin e përgjithshëm dhe atë special. Asnjë nuk duhet t'i shpëtojë këtij edukimi politiko-teorik, asnjë nuk duhet t'i shpëtojë edukimit të përgjithshëm ushtarak. Të inkuadruarit në edukimin në specialitete të ndryshme duhet të përvetësojnë më së miri specialitetin.

Rëndësi të madhe marrin dhe programet e kategorive të ndryshme, hartimi dhe përgatitja, zbatimi i tyre me efikasitet dhe me sukses në jetë, dhënia e mësimi dhe përvetësimi i thellë i dijeve. Ky është një nga proccset më të rëndësishme. Pa i vendosur të gjitha këto drejt, në frymë partie, në rrugë partie marksiste-leniniste, pa kontrolluar zbatimin e tyre, pa u frymëzuar për çdo gjë nga një temp dhe hov revolu-



cionar, nuk mund të kemi, as mund të ndërtojmë dhe të edukojmë një ushtri ashtu siç e do Partia... Ministria e Mbrojtjes dhe Partia në ushtri janë përgjegjëse përpara Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë për zbatimin si duhet të programeve.

Duhet të caktohet periudha e rishikimit të programeve dhe ndryshime parimore nuk mund të bëhen veçse nga Komiteti Qendror dhe nga Qeveria në bazë të propozimeve. Nuk lejohet largimi nga programet. Përmirësime në metodën e dhënies së mësimëve, në pastrimin e brendisë së programeve dhe në korrigjimin e gabimeve mund dhe duhet të bëhen, por këto duhet të jenë fryt i eksperiencës personale dhe kolektive dhe kurrë nuk mund të lejohet që të bëhen në mënyrë të pakontrolluar dhe të paaprovuara.

I gjithë edukimi politiko-ideologjik në ushtri duhet të bazohet në teorinë marksiste-leniniste, në klasikët tanë të marksizëm-leninizmit dhe në materialet e Partisë së Punës të Shqipërisë. Çdo material, çdo argument, në çdo formë edukimi qoftë, duhet të ketë këtë vullë. Edukimi ideologjik duhet të plekset dhe me praktikën e Partisë sonë të Punës. Nuk lejohet të studiohet teoria për teori, jashtë realitetit dhe jashtë punës revolucionare që zhvillohet sidomos në atdheun tonë. Puna politiko-ideologjike në ushtri nuk mund të zhvillohet pa e lidhur ngushtë me stërvitjen e gjithanshme të Ushtrisë Popullore.

Nuk mund të lejohen libra të huaj nëpër biblioteka të ushtrisë pa aprovimin e komisioneve të zgjedhura posaçërisht nga Partia. Komisionet janë përgjegjëse për këtë punë përpara Partisë dhe përpara komandës.

**Vendimet që merren nga Partia dhe nga Ministria**

e Mbrojtjes duhet të zbatohen me përpikëri nga i gjithë efektiv i ushtrisë. Çdo gjë duhet të zhvillohet, të mësohet dhe të zbatohet në mënyrë krijuese dhe në frymë revolucionare. Të gjitha vendimet, të çdo natyre qofshin, të marra në mënyrë kolegjiale, duhet të zbatohen me rreptësi nën drejtimin e komandantit dhe të komisarit, të cilët për këtë çështje janë përgjegjës përpara komandës dhe Partisë. Të dy këta, të ndihmuar nga të gjitha aparatet e tyre, me t'u marrë vendimi, me t'u dhënë urdhri, me t'u caktuar programet, duhet të zërthejnë me seriozitetin më të madh detyrat, të japin urdhra për formën, për mënyrën e shtruarjes e të dhënies së mësimit dhe të organizojnë, gjithashtu, me seriozitet të madh sigurimin e bazës materiale dhe kontrollin e punës për zbatimin e vendimit.

**Ka kontroll partie dhe kontroll komande.** Të dy këto kontrole duhet të bëhen me frymë partie, duke observuar si zbatohen normat e Partisë, ligjet e rregulloret ushtarake, si bëhet puna ideopolitike. Të dy këto kontrole duhet të jenë të koordinuara, pse janë të kushtëzuara njëra nga tjetra, pavarësisht se mund të bëhen nga grupe të veçanta, në kohë të ndryshme dhe me objektiva të veçantë. Të gjitha kanë një qëllim dhe pikërisht ky qëllim i madh i përbashkët duhet të jetë konkluzioni i këtyre përpjekjeve: kryerja si duhet e të gjitha detyrave që Partia i ka vënë ushtrisë.

**Komandanti dhe komisari i njësisë ose i repartit** duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë me njëri-tjetrin, por asnjëherë jashtë frymës dhe normave të Partisë. Kjo do të thotë që të dy, edhe komandanti,

edhe komisari, duhet të jenë njerëz partie në radhë të parë, pavarësisht se komandanti mund të mos jetë gjithnjë anëtar partie. Asnjë nuk është epror mbi tjetrin në funksione. Të dy, pa dallim, janë kuadro, në dy funksione të ndryshme dhe funksionet nuk lejojnë të krijohet përçmimi. Të dy janë në komandë. Të kuptohet drejt «qenia në komandë». Në komandë kudo është Partia. Edhe komandanti, edhe komisari, edhe ministri, apo edhe drejtori komandojnë në emrin e Partisë dhe jo në emrin e tyre personal. Kjo do të thotë që këta flasin, zbatojnë, urdhërojnë në bazë të vendimeve, të urdhëresave, të ligjeve, të normave e të formave të punës që ka vendosur Partia. Prandaj çdo gjë në Parti zhvillohet në frymë revolucionare. Pra, në ushtri, gjithçka që përmenda më lart, duhet të kryhet në frymë partie. Të bazuar në këtë duhet të ndryshohen shumë pikëpamje të gabuara që u zhvilluan kohët e fundit në ushtri.

Disiplina ushtarake nuk kuptohet kurdoherë drejt. Disiplina ushtarake duhet të jetë një disiplinë e ndër-gjegjshme për një çështje të madhe që arrin deri në sakrificën e fundit: të vritesh për të mbrojtur atdheun. Për këtë qëllim në ushtri duhet të edukohen pa përjash-tim të gjithë, por edukimi duhet të bëhet nëpërmjet më-simeve ideologjike dhe politike, nëpërmjet praktikës dhe nëpërmjet stërvitjes. Nga Partia nuk pranohet që ushtari të bëhet *perinde ac cadaver*<sup>1</sup> në dorën e komandantit. Përkundrazi, ushtari dhe oficeri më parë duhet të bi-

---

1. Latinisht — si një trup i vdekur. Në tekst ka kuptimin e të genit i bindur dhe i disiplinuar verbërisht.

nden për atë që do të kryejnë, duhet të mësojnë dhe të edukohen që çdo gjë ta mësojnë mirë dhe ta kryejnë mirë, të binden për të në radhë të parë vetë e pastaj të bindin edhe të tjerët.

**Demokracia proletare dhe disiplina proletare duhet të vendosen me baza teorike në ushtri, këto jo të njihen me fjalë e slogane dhe në praktikë të veprohet krejt ndryshe, domethënë të mos ketë demokraci, po dhunë, arrogancë, prepotencë. Burimi i arrogancës dhe i prepotencës rrjedh pikërisht nga moskuptimi i drejtë i këtyre çështjeve me karakter të thellë ideologjik: i kupton dhe i zbaton këto gjëra në rrugën marksiste-leniniste apo të duket sikur i kupton dhe i zbaton si në ushtritë borgjeze.**

Në ushtri, si kudo, duhet të ketë dënime, natyrisht sipas shkallës së fajeve që bëhen. Dënimet nuk mund të jenë dhe të lihen në dorë të komandantit apo të komisarit pse «kështu duan këta», pse «këta komandojnë», pse «këta janë eprorë», pse «këtyre duhet t'u binden», pse gjoja «janë garantë për çdo gjë përpara Partisë dhe komandës». Dënimin duhet ta japë kolektivi, organizata-bazë, gjithë shtabi i njësisë apo i repartit. Asnjë dënim nuk mund të jepet në formë individuale, domethënë nga një person. Për krimet veprohet si duhet vepruar për to. Dhënia e dënimit për fajet që kryhen nuk duhet të jetë një akt i thjeshtë, por të jepet para kolektivit nga komandanti, komisari, sekretari i organizatës-bazë të Partisë dhe nga komunistët. Mbledhja për këtë qëllim duhet të kthehet në një mbledhje edukative për të shpjeguar teorikisht e praktikisht shkaqet dhe dëmet që rrjedhin prej fajeve të ndryshme.

Të thirrurit me zë të lartë nga ana e komandantëve dhe e oficerëve gjatë dhënies së komandës është vetëm një formë komunikimi që duhet t'i shërbejë dëgjimit të urdhrin nga të gjithë dhe asgjë tjetër. Komandanti gjatë dhënies së komandës duhet të zhdukë pikëpamjen e gabuar se, kur bërtet ai, «reparti është në këmbët e tij dhe ai qenka perëndia, diktatori». Jo, ai nuk është veçse një ushtar i Partisë, si gjithë të tjerët, ai vetëm i transmeton repartit direktivat e Partisë, vullnetin e Partisë dhe jo dëshirat dhe tekat e tij. Edhe ata që duhet të zbatojnë urdhrin, kështu duhet t'i kuptojnë eprrorin dhe ato që u komunikon ai. Atë që thotë cprori ata duhet ta kuptojnë dhe, që ta kuptojnë, më parë duhet t'u shpjegohet që të binden se është e drejtë. Përkërisht në qoftë se komandanti dhe komisari i bëjnë si duhet të gjitha këto që thashë dhe i bëjnë në frymë partie, atëherë të tjerët do t'u binden, do t'i duan dhe do t'i respektojnë. Përndryshe, ata nuk mund të kenë besimin as të Partisë, as të masës.

Përpara Partisë, në organizatën-bazë, të gjithë komunistët janë njësoj, të gjithë kanë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat detyra. Në Parti kurrkush nuk mund të diktojë vullnetin dhe dëshirat e tij. Atje nuk ka as grada, as tituj, atje dikton ideologjia marksiste-leniniste, atje diskutohet dhe vendoset sipas normave të Partisë. Kritika nuk mund të ketë asnjë kufizim. Ushtar e kuadër janë njësoj përpara kritikës. Kushdo që bën faj duhet të kritikohet në rrugë partie, kushdo që ka bërë faj, ta njohë atë, të luftojë ta ndreqë dhe të shërohet.

Në ushtri nuk mund të ekzistojë autoritet, besim, nuk mund të ekzistojë, gjithashtu, bindje, demokraci e vërtetë dhe disiplinë proletare, në rast se u fshihen të

metat njerëzve, në qoftë se krijohen privilegje nën maskën se «i bie prestigji kuadrit», se «dobësohet komanda», se «nuk zbatohet urdhri». Këto në të vërtetë janë pikëpamje antiproletare. Në qoftë se ne u qëndrojmë këtyre sloganeve, atëherë në ushtri do të vazhdohet të na ngjasin ato që na ngjanë me Beqir Ballukun, me Petrit Dumen dhe me Hito Çakon. Ata përfituan dhe u fshehën pikërisht prapa këtyre sloganeve jomarksiste...

Puna trockiste-revizioniste e Hito Çakos, e Beqir Ballukut dhe e Petrit Dumes e kishte ulur përtokë rolin e komisarit, me qëllim që të likuidonin Partinë në ushtri. Duhet kuptuar drejt roli, pozita dhe detyra e komisarit. **Qenia komisar në ushtri është një funksion partie, njëkohësisht edhe komandë.** Komandant dhe komisar janë funksione në një nivel të barabartë. Zotësia e njërit apo e tjetrit, ngritja në zotësi të njëri ose tek tjetri nuk lidhen me rolin e funksionit që zënë në repart. Njëri merret me çështjet ushtarake dhe tjetri me punë partie. Njëri kompletton tjetrin, por nuk duhet të kuptohet në asnjë mënyrë sikur komandanti nuk merr vesh nga punët e Partisë dhe sikur komisari injoron çështjet ushtarake. Jo, të dy duhet të jenë të ngritur në të dy drejtimet, të jenë të ngritur në rolet e udhëheqjes, të dy të kuptojnë njësoj dhe drejt brendinë e programeve e të detyrave, të strategjisë dhe të taktikës së Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, të dy të njohin gjendjen moralo-politike të trupës, të dy të njohin zhvillimin e vendit dhe ndërtimin e socializmit, të dy duhet të jenë të ngritur nga ana ideologjike. Këto dituri, këto cilësi të dy duhet t'i fitojnë me punë dhe me edukim. Duke i pasur këto, atëherë ku qëndron uni-

teti? Pikërisht në atë që komandanti është posaçërisht i specializuar në anën ushtarake dhe, tok me komandantët e tjerë vartës të specialiteteve të ndryshme, ka për detyrë jo vetëm të komandojë, por sidomos të edukojë ushtrinë me artin ushtarak. Komisari është specializuar në njohuri në drejtim të edukimit ideopolitik të ushtrisë me problemet ushtarake. Por duhet të jetë e qartë se komisari politik nuk zë vendin e organizatës-bazë ose të komitetit të Partisë, ai nuk ua hipën këtyre në zverk, ligjin nuk e bën ky në Parti. Jo, aspak, ky është nën drejtimin e Partisë, është një funksionar i Partisë, një «instruktur», i deleguar i Partisë në repart për punët ideopolitike. Komisari, me gjithë komisarët e tjerë të repartit, me gjithë komunistët, me sekretarët e organizatave-bazë dhe me komitetet e Partisë, duhet të organizojnë dhe të zbatojnë programet e punës ideopolitike të ushtrisë. Komisari për këtë ka përgjegjësi partie dhe funksionale në komandë. Ai duhet të zbatojë të gjitha detyrat që i vihen nga Partia dhe nga komanda eprorë. Ai është nën urdhrat e tyre dhe jep llogari përpara tyre, ashtu siç jep edhe komandanti. Të dy, komandanti dhe komisari, janë përgjegjës për detyrat, sipas funksioneve, tok, që të dy, janë përgjegjës për perfeksionimin e gjithanshëm të stërvitjes së ushtrisë.

Të gjitha këto probleme, që mendoj se janë shumë të rëndësishme, duhet të zhvillohen që kuadrot të sqarohen për to dhe të edukohen me frymë marksiste-leniniste që t'i kuptojnë normat, ligjet, urdhëresat dhe funksionet në dritën e vërtetë të tyre, pse shumë gjëra, puna armiqësore e Beqir Ballukut, e Hito Çakos dhe e Petrit Dumes me bashkëpunëtorët e tyre i kishte bastar-

duar, i kishte zbratur nga brendia e tyre marksiste-leniniste revolucionare, kishte lënë disa maska sa për të fshehur të këqijat dhe sëmundjen.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 162*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përmbledhje veprash), vëll. I  
3-të, f. 178*



## SUKSESET NE I KEMI ARRITUR NE SAJE TË VIJËS MARKSISTE-LENINISTE TË PARTISË SONE

*Nga biseda me një delegacion<sup>1</sup> të partisë  
dhe të qeverisë së RP të Kinës*

28 Nëntor 1974

*Duke i uruar mirëseardhjen dhe duke e falënderuar delegacionin për transmetimin e përshëndetjes së partisë dhe të qeverisë kineze me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit të vendit tonë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Përshëndetjet e miqve janë gjithmonë inkurajim për ne. Ato na bëjnë të luftojmë akoma më shumë për të mirën e këtij populli trim dhe heroik, që ka bërë sakrifica të panumërta gjatë gjithë historisë së tij, të punojmë me të gjitha forcat që ai të udhëhiqet vazhdimisht për thellimin e revolucionit e ndërtimin e socializmit nga ideologjia e marksizëm-leninizmit, e cila u tregon rrugën e fitores proletariatit dhe gjithë popujve revolucionarë në botë.

Sukseset tona në ndërtimin e socializmit ne i kemi

---

1. Delegacioni kryesohej nga Jao Ven Juan, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të PK të Kinës. Më vonë u dënuua si pjesëtar i «katërshes».

arritur në sajë të rrugës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, me heroizëm, me punë e djersë, me ndershmëri e sakrifica dhe po me heroizëm e me sakrifica duhet e do t'i shtojmë ato. Populli shqiptar duhet të punojë edhe për t'i ruajtur fort fitoret e arritura, se ai ka përballë armiq të egër, tradhtarët e marksizëm-leninizmit dhe të të gjithë popujve të botës, revizionistët sovjetikë, ka përballë imperializmin amerikan dhe reaktionin botëror. Në marrëveshje me njëri-tjetrin, imperialistët dhe revizionistët armatosen e përgatiten çdo ditë për luftë kundër popujve dhe në radhë të parë kundër socializmit. Por vitaliteti i ideve të marksizëm-leninizmit dhe forca e popujve që kërkojnë liri janë të tilla që i kanë vënë përpara dhe u kanë dhënë grushte vdekjeprurëse imperializmit e socialimperializmit.

Armiq e tradhtarë të shitur tek imperialistët e socialimperialistët kanë dashur të shkatërrojnë socializmin duke goditur në radhë të parë partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe lëvizjen botërore marksiste-leniniste, por forca e ideve të marksizëm-leninizmit, forca e popujve i kanë shpartalluar planet e tyre. Ashtu siç fshimë tradhtinë e Beqir Ballukut dhe të të tjerëve para tij, ne do të fshijmë e do të likuidojmë çdo armik që do të guxojë të ngrejë kokën kundër Partisë e popullit tonë.

Armiqtë te ne synonin të përgatitnin terrenin për të lehtësuar invadimin e vendit tonë nga agresorët e huaj. Për këtë qëllim, ata u përpoqën ta komprometonin ushtrinë tonë, ta demoralizonin atë dhe t'i praktikonin taktikat dhe strategjinë e luftës sonë në mënyrë të tillë që revizionistët sovjetikë ta gjenin Shqipërinë në një situatë të vështirë, të kalbur. Por ata nuk ia

arritën dot qëllimit të tyre të ndyrë, sepse Partia jonë ishte vigjilente dhe i zbuloi në kohë, sado i fshehtë që ishte aktiviteti i tyre. Komiteti Qendror i Partisë kishte krijuar një tablo të qartë të veprimtarisë tradhtare të këtyre armiqve.

Në këtë situatë të shëndoshë revolucionare, që është krijuar edhe nga indinjata e Partisë dhe e popullit ndaj veprës së urreyer të tradhtarëve, ne duhet të shërojmë ata kuadro që kanë gabuar, por që janë besnikë të Partisë, sepse puna armiqësore e Beqir Ballukut, e Hito Çakos dhe e Petrit Dumes nuk ka mundur ta dëmtojë sadopak këtë besim. Detyra jonë është që çdo sëmundje ta shërojmë rrënjësisht, në një kohë të shkurtër, me metoda partie dhe me zemër revolucionare.

Beqir Balluku e dha shenjën e parë të tradhtisë së tij kur u kthye nga vizita në Republikën Popullore të Kinës. Ne, pasi e dëgjua, e kritikua rëndë atë. Për ne, qëndrimi i tij ishte sinjali i parë i tradhtisë kuqe zhytur. Edhe pasi u kritikua, ai vazhdoi rrugën e tradhtisë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, popullit shqiptar dhe atdheut socialist.

Uniteti i marksistë-leninistëve i tmerron armiqtë. Ne pikërisht këtë dëshirojmë. Le t'i shikojnë armiqtë marksistë-leninistët dhe gjithë popujt e botës, që luftojnë për liri, të bashkuar. Le të dridhen ata nga frika e grushtit tonë të fuqishëm. Për të shkatërruar armikun, proletarët duhet të jenë të bashkuar sup më sup në mënyrë që të mos lënë asnjë armik të futet në radhët e tyre. Ne dimë të bëjmë politikë dhe të ndërtojmë taktika të drejta në shërbim të strategjisë sonë, sepse mbështetemi e frymëzohemi nga idetë e marksizëm-leninizmit, që u kallon frikën armiqve tanë.

Ne do t'i dërrmojmë dhe do t'i shtypim këta armiq. Në luftën kundër të dyja superfuqive ne kurrë nuk do t'i mbyllim sytë, përkundrazi do të jemi gjithmonë vigjilentë. Lufta e klasave është ligj i zhvillimit, që çon revolucionin përpara dhe si e tillë, ajo vazhdon.

Megjithëse ka 7 vjet që ju nuk keni ardhur në Shqipëri<sup>1</sup>, besojmë se i keni ndjerë sukseset e saj. Gjatë këtyre katër ditëve të qëndrimit tuaj, ju do t'i shikoni nga afër përparimet që kemi arritur.

*Midis të tjerave, kryetari i delegacionit kinez theksoi:*

Si gjatë 7 vjetëve, si edhe gjatë 30 vjetëve, populli shqiptar ka bërë një punë shumë të madhe për të arritur fitore. Ai punon sot për të arritur fitore akoma më të mëdha.

Për sa i përket ndihmës që ju kemi dhënë ne, ajo ka qenë e kufizuar; veç kësaj, ndihma ka qenë edhe reciproke, pra kemi ndihmuar dhe jemi ndihmuar.

*Fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:*

Ne i këshillojmë Partinë dhe njerëzit tanë të jenë të thjeshtë. Ne kurrë nuk do të na rritet mendja nga sukseset që arrijmë dhe nuk do të dehem prej tyre, por do të udhëhiqemi nga parimi që të bëjmë sakrificën më të madhe për popullin, të cilit duhet t'i shërbejmë me besnikëri deri në fund, se ai meriton akoma më shumë nga ç'kemi bërë për të.

Megjithëse koha e qëndrimit tuaj është e shkurtër,

---

1. Shoku Enver Hoxha i drejtohet kryetarit të delegacionit kinez, Jao Ven Juan, i cili kishte ardhur në Shqipëri edhe në qershor 1967 për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 5-të të BRPSH.

ne do të gjejmë rast të bisedojmë që çdo gjë të jetë e qartë për shokët kinezë. Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar i kanë qëndruar dhe do t'i qëndrojnë besnikë miqësisë me popullin kinez dhe do të luftojnë dhëmb për dhëmb me armiqtë, ata do të vënë të gjitha forcat, do të derdhin djersë, mund dhe gjak po të jetë nevoja për të mbrojtur tokën e tyre të shtrenjtë, vendin e tyre heroik dhe idetë madhështore të marksizëm-leninizmit, që i frymëzojnë dhe i udhëheqin.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## **PËR MIQTË E VËRTETË SHQIPËRIA ËSHTË E DO TË JETË KURDOHERË E HAPËT**

*Nga fjala në takimin me delegacionet  
e huaja që kishin ardhur në Shqipëri me rastin  
e festës së 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut*

**28 Nëntor 1974**

Të dashur shokë dhe miq,

Dëshiroj t'ju falënderoj në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë, të popullit shqiptar dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për nderin e madh që na bëtë, duke ardhur në gjirin e popullit tonë, i cili këto ditë feston një nga jubiletë e tij më të rëndësishëm. Me përpjekje e luftë, 30 vjet më parë populli ynë çliroi veten nga robëria e imperialistëve. Pas Çlirimit, duke vazhduar luftën dhe duke derdhur djersë në frontin e ndërtimit të jetës së re, populli shqiptar ka forcuar pavarësinë dhe lirinë e vet.

Gjatë gjithë luftës së armatosur kundër pushtuesve si dhe pas Çlirimit të vendit, Shqipëria ka gëzuar miqësinë e madhe, të ngushtë e të thellë të popujve tuaj. Kjo miqësi, që ne e vlerësojmë dhe e respektojmë shumë, ka qenë dhe është një mbështetje e madhe për ne. Populli ynë është i paktë në numër, ai në të kaluarën

ka qenë i shtypur, i vuajtur, pa bukë e pa liri. Por edhe atëherë ai preferonte më mirë urinë sesa shtypjen. Në ato kohë të vështira për të, ai përdorte fjalën e urtë: «Më mirë një mik se një çiflig». Këto fjalë shprehnin dëshirën e zjarrtë të popullit tonë për miqësi të vërtetë me popujt dhe me forcat përparimtare të botës, por jo me klikat sunduese dhe me shtypësit. Lidhjen dhe forcimin e kësaj miqësie, klikat sunduese e pengonin, sepse ia kishin shumë frikën, por kohët ndryshuan dhe forca e madhe e popujve, që shtyn përpara rrotën e historisë, bëri që sundimtarët të dobësohen dhe miqësia e uniteti në mes popujve të lulëzojnë.

Uniteti i të gjithë popujve të botës është sot një forcë e madhe kundër dy superfuqive. Ky unitet do t'i shpartallojë dhe do t'i thyejë intrigat që thurin e do të thurin armiqtë tanë të përbashkët.

Sot kemi midis nesh përfaqësues të vendeve të ndryshme e të partive marksiste-leniniste motra, të cilat, edhe pse nuk e kanë marrë akoma pushtetin, kanë një fuqi të madhe, sepse mbështeten në forcën dhe vullnetin e përbashkët të klasës punëtore të vendeve të tyre, të proletariatit ndërkombëtar, përfaqësojnë aspiratat dhe dëshirat e popujve e të forcave përparimtare të vendeve të tyre e të mbarë botës. Pavarësisht se disa nga partitë, që kanë dërguar përfaqësuesit e tyre në Shqipëri, sot janë akoma të vogla, idetë që i frymëzojnë ato janë të mëdha. Këto ide nuk ndalen dot as me topa, as me bomba atomike. Idetë e mëdha të Marksit e të Leninit nuk njohin kufij shtetesh, ato rrojnë dhe përhapen çdo ditë e më tepër, pavarësisht nga dëshira e kundërshtarëve të tyre. Ne kurrë nuk e kemi fshehur dhe nuk e fshehim se punojmë dhe luftojmë

duke u frymëzuar dhe udhëhequr nga këto ide. Përkundrazi, jemi krenarë dhe të lumtur që veprojmë kështu.

Për të mposhtur idealet tona, armiqtë na kanë djegur, na kanë plagosur dhe na kanë vrarë, por qëllimit nuk ia kanë arritur, një binte në luftë, një mijë të tjerë ngriheshin. Ky është ligji i zhvillimit.

Në rrugën tonë ne na ndjekin gjithë njerëzit e ndershëm në botë. Po përse na ndjekin? Sepse ne mbrojmë një ideal të lartë, luftojmë për interesat e popujve. Proletariatit e ndjekin edhe njerëz të ndershëm që rrjedhin nga shtresa të tjera, sepse kanë respekt për të, sikundër ne marksistë-leninistët ushqejmë respekt për revolucionarët jomarksistë, sepse edhe ata luftojnë kundër shtypjes, kundër barbarizmit të fuqive të mëdha, që kërkojnë të mbajnë popujt nën thundër. Mirëpo çdo popull ka të drejtë të qeverisë dhe t'i rregullojë punët në vendin e vet ashtu si i pëlqen dhe jo t'i nënshtrohet diktatit të të tjerëve. Pikërisht për këtë luftojmë ne. Prandaj lufta jonë, lufta e përbashkët e popujve i rrit dhe i bën të mëdha forcat tona në numër dhe në potencial.

Ne jemi jashtëzakonisht të lumtur e të gëzuar që sot festojmë bashkë me ju 30-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit tonë popullor. Popullit shqiptar i bëhet zemra mal, sepse prania juaj në këto ditë gëzimi e bën ta ndiejë veten sikur ka në gjirin e vet të gjithë popujt tuaj, të gjithë shokët tuaj marksistë-leninistë, që luftojnë në kushtet e ilegalitetit dhe nën kërcënimin e vazhdueshëm të plumbave e të bombave të armiqve fashistë. Në këtë luftë të ashpër klasore, ne, me gjithë shpirt e me gjithë zemër, jemi atje,



pranë jush, duke qenë të bindur se kauza jonë do të triumfojë.

Të dashur shokë dhe shoqe! Ju lutem ta ndieni veten të ne si në shtëpinë tuaj, si në atdheun tuaj. Shqipëria është edhe juaja. Për shokët, për miqtë e vërtetë, për vëllezërit, për të gjithë njerëzit me zemër të mirë, qofshin këta komunistë dhe jokomunistë, ajo është e do të qëndrojë kurdoherë e hapët. Shqipëria socialiste është dhe do të jetë kurdoherë e mbyllur vetëm për armiqtë e popujve, për revizionistët sovjetikë, për imperialistët janki dhe për gjithë reaksionarët e tjerë në botë.

Në jemi të lumtur e të gëzuar që ju bashkoheni me ne në këtë gëzim tonin të madh. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, ju do të shihni edhe përparimet tona në fushën ekonomike. Te ne janë ndërtuar fabrika, uzina dhe kombinate, shtëpi banimi për punonjësit, fushat janë të punuara mirë etj. Natyrisht, ato që do të shikoni nuk janë ndonjë gjë e madhe. Mjaft nga ju vijjnë nga vende ku ka grataciela, fabrika e kombinate, disa nga të cilat janë shumë më të mëdha se tonat, por, megjithëse janë ndërtuar me djersën, gjakun, mendjen, zemrën dhe zotësinë e punëtorëve, ato ndodhen në duart e borgjezisë, të kapitalistëve. Punëtorët, të cilëve u takojnë meritat për gjithë këtë punë të madhe që kanë bërë, nuk gëzojnë të drejtat që u përkasin, ata shfrytëzohen dhe jetojnë në skamje e mjerim. Pra, në vendet kapitaliste ekziston një kontradiktë e madhe në mes punëtorëve dhe kapitalistëve, e cila nuk do të zgjidhet derisa pasuritë e mëdha, që përvetësohen nga kapitalistët, të bëhen pronë e përgjithshme e mbarë popullit punonjës. Këto që populli ynë i ka ndërtuar me djersë, me mund e me sakrifica, vërtet janë vepra mo-

deste, por s'janë pronësi e klasave apo e disa shtresave të privilegjuara. E drejta e pronësisë mbi to i takon popullit në tërë kuptimin e fjalës.

Te ne është ndërtuar një sistem shoqëror i tillë ku, në rast se largohesh nga populli dhe tradhton interesat e tij, atëherë nuk meriton as të rrosh më. Në këtë sistem shoqëror kërkohet që ne udhëheqësit të jemi kurdoherë në shërbim të popullit, sepse në demokracinë tonë proletare funksionet që na janë dhënë na ngarkojnë detyra të mëdha dhe nuk na sjellin privilegje. Kush e shfrytëzon besimin e dhënë nga populli për të siguruar privilegje për vete, s'ka vend në shoqërinë tonë! Ne i themi popullit: «Ngrihu në këmbë kur sheh se dikush tradhton interesat e tu, tregoji vendin atij që abuzon besimin tënd!».

Ju kemi vëllezër dhe shokë lufte, prandaj atë çka nuk e kemi deklaruar akoma botërisht, po jua themi juve. S'ka shumë kohë që ish-anëtari i Byrosë Politike, Beqir Balluku, u zbulua si tradhtar i Partisë, prandaj fshesa e saj e hekurt e fshiu këtë armik. Në Shqipërinë socialiste, cilido, sidomos kuadri me përgjegjësi, duhet të jetë besnik gjer në fund i Partisë, i popullit dhe i ushtrisë së tij. Te ne, shokë, Partia dhe populli janë një, sepse kanë qëllime dhe interesa të përbashkët. Kush veçohet nga Partia dhe populli, kush i ndan interesat e tij nga ata të Partisë dhe të popullit, qërohet nga radhët e tyre. Populli thotë: «Delen që ndahet nga kopeja, e ha ujku».

Të dashur shokë, te populli ynë ju keni një mik të vërtetë. Këtë jua them sinqerisht e me modesti. Ne kemi shumë punë për të bërë e shumë gjëra për të mësuar nga ju, nga forca krijuese dhe nga mendja e

madhe e proletariatit dhe e popujve përparimtarë, prandaj studiojmë me vëmendje eksperiencën e të tjerëve. Për të nxjerrë mësim, ne studiojmë me vëmendje luftërat revolucionare të popullit meksikan, të Zapatës<sup>1</sup> e të Panço Vilës<sup>2</sup>, të popujve arabë e veçanërisht të popullit algjerian, studiojmë luftërat e Abd al-Kadirit<sup>3</sup> dhe të udhëheqësve të tjerë të shquar të dalë nga gjiri i popullit, luftërat e popujve të tjerë të Amerikës Latine e të popujve të Azisë. Shqipëria e vogël socialiste është kryelartë, sepse me të janë revolucionarët dhe popujt e botës, prandaj Partia na këshillon të mësojmë prej tyre, të punojmë e të luftojmë së bashku me ta. Përkrah tyre ne e ndiejmë veten të pamposhtur dhe ju sigurojmë se kurrë nuk kemi pasur e nuk do të kemi frikë as nga imperializmi amerikan dhe as nga revizionizmi sovjetik. Ne nuk e themi këtë për mburrje, por duke e thënë, pohojmë një të vërtetë që bazohet në realitetin tonë objektiv dhe në unitetin e çeliktë të popujve para armiqve të përbashkët.

Edhe një herë ju falënderoj për ardhjen tuaj në Shqipëri. Prania juaj na i ka shumëfishuar forcat.

Të rrojë uniteti i popujve revolucionarë të botës!

Të rrojnë partitë marksiste-leniniste dhe partitë revolucionare që luftojnë në botë për kauzën e madhe

---

1. Emiliano Zapata (1877-1919) — udhëheqës i shquar i lëvizjes fshatare dhe hero i revolucionit (1910-1917) në Meksikë.

2. Panço Vila (1878-1923) — udhëheqës i lëvizjes së fshatarësisë meksikane në fillim të shekullit të 20-të.

3. Abd al-Kadir (1808-1883) — Hero Kombëtar i Algjerisë. Në vitet 1832-1847 udhëhoqi kryengritjen e popullit algjerian kundër pushtuesve francezë.

të popujve, për liri dhe sovranitet kombëtar, për progres shoqëror!

*Në vazhdim të takimit, shoku Enver Hoxha bëri biseda të veçanta me delegacione të partive marksiste-leniniste dhe ndër të tjera, theksoi:*

Ne e ndjekim nga afër veprimtarinë tuaj, solidarizohemi me ju dhe kemi respekt për luftën tuaj, sepse edhe ne kemi zhvilluar luftë sa arritëm fitoren, sepse edhe populli ynë i ka hequr vetë në kurriz vuajtjet që po heqin popujt tuaj. Borgjezia në Shqipëri, megjithëse ishte e dobët, goditjet kundër popullit dhe komunistëve i bënte të ashpra dhe kjo dihet, goditjet e borgjezisë janë kurdoherë të tilla. Pra, edhe goditjet kundër partive tuaja janë gjithashtu shumë të rënda, prandaj, në këto situata, duhen luftë, trimëri, guxim dhe zotësi.

Ne gjykojmë se uniteti në mendime dhe në përpjekjet për të gjetur rrugë të përbashkëta dhe të veçanta, me qëllime dhe strategji të njëjta marksiste-leniniste, me taktika të ndryshme sipas situatave, është shumë i dobishëm. Uniteti marksist-leninist është i domosdoshëm si brenda një partie, ashtu edhe ndërmjet partive. Brenda në radhët e një partie ka njerëz me nivele të ndryshme ideopolitike dhe kulturore, ka që gabojnë me dashje, por ka edhe nga ata që janë të pangritur dhe gabojnë pa dashur. Në mes partive mund të ketë edhe keqkuptime e ndryshime në pikëpamje, që duhen sheshuar mbi baza të drejta, parimore. Marksi ka thënë se proletariati, që ka përpara armikun më të egër, duhet t'i bëjë atij një luftë frontale, duke u bashkuar sup më sup dhe duke shtrënguar radhët fort, sepse po gjeti të çarë, armiku futet lehtë në radhët e tij dhe e dëmton. Ne, shokë, duke pasur parasysh këtë mësim të Marksit,

nuk duhet të lëmë asnjë të çarë në partitë tona, nga ku mund të na futet armiku.

Unë fola këtu në përgjithësi, duke pasur parasysh të gjitha partitë tuaja, por dua të flas veçanërisht për Partinë Komuniste të Brazilit, që është një nga partitë marksiste-leniniste revolucionare me autoritet, e cila gëzon simpatinë e revolucionarëve në botë. Ne kemi respekt për vijën e drejtë politike që ndjek Partia Komuniste e Brazilit, kemi respekt të madh për shokun Amazonas dhe për gjithë udhëheqësit e tjerë të kësaj partie. Ne vlerësojmë kombinimin e drejtë që ju i bëni luftës në fshat dhe në qytet, taktikat e ndryshme që praktikoni në përshtatje me situatat. Kjo veprimtari e drejtë dhe parimore flet për pjekurinë e Partisë Komuniste të Brazilit dhe tregon se ajo është një parti, që e ka të qartë se komunistët nuk mund të shkojnë të izoluar në luftë, por bashkë me popullin dhe në krye të tij. Ne shikojmë që Partia Komuniste e Brazilit dhe partitë e tjera marksiste-leniniste shkojnë drejt asaj që është e domosdoshme, shpëtimtare: drejt unitetit të mendimit e të veprimit.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Shoku Enver, duke folur një nga një me secilin nga delegacionet e partive, do të lodheni. Ne do të gjejmë kohë për të biseduar me secilin prej tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duke folur me shokët për këto probleme nuk ndiej fare lodhje.

Jam shumë i gëzuar që keni ardhur me këtë rast në Shqipëri shoku Aust<sup>1</sup>. Dëshiroj t'ju falënderoj për

---

1. Ernst Aust, në atë kohë, Kryetar i Partisë Komuniste të Gjermanisë.

ndihmën që po i jepni edhe në këtë rast, me ardhjen tuaj, popullit shqiptar. Ne vlerësojmë luftën dhe përpjekjet e anëtarëve të partisë që ju udhëhoqni. Puna e mirë që bën partia juaj le të zhvillohet dhe të forcohet më tej. Në kushtet e rënda të kapitalizmit rriten e kaliten revolucionarët.

Ne shprehim respektin tonë për popullin suedez, i cili ka zemër të bardhë si bora e pastër e maleve të Suedisë. Populli ynë thotë: Zemrën ta kesh të bardhë si bora e të zjarrtë si flaka. Të kesh zemër të bardhë do të thotë të jesh i pastër e i ndershëm. Këto karakteristika të mira janë cilësi të revolucionarëve. Dëshirojmë t'u çoni shokëve dhe popullit tuaj, bashkë me të falat, dashurinë dhe respektin tonë!

Ne kemi bindjen e madhe që Partia Komuniste e Indonezisë do të ecë përpara. Të gjitha vuajtjet dhe sakrificat tuaja nuk do të shkojnë kot, ato do të forcojnë themelet e Partisë suaj. Kujtimi i shokut Aidit nuk do të na shlyhet kurrë. Në zemrën time e ruaj të qartë kujtimin e tij dhe të të gjithë heronjve indonezianë, që flijuan jetën e tyre për një çështje të madhe. Ata rrojnë në mendjet dhe në zemrat tona, sepse me veprat e tyre u bënë të pavdekshëm.

*Gjatë takimit, shoku Enver Hoxha bisedoi edhe me delegacionin vietnamez, algjerian, meksikan, kambodhian e me delegacionet e tjera. Biseda u zhvillua në frëngjisht.*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NE KEMI RRUGËN TONË, KUSH TË DOJË LE TË VIJË ME NE

*Nga biseda me kryetarin e delegacionit të partisë  
dhe të qeverisë së RP të Kinës, Jao Ven Juan*

29 Nëntor 1974

*Me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor, në Pallatin e Brigadave në Tiranë u dha një pritje, ku asistuan edhe delegacionet e huaja që ishin ftuar për të marrë pjesë në festimet e organizuara. Në bisedën me kryetarin e delegacionit kinez, midis të tjerave, shoku Enver Hoxha theksoi:*

Sot në gëzimin e popullit merrte pjesë edhe natyra, sepse koha ishte shumë e bukur, sidomos në mëngjes, kur u zhvillua parada. Por aktivitetet festive vazhdojnë edhe tani në mbrëmje. Ka disa net që aktivitete të tilla në kuadrin e festave kombëtare të Pavarësisë dhe të Çlirimit po zhvillohen kudo, në fabrika, uzina, kooperative bujqësore, shkolla, institucione social-kulturore etj. Festat kombëtare janë bërë masive te ne. Që në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, menjëherë sa u formuan çetat partizane dhe më vonë, Partia vazhdimisht ka bërë punë bindëse me njerëzit për kotësinë e festa-

ve fetare që praktikoheshin. Mund të themi se tashmë ato janë lënë në harresë.

Ruajtja e traditave të Luftës Nacionalçlirimtare ka rëndësi të madhe politike e ideologjike, sepse kështu fryma luftarake e popullit dhe shpirti i tij i sakrificës mbahen gjallë dhe shndërrohen në simbol virtytesh e heroizmi. Partizanët tanë, që morën pjesë në luftë dhe sot nderohen si luftëtarë veteranë, shkojnë në gjirin e masave të popullit, ulen këmbëkryq me to, hanë e bisedojnë së bashku në mënyrën më të thjeshtë, ashtu si në kohën e luftës. Partia i mëson kuadrot e saj, të rinj e të vjetër, të jenë sa më të thjeshtë, t'i tregojnë popullit me sjelljet dhe qëndrimet e tyre se pozitat që kanë në Parti dhe në shtet u janë besuar jo për të siguruar privilegje, por për të kryer detyra me përgjegjësi. Ne punojmë që komunistët dhe kuadrot tanë të jenë të thjeshtë si vetë populli.

Në vendin tonë, Partia ka një mision mjaft të madh: të ndërtojë shoqërinë e re socialiste. Këtë shoqëri e ndërtojnë njerëzit e pajisur me virtyte të larta morale, me cilësi dhe ndershmëri proletare. Një nga objektivat më të rëndësishëm të Partisë sonë është formimi dhe kalitja e njeriut të ri të socializmit. Ne luftojmë që mësimet e marksizëm-leninizmit të lidhen sa më mirë me jetën, që ato të zbatohen sa më drejt për interesat e popullit, i cili është kundër veseve të tilla si: mendjemadhësia, hipokrizia, servilizmi, gënjeshtria, vjedhja etj. Këto vese Partia jonë nuk i duron.

*Gjatë bisedës e mori fjalën kryetari i delegacionit kinez, i cili, midis të tjerave, foli edhe për vizitën e tij në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit e për përshtypjen që i kishte bërë respekti që tregohet për ta në vendin tonë.*



*Pastaj fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:*

Për ditët që gëzojmë sot dhanë jetën në lulen e rinisë mijëra djem dhe vajza, për të cilët populli ka respektin më të madh. Asgjë nuk vënë populli dhe Partia mbi kujtimin e dëshmorëve. Është shprehje e konsideratës së madhe për Partinë tonë kur njerëz të thjeshtë nga populli thonë: Me veprën e saj Partia na i ngjalli bijtë e bijat tona.

Kur u zbuluan në nëntokën tonë shtresa mermeri, ne vendosëm që me to të ndërtoheshin, në radhë të parë, varrezat e dëshmorëve. Jo vetëm në qytete, por edhe në fshatra janë ngritur lapidarë në kujtim të betejave të zhvilluara e të dëshmorëve të rënë. Në të gjitha rrethet e vendit tonë varrezat e dëshmorëve janë vepra të vërteta arti, të ndërtuara me pllaka mermeri. Në ndërtime te ne janë bërë përparime dhe çdo vit e më shumë po përmirësohet stili i të ndërtuarit; çdo vit po vëmë, si të thuash, nga një çikë «dhjamë» në këtë drejtim.

Ju na treguat se sot, duke biseduar me anëtarët e delegacionit të qeverisë së Republikës Socialiste të Rumanisë, që ka ardhur për të marrë pjesë në festën e Çlirimit të Shqipërisë, u thatë atyre se duhet të luftojnë kundër revizionistëve sovjetikë. Mirë u paskenë thënë! Ju u thatë, gjithashtu, se në këtë drejtim, shokët shqiptarë i përkrahin.

Po, keni të drejtë, ne duhet t'i mbështetim ata, por nuk kemi besim në qëndrimin e tyre, qoftë edhe për sa i përket rezistencës kundër revizionistëve sovjetikë, për arsye se udhëheqja rumune ka pikëpamje jomarksiste, atje bëhet një politikë personale dhe jo në frymë partie. Revizionistët sovjetikë kanë tendencë ta gllabërojnë

Rumaninë, kurse udhëheqësit rumunë, me politikën e tyre gjoja kundër revizionistëve sovjetikë, në të vërtetë, nuk udhëhiqen nga parime të shëndosha marksiste-leniniste. Në qoftë se atje nuk mobilizohet populli në frymën e një politike revolucionare, edhe sikur të ketë njëfarë rezistence kundër revizionistëve sovjetikë, ajo nuk është e mjaftueshme për të përballuar rreziqet që mund t'i kanosen Rumanisë. Në partinë dhe në shtetin rumun po lulëzojnë veset më të këqija. Kjo po shfrytëzohet nga socialimperialistët sovjetikë, të cilët vetëm nga frika e opinionit ndërkombëtar nuk e kanë sulmuar akoma Rumaninë.

Në Jugosllavi, përveç revizionistit Tito e përkrahësve të tij, ka edhe grupime të tjera revizioniste. Megjithëse atje janë në fuqi revizionistët, popujt e Jugosllavisë do të luftojnë për pavarësinë e tyre.

Ju thatë se qëndrimet që mbahen ndaj Jugosllavisë synojnë përçarjen e popujve që përbëjnë Federatën. Në fakt, përçarja është pjellë e revizionizmit. Janë vetë revizionistët jugosllavë, të cilët, me qëndrimet që mbajnë, e kanë gjallëruar më tej ndjenjën shumë të rrezikshme të shovinizmit midis kombeve e kombësive, idenë e sundimit të kombit më të madh mbi kombet më të vogla në Jugosllavi. Pra, sipas kësaj, në Beograd mendojnë që edhe Serbia, si kombi më i madh, duhet të dominojë në Federatë. Kjo çon në përçarje. Përveç kësaj, atje ekziston e kultivohet edhe ndjenja e vjetër e pansllavizmit.

Në një nga bisedat me Stalinin, për qëndrimin që duhej mbajtur ndaj Titos, ai më tha: «Ne nuk duhet të ndërhyjmë dhe nuk do të ndërhyjmë në çështjet e brendshme të Jugosllavisë. Për Jugosllavinë ka rëndësi

Serbia». Duke marrë parasysh rolin e Serbisë, si dhe qëndrimin e saj edhe sot, mund të thuhet se rreziku sovjetik për Jugosllavinë vjen nga Serbia.

Titoja është në pozita mjaft të vështira, prandaj edhe kohët e fundit, siç e ka zakon të veprojë kur bie ngushtë, tentoi të bënte demagogji. Ai është dinak i madh. Kudo ka bërë vizita. Vetëm në Shqipëri nuk ka mundur të vijë, por edhe në Kinë deri tani nuk ka shkuar. Mirëpo, në buletinet e agjencive të ndryshme të lajmeve thuhet se ka mundësi që ai të vejë në Pekin, në qoftë se do të ftohet për vizitë nga ana juaj<sup>1</sup>. Me vizitat që bën, Titoja kërkon të spekulojë, se ka nevojë për kredi politike.

Kur ne u vëmë theksin marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Greqinë dhe me Jugosllavinë, këtë e bëjmë, nga njëra anë, për t'i inkurajuar popujt e këtyre vendeve fqinje për rezistencë kundër ndërhyrjeve të revizionistëve sovjetikë dhe, nga ana tjetër, për t'u bërë të ditur këtyre popujve se ne duam të jemi miq me ta. Veprojmë kështu, jo se jemi dakord me Titon, i cili është armiku ynë dhe i popujve. Ne i njohim taktikat djallëzore të Titos, i cili hidhet e përdridhet si kërcimtarja në tel. Ai nuk është aspak marksist, pra nuk e zbaton, por vepron në kundërshtim me marksizëm-leninizmin. Sidoqoftë ne duam të shfrytëzojmë kontraktat.

Kur u bënë manovrat e amerikanëve në detin Adriatik, jugosllavët ishin lajmëruar një muaj përpara dhe i kishin miratuar në heshtje. Mirëpo, më vonë, në

---

1. Titoja bëri vizitë në Kinë nga 30 gushti deri më 8 shtator 1977.

mënyrë hipokrite, i thanë ambasadorit tonë në Beograd: Protestoni ju shqiptarët për këto manovra. Ata veprojnë kështu, nga njëra anë, për të mos u prishur me amerikanët dhe, nga ana tjetër, për t'u treguar sovjetikëve se bënë protestë (natyrisht, duke përdorur të tjerët) kundër manovrave amerikane, sepse ishin kundër tyre! Ne nuk i hamë këto dredhi dhe nuk futemi në matrapazllëqet e revizionistëve jugosllavë me Titon në krye.

Ne e dimë që kërcënohemi nga revizionistët sovjetikë dhe jemi të përgatitur për mbrojtje. Për të na sulmuar, ata duhet të kalojnë nga Jugosllavia. Ne do ta ndihmojmë Jugosllavinë në rast se ajo sulmohet, megjithëse mbrojtja e saj, natyrisht, nuk varet nga ne, por nga vetë popujt e saj. Popujt e Jugosllavisë i njohim, se i kemi fqinj dhe besojmë se ata nuk do të pranojnë të nënshtrohen. Pavarësisht se në vend është futur kapitali i huaj me gjithë degjenerimin që ai sjell, popujt e Jugosllavisë nuk mund ta pranojnë pushtimin e huaj.

Organizimi i luftës kundër revizionistëve sovjetikë është një veprim i drejtë. Fundi i tyre është qëllimi ynë. Por në luftën që zhvillojmë kundër revizionistëve sovjetikë, ne nuk mund të bashkëpunojmë me jugosllavët, siç propozoni ju. Revizionistët jugosllavë bëjnë një politikë balancimi, duke u kthyer, sipas rastit, herë nga sovjetikët, herë nga amerikanët, herë andej e herë këtej. Këtë qëndrim të tyre ne nuk mund ta përkrahim. Megjithatë mendimet tona nuk ia imponojmë askujt. Ne kemi rrugën tonë, kush të dojë le të vijë me ne, kush nuk do, le të ndjekë rrugën që i pëlqen.

Meqenëse edhe shokët janë të lodhur nga festimi i

ditës së solme, do të ishte mirë ta mbyllnim këtë takim. Faleminderit shumë për nderin që na bëtë duke marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara me rastin e festës sonë të Çlirimit.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## NË SHQIPËRI, NJERIU E KA JETËN TË SIGURUAR

*Nga biseda me emigrantët ekonomikë shqiptarë  
Haki Hoxha dhe Qemal Çipi nga Izmiri<sup>1</sup>*

10 dhjetor 1974

*Pasi u uroi mirëseardhjen miqve, Hakiut e Qemalit, dhe i pyeti për njerëzit e familjeve të tyre, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

U gëzova shumë që erdhët në Shqipëri dhe që u takuam së bashku.

Ti, Qemal, ke lindur në Turqi, kurse unë me Hakiun e kemi kaluar bashkë fëmijërinë në Gjirokastër. Unë vajta 66 vjeç. Ti sa vjeç je, o Haki?

**SHOKU HAKI HOXHA:** Edhe unë aty afër jam.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më ngjan se ti je një çikë më i madh dhe po m'i fshih vitet!

Hakiu e kishte nënën shumë të mirë. Babanë e tij, xha Abdullahun, nuk e mbaj mend mirë, se kishte ikur më shpejt, por di që ai ishte me leshra të verdha. Nëna e tij Nasipja ishte grua e urtë. Ajo ka ardhur një herë

---

1. Në këtë pritje marrnin pjesë shoqja Nexhmije Hoxha, Ksenofon Nushi (në atë kohë zëvendësministër i Punëve të Jashtme) dhe Pëllumb Çipi, instruktor në aparatën e Komitetit Qendror të PPSH.

në Shqipëri, por unë nuk jam takuar dot me të, se në atë kohë nuk isha këtu.

Familja juaj ishte në gjendje ekonomike më të vështirë se ne, që kishim mulla Hysenin<sup>1</sup>. Me Çipajt ne jemi kushërinj nga gjyshja, nga nëna e dajkos. Ti, Qemal, ke pasur një gjyshe që quhej Lule, ajo ka qenë grua shumë e mirë. Ne vinim shpesh tek ajo dhe nga njëherë rrinim edhe për drekë. Më kujtohet që në shtëpinë tuaj kishte një avlli me dërrasa të lyera me gëlqere.

Të kujtohet kur luanim bashkë, more Haki, kur ngjiteshim me shkallë nga njëra anë e hanit tuaj dhe zbritnim nga ana tjetër? Në atë han Nasipja gatuate gjellën, por e ngatërronim edhe ne kur loznim aty pranë. Janë gjëra të vogla këto kujtimet e fëmijërisë, po nuk shlyhen kurrë nga kujtesa e njeriut.

Vajtët në Gjirokastër? I patë të gjitha shtëpitë, rrugën e shtruar me kalldrëm dhe pazarin?

*SHOKU HAKI HOXHA:* Po, i pamë. «Më lini se do të vete vetë t'i shikoj të gjitha shtëpitë», u thosha të afërmve që më shoqëronin. Shtëpinë time nuk e gjeta, asaj i kishin mbetur tri mure të mëdha.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe shtëpia ime u dogj, por Partia e rindërtoi, e bëri ashtu siç e patë ju.

Gjirokastra është ndërtuar, rritur e zbukuruar. Përpara nuk ka pasur asgjë në Gjirokastër. Të gjitha sa patë, janë ndërtuar pas Çlirimit. Kështu ka ndodhur edhe në qytetet e tjera. Shqipëria ka ndryshuar shumë.

---

1. Hysen Hoxha, shaxhai i shokut Enver, patriot, iniciator për çeljen e shkollës së parë shqipe në Gjirokastër dhe kryetar i shoqërisë «Bashkimi» dhe «Pleqërisë» të Klubit «Drita». Në vitin 1912 ishte delegat i Gjirokastrës në mbledhjen e Vlorës për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Te ne u bë një luftë shumë e ashpër kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë. Armiqtë e huaj, bashkë me bejlerët e agallarët, na vranë e na dogjën, por edhe ne i zbuam këtej. Lufta na i shkatërroi të gjitha. Populli ishte i vuajtur, i djegur, i mjeruar, por me punë i ndërtoi të gjitha. Njëra pas tjetrës ndërtuam fabrika, uzina e kombinatë, një pjesë të të cilave ju i patë vetë. Tani, kudo në Shqipëri populli ka shtëpi, qiraja e tyre është fare e vogël. Djemtë e vajzat e popullit venë në shkollë pa para. Në Shqipëri s'ka taksa. Vajzat shqiptare nuk janë më si ato të parat, tani ato janë zhvilluar, martohen me dashuri dhe mbi bazën e njohjes personale me atë që do të marrin. Gratë punojnë; ato nuk mbulohen më me perçe dhe për punë të barabartë marrin shpërblym të barabartë me burrin. Në qoftë se një burrë merr 700 lekë pagë në muaj për një punë të caktuar, po aq merr edhe një grua që kryen të njëjtën punë. Kur gruaja punëtore ose nëpunëse është shtatzënë, merr tre muaj leje, 35 ditë para lindjes dhe 49 ditë pas lindjes<sup>1</sup>. Ka raste që gruaja në këtë periudhë, për arsye shëndetësore, të ketë edhe më shumë leje, për shembull, edhe 8 muaj dhe, megjithëqë rri në shtëpi, paguhet nga Sigurimet Shoqërore Shtetërore.

*SHOKU HAKI HOXHA:* Kjo është një gjë shumë e mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe kur punëtori bëhet i paaftë përkohësisht për punë, se ka vrrarë, fjala vjen, dorën, ai nuk shkon në punë, por ndihmën për

---

1. Me vendim të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë më 27.6.1981 leja për gratë shtatzëna është caktuar 35 ditë para lindjes dhe 135 ditë pas lindjes.



paaftësi e merr, se paguhet nga Sigurimet Shoqërore Shtetërore. Te ne nuk ka pothuaj asnjë familje pa krahë pune. Tashti ka punë për të gjithë. Punojnë të gëzuar burra e gra. Të gjitha të mirat materiale njerëzit tanë i prodhojnë me duart e tyre dhe për veten e tyre. Te ne kush punon, ai ha. Po të punojmë, do të hamë. Vetëm kur ndonjëri është plakur ose është i sëmurë nuk punon.

Ishte hajdut i madh Ahmet Zogu, që e la vendin aq të varfër, sa njerëzit detyroheshin të mërgonin për të fituar kotheren e bukës. Ai mendonte vetëm për vete. Kurse drejtuesit e shtetit shqiptar të gjitha i bëjnë për popullin. Ne punuam me durim që populli të kuptonte rrugën e drejtë, pastaj u vumë satërin të gjithë armiqve. Gjetkë ka papunësi, kurse te ne tani ka punë kudo. Ne duam punëtorë dhe nuk kemi rrezik të na mbetet njeri pa punë.

Jugosllavia ka afër një milion njerëz të saj që nuk punojnë dot në vend dhe ikin për të siguruar punë e mjete jetese jashtë, kurse ne jemi nevojtarë për krahë pune. Shqipëria është një vend ku lindjet janë më të shumta se ato të vendeve të tjera. Qeveria jonë i rekomandon popullit që të shtohet akoma. Njeriu te ne e ka jetën të siguruar, ai nuk mbetet kurrë pa bukë dhe pa shkollë. Shërbimi shëndetësor te ne sigurohet falas, spitale ka kudo.

**SHOKU HAKI HOXHA:** Më thanë se këtu njerëzit punojnë me gjithë shpirt e jo me të shtyrë, nga nevoja.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, se ata e dinë që punojnë për jetën e tyre, për lumturinë e tyre, për begatinë e atdheut e të popullit të tyre. Tani i kemi të gjitha: qymyrin, kromin, hekurin, hidrocentralet etj., etj.

Mirë se na erdhët! Për shëndetin tuaj, për të mira e në gëzime! U gëzuam shumë që u poqëm, që u çmallëm.

*SHOKU HAKI HOXHA: Faleminderit! (Duke qenë shumë i emocionuar e i përmalluar, ai përlotet dhe, për disa çaste, nuk thotë dot asnjë fjalë.)* Më falni se jam shumë i emocionuar.

*SHOKU ENVER HOXHA: E patë asqerin tonë kur parakaloi në festën e Çlirimit?*

*SHOKU HAKI HOXHA: Po, e pamë atë parakalim madhështor.*

*SHOKU ENVER HOXHA: Ushtrinë e kemi të fortë, se oficerët e saj kanë dalë nga lufta ose janë përgatitur në shkollat tona. Tani në vendin tonë ka edhe shkolla të larta. Nuk ka asnjë fshat pa shkollë, pa elektrik, pa telefon, pa rrugë automobilistike etj. Të gjitha këto i bëri populli nën udhëheqjen e Partisë, i bëri se pushtetin ua mori me forcë agallarëve, bejlerëve e fajdexhinjve dhe tani ka në dorë Qeverinë dhe pasuritë e tij, edhe malet tona janë zbukuruar si fushat. Tani në Shqipëri ka hekurudha, vërshëllima e trenit dëgjohet kudo.*

*SHOKU HAKI HOXHA: I pashë të gjitha. Atëherë ne vetëm emrat u dinim hekurudhave, se nuk kishim parë kurrë me sy.*

*SHOKU ENVER HOXHA: Kemi bërë shumë për Shqipërinë, por do të bëjmë akoma më shumë në të ardhmen për përparimin e saj.*

*SHOKU HAKI HOXHA: Këto të gjitha janë bërë në pak vjet. Do të kalojnë vitet dhe Shqipëria, për sa u përket teknikës e industrisë, do të përparojë edhe më shumë, veçse pa kapitalistë e shfrytëzues. Ajo do të bë-*

het e tillë se është një vend ku puna nuk është angari, por detyrë dhe nder.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa vjet t'u bënë që je larguar nga atdheu?

*SHOKU HAKI HOXHA:* M'u bënë 53 vjet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me Turqinë tani i kemi të mira marrëdhëniet shtetërore, të cilat do t'i përmirësojmë akoma më shumë. Në përgjithësi populli turk është i mirë. Në Turqi jetojnë shumë shqiptarë. Ka prej tyre që i kanë bërë shërbime të shquara Turqisë, kanë qenë sadrazemë, mjekë të dëgjuar, dijetarë etj. Sa më mirë të sillen turqit me shqiptarët që jetojnë në Turqi, aq më shumë do t'i respektojmë edhe ne ata. Ne do të përpiqemi që ata të mos u nxjerrin pengesa shqiptarëve të mërguar për gëzimin e të drejtave që u takojnë.

Si është jetesja andej nga vini ju?

*SHOKU HAKI HOXHA:* Është shumë e vështirë dhe e shtrenjtë. Me një rrogë nuk mund të jetohet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ne e kemi të lirë. Që kur është çliruar Shqipëria e deri më sot, çmimet nuk janë ngritur asnjëherë, përkundrazi janë ulur vazhdimisht.

Tani, si në gjithë botën, edhe në Evropë, edhe në Turqi, çmimet ngrihen. Kështu, për shembull, çmimi i tonit të sheqerit në tregun e lirë ndërkombëtar tani pothuaj është dyfishuar. Ne kemi një fabrikë sheqeri, por prodhimi i saj nuk na mjafton. Megjithëse blejmë edhe jashtë sheqer me të shtrenjtë, çmimin nuk e kemi ngritur. Diferencën e çmimit në tregun ndërkombëtar e përballon tërësisht shteti, kurse populli e blen sheqerin aq sa e blinte edhe më parë. Po kështu është puna edhe

për mishin, për orizin dhe për shumë artikuj të tjerë ushqimorë. Dhe e dini pse veprohet kështu në Shqipëri? Sepse rrogat janë gati të gjitha njëloj. Kështu paga ime, që është më e madhja, nuk e kalon dyfishin e pagës së një punëtori, kurse jashtë kjo diferencë arrin në dhjetëra herë më shumë! Dallimet në paga te ne nuk janë më si përpara kur pashai, sadrazemi ose çdo funksionar tjetër shteti ia rrëmbente popullit të gjitha. Këtu nuk ka më çifligje e pronarë të privilegjuar. Pra, si unë, si ai tjetri kemi mundësi të hamë, të pimë e të vishemi gati njësoj.

**SHOKU HAKI HOXHA:** Të gjithë duhet të vijnë vetë që ta shikojnë Shqipërinë. Ndryshe është ta shikosh vetë vendin tënd, ndryshe të të flasin të tjerët për të. Unë nuk mund t'i shpreh të gjitha ato që kam parë.

**SHOKU QEMAL ÇIPI:** Kur arritëm në Jugosllavi, na pyetën: «Ku do të shkoni?». Ne u thamë se do të shkojmë në Shqipëri. «Pse po shkoni atje, ai është një vend fukara», — na tha garsoni. «Pse flet kështu, — i thashë, — çfarë zarari të ka bërë ty Shqipëria, për të cilën ne e kemi zemrën mangall?».

**SHOKU HAKI HOXHA:** Një njeri, kur i thotë fjalët nga zemra, nuk mendon fare se ç'do të bëhet me të. Le të bëhet çfarë të bëhet, edhe sikur ta vrasin ai nuk mund të dëgjojë asnjë fyerje për atdheun e tij.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ashtu është, të lumtë Haki!

**SHOKU HAKI HOXHA:** Dëshira për të ardhur këtu ka qenë edhe më përpara, por nuk gjeta asnjë mundësi, ishte edhe ana ekonomike që më pengonte.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të na vini prapë. Kjo

të mos jetë hera e fundit që vini në Shqipëri! Gëzuar të gjithë!

**SHOKU HAKI HOXHA:** Do të vi me gjithë djalin.

Me këtë rast mora edhe një çikë dhe nga toka jonë për t'ia hedhur nënës mbi varr, se ajo këtë gjë ma kishte lënë amanet. Neve, që jemi larg, na qan zemra për vendin tonë.

**SHOKU QEMAL ÇIPI:** Babai im, kur ishte i sëmurë, thoshte: «Punova këtu për Turqinë, po për vendin tim nuk vura asnjë gur». Ai qante nga malli për Shqipërinë dhe shpesh thërriste me tërë fuqinë e tij: «Rroftë Shqipëria!».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur do të ikni?

**SHOKU HAKI HOXHA:** Nesër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë shpejt. Herë tjetër të vini dhe të rrini më gjatë. Kur të vini, do ta shikoni edhe më të bukur Shqipërinë.

Qofshi mirë, të lumtur e të gëzuar! T'ju rrojnë të gjithë të dashurit tuaj. Të na rrojë Shqipëria! Gëzuar!

**SHOKU HAKI HOXHA:** Faleminderit. Gëzuar!

**SHOKU QEMAL ÇIPI:** Të rroni ju sa malet! Gëzuar!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit. Të na rrojë Partia! Rrugë të mbarë! Të fala të gjithëve! Qofshi mirë! T'ju dëgjoj zërin e mirë! Të na vini prapë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

# DREJTORIA E KULTURËS DHE E PROPAGANDËS TË MOS MARRË FUNKSIONET E DREJTORISË POLITIKE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

11 dhjetor 1974

Unë jam dakord me propozimin që bëhet në material<sup>2</sup>. Vetëm se nuk duhet të lejojmë që Drejtoria e Kulturës dhe e Propagandës që do të krijohet të marrë funksionet e Drejtorisë Politike.

Më parë, drejtimin e gjithë punës së Partisë në ushtri e kishte Drejtoria Politike, kurse tani këto aktivitete themi t'i ketë aparati i Komitetit Qendror. Por këtë duhet ta kuptojmë drejt. Komiteti Qendror dhe aparati i tij duhet të luajnë rolin që u përket dhe të kryejnë ato funksione që u janë caktuar. Ata duhet të

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth relacionit «Mbi disa çështje të ndërtimit të Partisë dhe të lidhjeve të organizatave të Partisë të ushtrisë me ato të terrenit».

2. Është fjala për krijimin pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore të Drejtorisë së Kulturës dhe të Propagandës, e cila merret me problemet e zhvillimit të aktiviteteve kulturore, artistike e sportive si dhe me shtypin në ushtri.

japin ndihmën maksimale; të venë ta kontrollojnë dhe ta ndihmojnë ushtrinë në të gjitha drejtimet. Por, punën politike, ideologjike e kulturore do ta bëjë vetë ushtria përmes organizatave dhe organeve të saj të Partisë.

Këtu, në material, ka disa formulime që nuk janë ekzakte. Tani që punën e Drejtorisë Politike do ta kryejë aparati i Komitetit Qendror, të mos mendohet se duhen pritur nga ai të gjitha. Për shembull, aktivitetet kulturore të ushtrisë nuk mund të drejtohen nga Komiteti Qendror. Ky do ta udhëzojë, do ta ndihmojë ushtrinë në këtë drejtim, por punën ajo do ta bëjë vetë. Ky aktivitet, është e kuptueshme, ka karakter politik dhe këtë nuk do t'ia japë vetëm Komiteti Qendror. Gjithë kjo ushtri, gjithë kjo ministri, gjithë këta kuadro, ç'janë vallë, automatë? Jo! Të tërë këta janë kuadro partie; para së gjithash këta janë njerëz politikë.

Natyrisht, kjo punë që do të bëhet ka karakter ideologjiko-politik se vetë fjala «kulturë» nuk përjash-ton as ideologjinë, as politikën e Partisë. Për këtë duhet të kenë kujdes, në radhë të parë, vetë shokët e ushtrisë, komitetet e Partisë dhe gjithë ministria, me qëllim që kultura që do të zhvillohet në ushtri, si kudo te ne, të jetë në rrugën marksiste-leniniste. Mirëpo, aparati ynë është i kufizuar; aparati i rretheve po kështu etj., kurse drejtorja që do të krijohet do të jetë si gjithë drejtoritë e tjera të Ministrisë së Mbrojtjes që do të ketë veçoritë e kërkesat e saj ushtarake. Prandaj, krijimi i kësaj drejtorie më duket se është i drejtë.

Për sa i përket ndjekjes së zbatimit të ligjeve në ushtri, të bëhet kujdes për të mos na ndodhur më fenomene negative, ashtu siç na kanë ndodhur më përpara

që, kur vinte Petrit Dumja në ndonjë rreth, thoshte: «Prishni këto që keni bërë dhe bëni kështu si them unë», «Më jepni mua këtë fushë këtu, se më duhet!». Po si do ta lejojë komiteti ekzekutiv që të jepen urdhra nga njëri e nga tjetri pa u marrë miratimi nga organi kompetent?! «Pa dalë një herë, — ka të drejtë t'i thotë ai shoku i komitetit ekzekutiv të rrethit, — se unë nuk ta jap tokën që kërkon ti, po do të marrësh këtë që të caktojme ne!».

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Bujrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*



## E GJITHË PARTIA, POPULLI DHE USHTRIA DËNUAN NJËZËRI TRADHTARËT

*Diskutim në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 dhjetor 1974

Kisha përgatitur një diskutim me disa konkluzione, me qëllim që ta dëgjonin edhe pjesëtarët e grupit armik komplotist, para se Plenumi të merrte vendim përfundimtar për ta. Pa filluar mbledhja, mendova se do të ndiqnim procedurën e zakonshme, të dëgjonim të flisnin më parë tradhtarët e Partisë dhe të popullit, pastaj të fillonin pyetjet nga ana e shokëve, pas këtyre diskutimet dhe në fund unë të bëja konkluzionet. Mirëpo vendimet për ta, kësaj radhe, Plenumi i mori një nga një, pasi dëgjoji thëniet e gjithsecilit prej tyre. Procedura që u ndoq, për rastin konkret, mua më duket shumë e drejtë, pse të gjithë anëtarët e Plenumit e studiuuan raportin e Byrosë Politike dhe ishin mirë në dijeni të veprimtarisë armiqësore të komplotistëve.

---

1. Ky Plenum, që i zhvilloi punimet në datën 16-17 dhjetor 1974, diskutoi raportin e Byrosë Politike «Mbi përfundimet e diskutimit që u zhvillua në Parti rreth veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut, Petrit Dumes, Hito Çakos etj.» dhe shqyrtoi zbatimin e detyrave që vendosi Plenumi i 5-të i KQ të PPSH.

tistëve. Pastaj gjatë gjithë kohës, që nga korriku e këtej, këta elementë kaluan nëpër organizatat-bazë përkatëse, nëpër plenumet dhe aktivet e Partisë, ku u shohit mirë çdo gjë, derisa erdhi puna që çështja e tyre të shqyrtohej këtu, në Komitetin Qendror. Këtyre tradhtarëve, siç e pamë, nuk u mjaftuan disa muaj që Partia u mor me çështjen e tyre, ata nuk nxorën asnjë mësim, po edhe këtu vazhduan të na gënjejnë dhe të mbanin, si kudo në Parti, të njëjtin qëndrim armiqësor. Prandaj mendoj se ishte shumë e drejtë procedura që ndoqëm.

Përveç konkluzioneve që doja të bëja, në dritën e fakteve të reja që kanë dalë, kam përgatitur edhe një fjalim tjetër më të gjatë lidhur me thellimin e mëtejshëm në këtë komplot, të cilin i propozoj Plenumit që ta mbaj nesër<sup>1</sup>.

Në atë fjalim jam përpjekur të bëj një analizë të këtij problemi të rëndësishëm, që po shqyrtojmë, këtë le ta gjykojë nesër Plenumi, kurse në materialin që po lexoj sot janë konkluzionet e çështjeve që u trajtuan këtu.

Jam plotësisht dakord me raportin e Byrosë Politike që iu paraqit Komitetit Qendror. Jam plotësisht dakord me gjykimet revolucionare të mbarë Partisë, e cila, ashtu siç ka bërë kurdoherë, i gjykoj shumë drejt veprimet e armiqve të Partisë e të popullit dhe, duke i aprovuar me gjithë zemër vendimet e saj, jam gjithashtu dakord me vendimet e Komitetit Qendror të Partisë.

Beqir Balluku përgatiste materialet që përbënin

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 408.

antitezat. Ai thirri dy oficerë që t'ia bënë ato gati: Ernest Jakovën dhe Spiro Shalësin. (Kjo histori tash është e njohur për ne.) Petrit Dumja gënjen duke na thënë se jo vetëm nuk dinte gjë për këtë materiale që përgatiste Beqir Balluku, por edhe kur u përpoq të mësonte diçka, Beqiri gjoja i tha i zemëruar: «Kur t'i mbaroj, do t'jua jap t'i shikoni».

Ky version i Petrit Dumes është i gënjeshtërt dhe i kurdisur për ne. Faktet, shokët në aktivet e ushtrisë flasin se:

Petrit Dumja ka qenë prezent në Pogradec kur Beqir Balluku u caktoi detyrat mbi punën që do të kryenin dy kalemxhinjtë<sup>1</sup>, bile Petrit Dumja u këshillua t'u sigurojë vendin e punës në Shtëpinë e Ushtrisë në Pogradec.

Spiro Shalësi, njeri i Petrit Dumes, s'mund të rrinte pa ia thënë Petritit atë që po i ngarkohej edhe për arsye se ishte e kompetencës së Petrit Dumes, e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.

Ernest Jakova ishte njeri i Sadik Bektshit. Ky dhe të tjerë vërtetojnë se dinin për këtë material, kështu që nuk ishte e mundur të mos dinte Petrit Dumja. Kështu edhe ndonjë tjetër...

Është e paimagjinueshme që Beqir Balluku, siç po e njohim ne, të mos i ketë biseduar këto çështje me Petrit Dumen për dy arsye. Vërtetohet se të dy ishin kundër Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, të dy «i mbështetnin ato sa për sy e faqe», pse në praktikë që të dy lëshonin «romuze», i sabotonin dhe punonin që t'i likuidonin fare ose t'i shtrembëronin. Ata, për të mos u

---

1: Nënvizimet në këtë diskutim janë të vetë autorit.

demaskuar, zgjodhën rrugën e dytë, formën e «studimeve».

Nga të gjitha këto të dhëna rezulton se Beqir Balluku dhe Petrit Dumja ishin dakord për këtë veprim. Pasi mbaroi kjo çështje, domethënë «studimi», Beqir Balluku dhe Petrit Dumja me siguri u konsultuan mbi materialin dhe që të dy vendosën që ai të ndreqej. Petrit Dumja gënjen, kur thotë se nuk dinte gjë as këtë herë. Mundet që materialin e parë ta ketë kthyer Beqir Balluku për t'u përpunuar, po ai pa Petritin nuk e ka bërë këtë gjë. Këta ishin solidarë, prandaj Beqir Balluku nuk kishte pse të mos e konsultonte materialin me Petrit Dumen edhe për të dytën herë. Materiali u ripunua dhe pastaj doli një i tretë. Kjo manovër paraqitet kështu:

Petrit Dumja dhe Hito Çakoja bëjnë sikur s'dinë gjë. Beqir Balluku ua kishte mbajtur fshehur gjoja dhe, kur ua dha, këta ishin kundër (thonë Petrit Dumja dhe Hito Çakoja), po të dy këta gënjejnë edhe për atë që «nuk kanë ditur», edhe për atë që «kanë qenë kundër».

Beqir Balluku nuk tha atëherë as dinë për materialet, as jo Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, ai heshti, pse nuk donte t'i kompromentonte. Edhe vetë Beqir Balluku refuzoi t'i merrte përsipër këto materiale dhe fajin ua hodhi kalernxhinjve që gjoja shtrembëruan idetë e tij. Më në fund ai pranoi, por Petrit Dumen dhe Hito Çakon ende nuk i dha.

Faza tjetër: Petrit Dumja dhe Hito Çakoja na thonë neve se kur morën dijeni për materialin, ata gjoja i thanë Beqir Ballukut: «Mos ua shpërndaj kuadrove kryesorë!». Beqir Balluku «nuk i dëgjoi, por i shpërndau». Pasi u shpërndanë këto materiale Petrit Dum-

ja dhe Hito Çakoja e bindën gjoja Beqir Ballukun që jo vetëm t'i mblidhte ato, por edhe t'i kritikonte, por në aktivin e ushtrisë Beqir Balluku nuk bëri as njërën, as tjetrën. «Beqir Balluku, — thotë Petrit Dumja, — nuk e mbajti premtimin».

Sipas Petrit Dumes dhe Hito Çakos dy materialet «e këqija» patën këtë fat, kurse «versioni i fundit» kishte gjëra të drejta, sipas tyre, «duheshin bërë vetëm disa korrigjime».

Pra, si konkluzion:

Të tre ishin në dijeni dhe në akord.

Të tre ishin dakord që «versioni i fundit» i punimit ishte «më i miri».

Dy materialet e mëparshme, për të cilat gjoja nuk ishin dakord Petrit Dumja, Hito Çakoja dhe kuadro të tjerë kryesorë, në një mënyrë o në një tjetër «u bënë të paqena dhe faktet tregojnë se u qetësua situata». Të tërë këta ishin dakord, të tërë këta ishin në një mendje, si ngahera, që kjo çështje të mbetej sekrete dhe, si ngahera e për çdo gjë, të mos na vinin në korent. Edhe kuadrot e tjerë e veçanërisht Rahman Perllaku e Sadik Bekteshi, elementë plotësisht të kredhur në këto punë antiparti, elementë fodullë, arrogantë, prepotentë dhe karricistë, ishin jo vetëm solidarë me të tre armiqtë kryesorë, por me qëndrimet dhe me sjelljet e tyre i ndihmuan ata e, veçanërisht, kur morën dijeni për këto materiale, ishin në të njëjtin mendim me «Treshen».

Mirëpo diçka ua ngatërroi atyre planet dhe kjo ishte çështja e «riorganizimit të Komandës së Përgjithshme». Këtë çështje «miqtë» e morën lehtë, filluan diskutimet, vunë në dyshim organizimin e vendosur

nga Komiteti Qendror, filluan kundërshtimet, kontraktat, çdo gjë diskutohej nga platforma personale, kërraba tërhiqte nga njëri dhe nga tjetri, çdo gjë diskutohej nga platforma e «Komandës» dhe u arrit në përfundim që kaporionët u ndanë më dysh, një pjesë me Beqir Ballukun, një pjesë tjetër me Petrit Dumen, ndërsa Hito Çakoja u bë arbitër. Ky, i këshilluar edhe nga të tjerët, i bëri një raport Komitetit Qendror, me të cilin kërkonte që të vendosnim ne për njërin o për tjetrin version.

Ne, me të parë këtë raport, i hodhëm poshtë që të dy këto versione dhe qëndruam në organizimin që kishim më parë. Këtu filloi nga ana jonë dyshimi serioz se në udhëheqjen e ushtrisë diçka e sëmure po zhvillohej. U vendos që shoku Hysni me një tjetër të thërrisnin Beqir Ballukun, Petrit Dumen e Hito Çakon dhe t'u kërkonin llogari dhe arsyet përse kërkonin të bëheshin këto ndryshime. Natyrisht, arsyet e tyre nuk qëndronin, pse ishin false, kishin qëllime të tjera të fshehta, të cilave u kam dhënë një supozim më parë në një shkrim<sup>1</sup> timin mbi këtë çështje. Atyre u bënë pyetje: Pse? Ku? Tek? etj. Nga këto pyetje ata s'dilnin dot dhe, më në fund e më në bisht, si me darë, Petrit Dumja u detyrua të pohojë se «me Beqir Ballukun kanë kundërshtime parimore», dhe kaq. Beqir Balluku u hodh përpjetë, krisi grushtin në tryezë kundër Petrit Dumes, ai u orvat ta frikësojë këtë duke bërë titur: «Kërkoj që Komiteti Qendror t'i vejë deri në fund kësaj çështjeje». S'menduan as Beqir Balluku, as Petrit Dum-

---

1. Është fjala për materialin «Enigma e P. Dumes dhe e H. Çakos».

ja, se ranë brenda. Fakt është se Petrit Dumja e dha Beqir Ballukun. Për ne ky pohim na përforcoi dyshimet dhe iu futëm punës për të parë se ku qëndronin këto kontradikta parimore.

Që këtej fillon manovra e madhe e Petrit Dumes dhe e Hito Çakos: «Duhej djegur nga ana e tyre Beqir Balluku, të shpëtonin veten dhe të dilnin si shpëtimtarë». Ata zhvilluan historinë që dimë, por në veprimet e tyre «për të djegur Beqir Ballukun» që të dy kërkuan nga 5 a 6 kuadro kryesorë që të bënin letra deklarative se ishin kundër «materialeve» që kishte përgatitur Beqir Balluku. Dhe këta i bënë këto deklaratat. Halim Ramohitoja i ka deklaruar një kuadri të një njësie të ushtrisë se «materialelet e Beqir Ballukut unë nuk i kam pasë lexuar, por Hito Çakoja më tha t'i denoncoj dhe unë i denoncova». (Vërtetohet supozimi im.) Petrit Dumja dhe Hito Çakoja dhanë edhe ata deklarata me shkrim nga ana e tyre, kurse Sadik Bekteshi s'dha, se ishte pro materialeve të Beqir Ballukut, domethënë pro antitezave.

Mirëpo atyre u qëndronte një kockë në grykë: «Pse nuk vunë në korent Komitetin Qendror për këtë punë armiqësore?».

Ata menduan se do ta kalonin lumin, «duke bërë një autokritikë», thanë «bëmë gabim të madh». Por lumin s'e kaluan dot, se i mbyti Partia.

Po pse e dha Petrit Dumja Beqir Ballukun?

U ndodh ngushtë. Petrit Dumja mendoi se Byroja Politike ose kishte marrë vesh ç'kishin bërë këta prapa krahëve të saj, ose do ta zbulonte. Atëherë ai mendoi: «T'i dal përpara punës», «të akuzoj Beqir Ballukun, ta fut thellë dhe me këtë rast ta heq qafe e t'i zë vendin».

Petrît Dumja mendoi se nuk mund të thoshte dot më se me Beqir Ballukun, kundërshtimet që kishte me të ishin «stili e metoda, zënkat personale etj.», por që të besohej nga ne, ai i kthen këto në «kontradikta parimore». Beqir Balluku nuk e priste këtë sulm nga krahet, pse e dinte që «me Petrît Dumen ishin dakord që më parë», prandaj u revoltua.

Petrît Dumja dhe Hito Çakoja e shtjelluan sulmin, Beqir Balluku u përpoq të mbrohej, po nuk kundërsulmoi mbi Petrît Dumen dhe mbi Hito Çakon. Pse nuk u mbrojt Beqir Balluku kundër këtyre të dyve? Pse nuk i sulmoi? Pse nuk i demaskoi ata? Shpjegimi është se ai «mbronte një çështje më të madhe, një plan sekret më të rëndësishëm», për të cilin ishin në dijeni që të tre. Që të tre e mbajnë fshehtë, dy prej tyre u ngritën dhe goditën njërin, Beqir Ballukun, duke e djegur këtë. Beqir Balluku u sakrifiku, pse nga analiza që po bëhej në ushtri, Beqir Balluku del një tradhtar, por Petrît Dumja dhe Hito Çakoja janë jo më pak tradhtarë. Beqir Balluku u njihte këtyre dhembë e dhëmballë. Atëherë pse nuk i demaskoi? Pse heshti? Ai totalisht heshti në ato momente, me gjithë kërcënimin që i bëri Petrît Dumes që «kësaj çështjeje Komiteti Qendror t'i shkojë deri në fund».

Petrît Dumja dhe Hito Çakoja e dogjën Beqir Ballukun për të shpëtuar kokën dhe për ta hequr qafe, për t'i zënë vendin. Ç'do të bënin këta, pasi të eliminonin Beqirin? Atë punë që kishin filluar të bënin që të tre, por këtë herë në mënyrë më aktive. Petrît Dumja dhe Hito Çakoja kishin menduar që puçin dhe komplotin ta zhvillonin më tej. Beqir Balluku për ta ishte shumë i nxituar, pse ata i njohnin mirë bisedimet që bënin në



mes tyre, se Beqir Balluku rrezikonte «puçin», mund të zbulohet, prandaj edhe e dogjën.

Petrît Dumja dhe Hito Çakoja mendonin me siguri se «pozitat e tyre» në ushtri dhe karshi nesh «ishin më të forta» se ato të Beqir Ballukut, se për ta, poshtërsitë që po bënin çdo ditë në ushtri dhe në organizatën e saj të Partisë, do të mbaheshin të fshehta se ishin «gjëra» të normuara, të parëndësishme për ta dhe «s'kishte asnjë rrezik nga kjo anë». Ashtu siç nuk llogaritnin forcën e Partisë në ushtri, këta tradhtarë mendonin se Komiteti Qendror dhe e gjithë Partia ishin në gjumë.

«Lodra» e tyre nuk vazhdoi më shumë se një muaj a dy. Tradhtinë e tyre ne e diktuam që pas aktivitetit të parë të ushtrisë, që u bë për këtë punë<sup>1</sup>, që pas Plenumit<sup>2</sup> të Komitetit Qendror, por i lamë të futeshin më thellë në «eufori», pastaj t'u thyenim kokën.

Historia e njerëzimit, që nga kohët më të lashta e deri më sot, historia e çfarëdo revolucioni, nuk ka parë një gjyq tradhtarësh si ky që po i bëhet në Shqipërinë socialiste këtij grupi tradhtarësh, Beqir Ballukut, Hito Çakos, Petrît Dumes dhe shokëve të tyre. Gjyqi vazhdon prej 6 muajsh, i hapët për të gjithë popullin, deponimet kundër tyre që formojnë akuza janë me dhjetëra e me dhjetëra mijë. Të tërë të akuzuarit kanë qenë të lirë dhe jo të arrestuar dhe janë ballafaquar me punonjësit, bile ata qëndronin edhe në funksionet që kishin. Masat e gjera të Partisë, të ushtrisë, të popullit me një hov revolucionar të paparë ndonjë-

1. Ky aktiv i zhvilloi punimet e tij në Durrës më 6-7 korrik 1974.

2. Shih në këtë vëllim, f. 53.

herë, bënë vetë edhe rolin e hetuesit, edhe të prokuro-rit, edhe të gjykatësit. E gjithë Partia, ushtria dhe po-pulli vendosën njëzëri dënimin e tyre. Kjo s'ka ngjarë kurrë në histori. Kjo tregon forcën e ideve marksis-te-leniniste, forcën e popullit tonë. Ne këtu, në Komi-tetin Qendror, po japim sanksionin e këtij gjykimi të madh popullor. Tash mbetet akti i fundit i sanksioni-mit ligjor, puna e hetuesisë, e prokurorisë që të zbu-lojnë plotësisht deri në skajet më të errëta komplotin, në dritën e fakteve kaq të shumta që kanë dalë. Këta tre tradhtarë duhet t'i zhveshim, t'i bëjmë lakuriq dhe t'u japim dënimin që meritojnë si gjithë tradhtarëve të Partisë, të popullit dhe të ushtrisë. Mbi ta rëndojnë shu-më akuza që formojnë krime ndaj Partisë dhe popullit.

Këta të tre, Beqir Balluku, Hito Çakoja dhe Petrit Dumja në krye të Rahman Perllakut, të Sadik Bekte-shit e të tjerëve, organizuan një fraksion të rrezikshëm në kokë të Partisë dhe në krye të ushtrisë për të go-ditur vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë, për të rrëzuar Komitetin Qendror marksist-leninist të Par-tisë dhe për ta shndërruar Partinë tonë në një parti revizioniste. Ata, për t'ia arritur këtij qëllimi:

U orvatën të dobësonin organizatën e Partisë në ushtri, duke dobësuar dhe shtrembëruar parimet mark-siste-leniniste, normat dhe ligjet e Partisë.

I imponuan Partisë në ushtri normat më të këqija antimarksiste ushtarake borgjeze: komandimin ush-tarak, disiplinën ushtarake të identifikuar me arrogan-cën dhe prepotencën.

Dobësuan vigjilencën e Partisë dhe futën frikën në kuadrot dhe në komunistët, për t'i mbajtur të nën-shtruar.

Eliminuan gati krejt mësimet në bazë të materialeve të Partisë dhe i zëvendësuan këto me materiale revizioniste sovjetike. Pra, bënë përpjekje të hapëta që të zëvendësonin marksizëm-leninizmin me revizionizmin.

Beqir Balluku, Hito Çakoja, Petrit Dumja dhe të tjerët:

Sabotuan edukimin ushtarak të Ushtrisë Popullore. Ata udhëhiqeshin në këtë vepër armiqësore nga teoria revizioniste sovjetike. Që të tre injoruan dhe përçmuan Luftën Nacionalçlirimtare dhe eksperiencën e saj. Ata ishin kundër dhe sabotuan Letrën e Hapur të Komitetit Qendror të Partisë drejtuar ushtrisë, sabotuan Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, hodhën në shportë Tezat «Mbi Shkollën e Lirë Ushtarake».

Ata krijuan ndarjen në mes kuadrove dhe masës së ushtrisë, krijuan ndarjen në mes kuadrove të lartë nga njëra anë dhe kuadrove të mesëm e të ulët nga ana tjetër, krijuan kastë të privilegjuar, të dënueshme për disa kuadro të lartë.

Ata vendosën në ushtri metoda të urryera komandimi, vendosën arrogancën, prepotencën, shkonin drejt likuidimit të drejtimit të ushtrisë nga Partia dhe drejt vendosjes në drejtim të pushkës mbi Partinë.

Ata kanë sabotuar programet ushtarake dhe ndërtimin e fortifikimit të vendit.

Ata përgatitnin në fshehtësi antiteza në kundërshtim me Tezat e Këshillit të Mbrojtjes.

Të gjitha këto kishin për qëllim të dobësonin dhe të zhduknin rolin e Partisë në ushtri, të dobësonin ushtrinë dhe mbrojtjen e vendit, të përgatitnin një forcë goditëse fashiste për të zhvilluar një puç kundër Par-

tisë së Punës të Shqipërisë, për të goditur pushtetin popullor, për t'i përgatitur terrenin një invadimi sovjetik ose ndonjë fuqie tjetër armike të jashtme, të shkatërronin diktaturën e proletariatit, të vendosnin në vendin tonë diktaturën borgjezo-fashiste dhe të restauronin kapitalizmin.

Për të gjitha këto faje dhe krime të rënda edhe një herë shprehem plotësisht dakord me vendimet e drejta që miratoi Plenumi, që Hito Çako dhe Petrit Dume të përjashtohen nga Komiteti Qendror dhe nga Partia, t'u hiqet imuniteti parlamentar dhe që të katër Beqir Balluku, Hito Çako, Petrit Dume dhe Rahman Perllaku të arrestohen dhe, si tradhtarë, të kalojnë para një gjykate speciale ushtarake.

Për fajtorët e tjerë në këtë çështje shprehem, gjithashtu, plotësisht dakord që:

Të përjashtohet nga Komiteti Qendror, nga Partia dhe nga ushtria Sadik Bekteshi.

Të përjashtohet nga Komiteti Qendror dhe nga Partia Halim Ramohitoja.

Të përjashtohet nga Komiteti Qendror Dilaver Poçi.

T'i jepet vërejtje e rëndë me shënim në kartën e regjistrimit Veli Llakajt.

Për sa i përket Dashnor Mamaqit jam plotësisht dakord me vendimet që janë marrë kundër tij dhe propozoj të përjashtohet nga Partia si njeri krejt i degjeneruar dhe vagabond, imoral, antikomunist, bashkëpunëtor dhe në akord me mendime politike me Beqir Ballukun, ashtu siç ishte edhe në marrëdhëniet në jetë me të. Ky element i degjeneruar na qenka edhe një provokator, pse kërkon të diskreditojë udhëheqjen e Partisë që gjoja nuk e ka njohur Beqir Ballukun dhe

kompaninë e tij. Por ne i themi këtij provokatori imoral dhe armik se, njerëzve si ai dhe shokët e tij, ne nuk do të marrim as mundimin më të vogël që t'u përgjigjemi, se ne jemi nga ata që dimë t'ia themi Partisë sonë atë që kemi dhe që mendojmë. Por këtë satisfaksion këtij dhe shokëve të tij ne nuk do t'ua japim, vetëm u themi se, po të kishim marrë dijeni vetëm një të njëmijtën e atyre poshtërsive dhe tradhtive që kanë bërë në mënyrë të fshehtë, ata do të pësonin atë që pësuan tash dhe atë që do të pësojnë nesër.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TË THELLOHEMI MË TEJ NË ANALIZËN  
E KOMPLOTIT TË BEQIR BALLUKUT, PETRIT  
DUMES, HITO ÇAKOS DHE TË NXJERRIM MËSIMI  
PËR PUNËN E PARTISË NË USHTRI E NË TERREN**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 6-të*

*të KQ të PPSH*

17 dhjetor 1974

Gjatë analizës së punës armiqësore të Beqir Ballukut, Partia ka theksuar se ushtarakët veçanërisht duhet të ndihmojnë për të vërtetuar në thellësi këtë veprimtari të tij. Ne duhet të çëmtonim hallkat e zinxhirit që përbëjnë veprimet dhe thëniet andej-këndeje të Beqir Ballukut dhe të formonim kështu me to zinxhirin e plotë të punës së tij armiqësore. Gjithashtu është theksuar nga udhëheqja e Partisë se puna armiqësore e Beqir Ballukut nuk mund të jetë e rastit, se ajo duhet të jetë e vjetër dhe e koordinuar me jashtë, mundet me titistët dhe me sovjetikët, se ky veprim i Beqir Ballukut duhet të jetë një puç, një komplot i organizuar nga brenda nga ana e tij, që do të mbështetej edhe nga jashtë. Por kjo duhej vërtetuar.

Ekskludohet që Beqir Balluku të ketë qenë vetëm ose vetëm ai me Petrit Dumen dhe Hito Çakon. Këta

janë kryesorët, gjë që vërtetohet nga materialet dhe nga të dhënat që kemi. Ndihma e tyre e jashtme do të ishte revizionizmi sovjetik. Por cilët janë pjesëtarët e tjerë të këtij komploti dhe si do të vepronin këta? Kjo medoemos duhet sqaruar dhe, që të bëhet sqarimi, lyp nga njerëzit shpirt revolucionar dhe vigjilencë.

Në radhë të parë, duhet kuptuar mirë se ajo që ngjau nuk përbën «disa gabime, disa faje, disa keqkuptime» e të tjera të këtij lloji, por një krim kundër Partisë dhe pushtetit popullor, ai ishte një komplot për të rrëzuar pushtetin tonë socialist. . . Prandaj asgjë nuk na lejohet të merret përciptazi, duke thënë «Ky shok ka qenë i mirë, ka bërë luftën, nuk mund të shkojë deri në atë gradë, u gënjye» etj. Mund të jetë edhe kështu, por ndonjërit që ka vepruar keq, t'i vinim *a priori* këto arsye lehtësuese, pa i kontrolluar dhe pa vërtetuar imtësisht pikëpamjet dhe qëndrimet e tij, do të bënim gabim dhe nuk do të zbulonim as bashkëpunëtorët e Beqir Ballukut, të Petrit Dumes dhe të Hito Çakos dhe as gjerësinë e thellësinë e këtij komploti të rrezikshëm. Natyrisht, nuk na lejohet dhe do të bënim, gjithashtu, një gabim të madh që të dyshojmë te çdo kuadër.

Ne duhet të shkojmë nga fakti që Beqir Ballukut, Petrit Dumes dhe Hito Çakos u nevojiteshin, në radhë të parë, kuadro kryesorë të ushtrisë, me qëllim që, në kohën e një puçi eventual, këta puçistë të kishin kështu besimin e ushtrisë dhe ushtria jonë të thoshte: «Kjo që po bëhet, derisa ne udhëhiqemi nga këta kuadro të lartë të Partisë dhe të ushtrisë, është një punë e drejtë».

Duhet të kemi parasysh që këta komplotistë nuk mund t'i bënë dot të gjithë kuadrot e lartë me vete, por, si komplotistë dhe puçistë, ata synonin ose përpi-

qeshin të bënin me vete ata kuadro që ishin në vende kyç dhe që do të ishin vendimtarë për momentet e para të puçit. Këta elementë duhet të njiheshin nga reparti ose repartet, duhet të ishin «kurajozë aventurierë», «prepotentë dhe arrogantë», «mendjemëdhën timer dhe feudalë ushtarakë». Në brendi këta duhet të ishin antiparti, ndërsa në dukje gjoja me Partinë. Midis të tillë kuadrove duhet të bëjmë përsëri një nëndarje: një pjesë mund të kishte dijeni më parë për çka po përgatitej nga Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, një pjesë do të bashkohej lehtë më vonë. Të mos harrojmë atë që u tha Beqir Balluku dy oficerëve që po i përgatitnin materialin, kur këta i shfaqën njëfarë dyshimi: «S'ka gjë, ju mbarojeni, disa do ta kuptojnë shpejt, disa do ta kuptojnë më vonë». Kjo thënie e Beqir Ballukut ka një kuptim të thellë dhe tregon një siguri tek ai, gjë që duhet të na bëjë të mendojmë se në këtë punë armiqësore komplotiste Beqir Balluku dhe Hito Çakoja nuk ishin vetëm, por mund të kishin formuar një bërthamë që ata e konsideronin «të fortë».

Ky organizim komploti «në kokën» e ushtrisë duhet të kishte edhe degëzime poshtë. Si mund të ishin krijuar këto degëzime? Me zgjedhjen e kuadrove «pretorianë» që nga natyra e tyre ishin të përshtatshëm për qëllimin. Ishin këta të inkuadruar ose jo dhe deri në çfarë pike, kjo është një çështje që duhet vërtetuar. Duhet bërë studime nga afër për të parë se te cili nga të tillë kuadro e me të tilla tipare mbështeteshin, pse ngriheshin, përkraheshin dhe vilheshin në poste kyç nga Beqir Balluku, Hito Çakoja, Petrit Dumja e të tjerë. Objekt inkuadrimit nga Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja qenë njerëzit e degjeneruar, vjedhësit,



të padisiplinuarit, elementët antiparti të kamufluar e të tjerë të këtij lloji, që ne duhet t'i diktojmë, pse për komplotistët këta do të ishin «njerëzit e veprimeve të egra», sepse të tillë njerëz janë të interesuar që të ndërrojnë regjimi ynë. Komplotistët përdornin, gjithashtu, edhe metodën e komprometimit të kuadrit.

Prandaj duhen zbuluar më tej edhe metodat që kishin përdorur, edhe rezultatet që kishin arritur komplotistët. Neve për asnjë çast nuk na lejohet të mos e sqarojmë plotësisht këtë punë armiqësore. Në këto drejtime duhet të punohet nga ana e Partisë dhe nga ana e Sigurimit të Shtetit. Asgjë të mos na shpëtojë, asnjë fakt, asnjë e dhënë, asnjë fjalë të mos e neglizhojmë pa e marrë në konsideratë, pa e analizuar, pa e vlerësuar, pa u thelluar në të dhe pa e lidhur me të tjerat. Për komplotistët s'mund të ketë mëshirë. Nuk hyjnë këtu metoda të buta, oportuniste ose «bindëse», përkundrazi, kundër atyre duhet të veprojnë ligjet e ashpra të diktaturës së proletariatit dhe të Partisë. Këta s'mund të konsiderohen njerëz që kanë bërë gabime dhe që mund të ndreqen, pse janë armiq komplotistë, që kanë punuar për të shkatërruar Partinë dhe socializmin në vendin tonë.

Në vendet kyç të ushtrisë, në komandë, në drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, në njësitë dhe në disa reparte speciale, tani që na ngjanë këto gjëra, duhet të zgjedhim shokë të vendosur e të ngritur partie, besnikë, të shkathët dhe të zotë nga ana ushtarake, të përpjyer në këto ujëra të turbullta dhe që t'i kuptojnë e t'i zbatojnë drejt çka thashë më lart veçanërisht, pse vetëm në këtë mënyrë ata do të jenë në gjendje të mo-

bilizojnë Partinë dhe efektivin për të llagaritur ujërat e qelbura dhe të turbullta në ushtri.

Është e domosdoshme të bëhet shumë kujdes që as të dyshohet pa baza për ndonjë kuadër, as të krijohet panik, por as edhe të lihen plagët brenda, pikërisht nën parullën se «mos krijohet panik». Të kemi parasysh se panik, pakënaqësi ose rezistencë, si të duash ta quash, mund të krijohet në disa kuadro të vjetër, që janë mësuar me një metodë pune të tillë të sëmurë, që nuk u pëlqen kur çështjet vihen drejt, që u duket sikur nënvleftësohen, ose sikur dyshohet ndaj tyre. Këto janë probleme që, ku hapur e ku fshehur, do të na dalin. Prandaj në ushtri Partia duhet t'u dalë përpara atyre.

Të bëhet kujdes që njerëzit e drejtë dhe të mirë, që do të sillen në vendet kyç, të mos përdorin arrogancën e prepotencën për të vendosur drejt gjërat në ushtri, por të përdorin metodat e bindjes dhe të durimit të Partisë, pse ndryshe do të acarohen konfliktet të dëmshme e të rrezikshme, që në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë të na krijojnë. Partia të luftojë tendencën «të vjetër e të rinj», që mund të krijohet fare lehtë në këto situata, pse ne duhet e do të ngremë kuadro të rinj.

Armiq të Partisë dhe të shtetit, në një bisedë që kanë bërë në mes tyre, kanë thënë: «... sa keq që u zbulua dhe dështoi kjo punë e Beqir Ballukut para muajt gusht», pse më 16 gusht, sipas tyre, do të zaptohet Radioja dhe Televizioni, do të izolohej udhëheqja (Komiteti Qendror i Partisë), do të merrej fuqia dhe do të hidheshin për ndihmë nga Bashkimi Sovjetik 20 000 parashutistë.

Kjo është një e dhënë që duhet verifikuar. Po, pa-

varësisht nga kjo, këta armiq flasin sikur janë që më parë në dijini të këtij komploti, deri dhe në data: «Do të zhvillohej më 16 gusht», «Do të izolohej Komiteti Qendror», «Do të zaptuhej Radioja e Televizioni», «Do të zbarkonin edhe 20 000 parashutistë sovjetikë».

Të jetë kjo thjesht një imagjinatë e tyre, apo e pritnin se e dinin një gjë të tillë? Por edhe në qoftë se nuk e dinin dhe e imagjinonin, me ato «precizione karakteristike» që japin, komploti që përgatitnin Beqir Balluku me shokë kështu kishte mundësi që të zhvillohej. Ata kujtonin se në, duke qenë në pushime, do të na zinte gjumi dhe do të vepronin, prandaj çështja nuk mund të jetë fare imagjinatë nga ana e tyre.

Çështja tjetër në të cilën u thellua Partia ishte ajo e Petrit Dumes. U shtrua pyetja: Është ky i implikuar në këtë komplot apo jo, pse i doli emri si «shpëtimtar i situatës»? Përveç atyre që kemi thënë, natyrisht, Partia duhet të ndalet mirë në disa çështje me rëndësi, që janë:

a) Beqir Balluku dhe Petrit Dumja «grindeshin» si dy gjela për çështje «kompetencash, stili e metode», «jo ti, jo unë, jo pse e bëre kështu, jo pse e bëre ashtu». Të gjitha këto ngjishnin dhe mund të ngjishnin. Të dy vinin në Byronë Politike, kritikoheshin, pranonin aty kritikën, bënë gjoja autokritikë dhe iknin. Ata ktheheshin përsëri në Byronë Politike dhe prapë avazi i parë, por është karakteristike se asnjëherë nuk thanë arsye e vërtetë përse në mes tyre kishin grindje e mosmarrëveshje. Kjo ka rëndësi.

Nga ana parimore, pavarësisht ç'është tash Petrit Dumja, ky ka qenë dakord me rrugën antiparti dhe antishtetërore që ndiqte Beqir Balluku që më 1966 («Te-

oria e rrëshqitjes»), pse Petrit Dumja asgjë nuk denoncoi. Puna e Petritit në ushtri është, gjithashtu, antiparti. Mos vallë zënkat ishin një mbulesë për akordin që ekzistonte në mes tyre dhe për të na bërë ne të mos dyshonim për asgjë e të mendonim se «në mes të të dyve ka kontradikta dhe s'ka e s'mund të ketë kurrë marrëveshje»?

b) Si mund të ngjasë që Beqir Balluku, me karakteristikat e tij dhe gjoja me kontradiktat dhe zënkat e vazhdueshme që kishte me Petrit Dumen, tri herë me radhë, kur kërkoi të jepte dorëheqjen, na propozoi në vend të vet Petrit Dumen? Ai nga ana e vet mund të kërkonte vetëm dorëheqjen dhe të thoshte: «Le të vendosë Byroja Politike kush do të më zëvendësojë». Kjo, pra, është karakteristike. E bënte këtë Beqir Balluku si shantazh? Mundet. Apo e bënte vallë për të tatuuar pulsionin tonë, për të parë me kë anonim ne, me të apo me Petrit Dumen? Mundet. Apo e bënte për të parë nëse dyshonim gjë ne për çka po përgatitnin të dy bashkë, Beqir Balluku e Petrit Dumja? Edhe kjo ka mundësi.

Por më në fund ka rëndësi edhe supozimi tjetër «që të dy, të lidhur në komplot, krijojnë zënkat. Beqir Balluku vinte dhe kërkonte të jepte dorëheqjen që të qëndronte si zëvendëskryeministër dhe që prej andej të drejtohte pastaj përveç ushtrisë edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me një fjalë, përgatitej për punën, për të marrë fuqinë. Petrit Dumja bëhej me këtë rast ministër i Mbrojtjes dhe Hito Çakoja, si «ekspert i punës politike», bëhej sekretar i komitetit të Partisë të ministrisë». Ky është një supozim tjetër. Si zor t'i japësh shpjegim tjetër kësaj çështjeje. Faktet e reja na sqarojnë më mirë.

c) Çështja e tretë, është ajo që veprimet armiqësore të Beqir Ballukut, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja i mbajtën fshehur.

U vërtetua katërcipërisht se ata i dinin dhe me siguri që ishin dakord me to. Ata dinin që të tre se literatura e huaj revizioniste hynte në ushtri. Jashtë orientimeve të Komitetit Qendror këta nga njëra anë futnin këtë literaturë, ndërsa materialet e Partisë i pengonin. Vërtetohet se antitezat e Beqirit ata i dinin dhe për këtë na gënjyen një herë, gënjyen të dytën herë dhe nuk na vunë në korent edhe kur gjoja i mësuan. Po ç'ngjau në këtë mes? Diçka e çuditshme, të cilën Petrit Dumja dhe Hito Çakoja e sjellin si argument të tyre: Ata nuk pranuan materialin e parë, Beqir Balluku u paraqiti një të dytë, edhe këtë gjoja nuk e pranuan; Beqir Balluku bëri atëherë një të tretë etj., etj. Më në fund, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja bënë çmos jo vetëm që të mos na thoshin gjë, por u përpoqën ta mbyllnin me çdo kusht këtë material.

Përse u bënë nga ana e tyre këto veprime misterioze? Këto kanë ngjyrë komploti. Po pse nuk ranë dakord? Petrit Dumja dhe Hito Çakoja donin që «ky material të mos u shpërndahej kuadrove kryesorë», kurse Beqir Balluku e shpërndau atë. Kësaj pyetjeje ne mund t'i përgjigjemi me arsyetimin se që të tre kanë qenë të lidhur në komplot dhe Petrit Dumja një ose dy herë arriti që t'i impononte Beqir Ballukut që të korrigjoheshin antitezat, pse kishte frikë, kurse, për Beqir Ballukun, të mos harrojmë atë që tha se «disa do t'i kundërshtojnë, por do të binden më vonë».

Beqir Balluku ishte «në i sigurt» dhe shpejtonte, kurse Petrit Dumja përpiqej të mos shpejtohej. Mirëpo

pse shpejtohej Beqiri? Le t'i referohemi informatës që përmenda pak më parë. Beqir Balluku mund të kishte sigurime dhe urdhër nga sovjetikët që të veprohej pa humbur kohë. Duhet të supozojmë se Petrit Dumja e dinte këtë vendim, por hezitoi, nuk mendonte se qe pjekur situata, kishte frikë se mos dështonte puçi. Prandaj që të tre e mbajtën të fshehtë, kurse Petrit Dumja dhe Hito Çakoja u përpoqën ta mbyllnin këtë çështje, çka do të thotë «ta futnin në frigorifer», pse, sipas këtyre, duhej punuar akoma më shumë, duhej pritur një moment më i volitshëm. Këtë variant shumë të mundshëm ne nuk duhet ta neglizhojmë.

Po i ka Petrit Dumja karakteristikat e një puçisti? I ka, bile të plota. Ai është aventurier me kurajë, arrogant dhe prepotent, ka dëshirë të komandojë dhe të bëjë ligjin në ushtri, hiqet i zoti dhe aktiv, është i lëvizshëm dhe i ahengjevc, është i paqartë ideologjikisht, çështjen e Partisë e dëmton, e lufton dhe e denigron. Bile, përveç të tjerave, në një darkë të Mehmet Shehu, në pije e sipër dhe gjoja si me shaka, Petrit Dumja i tha një shoku: «Unë edhe të arrestoj». Ja deri këtu arrijnë sjelljet e një *soudard*<sup>1</sup>-i të tillë.

Pra, Petrit Dumja i ka karakteristikat e një puçisti dhe, duke qenë se në bazë të fakteve, ne mund të konkludojmë se ky ishte një komplot, ose një puç, Beqir Balluku këtë nuk mund ta bënte dot pa Petritin, bile duhet të kishte me vete edhe shumë oficerë të tjerë madhorë me karakteristika si të Petrit Dumes. Ky nuk mund t'u shpëtojë dot veprimeve që ka bërë, duke vazhduar të gjejë arsye të paqena, as me disa «autokri-

1. Frëngjisht — ushtarak i vrazhdë, brutal.

tika» të përsëritura, që e rëndojnë akoma edhe më shumë në drejtim të atyre që thashë më lart.

Për Hito Çakon tash çdo gjë për ne është e qartë, ai është një agjent i sovjetikëve, një komplotist. Edhe karakteristikat e Petrit Dumes, të karakterit dhe të punës, si dhe qëndrimet që ai mbajti për këto probleme, janë po ato të një komplotisti. Ç'mund ta lidhë këtë me Beqir Ballukun? Karakteri? Mendoj se ky jo edhe aq, se në dukje ata nuk pajtohen, por ata i lidh me njëri-tjetrin ideologjia antimarksiste. Pikëpamjet anti-parti dhe antishtetërore ishin të kristalizuara si te Beqir Balluku, ashtu dhe te Petrit Dumja, prandaj që të dy janë marrë vesh me njëri-tjetrin për puçin që do të bënin.

Petrit Dumja edhe në çështjet ushtarake mendoj se nuk kishte ndonjë zotësi, siç hiqej dhe siç e trumbetonte. Unë nga afër në këto çështje nuk e njoh, por mendoj se ai nuk kishte kokë për shef shtatmadhorie, s'ishte njeri i konkluzioneve dhe i vendimeve të drejta dhe me karakter të rëndësishëm për organizimin e ushtrisë dhe të veprimeve të saj në luftë. Ai kishte më tepër blofin e një ushtaraku «të madh», por për punë të vogla, praktike, shko këtu, shko atje, merr një vendim, ndryshoje nesër, duke qenë i bindur se çdo gjë që bënte ishte e drejtë. Nga ana ushtarake ai e ndiente veten «epëror mbi gjithë të tjerët» dhe donte e kërkonte që të zbatohesh hierarkia e sëmurë nën atë e poshtë, por jo mbi të. Mbi atë nuk duhet të kishte hierarki.

Unë kam menduar dhe mendoj se Petrit Dumja nuk ka horizonte të gjera të një ushtaraku revolucionar që është në gjendje të dijë dhe të diskutojë për karakterin e luftërave kryesore të zhvilluara gjatë kohëve,

të bëjë krahasime dhe deduksione që t'i shërbejnë për t'u armatosur kundër luftërave të imperialistëve etj. Jo, ai as që ka ide nga këto luftëra, as i njeh, as bën përpjekje t'i njohë. Ai di disa gjëra organizative, disa numra apo kalibra topash, ka dijeni për disa norma të mësuara në akademinë sovjetike, kurse Luftën tonë Nacionalçlirimtare e ka harruar dhe e ka errësuar me vlerësimet e vetes së tij, duke u nisur nga ato koncepte të çala, gjoja akademike dhe klasike, që ka marrë në shkollën sovjetike.

Fakt është se Petrit Dumja hiqej sikur i mbronte Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, por në të vërtetë nuk i zbatonte dhe i sabotonte, ai nuk u shtrua kurrë që t'i zhvillonte ato, t'i planëzonte, t'i pasuronte, t'i kontrollonte se si zbatoheshin në jetë dhe si studioheshin. Asgjë serioze nuk bënte nga këto. Pra, në fakt, ishte kundër tyre. Çështjes aq të rëndësishme të Shkollës së Lirë, që është një mësim i Leninit, që duhet të gjente zbatim në kushtet kaq të përshtatshme të vendit tonë, Petrit Dumja as që i kishte vënë rëndësinë e duhur. Shumë pak rëndësi do t'u vinte ai edhe urdhrave të Këshillit të Mbrojtjes e të Komandantit të Përgjithshëm në çdo kohë, por sidomos në kohë lufte. Karakteri i tij, metoda e punës së tij, «e vogël», me «kërcime» dhe me gjithë të këqijat dhe poshtërsitë që dalin, e vënë këtë në radhën e parë të komplotistëve.

Petrit Dumja nuk studionte dhe përshtypja ime është se gjykimet e tij ishin rezultat më shumë i një rutine të sëmurë, sesa rezultat i një thellimi. Kultura e tij ishte shumë e paktë, për të mos thënë hiç. Ai nuk merrte pjesë në asnjëfarë diskutimi, rrinte i mbyllur



dhe i heshtur dhe kjo nuk ishte shenjë modeste, por mungesë kulture dhe bindjeje në vijën e Partisë.

Petrit Dumja, dhe pas tij edhe mjaft të tjerë, nuk ishin dakord me orientimet e Partisë për ushtrinë. Solidariteti i tyre me to ishte formal, pse në praktikë ata vepronin si «bajraktarë» ushtarakë. Demokracia, gradat, hierarkia, të gjitha këto, viheshin në zbatim dhe kuptoheshin prej tyre në mënyra krejt të kundërta me ato që donte dhe që kishte urdhëruar Partia. Prandaj nuk lejohet që të tillë kuadro të cilësohen se kanë punuar mirë, kur në të vërtetë gabonin dhe vepronin shtrembër, në teori dhe në praktikë. Një punë e tillë e tyre i dëmtonte rëndë Partinë, ushtrinë dhe kuadrot dhe, pa dashur apo me dashje, çonte ujë në mullirin e armikut. Partia do të vihëj medoemos në ballafaqim me ta, në mos sot, nesër, ashtu sikurse u vu.

Një situatë e tillë absolutisht duhet spastruar dhe ndrequr rrënjësisht në rrugë partie. Çdo sektor të punës në ushtri duhet ta shohim dhe ta vëmë në rrugë të drejtë, me anën e një pune intensive partie. E theksoj, me një punë intensive partie, pse rutina e rrezikshme mund të na çojë përsëri që të përdorim metodat «personale» dhe ato t'i vetëquajmë «veprime partie».

Çdo sektor pune ka pasur të metat dhe të këqijat e tij. E kam theksuar në fjalimin<sup>1</sup> që u mbajta oficerëve, se në ushtri duhet kthyer në materialet dhe në direktivat e Partisë, ato duhet të punohen e të ripunohen

---

1. Këtë fjalim shoku Enver Hoxha e mbajti më 14 tetor 1974 në mbledhjen me kuadrot kryesorë të ushtrisë, lidhur me veprimtarinë armiqësore të B. Ballukut, P. Dumes e H. Çakos. (Shih në këtë vëllim, f. 194.)

thellë me efektivin e ushtrisë, të futen në studimet politiko-teorike dhe ushtarake. Kuadrot duhet të rifreskohen me normat e vërteta të Partisë, që nga heqja e gradave, demokracia proletare dhe deri te politika e kuadrit, me fjalë të tjera me idetë e Letrës së Hapur<sup>1</sup>.

«Treshja» Beqir Balluk-Petrit Dume-Hito Çako bënte politikën e kuadrit. Duhet thëlluar shumë në rrezikshmërinë e kësaj gjendjeje, se mund të na jenë krijuar grupe dhe tarafe në ushtri, kundër ose pro njërit dhe tjetrit, sipas përkrahjes ose denigrimit... Prandaj vetëm një punë e shëndoshë partie mund të spastrojë dhe të vërë në vend çka ishte bastarduar. Larg punës «personale!».

Të mos kemi frikë se rivendosja siç duhet e punës së Partisë në drejtimin e ushtrisë mund të duket «si një burokraci». Jo, kjo është e domosdoshme të bëhet, por jo siç bëhej, si një rutinë e mërzitshme dhe pa vlerë, por luftarake dhe revolucionare. Kjo mënyrë pune duhet t'u hyjë në gjak kuadrove, komunistëve dhe të rinjve në ushtri. Dhe njerëzit në ushtri jo vetëm t'i binden Partisë me vullnet, por t'i japin asaj edhe llogari deri në një dhe të zhduket në të ajo frymë antiparti, që organizata-bazë apo komiteti i Partisë flitnin e vendosnin, por çdo gjë pastaj e merrte era, mbasi përfundimisht vendosnin si të donin «Treshja» Beqir Balluk-Petrit Dume-Hito Çako ose komandanti e komisari i njësisë. Komisari dhe komandanti e tok me ta edhe shtabet duhet të zbatojnë urdhrat dhe direktivat e Par-

---

1. Letra e Hapur e KQ të PPSH drejtuar komunistëve, punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve të vendit tonë, datë 4 mars 1968. (Shih: «PPSH Dokumente Kryesore», vëll. V, f. 23.)

tisë, që nga ato të organizatës-bazë e deri tek ato të Komitetit Qendror. Ata duhet të zbatojnë me përpikëri vendimet e Komandës dhe të Shtabit të Përgjithshëm, të ministrit të Mbrojtjes dhe të Këshillit të Mbrojtjes, duke pasur parasysh që këto vendime duhet të përputhen dhe të jenë në akord të plotë me parimet dhe me normat e Partisë, të vendosura prej saj nga kongreset dhe nga Komiteti i saj Qendror dhe me ligjet e shtetit. Vetëm në këtë mënyrë duhet të ecë përpara ushtria. Tjetër rrugë s'ka, tjetër rrugë nuk lejohet, pse është antiparti.

Rruga e Partisë, e përcaktuar kështu, vë në krye dhe në udhëheqje të ushtrisë Partinë, vlerëson dhe vë drejt kompetencat e format e ndryshme politike, ushtarake, logjistike, arsimore, kulturore etj., vë drejt rolin e kuadrove në drejtim, në komandim, me kompetencat e tyre, me të drejtat dhe me detyrat që kanë. Në këtë rrugë të drejtë partie asnjërit, qoftë ky kuadër, qoftë forum, komandë, nuk mund t'i shkelen të drejtat, kompetencat, nuk mund t'i bëhen padrejtësi e t'i mbyllet goja kur ka të drejtë dhe nuk mund të mos korrigojohet kur gabon e të mos dënohet kur nuk ndreqet.

E gjithë kjo çështje, më duket, duhet të zërthehet në detaje nga Partia nga ana teorike dhe në aplikimin ushtarak dhe këto tema të zërthyera të hyjnë në edukimin politik-ushtarak. Këto gjëra nuk janë kuptuar mirë, prandaj shumë kuadro kanë gabuar. Direktivat e Partisë, nëpër të cilat këto çështje janë theksuar shumë herë, janë studiuar përciptas, atyre nuk u është vënë rëndësi as në teori, as në praktikë, bile në praktikë është vepruar në kundërshtim dhe pranimi teorik ishte formal.

Shokët, kur po punonin raportin që u paraqit këtu, paraprakisht më raportonin përshtypjet e para nga aktivët se:

1. Ka bërë efekt të madh shtruarja hapur e punës armiqësore të zhvilluar në ushtri dhe, gjithashtu, zbulimi i gabimeve dhe i të metave.

2. Oficerët janë shumë të preokupuar për çka u ngjau dhe që nuk e kishin diktuar e denoncuar; ata ishin të preokupuar për të bërë autokritikë të hapët, të singertë dhe të thellë; ishin të preokupuar se si do t'i ndreqnin gabimet, që puna në ushtri këtej e tutje të shkojë mirë. Kjo është shumë pozitive.

3. Të gjitha tezat e fjalimit që mbajta me kuadrot ushtarakë, deri në gjërat më të vogla, nga diskutimet e kuadrove, që pohojnë gabimet e tyre dhe të shokëve, po vërtetohen me fakte.

4. Situata ishte me të vërtetë e rëndë në ushtri, ajo nuk ishte në binarë dhe kryesisht për shkak të punës armiqësore të Beqir Ballukut, të Hito Çakos dhe të Petrit Dumes, por edhe për fajet e gabimet e disa kuadrove të tjerë të lartë të ushtrisë.

5. Hito Çakcja na del me tërë kuptimin e fjalës një bandit revizionist antiparti dhe aktiv që kishte për objektiv shkatërrimin e ushtrisë dhe të mbrojtjes. Ai hapur fliste në trupa: «Pa Parti mund të bëjë ushtria, por pa shtab nuk mund të bëjë». Punën e Partisë ai e kishte neglizhuar sistematikisht; gjoja merrej me çështjet ushtarake, por këtë e bënte në mënyrë të keqe, për të neglizhuar punën politike dhe për të qenë konsekuent me atë që «Ç'na duhet Partia përpara shtabeve». Komisarët në çdo rast i ofendonte përpara trupës, i diskreditonte për të diskredituar funksionin e tyre dhe

Partinë. Asnjë nuk mbeti pa e akuzuar këtë armik për mbrapshti të panumërta, për mashtrime, për karricrizëm, si element intrigant, prepotent, arrogant, deri edhe kusar, mashtrues e matrapaz i mallit ushtarak. Ç'nuk kanë thënë për të?! Po, për fat të keq, këto njerëzit i thonë tani. Megjithatë, më mirë vonë se kurrë!

Këta armiq Partinë në ushtri e kishin vënë nën këmbë. U kishin kallur frikën kuadrove që këta të mos guxonin t'u thoshin asnjë fjalë organeve më të larta të Partisë, gjë kjo shumë e rrezikshme. Kjo vazhdonte prej shumë kohe. Puna armiqësore e të treve zhvillohej në mënyrë sistematike dhe e planëzuar në vija të përgjithshme, në qëllimet kryesore se ku donin të arrinin. Çështja nuk është te forma, por në përmbajtjen e punës ideologjike armiqësore dhe në veprimet e tyre të dëmshme ushtarake të përditshme.

Çdo gjë që bënin ata ishte kundër Partisë. Që të tre luftonin dhe kishin arritur rezultate në dobësimin e Partisë në ushtri, nga parti marksiste-leniniste e proletariatit, donin ta shndërronin këtë në një «parti të tyre» që të heshte, që ajo të ishte formale dhe të dënonte ata dhe ato gjëra që donte «Treshja», që ajo të ushqej me ideologjinë, me politikën, me taktikën dhe me strategjinë e ushtrisë revizioniste sovjetike, të ngrinte kultin e «Treshes» me kualifikime që ata përdornin për të lëvduar njëri-tjetrin. Me fjalë të tjera, ata punonin që të krijohej opinionin se «Ushtria ka një kokë me vlera të mëdha, bile kolegjiale, pse janë këta të tre dhe pas tyre edhe anëtarë të tjerë të Komitetit Qendror në ushtri që u mbajnë ison».

Këta kudo dhe kurdoherë përhapnin idenë se «kanë lidhje me Komitetin Qendror, me Byronë Politike,

me Këshillin e Mbrojtjes», se gjoja për çdo gjë «merrnin aprovimin e tyre», se për çdo gjë «informonin». Pra, çdo gjë që thoshin, çdo gjë që bënin, gjoja e bënin dhe e thoshin në emër të Partisë dhe të udhëheqjes. Ata bënin ligjin në ushtri dhe kishin përgatitur terrenin që Partia dhe ushtria ta zbatonin pa hezitim, pa murmuritje këtë «ligj» antiparti. Vepronin kudo hierarkia «pretoriane» dhe metodat e urryera me të cilat ata donin ta kthenin ushtrinë tonë në një ushtri mercenare, në shërbim jo të popullit, të proletariatit, të socializmit, jo nën drejtimin e Partisë marksiste-leniniste, por nën drejtimin e aventurierëve, të banditëve. Të tre këta, Beqir Balluku, Hito Çakoja dhe Petrit Dumja ishin banditë me të gjitha tiparet.

Të gjitha karakteristikat e tyre më të këqija ata i kishin shndërruar në një frymë të keqe, veçanërisht në kuadrot e lartë të ushtrisë. Këta, por edhe shokët e tyre më inferiorë, tani po i pohojnë dhe po i vënë këto në dukje, duke filluar që nga gënjeshttrat, arroganca, prepotenca, shkëputja nga kuadrot vartës dhe nga ushtria dhe deri te megalomania e theksuar, pritjet me pompë nëpër reparte, drekat dhe darkat, pijet, fshehja e gabimeve, lustrosja e gjendjes, mosdhënia e mirë e mësimëve dhe dënimet për inferiorët. Organizatën e Partisë në ushtri ata e shtypnin, e bënin leckë, e përdornin si «gogol» për të dënuar të vegjlit dhe për të propozuar dekorata për të mëdhenjtë.

Në ushtri qarkullonin parulla të huaja revizioniste si: «Oficeri duhet t'i ketë vithet të forta (se mund të hajë shqelma), duhet ta ketë gjoksin të fortë si të marinarëve dhe të pijë». Dhe kështu bëhej në fakt nga disa prej kuadrove të lartë. Kur shkonin këta nëpër repartet

e ushtrisë, punën e bënin në fare pak orë, kurse pjesën më të madhe të kohës e përdornin pastaj për të ngrënë e për të pirë. Bile paralajmëroheshin repartet se kush do të vinte atje për inspektim nga «të mëdhenjtë» e ushtrisë, informoheshin ato se ç'u pëlqente këtyre të hanin, çfarë mishi, gjahu apo pule, çfarë lloj pijeje, çfarë ëmbëlsirash dhe frutash. Skandaloze! Këto i pohojnë tash me turp shokët në aktive. Skandali arrinte deri atje saqë kontrolli zyrtar, që duhet të mbahej sekret, paralajmërohej 1-2 muaj më parë. Kështu çdo gjë përgatitej posaçërisht sipas huqeve dhe tekave të atyre që do të ishin në krye të inspektimit, çdo gjë në repart spastrohej, bile, ushtarët pohojnë se flinin jashtë tërë javën para inspektimit, në mënyrë që çdo qoshe atje, në kohën që do të bëhej «inspektimi», të ishte e pastër.

Me dhjetëra ishin hiletë e këtilla! Po ç'qëllime kishin këto hile? Të dobësonin ushtrinë, ta demoralizonin dhe ta bënë atë të merrte tiparet e tyre. Ç'mund të bënte një ushtar që i vuante në kurriz këto gjëra? Ç'mund të bënte një oficer i ulët kur shihte se eprorët e tij bënë nga këto gjëra? Kuptohet ku e çonte ushtrinë një punë e tillë armiqësore.

Siç thashë më lart politikën e kuadrit e bënte «Treshja», gjoja në emrin e Partisë. Drejtoritë dhe degët e kuadrit e pohojnë vetë se merrnin urdhra nga «Treshja». Kjo u diktonte jo vetëm gradimin o degradimin, por edhe karakteristikat e çdo kuadri. Del aq se Petrit Dumja synonte të vinte shefa shtabi njerëzit e vet dhe me karakteristika si të tijat. Te Hito Çakoja tendenca, gjithashtu, ishte që komisarët dhe vartësit e vet të ishin njerëz me karakteristikat e tij deri edhe hapur kusarë, armiq, bile që kishin bërë edhe burg. Beqir Balluku

ishte personi që jepte mendime për kuadrot e lartë, të cilët, natyrisht, «i gjykonte sipas dëshirës dhe qëllimeve të tij». Për të gjitha llojet e kuadrove konsultoheshin që të tre, ata i bënë koncesione dhe pazarllëqe njëri-tjetrit, por që të tre synonin të lëshin nga ana e vet njerëzit e tyre, të njohurit e tyre, servilët e tyre dhe me huqet e tyre.

Kjo mënyrë pune kishte qëllimet e saj, që ishin në kundërshtim me qëllimet e Partisë. Këto i bënte «Treshja»! Po përse? Për të komplotuar! Çdonjëri nga këta përgatiste njerëzit e vet për momentin. Po për cilin moment? Është e qartë, për atë moment që do të rrezonin çdo gjë që ishte në frymë partie dhe do ta zëvendësonin atë me çdo gjë antiparti.

Është shumë karakteristik dhe i dyshimtë fakti që Hito Çakoja për një nipin e tij aviator, jo të zotin dhe me plot vese të këqija si veten e tij, ndërsa komanda e aviacionit tri herë me radhë e propozoi për ta transferuar, se nuk bënte, të tri herët ai (Drejtoria Politike) e refuzoi propozimin dhe më në fund Hito Çakoja e caktoi vetë «pilot të parë të avionit të parë qeveritar» (avion që është rezervuar gjoja për mua e në të cilin, për fat të mirë, nuk kam hipur asnjëherë). Komanda e aviacionit e refuzoi këtë propozim, por kjo çështje duhet thelluar, pse me siguri prapa këtyre veprimeve fshihen gjëra të tjera!... Këto gjëra nuk bëheshin pa qëllime.

Hito Çakoja, pra, nga ana e vet emëron aviatorin, Beqir Balluku s'dëgjonte të jepte tanke për Gardën, Petrit Dumja i ka thënë një shoku: «Të arrestoj kur të dua»! Shqip po flitnin këta armiq. Këto janë pjesë përbërëse të komplotit. Këto janë ndodhi reale që lidhen me njëra-tjetrën. Një oficer në diskutimin e tij për-



mendi se «Hito Çakoja një ditë na tha pa koment dhe pa nxjerrë asnjë detyrë për ne: «Nesër do të vdesë Titoja dhe sovjetikët do t'i kemi në kufi». Atëherë, — thotë oficeri, — nuk më bëri ndonjë përshtypje kjo thënie e Hito Çakos, por tash, duke e parë ç'njeri është ai, u jap tjetër kuptim dhe tjetër qëllim këtyre fjalëve».

Oficerët tanë të mirë janë mbushur plot me «dënim» të dhëna nga «Treshja» dhe nga njerëzit e tyre poshtë. Shumë oficerë të mirë, gjithashtu, janë ulur në përgjegjësi për gjëra të vogla dhe në vend të tyre janë ngritur njerëz me huqe të dënueshme dhe me të dhëna të dyshimta në biografite të tyre. Sa pa vlerë dalin karakteristikat që u bëheshin oficerëve nga kjo frymë kaq e sëmure që kishin futur në ushtri këta armiq!!

Oficerët, me urrejtje dhe me revoltim i dënojnë Beqir Ballukun, Hito Çakon, Petrit Dumen dhe të tjerë, propozojnë për ta masa të rënda dhe të drejta dhe shprehen: «Këta njerëz s'kanë ç'i duhen as Partisë, as ushtrisë, ata u bënë këtyre shumë të këqija dhe në të ardhmen nuk pritet asnjë e mirë prej tyre».

Ilo Prifti, bashkëpunëtor i ngushtë i Hito Çakos dhe revizionist si ai, pohoi në aktiv se «Autokritika, që i dërgova Komitetit Qendror, ishte një gënjeshtër që kurdisa; po shoku Enver nuk e hëngri». E pyetën: «Po pse doje të gënjeje?». «Të shpëtoja vetë dhe t'ia hidhja edhe fajet e mia Hito Çakos», pohoi ai me gojën e tij.

Skënder Malindi, shef shtabi i komandës kundërajrore, njeri me biografi të dyshimtë, thoshte lart e poshtë: «Sa të rrojë Petrit Dumja, s'ka ç'më bën asnjëri!».

Kuadro të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe të njërive ushtarake, pa folur këtu për «Treshen» dhe për Sadik Bekteshin, janë kritikuar për ve-

prime dhe sjellje jokomuniste. Nga këta mund të përmenden Muhamet Prodani, Rahman Perllaku, Halim Ramohitoja, për të mos folur pastaj për disa kuadro më të ulët, por që nuk ngarkohen kaq rëndë si këta. Duket qartë tendenca e «Treshes» që është theksuar në raport<sup>1</sup>, «Ta ketë mirë me kuadrot e lartë, t'i frymëzojë këta, të përpiqet t'i korrutojë dhe nëpërmjet tyre të ndikojë te kuadrot poshtë». Është një punë shumë djallëzore kjo e «Treshes»!

Mund të themi se ka disa oficerë madhorë që kanë gabuar, bile edhe rëndë, por këta nuk janë në gradën e këtyre tre armiqve. Këta oficerë të lartë, duke vepruar në këto mënyra, nuk kanë menduar si njerëz partie, i kanë shtrembëruar nocionin e Partisë dhe ligjet e saj, të cilat, duke i deformuar, ua përshtatnin tekave të tyre, në vend që t'u nënshtroheshin, t'i kuptonin drejt dhe t'i zbatonin me përpikëri normat e Partisë. Përbërja e tyre kishte arritur në atë shkallë sa që edhe «të këqijat që bënin, kujtonin se ishin të mira, se ashtu duhej, se ata nuk gabonin, se kishin bërë luftën dhe lufta duhej t'u bindej atyre dhe jo ata ligjeve të luftës së klasave». Ata mendonin se «personaliteti i tyre duhet të ishte gjithçka». Ky «personalitet» nuk duhej të prekej në asnjë mënyrë. Kurse vetë këta të quajtur personalitete kishin një gojë të ndyrë ndaj inferiorëve, sa të vjen turp t'i numërosh gjithë ato sharje që përdornin, ata as që skuqeshin dhe nuk u vinte turp nga vetja e tyre! Edhe oficeri i një ushtrie borgjeze besoj se rezervohet nga të tilla gjëra.

---

1. Raporti i Byrosë Politike të KQ të PPSH i mbajtur në këtë Plenum.

Ç'tregojnë këto vese të këqija të disave? Këto tregojnë pikërisht ato që kemi thënë: prepotencën, foddllëkun, tregojnë atë që këtyre vetja u dukej «mal», kurse të tjerët për ta qenë «miza». Për veten e tyre duhej të kishte nderime, për të tjerët poshtërime. Këto vese janë shqetësime serioze, s'janë tipare të njerëzve të Partisë dhe të popullit, prandaj mos t'i nënvleftësojmë këto shfaqje, pse tregojnë një botëkuptim të tërë. Disa njerëz si këta thonë: «Hë mo se u nxcha, më erdhi inati në hundë, më shkau goja, bëj një autokritikë» dhe me kaq kalohet. Autokritika është e mirë dhe e shëron njeriun, kur gabimi ndreqet, por e keqja është se, kur autokritikën e bën sa për të shkuar radhën dhe nesër vazhdon prapë njëlloj si dhe më parë, ajo s'ka asnjë vlerë. Këta elementë kujtojnë se llogaria kërkohej duke sharë. Jo, ata gabohen shumë, llogaria s'ka asnjë lidhje me ndyrësitat që nxjerrin ata nga goja. Prandaj ata oficerë që kanë të tilla vese të këqija, duhet të shërohen, përfundimisht dhe rrënjësisht.

Të gjitha këto vese që po numëroj dhe që janë dukur në mjaft kuadro, dhe jo vetëm në kuadro të ushtrisë, duhet ta preokupojnë seriozisht Partinë, çdo organizatë-bazë të saj, si dhe organet e pushtetit, në qendër e në bazë. Ka njerëz që gënjejnë pa pikë turpi, që fshehin të metat e tyre dhe të shokëve, që lustrojnë veten, punën e tyre dhe repartin. Natyrisht, këta janë mendjemëdhenj dhe bëjnë çmos atje ku punojnë të krijojnë një situatë të privilegjuar në Parti dhe në shtet. Ata përpiqen (dhe është mentaliteti i tyre i sëmurë që i nxit në këtë drejtim) që të krijojnë në vartësi të tyre po atë gjendje që krijonte «Treshja» në ushtri. Ka njerëz të tillë edhe në pushtet e në Parti që për-

piqen të çajné përpara me supe, pa e merituar, që hiqen se kanë lidhje me udhëheqjen kryesore dhe, për të ngritur «personalitetin» e tyre, përdorin takimet e rastit ose të punës me ndonjë udhëheqës, për t'u imponuar mbi të tjerët. Këta njerëz janë dhe do të bëhen shumë të rrezikshëm, në goftë se Partia nuk i fut në mengenenë e saj dhe t'i shërojë. Këta kanë prirjen që një mëngjes të bëhen «njerëz historikë». Dhe, po t'i lëvizësh nga vendi, mendojnë se priset dynjaja. Por as nuk duhet të mendohet se me lëvizjen e tyre nuk krijohen turbullira dhe mjegull në kokën e disa të tjerëve, të cilët nuk shohin më larg se hunda e tyre...

Kur Partia emëron një kuadër në punë, e cakton atë që edhe ta bëjë punën, edhe me perspektivë. Por ka kuadro që jo vetëm punën nuk e bëjnë si duhet, por as që bëjnë përpjekje të mësojnë dhe të ngrihen në zotësi. Në pozita po, duan të ngrihen dhe në këtë drejtim bëjnë shumë përpjekje. Por, pasi kalojnë vite dhe një kuadër i tillë hiqet, se ka ngelur në vend nga ana e aftësive, ai nuk mungon të thotë: «Unë jam i vjetër, kam punuar, jam i luftës, jam njeri historik». Dhe të gjithë këta «tituj» ai ia vë përpara organizatës ose forumit të Partisë për të fshehur pazotësinë e tij, të metat dhe gabimet e tij. Bile, kur i vjen koha të dalë në pension, kjo nuk i pëlqen dhe as mendon të ngrejë në vendin e vet shokun e tij më të ri. Nderet dhe rrogat më të mira duhet më parë të jenë për të.

Partia na këshillon të punojmë sa të kemi jetën, po kjo nuk do të thotë që t'i qepemi karriges dhe të mos e lëshojmë jo vetëm kur nuk mundim më, por sidomos kur nuk e meritojmë. Kjo çështje është me rëndësi, më duket, dhe duhet ta thellojmë dhe të bëjmë

që të ecë në rrugën e drejtë të Partisë, pse ka lidhje me të tashmen dhe me të ardhmen, me shëndoshjen e Partisë dhe me gjallërimin e saj me gjakun e ri, si të Partisë në përgjithësi, ashtu dhe të udhëheqjes së saj. Kuadrot e Partisë dhe të pushtetit duhet të kuptojnë që të ecin me kohën, me ligjet e Partisë. Të ruhen nga mentalitetet e vjetra, të mos kemi iluzione se këto spastrohen rrënjësisht brenda një ose dy brezave. Nuk i lejohet komunistit të mos i vërejë këto gjëra më parë në veten e tij, pastaj në të tjerët, as t'i nënvleftësojë këto mbeturina në veten e tij dhe, kur vetë nuk është në rregull, tjetrit t'i bëjë moral, siç bën Dashnor Maqaj.

Disa oficerë të lartë nuk i shikonin të metat dhe gabimet e tyre, por ishin të shpejtë në dënimin e inferiorëve, qoftë edhe për fajin më të vogël. Ç'të bëjmë tash me këta oficerë të lartë që kanë bërë faje? T'i dënojmë? Dakord, por mendoni dhe shikoni pak se ç'ngjet për Partinë, kur organizata-bazë dhe kur organet e pushtetit nuk janë vigjilente me njerëzit për t'i ndrequr, për t'i kritikuar, për t'i ulur e për t'i ngritur me kohë në përgjegjësi, ashtu siç e meritojnë.

Por në ushtri, dhe këtë na e tregojnë aktivet e Partisë, shumicën e oficerëve ne i kemi me moral të lartë komunist, patriotë, guximtarë, të ndershëm. Nuk mund të thuhet se kuadrot dhe komunistët në ushtri nuk kanë folur e nuk janë ankuar fare. Këtë veprim të drejtë partie e kanë bërë. Ne kemi edhe letra të tyret drejtuar Komitetit Qendror. Thërritej Hito Çakoja në Komitetin Qendror, i viheshin në dukje këto, ai gjoja i mbante shënim dhe thoshte: «Si urdhëron», «Do të marr masa menjëherë».

Po ç'bëhej me këto kritika të drejta e parimore? Asgjë e mirë, asnjë analizë, asnjë konkluzion, asnjë masë nuk merrej. Përdorej taktika: «Kur për diçka kishte dijëni aparati i Komitetit Qendror nëpërmjet ndonjë letre, Hito Çakoja, si të qëllonte, bënte sikur i pyeste të dy ose të tre ata që kishin gabuar dhe «i këshillonte». Pas ndonjë muaji, ai që e kishte vënë në dijëni Komitetin Qendror transferohej ose i gjendej një arsye dhe ulej në përgjegjësi» etj. Kjo ishte hakmarrja nga këta banditë, të cilët nuk donin që Komiteti Qendror të vihej në dijëni për çka ngjiste në ushtri. Kurse çdo çështjeje tjetër që dilte në shesh në trupa, në organizatat-bazë dhe në shtabe, i jepej zgjidhje sipas qejfit dhe dëshirës së «Treshes». Çdo gjë ose mbyllej, ose veprime në favorin e njerëzve të preferuar të «Treshes». Këtë metodë pune që është zhvilluar të mos e harrojmë, të mos e nënvleftësojmë, pse ka krijuar situata të sëmurë në ushtri, ka krijuar një mentalitet të çuditshëm e të sëmurë në një takëm kuadrosh dhe tash një takëm kuadrosh të tjerë, që kanë vuajtur nga qëndrimet e sëmurë dhe arrogante që po analizoj, mund të kërkojnë të hakmerrin dhe të mos veprohet me gjakftohtësi sipas normave të Partisë.

Pra, problemi më i madh që i shtrohet tash Partisë, Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike, është të forcojë gjithë situatën në ushtri. Çka kemi bërë deri tash duhet konsideruar vetëm fillimi, pse më e madhja, më e koklavitura, është ajo që do të bëjnë paskëtaj. Dhe në këtë fazë, ashtu si edhe në të parat, duhet të tregohet pjekuri, gjakftohtësi, durim i madh, drejtësi partie dhe vendosmëri revolucionare.

Nga të gjitha këto analiza, që u bënë në ushtri,

na bie si detyrë e parë që të nxjerrim detyrat e mëdha dhe urgjente dhe të përcaktojmë masat që duhen marrë. Çështja na vihet pastaj të gjejmë format, mënyrat, stilin dhe metodën që duhet të përdorim për t'i zbatuar këto në jetë. Të mos kujtohet se kjo është një punë e lehtë dhe e mundshme që të kryhet me shpejtësi. Të mos harrojmë se këtë kthesë të madhe duhet ta bëjnë kryesisht Partia në ushtri dhe kuadrot e ushtrisë. Vullneti është i madh që të ndreqen këto punë dhe pikërisht kjo është ajo garanci, tek e cila ne duhet të mbështemi dhe ta shfrytëzojmë mirë për të dalë me sukses në këtë detyrë kaq të madhe. Vullneti, pra, është, por Partia dhe kuadrot e ushtrisë dalin nga një sëmundje e rëndë shumëvjeçare, njerëzit kanë marrë gjatë kësaj kohe disa zakone, disa huqe, disa mentalitete që duhet t'ua zhdukim, se kanë qenë të sëmura. Dhe këto me dekrete e me urdhra nuk zhduken, ato zhduken kryesisht me edukim partie. Edukatën e Partisë, stilin dhe metodën e saj të punës, armiqtë e kishin bastarduar në përgjithësi dhe ishin përpjekur t'u vishnin rrobën e Partisë të këqijave që u përpoqën dhe futën ata në ushtri. Pra, duhet çjerrë kjo maskë e fëlliqur e imponuar nga armiqtë. Këto gjëra, natyrisht, duhet të vihen në vend me një punë këmbëngulëse partie.

Detyra e parë që na vihet, pa hezitim dhe me drejtësi e pjekuri partie, është të spastrojmë radhët e Partisë dhe radhët e kuadrove. Ne duhet të bëjmë bilancin e atyre që kanë gabuar, t'i klasifikojmë ata sipas madhësisë së fajeve e gabimeve që kanë kryer, të hedhim jashtë Partisë dhe ushtrisë të gjithë ata që e meritojnë këtë masë. Kjo duhet të bëhet pa hezitim, këtë e kërkon normat e Partisë dhe të shtetit, këtë e kërkon

nevoja e forcimit të ushtrisë, e mbrojtjes së atdheut dhe të fitoreve socialiste. Të gjithë ata që për aq kohë i kanë bërë të këqija Partisë dhe ushtrisë, pavarësisht se kush janë, janë bërë të pavlefshëm për Partinë dhe për ushtrinë.

Ata që kanë kryer veprimtari armiqësore të japin llogari para gjyqit, të tjerë të dalin në pension edhe me dënim partie, një pjesë tjetër që nuk është për pension të punojë gjelkë, dhe jo t'u ruajmë «nderet dhe timitë», «rangjet» e «gradat» por të vendosen në vende të ulëta, ku edhe të fitojnë bukën, edhe të ndreqen, duke pasur kurdoherë parasysh vetë, por edhe njerëzit që i rrethojnë, se ata kanë bërë gabime në ushtri dhe këto duhet t'i lajnë me sjellje të mira dhe me punë të palodhur. Duhet të ketë edhe kuadro që kanë gabuar, por që janë të ndreqshëm. Këta duhet t'i ulim në përgjegjësi në ushtri dhe t'i edukojmë, t'i bëjmë të njohin gabimet, se ndryshe huqet e tyre rikthehen me revan.

Në të gjitha vendet që do të boshatisen duhet të ngremë njerëz të rinj. Ne kemi shumë njerëz të mirë që fatkeqësisht nuk i njohim, pse karakteristikave që u ka bërë «Treshja» nuk mund t'u zëmë besë. Propozimet për emërimin e tyre t'ia shtrojmë masës së komunistëve dhe të kuadrove të ushtrisë, pastaj të veprimtarëve. Do të jetë një metodë nga më të mirat partie që, pas kësaj situatë të sëmurë, kuadrot të shoshiten dhe të kenë miratimin e gjithë ushtrisë.

Një veprimtari e tillë për spastrimin e radhëve, për vendosjen e kuadrove të besuar të Partisë dhe që i do ushtria, është absolutisht e domosdoshme të bëhet, se me këta do të punohet për të kryer detyrat e mëdha që i vihen përpara Partisë në ushtri. Ky veprim do të



ngjallë besimin, pa të cilin nuk mund të ecet përpara. Këta do të venë në rrugë të drejtë partie, pra duhet të jenë të atillë të papërlyer, që të mundin pa druajtje t'u flasin hapur shokëve, të cilët duhet t'i dëgjojnë dhe t'i respektojnë me një respekt partie dhe jo hierarchie të bastarduar, siç kishte vendosur «Treshja» armiqësore.

Kjo punë e parë duhet të bëhet me një cilësi të lartë partie, në bashkëpunim të ngushtë midis sektoreve të kuadrit të Komitetit Qendror, të ushtrisë dhe të terrenit. Të gjithë t'i frymëzojë qederi i madh, të largohen nga prirjet individuale dhe sentimentale, të bazohen në parimet. «Siguria politike në radhë të parë, pastaj zotësia» dhe, sa të jetë e mundur, të mos bëhen lëvizje të shumta, që shkaktojnë shqetësime të mëdha shpirtërore dhe familjare.

Kjo gjë duhet të kryhet, siç thashë, me cilësi të lartë, po edhe në një kohë të shkurtër. Lypset të kryhet me cilësi, pse nuk duhet të krijojmë pasiguri në kuadrot që do të ngremë ose që do të ulim. Duhet, gjithashtu, që kjo punë të kryhet në një kohë të shkurtër, se këta kuadro do të marrin punën në dorë dhe do të prijnë tok me shokët e tjerë ushtrinë në të gjitha drejtimet. Është detyrë urgjente që kjo situatë që po krijohet në ushtri të çohet përpara për të spastruar të këqijat dhe për të ngritur në këmbë traditat e mira të saj.

Çdo gjë në ushtri duhet të rishikohet me kujdesin më të madh, të spastrohen të këqijat dhe të vendosen të mirat. Asnjë vakuum nuk duhet të lëmë të krijohet. Shumë spastrime do të bëhen në çështjet ideologjike, politike, ushtarake, do të rishikohen rregulloret, skemat, ligjet, urdhëresat, do të spastrohen tekstet e shumë çështje të tjera; do të rishikohen stërvitja ushta-

rake, edukimi politiko-ideologjik, do të vihen në jetë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe një numër i madh çështjesh të tjera. Dhe të gjitha këto do të bëhen duke zbatuar me rreptësi programet e caktuara, duke ruajtur dhe duke forcuar më tej gatishmërinë ushtarake. I tërë ky hov revolucionar duhet ta krijojë këtë situatë. E gjithë kjo punë i jep fund fazës së parë të shtrimit të punës armiqësore, të revoltimit, të hutimit dhe krijon premisa të shëndosha për një punë të hovshme revolucionare ndërtimore, konstruktive. Këtë frymëzim në ushtri duhet ta krijojë Partia, duke vendosur në të normat e saj, duke ua bërë këtë çështje të kuptueshme njerëzve, si në teori, edhe në praktikë.

Të gjitha veprimet që përmenda më lart duhet të kryhen në mënyrë kolegjiale, me komisione specialishtësh, me partishmëri dhe çdo gjë të vendoset rregullisht në rrugë partie dhe shtetërore. Asgjë të mos lejohet të kalohet në forma individuale, siç bëhej më parë. Vetëm në këtë mënyrë mund t'u dilet mbanë, mirë dhe shpejt të gjitha këtyre problemeve të mprehta që kanë dalë dhe që kërkojnë zgjidhje në ushtri.

**Puna armiqësore antiparti dhe antishtetërore o Beqir Ballukut, e Hito Çakos dhe e Petrit Dumes karakterizohet nga të dhënat e faktuara si një komplot i studiuar në detaje dhe i vënë në zbatim hap pas hapi. Kur flitet për komplot njeriu kupton një përgatitje që bëhet në mënyrë të fshehtë dhe një ditë në mënyrë të papritur pëlqet, pavarësisht nëse fiton apo dështon. Edhe ky komplot i organizuar nga këta tre armiq ka pasur qëllimet e tij të fshehta, si dhe veprimet e tij të hapëta dhe të maskuara për përgatitjen e terrenit për kryerjen me sukses të krimit.**

Qëllimi i fshehtë i të tre armiqve ishte të bënin një puç fashist ushtarak, të merrnin fuqinë dhe të vendosnin në vendin tonë kapitalizmin. Ky, sipas konkluzioneve që mund të nxjerrim nga të dhënat (pa marrë parasysh çka do të thonë, çka do të pohojnë ose nuk do të pohojnë vetë të tre këta armiq dhe të tjerë shokë të tyre), mund të arrihej duke goditur Komitetin Qendror, duke arrestuar udhëheqjen, duke zënë në befasi pozitat kyç, me një fjalë do të arrihej siç veprojnë gjithë puçistët kolonëlë fashistë në vendet kapitalisto-revizioniste. Këtë mund ta bënin vetëm, ashtu sikurse mund ta bënin edhe në bashkëpunim me një ndërhyrje ushtarake të revizionistëve sovjetikë. Kjo rrugë e dytë është më e mundshme, pse orientimi i tyre, siç del, ishte nga Bashkimi Sovjetik revizionist. Por fashistët janë fashistë, mund të anonin edhe nga NATO-ja, mund të bëheshin solidarë edhe me titistët jugosllavë. Për këto dy drejtime të fundit tani për tani nuk ka të dhëna konkrete. Por kjo nuk do të thotë se më vonë nuk mund të dalin lidhjet sekrete agjenturore që mund të kishin Beqir Balluku, Hito Çakoja dhe Petrit Dumja me titistët jugosllavë që shumë kohë përpara. Sidoqoftë orientimi i tyre më i dukshëm ishte drejt Bashkimit Sovjetik.

Këta armiq vepronin duke u mbështetur në funksionet e larta që kishin në Parti, në shtet dhe në ushtri. Pozitat e tyre ishin «të palëkundshme» ndonjëherë nga ndonjë kritikë e rëndë, me përjashtim të Hito Çakos që është kritikuar rreptë në lidhje me çështjen e Tuk Jakovës. Kështu që nga kjo anë këta elementë e hiqnin veten dhe tregoheshin «udhëheqës të sprovuar», sidomos «udhëheqës të mëdhenj ushtarakë», dhe me një

sërë metodash, që do t'i numëroj më vonë, në ushtri ishin të imponuar dhe «statuja të vendosura», tek të cilët «ushtria duhej të shikonte dhe t'i rrënjosej në mendje se, pa këta, ajo nuk mund të ekzistonte». Si anëtarë të Partisë këta kishin, gjithashtu, «të kaluarën, vjetërsinë e luftës», që disa nuk kishin munguar t'ua lustronin, t'i ngrinin lart, duke u mbushur vrimat dhe duke u fshirë hijet që kishte e kaluara e tyre. Këta njerëz ishin në Komitetin Qendror dhe deri në Byronë Politike. Kështu që kjo anë kryesore «personalitetin» e tyre e ngrinte në një pedestal të veçantë, për të fshehur pazotësinë e tyre dhe të gjitha aktet e tyre ilegale.

Në ushtri kishte edhe anëtarë të tjerë të Komitetit Qendror me të tilla vese... që kishin krijuar mendimin dhe bindjen (dhe kjo për qëllimin e tyre djallëzor) se ishin «koka e ushtrisë», se ata ishin «komiteti qendror» që udhëheq ushtrinë.

Pra, ata, me metodat e punës që zhvillonin, kishin ushqyer mendimin dhe kishin krijuar bindjen se ishin një «komitet qendror» i veçantë brenda Komitetit Qendror të Partisë dhe në fakt këtë jepnin të kuptonin, se ata thoshin sikur ato gjëra që bënin i kishin biseduar me udhëheqjen e Partisë.

Kjo është një taktikë e koordinuar për të dhënë përshtypjen e gënjeshtërt dhe provokuese sikur grupi kishte mbështetjen e njërit a tjetrit sëç e veç në Komitetin Qendror. Të tre afishonin për qëllimet e veta se me kë kanë lidhje të veçanta, domethënë, gjoja i kanë krahët të ngrohtë... Ç'metoda të poshtra armiqësore, antiparti, trockiste, revizioniste, hrushoviane! Këta tre revizionistë shqiptarë i kishin studiuar mirë taktikat

antiparti të Hrushovit, të Mikojanit dhe të Zhukovit, kur bënë puçin.

Këto veprime të tyre ne mund t'i konsiderojmë si nga më kryesoret të komplotit, pse me anën e tyre do të krijohesh «kohezioni» në mes pjesëtarëve të «Treshes», do të krijohesh «uniteti» në mendime dhe në veprime i «komitetit qendror» brenda në Komitetin Qendror të Partisë, por në udhëheqje të ushtrisë, do të krijohesh fraksioni antiparti në krye të ushtrisë për të rrëzuar Partinë dhe pushtetin popullor.

Tash duhen studiuar mirë veprimet e tyre komplotuese, taktikat dhe ideologjia që i udhëhiqnin ato.

1. Ushtria ishte pjella e popullit trim kryengritës, ishte ushtri e Partisë, e krijuar, e brumosur dhe e edukuar me idealet e saj si arma e revolucionit, si arma e diktaturës së proletariatit. Këtë karakter dhe këto qëllime të larta këta tradhtarë punuan që t'ia ndryshonin ushtrisë sonë dhe ta shndërronin këtë në një ushtri fashiste, siç ishin fashistë vetë Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja.

2. Populli, Partia dhe Komiteti i saj Qendror kishin besim të plotë te besnikëria e ushtrisë dhe e kuadrove të saj, pse për këtë ushtri dhe për këta kuadro kishin vënë kujdesin më të madh dhe kishin bërë sakrificat më të shumta, që ajo të ishte e gatshme dhe e denjë për misionin e saj të lartë.

Këta tre trockistë u mbështetën në këtë gjë, që të ekuivaltonin vëset e këqija të njerëzve, duke dhënë shembullin vetë, duke i maskuar këto me slogane si: «Ne kemi të drejta të ligjshme e të natyrshme», «Ne ushtarakët jemi njerëz specialë, se kemi bërë luftën, por do të bëjmë edhe luftën tjetër», «Se ne si të tillë duhet

të kemi grada, ofiqe, privilegje», «Ne si ushtri duhet të jemi një shtet në shtet, me fabrika, me kombinatë, me toka, me kinema e deri me teatro të veçantë për ushtrinë», pa folur këtu për shtëpitë e kulturës, klubet e hotelet e veçanta për ushtarakët. Këto u dukeshin si normale, si gjëra që nuk dilnin jashtë ndonjë norme partie.

3. «Treshja» trockiste çdo veprim antiparti e mas-konte me parullat e Partisë. Këto i gjeje kudo, në kazerma, në klube, në klasa të mësimi, kurse në praktikë veprohej ndryshe.

E gjithë propaganda e fryrë, pompoze, megalomane, mbështillte normat, udhëzimet dhe ligjet e drejta të Partisë me një cipë të rreme e të trashë, aq sa këto zvogëloheshin, bëheshin të padukshme, të paqena, formale. Kjo ishte një punë djallëzore dhe një karakteristikë e ushtrisë sovjetike, që u bë një nga mjetet më efikase mashtruese të këtyre elementëve. Njerëzit joushtarakë që venin në ushtri hapnin sytë nga «lulkat», nga çdo gjë «e kuqe revolucionare», por ky ishte një iluzion për të fshehur realitetin dhe për të ekzaltuar lë sipërfaqshmen që fshihte boshllëkun, për të nxitur ndjenjën e rreme të forcës e të zotësisë së tyre. Këta armiq përpiqeshin të krijonin përshtypjen se «Ne, ushtria, jemi diçka kolosale, kemi armët në dorë, armiku vetëm neve na e ka frikën, pra ne jemi Partia, ne jemi shteti, ne jemi revolucioni, këta jemi ne dhe s'ka njeri tjetër, të gjithë rrojnë dhe marrin frymë në sajën tonë». E tërë kjo punë me tendenca armiqësore bëhej nën maskën gjoja të një pune partie, por për këtë do të flas më poshtë.

Cilat ishin rezultatet e kësaj pune armiqësore?

Disa kuadrove të lartë të ushtrisë iu rrit mendja dhe hunda u vajti në tavan. Sulm mbi gradat, mbi pozitë, mbi ofiqet, mbi privilegjet! Sulm mbi ushtarët dhe mbi inferiorët, lësho dënime, me faj dhe pa faj, sulm mbi automobilat, saqë dhe markat duhej t'u korrespondonin gradave. Sulm mbi shtëpitë e ushtrisë, të cilat u kthyen në dyqane për të furnizuar të privilegjuarit. Puna e Partisë ishte e paefektshme, përpara komplotit që kurdisesh i maskuar me slogane partie.

Pra, me një numër kuadrosh të Ushtrisë Popullore, duke shkelur mësime, normat dhe ligjet e Partisë e të shtetit, duke mashtruar dhe në mënyrë komplotiste Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja krijuan grupime kuadrosh me tipare «kastash» ushtarake, me huqe dhe teka antiparti, kasta në dukje pa ndarje, por të ndarë sipas prirjeve të shfave Beqir Balluk, Petrit Dume, Hito Çako, Sadik Bektesh e të tjerë, të cilët luftonin dhe bënë pazarllëqe të poshtra kush e kush të shtonte radhët e përkrahësve, të të bindurve e servilëve të tij. Qëllimi ishte i përbashkët për komplot, por më vonë, në rast se ky komplot fitonte, duheshin ndarë postet në mes ujëve. Luftohej kështu për komplot, por edhe për fuqi, luftohej kush të kishte autoritet dhe forcë më të madhe. Kështu mendonin dhe për këtë gjë punonin këta fashistë, pavarësisht se do t'u ecte apo jo. Por ata punonin dhe organizonin gjithë këtë veprimtari armiqësore, që t'ia arrinin qëllimit.

Nuk mund të thuhet se Komiteti Qendror nuk i ka parë deri në njëfarë shkalle këto tendenca të rrezikshme që shfaqeshin në ushtri dhe në disa kuadro. Beqir Ballukun dhe Petrit Dumen ai i kishte kritikuar rëndë disa herë. Duhet të mos harrojmë se «Treshja» dhe «ko-

miteti qendror» në ushtri kishin arritur të krijonin njëfarë «kordoni sanitar» rreth Komitetit Qendror të Partisë për t'i fshehur këtij anët e rrezikshme të punës së tyre armiqësore që zhvillonin në ushtri.

Megjithëkëtë Komiteti Qendror në mbledhje të veçanta:

a) Mori vendime shumë të rëndësishme partie dhe shtetërore për demokratizimin e ushtrisë, për krijimin e komiteteve të Partisë, për heqjen e gradave, për zhdukjen e komandës unike, për rishikimin e rregulloreve, ngriti zërin kundër pompozitetit, megalomanisë, prepotencës, gënjeshtërisë etj.

b) Komiteti Qendror, gjithashtu, i bëri thirrje Partisë në ushtri dhe tregoi mënyrën për të rishikuar programet politiko-ushtarake dhe në radhë të parë paralajmëronte Partinë dhe kuadrot në ushtri që të luftonin me forcë të madhe kundër revizionizmit modern dhe veçanërisht kundër atij hrushovian sovjetik, të luftonin mbeturinat e ndikimit të tyre, si kuadro, në dhënien e mësimëve, në format e në çdo gjë, të spastrohej çdo qoshe.

Këto ishin direktiva me rëndësi historike për Ushtrinë tonë Popullore. Kjo ishte goditje për komplotistët, por këta as e humbën shpresën dhe as i hodhën armët. Ata ishin kundër të gjitha këtyre vendimeve shpëtimtare që e gjithë ushtria dhe shumica dërrmuese e kuadrove të ulët e të mesëm, por kishte edhe të lartë, i pritën me entuziazëm. Komplotistët, por jo të gjithë, i mblodhën këmbët. Bënë sikur i pranuan, disa të tjerë si Petrit Dumja e Hito Çakoja thanë se në fillim «nuk i pranuan me bindje, por pastaj u bindëm se ishin të drejta». Këto qëndrime ishin me dy faqe, ishin gënje-



shtra, se në fakt ata ishin kundër vendimeve të Komitetit Qendror dhe do të punonin që të mos i zbatonin, përkundrazi, t'i sabotonin, siç i sabotuan.

Të gjitha vendimet e Partisë, të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, jo vetëm ato që i përkitnin ushtrisë, por edhe sektorit civil, venin në ushtri. Çdo material me përmbajtje politike dhe ideologjike që shtypej, duke filluar që nga veprat e klasikëve dhe deri te shkrimet e fjalimet e shokëve, shkonin edhe në ushtri dhe jo për të zbukuruar raftet e bibliotekave, por për të edukuar ushtarët dhe kuadrot.

Iu kërkua «Treshes» të formuloheshin Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, që do të ishin në bazë të edukimit të gjithanshëm të ushtrisë. Ata nuk i bënë dot këto edhe se ishin të pazotë, por edhe për arsyen se ato që do të bënin, do të zbulonin pikëpamjet revizioniste të tyre. Megjithatë Tezat u përgatitën<sup>1</sup>, i dërguam në ushtri dhe udhëzuam si të punoheshin, si të zbërtheheshin, si duhej mbështetur vetëm në to, se ato ishin eksperiencia e Partisë, e luftës dhe e ushtrisë sonë. E kështu me radhë veprohej për të gjitha materialet që dërgonim në ushtri.

Këtu në ushtri fillonte sabotimi i tmerrshëm. Çdo gjë që vente, ose s'punohej, ose punohej fare përceptas. «Treshja» dhe «komiteti qendror» i ushtrisë, që duhej të udhëhiqte zbërthimin, mënyrën e punimit teoriko-politik, që duhej t'i përgatiste dhe t'i fuste në format e edukimit dhe nga këto të formohej materiali i edukimit dhe të udhëhiqej stërvitja, asnjë gjë nuk bënte,

---

1. Ato u hartuan në bazë të platformës që përpunoi vetë shoku Enver Hoxha dhe që u shtrua në Këshillin e Mbrojtjes.

për arsye, që tani duket qartë, se ata ishin edhe të pazotë, po ata ishin edhe komplotistë. Poshtë, në kuadrot nën ta, ishte përhapur po kjo frymë. Kjo «Treshe» dhe ky «komitet qendror» kishin krijuar ca kalem-xhinj që bënin disa «simite» pa kripë, pa fund, pa taban dhe këto i lexonin si «ekstra». Këto natyrisht kontrolloheshin nga «lart» për të fshirë çka nuk duhej të figuronte ose në ç'masë duhej të figuronte (pse kishte edhe nga ata kuadro që donin të punonin dhe të nxirrnin nga dora diçka të saktë dhe të pastër).

Materialet me vlerë të Partisë dhe të klasikëve dhe Tezat e Këshillit të Mbrojtjes ishin mbyllur në biblioteka ose në kasaforta, ato përdoreshin gjoja për materiale plotësuese të «simiteve» ose për lexime, për «kuriozitate». Dhe kjo mënyrë e përdorimit të materialeve të Partisë ishte për kuadrot e ulët, se për kuadrot e lartë s'kishin shumë vlerë, ata «i dinin», «ata kishin bërë luftën», «ata kishin mbaruar akademitë në Bashkimin Sovjetik». Edhe ata që kishin mbaruar akademinë tonë mësonin në fakt teorinë dhe pikëpamjet e huaja revizioniste që i kishin futur në programe dhe i jepnin oficerë të bindur në ideologji me Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon, si Vaskë Gjinoja e të tjerë. Kështu që Partia për të tillë njerëz ishte diçka e pagënë, formale, që ata me fjalë thoshin se «e donin», që hiqeshin se e donin dhe e dëgjonin, por në fakt as e donin, as e dëgjonin.

«Treshja» tradhtare kishte vendosur një metodë dhe një stil punc të vetin, ajo kishte krijuar një mentalitet dhe qëndrime ndaj Partisë dhe teorisë marksiste-leniniste, kishte vendosur një formë edukimi politik-ideologjik jo me tiparet e Partisë, por me tiparet

revizioniste. Ajo kishte ndërtuar një metodë stërvitjeje ushtarake, kërkesë llogaric, forma kontrolli dhe inspektimi, forma shkollore dhe kurse që të gjitha çalonin në mënyrë të theksuar dhe kontribuonin jo për forcimin, por për shthurjen e dobësimin e ushtrisë nga ana morale, politike dhe ideologjike, si dhe për dobësimin e saj nga ana ushtarake.

Kjo «Treshë» tradhtare, nën maskën e Partisë dhe gjoja e orientuar nga materialet e saj, kishte futur në teori dhe në praktikë teoritë dhe praktikën e partisë revizioniste sovjetike dhe të ushtrisë fashiste sovjetike. Në sipërfaqe këto shaheshin, kurse në realitet njerëzit punonin dhe edukoheshin me materialet e huaja revizioniste, ku krejt të pandryshuara fare, ku ndërruar vetëm titujt dhe apelacionet specifike. «Treshja» dhe këta kuadro të lartë që i ndiqnin, digjeshin për këto materiale, ishin dashuruar me kujtimet e mareshalëve. Kjo ishte një nga format e hapëta të komplotit të rrezikshëm që kurdisnin.

Për këtë mënyrë jetese, kush me dashje e kush pa dashje, kush në heshtje, kush me frikë në zemër, nuk e ngrinte zërin. Kjo mund të duket e çuditshme. Si mund të ngjasë një gjë e tillë në ushtrinë tonë, në organizatat e Partisë të ushtrisë sonë, në kuadrot e ushtrisë sonë të dalë nga lufta dhe të zgjedhur? Si të na ngjasë kjo në ushtrinë tonë, që rron në gjirin e një populli revolucionar, të një Partie kaq revolucionare marksiste-leniniste, siç është Partia jonë? Kjo duhet absolutisht shpjeguar.

Kjo ndodhi se Partia në ushtri ishte dobësuar shumë, ajo kishte humbur vigjilencën dhe e gjithë metoda dhe stili i punës që «Treshja» dhe «komiteti qendror» i ushtrisë kishin vendosur dhe po zbatonin në ushtri ki-

shin këtë qëllim kryesor: Partinë në ushtri ta shtypnin, ta izolonin nga gjithë pjesa tjetër e Partisë, t'i jepnin asaj, si në brendi, por edhe në forma, tipare revizioniste, të ndërronin botëkuptimin e saj marksist-leninist, ta shndërronin në një «parti të tyre», «speciale» për të zbatuar qëllimet që i kishin caktuar vetes, ta bënin një parti të bindur tek ata dhe të hierarkia ushtarake, ta bënin një parti që të braktiste normat dhe ligjet e saj marksiste-leniniste dhe të pranonte revizionizmin e Hito Çakos, banditizmin e Beqir Ballukut dhe bonapartizmin e Petrit Dumes.

1. Në këtë llum luftonin për ta futur Partinë në ushtri këta komplotistë. Duhet të njohim se puna e tyre ka qenë sistematike, e vazhdueshme dhe në Komiteti Qendror i Partisë, s'kemi qenë shumë vigjilentë. Po kjo mungesë vigjilence nga ne mund t'i kishte kushtuar shtrenjtë Partisë dhe socializmit në vendin tonë.

2. Ne u besuam jashtë masës «Treshes» dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Qendror që punonin në ushtri. Lidhjet në përgjithësi mbaheshin me kuadrot e lartë, sido që flasim ngaherë se duhet të kemi kontakte me masën dhe me kuadrot e ulët. Kjo gjë bëhet në terren, po nuk bëhej në ushtri. Dëgjohej ç'thoshin kryesorët dhe nuk na vinte zëri i bazës. Në këtë mënyrë u lejua dhe u ndihmua «Treshja» ta izolonte ushtrinë dhe kuadrot e saj nga ne, anëtarët e Komitetit Qendror dhe nga e gjithë Partia.

3. Ekzagjeruam jashtë masës karakterin sekret të ushtrisë, sa që «Treshja» përfitoi nga kjo për t'i shpëtuar kontrollit.

4. Jemi kënaqur me raportimet e tyre bombastike, të lustruara, jemi mjaftuar me njoftime të përgjithshme

dhe «Treshja» edhe nga kjo ka përfituar dhe na ka gënjyer, ka mashtruar.

5. Të gjithë ne kemi pasur një dobësi të veçantë për ushtrinë, e kemi dashur shumë dhe kemi pasur besim në të. Kjo është një gjë e mirë dhe kështu duhet, por harruam atë që themi: «Beso dhe kontrollo». Besuam, por nuk kontrolluam dhe nga kjo mungesë jona përfitoi armiku.

6. Ne kemi pasë vendosur një vartësi të drejtë të Partisë në ushtri me Komitetin Qendror, por ajo dha fryte jo të mira dhe ne nuk e pamë më parë këtë defekt. Armiku gjithashtu edhe nga kjo përfitoi. Drejtoria Politike e Ushtrisë ishte konsideruar si një drejtori e Komitetit Qendror, por në realitet Sadik Bekteshi dhe Hito Çakoja e izoluan nga Komiteti Qendror dhe u krijua kështu ai tjetër «komitet qendror», për të cilin fola më lart.

Gjithë fati i organizatës së Partisë në ushtri, i edukimit të saj me ideologjinë marksiste-leniniste dhe i veprimeve të saj, gjoja na raportohej, merrnim vesh për të nga goja e Sadik Bekteshit dhe e Hito Çakos. Mirëpo këta të dy na dolën revizionistë, komplotistë. E shikoni sa e rrezikshme u bë çështja? Dhe çështja vihet: «Beso dhe kontrollo», por kontrollo me forma të gjera, të shumanshme, partie dhe ushtrie, me kontrole shtetërore të dyfishta e të trefishta dhe kurrë nëpërmjet një ose dy personave, sado kompetentë që të jenë këta.

Është fakt, dhe kjo vërtetohet katërcipërisht, se njerëzit e «Treshes» kanë qenë tipikë gënjeshtarë. Ata të tre gënjenin Komitetin Qendror, ata flitnin ndryshe dhe vepronin ndryshe, na thoshin «lepe e peqe», por, sa dilyn nga dera, të gjitha i hidhnin poshtë dhe asgjë prej tyre nuk çonin as në Parti, as në ushtri, as në ko-

mandë dhe as në shtabe. Kështu, normat, direktivat, udhëzimet dhe vendimet e kongreseve, të plenumeve të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Byrosë Politike të tij kalonin shumë përciptas, shumë herë shtrembëro-heshin, deformoheshin.

Petrit Dumja, Beqir Balluku dhe Hito Çakoja kritikoheshin nga shokët e Byrosë Politike, u bëheshin nga ne edhe paralajmërime të rrepta. Ata gjoja bënë auto-kritikë si «të tronditur», gjoja bënë premtime se nuk do t'i përsëritnin më gabimet, por çdo gjë nga ana e tyre ishte bluf. Që të tre ishin më bataqinjtë që mund të ketë njohur Partia dhe udhëheqja e saj, më hipokritët, më intrigantët antiparti. Ata nuk i çonin Partisë në ushtri nga ato çka thuhej dhe ç'vendosej në organet e larta të saj, jo vetëm për ushtrinë, por as edhe nga ato për sektorët e tjerë, për të cilat ushtria duhej të ishte në dijeni.

Si drejtor politik i ushtrisë Hito Çakoja lejohej të merrte pjesë në çdo mbledhje të Sekretariatit të Komitetit Qendror, të sillte aty eksperiencën e ushtrisë dhe të merrte eksperiencën e Partisë për në ushtri, por ai s'e hapi asnjëherë gojën në Sekretariat dhe asgjë nga mësimet e Partisë nuk çoi në organizatën e Partisë në ushtri dhe as në Drejtorinë Politike. Vetëm se Hito Çakoja çonte diçka tjetër te kuadrot e ushtrisë që e kundërshtonin për ndonjë gjë. Ai u thoshte: «Dëgjjo, mor djalë, zëri i Hito Çakos dëgjohet si top në Komitetin Qendror, kurse yti s'dëgjohet fare». Në çdo moment këta armiq Partinë e poshtëronin. Kështu bënë që të tre këta banditë. Ata kishin siguruar monopolin për të shpënë në ushtri çfarë donin vetë dhe asgjë nuk i thoshin organizatës së Partisë në ushtri kur kritikoheshin. Ata jo vetëm që nuk thoshin asgjë, por tregoheshin e hiqeshin

se ishin «shtyllat» e Komitetit Qendror, ishin «artileria e rëndë e Partisë».

1. Kjo «artileri e rëndë» për fat të keq e kishte vënë në shënjestër organizatën e Partisë në ushtri. Komiteve të Partisë atje u kishte rënë autoriteti, u qe dobësuar drejtimi, çdo gjë ua diktonte, ua impononte «Treshja» dhe aparati i tyre burokratik... E tillë ishte mënyra e diktimit të punës dhe e frymës trockiste që përhapnin këta armiq në ushtri. Çdo vendim, çdo propozim i mirë, por që cenonte caqet e caktuara nga klika, mbytej në vezë. Çdo kritikë e drejtë që bëhej kundër të metave dhe kuadrove, kur cenonte caqet e caktuara nga klika dhe godiste njerëzit e klikës, jo vetëm që shtypej, por u ktheheshin dhe godisnin pa mëshirë ata që i bënin këto kritika.

Në ushtri ideologjia marksiste-leniniste e Partisë po zëvendësohej me ideologjinë e huaj revizioniste. Materialet politike dhe teorike ushtarake të Partisë sonë vetëm sa thuhej që venin në ushtri, pse kjo nuk ushqej me to, as në teori, as në praktikë. Kuadrove dhe komunistëve u kishin futur frikën, ata venin në organizatë, por nuk e ndienin veten si në shtëpinë e tyre, pse klika kishte zhdukur sistematikisht frymën e demokracisë proletare... Këta kriminelë kishin mbytur frymën marksiste-leniniste të Partisë, kishin shtypur personalitetin e komunistëve dhe të kuadrove, kishin dobësuar me një fjalë forcën e madhe të ushtrisë. Në mes krimeve të tjera, ky është krimi më i madh që kanë bërë këta banditë. Pra, del qartë se synimi i tyre kryesor ishte Partia dhe Partinë në ushtri ata e goditën rëndë, pse, pa e goditur atë, nuk mund të kishte sukses puçi i tyre.

Asgjë nuk mund t'i ngjasë vendit tonë socialist, në rast se Partia është në këmbë, e fortë si çeliku, vigjilente dhe sypatrembur. Asgjë nuk mund t'i ngjasë vendit tonë socialist, në rast se Partia jonë qëndron siç është, «reparti pararojë i organizuar i klasës punëtore». Përkundrazi, ky repart, i udhëhequr nga marksizëm-leninizmi, me frymën e klasës dhe në krye të luftës së klasave, do të kalitë vazhdimisht unitetin dhe do të godasë pa mëshirë armiqtë e Partisë, armiqtë e klasës proletare. Ndryshe, atdheu ynë vihet në rrezik. Trimëria individuale është veti e njerëzve të guximshëm që, kur vihet me konsekuencë në mbrojtje të interesave të përgjithshëm, kthehet në një virtyt të lartë të personi, që fiton për këtë dashurinë dhe respektin e masave. Te ne shumëfishohet forca e trimërisë individuale, kur njeriu mendon dhe vepron me vendosmëri në bazë të mësimëve të Partisë, ndërsa jashtë frymës heroike të saj ajo vyshket dhe venitet. Dhe shembullin për këtë na e japin shokët tanë oficerë, që në luftë janë treguar trima të vendosur, por, tash, ka prej tyre që kur pyeten: «Ku ishit? Pse nuk u revoltuat?», ata thonë: «Kishim frikë!». Dhe nga kush kanë pasur frikë? Nga disa persona.

Këta shokë «të mirë» harruan ç'është Partia, ç'forcë e madhe është Partia dhe ç'përfaqëson Partia. Këta shokë «të mirë» harruan ç'luftë të gjatë kishte bërë Partia kundër një vargu tradhtarësh dhe ata që nuk patën frikë nga gjermani e italian, patën frikë nga një Beqir Balluk, nga një Petrit Dume e një Hito Çako.

Por ata mund të thonë me naivitete: «Nuk ishim të sigurt se këta ishin njerëz të tillë». Studio materialet e Partisë dhe pastaj i gjyko veprimet e tyre dhe do të



shikosh të ç'natyre ishin ata që po ju bënin kaq të këqija. Këta shokë «të mirë», por naivë, mund të thonë se «nuk mendonim që ishin tradhtarë»... Por a nuk u shkonte pak ndër mend këtyre shokëve se ç'ishin këta njerëz që bënin të tilla poshtërsi?!

Nuk duhet menduar për asnjë çast se këta armiq të gjitha këto gjëra i bënë rastësisht, se i bënë «nga padija», apo se ishin megalomanë, se donin vetëm të dukeshin e të tjera gjëra të tilla. Jo, këta kishin një plan të gjerë, që po e vinin këmba-këmbës në zbatim. Po të krahasojmë punën armiqësore të grupeve antiparti që janë zbuluar në Partinë tonë që nga Anastas Lula e deri te Fadil Paçrami me Todi Lubonjën, gjerësia dhe rrezikshmëria e veprimtarisë tradhtare të këtyre tre komplotistëve, Beqir Ballukut, Petrit Dumes dhe Hito Çakos, mund të themi se është po aq e madhe, në mos më shumë se ajo e grupit tradhtar antiparti dhe anti-shqiptar të Koçi Xoxes.

2. Vendimet e Partisë për vendosjen në ushtri të komiteteve të Partisë dhe të të gjitha masave të tjera që dimë, nga këta komplotistë nuk u pranuan, ato u luftuan, u sabotuan. Forma e re gjoja u vu, kurse u ruajt dhe u forcua përmbajtja e vjetër. Kjo donte të thoshte: «Partia të mos jetë në drejtim dhe në udhëheqje, po në bisht», gjë që nuk është e rastit, po pjesë përbërëse e komplotit të organizuar me ndërgjegje.

3. Të bëhet organizata e Partisë në ushtri një organizatë amorfe, të degjenerojë, të edukohet jo me frymë partie, të bëhet e frikshme etj., nuk është diçka e rastit, por, siç e thashë më lart, është rezultati i një veprimtarie të përgatitur me ndërgjegje, është përgatitja kryesore për realizimin e komplotit të tyre.

4. Tezat e Këshillit të Mbrojtjes ishin dokumentet kryesore mbi të cilat duhej të mbështeteshin stërvitja, edukimi ushtarak, taktika dhe strategjia e ushtrisë sonë dhe e luftës popullore. Këto teza nuk u pranuan nga komplotistët, ato u sabotuan dhe u mbyllën nëpër kasaforta. Flitej për to sa për formë, por në fakt, asgjë nuk vihej në zbatim, zbatimi i tyre u pengua nga komplotistët Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja. Kjo, gjithashtu, nuk ishte diçka e rastit, po pjesë përbërëse e komplotit të madh. Në mënyrën e tyre ata duhej të ndërtonin «teza» të tjera dhe, nën mbulesën e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, të zbatonin antitezat që përgatiti Beqir Balluku dhe për të cilat ishin në dijeni me kohë edhe Petrit Dumja, edhe Hito Çakoja, por, siç duket, dhe siç e kemi shpjeguar më parë, ata duhet të kenë pasur midis tyre disa «mosmarrëveshje» në formë dhe në paraqitje, se në përmbajtje dhe në qëllim ishin dakord. Pra, kjo çështje me rëndësi ishte një nga detyrat kryesore të komplotistëve për të sabotuar luftën popullore, për të sabotuar modernizimin e ushtrisë, për ta mbajtur atë të çarmatosur dhe për t'i përgatitur terrenin invadimit armik nga jashtë.

5. Për ndërtimin e Shkollës së Lirë Ushtarake, që u propozua të ngrihej duke u bazuar në tezat e famshme të Leninit, për të cilën Partia jonë kishte krijuar kushtet nga çdo pikëpamje që ajo të realizohej edhe për arsye të taktikës dhe të strategjisë sonë të luftës, të caktuara nga Komiteti Qendror, këta komplotistë, Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, qenë kundër dhe e sabotuan atë. Ata përpiqeshin të linin përshtypjen sikur punonin, sikur e studionin, por në realitet s'bënin asgjë për ndërtimin e saj. Atë e organizuan vetëm në

disa pika hapjeje dhe e quajtnë «shkollë e lirë» dhe mbetën me kaq sa për t'u maskuar.

Pse këta komplotistë ishin kundër Shkollës së Lirë dhe pro ushtrisë së kazermës? Mund të mendohet me naivitet: «Pikëpamje, mentalitet i vjetër ushtarak, traditë e sovjetikëve, ushtrimet dhe stërvitjet bëhen më mirë në kazermë, ushtria përgatitet më mirë këtu». Mirë, mirë, por Komiteti Qendror ka thënë qartë se pjesa më e madhe e ushtrisë nuk është në kazerma, se jashtë kazermave janë forcat rezerviste, forcat vullnetare etj., prandaj edhe këto duhet të organizohen dhe të edukohen.

Muhamet Prodani u kishte thënë oficerëve që folën në aktive: «Ç'ua vini veshin këtyre forcave vullnetare, këto unë me një mitraloz i vë përpara». Ky farë burri harron se, kur doli të luftonte, nuk ishte më i mirë se këta që përbëjnë forcat vullnetare aktuale. Por Muhamet Prodani u bë gjeneral dhe mbeti «gjeneral», edhe pse i hoqën gradat; ai e mbajti hundën përpyetë, mbaroi akademi në Bashkimin Sovjetik, mori edhe pozita të larta, në ushtri thërritej «gjeneral legjendar» dhe vlëra e një vullnetari për të ishte e vogël, ajo është «mizë», kurse vlëra e ushtrisë së kazermës është e madhe. Lufta që Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja u bënëin krijimit dhe forcimit të Shkollës së Lirë Ushtarake ishte një nga pjesët kryesore përbërëse të komplotit që këta përgatitnin. Për të realizuar komplotin, për të realizuar puçin, është e përshtatshme vetëm ushtria e grumbulluar në kazerma. Këtu komplotistët mund të organizojnë forcën goditëse, për të bërë puçin, për të realizuar komplotin e kurdisur. Kurse organizimi i Shkollës së Lirë Ushtarake ishte një rre-

zik i madh për puçistët, si imediatisht, si në perspektivë. Këtë ushtri të madhe nuk e kishin dhe nuk mund ta kishin nën kontrollin dhe nën drejtimin e plotë të tyre, përkundrazi, në kohë rreziku ajo ishte jashtë kazerms, drejtohej nga tjetërkush dhe do të ngrihej e do t'i bënte hi komplotistët.

Unë u përpoqa të nxjerr konkluzione nga e gjithë kjo punë armiqësore që zhvillohej në ushtrinë tonë. Këto janë bazuar në analizat që kemi bërë deri tani, jemi bazuar në aktivet e Partisë që u zhvilluan në ushtri, në kritikën, në autokritikën dhe në deklaratat e shokëve. Por duhet të jemi të bindur se dokumentacioni për këtë ngjarje të hidhur është shumë larg që të jetë i plotë dhe të ketë sqaruar të gjitha qoshet e errëta, si të organizimit të këtij komploti, si të skutave të ndërgjegjes së shokëve që kanë gabuar, flas këtu për ata shokë që kanë gabuar dhe jo për ata që kanë tradhtuar.

Partisë dhe pushtetit u duhet të vazhdojnë me këmbëngulje dhe me durim që t'i bindin të gjithë ata që kanë gabuar, që t'i flasin hapur Partisë në organizatat-bazë për të tëra çështjet e këqija që kanë bërë të tjerët, përse i kanë bërë ato, nga ç'arsye janë shtyrë, ç'qëllime kishin, po të pohojnë edhe vetë të tyret, para se t'ua thonë shokët, të thonë ç'duhet të bëjnë që të shërohen, që t'i spastrojnë këto të këqija, të kërkojnë vetë dënimin dhe masën e dënimit që meritojnë dhe të mos presin që t'ua caktojnë të tjerët, «të na i caktojë Partia», siç shprehen zakonisht shumë nga këta. Në fund Partia do t'ua caktojë masën e dënimit, siç përcakton çdo gjë, por komunistët t'i mësojmë jo vetëm të gjykojnë dhe të dënojnë të tjerët, por të gjykojnë edhe veten,

që ata të peshojnë vetë edhe masën e dënimit që meritojnë.

U duhet Partisë dhe pushtetit të shfletojnë urdhra e vendime të panumërta që klika e komplotistëve u ka lëshuar organizatave, komandave, komiteteve. Në to ne do të gjejmë me siguri të dhëna të shumta, se si e kishin organizuar ata sabotimin dhe degjenerimin e ushtrisë.

U duhet organeve të diktaturës të hetojnë me imtësi dhe në thellësi punën armiqësore të këtyre banditëve, lidhjet e brendshme dhe të jashtme, format e metodat që kanë përdorur në këto drejtime. Duhet absolutisht të vërtetohet gjerësia e komplotit, deri ku shkonin flijet e organizimit të tij, brenda dhe jashtë ushtrisë, brenda dhe jashtë atdheut.

Është e domosdoshme që Partia dhe pushteti ta kenë të qartë potencialin e kësaj pune armiqësore, krejtësisht të qartë për çdo gjë, pse duhet absolutisht, dhe është jetike për fatet e socializmit në vendin tonë, që ushtria të jetë plotësisht e pastër, plotësisht në pozita të repartit të diktaturës së proletariatit, plotësisht në duart dhe nën drejtimin e Partisë, në shërbim të popullit dhe të socializmit.

Për t'i arritur këta objektiva nuk lejohet te kurrkush sentimentalizëm i sëmurë, shoqëri e sëmurë, miqësi e farefis i sëmurë, frymë reparti e sëmurë. Jo, në asnjë mënyrë, qoftë edhe një grimë frymë lëshimi, butësie, oportunizmi. Këto janë çështje jetike për popullin dhe për atdheun. Partia dhe pushteti duhet të veprojnë me dorë të hekurt dhe me zemër të hekurt kundër armiqve, të brendshëm dhe të jashtëm. Ky nuk është terror. Partia jonë, pararoja e çeliktë e proletariatit,

është ajo që ka qenë dhe kështu do të mbetet, e ashpër me armiqtë, por e dashur me njerëzit dhe në shërbim të plotë të popullit dhe të socializmit.

Pse duhet të jetë kështu Partia? Pse e ngre përsëri këtë çështje kaq me forcë? A nuk ka qenë gjithmonë kështu Partia?

Këtë çështje ne duhet ta ngremë me forcë, se na ngjau diçka e rëndë në ushtri, diçka jo e vogël dhe jo e përciptë, diçka jo e lehtë, po shumë e rrezikshme. Dhe ku na ngjau? Në ushtri, ku neve nuk na shkonte kurrë në mendje se do të na ngjiste një gjë e tillë. Këtë kështu duhet ta ndiejmë dhe kështu hapur ta themi. Ne e kishim fjetur mendjen dhe gabuam, nuk e kishim parasysh sa duhet atë që thotë populli: «Ujët fle, armiku s'fle».

Dhe kur na ngjau kjo? Pas një lufte kaq të rreptë dhe të vazhdueshme që Partia dhe shteti ynë kanë zhvilluar dhe zhvillojnë kundër armiqve të tyre të jashtëm dhe të brendshëm, kundër një sërë deviatorësh e tradhtarësh të marksizëm-leninizmit dhe të Partisë sonë, agjentë të titistëve, të revizionistëve sovjetikë, të imperialistëve amerikanë dhe të shteteve të tjera kapitalisto-revizioniste. Kjo na ngjau pas një lufte të vazhdueshme, të pareshtur e dhëmb për dhëmb me revizionistët modernë të të gjitha kallëpeve dhe veçanërisht me revizionistët titistë dhe sovjetikë; na ngjau kur e gjithë Partia dhe masat e popullit janë hedhur në sulm revolucionar kundër presionit ideologjik armik, kundër rrethimit kapitalisto-revizionist, sapo Partia kishte demaskuar e shpartalluar punën armiqësore të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës.

Kjo që po bëjmë është një luftë e rreptë klasash.

Po, kështu është, dhe duhet të luftojmë që kështu ta kuptojë dhe ta bëjë Partia këtë luftë klasash dhe jo me fraza, jo me zemër të butë, por me vendosmëri e në mënyrë parimore. A mund të bëhet më qartë ç'kërkon të na bëjë armiku, si vepron armiku, ku kërkon të futet armiku, ç'metoda përdor armiku? Jo, nuk ka si bëhet më qartë! Të mos harrojmë as për një çast përlëshjen me armikun. Këtë vazhdimisht na e ka mësuar Partia dhe nuk mund të na akuzojë kush se nuk e kanë bërë komunistët tanë tok me klasën dhe me popullin, e kanë bërë, bile, në ballë, atje ku rreziku ka qenë dhe është më i madh.

Mirëpo ja, duhet të njohim dobësitë tona në këtë luftë, pse, po nuk i njohëm, është zor ta bëjmë si duhet luftën. Dhe në këtë çështje nuk duhet të qëndrojmë në gjëra të përgjithshme dhe në moralizime pa bukë, por t'i vëmë gishtin plagës dhe gjërat t'i themi hapur. Organizatat e Partisë në ushtri nuk kanë qenë në pozita luftarake, nuk ishin në binarët revolucionarë të Partisë, ato e kishin neglizhuar dhe zbehur, për të mos thënë e kishin harruar fare luftën e klasave, ato kishin arritur në një formalizëm të zbrazur nga fryma revolucionare në zbatimin e mësimeve, udhëzimeve dhe direktivave të Partisë.

Këta tradhtarë kanë punuar sa kanë mundur që organizata e Partisë në ushtri të mos bënte si e edukonte dhe si i thoshte Partia, por si i thoshin ata, që ajo të mos mendonte në frymën e parimeve, të normave e të direktivave të Partisë, por sipas urdhrave të grupit fraksionist tradhtar; ajo të mos vepronte si i thoshte Partia, por si i diktonin Beqir Balluku, Hito Çakoja, Petrit Dumja dhe disa të tjerë. Partinë në ushtri ata e çuan

në këtë rrugë, ajo nuk shkoi vetë. Dhe këtu qëndron tragjedia. Si e lëshuan veten gjithë këta shokë komunistë që lejuan një gjendje të tillë? E shpjguam më sipër këtë fenomen se si vepruan elementët tradhtarë.

Mirë, mirë, mendojmë se i kemi shpjeguar të gjitha këto dhe këto nuk janë shpjeguar pa baza. Përkundrazi, janë konkluzione logjike marksiste-leniniste, por, megjithatë, duhet të analizojmë akoma më thellë si është e mundur që gjithë ata komunistë të ushtrisë të mbyllnin gojën për të këqijat që bëheshin në ushtri, për Partinë, për popullin dhe kundër tyre si individë ushtarakë? Kjo nuk është aq e lehtë të kuptohet se si këta komunistë nuk i folën hapur Partisë për gjithë këtë punë armiqësore antiparti shumëvjeçare dhe të përditshme që po zhvillohej në ushtri.

Kemi shpjeguar, gjithashtu, veçanërisht për kuadrot e lartë të ushtrisë, se qysh e pse lindën dhe u zhvilluan tek ata megalomania, prepotenca, arroganca, servilizmi etj., po si mund të kuptojmë që jo vetëm si komunistë shqiptarë, por dhe thjesht si shqiptarë, të durojnë nga kuadro arrogantë në ushtri të shara aq të ulëta në çështjet më të shenjta të njeriut dhe veçanërisht të shqiptarit, të mos revoltohen, të mos njoftojnë Komitetin Qendror, persona të udhëheqjes së Partisë dhe të Qeverisë, jashtë ushtrisë? Si është e mundur të lejohen njerëz të tillë që kanë taserën e Partisë dhe të sillen në këtë mënyrë? Me të vërtetë e habitshme!

T'i zvogëlojmë këto gjëra dhe të mos i themi aq sa janë dhe ashtu si janë? Në asnjë mënyrë! Ushtria jonë është dhe duhet të jetë e të mbetet arma e diktaturës së proletariatit, të jetë një ushtri me moral të lartë. Nuk lejohet që disa banditë ta kthejnë atë në një



mjet të tyre kundër interesave të popullit e të socializmit. Duhet ta shohim në sy këtë realitet të hidhur që na ngjau në ushtri, ta shohim ne, udhëheqja, ta shohë organizata e Partisë në ushtri dhe çdo kuadër i saj, që ka gabuar ose nuk ka gabuar, pse ndryshe nuk mund ta shërojmë sëmundjen.

Partia me punën e saj speciale duhet të bëjë një kthesë rrënjësore në karakterin e kuadrove të ushtrisë. Njerëzit e mirë të mos ofendohen, po duhet njohur se përveç tyre ka edhe ndonjë vjedhës, mashtrues, gënjeshtar, matrapaz, imoral, për të mos folur për arrogantët, mendjemëdhenjtë, prepotentët e të tjerë. As të mos lejohet kurrkush që të mendojë se janë të gjithë kështu. Jo, këta janë vetëm një pakicë, por ama kur them pakicë, nuk kuptoj 10 apo 20 veta, por as të mos nisemi nga ideja e gabuar që, për t'i ruajtur «prestigjin ushtrisë», ta lëmë që kjo të krimbet. Jo, të tillë njerëz ka edhe në pushtet, edhe në organizatat e Partisë të terrenit. Pse mos vallë u bie prestigji Partisë dhe pushtetit në terren që i godit në kokë të tillë njerëz pa dinjitet e pa moral? Jo, aspak, përkundrazi, duke goditur të ligjtë, Partisë dhe pushtetit u është ngritur prestigji. Pse duhet të veprojmë atëherë ndryshe me ushtrinë? S'lejohen më sentimentalizmat e sëmurë. Tradhtia e «Treshes» qëndron edhe në atë që punoi dhe i nxiti këto vese, që i përkrahte dhe i fshihte veprimet e këqija. Ne duhet t'i zbulojmë, t'i dënojmë, t'u presim hovin dhe të edukojmë njerëzit, t'u ndreqim boshllëqet dhe anët e dobëta e të këqijat t'ua luftojmë, t'u vëmë në dukje të mirat që formojnë karakterin e njeriut të mirë.

Çështjen e karakterit Partia jonë nuk e ka parë dhe as nuk mund ta marrë si një nocion abstrakt, idealist,

siç e shpjegon filozofia dhe psikologjia borgjeze revisioniste, të cilat «Treshja» tradhtare i fuste në ushtrinë tonë për «edukim», që duhet lexuar demoralizim.

Vetitë që përbëjnë karakterin e njeriut nuk duhet të kuptohen si koncepte idealiste ose psikologjike, këto nuk mund të bëjnë, gjithashtu, objektin e një përmbledhjeje, parë kjo vetëm nga pozitat politike. Të gjitha këto duhet të inkuadrohen dhe të zhvillohen në një praktikë me hov dhe temp revolucionar. Karakteri i njerëzve do të thotë qëndrimi i njeriut ndaj ligjeve të natyrës, ndaj ligjeve të zhvillimit të shoqërisë, ndaj shoqërisë vetë, ndaj klasave që e përbëjnë atë, ndaj botëkuptimeve filozofike të ndryshme të tyre, ndaj moralit dhe derivateve të tij të çdo klase, të çdo shtrese dhe në përleshje në mes tyre për hegjemoni. Karakteri i njeriut pra është një botëkuptim filozofik që pasqyrohet në jetën, në kulturën, në mendimet dhe në veprimet e tij ndaj vetes, ndaj të afërmeve, ndaj shoqërisë. Asgjë nuk lind me njeriun për sa i përket karakterit, por ky formohet, asgjë nuk qëndron në vend, po bën ndryshime dhe transformime cilësore, progresive, por edhe regresive. Çdo gjë është në ndryshim dhe në luftë të pareshtur me të kundërtat. Edhe njeriu nuk bën përjashtim, po ndjek këtë proces dialektik të zhvillimit që ndjek edhe natyra. Pra karakteri dhe ndërgjegjja e njerëzve marrin format e zhvillimit ku njeriu jeton dhe lufton, të klasës ku lind, ku rritet dhe lufton dhe atje përqafohet ai tiparet e klasës së vet, përfaqëson klasën dhe përqafohet me idealet e saj, por edhe ndryshon pozitivisht ose negativisht.

Ndikimi i një klase në tjetrën, filozofia e njërës klasë mbi tjetrën, mënyra e jetesës së njërës mbi tjetrën

ndikojnë në individë dhe në shoqëri, sjellin ndryshime, krijojnë konflikte. Pa u zgjatur në këto nocione filozofike, desha të theksoj me këtë se Partia jonë, si parti marksiste-leniniste, ka besim te njeriu dhe me edukatën e saj të shëndoshë proletare e edukon, e bën atë, siç thuhet, një njeri me karakter, i jep atij ndjenjën e punës, të ndershmërisë, të heroizmit, të sakrificës, të patriotizmit, të thjeshtësisë, i jep ndjenjën e vërtetë të dashurisë dhe të respektit për tjetrin, për shoqërinë, për pronën e përbashkët dhe, në regjimin tonë socialist, ajo e edukon me një fjalë njeriun me virtyte të larta të klasës dhe me urrejtje për botën kapitaliste e borgjeze dhe për veset e mënyrën e jetesës, të të menduarit dhe të të vepruarit të tyre.

Si rrjedhim i punës armiqësore karakteristike e përgjithshme në karakterin e një sërë kuadrosh të ushtrisë është arroganca, prepotenca, violenca. Kjo duhet të konsiderohet si një problem joabstrakt, as psikik, që i vihet përpara Partisë për ta studiuar, por si një problem i madh ideologjik. Të jesh i rrëmbyer dhe nevrrik në mendime dhe në veprime, nuk është thjesht një manifestim spontan, i pamenduar ose thjesht i «një nxehjeje» të shkaktuar nga një padrejtësi ose shkelje ligji nga një person apo nga një tjetër. Nuk e kam fjalën këtu për manifestime të tilla që shkaktojnë revoltën e ligjshme kundër padrejtësive. Jo, po e kam fjalën në atë që gjithë kjo frymë arrogance dhe megalomanie, që kishte mbuluar një numër kuadrosh të ushtrisë, nuk qe një gjë e rastit. Këta njerëz me të tilla vese, karakteristike e njerëzve të rrëmbyer, megalomanë dhe me një frazeologji të ndyrë, me huqe imorale e të degjeneruar, nuk hyjnë në kategorinë e atyre që rastësisht u ngjet

në jetë një aksident i kësaj natyre. Jo, te këta njerëz, «të thjeshtë» në fillim të jetës së tyre politike, më vonë u krijua një kompleks i rrezikshëm në karakterin e tyre, u formua tek ata një botëkuptim filozofik, ideologjik, reaksionar. Ndjenjat dhe mbeturinat e ideologjisë borgjeze dhe mikroborgjeze, të strukura për një kohë në ndërgjegjen dhe në veprimet e tyre, shfaqeshin por jo me atë forcë aq të theksuar që i shohim tash në ta, pse edukata e Partisë bënte edhe ajo efektin e saj dhe ky efekt ka qenë dhe është i madh në edukimin e komunistëve dhe të njerëzve të shoqërisë sonë. Fakt është se Partia lufton dhe do të luftojë vazhdimisht në këtë drejtim kryesor. Fakt është, gjithashtu, se, në një numër kuadrosh të ushtrisë, edukata e Partisë, në drejtimin e shfaqjeve që numërova më lart, nuk ka dhënë rezultatet e duhura për të cilat ajo luftonte, kështu që në disa kuadro kryesorë ushtarakë këto karakteristika kanë marrë trajta të hapëta të filozofisë dhe të ideologjisë antimarksiste. Këto ndjenja dhe shfaqje mikroborgjeze në karakterin dhe në veprimet e këtyre njerëzve u trashën dhe këta u kthyen në elementë antiparti. Tash ata ne i cilësojmë revizionistë dhe të tillë janë, por këta revizionistë janë edhe komplotistë, edhe bonapartistë. Dhe kur i cilësojmë si bonapartistë, të mos mendojë ndokush se janë «koka ushtarake» si Napoleon Bonaparti, jo, por se këta kanë frymën e komandimit, janë brutalë dhe arrogantë si prej borgjezi imperialist dhe sidomos pse janë puçistë, siç ishte Bonaparti që bëri 18 Brymerin. Pra, këta bonapartistët tanë përgatitnin puçin me violencë për të marrë fuqinë dhe për të vendosur kapitalizmin në Shqipëri. Këta puçistë do të vetëquheshin marksistë-leninistë dhe, në qoftë se do të fitonte ndërmarrja e

tyre, atë që do të vendosnin, do ta quanin «revolucion».

Mirëpo ideologjia që i frymëzonte këta, ishte ajo ideologji reaksionare, që në histori ka marrë emrin «teoria e violencës», babai i së cilës është Zhorzh Sorreli, që kishte si nxënës besnik Charl Morasin dhe Benito Musolinin dhe si armik të tmerrshëm Vladimir Iliç Leninin. Zhorzh Sorreli për një kohë është hequr edhe si marksist, por nuk ka qenë asnjëherë i tillë, përku ndrazi, shpejt u duk se idetë e tij nuk përbënin veçse teorinë e tij të violencës që frymëzon dhe nxit luftën për vendosjen e diktaturës fashiste. Puçistët e tipit Beqir Balluku me shokë mund të mos e njohin «teorinë e violencës» të Sorrelit, por ata njihnin «marshimin mbi Romë» të Duçes dhe akoma ca më afër puçin e Hrushov-Mikojan-Zhukovit që zhvillohej brenda në parti dhe me ngjyra partie për të vendosur revizionizmin dhe kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik, siç e vendosën.

Por puçistët te ne dështuan. Megjithatë Partia duhet t'i përvishet një pune të madhe riparimi, edukimi. Ne, siç thashë, duhet të kemi besim të plotë tek ushtria dhe te kuadrot e saj. Por, të jemi realistë, puçistët antimarksistë na kanë dëmtuar rëndë në kuadrot, duke shtrembëruar ideologjinë dhe filozofinë marksiste-leniniste, ata na kanë dëmtuar në kuptimin e interpretimin e brendisë ideologjike dhe në zbatimin e parimeve e të normave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit në ushtri duke i deformuar këto, kur mundnin, edhe në teori, edhe në zbatimin praktik të tyre. Ata na kanë dëmtuar deri në format dhe në trajtat e paraqitjes së mësimëve të Partisë, qoftë ato me karakter ideologjik, qoftë ushtarak. Të gjitha këto, që po shtroj, mendoj se duhet të bëhen objekt serioz diskutimi me kuadrot që punojnë

dhe që do të punojnë në ushtri për forcimin dhe kalitjen e saj.

Analiza e ngjarjeve dhe kronika e zezë e tyre nuk duhet të konsiderohet vetëm një çështje kurioziteti dhe një revoltim e urrejtje e ligjshme kundër tyre dhe njerëzve që i bënin, por të na shërbejnë për të nxjerrë mësim nga to. «Të nxjerrim mësim» e themi lehtë, por se si duhet t'i nxjerrim këto mësim, si duhet vepruar që këto mësim të mbështeten në një analizë të thellë, të shoqërohen me mbështetje dhe me shpjegime ideologjike dhe politike, me forma organizative origjinale dhe të përshtatshme për këto situata të sëmura që lejuan të krijoheshin format burokratike, dogmatike, shabllone e rutinë deri edhe te mënyra e shprehjes dhe e tonit, nuk është një punë edhe aq e lehtë. E tërë kjo duhet të ketë frymë të ngrohtë shoqërore e vëllazërore partie. . .

Toni me partishmëri është kurdoherë toni i ngrohtë, i vendosur e parimor, gjakftohtë dhe me durim. Askush të mos mendojë se një ton i tillë është oportunist. Toni i egër është i neveritshëm dhe bëhet i rrezikshëm kur hyn në tiparet e prepotencës. Në ushtri ne duhet të ribëjmë një punë të thellë me baza të shëndosha, të spastrojmë të këqijat dhe të kalitim të mirat. Nuk duhet të kënaqemi me një punë të sipërfaqshme, vetëm sa për të thënë njerëzit «Jemi dakord dhe u bindëm». Këtë na e kanë pasë thënë shumë herë këta elementë armiq që po dënojmë.

Ne do t'u besojmë shokëve, por edhe duhet të krijojmë atë gjendje, të bëjmë atë punë, të mbajmë me ta ato qëndrime marksiste-leniniste, që edhe ata të kenë besim te ne. Besimi duhet të jetë reciprok. Lypset të

jemi të thjeshtë me ushtarin, që edhe ai të jetë i afërt me ne, ta duam ushtarin, që të na dojë dhe ai, që ai të bindet për atë që i themi dhe të shohë si veprimë ne. Edhe ne nga ana jonë duhet të bindemi me atë që na thotë ushtari dhe me veprimet e tij. Këtu ka edhe hierarki marksiste-leniniste, centralizëm demokratik, unitet marksist-leninist, patriotizëm revolucionar, por çdo gjë në thjeshtësi, çdo gjë në bindje, në dashuri të sinqertë, edhe hapur me njëri-tjetrin dhe në ashpërsi kundër armiqtë të Partisë dhe të socializmit.

Roli i ushtrisë ka qenë dhe mbetet, edhe pas kësaj ngjarjeje, shumë i madh për mbrojtjen e Partisë dhe të socializmit, prandaj ne duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh jo në kuptimin «paternalist», po marksist-leninist, revolucionar. Duhet që absolutisht të shërojmë shokët tanë të sëmurë, të cilët në çdo gjë dhe për çdo rast, pas kësaj që na ngjau, kanë nevojë të shohin ngrohtësinë e Partisë dhe kjo jo vetëm si një çështje teorike, po edhe në planin humanitar komunist të kontakteve. Këta shokë të sëmurë janë në gjendje deprezioni moral, e ndiejnë fajin e tyre, nuk kërkojnë mëshirë dhe Partia është kundër mëshirës kristiane, po ata duan ndihmë dhe duhet ta kenë këtë ndihmë të sinqertë e të hapët. Këto momente të vështira për shokët të mos na bëjnë që të humbasim durimin; të kemi kurdoherë parasysh se luftojmë për të fituar njeriun, për të fituar shokun që na e kishte çoroditur puna e armikut.

Të kemi parasysh se kuadrove të ushtrisë, gjithë organizatës së Partisë në ushtri, kjo çështje u ra përpitur si një shpellë e madhe në një ujë të fjetur. Shumë shokë partie, jo udhëheqës dhe udhëheqës brenda dhe jashtë ushtrisë, as nuk arritën dhe as nuk kanë arritur

akoma ta realizojnë si duhet rrezikshmërinë e madhe të kësaj pune armiqësore, jo pse duan ta minimizojnë, por se ata nuk arrijnë ta përcaktojnë dot as gjerësinë e kontureve, as thellësinë e saj. Prandaj, kur them se Partia këta shokë ushtarakë që kanë gabuar duhet t'i marrë në gjirin e saj të ngrohtë, ajo duhet të mos përdorë me ta metoda jopartie, të mos përdorë metoda «hetuesie», që u përkasin organeve të tjera, ajo duhet të ketë parasysh kohën e duhur të reflektimit, që i nevojitet shokut për të realizuar gjithë gjendjen që u krijua dhe gabimet e tij që kanë kontribuar për krijimin e kësaj gjendjeje. Kjo bën pjesë në atë që thashë, të ndreqen këta shokë në mënyrë revolucionare, që do të thotë, të bëhet një analizë e drejtë dhe të mos harrohet ilaçi i shërimit, kritika dhe autokritika, por të mos harrohen as momentet dhe as pacienti i sëmurë. Ngul këmbë, pra, në metodën e punës edukative që duhet të zhvillojë Partia në ushtri me kuadrot e saj: bindje, ngrohtësi dhe durim që na i jep arma e madhe e teorisë sonë, marksizëm-leninizmi, luftë dogmatizmit dhe imponimit të këshillave dhe të udhëzimeve me «krenari» të sëmurë.

Urdhrat në ushtri janë dhe do të mbeten urdhra, ata duhet të zbatohen deri në fund, por ata në radhë të parë duhet të jenë në vijën e Partisë, në ideologjinë e Partisë, në rrugën ushtarake të Partisë, ata duhet të jenë që më parë shumë mirë të studiuar dhe të kuptueshëm për ushtarët dhe për kuadrot. Këto gjëra janë të njohura dhe më falni që i përsëris, por e ndiej se është më tepër se kurrë momenti që t'i përsëris.

Njerëzit, goftë në gëzime, goftë në hidhërime kërkojnë shoqërimin, kërkojnë mbështetjen. Do t'i lëmë ne



këta shokë të sëmurë dhe në mjerim shpirtëror, që jo vetëm të vuajnë shpirtërisht, por të venë e të gjejnë ngushëllim dhe mbështetje tek ata që janë në të njëjtën gjendje shpirtërore si vetja e tyre, apo Partia t'i marrë në gjirin e saj të ngrohtë? Sigurisht, ne duhet të ndjekim rrugën e dytë dhe këtë rrugë të dytë ta ndjekim në mënyrë revolucionare, në frymë revolucionare, vetëm në rrugën marksiste-leniniste të Partisë sonë. Pra, të ndjekim dhe të zbatojmë edhe në këtë çështje rrugën e sigurt e të pjekur të Partisë, ashtu siç kemi bërë kurdoherë në kohë të mira dhe në kohë të vështira.

Kur themi që Partia duhet t'i edukojë njerëzit me moralin e lartë proletar, kjo disa herë nuk kuptohet drejt e natyrisht edhe edukata nuk bëhet aq e përsosur. Klasa punëtore është klasa më revolucionare, prandaj të marrësh tiparin e klasës, në jetë dhe natyrisht në veten tënde të brendshme, në atë që e quajmë «ndërgjegje», duhet të mendosh dhe të veprosh, siç mendon dhe siç vepron klasa, domethënë në mënyrë revolucionare.

**Partia lufton dhe duhet të luftojë fort kundër mbeturinave mikroborgjeze.** Ka shokë që me naivitet mendojnë se «lufta është e mjaftë, se karakteri u formua deri në një periudhë jete dhe ai jo vetëm që nuk shtrembërohet më, por, sipas tyre, s'ka më rrezik të ndikohet nga mbeturinat dhe, meqenëse klasa punëtore është rritur në vendin tonë, sot nuk ekziston ai rrezik që ekzistonte para Çlirimit».

Ky konsideracion i fundit është i vërtetë. **Klasa punëtore te ne është rritur, por të mendohet se mbeturinat mikroborgjeze zhduken me një brez njeriu, atëherë do të gabojmë.** Këtë çështje unë e kam trajtuar edhe herë të tjera, por në këtë rast e kam fjalën gjetkë. Të

mos harrojmë fillin. Për të gjitha këto që them, nuk bëj moral në hava, por i kam kurdoherë lidhur me kuadrot e ushtrisë, ku na u vërtetuan gabimet.

Populli ynë ka shumë virtyte të mira, që njerëzit tanë në breza i kanë trashëguar, i kanë zhvilluar dhe i kanë transformuar për mirë ose për keq. Ne, komunistët, luftojmë që karakteristikat e mira të popullit t'i ruajmë, t'i zhvillojmë dhe t'i bëjmë sidomos revolucionare. Të përmendim disa nga këto karakteristika: Populli ynë është trim, që do të thotë nuk është i frikshëm, ai është i drejtë, është i besës, është punëtor, ai e do shumë pushkën dhe për atdheun lë kokën, ai e do dhe ka luftuar vazhdimisht për lirinë. Të mos zgjatemi, se këto karakteristika janë të shumta dhe lum ne që i kemi, prandaj t'i ruajmë si beben e syrit, por edhe t'i kthejmë në karakteristika revolucionare, t'i zhveshim nga botëkuptimi i vjetër borgjez e mikroborgjez.

Të jesh i drejtë është gjithashtu një virtyt. Po mund ta kuptosh atë në mënyrë të qetë: «Unë nuk vjedh, nuk i bëj keq njeriu. Kur më pyesin, mund të them me druajtje ndonjë fjalë, të këqija unë s'bëj, po ç'më duhet të përzihem, le të rroj ndershëmrisht në punën time». Vetëm se ky qëndrim nuk është aspak revolucionar, pse nuk lufton me forcë që të vendoset drejtësia kudo, që ta mbrosh atë në shi e në furtunë dhe të sakrifikosh për të. Pra, çështjes të jesh i drejtë mund t'i japësh dy lloj kuptimesh dhe dy lloj zbatimesh të kësaj drejtësie. Ne duhet që kuptimin që përmenda ta kthejmë në revolucionar. E kështu me radhë mund të flitet për të gjitha virtytet e tjera të mira të popullit tonë.

Disa fenomene jo të shëndosha në këtë drejtim na

u shfaqën në kuadrot e ushtrisë dhe sidomos në ata të lartët dhe kjo ngjau nga puna armiqësore e elementëve antiparti dhe për mungesë të një edukate të shëndoshë, sistematike e këmbëngulëse nga ana e Partisë. Kuadrot e ushtrisë, sidomos ata të lartët, bënë luftën dhe dolën nga ajo me një krenari të ligjshme. Por kjo krenari duhej zdruguar me një edukatë të shëndoshë marksiste-leniniste. Dhe kjo u bë aq sa u bë dhe ashtu si u bë për të gjithë njerëzit që dolën nga lufta dhe veçanërisht për komunistët. Natyrisht, Partia, ashtu siç i vuri gjoksin Luftës Nacionalçlirimtare, ajo i vuri gjoksin edhe rindërtimit të vendit të rrënuar; ishin kohë të lavdishme ato të viteve të para të pasçlirimit, por edhe shumë të vështira, pse vazhdonte lufta me reaksionin e brendshëm, me reaksionin ndërkombëtar dhe me vështirësitë ekonomike. Edhe në këtë luftë të vazhdueshme u kalitën kuadrot e dalë nga lufta. Te këta, komunistë dhe jokomunistë, u mbështet Partia për të udhëhequr popullin në luftën vigane që vazhdoi për ndërtimin e bazave të socializmit. Partia u zmadhua, u forcua, u kalit, u kalitën dhe kuadrot e saj. Partia i edukonte anëtarët e saj dhe kuadrot me ideologjinë marksiste-leniniste, me shkencë, me kulturë dhe me punë.

Në veçanti dhe në mënyrë më të privilegjuar Partia u interesua për ushtrinë dhe sidomos për kuadrot e saj. Këta kuadro, nga trajtimi ekonomik ishin më të favorizuar dhe kjo u bë me plot bindje nga ana e Partisë për arsye të punës së rëndë dhe të rëndësishme të këtyre kuadrove dhe të ushtrisë sonë që duhej ndërtuar, duhej organizuar, duhej stërvitur dhe duhej pajisur me armë si një ushtri moderne. Karakteristikës së shqiptarit, që luftoi, që mban armën në dorë dhe qëndron e

edukohet për të qenë vigjilent e i gatshëm, pikërisht kësaj gjëje të ligjshme dhe pozitive neve na u desh t'i vinim një kujdes të veçantë dhe të punonim për t'i kalitur dhe për t'u dhënë kuadrove tiparet e klasës, tiparet revolucionare. Partisë iu desh të bënte kujdes më shumë që kuadrove të luftës, dhe sidomos atyre të ushtrisë, të mos u rritej mendja, që këta të mos bëheshin arrogantë dhe prepotentë, karakteristika që mund të shfaqeshin në momentet e pasluftës. Ne, njerëzit e Partisë, sigurisht e kishim parasysh një kujdes të tillë dhe ishim të bindur se ata që bënë luftën dhe tok me ta gjithë ata që do të udhëhiqnin ndërtimin e socializmit, ishin të vuajtur, djem e vajza të popullit fukara, prandaj do të ishin të thjeshtë si populli. S'ka asnjë dyshim se këtë e vërtetojnë faktet, e vërteton historia, se Partia e Punës e Shqipërisë punoi dhe luftoi në të gjitha drejtimet, në radhë të parë me njerëzit, në mënyrë revolucionare, në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, në rrugën e normave të saj dhe pati dhe ka arritur rezultate kolosale që shihen dhe preken nga të gjithë. Por vazhdimisht duhej dhe duhet të mos humbasë kurrë vigjilenca në drejtim të edukatës së njerëzve dhe sidomos në ato raste kur grupime njerëzish, siç është rasti i ushtrisë, punojnë dhe rrojnë të grumbulluar në kazerma, ku edhe edukohen.

Ushtrinë ne e kemi konsideruar, dhe në këtë nuk kemi gabuar, një shkollë të madhe, jo vetëm se në të stërvitim popullin për mbrojtje, por se atje është luftuar me sistem analfabetizmi, atje janë edukuar dhe edukohen të rinjtë tanë me frymën luftarake dhe heroike të Luftës Nacionalçlirimtare. Sa ndihmë të madhe i ka dhënë ushtria Partisë dhe vendit në këtë drej-

tim me ushtarët pas kryerjes së shërbimit ushtarak! Mirëpo këtu ka ekzistuar një rrezik, ndaj të cilit duhej pasur më shumë kujdes: ishte çështja se format e punës në ushtri e mbanin këtë jo plotësisht të lidhur me popullin. Jeta në kazerma e krijonte këtë farë izolimi të saj, i cili duhej të zhdukej me një punë intensive edukative dhe politike. Por mënyra dhe format e edukimit nuk u treguan të mjaftueshme në këtë drejtim. Na lindi fenomeni që kuadri ushtarak u edukua që të komandonte dhe pikërisht në këtë edukim dhe në këto forma edukimi Partia nuk bëri sa duhet kujdes dhe, duhet thënë, nuk pati një eksperiencë shumë të madhe në këtë drejtim.

Lidhjet me Jugosllavinë nuk na sollën asgjë të mirë, veç të këqijave.

Ndërsa lidhur me Bashkimin Sovjetik të kohës së Stalinit, si gjatë kohës së luftës, edhe pas luftës, dashuria e kuadrove tanë ushtarakë ishte e madhe për Ushtrinë e Kuqe të Stalinit, për artin ushtarak stalinian. Kjo ishte e drejtë, ishte marksiste-leniniste, ishte internacionaliste.

Ne dërguam në shkolla ushtarake, në uqilishet dhe në akademitë sovjetike shumë kuadro. Ata vajtën, mësuan atje artin e luftës, e sollën atë në ushtrinë tonë dhe filluan ta jepnin. Kuadrot tanë ishin njerëz të thjeshtë, njerëz të luftës, ata sapo kishin dalë nga lufta, jo vetëm nuk kishin kulturë, por shumë prej tyre kishin pak shkollë. Ata vajtën për herë të parë nga Shqipëria në Bashkimin Sovjetik dhe përvetësuan atje edhe të mirat, por edhe disa karakteristika jo të mira të ushtarakëve sovjetikë, të pjesëtarëve të një ushtrie të madhe që fitoi luftën, që sillej dhe rronte me gjoks në plot ni-

shane dhe të tjerët i konsideronte si «çunakë» etj. Këto gjëra në kuadrot tanë të thjeshtë kanë bërë efekt dhe pa e ndier, pse mendohej, dhe zor do të ishte të mos mendohej ndryshe prej tyre, se ato «krenari, fodullëqe, privilegje, grada e dekorata ishin dhe bëheshin në rrugën marksiste-leniniste».

Shabllonizmi ka luajtur rolin e vet. Tendenca që «ato që pamë në Bashkimin Sovjetik ne duhet t'i vëmë në jetë edhe në ushtrinë tonë», qe e theksuar te kuadrot tanë dhe në këtë drejtim Partia nuk bëri shumë kujdes, pse ne kishim besim të madh te çdo gjë që vinte nga Bashkimi Sovjetik.

Partia dërgoi, gjithashtu, në Bashkimin Sovjetik mjaft kuadro për të mësuar në fakultete të ndryshme të universiteteve, bile këta qëndruan edhe më gjatë në Bashkimin Sovjetik, sesa ushtarakët. Mirëpo, kur u kthyen, u bashkuan me jetën e gjerë të popullit, pse ata u kthyen në ara, në fabrika, në spitale etj., kurse ushtarakët shkuan drejt e në kazerma, kaluan nga kazerma në kazermë. Mjaft prej këtyre shfaqën një «krenari» të theksuar dhe kujtuan se arritën kulmin e dijes, se tash ata mund të komandonin pa druajtje, pa frikë se gabonin as ushtarakisht, as politikisht dhe as ideologjikisht. Pas kësaj kohe lindën disa pikëpamje të rrezikshme në një numër ushtarakësh me të kaluar të mirë të luftës, por edhe tek ata që vinin nga shtresa të varfra. Duhet thënë se Partia nuk i vërejti si duhet në zhvillimin e tyre këto karakteristika që po ngrinin krye, i quajti ato si një fenomen të veçuar, personal, nuk u thellua sa duhej në aspektin dhe në rrezikshmërinë që formonin në një shoqëri të mbyllur, në një zanaat delikat, ku të tilla vese mund të gjenin fushë zhvillimi më

lehtë, ku çdo gjë «komandohej», ku çdo gjë i nënshtrohej «disiplinës dhe sekretit ushtarak», ku gradat, dekoratat, hierarkia i nxitnin dhe i zhvillonin. . .

Nga këta kuadro, shumica me 5-6 vjet shkollë «mbauran» jo një, po nga dy akademi ushtarake nga më të lartat të Bashkimit Sovjetik dhe me notë «të shkëlqyeshme» dhe kur u kthyen në atdheun e tyre të vogël dhe në ushtrinë e tyre të vogël, e ndienin veten «shumë të mëdhenj» për këto reparte, prandaj jo vetëm që në ëndrra dhe në imagjinatë e shikonin veten në «madhësinë e duhur», por edhe në jetë e në punë kurdoherë lustronin çdo gjë që kishte lidhje me ta. Këta u bënë «heronjtë e revolucionit».

Sadik Bekteshi hiqej si pasardhësi i drejtpërdrejtë i Heroit të Dragobisë. Kur e dëgjoje që të fliste për Luftën e Reçit, ai i jepte kësaj ngjyrat e luftës së Kurskut dhe veten e shihte jo gjeneral, por marshal. Por Partia ua preu krahët të fluturonin të tillë njerëzve dhe jo vetëm kaq, por u hoqi edhe gradat. Këta elementë të sëmurë pësuan një deziluzion të tmerrshëm.

Beqir Balluku, Petrit Dumja e Hito Çakoja, që kishin marrë frenat në dhëmbë dhe që ecnin revan, e konsideronin veten «diva mbi divat». Batalioni «Hakmarrja» u bë «batalioni i legjendës», Brigada II, e drejtuar nga Beqir Balluku, hyri në histori «me himn» të veçantë. Disfatat e Beqir Ballukut u kthyen në «fitore», tërheqjet dhe goditjet që hëngri kjo brigadë, nga pazotësia e Beqir Ballukut, u kthyen në objekte model të «taktikës partizane», u mësuan në shkollat ushtarake me «harta mbushur me shigjeta blu e të kuqe», që të impresiononin «colot», siç i quante Hito Çakoja komisarët e ushtrisë, që nuk kishin bërë luftën, pse atëherë

ishin akoma të rinj. Me paturpësinë më të madhe Hito Çakoja thoshte: «Çfarë komisarësh jeni ju, merrni she-mbull nga unë dhe Muhamet Prodani». Deri këtu kishte arritur megalomania e këtyre njerëzve.

Miqësia aq e ngushtë dhe e singertë me Bashkimin Sovjetik e mbulonte deri në njëfarë shkalle një situatë të tillë që po fillonte të sëmurej. Çdo të metë, çdo gabim në ushtri, Partia e godiste, por ajo nuk ishte në gjendje të shikonte fenomenin, për arsye të thjeshtë se «shtylla» e organizatës së Partisë në ushtri ishin këta kuadro të vjetër të Partisë që kishin bërë luftën dhe që udhëhiqnin edhe Partinë, edhe ushtrinë. «Komanda unike» e forcoi akoma më shumë këtë mentalitet bonapartist jo vetëm në ushtri, por edhe mbi Partinë.

Këta shokë «të thjeshtë partie», duke u hequr sikur e donin Partinë, filluan ta kuptojnë ndryshe atë, parimet, normat dhe direktivat e saj. Partia për ta «nuk ishte ajo që udhëhiqte», por «ishin ata që e udhëhiqnin atë». U formua mentaliteti dhe praktika se «Ne që drejtojmë ushtrinë, duhet të komandojmë edhe Partinë». «Komandimi, — thanë ata, — u bë unik, pra, të gjitha ato metoda ushtarake ne duhet t'ia veshim edhe Partisë, t'ia imponojmë edhe Partisë» dhe këtë e bënë. Partisë në ushtri i mungoi vigjilenca dhe kontrolli, pse në formë asgjë nuk ndryshonte. Partinë e «donin», për Partinë «bërtitnin», «përgjërroheshin», «ishin gati të hidheshin në luftë». Flitej në organizatat-bazë për normat, direktivat, për kritikë dhe për autokritikë etj., por, në fakt, këta njerëz të sëmurë që imponoheshin në Parti, nuk e kuptonin Partinë ashtu siç duhej kuptuar, nuk i zbatonin normat siç duheshin zbatuar, për ta Partia,



për të gjitha këto probleme kapitale, ishte krejt ndryshe. Këta elementë futën metodat ushtarake dhe ato më të këqijat në Parti. Partia në ushtri, pa u kuptuar, ecte drejt një qorrrokaku.

Revolta kundër revizionizmit sovjetik dhe shkëputja në mënyrë revolucionare nga Bashkimi Sovjetik revizionist ishte një akt i madh historik e me rëndësi ndërkombëtare, në lëvizjen komuniste botërore, që bëri Partia jonë. Kjo në mënyrë të shkëlqyeshme tregoi pjekuri të pashoqe marksiste-leniniste, kurajë dhe guxim marksist-leninist, tregoi zotësi udhëheqëse në furtunë dhe në stuhi, diti të ngrejë peshë në një unitet të çeliktë veten e saj dhe popullin, galvanizoi dhe hodhi në luftë të gjitha energjitë e vendit jo vetëm për të përballuar furtunën, por për të dalë, gjithashtu, fitimtare dhe në lëmin ndërkombëtar të jepte shembullin se s'ka forcë që mposht një popull të vogël, por trim, një parti të vogël, por heroike, një parti të vërtetë marksiste-leniniste, s'ka forcë në botë që të mposhtë marksizëm-leninizmin dhe revolucionin. Dhe në këtë moment të vështirë, por heroik, ushtria, si një trup, si një bllok graniti, e mbështeti Partinë, mëmën e saj që e lindi dhe e rriti në betejë, që e edukoi, e stërviti dhe e armatosi me fukarallëkun e saj, kur Shqipëria doli e shkatërruar ekonomikisht nga lufta. Kuadrot e ushtrisë u treguan në lartësinë që kërkonte momenti. E gjithë kjo ishte një forcë e madhe e Partisë në shërbim të popullit dhe të socializmit. Kuptohet se Partia në kohë rreziku i provon si duhet njerëzit dhe kjo ishte një provë e madhe për të gjithë.

Në situatën e krijuar Partia i vuri rëndësi çdo sektori, veçanërisht ushtrisë. Ajo mori masa dhe forcoi

armatimin, edukimin e saj, fortifikimin e vendit. Në radhë të parë, Komiteti Qendror i Partisë i vuri rëndësi kalitjes së Partisë në ushtri, ngritjes ideologjike dhe politike të saj, i vuri rëndësi luftës kundër revizionizmit modern, veçanërisht atij sovjetik dhe mbeturinave të ndikimeve të dënueshme të ushtrisë sovjetike në ushtrinë tonë.

Gjithë këtë luftë në drejtim të kalitjes së ushtrisë dhe të kuadrove Komiteti Qendror dhe Partia e bënë nëpërmjet organizatës së Partisë në ushtri, nëpërmjet komunistëve që militonin në të. Kjo ishte krejt e rregullt dhe normale dhe ushtria e kuadrot e saj e meritonin këtë besim. Mirëpo, siç e shpjegova më lart, organizata e Partisë pak nga pak mori një frymë tjetër pune dhe kuptimi të ideologjisë marksiste-leniniste dhe këtë frymë të sëmurë bartësit e saj, me dashje ose pa dashje, jo vetëm e gjenin të drejtë, por e theksuan, e forcuan akoma më shumë në tërë ushtrinë, duke përfituar nga situatat e vështira ndërkombëtare, nga rrethimi i egër, real dhe joimagjinar, kapitalisto-revizionist. Komanda kishte prirje të vihej mbi Partinë, të komandonte Partinë, hierarkia e sëmurë përpiqej të zhdukte demokracinë në Parti. Këtë rrezik e pa Komiteti Qendror dhe mori vendimet që dimë për heqjen e gradave etj., etj. Këto vendime historike të Komitetit Qendror nuk ishin të kopjuara nga kinezët, siç mund të mendojnë disa njerëz, por ishin vendime të diktuar nga kushtet konkrete të vendit tonë për revolucionarizimin e jetës në ushtri.

Kuadro të lartë dhe sidomos ata të sëmurë nga koncepte e prirje të huaja, nuk i pranuan këto vendime. I pranuan ato me gjysmë goje. më në fund në dukje i pra-

nuan se nuk kishin ç'të bënin, por, në fakt, ata ishin kundër. E gjithë ushtria dhe kuadrot e ulët dhe të mesëm këto vendime i pranuan me entuziazëm. Masat që mori Partia nuk mbetën pa efekt as në shumë kuadro të lartë të devotshëm, që reflektuan dhe u bindën për drejtësinë e tyre. Këtu u bë diferencimi në mes elementëve armiq dhe kuadrove të devotshëm.

Kuadrot armiq, si Beqir Balluku, Petrit Dumja, Hito Çakoja e disa të tjerë, duke u maskuar pas të gjitha atyre rrethanave që analizova përpara, vazhduan më me egërsi punën armiqësore kundër Partisë dhe pushtetit të proletariatit. Ata organizonin komplotin që shpjegova, të cilin Komiteti Qendror e zbuloi dhe e demaskoi. Kështu shpjegohet dobësimi i organizatës së Partisë në ushtri, kështu shpjegohen frika dhe druajtja që kishin kuadrot oficerë për të hapur gojën dhe për të folur, kështu shpjegohen veset e sëmura, por të shërueshme, të disa kuadro të lartë dhe të mesëm të ushtrisë, kështu shpjegohet degjenerimi i pashërueshëm dhe tradhtia e dënueshme pa asnjë mëshirë e komplotistëve.

Si konkluzion i gjithë këtyre që thamë, Partia duhet t'i përvishet punës për të riparë mirë dhe për ta ndrequr këtë situatë, por këtë herë lypset të ndreqet rrënjësisht dhe në atë mënyrë që të mos përsëritet më. Për t'ia arritur këtij qëllimi duhet të kemi parasysh eksperiencën e madhe të Partisë dhe sidomos punën armiqësore të titistëve jugosllavë dhe të agjenturës së tyre, me Koçi Xoxen e Pandi Kriston me shokë. Të gjitha konkluzionet për këtë problem i ka tërhequr prej kohësh Partia. Atyre shokëve që nuk i kanë parasysh

këto, se gjoja «i dinë, se i kanë jetuar», ose atyre që «i kanë lexuar (dhe jo studiuar) si histori e kaluar», u rekomandoj t'u rikthehen, t'i ristudiojnë dhe jo vetëm t'i rilexojnë.

Unë do të ndalem këtu vetëm në disa konkluzione që ka nxjerrë Partia nga kjo punë armiqësore. Revizionistët jugosllavë kishin për qëllim inkudrimin e Shqipërisë në Republikën Federative Jugosllave, gjë që do të thoshte likuidimin dhe zhdukjen e lirisë dhe të sovranitetit të atdheut tonë. Ky objektiv strategjik i titistëve maskohej me parulla pseudosocialiste, me parulla të ashtuquajtura marksiste-leniniste. Taktikat kryesore që ata përdorën qenë: «Vija e Partisë sonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ka qenë e gabuar, udhëheqja kryesore e Partisë kishte gabuar, prandaj ajo duhej zëvendësuar; Partia pas Çlirimit duhej të binte në gjysmegaliteti dhe në plan të parë të dilte Fronti Nacionalçlirimtar» dhe, që të shkonin këto siç donin jugosllavët, Ministria e Punëve të Brendshme duhej të drejtonte Partinë. Në këtë ministri ishte agjentura e jugosllavëve, me Koçi Xoxen në krye. Jugosllavët dhe Koçi Xoxja donin ta likuidonin Partinë, ta reduktonin rolin e saj të madh në një organ të thjeshtë agjenturor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, çerdhe agjenturore e jugosllavëve. Duke kaluar nga këto premisa, këta armiq të brendshëm dhe të jashtëm përpiqeshin të arrinin në qëllimet e tyre finale, por, për arsyet që dimë, ata nuk i arritën dot këto qëllime.

A ka analogji kjo me punën armiqësore të Beqir Ballukut, të Hito Çakos dhe të Petrit Dumes? Qëllimi strategjik është po ai si i jugosllavëve me Koçi Xoxen

e kompani. Disa taktika ndryshojnë, se, natyrisht, edhe situatat aktuale ndryshojnë nga ato të asaj kohe.

Sot as revizionistët jugosllavë, as ata sovjetikë nuk ndodhen në vendin tonë që të organizojnë vetë komplotin nga brenda me klikën e Beqir Ballukut, të Petrit Dumes dhe të Hito Çakos. Lidhjet e kësaj klike me armiqtë e jashtëm janë të padukshme ose sekrete. Po që lidhje ekzistojnë, për këtë s'ka asnjë dyshim. Pra, klika aktuale antiparti, në ndryshim me klikën e Koçi Xoxes, ka qenë e detyruar ta organizonte vetë komplotin.

Karakteristike është se jugosllavët dhe klika e Koçi Xoxes shkonin nga rruga: «Të ulnin aktivitetin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, ta futnin këtë në ilegalitet dhe ta kthenin në një agjunkturë të thjeshtë». Kurse klika e Beqir Ballukut, e Hito Çakos dhe e Petrit Dumes nuk mund të ndiqte këtë rrugë, pse Partia nuk ishte më ajo Parti e re e dikurshme e asaj kohe, Partia e Punës e Shqipërisë sot është shumë e fortë nga çdo pikëpamje, nën udhëheqjen e saj socializmi në vendin tonë po ndërtohet me sukses. Kjo klikë nuk mund ta shkatërronte Partinë tonë, siç u orvat të bënte Koçi Xoxja me format organizative që përdori. Klika e Beqir Ballukut ndoqi kështu një rrugë tjetër nga ajo e Koçi Xoxes. Ky dhe jugosllavët mendonin të kalonin në objektivat e tyre finalë në «mënyrë paqësore», kurse klika e Beqir Ballukut nuk mund t'ia arrinte qëllimit me këtë rrugë «paqësore», pse nuk mund ta nënshtronte dot gjithë Partinë, siç synonte Koçi Xoxja. Pra, Beqir Ballukut, Hito Çakos dhe Petrit Dumes nuk u mbetej rrugë tjetër veç asaj të puçit ushtarak, ala Bonapart, ala Hrushov-Zhukov.

Sfera e punës komplotuese e Beqir Ballukut e kom-

pani ishte pra ushtria. Siç shihet, tendenca e komplotit të jugosllavëve dhe të Koçi Xoxes ishte ta zgjeronin fushën, kurse ajo e Beqir Ballukut, e Hito Çakos, e Petrit Dumes ishte ta ngushtonin në fillim në ushtri, ku veprohej me një punë konspirative të maskuar me parulla partie e marksiste-leniniste.

Jugosllavët, siç e dimë, qëllimet që kishin u orvatën në atë kohë t'i realizonin me sjelljen e divizioneve të tyre të ne<sup>1</sup>, po këtë nuk e arritën dot. Edhe klika e Beqir Ballukut, para se të shpërthente puçin apo pas. këtë do të bënte. Por mbetet, gjithashtu, për t'u zbuluar se kush nga jashtë do ta mbështeste puçin e tij. Dhe një gjë duhet të jetë e sigurt, se puçistët ishin të bindur që do të gjenin rezistencë të ashpër nga Partia, nga ushtria vetë dhe nga gjithë populli, prandaj, pavarësisht se janë fashistë dhe aventurierë, puçistët nuk mund të mos llogaritinin ndihmën e huaj nga jashtë.

Nga sa thashë më lart duhet të konkludojmë se jugosllavët dhe Koçi Xoxja donin t'ia arrinin qëllimit duke i dhënë dhe duke përqendruar fuqinë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe këtej të likuidonin Partinë ose ta bënin këtë të pafuqishme, kurse klika e Beqir Ballukut përqendronte nga ana e vet fuqinë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe synonte të izolonte ushtrinë dhe organizatën e saj të Partisë nga gjithë Partia për të paralizuar Partinë e Punës të Shqipërisë me anën e një puçi ushtarak.

Tash le të nxjerrim një konkluzion tjetër, që del

---

1. B. Balluku ka pohuar se që në atë kohë kishte rënë dakord me titistët jugosllavë për ardhjen e këtyre divizioneve në Korçë nën pretextin se do të na sulmonte Greqia.

nga analizat që po bëjmë, por duhet thënë se analizave t'u shkojmë në thellësi dhe jo t'u qëndrojmë në sipërfaqe.

Më lart shpjegova një sërë çështjesh, shtrova shumë konstatime, dhashë edhe shpjegime, por, si të thuash, nuk isha plotësisht i kënaqur nga arsyet që shpjegova «Përse na ngjau kjo çështje në ushtrinë tonë, ku ne kishim kuadro të luftës nga më të mirët?», «Pse Komiteti Qendror u mbajt në errësirë, përse organizata e Partisë në ushtri nuk u tregua revolucionare, pse gati të gjithë kuadrot e lartë dhe të ulët e pranonin një gjendje kaq anormale dhe të sëmurë?», «Si ngjiste që çdo gjë, të gjitha direktivat e Partisë që shkonin në ushtri nga Komiteti Qendror dhe që ishin të drejta nuk zbatoheshin si duhet, nuk kuptoheshin si duhet dhe në analizën e fundit këto ose e humbisnin forcën revolucionare ose shtrembëroheshin?».

Shumë «pse» na dalin, të cilave ne jo se nuk u kemi dhënë përgjigje, bile të gjitha përgjigjet e dhëna janë të drejta, të bazuara, janë rezultat i një analize dialektike marksiste-leniniste, por vetëm kemi gabuar në diçka të rëndësishme dhe kjo është çështja organizative e ushtrisë dhe e Partisë në ushtri. Këtu kemi gabuar ne deri në analizën e fundit që bëmë, kur thashë se «Format organizative në ushtri i kemi drejt, ato duhet t'i mbajmë, por duhet studiuar vendosja e lidhjeve më të drejta me organizatën e Partisë të terrenit». Pikërisht, duke menduar se si do t'i konkretizojmë këto lidhje të drejta, më del ajo «që format organizative nuk kanë qenë drejt». Dhe fati i zbatimit të direktivës varet nga organizimi i mirë ose i keq i zbatimit të saj në jetë.

Ku qëndron ky gabim dhe ç'konsekuenca rrodhën prej tij. Le të ngjitemi në histori dhe, pra, në zhvillim.

Në kohën e luftës Partia ishte në udhëheqje të ushtrisë, Komiteti Qendror udhëhiqte, komitetet e Partisë ishin në komandë, organizatat-bazë ishin në rolin e vërtetë të tyre. Ne kishim në ushtri edhe komandant, edhe komisar, edhe zëvendëskomisar në një rang, në unitet. Mbi çdo gjë komandonte Partia dhe Komiteti i saj Qendror. Deri këtu çdo gjë ishte në rregull edhe nga ana ideologjike, edhe nga ana organizative dhe ushtarakisht dha rezultate të shkëlqyera. Këto ishin karakteristika të një ushtrie popullore, armë e Partisë, pra, armë e diktaturës së proletariatit.

Erdhi Çlirimi. Ushtria për Partinë ishte çështje kryesore, ajo duhej organizuar, duhej modernizuar, duhej armatosur, duheshin edukuar kuadrot etj., dilnin, pra, një mijë probleme. Dhe ne iu futëm punës për t'i zgjidhur të tëra, natyrisht, me aq sa dinim dhe me aq sa mundnim. Por një gjë dinim mirë dhe nuk lëviznim prej saj: Partia duhej të drejtonte ushtrinë. Mos harroni intrigat e jugosllavëve edhe në ushtri, intriga që kishin për objekt likuidimin e Partisë edhe nga udhëheqja e ushtrisë.

Pas likuidimit të punës armiqësore jugosllave dhe të Koçi Xoxes, model për ushtrinë tonë u bë Ushtria Sovjetike e udhëhequr nga Stalini. Në fytyrën e Ushtrisë Sovjetike ne organizuam ushtrinë tonë. Natyrisht, në masshtabin e ushtrisë sonë Partinë në ushtri e organizuam si në Ushtrinë Sovjetike. Mbi këtë bazë adoptuam ne njësoj format organizative të punës, lidhjet, edukimin etj., dhe me plot bindje të gjitha këto i konsideronim nga më të drejtat dhe s'kishte pse të mos



mendonim kështu, pse Ushtria Sovjetike ishte ushtria e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, ishte arma e diktaturës së proletariatit, ishte ushtria më e fuqishme në botë dhe kishte dalë triumfuese mbi hitlerianët. Ne dërguam kuadrot tanë për të mësuar në Bashkimin Sovjetik, na erdhën këtu edhe specialistë sovjetikë.

Gjatë zhvillimit të ushtrisë ne i suprimuam funksionet e komisarit dhe vendosëm komandën unike, pse kështu e kishtë Ushtria Sovjetike dhe ky vendim konsiderohej i drejtë nga ne. Ushtria mbetej «Ushtria e Partisë», mbetën organizatat-bazë siç ishin dhe Komiteti Qendror udhëhiqte. Po si udhëhiqte? Si në Ushtrinë Sovjetike. Nominalisht udhëhiqte Komiteti Qendror, ekzistonte Komandanti i Përgjithshëm, nuk kishte Këshill të Mbrojtjes, kishte ministër të Mbrojtjes, por që nuk jepte kurrë llogari si duhej e të plotë; kishte, gjithashtu, një Drejtori Politike që qëndronte në ushtri në krye të organizatës së Partisë. Kjo Drejtori Politike konsiderohej si një drejtori e Komitetit Qendror, lidhjet tona me të ishin reduktuar vetëm në takime me drejtorin politik, kurse nga ana shtetërore lidhjet mbahehin ministër me kryeministër. Asnjë organ nuk kishte Kryeministria për ushtrinë. Kur isha unë Kryeministër, ishte kështu, pse isha njëkohësisht edhe ministër i Mbrojtjes, por edhe më vonë gjendja ashtu mbeti. Ushtria dhe repartet e saj në terren asnjë lidhje nuk mbanin me Partinë dhe me komitetet e saj, asnjë lidhje nuk mbanin, gjithashtu, me komitetet ekzekutive.

Kjo ishte forma organizative dhe e drejtimit të ushtrisë nga ana e Partisë dhe nga ana shtetërore, kjo, pra, ishte e njëllajtë me atë sovjetiken dhe ne e kon-

sideronim më të drejtën, por na rezulton se ishte një formë e gabuar. Kjo formë organizimi dhe drejtimi çoi në izolimin e ushtrisë nga Partia dhe nga pushteti, diktatura e proletariatit. Organizata e Partisë në ushtri u izolua nga e gjithë Partia. Partia drejtonte në teori, pse në realitet udhëheqja e saj, me format organizative në fuqi, ia kishte dorëzuar çelësat Drejtorisë Politike dhe diktatura e proletariatit, pushteti, ia kishte dorëzuar çelësat komandës, me Beqir Ballukun në krye (domethënë ministër dhe anëtar i Byrosë Politike, në praktikë komandë unike).

Tash kuptohet qartë që kjo formë e gabuar organizimi ndihmoi elementët armiq që të zhvillonin përgatitjen e komplotit. Drejtorja Politike dhe udhëheqja kryesore e saj, qoftë Sadik Bektashi, qoftë Hito Çakoja e të tjerë, nominalisht dhe efektivisht u bënë udhëheqësit kryesorë të organizatës së Partisë në ushtri. Partia dhe Komiteti Qendror e humbën kështu drejtimin dhe kontrollin dhe këta armiq e izoluan këtë pjesë të Partisë nga gjithë pjesa tjetër e saj. Pra, u krijua «një parti në parti», që formoi të menduarit dhe të zbatuarit special të saj për sa u përket teorisë marksiste-leniniste, normave të Partisë etj.

Ministria e Mbrojtjes dhe udhëheqësit e saj kryesorë, me Beqir Ballukun, Petrit Dumen e të tjerë, e konsideronin ushtrinë si një fuqi shtetërore në shtet, si një shtet në shtet, me ligjet e saj, me të drejtat e saj.

Kjo klikë ushtarake, me Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon, e forcoi në këto rrethana akoma edhe më shumë izolimin e organizatës së Partisë dhe të tërë ushtrisë dhe kujtoi se u bë kështu zot i plot-fuqishëm në ushtri. Në këto kushte dhe me të tilla pikë-

pamje këta të tre krijuan në fakt një fraksion në udhëheqjen e Partisë dhe ky fraksion antiparti «udhëhiqte» ushtrinë dhe organizatën e Partisë në rrugën e puçit: ushtarak për rrëzimin e Komitetit Qendror, të Qeverisë, për likuidimin e Partisë dhe për kthimin e saj në parti revizioniste dhe vendin tonë socialist në një vend kapitalist.

Tash besoj se është e qartë përse ishin këta armiq kundër demokratizimit të ushtrisë, kundër zhdukjes së gradave dhe të komandës unike, përse nuk pranuan, në fakt dhe në teori, Shkollën e Lirë Ushtarake. Këta panë se me Letrën e Hapur ne po riktheheshim në Ushtrinë e vërtetë Popullore të udhëhequr nga Partia, në ushtrinë si një armë e proletariatit në të gjitha tiparet e saj.

Këta armiq trockistë revizionistë ishin vendosmërisht në luftë me vendimet e Komitetit Qendror dhe, në pamundësi që të luftonin haptazi, vazhduan luftën në forma të tjera. Këta qëndruan «zotër» si më parë në ushtri dhe mbi organizatën e Partisë e shtuan akoma më shumë zullumin, shtypjen, deformimin, degjenerimin dhe u futën në rrugën e komplotit dhe të puçit fashist.

Komiteti Qendror dhe unë si Sekretar i Parë, nuk pamë defektin organizativ të drejtimit dhe të kontrollit të ushtrisë nga ana e Partisë; Komiteti Qendror dhe Qeveria qëndruan në vend, kur, me masat që morëm, ecnim përpara. Masat që mori Komiteti Qendror për ushtrinë ishin të drejta, marksiste-leniniste, kurse format e organizimit jo vetëm ishin të vjetruara, por, në dritën e këtyre ngjarjeve, mund të themi se ishin edhe të gabuara.

Tash besoj se bëhen të qarta edhe të gjitha ato konsiderata politiko-ideologjike që kam bërë gjatë gjithë kësaj analize, marrin përgjigje edhe «psetë» që bëjnë. Dëshiroj të theksoj, gjithashtu, se, po të bëni kujdes në fjalimet që kam mbajtur më parë për këtë problem, do të konstatoj se si një çështje që nuk ka qenë e qartë plotësisht më parë, bëhet më e qartë një çikë më vonë. Aktivitetet dhe mbledhjet në ushtri na japin fakte, na sqarojnë situatën dhe unë kam dashur të lë të duket ky zhvillim dialektik edhe në mendimet e konkluzionet që po nxjerr.

Le ta shikojmë këtë punë armiqësore të Beqir Ballukut, të Petrit Dumes dhe të Hito Çakos në prizmin e ngjarjeve që ndodhën në Bashkimin Sovjetik në kohën e Stalinit dhe pas vdekjes së tij. Një punë armiqësore e tillë në Bashkimin Sovjetik të paktën u zhvillua dy herë me fate të ndryshme për komplotistët. Herën e parë ata dështuan, herën e dytë fituan. Herën e parë dështoi komploti i Tukaçevskit dhe i gjeneralëve, të cilët shkuan në gjyq dhe u pushkatuan. Ne e njohim atë situatë nga zhvillimi i proceseve të Moskës. Për ne proceset ishin të drejta dhe tradhtarët morën dënimin e merituar. Stalini ishte një revolucionar i madh marksist-leninist, Partia Bolshevike ishte vigjilente dhe e zbuloi komplotin. Faktet këto janë. Po si punonte Partia Bolshevike në ushtri? Si i kishte ajo lidhjet e një sërë çështjesh të tjera si këto, ne nuk i dimë. Mundet që këto të ishin në bazë të normave leniniste.

Borgjezia kapitaliste ngriti zërin në qiell, kur u pushkatuan Tukaçevski dhe shokët e tij tradhtarë dhe agjentë të të huajve. Këta agjentë i kishin shkaktuar dëme të rënda Ushtrisë së Kuqe dhe këto dëme u dukën

më vonë. Me gjithë sforcon e madhe që bënë Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik dhe Stalini për të forcuar Ushtrinë Sovjetike, sulmi gjerman e gjeti Bashkimin Sovjetik dhe ushtrinë e tij jo të përgatitur si duhej. Imperializmi dhe hrushovianët mbrojnë tezën se Stalini preu «kokat e mëdha të ushtrisë dhe e dobësoi Ushtrinë Sovjetike». Kjo, natyrisht, është shpifje. Prerja e kokës së Tukaçevskit e forcoi Ushtrinë Sovjetike, puna tradhtare e tij e kishte dobësuar Ushtrinë e Kuqe, së cilës iu desh kohë që të merrte veten, por më në fund ajo e mundi Gjermaninë hitleriane. Pra, komploti i parë i Tukaçevskit kundër Bashkimit Sovjetik dështoi.

Komploti i dytë i revizionistëve hrushovianë fitoi. Si u përgatit, si u vu në veprim puçi dhe si fitoi, e dimë. Ne, gjithashtu, dimë ç'rol luajtën Ushtria Sovjetike dhe krerët e saj si Zhukovi, Konjevi, Malinovski e të tjerë. E marrim me mend se si e kishin katandisur ata organizatën e partisë në ushtri, pse tash kemi edhe pasqyrën e asaj ç'kishin bërë dhe ç'po bënin puçistët shqiptarë në organizatën e Partisë të ushtrisë sonë. Ndërsa në Bashkimin Sovjetik e gjithë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik kishte marrë rrugën e degjenerimit, te ne puçistët trockistë, Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, jo vetëm që nuk kishin guxuar ta preknin Partinë tonë, por edhe në ushtri i kishin rrënjët mbi ujë. Organizata e Partisë në ushtri, pavarësisht nga gabimet, ishte me Partinë deri në fund.

Në Bashkimin Sovjetik, për arsyet që thamë, fitoi puçi i hrushovianëve. Kurse puçi i Beqir Ballukut, i Petrit Dumes dhe i Hito Çakos në vendin tonë dështoi. Ne duhet të nxjerrim konkluzione nga këto ngjarje.

Partia Bolshevike dhe Stalini e shkatërruan komplotin e Tukaçevskit, por pas Luftës së Dytë Botërore, dhe sidomos pas vdekjes së Stalinit, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik e humbi vigjilencën, në të u shkëlën normat e saj dhe në vend të tyre u vendosën norma të tjera me brendi antimarksiste dhe rezultoi ajo që dimë.

Te ne puçistët revizionistë, Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja, të frymëzuar nga hrushovianët, dështuan, ata u zbuluan nga Partia dhe duhet t'i jepen gjyqit. Por këta puçistë, ashtu si Tukaçevski në Bashkimin Sovjetik, na e kanë dobësuar ushtrinë, prandaj na vihet detyrë e ngutshme për të marrë masa serioze që nesër të mos na ngjasë ashtu siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore, sidomos pas vdekjes së Stalinit. Dhe, që të mos na ngjasë e njëjta gjë, ushtria jonë duhet të vendosë në çdo çështje normat leniniste, Partia kudo në ushtri të vihet në udhëheqje, të hidhen poshtë menjëherë format organizative të vjetruara dhe të gabuara të drejtimit dhe të kontrollit dhe të vendosen forma të reja efikase, revolucionare marksiste-leniniste. Karakteri, ideologjia, organizimi dhe çdo gjë tjetër në ushtrinë tonë duhet t'u përshtaten direktivave të Partisë, ato të jenë të frymës së një ushtrie popullore, të një arme të vërtetë të diktaturës së proletariatit që udhëhiqet në çdo gjë nga ideologjia marksiste-leniniste.

Partia dhe Komiteti Qendror duhet të shohin një nga dobësitë kryesore të punës, që u duk shumë e theksuar dhe shumë e rrezikshme në ushtri, në çështjen e edukimit ideopolitik.

Për ato që na ngjanë në ushtri, pa folur për punën

armiqësore të grupit të Fadil Paçramit, një nga burimet kryesore duhet ta gjejmë në ngritjen shumë të dobët ideologjike të kuadrove ushtarakë në shkallë të gjerë. Edukimin ideologjik duhet ta konsiderojmë një nga çështjet më serioze, kyç për të gjitha problemet në ushtri dhe në gjithë Partinë në përgjithësi. Nuk duhet të flemë mendjen dhe të themi se komunistët po edukohen, se ata kanë në duart e tyre materialet e klasikëve, dokumentet e shumta të Partisë, se kemi shkollë partie nga e cila dalin kuadro, që edhe këta mësojnë kuadro të tjerë. Është e vërtetë që të gjitha këto i kemi dhe japin rezultate, por çështja qëndron sa përfitohet, sa kuptohen, sa bluhën dhe sidomos si lidhen me jetën dhe me punën këto mësimë? Pikërisht kjo ka qenë jash-tëzakonisht e dobët në ushtri.

Duhet bërë një analizë e thellë marksiste-leniniste në këtë drejtim dhe të dalim me konkluzione. Nuk është e mjaftueshme të themi vetëm se këtë situatë në ushtri na e shkaktoi puna armiqësore e Beqir Ballukut e kompani. Kjo është një e vërtetë dhe ka bërë efektin e vet shumë minues në këtë drejtim, për arsye se terrenin e gjeti të dobët dhe e dobësoi edhe ca më shumë, por tash që ne po i spastrojmë këta armiq nga ushtria, të mos mendojmë se vetëm me këtë veprim çdo gjë do të rregullohet.

Çështjet se «Partisë në ushtri ia kishin hipur në zverk hierarkia ushtarake, prepotenca, frika» etj., etj. të gjitha këto ne i analizojmë drejt, mund të tjerrim edhe definicione për secilin nga këta terma, të rekomandojmë edhe se s'duhet të përsëriten më, por të mos kufizohemi me kaq, të mos kujtojmë se me një punë të përciptë formulash kuadrot e ushtrisë i kemi ngritur

ideologjikisht. Jo, të mos kemi iluzione pa e kapur problemin nga brirët dhe t'i futemi thellë studimit të ideologjisë sonë.

Duke u bazuar në analizat që po bëjmë për ushtrinë, arrijmë në disa konkluzione të hidhura, se kuadrot në ushtri e kishin lënë shumë pas dore edukimin e tyre ideologjik dhe atë politik. Në ushtri kujtohej se edukimin ushtarak e kishin vënë në vijë, por edhe në këtë drejtim kuadrot kanë boshllëqe të mëdha, qoftë në njohjen dhe përdorimin e teknikës ushtarake, por sidomos në kuptimin e artit ushtarak në platformën e teorisë marksiste-leniniste dhe, kur them në platformën marksiste-leniniste, nuk kuptoj aspak mësimin e disa formulave. Formulatat dhe citatet harrohen, po nuk i hyre në thelb ideologjisë marksiste-leniniste, e cila të orienton në çdo situatë.

**Mjaft kuadro ushtarakë kanë nënvleftësuar pikërisht studimin e ideologjisë marksiste-leniniste.** Jo vetëm studimin e veprave të klasikëve tanë të mëdhenj, por ata nuk studionin as materialet e Partisë sonë që janë të kuptueshme për ta. Unë dyshoj që edhe shtypin e përditshëm nuk e lexonin kuadrot në ushtri dhe të orientoheshin prej tij. Se të çudit fakti: Si harruan këta kuadro ç'është Partia dhe e katandisën këtë në një kuptim simbolik? Si e harruan këta kuadro ç'janë normat e Partisë dhe kuptimin e tyre teorik? Si këta kuadro dolën dhe u larguan nga boshti ideologjik i Partisë sonë? S'ka tjetër shpjegim veç atij se ky studim, ky edukim, nuk bëhej si duhej, ai ishte shumë formal, ishte reduktuar në një rutinë shumë të keqe dhe kjo punë as kontrollohej, as korrigjohej, as ndihmohej si duhej.



Pa hequr edhe ne përgjegjësinë tonë si Byro Politike dhe Komitet Qendror, duhet njohur haptazi se sektorët e organizimit dhe të agjitacionit e të propagandës të Komitetit Qendror kanë përgjegjësi në këtë drejtim. Fakt është se Drejtoria Politike e Ushtrisë, organizatat e Partisë në ushtri, komisarët dhe komunistët kanë përgjegjësi të madhe edhe ata që kjo çështje u la të ndiqte një rrugë kaq formale, plot me gabime dhe me shmangie të rënda.

Nga nënvleftësimi i materialeve të klasikëve dhe të Partisë sonë në ushtri u krijua një vakuum i madh, saqë këto u zëvendësuan me materialet e revizionistëve sovjetikë. Ky zëvendësim nuk erdhi vetvetiu dhe nuk është vetëm personi i Hito Çakos që e solli këtë gjë. Ky, si armik, e zgjeroi hendekun, përfitoi nga mungesat që thashë dhe punoi me sistem dhe me armiqësi të egër nga ana e vet, por punëtorët politikë në ushtri, komisarët e të tjerë, as që e vinin ujët në zjarr që nga gjithë veprat e materialet e klasikëve e të Partisë sonë të bënin studime, të thelloheshin, të formulonin libra e referate, të hartonin programe të sakta dhe të demaskonin këtë punë armiqësore. Jo, shumë nga këta shokë kishin sajuar nga një shkrim bajat, i cili u shërbente, si të themi, për dhjetë vjet me radhë. Ngrihej dhe fliste tjetri pa qeder! Atë leksion që ai këndonte sivjet, e këndonte edhe mot, pavarësisht se jeta dhe ngjarjet rridhnin si një lumë i rrëmbyer. Mbanin udhëheqësit nga një fjalim, ku shpjegonin probleme dhe situata, punëtorët politikë në ushtri i lexonin përçiptas, përhapnin pikëpamjen se «ishin të kuptueshme» dhe nuk e shihnin të nevojshme t'i komentonin, t'i thëllonin, t'i zbërthenin ato. Jo, dhe kur e bënin, këtë e bënte Beqir

Balluku, Hito Çakoja dhe Petrit Dumja me të vetmin qëllim që të zëvendësonin fjalimet e udhëheqësve me të tyret, t'i shtrembëronin ato nga ana ideologjike dhe kuadrot i hanin këto shtrembërime.

Kjo ishte një punë tmerrësisht e keqe. Pa e ndryshuar rrënjësisht këtë punë të keqe, dhe kjo është një nga kryesoret që duhet të kryejmë, të jemi të sigurt se nuk mund të na shkojnë mirë punët në ushtri. Ne do t'i spastrojmë armiqtë, por po nuk bëjmë atë që thashë më lart, domethënë, të vëmë në baza të drejta dhe të shëndosha edukimin ideologjik dhe politik, fryma e sëmurë do të ngelë në njerëzit. Ne mund të ngremë kuadro të rinj, por, po të mos vëmë drejt në vend atë që thashë, këta do të na sëmuren përsëri. Ne mund të bëjmë riorganizime të mira, por në rast se nuk do të punojmë për të edukuar kuadrot, këta nuk do të na shërbejnë siç do Partia.

Kur themi të ngremë kuadro të rinj në ushtri, të dërgojmë atje kuadro nga gjatë etj., kemi për qëllim të forcojmë Partinë në ushtri. Por këtë forcim ne duhet ta kuptojmë drejt dhe jo në forma skematike. Një nga kuptimet e tij kryesore është puna për edukimin ideologjik marksist-leninist të komunistëve. Këtej varet çdo gjë. Të mos kujtohet se është e mjaftueshme që bëhen mbledhjet e organizatave-bazë në rregull, që ka kritikë e autokritikë, që respektohen normat, disiplina dhe shumë të tjera. Këto gjëra do të bëhen mirë pikërisht po të kuptohet pseja, në qoftë se kuptohet se këto janë format e organizimit dhe ligjet për t'u hedhur në luftë për një ide të madhe që është ndërtimi i socializmit, mbrojtja e tij, lufta për fitoren e revolucionit në vendin tonë; në qoftë se kuptohet se është marksi-

zëm-leninizmi ajo shkencë, ajo teori që na mëson si t'i kuptojmë këto dhe si të luftojmë për to, në qoftë se kuptojmë se është Partia jonë, lufta e saj, dituria e saj që na i mëson këto gjëra. Në rast, pra, se ne nuk mësojmë kryesoren, dhe kjo ka rëndësi, formulat mbi disiplinën, normat etj., mbeten formale.

Shumë shokë të Partisë në ushtri, por edhe mjaft në terren, u japin më shumë rëndësi formalizmave sesa thelbit të këtyre gjërave, sesa edukimit. «Të studioj e kam të zorshme», thonë mjaft komunistë, po ata nuk mendojnë aspak se këto pikëpamje janë të dëmshme dhe se bëjnë gabim të madh kur flasin dhe veprojnë kështu. Nuk është hera e parë që flasim për këto gjëra. mirëpo çështja që na ngjau në ushtri duhet të na bëjë t'i vëmë gishtin kokës.

Prandaj çdo gjë, për sa i përket edukimit ideopolitik, për sa u përket përgatitjeve në këtë drejtim duhet të ndryshojë rrënjësisht në ushtri. Por ta kemi mirë të qartë se këtë nuk do ta ndreqë vetëm krijimi i një seksioni në Shkollën e Partisë «V.I. Lenin», nuk do ta ndreqin as disa kuadro që do të dërgojmë, të cilët duhet të dimë t'i zgjedhim pikërisht për qëllimet kryesore që themi, as vetëm kontrolli dhe ndihma e aparatit të Komitetit Qendror, që duhet të ndryshojë krejtësisht punën në sensin pozitiv për sa i përket çështjes ushtarake, por, të ndihmuar fuqimisht nga të gjitha këto masa, situatën duhet ta shërojmë dhe ta shëndoshim me organizatën e Partisë në ushtri, me organizatat-bazë, me komitetet e Partisë, me komisarët, me komandantët, me organizatën e rinisë, me të gjithë kuadrot që Partia duhet t'i forcojë dhe t'i kalitë.

Optimistë duhet të jemi, revolucionarë duhet të

jemi, në sulm duhet të punojmë për t'i dalë mbanë kësaj pune, po jo të bëjmë punë për bujë, jo në sipërfaqe, por të punojmë thellë, thellë, shokë, ndryshe ka rreziqe për Partinë dhe për socializmin. Kjo çështje që ngre për ushtrinë, është, mendoj, deri në njëfarë shkalle dhe për gjithë Partinë, edhe për organet e pushtetit, është edhe për organizatat e masave, të cilat duhet të zbatojnë si duhet një nga detyrat kryesore të tyre, edukatën ideopolitike të punonjësve.

Me këtë rast dëshiroj të theksoj që këto organizata të masave janë dhe duhet të jenë nën drejtimin e Partisë dhe kur them nën drejtimin e Partisë, kuptoj jo vetëm Komitetin Qendror dhe aparatit e tij, jo vetëm komitetet e Partisë dhe aparatet e tyre, por edhe organizatat-bazë, sidomos, edhe grupet e komunistëve. Për programet e edukimit, për mënyrat dhe format e propagandës, për gazetat dhe për revistat që nxjerrin, është e vërtetë se ato vetë janë përgjegjëse, por kontrolli dhe ndihma nga lart duhet të jenë të vazhdueshme dhe kjo ndihmë duhet t'u jepet dhe ato duhet ta kërkojnë. Nga tendenca e mendjemadhësisë dhe e pavarësisë së sëmure që u vërtetua në ushtri duhet të bëjnë shumë kujdes udhëheqësit e këtyre organizatave. Të mos harrojnë dhe të mos nënvleftësojnë rolin e Partisë dhe ta konsiderojnë këtë vetëm si simbol, kurse organizatat e tyre t'i konsiderojnë si «parti», se kjo përbën një devijim të rrezikshëm.

Studimi me rrënjë i materialeve të Partisë dhe praktikave e saj janë të vetmet ilaçe që s'na lënë të biem në shmangie të rrezikshme. Prandaj të kemi kujdes dhe të analizojmë seriozisht herë pas here punën dhe, kur them të bëjmë analizë serioze, kuptoj, në mes të tje-

rash, faktin që të lëmë dhe të krijojmë atë situatë që njerëzit të shprehin lirisht mendimet. Kjo duhet të bëhet edukatë.

Përveç masave të tjera, që ne duhet të marrim për përmirësimin e punës në ushtri, mendoj se ne duhet të bëjmë edhe këto ndryshime në ushtrinë tonë:

1. Të suprimojmë Drejtorinë Politike të Ushtrisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe drejtimi i punës së Partisë në ushtri të bëhet drejtpërsëdrejti nga Komiteti Qendror nëpërmjet aparatit të tij, i cili duhet të interesohet edhe për organizatat e Partisë të ushtrisë një-lloj si për ato të terrenit, të mbajë lidhje të drejtpërdrejta me të gjitha komitetet e Partisë të ushtrisë, siç mban me komitetet e Partisë të rretheve. Kjo masë nuk ka të bëjë me një ndryshim të thjeshtë organizativ, por, në radhë të parë, me një ndërrim koncepti ideologjik, me një ndryshim rrënjësor në punën e Partisë në ushtri. Drejtoria Politike ishte kthyer në një bisht të ish-ministrit dhe ish-shefit të shtabit, se ajo gjoja përfaqësonte Partinë në ushtri, por në realitet ajo përfaqësonte atje puçistët, të cilët, për të realizuar punën e tyre armiqësore, e kishin shndërruar këtë organ në një aparat «partie» të tyre dhe fraksionistët, «komiteti qendror» i ushtrisë, e kishin bërë si aparatit e tyre «të komitetit qendror» fraksionist.

Një Drejtori Politike e Ushtrisë si kjo, me të tilla koncepte revizioniste, e kishte izoluar krejt organizatën e Partisë në ushtri nga pjesa e madhe e Partisë dhe nga udhëheqja e saj, Komiteti Qendror. Kjo Drejtori Politike e kishte çorientuar Partinë në ushtri, kishte futur në organizatat e Partisë atje metodat më të urryera të një ushtrie borgjeze pretoriane. Ajo luftoi me të

dyja duart principet dhe orientimet që përmbante Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë. Kjo drejtori i kishte bastarduar të gjitha normat e Partisë dhe, nën pretekstin se «Ushtria është ushtri», se «Disiplina është disiplinë», se «Urdhri është urdhër (*Befehl ist Befehl*) dhe, pra, duhej të zbatohet», se «Urdhri i komandantit duhej të zbatohet», se «Duhej ruajtur prestigji i komandës, pra, i komandantit, i ushtrisë» etj., i shndërroi të gjitha orientimet e Partisë në parime të një ushtrie borgjeze, ku në të gjitha hallkat lulëzuan hierarkia, arroganca dhe prepotenca e kuadrove. Sa më lart të ngjiteshe në këtë hierarki të ushtrisë, aq më tepër arrogancë dhe metoda pretoriane do të gjeje. Për shumë kuadro të lartë Partia dhe normat nuk ekzistonin, nga kjo anë çdo gjë në ushtri ishte formale. Kjo gjendje krijoi shtresa të ndryshme në kuadro, shtresa me privilegje të shkallëzuara.

E tillë ishte shndërruar Drejtoria Politike, e cila me Hito Çakon dhe me Sadik Bekteshin në krye, në bashkëpunim të ngushtë me Beqir Ballukun dhe me Petrit Dumen dhe të gjithë së toku si «komitet qendror» fraksionist dobësuan gjithë Partinë në ushtri, duke hedhur poshtë teorinë e Partisë sonë dhe duke e zëvendësuar atë me teorinë revizioniste sovjetike dhe kapitaliste. E tillë u bë Drejtoria Politike në ushtri, prandaj është e domosdoshme dhe imperative masa që propozojmë të merret, që çdo gjë në ushtri të sillet në normat e Partisë, duke ndryshuar rrënjësisht konceptet e gabuara.

Tash punën e kësaj drejtorie do ta bëjnë aparatet e Komitetit Qendror, të cilat do të mbajnë lidhje me Partinë në ushtri, do të ndihmojnë dhe do të kontro-

llojnë atje organizatën e Partisë, do të sjellin në Komitetin Qendror gjendjen e kësaj organizate dhe do të çojnë në ushtri ndihmën e Komitetit Qendror. Për ta kryer këtë punë, natyrisht, aparatet e Komitetit Qendror do të kenë nevojë për disa kuadro, por këta, që do të sillen për të punuar në këto aparate për ushtrinë, nuk do të quhen më kuadro ushtarakë, pavarësisht se mund të merren nga ushtria, por punëtorë partie, si gjithë të tjerët që janë këtu. Dhe puna e Partisë, ideologjia, ligjet dhe normat e saj janë kudo njësoj, prandaj të mos mendohet se ato të ushtrisë qenkan «specifike», siç i kishte ndërruar Hito Çakoja, ky agjent i revizionistëve sovjetikë, për të cilin kishte një materializëm të veçantë për ushtrinë, një psikologji të veçantë.

Në ushtri qëndron në udhëheqje Partia me organizatat-bazë, me byrotë dhe me komitetet e Partisë, me komisarët dhe me sekretarët e komiteteve të Partisë, të cilët, në qoftë se nuk i kemi, mendoj t'i krijojmë. E tërë Partia në ushtri të marrë punën sa më parë dhe si duhet në dorë, të zbatojë si duhet normat e saj, të ruajë kompetencat e gjithsecilit dhe të çdo organi dhe të lidhë punën politike dhe ushtarake në një unitet të harmonishëm marksist-leninist revolucionar. Të mos harrojmë se Partia në ushtri ka dy detyra kryesore: të edukojë dhe të lartësojë politikisht, ideologjikisht ushtarët dhe kuadrot dhe t'u mësojë atyre si duhet të përvetësojnë artin ushtarak në tërësi. Këto janë dy detyra kryesore të mëdha, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, në funksion të njëra-tjetrës dhe jo «Njëra t'i bjerë gozhdës, tjetra potkoit», jo të na thuhet se «Njëra shkon mirë, tjetra shkon keq». Në qoftë se «Njëra shkon

mirë dhe tjetra jo mirë», atëherë Partia duhet të vihët në alarm, pse do të thotë që të dyja këto anë nuk shkojnë në mirë. Ç'na ngjau, na e provon këtë.

Çdonjëri në ushtri duhet të shihet me frymë partie se si e kryen detyrën. Je korrekt me Partinë, i kryen mirë të dyja detyrat dhe si duhet? Kjo ka rëndësi, posti që zë në ushtri është një funksion, një detyrë dhe jo një «ofiq» për të sunduar jashtë ligjeve dhe normave të Partisë dhe rregulloreve të ushtrisë, të cilat, e çdo gjë tjetër, i ka vendosur Partia. Edhe kuadrin, në postin që ka, e ka vendosur Partia për të kryer si duhet detyrën që i është ngarkuar.

Edhe në komitetet e Partisë në rrethe mendoj të krijojmë një sektor për ushtrinë, me detyra analoge si në aparatit e Komitetit Qendror. Komiteti i Partisë në rreth duhet të ketë kompetenca dhe detyra në drejtim të reparteve që janë të dislokuara në rreth, jo vetëm për ato të ushtrisë efektive, por edhe të Shkollës së Lirë Ushtarake, e cila të organizohet si duhet. Ne duhet të punojmë që të përcaktojmë format e organizimit dhe të drejtimit të Shkollës së Lirë Ushtarake, pse Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja këtë e kishin sabotuar krejtësisht. Në çdo rreth ekziston edhe shtabi i mbrojtjes. Atij i duhen përcaktuar mirë funksionet dhe lidhjet me komitetin e Partisë, me komandat e reparteve dhe me komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Të gjithë këta organizma duhet të funksionojnë, të aktivizohen, të marrin kompetencat dhe t'i zbatojnë. Këtë ne kështu e kemi thënë, por nuk është bërë kështu,



prandaj pësimit të na bëhen mësim. Shihni ku na çuan formalizmi, moskryerja e detyrave si duhet, mungesa e kontrollit dhe moszbatimi si duhet i motos «Beso dhe kontrollo». Puçistët komplotonin, ata krijuan fraksionin në gjirin e Komitetit Qendror dhe në krye të ushtrisë. Kjo e keqe e madhe që u zbulua, tash duhet spastruar rrënjësisht dhe gjithë kjo që ndodhi, të na bëhet mësim.

Ngjarjet e ushtrisë duhet të na mprehin vigjilencën revolucionare dhe të na bëjnë jo një herë, por shumë herë të nxjerrim konkluzione për problemet që kemi shtruar, që u kemi dhënë zgjidhje dhe që janë duke u zbatuar.

A i kemi parë drejt problemet? A ka qenë e drejtë zgjidhja? Ka qenë vallë e përshtatshme forma organizative që u përdor për zbatimin e direktivës? Kjo analizë, sipas rëndësisë së problemit, duhet të bëhet herë pas here, sidomos në disa momente që mendohet se janë kyç, gjë që nuk duhet të harrohet, as të neglizhohet kurrë.

Mund të bihet në gabim duke thënë: «Ky problem është zgjidhur drejt një herë e mirë dhe s'ka nevojë t'i rikthehem». Ky mendim i vendosur *a priori* mund të jetë i gabuar, pra, para se të afirmohet, ai duhet kontrolluar dhe duhet verifikuar. Mund të kenë qenë të drejta në kohën që u vendosën edhe problemi, edhe format e organizimit, por situatat kanë nxjerrë probleme të reja dhe, lidhur me to, format organizative mund të mos i përshtaten më gjendjes. Në qoftë se këto nuk rishikohen, atëherë do të vërtetohen gabime.

Për shembull, Drejtorinë Politike të Ushtrisë ne e vendosëm, në qoftë se nuk gabohem, në vitin 1946, dhe

qenien e saj si dhe formën e organizimit nuk i rishikuam më vonë. Mirëpo ç'ngjau? Nga një Drejtori Politike ajo me kohë u kthye në një «komitet qendror» në ushtri, me «seksione të veçanta» në formë më të reduktuar, por në shembullin e ish-drejtorive të Komitetit Qendror. Dhe këtë situatë ne e pranuan, deri tash në fund që u zbuluan këto ndyrësira.

Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë në rrethe, dikasteret dhe organizatat e Partisë në ndërmarrje, duke njohur çka na ngjau në ushtri, dyshoj se reflektojnë si duhet dhe sa duhet dhe të procedojnë për të analizuar punët e tyre, të nxjerrin ç'probleme u dalin dhe në cilat drejtime duhet kontrolluar dhe duhen marrë masa për të shëruar gjendjen. Disa mund që thonë dhe të kënaqen: «Te ne nuk ka gjëra të tilla, te ne ka shfaqje, por sporadike, të izoluara, personale, kundër të cilave luftojmë çdo ditë». Mirëpo kjo nuk duhet të na kthehet në një rutinë. Disa të tjerë mund që thonë dhe të kënaqen duke pohuar: «Të poshtrit, na krimbën Partinë në ushtri, t'i dënojmë dhe disa t'i ndreqim!». Është lehtë të thuash: «T'i godasim dhe t'i ndreqim!», po kush do ta bëjë këtë? Natyrisht Partia. Por fakt është se Partia në rrethe, komitetet e Partisë dhe komunistët, nuk e kanë bërë si duhet detyrën, duke qitur mjaft arsyetime, se «ekziston kjo formë, kjo pengesë, se ajo është e lidhur me atë dhe kjo me këtë» dhe dalin në konkluzionin e gabuar: «Kjo nuk më takon mua, po të tjerëve».

Duhet të konkludojmë se ata që mendojnë dhe që veprojnë kështu, nuk thellohen sa duhet mbi ato detyra që janë edhe të tyre, prandaj nuk mund të lajnë aspak duart për ndihmën që duhej t'i jepnin ushtrisë.

Pra, konkludojmë se organet dhe organizatat e Partisë të terrenit duhet të thellohen mirë në problemet e ushtrisë dhe të mbrojtjes, të mendojnë e të organizojnë konkretisht punën për ndihmën që duhet t'i japin ushtrisë. Fakt është se asnjë informacion dhe asnjë konkluzion nuk i ka ardhur Komitetit Qendror nga Partia në terren për gabimet dhe fajet e ushtarakëve që rrojnë në terren. Asnjë informatë nuk i ka ardhur Komitetit Qendror as nga vetë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror. Vihet çështja: Atëherë ku duhet të mbështetet Byroja Politike e Komitetit Qendror? Mos vallë vetëm në aparatin e vet? Të gjithë mund të thonë: Jo! Atëherë përse nuk bëhet si duhet kjo detyrë? Të gjithë i njohin kompetencat, të gjithë e dinë se janë përgjegjës për vijën e Partisë dhe, si anëtarë të Komitetit Qendror, nuk është e vërtetë se ju jeni kufizuar vetëm në funksionet e punës së caktuar, ju e dini se duhet t'i kapërceni këto caqe. Në mënyrë naive disa thonë: «Po, kemi bërë gabim, të na këshillojë Komiteti Qendror». Po cili është Komiteti Qendror? Kush e përbën Komitetin Qendror? Kjo çështje është serioze. Te ndonjëri ekziston mentaliteti: «Ta bëjë Komiteti Qendror», «E ka vendosur Komiteti Qendror». Prandaj ndodh që ndonjë anëtar i Komitetit Qendror, anëtarë të plenumeve të komiteteve të Partisë në rrethe, me gjithë detyrat dhe të drejtat që përcakton qartë Statuti i Partisë, me gjithë direktivat dhe udhëzimet e kongreseve, të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike, pasi dalin nga mbledhjet plenare ku bëjnë pjesë, nuk interesohen si duhet për fatin e gjithë vijës së Partisë, për ruajtjen e pastërtisë së saj, për zbatimin si duhet dhe për kontrollin e zbatimit të saj. po kufizohen vetëm në sferën

e punës së tyre dhe më të shumtat e herës vetëm në afërsitë e funksionit të tyre imediat. Ata nuk e ndiejnë dhe nuk e ushtrojnë si duhet mandatin që kanë marrë në Kongres. Si anëtarë të udhëheqjes ata fetishizojnë aparatet dhe funksionarët që ka zgjedhur Partia në krye të këtyre aparateve, ata e kuptojnë udhëheqjen kolegjiale si diçka formale. Praktika na bën të gjejnë në këtë mënyrë. Byroja Politike dhe byroja e komitetit të Partisë të rrethit janë gjithçka për ta e, tok me ta, edhe aparatet e tyre. Në qoftë se «i urdhëron» byroja, ata mund të venë diku dhe të shohin vetëm atë çka u thuhet, s'marrin në vend asnjë vendim, nuk lënë asnjë udhëzim. Shumë herë e shikojnë përciptas problemin dhe harrojnë se janë udhëheqës. Si të tillë, duke mos e luajtur rolin që u takon, ata nuk bëjnë si duhet konkluzione me përgjegjësi nga ngjarjet që i rrethojnë dhe nuk venë të bëjnë raporte serioze dhe me përgjegjësi përpara përgjegjësve të byrosë. Jo, këtë ata s'e bëjnë si duhet, kurse disa anëtarë të thjeshtë partie, e bile edhe qytetarë, e bëjnë duke i shkruar letra Partisë.

Edhe anëtarët e byrove dhe sekretarët e komiteteve të Partisë as nuk e kuptojnë si duhet dhe as nuk e zbatojnë si duhet bashkëpunimin dhe bashkëdrejtimin e çështjeve me anëtarët e Komitetit Qendror dhe me anëtarët e komiteteve të Partisë të rretheve. Ata e dinë teorikisht këtë, po besimi i tyre është i kufizuar dhe burokratik, në aparatet.

Pse nuk e zbatojnë ata si duhet, megjithëse e dinë këtë çështje? Unë mendoj se ata, pa u menduar, i nënvleftësojnë plenumet, mbivlerësojnë veten dhe byrotë. Këtu ne duhet të diktojmë se mos fshihet një megalomani e heshtur nga ana e tyre, një formë e mbuluar

e prepotencës, një mënyrë e diktimit të urdhrave dhe e përqendrimit të fuqisë në duart e tyre. Udhëheqësit e byrove shumë rrallë kritikohen, metoda e punës jashtë kontrollit të anëtarëve të Komitetit Qendror dhe të të gjithë organizatës krijon kultin e byrove dhe të anëtarëve të saj, gjë kjo shumë e rrezikshme për Partinë!

Byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve vetëm kontrollin dhe kritikën e Byrosë Politike dhe të njerëzve që e përbëjnë atë marrin në konsideratë, pa harruar instruktorët e Komitetit Qendror që janë zëdhënësit e tyre. Kurse Byronë Politike të Komitetit Qendror, në fakt, s'e kritikon kush, as komitetet e Partisë të rretheve, as anëtarët e Komitetit Qendror veç e veç. Por edhe të mbledhur në plenum, rrallë kritikohet Byroja Politike ose pjesëtarët e saj nga anëtarët e Komitetit Qendror. Pse nuk bëhet kjo? S'ka vallë të meta? Ka, dhe këto vetë Byroja Politike i ka denoncuar, por rrallë e tek e ka marrë guximin ta bëjë këtë ndonjë shok. Pse? Mendoj se ka një kult të dënueshëm, ka një druajtje të pajustificueshme, se nuk ka thellim në probleme, nuk nxirren prej tyre konkluzione për të gjykuar nëse ka ose jo gabime në këtë apo në atë direktivë, në këtë apo në atë vendim dhe t'i vihet gishti përgjegjësit. Po t'i shohim këto çështje që po ngre në drejtimin e ushtrisë, atëherë do të realizojmë sa të rrezikshme janë.

Kur analizojmë një gabim serioz si ky i ushtrisë, atëherë disa thonë se Komiteti Qendror ka përgjegjësi, por a e ndiejnë të gjithë si duhet këtë përgjegjësi? Jo, mendoj, këtë vetëm sa e thonë dhe përgjegjës bëjnë vetëm ata anëtarë të Komitetit Qendror që janë në ushtri, drejtuesit kryesorë të ushtrisë që janë edhe në Byronë Politike (dhe këtë gjë në asnjë mënyrë nuk e

thonë hapur) dhe kaq, «përgjegjësia», që thuhet, është fiktive. Arrihet në konkluzionin e heshtur: «Unë s'kam asnjë faj për këtë çështje, se punoj në bakër», «Unë jam kryetar kooperative, ç'lidhje kam unë me ushtrinë?» etj. Natyrisht, anëtarin e Komitetit Qendror qederoset për këto që kanë ngjarë, bile s'ka asnjë dyshim që qederoset shumë, po ndonjë përgjegjësini e heq nga vetja, megjithëse përgjegjësi ka, bile edhe të madhe, pse si udhëheqës ai është përgjegjës për pastërtinë e vijës dhe për zbatimin e drejtë të saj në të gjitha sferat.

Kjo çështje nuk kuptohet kështu dhe nuk zbatohet si duhet dhe me konsekuencë roli i udhëheqësit, gjë që është e mbarsur me rreziqe për Partinë. Kujdes! Kujdes shokë! Të mos harrojmë ç'i ngjau Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, të mos harrojmë ç'ngjau në Partinë Komuniste të Kinës. Partia jonë nuk është e imunizuar nga të tilla rreziqe. Të mos lejojmë të na zërë gjumi i rëndë mbi dafina. Dafinat mund të na kthehen në gjemba dhe trupi të na bëhet me gjak. Të mos i neglizhojmë dhe të mos i minimizojmë këto që na ngjasin. Tri plenumë me radhë kemi bërë, të 4-tin, të 5-tin dhe tani po bëjmë të 6-tin, vetëm për luftën kundër presionit të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm në Partinë tonë.

E kam theksuar shumë herë që të mos e mbivlerësojmë veten, të mos e mbivlerësojmë forcën tonë. Të jemi realistë. S'humbasim gjë, përkundrazi, fitojmë duke qenë kurdoherë të thjeshtë, mendja asnjëherë të mos na rritet, pse thjeshtësia na ndihmon të shohim realitetin, të shohim të metat dhe t'i ndreqim. Ja ç'pësuam me ushtrinë. «S'ka si ushtria jonë, ajo është çelik!», thuhej. Çdo gjë kontrollojmë, atë jo; kudo vë-

renim gabime, atje sikur s'kishte gjë fare; kudo shkonim për të parë se si u vendos boshti ideologjik, atje jo; kudo kontrollohej puna politike dhe ideologjike me njerëzit, atje jo; u bë gjithë ajo punë në shkollat e të gjitha niveleve me tekste e çdo gjë tjetër të nevojshme, atje jo! «Në ushtri çdo gjë ishte perfekte, bile e shkëlqyeshme!» Mirëpo ç'na doli? Një punë e kalbur, një tradhti, një shmangie e rëndë nga vija e Partisë.

Lidhjet individuale në mes udhëheqësve të ndryshëm janë të domosdoshme, këto duhet të jenë të gjalla, jo burokratike me letra, bile kontaktet duhet të jenë të shpeshta midis tyre. Por këto lidhje lypset të jenë me bukë, se shumë herë nuk janë të tilla, ato reduktohen në cikërrima, duket sikur tregojnë aktivizim, por pengojnë iniciativën, shkarkojnë përgjegjësitë, duke thënë: «Të kam vënë në korent» etj. Mirëpo vënia në korent «në këmbë» nuk e shtron gjithë problemin, po vetëm një pjesëz dhe kjo «pjesëz» mund të çojë në dhënie gabim të mendimit, gjë që i shërben atij tjetrit ta ketë si një atu për të fshchur gabimet e tij më të mëdha.

Që të ecin mirë punët në këtë drejtim çështjen e ka në dorë vetë udhëheqësi. Ai duhet të dijë për se duhet të pyesë dhe për se jo dhe për atë që do të pyesë të japë sqarime jo «në këmbë», pse, derisa pyet, atëherë problemi e kalon kompetencën e tij dhe për ato që mendon se s'duhet pyetur, të mbajë përgjegjësi të plotë. Ai që pyetet, nuk është i detyruar t'u përgjigjet të gjithave, kur e shikon që s'meriton dhe nuk duhet të japë përgjigje, le t'i thotë bashkëbiseduesit: «Merr përgjegjësi vetë!». Kjo metodë e natyrshme dhe e thjeshtë në

paraqitje, mendoj se ka një domethënie të madhe: kjo rrit kuadrot, i mëson këta të mendojnë me kokën e tyre, i mëson të drejtojnë, të jenë të pavarur dhe të mbajnë përgjegjësi në marrjen e vendimeve. Çdo kuadër do të bëjë kështu detyrën e tij dhe nuk do t'i hajë kohën eprorit, i cili mendon dhe duhet të mendojë edhe për probleme të tjera.

Një metodë pune e sëmure në këtë drejtim eprorin e bën të merret me cikërrima, të harrojë problemet e mëdha dhe t'i duket sikur punon, ndërsa, kur nuk e pyesin orë e çast, atëherë mërzhitet, bërtet, bëhet nevrík pse rutina nuk po ecën si në gjalpë.

Kjo çështje hyn në metodën dhe në stilin e punës. «Stili dhe metoda e punës» na mbetën në gojë, na janë bërë një slogan që futet në çdo supë, për ta bërë të shijshme, të ashtuquajtur shkencore analizën e të metave, por kësaj formule nuk i futemi seriozisht dhe ta zbërthejmë fill e për pe, sepse në vetvete ajo përmban shumë parime, shumë forma që duhen zhdukur dhe zëvendësuar, që përmban një frymë si ta kuptosh dhe si ta zbatosh direktivën apo vendimin më javash, më shpejt, në rrugë të drejtë a në rrugë të shtrembër, në rrugë idealiste apo materialiste, në frymë burokratike apo revolucionare etj., etj. Vetë zberthimi në praktikë i problemeve, përcaktimi i formave dhe i tempit të caktuar për realizimin e direktivës përcaktojnë, gjithashtu, stilin dhe metodën në punë. Mund të jesh metodik në punë dhe të mos kesh një stil revolucionar, mund të kesh një stil revolucionar, por të të mungojë shpirti i metodës së përshtatshme në këtë stil. Njëra pa tjetrën nuk ecin, njëra ndikon mbi tjetrën, të dyja duhet të jenë revolucionare.



Dhe stili e metoda, që shumë herë konsiderohen si diçka të shkëputura, diçka parimore, janë të lidhura me punën, me teknikën, me politikën, me ideologjinë, me socializmin, me revolucionin; ato janë të lidhura ngushtë me karakterin e njeriut, me edukatën e tij, të cilat evoluojnë, ndryshohen, në forma dhe në cilësi.

Lidhjet individuale në mes udhëheqësve, flas kurdoherë për çështje pune, nuk mund të zëvendësojnë ato lidhje partie dhe shtetërore të domosdoshme në të gjitha format e caktuara kolegjiale, që edhe këto zhvillohen, përmirësohen, pasurohen, me një fjalë, duhet të revolucionarizohen. Këto duhet të konsiderohen si lidhje kryesore, kurse lidhjet individuale si plotësuese, operative. Me të parat shtrohen, diskutohen, merren vendime kolegjiale, e theksoj, me lidhjet kolegjiale. Kjo ka rëndësi. Të mos lejojmë që praktikën e «kolegjialitetit» ta zhdukim me praktikën e drejtimit personal, duke menduar se nuk është operuese dhe se krijon burokracinë, ashtu siç mendonte Beqir Balluku që i tha Konjevit (këtë e thotë shoku i tij Sadik Bekteshi), kur ai e pyeti se si vete puna në Kinë me komitetet e partisë dhe Beqir Balluku iu përgjigj: «Edhe për të ngritur një helikopter duhet të merret atje mendimi i komitetit».

Mendimi dhe vendimi kolegjial nuk krijojnë burokraci, nuk pengojnë mendimin dhe veprimin individual, përkundrazi, luftojnë burokracinë, se mendohet dhe vendoset për çështje serioze të mëdha, prandaj ato gjallërojnë e zgjerojnë veprimin individual. Kurse ky i fundit gjoja sikur lufton burokracinë, po krijon rutinën, përçmon dhe më në fund eliminon kolegjialitetin.

Lidhjet individuale mund të jenë të frytshme, por,

me dashje ose pa dashje, mund edhe të dëmtojnë rëndë. Këto na dëmtuan në çështjet ushtarake, prandaj duhet të na bëhen mësim. Kurse, po të kishim vendosur forma dhe lidhje kolegjiale me ushtrinë, siç kemi vendosur në mes organizatave të Partisë dhe pushtetit në terren, nuk do të na ngjiste kjo që na ndodhi në ushtri. Prandaj edhe nga kjo çështje ne duhet të nxjerrim mësim serioze.

Në terren kemi vendosur lidhje dhe drejtime kolegjiale, flas nga ana e Partisë, por përsëri duhet të jemi vigjilentë dhe sidomos në ata sektorë ku ekzistojnë çështje sekrete. Sekretit ka shumë rëndësi të ruhet, se armiku atë synon, të na diktojë ato që i duhen për të na dëmtuar e luftuar dhe këtë e bëjnë me anë të njerëzve që korrupton ose që neglizhojnë në këtë çështje delikate. Megjithatë nuk lejohet që «sekretica» të zhdukë drejtimin dhe kontrollin e Partisë.

Ne kemi kudo organizata-bazë, byro, komitete partie, kudo këto duhet të drejtojnë. Për Partinë nuk ka sekret në sferën ku drejton, nuk ka sekret as për udhëheqjen e Partisë më të lartë se komiteti i dikasterit, dua të them për komitetin e Partisë të rrethit dhe më në fund për Komitetin Qendror. Kjo duhet të kuptohet thellë, mirë, drejt dhe të zbatohet.

Të gjitha këto instanca kanë detyra dhe të drejta, kanë edhe kompetenca, të cilat duhet t'i ushtrojnë brenda Statutit të Partisë, normave, ligjeve të saj dhe platformave që janë caktuar. Kjo duhet, gjithashtu, të kuptohet thellë, mirë, drejt dhe të zbatohet.

Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës dhe veçanërisht byroja e tij, kur e gjen të nevojshme, s'ka asnjë pengesë të vejë, të kontrollojë punën e Partisë në Mi-

nistrinë e Financave, në Bankë, në Ministrinë e Industrisë etj.; them kështu dhe kuptoj me këtë kur është çështja për të shkuar me ekipe dhe me instruktorët e saj dhe nuk kuptoj këtu ato lidhje pune individuale.

Po me Ministrinë e Punëve të Brendshme e bën këtë kështu ky komitet? Apo e ka reduktuar këtë ndihmë dhe kontroll në disa lidhje individuale në mes sekretarit të parë të tij, me ministrin e Punëve të Brendshme dhe me sekretarin e komitetit të Partisë të kësaj ministrie dhe poshtë, në bazë, ato realizohen vetëm nëpërmjet lidhjeve në mes sekretarit të parë të rrethit dhe shefit të degës së punëve të brendshme? Kjo gjë dyshoj të bëhet si duhet dhe, në qoftë se nuk bëhet si duhet, shkaktohet nga këto konsiderata: «Atje ka çështje sekrete, shokët e Sigurimit janë shokë të mirë, të zgjedhur një nga një. Meqenëse ata luftojnë dhëmb për dhëmb me armikun, s'ka se si të thyhen nga armiku, ata janë të ngritur ideologjikisht, kanë format e tyre, kanë shkollat e tyre» etj. Kjo është kështu, por këto arsyttime i kemi thënë dhe për ushtrinë dhe kishim arsye t'i thoshim. Por na zuri gjumi mbi dafina dhe harruam moton «beso dhe kontrollo!». Mirëpo «Sekreti i Ministrisë së Punëve të Brendshme është special»! Po sekreti i Ministrisë së Mbrojtjes nuk ishte «special»? Po sekretet financiare nuk janë «speciale»? Po sekretet e minierave, gjithashtu, nuk janë «speciale»? Të gjithë sektorët kanë sekretet e tyre, të cilat duhen të ruhen dhe të mbrohen dhe më parë se kushdo tjetër ato duhet të ruhen dhe të mbrohen nga Partia, pastaj nga çdo institucion shtetëror dhe nga arma e Sigurimit të Shtetit. Pra, Ministria e Punëve të Brendshme dhe puna e saj, në qendër e në rrethe, duhet të jetë nën drejtimin

kolegjial të Partisë në ministri dhe në degët e rretheve, të jetë nën drejtimin dhe kontrollin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës dhe të komiteteve të Partisë të rretheve dhe këto, nga ana e tyre, nën drejtimin dhe kontrollin e Komitetit Qendror.

Për të ndihmuar dhe për të kontrolluar organizatën e Partisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të mos dërgohet kush të mundet, por për këtë punë duhet të caktohen shokë dhe jo vetëm një. Jo vetëm sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës duhet të dijë ç'ngjjet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, jo vetëm sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit të dijë ç'bëhet në degën e punëve të brendshme në rreth, por të gjithë sekretarët, të paktën raportimi të bëhet para tyre dhe jo të bëhet raportim formal, siç na e bënte neve Drejtoria Politike e Ushtrisë. Këta shokë duhet të dinë politikën e goditjes që do të bëhet nga ana e Sigurimit dhe kjo politikë përcaktohet nga Partia. Prandaj organi i Punëve të Brendshme duhet t'i parashtojë Partisë pse propozon të përdorë këtë ose atë goditje, ç'rrethana ekzistojnë dhe këto rrethana duhet t'i dijë më parë komiteti i Partisë, të dëgjojë edhe nuancat e tyre dhe t'i koordinojë, t'i shoshitë ato dhe të vendosin së toku. Kështu duhet të vendoset, kjo është rruga e Partisë. Pastaj sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit mund të bisedojë me shefin e degës së brendshme, por jo vetëm ai, po të bisedojnë edhe sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë. Shefi i degës nuk lejohet ta konsiderojë një sekretar të komitetit të Partisë në rreth si të huaj për problemet e degës ose ta konsiderojë veten epror mbi të. Lidhje të tilla partie nuk do të na lejojnë të na ngja-

sin gabime, lidhje të tilla nuk e pengojnë iniciativën e punonjësve të Sigurimit, brenda vijave dhe platformave të vendosura ato nuk pengojnë përdorimin e taktikave të ndryshme speciale dhe as kërkohet që me këto lidhje të zbulohen edhe gjërat më të vogla, se mos dekonspirohen. Të gjithë dhe kudo duhet të dinë rëndësinë e sekretit dhe, në radhë të parë, sekretarët e komiteteve të Partisë në rrethe, pse sekretin mund ta zbulojë si një që punon në Sigurim, ashtu edhe një që nuk punon atje. Po çështja qëndron në atë që të edukohen njerëzit me frymë partishmërie dhe për këtë Partia duhet të jetë në këmbë, kurdoherë vigjilente dhe në drejtim.

Shumë shfaqje të këqija na u vërtetuan në karakterin e disa kuadrove të ushtrisë, të cilët degjeneruan rëndë, kurse disa, si Beqir Ballukun, Hito Çakon dhe Petrit Dumen, ato i katandisën në banditë të vërtetë. Shfaqje të tilla degjenerimi përbëjnë një rrezik të madh për pastërtinë ideopolitike të të gjithë Partisë dhe minojnë qenien e saj si një repart i organizuar pararojë i klasës punëtore. Ky repart ka ideologjinë, ka parimet, normat dhe etikën e tij. Në rast se këto lejohen të deformohen dhe të degjenerojnë, do të thotë të degjenerohet ideologjia që frymëzon repartin pararojë dhe ky repart vetë si organizim të shturet dhe në një kohë të bëhet i paqenë ose formal, ose, siç e themi, nga një parti komuniste të kthehet në një parti revizioniste.

E shpjegova më lart se si e në ç'rrethana organizata e Partisë në ushtri na u ligështua, gjë që ndikoi edhe në repartet e ushtrisë. Ushtria mund të konsiderohet si një «shoqëri» pak a shumë e mbyllur dhe e izoluar

në drejtimin e jetesës së përbashkët dhe të stërvitjes që bëhen së toku. Jeta e ushtrisë së kazermës e lehtëson zhvillimin e veseve të këqija, në rast se Partia lëviz nga binarët e marksizëm-leninizmit dhe lejon të zhvillohen tiparet e urryera të një ushtrie borgjeze. Shkolla e Lirë Ushtarake, që ka rekomanduar Lenini dhe që do të vendoset gradualisht te ne, do të jetë një shkatërrim i «mureve» të kazermës, një shkatërrim i plotë i izolimit nga masat e gjera të popullit, i cili bëhet vetë pjesëtar aktiv i kësaj ushtrie popullore dhe udhëheqja e Partisë e kontrolli punëtor bëhen kështu më të fuqishëm dhe më efektivë.

Kur themi se ushtria ka qenë disi e izoluar, ky izolim duhet të kuptohet se është relativ. Njerëzit e ushtrisë, me të mirat, po dhe me të këqijat e tyre, kanë ndikuar edhe në masat e gjera të popullit, në gjirin e të cilave rrojnë, pse andej kanë dalë. Por duhet të njohim se ndikimi i masave në njerëzit e ushtrisë, megjithëse ka qenë reciprok, në analizë të fundit, ka qenë prapëseprapë më i dobët në ta, mundet edhe për shkak të pikëpamjeve të sëmura sentimentale: «Djali im është oficer, pra, njeri i zoti, besnik i Partisë, s'kam ç't'i mësoj, s'kam ç't'i kritikoj, ai është i mësuar, pastaj ai është ushtarak dhe ushtria ka ligjet dhe të fshehtat e veta».

Por të mos dalim me konkluzione të gabuara se vese të tilla të dënueshme paskësh vetëm në kuadrot e ushtrisë dhe në ushtri. Veset këtu u akumuluan në «një vazo të mbyllur», prandaj edhe infektimi i njerëzve prej tyre pati atje një gjerësi të theksuar. Të tilla vese shfaqen edhe në disa kuadro të pushtetit në qendër dhe në bazë, edhe në kuadro të Partisë. Në

disa prej tyre ka shfaqje të theksuara të mendjemadhësisë, të arrogancës e të prepotencës. Ata shkelin normat dhe ligjet e Partisë dhe të shtetit, shfrytëzojnë në dëm të shoqërisë postet dhe detyrat që u janë ngarkuar, bëjnë abuzime, rendin pas dietave, sulmojnë ofiqet, tribunat, apartamentet më të mira, kanë kujdes të madh për «personalitetin» e tyre që të mos preket, në organizatat-bazë nuk japin komandë si në ushtri, por u pëlqen një gjë e tillë dhe në brendinë e ndërgjegjes së tyre, në mos hapur, heshtazi, e pranojnë «epërsinë» e «ofiqit» të tyre.

Edhe në terren ka kuadro që fshehin të vërtetën, që lustrosin gjërat, që i kanë në gojë e në raporte emërtimet superlative. Këto shfaqje nuk janë dhe nuk duhen parë fare thjesht në persona, në individë të veçuar. Jo, ka shumë komprometime, ka miqësi të sëmura, ka tarafe kushërrilëqesh, krushqish dhe farefisi jo vetëm jashtë Partisë, por edhe brenda saj, edhe në pushtet.

Disa kuadro komitetesh partie rrethesh e kanë gënjyer Komitetin Qendror, kanë fshehur gabimet, kanë shtrembëruar rezultatet e të dhënave ekonomike, për të marrë flamurë e dekorata, ka prej tyre që kanë shtrembëruar edhe direktiva të Komitetit Qendror dhe me veprime të tyre të padrejta kanë zemëruar kooperativistë dhe punëtorë. Të tilla fenomene në terren sikur nuk para duken si në ushtri, pse janë të përhapura sa andej-këndej, por ama në terren njerëz të tillë nuk mund të veprojnë gjatë në këtë rrugë të gabuar, pse presioni i madh i Partisë, i opinionit të masave të gjera të popullit dhe kontrolli punëtor u rri mbi kokë si çekan dhe, kur mbushin kupën, ai u bie fort e i godet dhe i hedh në një anë. Këta janë elementë që, po të

lihen, rrezikojnë të degjenerojnë Partinë. Revolucionarizimi i vazhdueshëm i masave të gjera të popullit kërkon dhe presupozon revolucionarizimin e madh të komunistëve, në radhë të parë, të të gjithë Partisë dhe të organeve drejtuese të saj. Ndryshe s'ka revolucionarizim të vërtetë të pushtetit, të ushtrisë, të masave. Degjenerimi është si krimbi që pa kuptuar, por gradualisht, gërryen mobilien e bukur nga brenda.

Të gjithë komunistët, të gjitha organizatat e Partisë dhe komitetet e tyre në të gjitha instancat, si dhe njerëzit e pushtetit duhet të ngrihen në këmbë, jo një herë, por të ngrihen dhe të qëndrojnë vazhdimisht në këmbë për të mbrojtur pastërtinë e Partisë dhe krijesat e saj dhe jo të luftojnë dhe ta mbrojnë Partinë nga armiq «imagjinarë», por nga ata konkretë, të jashtëm, por edhe të brendshëm. Të brendshmit janë të shumanshëm, të paraqitshëm me shumë forma e mënyra, që fillojnë nga diçka e vogël dhe arrijnë te diçka e madhe. Partia duhet të edukojë njerëzit që të shohin e të vlerësojnë të voglën, të cilën ta godasin porsa e diktojnë, ta ndreqin por edhe të nxjerrin konkluzione, çdo herë që këto gabime të vogla, të izoluara, personale, marrin formë masive. Duhet të analizojmë dhe të gjejmë shkaqet dhe arsyet që e sjellin këtë gjendje, e cila duhet riparuar dhe jo të minimizohet e të mbulohet, se mos i bjerë nderi ndërmarrjes, rrethit, komitetit, ministrit, Qeverisë apo Komitetit Qendror. Jo, e keqja duhet goditur, duhet zhdukur, nga çdo anë që të vijë dhe në çdo formë që të paraqitet.

Prandaj kjo çështje që na ngjau në ushtri të mos merret si një fenomen i izoluar, të mos qajmë, po të luftojmë dhe nga gabimet të nxjerrim mësimë jo vetëm



për ushtrinë, por edhe për të gjitha aktivitetet e Partisë dhe të pushtetit në terren.

Gjithë këtë çështje, të tëra situatat që janë zhvilluar dhe si janë zhvilluar, ne duhet t'i kuptojmë realisht, nën prizmin e dialektikës sonë marksiste-leniniste, pse vetëm kështu do të marrim masa të efektshme për ta shëruar rrënjësisht dhe drejt këtë situatë.

Armiku punoi dhe na dëmtoi në disa kuadro, për shërimin e të cilëve Partisë do t'i duhet kohë, por kjo do të bëhet se është një nga detyrat kryesore të saj. Një pjesë e Partisë, organizata e saj në ushtri, është ligështuar pak, por asgjë nuk është alarmante, çdo gjë do të shërohet mirë e shpejt. Forca e Partisë, mendja dhe zemra e saj e madhe e nënës, çdo gjë do ta vërë në vend dhe ata djem të saj, të çoroditur e të gënjyer nga këto rrethana dhe në këto rrethana, si komunistë dhe si patriotë revolucionarë që janë, do ta gjejnë shpejt rrugën e drejtë dhe do ta kapin e s'do ta lëshojnë kurrë dorën shpëtimtare që po u nder Partia. Me gjithë të metat e gabimet që u vërtetuan në organizatën e Partisë në ushtri, atje militojnë me mijëra e me mijëra komunistë heroikë, bij të denjë të Partisë, besnikë të saj deri në vdekje, bij të popullit tonë të lavdishëm, që kanë bërë Luftën Nacionalçlirimtare dhe luftën për ndërtimin e socializmit, që e kanë edukuar, e edukojnë dhe do ta edukojnë vazhdimisht ushtrinë si armën më të dashur të Partisë dhe të diktaturës së proletariatit.

Partia dhe Komiteti i saj Qendror kanë besim të plotë tek Ushtria jonë heroike Popullore, kanë besim të plotë te kuadrot e saj komunistë dhe jo anëtarë të Partisë, por me shpirt dhe me vepra prej komunisti, kanë besim të plotë se ata do ta marrin punën në dorë

dhe, me një hov revolucionar të paparë ndonjëherë, nën udhëheqjen e Partisë, do ta bëjnë ushtrinë akoma më të çeliktë, që kjo të jetë kurdoherë në gatishmëri.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 177*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TREGUESIT**



## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Alcanca, bashkëpunimi dhe rivaliteti sovjeta-amerikan* — 163, 307-308, 311.

*Armatimi, çarmatimi; demagogjia e superfuqive për çarmatim* — 6, 157.

*Armiqtë — lufta kundër veprimtarisë armiqësore të tyre* — 36-37, 53-59, 104-106, 109, 112-113, 122, 133-134, 153, 154, 166-167, 197-198, 285-286, 298, 364-365, 370, 457, 515.

*Arsimi në RPSH — zhvillimi i tij* — 144.

*Arti Ushtarak i Luftës Popullore* — 11, 14, 15, 16, 18, 23, 47, 291.

### B

*Ballkani; planet imperialiste e revizioniste për këtë zonë dhe rezistenca e popujve të Ballkanit* — 50, 52, 106-107, 125, 173-174, 176-177, 179.

*Bashkimi i Rinisë së Punës*

*të Shqipërisë — organizata e rinisë në ushtri* — 96, 273, 351-352, 493.

*Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik*

— degjenerimi i partisë, i pushtetit dhe i ushtrisë — 284-285, 487, 488;

— politika e jashtme — 107, 134, 137, 138-139, 163, 169-170, 176, 306-307, 310, 311-312, 379-380;

— qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë — 137, 138, 139, 167-168, 170, 307, 412, 413.

*Bashkimi Sovjetik, ushtria sovjetike (1917—1953)* — 112-113, 138, 168, 284, 471-472, 482-483, 486-487, 488.

*Bindja; harmonizimi i saj me masa administrative* — 215, 216, 347-348, 358-359, 466.

*Borgjezia* — 149-150, 156-157, 160, 374, 486.

*Botëkuptimi marksist-leninist dhe lufta për formimin e tij* — 263-264, 460.

*Britania e Madhe — qëndrimi ndaj Shqipërisë* — 172.

*Bujqësia* — zhvillimi i saj.  
*Mekanizimi dhe fuqia punë-  
 tore në bujqësi* — 143-144,  
 147.

*Burokratizmi, liberalizmi, te-  
 knokratizmi dhe lufta kun-  
 dër tyre* — 229, 236, 507.

## Ç

*Çmimet; politika e Partisë në  
 fushën e çmimeve* — 146, 389-  
 -390.

## D

*Demokracia borgjezo-revizio-  
 niste* — 149-150.

*Demokracia socialiste* — 83,  
 149, 150-151, 243-244, 358,  
 372.

*Dëshmorët, heronjtë* — 317,  
 379.

*Diktatura e proletariatit* —  
 149, 455.

*Disiplina proletare, disiplina  
 ushtarake* — 81, 83, 124, 229-  
 -230, 296, 357-359.

## E

*Edukimi komunist*

— edukimi ideopolitik i ko-  
 munistëve, i masave dhe  
 i kuadrove — 246-258,  
 333-334, 355, 378, 459-461,

466-467, 469-470, 488-489,  
 493-494, 512-514;

— studimi i dokumenteve e  
 materialeve të Partisë —  
 96-97, 110, 245-246, 248,  
 298, 301, 346-347, 419-420,  
 443-444, 477-478, 490-491,  
 494-495.

*Ekonomia popullore* — zhvi-  
 llimi i saj — 142-144, 145.

*Engels, Frederik* — 57, 250,  
 333, 337, 347.

*Enver Hoxha* — të dhëna au-  
 tobiografike — 7, 26-27, 41-  
 -42, 75-77, 85-88, 308-309, 338,  
 384-385.

*Evropa. «Sigurimi evropian»*  
 — 50, 158-159.

## F

*Forcat Vullnetare të Vetë-  
 mbrojtjes Popullore, Forcat  
 rezerviste* — 21-22, 30-31, 324,  
 453.

## G

*Greqia* — gjendja e brendsh-  
 me, politika e jashtme — 49,  
 52, 139, 164, 173-174, 175.

*Grupi armiqësor, komplotist e  
 puçist i B. Ballukut, P. Du-  
 mes, H. Çakos etj. dhe lufta  
 për shpartallimin e tij*

— veprimtaria komplotiste  
 kundër Partisë, pushtetit

- dhe rendit socialist — 9, 15-16, 26, 36, 38, 40-41, 53; 61, 62, 66, 71, 99-100, 103-104, 115, 186-187, 190-191, 206-207, 221, 231-232, 236-237, 264-265, 338, 339-340, 343, 365, 372, 404, 405-406, 412-413, 414, 415-417, 426-427, 436-439, 441, 451, 462-463, 477, 479, 484-485;
- veprimtaria e tij për të dobësuar dhe goditur organizatën e Partisë dhe rolin e saj udhëheqës në ushtri — 77-78, 208-209, 230, 232-233, 237-239, 272, 273-274, 340, 360, 404, 405, 420-421, 422-424, 433, 445-449, 451, 457-458, 474-475, 476, 477, 484-485, 489, 495, 511;
  - përpjekjet për të zëvendësuar ideologjinë marksiste-leniniste me ideologjinë borgjezo-revizioniste — 184, 192-193, 223-224, 271-282, 285, 287, 301-302, 303, 347, 405, 415, 444-445, 449, 461-463, 489-492, 496;
  - puna e tij për të sabotuar vijën ushtarake të Partisë, ushtrinë dhe mbrojtjen e vendit — 3-4, 9, 11-24, 28-33, 37-38, 41, 61, 62, 71, 79, 81-83, 92-93, 95-96, 99, 105-106, 108, 115-116, 119, 183-184, 186, 189-190, 195-196, 206, 207, 219-225, 229, 230-232, 235-238, 241, 254-256, 265-266, 273-274, 276, 282, 285-286, 287, 289-290, 292, 300-301, 323-324, 340-342, 364-365, 396-405, 409-411, 413-416, 418-419, 423, 425, 426, 428, 437-444, 452-454, 458-459, 479-480, 484-485, 495-496;
  - metodat dhe taktikat e grupit komplotist e puçist — 26, 34-35, 36, 39-40, 54-55, 56, 61, 65, 66, 68, 84-91, 97-98, 118, 186-188, 190-191, 195-196, 203-204, 206-210, 216, 219-220, 264-265, 267-269, 274-275, 276, 298-299, 314-316, 341, 342, 364-365, 397, 403, 409-411, 413-416, 423-425, 427-428, 432, 437-443, 444-445, 478-479;
  - degjenerimi borgjezo-revizionist i pjesëtarëve të tij — 37-38, 65, 117-118, 188-190, 225-229, 230-231, 254-255, 270-271, 300, 341, 406-407, 410-411, 416-417, 418-419, 422-423, 424-425, 427-429, 439-442, 458, 459, 461-463, 477, 511, 512-514;
  - agjunkturë në shërbim të shteteve revizioniste. Lidhjet e tij me grupet e tjera armiqësore — 4, 38-

-39, 98-100, 118, 186, 187, 204-206, 207-210, 231-232, 255, 341, 343, 408-409, 412-413, 416, 417, 437, 479, 480;  
 — zbulimi, gjykimi dhe dënimi i grupit armiqësor e i punës armiqësore të tij — 2-4, 9-10, 43, 45, 56, 59-61, 71-72, 100, 111-114, 119-120, 200-204, 205-207, 210, 217, 236-237, 265, 271, 272, 274-275, 277-278, 279, 280, 299, 339, 342-343, 395-396, 403-404, 407, 408-409, 411-415, 422-423, 427, 454-455, 458-459, 486.

## H

*Hierarkia ushtarake* — 79-80, 186, 232, 340, 417, 424, 476, 496.  
*Historia; mësimet e saj* — 63, 134, 135, 154, 173, 403, 404.

## I

*Industria e rëndë — industria e minierave, e naftës dhe ajo elektrike* — 143, 144, 146.  
*Instituti i Studimeve Ushtarake* — 192-193, 244-246, 247-252, 289, 291.  
*Inteligjencia — edukimi dhe*

*roli i saj në ndërtimin socialist* — 144-145.

*Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak* — 27, 72, 243, 260, 304.

## J

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — gjendja e brendshme, politika e jashtme. Veprimtaria armiqësore kundër Shqipërisë* — 107, 137-138, 139, 164, 173-174, 308, 311-312, 380-382, 387, 471, 477-480, 482.

## K

*Kapitalizmi — kriza, kontraktat, varfërimi i masave punonjëse, papunësia* — 145-146, 147, 156-157, 160, 371, 389.  
*Këshilli i Mbrojtjes. Tezat e Këshillit të Mbrojtjes; lufta kundër përpjekjeve për sabotimin dhe revizionimin e tyre* — 6, 8, 11-24, 28-33, 62, 69, 71, 80, 90, 93, 109-110, 116, 117, 123, 206, 217, 219, 220, 234, 236, 255, 276-278, 288-289, 290-292, 341-342, 353, 397-398, 405, 418, 443, 444, 452.  
*Kina — qëndrimi ndaj Shqipërisë* — 128-130.



*Klasa punëtore në Shqipëri —*  
467.

*Klasa punëtore në vendet kapitaliste e revizioniste —* 370, 371, 374.

*Komanda e përgjithshme e ushtrisë. Shtatmadhoria —* 39, 68-69, 230, 234, 258, 292, 323, 324, 399-400.

*Komplotet dhe grupet armiqësore kundër Partisë e shtetit dhe lufta për shpartallimin e tyre.*

*Shih:* Grupi armiqësor komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. dhe lufta për shpartallimin e tij; PPSH — lufta e klasave në Parti.

*Komunikacioni, transporti —* 144.

*Komunisti*

— cilësitë moralo-politike, militantizmi dhe revolucionarizimi i tij — 261-262, 327-330, 331, 334, 515;

— lufta për zbatimin dhe mbrojtjen e vijës, vendimeve e direktivave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit — 102, 121-122, 125-126, 247, 333-334, 349, 353.

*Komunizmi —* 334.

*Kontradiktat në shoqërinë socialiste —* 263-264.

*Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë në ushtri —* 299, 345, 356, 446, 447, 498-499, 504-505.

*Kontrolli i Partisë, i shtetit, i klasës punëtore dhe i masave —* 151-152, 345-346, 350-351, 356, 446, 447, 498-499, 504-505, 508-510, 513.

*Kritika dhe autokritika —* 10, 64, 182-183, 242, 260-262, 287-288, 336, 337, 359, 429, 503.

*Kuadrot, kuadrot në ushtri — cilësitë dhe virtytet moralo-politike —* 515-516;

— politika e Partisë me kuadrin; lufta kundër shfaqjeve të huaja të kuadrot dhe kundër qëndrimeve të huaja ndaj tyre — 39, 74-75, 77-78, 79-80, 92-93, 125, 210-217, 265, 299-301, 352-353, 405, 411-412, 420, 425-426, 427-428, 429-432, 433-435, 441, 449, 469-470, 472-473, 476-477, 498, 505-506;

— lufta për zbatimin dhe mbrojtjen e vijës, të vendimeve të Partisë dhe të ligjeve të shtetit — 79-80, 121-122, 152, 247-248, 259, 349-350, 361-362;

— vigjilenca dhe lufta e tyre kundër armiqve dhe veprimtarisë armiqësore — 43-45, 79-80, 82-83, 116-117, 125, 233-234, 282-

- 283, 286, 292-293, 302-305, 450-451, 454-455;
- përgatitja, edukimi, zgjedhja dhe vendosja e kuadrove. Ngritja e kuadrove të rinj — 92-93, 248-252, 256-258, 281-282, 283, 284, 297-298, 340-341, 343-344, 347-348, 354-355, 411-412, 434-435, 471-472, 469-490, 492;
- kuadrot politikë dhe ushtarakë (komisari, komandanti) — 43-44, 210-217, 234-235, 241, 247-252, 297, 300-301, 349-350, 356-357, 359, 360-361, 431, 469-470, 471, 491;
- marrëdhëniet kuadër-masë, kuadër-ushtarë. Lidhjet me masat, dhënia llogari dhe kontrolli i masave mbi kuadrot — 35, 125-126, 151-152, 185-186, 296-297, 378, 464-465.
- Kultura — edukimi kulturor dhe veprimtaritë kulturore e artistike — 249-250, 393.*
- Kuvendi Popullor, deputetët. Zgjedhjet për Kuvendin Popullor — 141-142, 150-151, 181.*

## L

- Lenin, Vladimir Iliç — 57, 93, 112, 119, 333, 337, 346, 347, 369, 418, 452, 463, 512.*

*Letrat, kërkesat, ankesat e punonjësve; puna me letrat — 42, 351.*

*Lëvizja marksiste-leniniste botërore. Partia Komuniste e Brazilit, e Gjermanisë dhe ajo e Indonezisë — 365, 369-370, 374-376.*

*Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve — 159-160, 165, 373.*

*Ligjet, aktet nënligjore; njohja, zbatimi dhe mbrojtja e tyre — 321-322, 393-394.*

*Ligjet objektive të shoqërisë dhe të natyrës — 248.*

*Lindja e Mesme — përpjekjet e superfuqive për të depërtuar në këtë zonë dhe lufta e popujve kundër tyre — 178-180.*

*Literatura e huaj dhe qëndrimi kritik ndaj saj — 301-302, 303, 355, 445.*

*Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar — synimet, mësimet, rëndësia dhe përvoja e saj — 23, 24-25, 27-28, 29-30, 63-64, 347, 377-378, 386;*

— historia e saj; historikët e njëjësive dhe reparteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare — 24-25, 62-63.

*Lufta e klasave — 57-59, 122, 152-153, 166-167, 202, 264, 366, 456-457.*

*Shih edhe: PPSH — lufta e klasave në Parti.*

*Lufta e së resë me të vjetrën dhe fitorja e së resë* — 263-264.

*Lufta. Psikoza e luftës* — 164;  
— roli i njeriut dhe i armëve në luftë — 139, 154, 198.

## M

*Marksizëm-leninizmi: studimi, zbatimi dhe mbrojtja e tij* — 34, 36, 249-250, 283, 326, 333-334, 363-364, 369-370, 490, 492-493.

*Marks, Karl* — 26, 57, 76, 250, 333, 337, 346, 347, 369, 374.

*Mbrojtja e atdheut*

— vija ushtarake e Partisë — 1, 2, 3, 6, 12-13, 28, 106, 108-110, 123;

— përgatitja dhe forcimi i gatishmërisë ushtarake të ushtrisë, të popullit dhe gjithë vendit për mbrojtje — 15-16, 30-31, 47, 106, 108-110, 115-116, 122-123, 146, 153-155, 174, 197, 251-252;

— bashkëpunimi, lidhjet ushtri-terren — 252, 294-296, 435, 481-482, 483, 500-501, 507-508, 512;

— fortifikimi i vendit, rajonet mbrojtëse — 20-21, 224-225.

*Mendjemadhësia, euforia, prepotenca, arroganca dhe lufta*

*kundër tyre* — 29, 70, 188-189, 228-229, 233, 297, 340, 345, 358, 412, 424, 429-430, 437-439, 440-441, 458, 459, 461, 473-474, 502-503, 513.

*Metoda dhe stili në punë — përsosja dhe revolucionarizimi i tyre* — 33-35, 196-197, 256-257, 344, 433, 505-507.

*Ministritë — kompetencat* — 67, 320-321;

— Ministria e Mbrojtjes Popullore; kritika dhe lufta kundër të metave, gabimeve dhe veprimtarisë armiqësore në këtë dikastr — 1-2, 13, 34-35, 36, 40, 43-44, 66-72, 80, 89, 94, 95, 99, 103-104, 203, 211, 217-220, 221, 240, 243, 250-251, 258, 299, 339, 355-356, 392, 393, 411, 427, 480, 483, 484, 509;

— Ministria e Punëve të Brendshme, organet e Punëve të Brendshme, Sigurimi i Shtetit — 89, 106, 345, 411, 478, 480, 509-511;

— Ministria e Financave — 345, 508-509.

## N

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri; politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit* — 142-145, 153-154, 363-364, 372, 378, 385-387, 398.

## NJ

*Njohja e armikut (e strukturës, e armatimit, e strategjisë dhe e taktikës së tij)* — 6, 17-18, 19, 31-32, 109, 246, 265.

## O

*Organizata-bazë e Partisë, organizata-bazë e Partisë në ushtri*

- roli udhëheqës dhe organizues i saj — 120-121, 239-240, 259, 290, 327-328, 331, 334-337, 351-352, 420-421, 424, 483, 484, 487, 491, 495, 497-498;
- mbledhja e organizatës-bazë dhe tematika; gjallërimi dhe revolucionarizimi i saj — 232-233, 286, 325, 327-333, 338-339, 347, 359, 493;
- zhvillimi i luftës së klasave dhe rritja e vigjilencës revolucionare nga organizata-bazë dhe nga komunistët — 55, 80-81, 122, 123, 185-186, 237, 238-239, 242-245, 254, 261-262, 290, 302-305, 336-337, 431, 454-455, 457, 458, 514-515;
- lidhjet dhe bashkëpunimi ndërmjet organizatave-bazë të ushtrisë dhe të terrenit — 124, 350, 495, 500-501.

*Organizatat e masave* — 494.

## P

*Paga* — ngushtimi i dallimit ndërmjet pagave — 390.

*Paqja, pacifizmi borgjez* — 135, 157-158, 178-179.

*Partia e Punës e Shqipërisë* — lufta e klasave në Parti

- lufta kundër elementëve armiq antiparti dhe veprimtarisë armiqësore të tyre — 26, 36-37, 98-99, 108, 117, 119-120, 126-127, 185-186, 193, 278, 406-407, 411, 419-420, 450, 451, 455-456, 477-479;
- lufta kundër grupit trockist, antiparti e armiqësor të K. Xoxes e P. Kristos — 451, 477-480, 482;
- lufta kundër veprimtarisë armiqësore antiparti të T. Jakovës e B. Spahiut — 187, 270;
- veprimtaria agjenturore dhe antiparti e L. Belishovës e K. Tashkos dhe lufta kundër saj — 100, 118;
- veprimtaria armiqësore antiparti e F. Paçramit, T. Lubonjës etj. dhe lufta kundër saj — 96-97, 98-99, 118, 202, 207-210, 253-254, 451, 456, 489;
- qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementëve që gabojnë dhe

- bëjnë faje — 9-10, 32-33, 55, 61-62, 64, 102-103, 195, 259-261, 282-283, 287-290, 298-299, 336-337, 343-344, 431, 454-455, 465-467, 481-484, 485, 503-504;
- përjashtimet nga Partia; qëndrimi ndaj të përjashtuarve — 119, 127.
  - Shih edhe:* Grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumës, H. Çakos etj. dhe lufta për shpartallimin e tij.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- *organet udhëheqëse qendrore, në rrethe dhe në ushtri*
    - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretaria-ti i KQ dhe anëtarët e tyre — 1, 2, 3-4, 8, 9, 10-11, 12, 32, 40, 42, 53-54, 55, 56, 59-60, 65-66, 68, 69, 79, 81, 84, 85, 91, 101-103, 105, 111-112, 115, 117, 119, 186, 188, 189, 193, 196, 209-210, 211-212, 217, 221, 253-259, 338, 339, 340, 342-343, 344, 350-351, 352, 353, 355, 392-393, 400, 404, 441, 442, 446, 447, 453, 476, 477, 483, 491, 501-502, 503-504;
    - Plenumi i 12-të i KQ (29 qershor — 1 korrik 1971) — 8, 11, 12, 13, 96, 97, 222, 269;
    - Plenumi i 4-të i KQ (26—28 qershor 1973) — 96, 210, 253-254, 255-256, 504;
    - Plenumi i 5-të i KQ (25—26 korrik 1974) — 45, 53-114, 115-126, 204, 207, 221, 267, 504;
    - Plenumi i 6-të i KQ (16—17 dhjetor 1974) — 395-407, 408-516;
    - aparat i KQ — 93, 293-294, 301, 340, 345, 392-393, 491, 493, 494, 496-497;
    - komitetet e Partisë në rrethe; lidhjet dhe ndihma e tyre për ushtrinë dhe për organet e Punëve të Brendshme — 294-296, 325, 345-346, 350-351, 481-482, 498, 500, 502-503, 508-511;
    - komitetet e Partisë të rretheve të Tiranës e të Gjirokastrës; Komiteti i Partisë i Rajonit nr. 1 të Tiranës — 77, 209, 508-510;
    - komitetet e Partisë në ushtri; lidhjet dhe bashkëpunimi i tyre me terrenin — 120-121, 123, 232-233, 239-240, 244-245, 254, 296, 325, 349-350, 351-352, 361, 420-421, 493;
    - organizatat dhe komiteti

- i Partisë në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore —  
— 184-185, 208-209, 210-211, 217, 223-224, 235, 237, 238-239, 242-244, 258, 351.
- Partia e Punës e Shqipërisë*  
— *vija, vendimet e direktivat; organizimi dhe jeta e brendshme* — 120;
- *vija e përgjithshme; njohja dhe lufta për zbatimin dhe mbrojtjen e saj* — 3, 101, 110-111, 144, 256, 289-290, 292, 501;
  - *roli udhëheqës i Partisë* — 54, 450, 494;
  - *karakteristikat marksiste-leniniste revolucionare* — 54, 55, 289-290, 475, 511;
  - *parimet dhe normat, vendimet, direktivat, detyrat e Partisë; lufta për zbatimin dhe mbrojtjen e tyre* — 72, 101-102, 184-185, 246, 262-263, 335, 349-351, 355-356, 442-443, 447-448, 499-500, 501-503, 506, 508;
  - *uniteti në Parti dhe në udhëheqje, lidhjet me masat; lufta për forcimin e tyre* — 8, 9, 13, 26-27, 41, 56-57, 118, 153, 446;
  - *kolegjialiteti; kapja pas hallkës kryesore* — 346, 436, 499, 505, 506, 507-508;
- *informacioni, informimi në Parti* — 34-35, 82-83, 124, 258, 265-266, 267-268, 293, 298-299, 342, 345, 446-447, 501;
  - *përvoja dhe masat për t'i prerë rrugën revizionizmit në Shqipëri dhe për të çuar përpara revolucionin e ndërtimin e socializmit* — 202-203, 430-431, 478-480, 488-489, 493-494, 504, 511, 512-514.
- Planet, projektplani i 6-të pesëvjeçar (1976-1980)* — 128-130, 148-149.
- Politika e jashtme dhe pozita ndërkombëtare e RPSH*
- *politika e jashtme parimore marksiste-leniniste* — 133-134, 155-156, 158-159, 160-162, 170-171, 172, 174, 180, 313, 370;
  - *solidariteti dhe përkrahja internacionaliste për lëvizjet dhe luftërat çlirimtare dhe revolucionare të popujve* — 131-132, 133, 135-136, 140, 177-178, 369, 370-371;
  - *lufta për demaskimin e imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit* — 159, 161, 162-163, 165, 180, 475;
  - *marrëdhëniet me vendet fqinjë dhe qëndrimet e*

- drejta parimore ndaj tyre — 52, 173-176, 177, 179-180, 381-382, 389;
- qëndrimi ndaj BS, ShBA dhe Anglisë — 137, 138, 167-169, 171-172, 177-178, 308, 382;
- marrëdhëniet me Kinën — 128-130, 366-367;
- solidariteti dhe përkrahja internacionaliste e popujve dhe e forcave përparimtare për RP të Shqipërisë — 132, 133, 170-171, 172-173, 363, 368, 369, 370, 371, 372-373, 375-376.
- Politika në plan të parë; kuptimi politik i problemeve* — 247-248, 292, 296.
- Populli shqiptar — virtytet moralo-politike; traditat patriotike, përparimtare dhe revolucionare* — 63-64, 109, 145, 368-369, 450, 468, 469-470.
- Psikologjia — karakteri i njeriut dhe edukimi i tij* — 459-461, 467-468.

## Q

- Qipro — gjendja e brendshme. Planet dhe ndërhyrjet e superfuqive në këtë rajon* — 49-52, 107, 113, 125, 179-180.

## R

- Revizionizmi modern; mbledhja e partive revizioniste të*

*Evropës në Varshavë (tetor 1974) — 307-308.*

*Revolucionarizimi i Partisë, i pushtetit dhe i njerëzve* — 202-203, 514.

*Revolucioni proletar* — 159-160.

*Roli i masave dhe i udhëheqësve në histori; lufta kundër kultit të individit* — 10-11, 25-26, 44, 65, 72-74, 75-77, 126, 189, 239, 242.

*Rumania — gjendja e brendshme, politika e jashtme* — 164, 176-177, 308-310, 379, 380.

## RR

*Rrethimi dhe presioni imperialisto-revizionist; lufta për përballimin dhe çarjen e tyre* — 58-59, 122, 125, 147-148, 153-154, 165-166.

## S

*Sekreti, sekreti ushtarak; lufta për ruajtjen e tij* — 83-84, 124, 222-223, 294-295, 508, 509-510, 511.

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 57, 112, 119, 138, 284, 333, 337, 347, 380, 471, 482, 486, 488.

*Superfuqitë — strategjia dhe taktikat, politika ekspansioniste, demagogjike dhe hegjemoniste; kriza e tyre* — 50-52, 156-157, 158, 162-164, 165-166, 175, 178-179.

## SH

*Shfaqjet e huaja, lufta kundër tyre* — 58-59, 80-81, 263-264, 300-301, 472, 512-513.

*Shkolla e Lirë Ushtarake* — 93-95, 323-326, 418, 452-454, 495, 498, 512.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës* — *politika e luftës dhe e hegjemonizmit, kriza e kontradiktat. Qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë* — 134-135, 136-137, 140, 150, 158, 163, 171, 177-178, 306.

## T

*Teoria dhe praktika; uniteti dialektik i tyre* — 257, 355.

*Tregtia e brendshme* — *furnizimi i popullsisë* — 147.

*Tregtia e jashtme* — *e kësportit, importit* — 128-130, 147.

## U

*Uniteti i popullit, uniteti Partii-popull* — 27, 36, 122, 141, 153, 372.

*Ushtria Nacionalçlirimtare; roli udhëheqës i Partisë, karakteri popullor* — 482.

*Ushtria Popullore*

- *roli udhëheqës i Partisë; lufta kundër spostimit të Partisë dhe të rolit të saj udhëheqës* — 43, 47, 197, 232-233, 240-241, 242, 294-

-295, 349-351, 352, 405, 420-421, 440, 447-449, 474-475, 476, 482, 483-484, 488, 495, 496-497;

- *detyrat dhe roli i saj për mbrojtjen e atdheut* — 46-47, 108-109, 234-235, 290, 353-355;

- *cilësitë revolucionare, karakteri popullor dhe lidhjet e saj me popullin* — 110, 123, 155, 197, 229-230, 278, 439, 511-512;

- *forcimi, revolucionarizimi, organizimi dhe demokratizimi* — 23, 30, 46-47, 229-230, 232-233, 241-242, 243-244, 278, 295-296, 304-305, 357-358, 359-360, 435-436, 442, 458-459, 475-477, 481-484, 485, 492-493;

- *masat dhe detyrat për shëndoshjen e gjendjes në ushtri gjatë dhe pas shpartallimit të grupit komplotist të B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj.* — 43, 71-72, 120-126, 127, 202-204, 265, 287-290, 299, 303-305, 343-344, 365, 411-412, 419-421, 432-436, 454-455, 458-459, 463-464, 488, 492-494, 503-505, 514-516;

- *armët dhe teknika luftarake. Këmbësoria* — 23, 193-200, 224-225, 297;



- puna edukative, politike dhe ideologjike — 78-79, 123-124, 281-282, 291-293, 340-341, 353-355, 393-394, 443-444, 470-471, 488-490, 493, 497-498;
- edukimi dhe përgatitja ushtarake. Slërvitja ushtarake — 32-33, 110, 199-200, 224-225, 234-235, 253, 256-258, 281-282, 292-293, 324, 353-355, 497-498;
- taktikat ushtarake. Luftimi dhe llojet e luftimit: sulmi, kundërsulmi; goditja, kundërgoditja; mbrojtja; mësymja, kundër-mësymja — 12-24, 28-29, 30-31, 32, 198-199;
- komanda, komandimi në ushtri — 474, 476, 483;
- programet, rregulloret, planet mësimore dhe mësimdhënia në ushtri — 252-253, 286, 354-355, 442;
- urdhrat, vendimet, detyrat luftarake; njohja dhe

lufta për zbatimin e tyre — 296, 356, 359, 420-421, 466;

- Drejtoria Politike — 1, 39, 210-211, 218, 230, 246, 272, 292, 293-294, 340-341, 345, 392-393, 447, 483, 484, 491, 495-496, 499-500, 510.

*Shih edhe:* Grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. dhe lufta për shpartallimin e tij; Kuadrot, kuadrot në ushtri...

*Ushtritë borgjeze e revizioniste* — 212-213, 283-284.

## V

- Vietnami* — lufta e popullit vietnamez për liri e bashkim kombëtar — 131-132, 134-137, 139-140, 157, 163, 177-178.
- Vigjilenca revolucionare* — 78-79, 180, 238, 259, 263, 446, 456, 499, 504.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 6-7, 275, 276, 375.

Aidit, Dipa Nasuntora — 376.

Aleksandër (krall) — 312.

Amazonas, Zhoao — 375.

Aust, Ernst — 375.

Avgji — 58.

### B

Balluku, Beqir — 1, 2, 3-4, 5-6, 7, 8, 9, 11, 13, 15, 16, 17, 19-20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 31, 32, 34, 35-36, 37-45, 53, 54, 55, 56, 59, 60-63, 64-71, 74, 79, 81-83, 84-93, 94, 95, 96, 97-98, 99, 103, 104, 108, 109, 111-114, 116-120, 126, 136, 137, 139, 190-191, 192, 194, 195-196, 198, 200-212, 213, 216, 218-223, 224-232, 233, 234, 236, 237-238, 240, 243, 244, 246, 252, 253, 254-255, 258-259, 260, 262, 264, 265-268, 269-270, 271, 274, 275, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 284, 287, 288, 292, 293, 314, 315, 316, 323-324, 333, 339-340, 341-342, 343, 346, 360,

361-362, 364, 365, 372, 396, 397-399, 400-403, 404-405, 406-407, 408-416, 417, 419, 420, 422-423, 424, 425-426, 427, 436, 437, 439-440, 441-442, 444, 446, 448-449, 450, 451, 452, 453, 457-458, 463, 473, 477, 478, 479-480, 484-485, 486, 487, 489, 491-492, 498, 507, 511.

Bek — 163.

Bekteshi, Sadik — 182-185, 191-192, 211-212, 223, 224, 341, 397, 399, 401, 404, 406, 427, 441, 447, 473 484, 496, 507.

Belishova, Liri — 100, 118.

Benesh, Eduard — 310.

Brezhnjev, Leonid — 51, 137, 158, 169, 170, 302.

### Ç

Çarçani, Adil — 7.

Çako, Hito — 2, 3, 5, 42, 44, 68, 70, 87, 94, 103-104, 182-185, 186-183, 194, 211-212, 223, 224, 227, 236, 240-241, 244, 246, 258, 266-278, 279, 280-281, 282, 284, 285, 287, 289, 294, 300, 301-302, 323-

-324, 340, 341-343, 346, 360,  
361-362, 365, 398, 400, 401,  
402-403, 404-405, 406, 408-411,  
414-415, 419, 420, 422-423,  
424, 425, 426, 427, 431, 432,  
436, 437, 439-440, 441-443,  
444, 446, 447, 448-449, 450,  
451, 452, 453, 457-458, 473-  
-474, 477, 478, 479, 480, 484-  
-485, 486, 487, 491, 492, 496,  
497, 498, 511.

Çipi, Lule — 385.

Çipi, Pëllumb — 384.

Çipi, Qemal — 384, 385, 390,  
391.

Çu En Lai — 4, 266.

## D

Dezh, George Georgiu — 309-  
-310.

Dimitrov, Gjergj — 175.

Dubček, Aleksandër — 168.

Dume, Petrit — 2, 3, 34-36, 40,  
42, 44, 68, 70, 85, 87, 94, 103-  
-104, 184, 188-191, 194, 211-  
-212, 221-222, 223, 235-236,  
237-238, 239, 243, 252, 259,  
266-271, 274-275, 276, 277,  
278, 279, 280-281, 282, 284,  
287, 289, 300, 314-316, 323-  
-324, 339-340, 341-343, 360,  
361-362, 365, 394, 397-399,  
400-403, 404-405, 406, 408-411,  
413-419, 420, 422-423, 424,  
425, 436, 437, 439-440, 441-  
-443, 444, 446, 448-449, 450,  
451, 452, 453, 457-458, 473,

477, 478, 479, 480, 484-485,  
486, 487, 492, 498, 511.

## F

Fillov — 163.

Ford, Xherald — 171.

## G

Gierek, Eduard — 163.

Gorshkov, Sergci — 284.

Grečko, Andrei — 284.

Gromiko, Andrei — 158.

Groza, Petru — 309.

## GJ

Gjino, Vaskë — 444.

## H

Hoxha, Nexhmije — 384.

Hasha, Emil — 163.

Hazbiu, Kadri — 270.

Hitler, Adolf — 163, 170, 171.

Hoxha, Abdullah — 384.

Hoxha, Haki — 384, 385, 386,  
387, 388, 389, 390, 391.

Hoxha, Hysen — 385.

Hoxha, Nasipe — 384-385.

Hrushov, Nikita — 137, 138,  
140, 169, 170, 311, 439, 463,  
479.

Husak, Gustav — 163.

**J**

- Jakova, Ernest — 244, 267, 397.  
 Jakova, Tuk — 187, 270, 437.  
 Jao Ven Juan — 366, 377.  
 Jepishev, Aleksei — 284.

**K**

- Kapo, Hysni, — 2, 5, 7, 8, 41,  
 69, 86-87, 95, 98, 244, 268,  
 275, 276, 314, 315, 325, 400.  
 Kadir, Abd al — 373.  
 Këllezi, Abdyl — 128, 129, 130.  
 Kisinger, Henri — 137, 158.  
 Konjev, Ivan — 487, 507.  
 Kristo, Pandi — 477.

**L**

- Lon Nol — 178.  
 Lubonja, Todi — 96, 98, 99, 118,  
 202, 205, 207, 208-209, 253,  
 451, 456.  
 Lukulusi — 227.  
 Lula, Anastas — 451.

**LL**

- Llakaj, Veli — 406.

**M**

- Marko, Rita — 7.  
 Myftiu, Manush — 6.  
 Makarios, Elefter — 49.

- Malindi, Skënder — 427.  
 Malinovski, Rodion — 284, 487.  
 Mamaqi, Dashnor — 406-407,  
 431.  
 Mao Ce Dun — 4.  
 Masarik, Jan — 310.  
 Mero, Agim — 96-97.  
 Mihael I — 309-310.  
 Mikojan, Anastas — 138, 439,  
 463.  
 Moras, Shari — 463.  
 Musolini, Benito — 463.

**N**

- Napoleon III, Shari Lul Bona-  
 part — 462, 479.  
 Nguyen Huu Tho — 131, 132-  
 -133.  
 Nguyen Thin Bin — 133, 134.  
 Nguyen Van Hien — 133.  
 Nguyen Van Thieu — 135.  
 Nikson. Riçard — 51, 136, 137,  
 158, 171.  
 Nushi, Ksenofon — 384.

**P**

- Paçrami, Fadil — 96, 97, 98,  
 99, 118, 202, 205, 207-209,  
 253, 451, 456, 489.  
 Perllaku, Rahman — 235-236,  
 399, 404, 406, 428.  
 Plaku, Panajot — 100, 118, 298.  
 Poçi, Dilaver — 182-185, 406.  
 Prifti, Ilo — 272, 427.  
 Prodani, Muhamet — 428, 453,  
 474.

## Q

Qiqi, Ilija — 317-318.

Qiqi, Stefan — 318, 319.

## R

Ramohito, Halim — 182-185,  
272, 301, 342, 401, 406, 428.

Rankoviç, Aleksandër — 312.

## S

Sejko, Teme — 298.

Sorrel, Zhorzh — 463.

Suslov, Mihail — 302.

## SH

Shalësi, Spiro — 21, 244, 267,  
397.

Shehu, Mehmet — 5, 87, 95,  
128, 129, 130, 232, 268, 270,  
416.

Shiroki, Viliam — 310-311.

## T

Toska, Haki — 3.

Tashko, Koço — 100, 118.

Tito, Josip Broz — 137-138,  
139, 164, 308, 309, 311, 312,  
380, 381, 382.

Tollbukin, Fjodor — 308.

Toptani, Esat pashë — 227.

Truman, Harri — 171.

Tukaçevski, Mihail — 486, 487,  
488.

## V

Vila, Panço — 373.

Vishinski, Andrei — 112, 309.

## X

Xoxe, Koçi — 477, 478-479, 480,  
482.

## Z

Zapata, Emiliano — 373.

Zogu, Ahmet — 387.

## ZH

Zhivkov, Todor — 163, 175.

Zhukov, Georgi — 439, 463,  
479, 487.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

Adrianopojë (Turqi) — 107.  
Adriatik (deti ~) — 331.  
Afganistan — 163.  
Afrikë — 50.  
Akademia Ushtarake Italiane  
në Modenë — 21.  
Amerika Latine — 373.  
Austri — 163.  
Azi — 373.

### B

Balli Kombëtar — 31.  
Banka e Shtetit Shqiptar —  
345, 509.  
Batalioni partizan «Hakmarr-  
ja» — 473.  
Belgjikë — 172.  
Brigada II Sulmuese e Ushtri-  
së Nacionalçlirimtare Shqiptar-  
e — 24-25, 27-28, 62, 63, 473.  
Bukuresht — 112.  
Bullgari — 175-176, 311, 312.  
Burrel — 317, 318.

### Ç

Çekosllovaki — 163, 168, 310-  
-311.

### D

Dropull (Gjirokastër) — 318.

### F

Francë — 172.

### GJ

Gjermani — 170, 487.  
Gjermania Perëndimore (RF e  
Gjermanisë) — 172, 312.  
Gjirokastër — 77, 384, 385.

### I

Itali — 107, 177.

### K

Kambohia — 163, 178.  
«Kapltali» (Vep. ~, K. Marks) —  
— 249.  
Kili — 113, 149-150.  
Kombinati Metalurgjik (Kom-  
binati metalurgjik «Çeliku i  
Partisë») — Elbasan — 144.

Konferenca e Parisit (Marrëveshja e Parisit) për Vietnamin, 1974 — 134-135, 136-137, 178.

Konferenca «për pakësimin e ekuilibruar të ushtrive» në Vjenë — 158-159.

Konferenca «për sigurimin evropian» në Helsinki — 158-159.

Koreja e Jugut — 178.

Koreja e Veriut (RPD e Koresë) — 178.

Kostandinopojë [Stamboll] (Turqi) — 107.

Kroaci — 311, 312.

Kushtetuta e RPSH — 151.

## L

Legaliteti — 31.

Letra e Hapur e KQ të PPSH (1966) — 420, 485, 496.

Lis (Mat) — 317, 318.

Lufta e Parë Botërore (1914—1918) — 310, 311.

Lufta e Dytë Botërore (1939—1945) — 171, 310, 488.

Lufta e Reçit (gusht 1943) — 473.

## M

Mali i Zi — 311.

Maqedoni — 107, 312.

Mbledhja e partive revizioniste të Evropës (Berlin, 29—30 qershor 1976) — 169.

Mesdhe (zona ~) — 49, 50, 51,

52, 107, 125, 175, 179.

Minoriteti grek në Shqipëri — 318-319.

Moskë — 486.

## N

NATO (Pakti i Atlantikut Verior) — 50, 164, 174, 343, 437.

## O

Oqeani Indian — 50.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Sigurimit — 49, 157, 180.

## P

Pakistan — 163.

Pogradec — 341, 397.

## R

Radio Moska — 167-168.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit — 159.

Romë — 177.

## S

Selanik (Greqi) — 107.

Serbi — 312, 380-381.

Sigurimet Shoqërore Shtetërore — 386-387.

Skandali i Uotergeitit (ShBA) — 150, 158.

Sllloveni — 311, 312.

Suedi — 376.



## SH

Traktati i Varshavës — 50,  
163, 174.Shkolla e Lartë e Partisë «V.  
I. Lenin» — 493.

Turqi — 49, 52, 389.

## T

Tiranë — 145.

## TH

Thrakë — 107.



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 53-TË ..... V—IX

1974

VEPRIMTARI E RREZIKSHME DHE ARMIQËSORE  
E BEQIR BALLUKUT — Diskutim në mbledhjen e  
Byrosë Politike të KQ të PPSH (2-3 korrik 1974) ..... 1—45

USHTRI E VËRTETË E POPULLIT, USHTRI E RE-  
VOLUCIONIT NGADHËNJIMTAR — Përshëndetje  
drejtuar ushtarëve dhe oficerëve me rastin e 31-vje-  
torit të themelimit të Ushtrisë Popullore (10 korrik  
1974) ..... 46—48

QIPROJA DHE PLANET HEGJEMONISTE TË DY  
SUPERFUQIVE NË MESDHEUN LINDOR — Artikull  
i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (24 korrik 1974) 49—52

FORCA E PATHYESHME E UDHËHEQJES MARK-  
SISTE-LENINISTE TË PARTISË SONË QËNDRON  
NË UNITETIN E MENDIMIT DHE TË VEPRIMIT —  
Fjala e mbylljes në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH  
(26 korrik 1974) ..... 53—114

LETËR PËR VEPRIMTARINË ARMIQËSORE TË  
BEQIR BALLUKUT (29 korrik 1974) ..... 115—127

PROJEKTPLANIN E PESËVJEÇARIT TË ARDH-  
SHËM TA STUDIOJMË E TA REALIZOJMË POLI-  
TIKISHT DHE EKONOMIKISHT SHTRËNGUAR —  
Shënime (16 shtator 1974) ..... 128—130

NGA QËNDRIMI I MIQVE DHE I ARMIQVE NDAJ NESH KEMI MËSUAR T'I DUAM ME GJITHË ZEMËR MIQTË DHE T'I URREJMË PA MASË ARMIQ-TË — Nga biseda me një delegacion të Republikës së Vietnamit të Jugut, të kryesuar nga Nguyen Huu Tho (17 shtator 1974) .....	131—140
POLITIKA JONË ËSHTË E HAPUR, ËSHTË POLITIKË E PARIMEVE PROLETARE — Fjala në takim me zgjedhësit e zonës elektorale nr. 209 të Tiranës (3 tetor 1974) .....	141—181
USHTRIA JONË ËSHTË USHTRIA E PARTISË, ME NORMA, ME LIGJE DHE ME IDEOLOGJINË MARKSISTE-LENINISTE — Nga konkluzionet e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 tetor 1974) .....	182—193
TË SPASTROJMË ME FSHESË TË HEKURT VEPRIMTARINË ARMIQËSORE TË BEQIR BALLUKUT, TË NXJERRIM MËSIME PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS SË PARTISË NË USHTRI — Fjala në mbledhjen me kuadrot kryesorë të forcave të armatosura (14 tetor 1974) .....	194—305
NË GJYKIMIN E SITUATAVE DHE NË SHFRYTËZIMIN E KONIUNKTURAVE TË MBAJMË QËNDRIM PARIMOR — Nga biseda me ambasadorin kinez (16 tetor 1974) .....	306—313
MBI NJË LETËR «AUTOKRITIKE» QË MË DËR-GON PETRIT DUMJA (17 tetor 1974) .....	314—316
ATDHEU I TYRE ËSHTË GJITHË SHQIPËRIA — Letër ngushëllimi drejtuar familjes së Ilia Qiqit (30 tetor 1974) .....	317—319
UDHËZIMET NUK MUND TË ZËVENDËSOJNË PUNËN E VËRTETË SQARUESE ME NJERËZIT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (21 nëntor 1974) .....	320—322

- EDHE NJË HERË PËR SHKOLLËN E LIRË USH-TARAKE (22 nëntor 1974) ..... 323—326
- Ç'ËSHTË PËR NE KOMUNISTËT ORGANIZATA-BAZË E PARTISË — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë (25 nëntor 1974) ..... 327—348
- SI DUHET TË FUNKSIONOJNË ORGANIZATAT E PARTISË NË USHTRI — Udhëzime (26 nëntor 1974) ..... 349—362
- SUKSESET NE I KEMI ARRITUR NË SAJË TË VIJËS MARKSISTE-LENINISTE TË PARTISË SONË — Nga biseda me një delegacion të partisë dhe të qeverisë së RP të Kinës (28 Nëntor 1974) ..... 363—367
- PËR MIQTË E VËRTETË SHQIPËRIA ËSHTË E DO TË JETË KURDOHERË E HAPËT — Nga fjala në takimim me delegacionet e huaja që kishin ardhur në Shqipëri me rastin e festës së 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut (28 Nëntor 1974) ..... 368—376
- NE KEMI RRUGËN TONË, KUSH TË DOJË LE TË VIJË ME NE — Nga biseda me kryetarin e delegacionit të partisë dhe të qeverisë së RP të Kinës, Jao Ven Juan (29 Nëntor 1974) ..... 377—383
- NË SHQIPËRI NJERIU E KA JETËN TË SIGURUAR — Nga biseda me emigrantët ekonomikë shqiptarë Haki Hoxha dhe Qemal Çipi nga Izmiri (10 dhjetor 1974) ..... 384—391
- DREJTORIA E KULTURËS DHE E PROPAGANDËS TË MOS MARRË FUNKSIONET E DREJTORISË POLITIKE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (11 dhjetor 1974) ..... 392—394
- E GJITHË PARTIA, POPULLI DHE USHTRIA DËNUAN NJËZËRI TRADHTARËT — Diskutim në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH (16 dhjetor 1974) ..... 395—407

<p>TË THELLOHEMI MË TEJ NË ANALIZËN E KOM-          PLOTIT TË BEQIR BALLUKUT, PETRIT DUMES,          HITO ÇAKOS DHE TË NXJERRIM MËSIME PËR          PUNËN E PARTISË NË USHTRI E NË TERREN —          Fjala e mbylljes në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH          (17 dhjetor 1974) .....</p>	408—518
Treguesi i lëndës .....	519
Treguesi i emrave .....	533
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	537

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1987